

BERTON SULEJMANI
ZEJNEPE ALILI REXHEPI

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

PËR VITIN I
ARSIMI I GJIMNAZIT



BERTON SULEJMANI
ZEJNEPE ALILI REXHEPI

GJUHË SHQIPE
DHE
LETËRSI

PËR VITIN I
ARSIMI I GJIMNAZIT

Arbëria 
Design

Tetovë, 2026

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

PËR VITIN I

ARSIMI I GJIMNAZIT

Botues:

Arbëria Design - Tetovë, 2026

Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës:

Dashmir Ademi

Autorë:

Prof. dr. Berton SULEJMANI, profesor
në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Prof. dr. Zejnepe ALILI REXHEPI, profesoreshë
në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tetovës.

Recensent:

Prof. dr. Salajdin Salihu

Lektore:

Prof. dr. Hana Dardhishta

Përpunimi teknik dhe dizajni:

Afrim Bulica

Valbona Halili

(ArbëriaDesign)

Shtypi:

Arbëria Design - Tetovë

Tirazhi:

2.300 kopje

Me vendim të Komisionit Kombëtar për Tekstet Shkollore për Arsimin Fillor dhe të Mesëm, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 26-842/1, të datës 22.07.2026, miratohet përdorimi i këtij teksti shkollor.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	11
GJUHË DHE KOMUNIKIM	13
RRETH GJUHËS SHQIPE	15
ÇKA ËSHTË GJUHA?	15
KOMUNIKIMI	17
MODELI I PROCESIT TË KOMUNIKIMIT	18
LLOJET E KOMUNIKIMIT	19
KOMUNIKIMI VERBAL DHE JOVERBAL	19
KOMUNIKIMI VERBAL	19
Fjalimi	19
Metagjuha	19
FUNKSIONET E GJUHËS	20
Funksioni informues	20
Funksioni shprehës	20
Funksioni kërkues	20
Funksioni pyetës	20
Funksioni ndërveprues	20
KOMUNIKIMI JOVERBAL	20
Shenjat	21
Sinjalet	22
Simbolet	22
VARIANTET E GJUHËS	23
QYTETET QË NDIKOJNË NË VARIANTIN VERNAKULAR TË SHKUPIT ...	24
GJUHA STANDARDE	26
GJUHA SHQIPE NË FAMILJEN E GJUHËVE INDOEVROPIANE	29
ZHVILLIMI HISTORIK I GJUHËS LETRARE SHQIPE	33
SHKRIMET E PARA HISTORIKE TË GJUHËS SHQIPE	33
DOKUMENTET E PARA TË SHKRIMIT SHQIP	34

GJUHËSIA (LINGUISTIKA)	39
GJUHËSIA DHE DEGËT KRYESORE TË SAJ.....	39
DEGËT KRYESORE TË GJUHËSISË (LINGUISTIKËS).....	40
Fonetika	40
Fonologjia.....	40
Leksikologjia	40
Gramatika	41
FONETIKË DHE FONOLOGJI.....	45
OBJEKTI I FONETIKËS.....	45
NDËRTIMI I FJALËVE ME TINGUJ	45
SI FORMOHEN TINGUJT?	46
1. Fonetika përshkruese (deskriptive)	46
2. Fonetika historike (diakronike)	47
3. Fonetika eksperimentale	47
4. Fonetika e përgjithshme	47
5. Fonetika normative (drejtshqiptimi)	47
RËNDËSIA E STUDIMIT TË FONETIKËS	47
OBJEKTI I FONOLOGJISË	48
VARIANTET E FONEMAVE (ALOFONET)	49
MËNYRA E ARTIKULIMIT (NYJËTIMIT) TË TINGUJVE.....	51
CILAT JANË ORGANET E TË FOLURIT DHE SI NDAHEN ATË?.....	52
SISTEMI FONETIK DHE GRAFIK I GJUHËS SHQIPE.....	55
DALLIMET KRYESORE MIDIS ZANOREVE DHE	
BASHKËTINGËLLOREVE	55
ZANORET DHE KLASIFIKIMI I TYRE.....	55
1. Sipas pozicionit të gjuhës në drejtim horizontal (radhës)	56
2. Sipas pozicionit të gjuhës në drejtim pingul (vertikal) – ngritjes së gjuhës	
drejt qiellzës.....	56
3. Sipas pozicionit të buzëve.....	57
GRUPET (TOGJET) E ZANOREVE DHE DIFTONGJET	57
BASHKËTINGËLLORET DHE KLASIFIKIMI I TYRE.....	60
GRUPET (TOGJET) E BASHKËTINGËLLOREVE	61
NDRYSHIMET FONETIKE TË TINGUJVE.....	62
NDRYSHIMET HISTORIKE	62
I. Ndërrimet metafonike të zanoreve	62
II. Ndërrimet apofonike të zanoreve	62
III. Qiellzorizime e bashkëtingëlloreve	62

NDYSHIMET E GJALLA	63
QIELLZORIZIMI, BUZORËZIMI, VELARIZIMI.....	63
ASIMILIMI.....	63
DISIMILIMI DHE HAPLOLOGJIA.....	64
SHTESAT E TINGUJVE.....	64
RËNIET E TINGUJVE	65
ELIZIONI.....	66
THEKSI.....	67
ÇFARË ËSHTË THEKSI?	67
VEÇORITË E THEKSIT NË GJUHËN STANDARDE SHQIPE.....	67
VENDI I THEKSIT NË FJALË.....	68
THEKSI I FJALISË	68
FJALË QË NUK KANË THEKS	68
FJALË PROKLITIKE DHE ENKLITIKE	69
VENDI I THEKSIT NË FJALËT E PARME, TË PREJARDHURA DHE TË PËRBËRA (KOMPOZITAT)	69
ROLI FONOLOGJIK I THEKSIT	70
DRJETSHKRIM DHE DREJTSHQIPTIM	73
DREJTSHKRIMI I SHKRONJËS Ë	73
ZANORJA Ë E THEKSUAR.....	73
ZANORJA Ë E PATHEKSUAR	74
DREJTSHQIPTIMI I ZANORES Ë	75
DREJTSHKRIMI I FJALËVE KU TAKOHEN DY ZANORE	76
Zanoret e njëjta	76
DREJTSHKRIMI I FJALËVE QË KANË GRUPET YE, UA, UE	77
DREJTSHKRIMI I FJALËVE TË HUAZUARA NGA GJUHËT E HUAJA	78
FJALËT ME BURIM NGA GREQISHTJA E VJETËR DHE LATINISHTJA ..	78
FJALËT ME BURIM NGA ANGLISHTJA	79
FJALËT ME BURIM NGA GJUHËT SLLAVE	79
PËRDORIMI I SHKRONJËS SË MADHE	80
KUR PËRDORET SHKRONJA E MADHE?.....	81
SHKRIMI I FJALËVE NJËSH, NDARAS DHE ME VIZË NË MES.....	83
FJALËT QË SHKRUHEN NJËSH	83
FJALËT QË SHKRUHEN NDARAS.....	84
DREJTSHKRIMI I FJALËVE ME VIZË NË MES/VIZË LIDHËSE	85
FJALË QË NUK SHKRUHEN ME VIZË LIDHËSE	87

SHENJA TË PIKËSIMIT	89
PËRDORIMI I DREJTË I SHENJAVE TË PIKËSIMIT.....	89
SHENJAT E PIKËSIMIT QË PËRDOREN BRENDË FJALISË.....	89
PRESJA ,.....	89
PIKËPRESJA ;.....	89
VIZAT DHE THONJËZAT – („...” ”...”).....	89
DY PIKAT :.....	90
KLLAPAT ().....	90
SHENJAT E PIKËSIMIT QË PËRDOREN NË FUND TË FJALISË	91
PIKA	91
PIKËPYETJA ?	91
PIKËÇUDITJA !	92
TREPIKËSHI	92
APOSTROFI '.....	92
NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT	94
DREJTSHKRIMI I DATAVE	95
FJALËT E SHKURTUARA (AKRONIMET) DHE SHKURTESAT.....	96
SHKURTESAT	96
TË DËGJUARIT, TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT.....	97
TË DËGJUARIT PËR TË KUPTUAR	97
TË LEXUARIT PËR TË KUPTUAR	97
TË SHKRUARIT E TEKSTEVE.....	98
FORMATET E SHKRESAVE TË KOMUNIKIMIT ZYRTAR	98
Si duket një lutje zyrtare	99
Si duket një kërkesë zyrtare	100
KOMUNIKIMI ZYRTAR NË PRAKTIKË	101
FORMATET E SHKRESAVE TË KOMUNIKIMIT JOZYRTAR.....	101
Dallimi midis komunikimit formal dhe joformal.....	102

LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA..... 105

TEORIA E LETËRSISË	107
ARTI DHE ZANAFILLA E TIJ.....	109
ARTI.....	113
LLOJET E ARTIT	117
SHKENCA E LETËRSISË	123

HISTORIA E LETËRSISË	125
TEORIA E LETËRSISË	126
KRITIKA LETRARE	127
NDARJA E LETËRSISË	129
GJINITË LETRARE DHE LLOJET E TYRE	129
LIRIKA, VEÇORITË DHE LLOJET E SAJ	130
TROPET DHE FIGURAT STILISTIKE	145
TROPET	145
FIGURAT STILISTIKE	152
EPIKA, VEÇORITË DHE LLOJET E SAJ	157
LLOJET EPIKE NË VARGJE	159
LLOJET EPIKO-LIRIKE	161
LLOJET EPIKE NË PROZË	164
MITI	173
DRAMATIKA, VEÇORITË DHE LLOJET	179
LLOJET E VEPRËS DRAMATIKE	181
STRUKTURA E VEPRËS LETRARE	193
PËRMBAJTJA DHE FORMA E VEPRËS LETRARE	193
TEMA DHE IDEJA E VEPRËS LETRARE	195
SUBJEKTI DHE KOMPOZICIONI I VEPRËS LETRARE	198
STILI DHE GJUHA E VEPRËS LETRARE	200
LLOJET LETRARO - SHKENCORE	207
BIOGRAFIA	207
AUTOBIOGRAFIA	208
KRONIKA	208
DITARI	209
MEMOARET	209
ESEJA	210
LETËRSIA POPULLORE	213
FOLKLORISTIKA DHE VEÇORITË E SAJ	213
LIRIKA GOJORE	214
EPIKA GOJORE	221
HISTORIA E LETËRSISË SHQIPTARE	227
LETËRSIA E VJETËR SHQIPTARE	229
PAL ENGJËLLI	231

HUMANIZMI NË LETËRSINË SHQIPTARE	235
MARIN BARLETI - SHKODRANI	237
GJON BUZUKU	243
LEKË MATRËNGA	247
PJETËR BUDI	251
FRANG BARDHI	255
PJETËR BOGDANI	259
JUL VARIBOBA	263
ALAMIADA SHQIPTARE	267
NEZIM FRAKULLA	269
HASAN ZYKO KAMBERI	273
MUHAMED KYÇYKU ÇAMI	277
HISTORIA E LETËRSISË BOTËRORE	281
LETËRSIA BOTËRORE	283
PERIODIZIMI I LETËRSISË BOTËRORE	283
LETËRSIA ASIRO - BABILONASE	285
LETËRSIA E LASHTË HEBRAIKE	286
LETËRSIA E LASHTË INDASE	287
LETËRSIA ANTIKE GREKE DHE ROMAKE	287
POEMA: "EPI I GILGAMESHIT"	289
POEMA "ILIADA" E HOMERIT	290
TRAGJEDIA: "ANTIGONA" E SOFOKLIUT	290
KOMEDIA: "BRETOKOSAT" E ARISTOFANIT	292
HUMANIZMI DHE RENESANCA NË LETËRSINË EVROPIANE	305
DANTE ALIGERI	305
FRANÇESKO PETRARKA	311
NOVELA E RENESANCËS	315
XHOVANI BOKAÇO	315
ROMANI KALORSIAK	319
UILLIAM SHEKSPIRI	321
TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA	327
PREZANTIMI ME GOJË DHE FJALIMI	327
ESEJA	330
Të shkruarit krijues	332

NJOHURI MEDIATIKE 335**NJOHURI MEDIATIKE 337**

Fakte dhe opinione.....337

Burimet e informacionit338

Vërtetimi i fakteve338

Paragjykimi dhe manipulimi.....338

Dezinformatë dhe lajmet e rreme339

Manipulimi me imazhe dhe video339

Debatet online ("online") dhe gjuha e urrejtjes339

PARATHËNIE

Ky tekst mësimor është përgatitur për nxënësit e vitit të parë të gjimnazit, në pajtim të plotë me programin e miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Byroja e Zhvillimit të Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Libri është hartuar për nxënësin dhe mësimdhënësin, në përputhje me qëllimet e programit mësimor, për të ndihmuar në zhvillimin e aftësive të nxënësve për të menduar qartë, për t'u shprehur saktë dhe për ta përdorur gjuhën drejt. Qëllimi i tekstit nuk është vetëm t'u japë nxënësve njohuri për gjuhën dhe letërsinë, por edhe t'i udhëheqë drejt zhvillimit të mendimit të qartë, shprehjes së drejtë dhe shkrimit të mirë, duke i ndihmuar ta përdorin gjuhën, si mjet të përditshëm në mësim dhe në jetën shoqërore.

Ky libër është i ndërtuar mbi tri fusha programore: **Gjuhë dhe komunikim, Letërsi, të shprehurit dhe krijimtaria**, si dhe **Njohuri mediatike**. Këto fusha e përbëjnë bazën e përmbajtjes, duke i dhënë librit strukturë të plotë dhe të ndërthurur midis gjuhës, letërsisë, krijimtarisë dhe kulturës mediatike.

Në **pjesën e parë** të tekstit, trajtohet së pari gjuha shqipe. Ajo trajtohet, jo vetëm si mjet për t'u kuptuar me të tjerët, por si një sistem i ndërlidhur rregullash dhe kuptimesh që e përshkon gjithë jetën mendore e kulturore të njeriut. Nxënësit do të njihen me prejardhjen e gjuhës shqipe, me zhvillimin e saj në kohë dhe me dokumentet që e dëshmojnë rrugën e saj deri në ditët tona.

Temat kryesore përfshijnë:

- **Fonetikën dhe fonologjinë**, ku shpjegohen tingujt e gjuhës, mënyra se si formohen e si dallohen;
- **Theksin**, që ndihmon në shqiptimin e drejtë të fjalëve dhe fjalive;
- **Drejtshkrimin**, me të gjitha rregullat që ndihmojnë në të shkruarit e saktë, si dhe përdorimin e shenjave të pikësimit në mënyrë të kuptueshme dhe të natyrshme;
- **Shenja të pikësimit**, si: pika, presja, thonjëzat etj.

Këto përmbajtje nuk ofrohen vetëm në formë teorike, por ndërtohen mbi shembuj konkretë, ushtrime të zgjedhura dhe situata të jetës së përditshme.

Pjesa e dytë e tekstit është nga **lëmi i letërsisë** dhe është hartuar në bazë të programit të letërsisë shqiptare dhe botërore, për shkollat e mesme të vitit të parë të gjimnazit.

Qëllimi i autorëve të tekstit është që t'u ofrojnë nxënësve dituri për zanafillën dhe zhvillimin e letërsisë, periudhat përkatëse, njohuritë teorike, si dhe trajtimin kritik e analizat e kryeveprave letrare.

Teksti i letërsisë përfshin:

- **Teorinë e letërsisë**, me pjesët përkatëse: Arti dhe zanafilla e letërsisë; Shkenca e letërsisë dhe ndarja e saj; Gjinitë dhe llojet letrare (Lirika-Tropet dhe figurat stilistike, Epika dhe Dramatika); Letërsia popullore dhe
- **Historinë e letërsisë**: Letërsia e vjetër shqiptare; Periodizimi i letërsisë shqipe; Periodizimi i letërsisë botërore; Letërsia antike dhe Humanizmi.

Pjesa e tretë e tekstit u kushtohet njohurive mediatike, nëpërmjet të cilave nxënësit njihen me dallimin ndërmjet fakteve dhe opinioneve, me burimet e informacionit dhe me mënyrat e vërtetimit të fakteve. Në këtë pjesë trajtohen edhe paragjykimi, manipulimi, dezinformata, lajmet e rreme, manipulimi me imazhe e video, si dhe debatet onlajn dhe gjuha e urrejtjes. Këto përmbajtje synojnë t'i aftësojnë nxënësit ta kuptojnë më drejt botën mediatike dhe ta përdorin informacionin në mënyrë kritike e të përgjegjshme.

Qoftë ky tekst në shërbim të nxënies dhe të mësimdhënies!

Autorët

Gjuhë dhe komunikim

- RRETH GJUHËS SHQIPE
- GJUHËSI
- TË DËGJUARIT, TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT

RRETH GJUHËS SHQIPE

ÇKA ËSHTË GJUHA?

Gjuha është një sistem që përbëhet nga tinguj, të cilët kur kombinohen në mënyrë të caktuar formojnë fjalë. Fjalët pastaj përdoren për të ndërtuar fjali dhe tekste. Vetëm tingujt nuk kanë kuptim të plotë në vetvete, por kur bashkohen në rend të caktuar, ato krijojnë fjalë që ne i kuptojmë. Për shembull, fjala "dritare" në shqip ka kuptimin e një hapësire në mur që lejon dritën dhe ajrin të hyjnë brenda një ndërtese. Ajo përbëhet nga tingujt "d-r-i-t-a-r-e", të cilët më vete nuk kanë kuptim, por së bashku formojnë një fjalë me domethënie. Në gjuhë të tjera, për të njëjtin objekt përdoren fjalë të ndryshme: në anglisht thuhet "window", në maqedonisht "прозорец", në latinisht "fenestra", ndërsa në kinezisht përdoret fjala "窗户" (chuānghù). Kjo tregon se lidhja mes tingujve dhe kuptimit nuk është natyrore, por e vendosur nga njerëzit që e flasin atë gjuhë. Ne nuk e quajmë një objekt "dritare" sepse ai duket ose tingëllon ashtu, por sepse kështu është rënë dakord në gjuhën shqipe. Kjo marrëveshje e rastësishme quhet lidhje arbitrare.

Gjuhëtari Ferdinand de Sossyri (Ferdinand de Saussure) e shpjegon gjuhën si një sistem shenjash. Sipas tij, çdo fjalë përbëhet nga dy pjesë:

- **Shenjuesi:** forma e fjalës, pra si shqiptohet ajo (p.sh. "d-r-i-t-a-r-e").
- **I shenjuari:** kuptimi që ajo fjalë bart në mendjen tonë (pamja ose ideja e një dritareje).

Fjalët janë shenja gjuhësore, sepse krijojnë lidhje midis tingullit dhe kuptimit. Kjo lidhje ndryshon nga një gjuhë në tjetrën. Edhe pse një objekt është i njëjtë në realitet, njerëz të ndryshëm në kultura dhe gjuhë të ndryshme e quajnë ndryshe.

**Të mos harrojmë!**

- Gjuha ndërtohet nga tinguj që kombinohen për të formuar fjalë me kuptim.
- Tingujt më vete nuk kanë kuptim, por marrin kuptim kur lidhen në një fjalë të njohur.
- Fjalët kanë dy pjesë: shenjuesin (forma e fjalës) dhe të shenjuarin (kuptimi i saj).
- Në gjuhë të ndryshme, të njëjtat objekte ose ide kanë emërtime të ndryshme.
- Lidhja ndërmjet fjalës dhe kuptimit nuk është natyrore, por është arbitrare (e vendosur me marrëveshje).

**Sa kuptove?**

- Çka është shenjuesi dhe i shenjuari në një fjalë?
- Pse fjala 'dritare' nuk kuptohet nga dikush që nuk flet shqip?
- Çfarë tregon fakti që gjuhë të ndryshme kanë fjalë të ndryshme për të njëjtin objekt?
- Çfarë do të thotë që lidhja ndërmjet fjalës dhe kuptimit është arbitrare?

**Kuptimi i fjalëve të reja**

- **Shenjues** – forma e fjalës që dëgjojmë ose shqiptojmë; tingujt që e përbëjnë fjalën.
- **I shenjuari** – kuptimi që kemi në mendje kur dëgjojmë një fjalë; objekti ose ideja që ajo përfaqëson.
- **Shenjë gjuhësore** – bashkimi i formës dhe kuptimit të një fjale; lidhja mes shenjuesit dhe të shenjuarit.
- **Arbitrare** – që nuk ka lidhje të natyrshme me kuptimin, por është vendosur me marrëveshje nga njerëzit.

KOMUNIKIMI


Komunikimi është procesi përmes të cilit një person i përcjell një informacion një personi tjetër ose një grupi personash. Megjithëse mund të duket i thjeshtë në pamje të parë, në të vërtetë është një veprim mjaft kompleks, sepse në të marrin pjesë shumë faktorë. Njerëzit komunikojnë ndërmjet tyre në mënyra të ndryshme: duke folur, duke shkruar, me gjeste, mimikë, shenja ose duke i kombinuar këto forma.

Komunikimi ndodh atëherë kur dërguesi i një mesazhi, pra folësi, shkruesi ose ai që dërgon një sinjal të caktuar, përdor një kod për të formuar mesazhin. Ky kod mund të jetë një fjalë e shqiptuar, një fjali e shkruar, një shenjë komunikacioni, një gjest ose ndonjë mënyrë tjetër e të shprehurit. Mesazhi më pas i drejtohet marrësit, që mund të jetë dëgjues, lexues ose shikues dhe kalon përmes një kanali komunikimi. Ky kanal mund të jetë ajri (nëse komunikimi bëhet me zë), letra (nëse komunikimi është i shkruar), ekrani i një telefoni apo kompjuteri (nëse është digjital) etj. Mesazhi udhëton në këtë kanal në formë të koduar. Në komunikimin e folur, fjalët si: "s-h-k-o" ose "l-o-j-ë" janë shembuj të fjalëve që formohen nga tinguj të veçantë, të shqiptuar një nga një, për të ndërtuar kuptimin e plotë.

Nëse marrësi e një gjuhën në të cilën është formuar ky kod, ai arrin ta deshifrojë mesazhin dhe ta kuptojë atë ashtu siç është synuar nga dërguesi. Kjo nënkupton se komunikimi ka funksionuar me sukses. Por, në rast se marrësi nuk e kupton menjëherë kuptimin e mesazhit, ai përpiqet të gjejë domethënien përmes mjeteve të tjera: duke marrë parasysh rrethanat, fjalët përreth saj ose kontekstin e përgjithshëm të fjalisë. Nëse marrësi arrin ta kuptojë fjalën apo mesazhin falë këtij konteksti, atëherë komunikimi sërish quhet i suksesshëm. Por, nëse as kjo përpjekje nuk sjell kuptim të qartë, atëherë komunikimi dështon. Marrësi nuk mund të reagojë siç duhet ose nuk jep përgjigje fare. Në raste të tilla, dërguesi mund të vazhdojë përpjekjet për të bërë të kuptueshëm mesazhin, duke përdorur mjete shtesë si gjestet, mimikat ose një mënyrë më të thjeshtë e më të qartë të shprehjes.

Pra, komunikimi nuk është vetëm përdorimi i fjalëve, por një proces i ndërlikuar që përfshin kodimin e mesazhit, dërgimin përmes një kanali, deshifrimin nga marrësi dhe më në fund dhënien e një përgjigjeje. Gjatë këtij procesi mund të lindin pengesa, por përpjekja për ta realizuar me sukses është thelbësore në çdo marrëdhënie njerëzore.

MODELI I PROCESIT TË KOMUNIKIMIT



Të mos harrojmë!

- Komunikimi ndodh kur një person i përcjell një informacion një tjetri.
- Ai përfshin: dërguesin, mesazhin, kanalin, marrësin dhe përgjigjen.
- Nëse mesazhi nuk kuptohet, mund të ndodhin keqkuptime.
- Pengesat si zhurma ose fjalët e panjohura e bëjnë komunikimin më të vështirë.



Sa kuptove?

- Kush është dërguesi në një situatë komunikimi?
- Çfarë ndodh kur marrësi nuk e kupton mesazhin?
- Si mund të ndihmojmë dikë ta kuptojë më mirë një fjalë të panjohur?



Kuptimi i fjalëve të reja

- **Kodim** – mënyra se si dërguesi **formon mesazhin** në mendjen e tij dhe e shpreh atë në një formë që mund të kuptohet nga marrësi (me fjalë, me gjepte, me shenja etj.).
- **Dekodim** – **kuptimi i mesazhit** nga ana e marrësit, pra si ai e shpjegon dhe e kupton mesazhin që ka marrë nga dërguesi.
- **Kanal** – rruga ose mjete nëpërmjet të cilit mesazhi shkon nga dërguesi te marrësi, si zëri, letra, telefoni, interneti etj..

LLOJET E KOMUNIKIMIT

KOMUNIKIMI VERBAL DHE JOVERBAL

KOMUNIKIMI VERBAL

Komunikimi verbal realizohet përmes gjuhës së folur. Që ky lloj komunikimi të ndodhë, të dyja palët duhet të kuptojnë gjuhën në të cilën përcillet mesazhi. Komunikimi verbal mund të jetë njëkahësh ose dykahësh/i ndërsjellë. Në komunikimin dykahësh, folësi dhe dëgjuesi ndërrojnë rolet gjatë bashkëbisedimit, duke shkëmbyer mesazhe. Ky lloj komunikimi ndodh në biseda të përditshme, në familje, në shoqëri, në telefon, në debate apo në thirrje me kamerë përmes aplikacioneve të ndryshme, si: *WhatsApp*, **Viber**, **Messenger**, **Zoom**, **Google Meet**, *Skype* etj. Në anën tjetër, komunikimi verbal njëkahësh ndodh kur vetëm njëra palë flet dhe pala tjetër vetëm dëgjon, si në rastin e radios apo televizionit.

Fjalimi

Fjalimi është të folurit para një grupi dëgjuesish, zakonisht me një përmbajtje të përgatitur më parë, për të dhënë informacion, për të shpjeguar një temë, për të treguar qëndrime ose për të bindur dëgjuesin. **Për shembull: Një nxënës që lexon një ese për Kongresin e Manastirit të vitit 1908 para klasës, po mban një fjalim.**

Metagjuha

Metagjuha është kur flasim për vetë gjuhën, për rregullat e saj, për ndërtimin e fjalive, për kuptimin e fjalëve ose për pjesët e ligjëratës. Pra, është gjuha që përdorim për të shpjeguar si funksionon vetë gjuha. Metagjuha përdoret në situata si:

- Kur profesori thotë: "*Folja tregon veprim ose gjendje*", po përdor metagjuhë.
- Kur themi: "*Kjo fjali është e thjeshtë ose fjali e përbërë (periudhë)*", po flasim për ndërtimin e fjalisë, pra po përdorim metagjuhë.
- Kur dikush pyet: "*Çfarë do të thotë kjo fjale?*" – është gjithashtu metagjuhë, sepse po flasim për kuptimin e një fjale.

FUNKSIONET E GJUHËS

Funksioni informues:

Ky funksion përdoret kur japim një fakt ose informacion për diçka.

Për shembull: *Mësimi fillon në orën 13:30.*

Funksioni shprehës:

Përdoret kur tregojmë ndjenjat, mendimet ose qëndrimin tonë.

Për shembull: *Jam shumë i gëzuar sot.*

Funksioni kërkues:

Përdoret kur kërkojmë diçka, japim një udhëzim ose bëjmë një lutje.

Për shembull: *Ma jep fletoren, të lutem!*

Funksioni pyetës:

Përdoret kur duam të dimë diçka dhe bëjmë pyetje.

Për shembull: *A e ke lexuar tekstin?*

Funksioni ndërveprues:

Përdoret kur përshëndesim ose mbajmë lidhje me të tjerët gjatë bisedës.

Për shembull: *Mirëdita! – Si je?*

KOMUNIKIMI JOVERBAL

Komunikimi joverbal është një mënyrë tjetër e të shprehurit, ku nuk përdoret gjuha, por elemente të tjera si: gjestikulacioni, mimika, qëndrimi i trupit, veshja apo simbole të tjera. Ky lloj komunikimi është veçanërisht i rëndësishëm për personat me dëgjim të dëmtuar, por përdoret edhe nga të gjithë në situata të ndryshme për të ndihmuar apo përforcuar fjalët. Për shembull, kur flasim me dikë që nuk e kupton gjuhën tonë e përdorim gjestikulacion për të shpjeguar një mesazh apo për t'u kuptuar më lehtë.

Gjuhën e trupit dhe mimikat i përdorim çdo ditë, shpesh pa e vënë re, për të shprehur emocione si gëzim, hidhërim, kënaqësi apo mospajtim. Edhe veshja ose mënyra si qëndrojmë mund të përçojnë një mesazh. Gjestet dhe shenjat mund të kenë kuptime të ndryshme në kultura të ndryshme.

Për shembull, ngritja e gishtit tregues në kulturën tonë tregon numrin një, por në kultura të tjera mund të konsiderohet ofenduese. Po ashtu, pohimi me kokë poshtë-lart te një kosovar është i zakonshëm, ndërsa për dikë nga Shqipëria mund të ketë kuptim të kundërt.

Komunikimi joverbal mund të realizohet përmes duarve (gjestikulacion), lëvizjeve të fytyrës (mimikë) apo simboleve të tjera që ndihmojnë në shprehjen e qëndrimeve dhe ndjenjave. Këto shenja na ndihmojnë të kuptohemi më shpejt dhe më qartë, edhe kur nuk flasim.

Shenjat e komunikacionit janë pjesë e rëndësishme e komunikimit joverbal, sepse ato përcjellin rregulla dhe paralajmërime për drejtuesit e mjeteve dhe këmbësorët. Këto shenja kuptohen pa pasur nevojë të flasim.

-  Semafori i kuq – ndalim;
-  Semafori i gjelbër – lejohet kalimi;
-  Trekëndëshi me shenjen e rrezikut – kujdes, rrezik;
-  Rrethi me vijë të kuqe – ndalim hyrje;
-  Shenja me P – vendparkim;
-  Shenja me njeri në kalim – vijë e bardhë për këmbësorë.

Përveç shenjave të komunikacionit, ne përballemi çdo ditë edhe me shenja të tjera që përdoren në ambiente të ndryshme për të na dhënë informacion. Ato janë të zakonshme dhe kuptohen lehtë nga të gjithë.

-  Simboli i telefonit – tregon vendin ku ka telefon;
-  Shenja me karikues / Shenja për mbushje – vend për të karikuar pajisje / vend ku mund të mbushësh telefonin ose pajisje të tjera me rrymë;
-  Piktogrami me shkronjën 'i' – informacion;
-  Shenja me një figurë që tregon derë – dalje emergjente.

Shenjat

Shenjat janë gjeste, figura, shkrime apo vizatime që përdoren për të treguar ose për të na kujtuar diçka. Ato janë të pranishme në jetën e përditshme dhe luajnë rol të rëndësishëm në komunikimin joverbal. **Për shembull:** ngritja e dorës në klasë për të marrë fjalën është një shenjë që ka kuptim të njohur për të gjithë pjesëmarrësit në komunikim.

Sinjalet

Sinjalet janë shenja të vendosura sipas një marrëveshjeje që japin udhëzime të qarta dhe që interpretohen njësoj nga të gjithë. Ato mund të jenë zanore, pamore apo elektronike. **Për shembull:** *sinjali i dritës së gjelbër në semafor tregon që këmbësorët mund të kalojnë rrugën.*

Simbolet

Simbolet janë shenja që përfaqësojnë një ide, ndjenjë ose koncept të caktuar, shpesh pa një lidhje të drejtpërdrejtë me kuptimin që mbartin. Kuptimi i tyre është i vendosur nga kultura apo marrëveshja shoqërore. **Për shembull:** zemra ♥ simbolizon dashuri; kryqi i kuq + simbolizon ndihmën e shpejtë ose ndonjë institucion shëndetësor.



Të mos harrojmë!

- Komunikimi verbal përdor gjuhën e folur. **Komunikimi verbal përfshin si të folurën, ashtu edhe të shkruarën.** Të dyja format, edhe e folura edhe e shkruara, kanë të përbashkët përdorimin e **gjuhës si mjet për të përcjellë mesazhin**, dhe për këtë arsye bëjnë pjesë në komunikimin verbal.
 - E folura është një formë e komunikimit verbal që ndodh përmes zërit, si për shembull në biseda, ligjërata, intervista apo diskutime të përditshme.
 - E shkruara është po ashtu pjesë e komunikimit verbal, pasi përdor gjuhën në formë të shkruar, si në letra, mesazhe, libra, apo email-e.
- Komunikimi joverbal përdor gjeeste, mimika dhe elementë të tjerë të trupit.
- Komunikimi mund të jetë njëkahësh (një flet, tjetri dëgjon) ose dykahësh (bashkëbisedim).
- Gjestet dhe shenjat mund të kenë kuptime të ndryshme në kultura të ndryshme.
- Mimika ndihmon në shprehjen e ndjenjave dhe qëndrimeve pa fjalë.



Sa kuptove?

- Çfarë është komunikimi verbal dhe ku e përdorim më shpesh?
- Si realizohet komunikimi joverbal?
- Përmend një situatë kur përdorim mimikën për të shprehur një ndjenjë?



Kuptimi i fjalëve të reja

- **Verbal** – që ka të bëjë me të folurën, me fjalët që shqiptohen me zë.
- **Joverbal** – që nuk përdor të folurën, por shprehje me trup, mimikë ose shenja.
- **Gjesticulacion** – lëvizje të duarve ose trupit që përdoren për të përcjellë një mesazh.
- **Mimikë** – shprehje të fytyrës që tregojnë ndjenja si: gëzim, zemërim, habi etj.
- **I ndërsjellë** – kur në komunikim marrin pjesë të dy: njëri flet, tjetri dëgjon dhe pastaj ndërrojnë rolet.

VARIANTET E GJUHËS

Gjuha është mjeti më i rëndësishëm për komunikim mes njerëzve. Ajo na ndihmon të shprehim mendimet, ndjenjat, përvojat tona dhe të kuptohemi me të tjerët. Por, gjuha nuk përdoret njësoj nga të gjithë. Njerëzit që jetojnë në qytete, fshatra apo rajone të ndryshme nuk flasin në të njëjtën mënyrë. Ata përdorin fjalë, forma dhe shqiptim të ndryshëm. Këto dallime quhen **variante të gjuhës**.

Një variant është një mënyrë e veçantë e të folurit që përdor një grup njerëzish për të komunikuar. Shpesh, variantet janë të ngjashme dhe kuptohen lehtë mes njëri-tjetrit. P.sh.: një strugan dhe një kumanovar mund të flasin ndryshe, por kuptohen pa vështirësi. Ndërsa, në raste të tjera, si mes një tetovari dhe një korçari, dallimet janë më të mëdha. Ata flasin të njëjtën gjuhë, shqip, por aq ndryshe, sa komunikimi mes tyre bëhet më i vështirë, megjithatë jo i pamundur. Këto quhen **dallime dialektore**.

Ka raste kur disa gjuhë janë shumë të ngjashme dhe mund të kuptohen mes vete, por për arsye politike ose kombëtare, ato ndahen si gjuhë të ndryshme. Kjo ka ndodhur me serbishten, kroatishten, boshnjakishten dhe malazezishten. Edhe pse këto gjuhë janë shumë të ngjashme, secili popull dëshiron ta quajë të veten si gjuhë më vete.

Në rastin e shqipes, ajo është gjuhë zyrtare në dy shtete: në Shqipëri dhe në Kosovë. Në Maqedoninë e Veriut, shqipja është në përdorim zyrtar në disa komuna dhe në institucione publike. Në Serbi, përdoret zyrtarisht në komunën e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjes, ndërsa në Mal të Zi, është një nga gjuhët në përdorim zyrtar në Ulqin, Tuz dhe Plavë.

Në gjuhësi, variantet e gjuhës ndahen në dy lloje kryesore: **variante gjeografike** dhe **variante shoqërore**.

Variantet gjeografike lidhen me vendin ku flitet gjuha. Ato përfshijnë dialektet (si gegërishtja dhe toskërishtja), nëndialektet dhe të folmet vendore. Shqipja ka dy kryedialekte: **gegërishten** dhe **toskërishten**, të cilat kanë dallime në shqiptim, fjalor dhe strukturën e fjalisë. Por, kryedialektet e shqipes i përkasin së njëjtës gjuhë dhe janë të kuptueshme në masë të madhe.

Variantet shoqërore quhen ndryshe edhe **sociolekte**. Këto nuk varen nga vendndodhja, por nga grupet shoqërore. Për shembull, të rinjtë përdorin fjalë e shprehje që të moshuarit nuk i përdorin. Një nxënës mund të thotë: "*Je top*", "*Qet film*", "*Është tip i mirë*" ose "*Mos u nal*", që për një të rritur mund të mos ketë kuptim të menjëhershëm. Po ashtu, një mjek, një mësues apo një teknik kanë fjalor specifik që lidhet me profesionin e tyre. Mënyra e të folurit mund të ndryshojë edhe nga niveli i shkollimit apo mënyra e jetesës.


Kur shumë njerëz me të folme të ndryshme jetojnë në të njëjtin qytet, zakonisht krijohet një mënyrë e përbashkët komunikimi që të gjithë e kuptojnë dhe e përdorin. Kjo mënyrë e përbashkët e komunikimit quhet **vernakular**. Vernakulari është një formë e thjeshtuar, praktike dhe e përbashkët e të folurit në qytet. Nuk është gjuha standarde, por është e zakonshme në përditshmëri. Një shembull është qyteti i Shkupit, ku jetojnë shqiptarë nga shumë qytete, si: Tetova, Kumanova, Struga, Gostivari, Dibra, Prilepi, Kërçova, Manastiri, Prespa etj. Çdonjëri sjell mënyrën e vet të të folurit. Me kalimin e kohës, ata përshtaten me një të folme të përbashkët që është e kuptueshme për të gjithë – ky është vernakulari i Shkupit.

Edhe kur njerëzit shpërngulen nga fshati në qytet, ata shpesh e ndryshojnë pak nga pak të folurën e tyre. Përdorin fjalë të reja, shmangin forma që nuk kuptohen nga të tjerët dhe i afrohen mënyrës së të folurit të shumicës.

Këto dukuri gjuhësore, pra ndryshimet në gjuhë për shkak të vendit, grupit, profesionit apo jetesës i studion një degë e gjuhësisë që quhet **sociolinguistikë**. Ajo na ndihmon të kuptojmë se si shoqëria ndikon në gjuhën që flasim dhe si gjuha ndryshon në varësi të mjedisit social ku përdoret.

QYTETET QË NDIKOJNË NË VARIANTIN VERNAKULAR TË SHKUPIT

Kjo skemë paraqet qytete ku shqiptarët përbëjnë shumicën ose një pjesë të madhe të popullsisë në Maqedoninë e Veriut. Të folmet e këtyre qyteteve, përmes bashkëjetesës dhe komunikimit të përditshëm në Shkup, ndërthuren dhe formojnë një mënyrë të përbashkët të të folurit, e cila njihet si vernakular.



— Qytetet që ndikojnë në variantin gjuhësor të Shkupit

**Të mos harrojmë!**

- Gjuha nuk flitet njësoj në të gjitha vendet apo grupet shoqërore.
- Variantet janë forma të ndryshme të të folurit brenda së njëjtës gjuhë.
- Shqipja ka dy kryedialekte: gegërishten dhe toskërishten.
- Dialektet janë variante gjeografike; sociolektet janë variante shoqërore.
- Vernakulari është e folmja e përbashkët në qytetet e mëdha, si Shkupi, Prishtina, Tirana etj.
- Sociolinguistika studion ndikimin që ka shoqëria mbi gjuhën.

**Sa kuptove?**

- Çfarë është një variant gjuhësor?
- Si ndryshon një dialekt nga një sociolekt?
- Cilat janë disa veçori të gegërishtes dhe toskërishtes?
- Si krijohet një vernakular dhe pse është i nevojshëm?
- Në cilat vende shqipja është në përdorim zyrtar jashtë Shqipërisë?
- Me çfarë merret sociolinguistika?

**Kuptimi i fjalëve të reja:**

- **Variant** – është një mënyrë e ndryshme e të folurit brenda së njëjtës gjuhë. Njerëzit që jetojnë në zona të ndryshme mund të flasin pak ndryshe, por sërish kuptohen.
- **Dialekt** – është mënyra e të folurit që lidhet me një krahinë të caktuar. Dialektet ndryshojnë në shqiptim, fjalor dhe ndonjëherë edhe në ndërtimin e fjalisë. P.sh.: në një vend thuhet “**fëmijë**”, ndërsa në një tjetër “**kalama**”.
- **Sociolekt** – është mënyra e të folurit që përdoret nga një grup shoqëror, si për shembull të rinjtë, të moshuarit apo një grup profesionistësh.
- **Vernakular** – është e folmja e përbashkët dhe praktike që krijohet në qytetet e mëdha, ku bashkëjetojnë njerëz nga zona të ndryshme. Ata ndërtojnë një mënyrë të të folurit që e kuptojnë të gjithë.
- **Izoglosa** – është një vijë imagjinare që ndan dy zona ku fliten forma të ndryshme të së njëjtës gjuhë. Ajo tregon ndryshimin në fjalë apo shqiptim mes dy vendeve.
- **Sociolinguistikë** – është disiplina shkencore që studion lidhjen mes gjuhës dhe shoqërisë. Ajo analizon si ndikon mosha, kultura, vendi apo profesioni në mënyrën si flasim.

GJUHA STANDARDE


Kur një popull arrin një shkallë të caktuar zhvillimi kulturor, ekonomik dhe politik, lind nevoja për të lehtësuar komunikimin brenda tij. Kjo arrihet duke zvogëluar dallimet gjuhësore, sidomos ato dialektore, që mund ta bëjnë të vështirë të kuptuarin mes njerëzve që flasin të njëjtën gjuhë. Për këtë arsye, elitat kulturore, me mbështetjen e elitave politike, vendosin për një **gjuhë standarde**, pra një formë të përbashkët të gjuhës që përdoret në jetën publike.

Gjuha standarde përdoret në shkollë, në administratë, në media, në libra, në konferenca shkencore, pra, në të gjitha rrethanat ku njerëzit me variante të ndryshme të gjuhës duhet të kuptohen lehtësisht me njëri-tjetrin. Ajo ka rregulla të qarta dhe të njëjta për të gjithë folësit, në drejtshkrim, shqiptim dhe përdorim. Megjithatë, **dialektet dhe sociolektet** vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e gjuhës sonë. Ato përdoren çdo ditë në familje, në shoqëri, në art, si në letërsi, në film, në këngë dhe pasurojnë gjuhën në mënyrë të vazhdueshme.

Nevoja për një variant të përbashkët të gjuhës shqipe është shfaqur ndër shekuj. Për shembull, **këngëtarët e folklorit dhe interpretuesit e Kanunit** janë përpjekur të përdorin forma të shqipes që kuptoheshin nga të gjithë, pavarësisht prejardhjes dialektore. Këto forma të përbashkëta quhen **koine**, pra forma që kalojnë kufijtë e një dialekti të vetëm.


Me zhvillimin e shoqërisë shqiptare, u bë e domosdoshme të vendosej zyrtarisht **një variant i vetëm i gjuhës për përdorim kombëtar**. Kjo u përpoq të arrihej nga **Komisia Letrare Shqipe** në Shkodër në vitet 1916–1917. Më pas, në **Kongresin Arsimor të Lushnjës** në vitin 1920, u vendos që e **folmja e Elbasanit** të përdorej si formë bazë në shkollë, administratë dhe media.

Ky proces u përmbyll përfundimisht në vitin **1972**, kur në Tiranë u mbajt **Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe**, në të cilin u vendos që **baza e gjuhës standarde shqipe** të ishte **dialekti jugor – toskërishtja**, me përfshirje edhe të elementeve nga gegërishtja. Në këtë kongres morën pjesë përfaqësues nga të gjitha trevat shqiptare dhe më gjerë, përfshirë edhe **tre delegatë nga Maqedonia: Petro Janura, Remzi Nesimi dhe Sefedin Sulejmani**.



Pas këtij vendimi, **gjuha standarde shqipe** përdoret në domenin publik dhe njihet me emra të ndryshëm: **gjuhë standarde**, **gjuhë e përbashkët**, **gjuhë e njësuar**, apo **gjuhë letrare**. Por duhet bërë dallimi: **gjuha letrare** nuk është një variant më vete, siç janë dialekti apo standardi, por një **stil shkrimi** që përdoret në krijimtarinë letrare. Ky stil është më figurativ, më i lirshëm dhe nuk ndjek gjithmonë rregullat e standardit.

Prandaj, **gjuha standarde** dhe **gjuha e letërsisë** nuk janë e njëjta gjë. Letërsia mund të shkruhet në gjuhën standarde, por mund të përdorë edhe forma dialektore apo sociolektore, sepse ka nevojë për shprehje të lira, të ndjeshme e krijuese që e tejkalojnë komunikimin e zakonshëm.



— Delegatët pjesëmarrës në Komisinë Letrare Shqipe në Shkodër në vitet 1916–1917

— Pjesëmarrësit në Kongresin Arsikor të Lushnjës të vitit 1920 ku u vendos që e folmja e Elbasanit të përdorej si formë bazë në shkolla, administratë dhe media





Disa nga delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, Tiranë, 20 – 25 nëntor 1972



Të mos harrojmë!

- Gjuha standarde është forma e përbashkët e gjuhës që përdoret në jetën publike.
- Ajo përdoret në shkolla, media, administratë, libra dhe komunikim zyrtar.
- Dialektet dhe sociolektet nuk zhduken, por bashkëjetojnë dhe pasurojnë gjuhën.
- Në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe në Tiranë (1972) u vendos që baza e shqipes standarde të ishte toskërishtja me përfshirje edhe të elementeve nga gegërishtja.
- Gjuha letrare nuk është një variant më vete, por një stil artistik që përdoret në letërsi.



Sa kuptove?

- Pse nevojitet një gjuhë standarde?
- Ku përdoret gjuha standarde shqipe?
- Çfarë është koineja dhe kur është përdorur në historinë e shqipes?
- Çfarë vendosi Kongresi i Drejtshkrimit i vitit 1972?
- Cili është ndryshimi mes gjuhës standarde dhe gjuhës letrare?



Kuptimi i fjalëve të reja

- **Gjuha standarde** – forma e përbashkët e gjuhës që përdoret në komunikimin zyrtar dhe publik.
- **Koine** – mënyrë e të folurit që i tejkalon dallimet dialektore për të krijuar një formë të përbashkët.
- **Domen publik** – fusha të jetës publike si shkolla, media, administrata dhe shkenca.
- **Stil letrar** – mënyra e të shkruarit në letërsi, që përdor figura dhe liri shprehëse.
- **Njësim gjuhësor** – procesi i përzgjedhjes së një forme të përbashkët të gjuhës për të gjithë folësit.

GJUHA SHQIPE NË FAMILJEN E GJUHËVE INDOEVROPIANE

Në botë sot fliten mbi 7.000 gjuhë të ndryshme, të shpërndara në mënyrë të pabarabartë. Evropa numëron rreth 287 gjuhë, ndërsa numri më i madh flitet në Azi (rreth 2.294 gjuhë) dhe Afrikë (rreth 2.144 gjuhë). Edhe Amerika ka një larushi të madhe gjuhësore, me rreth 1.061 gjuhë. Megjithatë, kjo shumësi është e brishtë. Në 50 vitet e fundit janë zhdukur mbi 250 gjuhë, dhe sot rreth 2.500 gjuhë janë në rrezik. Disa prej tyre kanë vetëm një folës të vetëm, zakonisht në zona të izoluar të Australisë, Paqësorit dhe Amerikës Latine. Me vdekjen e atij personi, gjuha shuhet, sepse – siç thuhet shpesh – "nuk ka më me kë të flasë".

Shkenca e gjuhësisë i ka klasifikuar këto gjuhë në familje apo grupe gjuhësh, sipas **prejardhjes (gjenealogjisë)** në më shumë se 20 familje (gjuha shqipe bën pjesë në **familjen e gjuhëve indoevropiane**), dhe sipas **tipareve morfologjike apo tipologjike**, në katër grupe kryesore (gjuha shqipe bën pjesë në grupin e gjuhëve **flektive (sintetike nyjëtimore)**):

1. **Gjuhë izoluese (analitike izoluese)** – ku fjalët nuk ndryshojnë formë dhe kuptimi shprehet me renditjen e tyre në fjali. Shembull: kinezishtja, vietnamezja. Në traditën më të vjetër mund të haset edhe emërtimi gjuhë njërrrokëshe.
2. **Gjuhë aglutinative (sintetike ngjitëse)** – ku fjalëve u shtohen prapashtesa të dallueshme për çdo funksion gramatikor. Shembull: turqishtja, finlandishtja.
3. **Gjuhë flektive (sintetike nyjëtimore)** – ku një formë e vetme shpreh njëkohësisht disa kategori gramatikore, si numri, rasa, gjinia dhe trajta. P.sh.: fjala "vajzave" shpreh njëherësh: shumësin, gjininë femërore, rasën dhanore dhe trajtën e shquar. Në këtë grup bëjnë pjesë gjuha shqipe, latinishtja, greqishtja, gjermanishtja, anglishtja etj.
4. **Gjuhë polisintetike (apo inkorporuese)** – ku fjalët janë shumë të përbëra dhe përfshijnë kuptimin e të gjithë fjalive. Shembull: gjuhët eskimeze, amerindiane.

Gjuha shqipe, që e ka prejardhjen nga ilirishtja, bën pjesë në **familjen e gjuhëve indoevropiane**. Kjo familje përfshin gjuhë me një burim të përbashkët, të folura që nga lashtësia në një hapësirë të gjerë që shtrihet nga India deri në Evropë. Ajo përfshin shumë gjuhë, disa që fliten ende sot dhe disa që janë zhdukur.

Shqipja, greqishtja dhe armenishtja janë gjuhë të veçanta, secila më vete. Ndërsa, nga ana tjetër, flitet për grupe gjuhësh si grupi i gjuhëve sllave (rusishtja, polonishtja, çekishtja, serbokroatishtja, bullgarishtja etj.), grupi i gjuhëve

romane (italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, rumanishtja etj.), grupi i gjuhëve gjermanike (gjermanishtja, anglishtja, danishtja, norvegjishtja, suedishtja etj.) e të tjera.

Këto gjuhë kanë ngjashmëri të shumta mes tyre. Sa më larg të shkojmë në histori, aq më qartë duken këto ngjashmëri dhe lidhje, gjë që tregon se kanë një prejardhje të përbashkët. Edhe pse gjatë historisë kanë pësuar ndryshime të mëdha, gjuhët indoevropiane kanë ruajtur disa tipare të përbashkëta që i dallojnë nga familjet e tjera gjuhësore.

Gjuha shqipe ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve. Gjuhëtari gjerman **Franz Bopp** (Franz Bopp) ishte i pari që vërtetoi se ajo i përket familjes së gjuhëve indoevropiane në studimin e tij të vitit 1854 me titull **"Mbi shqipen në lidhjet e saj farefisnore"**. Më herët, në vitin 1843, F. Bopp e kishte përmendur shqipen në studimet e tij, por ende nuk ishte i sigurt për prejardhjen apo vendin e saj në këtë familje gjuhësh. Edhe albanologu austriak Gustav Majeri i kushtoi vëmendje kësaj çështjeje. Në studimin e tij **"Vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indoevropiane"**, ai vërtetoi se shqipja zë një vend më vete, ashtu si greqishtja, latinishtja, armenishtja etj.


Karakter i indoevropian i gjuhës shqipe shfaqet në të gjitha nënsistemet e saj: në fjalor, në sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore. Fjalori është pjesa e gjuhës që ndryshon më shpejt se tingujt dhe gramatika, prandaj shumë fjalë të vjetra indoevropiane janë zhdukur. Megjithatë, shqipja ka ruajtur rreth 2000 fjalë rrënjë të trashëguara. Sipas studimeve të prof. Eqrem Çabejt, ky numër është më i madh nga sa mendohej më parë, sidomos nëse llogariten edhe fjalët e prejardhura dhe të përbëra. Ndër këto fjalë të trashëguara nga indoevropianishtja janë: **atë, nënë, motër, djalë, sy, vesh, gojë, zemër, ujë, mal, natë, ditë, dritë, shikoj, ha, jam, shkoj** etj..

Në gjuhën shqipe, emrat ende lakohen me mbaresa rasore. Te mbiemrat e panyjshëm kjo mënyrë është zhdukur, ndërsa te mbiemrat e nyjshëm lakimi bëhet përmes ndryshimit të nyjës përpara mbiemrit. Shembull: *një djalë trim, i një djali trim; një djalë i mirë, i një djali të mirë.*

Në ndërtimin e numërorëve nga njëmbëdhjetë deri në nëntëmbëdhjetë, shqipja ndjek një model të hershëm, ku numri i vogël vihet para dhjetës dhe lidhet me të nëpërmjet trajtës **-mbë-**, që lidhet historikisht me parafjalën **mbi**. Shembuj: **një-mbë-dhjetë, dy-mbë-dhjetë.**

Gjuha shqipe ruan elemente të trashëguara indoevropiane edhe në pjesë të tjera të ligjëratës, si tek emrat, përemrat, foljet etj. Në gjuhën shqipe, si në shumë gjuhë indoevropiane, sistemi me tri gjini është thjeshtuar në dy, duke u zhdukur gjinia asnjësore. Gjurmë të saj ruhen te emrat prejfoljorë (të folurit, të menduarit) dhe në disa dialekte (ujët, djathët).

Në sistemin foljor të gjuhës shqipe bie në sy një tjetër tipar i hershëm indoevropian: **supletivizmi**, pra ndërtimi i formave të ndryshme të një foljeje me rrënjë të ndryshme. Shembuj: **jam – qeshë – qenë; kam – pata – pasur; shoh – pashë – parë; bie – rashë – rënë; shpie – prura – prurë; jap – dhashë – dhënë; rri – ndenja – ndenjur; ha – hëngra – ngrënë; vij – erdha – ardhur.**



**Të mos harrojmë!**

- Në botë fliten mbi 7.000 gjuhë, por ato nuk janë të shpërndara njësoj në të gjitha kontinentet.
- Gjuha shqipe bën pjesë në **familjen indoevropiane** dhe ruan shumë veçori që e lidhin me gjuhët e tjera të kësaj familjeje.
- Gjuhëtari gjerman Franc Bopi (Franz Bopp) ishte i pari që e vërtetoi shkencërisht përkatësinë e saj në këtë familje në vitin 1854.
- Ajo është një **gjuhë flektive (nyjëtimore)**, ku fjalët ndryshojnë formë për të shprehur kuptime të ndryshme.
- Gjuha shqipe ka ruajtur **rreth 2.000 fjalë të vjetra** që vijnë nga indoevropianishtja, si: **motër, djalë, sy, ujë, ha, jam** etj.

**Sa kuptove?**

- Sa gjuhë fliten në botë dhe pse nuk janë të shpërndara njësoj?
- Cilat janë katër llojet kryesore të gjuhëve sipas ndërtimit të tyre?
- Në cilën familje gjuhësore bën pjesë gjuha shqipe?
- Çfarë është supletivizmi? Jep një shembull nga shqipja.
- Cilat fjalë të përditshme në shqip vijnë nga indoevropianishtja?
- Kush ishte studiuesi i parë që vërtetoi përkatësinë e gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoevropiane?


**Kuptimi i fjalëve të reja**

- **Flektive** – gjuhë ku një fjalë e vetme mund të shprehë disa kuptime gramatikore njëkohësisht (si numër, gjini, rasë).
- **Supletivizëm** – kur format e ndryshme të një foljeje ndërtohen me rrënjë të ndryshme. Shembull: *jam* – *qeshë* – *qenë*.
- **Familje gjuhësore** – grup gjuhësh që kanë prejardhje të përbashkët.
- **Indoevropianishtja** – gjuha e lashtë nga e cila rrjedhin shumë gjuhë të sotme evropiane e aziatike.

ZHVILLIMI HISTORIK I GJUHËS LETRARE SHQIPE

SHKRIMET E PARA HISTORIKE TË GJUHËS SHQIPE

Çdo gjuhë ka historinë e saj, e cila lidhet ngushtë me historinë e popullit që e ka folur dhe që e flet ende sot. E tillë është edhe **historia e gjuhës shqipe** – një gjuhë e lashtë, me rrënjë të thella në Ballkan. Megjithatë gjuha shqipe është njëra ndër gjuhët më të vjetra të rajonit, dëshmitë e shkruara për të shfaqen relativisht vonë. **Vepra e parë e shkruar në gjuhën shqipe që njihet deri më sot është "Meshari" i Gjon Buzikut, i vitit 1555.** Ky tekst me përmbajtje fetare përmban pjesë nga mesha e kishës katolike dhe dëshmon përdorimin e gjuhës shqipe në jetën fetare dhe publike të kohës. "Meshari" u gjet në vitin 1740 nga kleriku shqiptar Gjon Nikollë Kazazi në Bibliotekën e Vatikanit. "Meshari" ishte shtypur në një nga shtypshkronjat e Venedikut dhe është shkruar me alfabet latin. **Kjo vepër është dëshmi e qartë se gjuha shqipe e shkruar ishte e konsoliduar që në shekullin XVI.**



— "Meshari" i Gjon Buzikut, i vitit 1555

DOKUMENTET E PARA TË SHKRIMIT SHQIP


Para «Mesharit» ekzistojnë disa dëshmi të rëndësishme që e vërtetojnë përdorimin e **gjuhës shqipe** në formë të shkruar. Ndër më të njohurat janë:

- **“Formula e pagëzimit” (1462),**
- **“Fjalorthi i Arnold von Harfit” (1497),**
- **“Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve” (shek. XVI).**

“Formula e pagëzimit”, e hartuar nga **Pal Engjëlli**, prift katolik dhe ipeshkv i Durrësit, është dokumenti më i hershëm i zbuluar deri më tani në gjuhën shqipe. Përdorimi i shprehjes **“më i hershëm i zbuluar deri më tani”** nënkupton se mund të ekzistojnë edhe dokumente më të vjetra, por që ende nuk janë gjetur. Ato mund të ruhen në biblioteka të vjetra në vende të ndryshme të botës. Një dëshmi që e përforcon këtë mundësi është një letër e vitit **1332**, e shkruar nga **prifti francez Brokardi** (Dom Broccardus), i cili shërbente në Tivar. Në të ai shkruan:

“Këtu, shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinishtja, megjithatë ata përdorin shkronjat latine në të gjithë librat e tyre.”

Kjo dëshmi, e njohur si **“Dëshmia e Brokardit”**, tregon se shqiptarët kishin libra të shkruar në gjuhën shqipe qysh në fillim të shekullit XIV, edhe pse ato ende nuk janë gjetur.




— Pal Engjëlli jetoi rreth viteve 1417–1470. Ishte edhe bashkëpunëtor i ngushtë i Skënderbeut.

"Formula e pagëzimit", dokument i vitit 1462, i zbuluar në vitin 1915 nga **Nikolla Jorga** në **Arkivin e Vatikanit**, është dëshmia më e vjetër e ruajtur në gjuhën shqipe. Për shkak të jetesës së vështirë në zonat malore dhe mungesës së klerikëve, kjo formulë u hartua që prindërit t'i pagëzonin vetë fëmijët. Është shkruar në gegërisht, me alfabetin latin. Teksti i saj është:

"Unte' paghesont premenit Atit et Birit et Spertit Senit"

("Unë të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt").



Formula e pagëzimit

Dokument tjetër me vlerë është **Fjalorthi i Arnold von Harfit**, i hartuar nga një udhëtar gjerman që vizitoi brigjet shqiptare në vitin 1497. Ai përfshiu **26 fjalë, 8 shprehje, si dhe numrat nga një deri në dhjetë, 100 dhe 1000** – të gjitha të përkthyer në gjermanisht. Kjo dëshmi tregon përdorimin e **gjuhës shqipe të folur** në jetën e përditshme. Në të vërtetë, bëhet fjalë për një ditar udhëtimi, ku autori kishte përfshirë një mini-fjalor **shqip-gjermanisht**, me fjalë dhe shprehje që i kishte mbledhur gjatë qëndrimit në trojet shqiptare.


Boicke - Bukë	Geneyre - Burrë	Nea - Një
Vene - Verë	Groëa - Grua	Dua - Dy
Oie - Ujë	Denarye - Para	Trij - Tre
Mische - Mish	Sto - Po	Quater - Katër
Jat - Djath	Jae - Jo	Pessa - Pesë
Foeie - Vezë	Criste - Zot	Jast - Gjashtë
Oitter - Uthull	Dreck - Djall	Statte - Shtatë
Poylle - Pulë	Kijrij - Qiri	Tette - Tetë
Pyske - Peshk	Kale - Kalë	Nantë - Nëntë
Krup - Kripë	Elbe - Elb	Dieta - Dhjetë
Myr - Mirë	Fijet - Me flejt	Nijtgint - Njëqind
Kycge - Keq	Mirenestrass - Mirëmëngjes	Nemijgo - Një mijë
Megarune - Me ngrënë	Myreprama - Mirëmbërma	
Pijnë - Me pi	Meretzeën - Mirësevjen	
Tauerne - Tavernë	Laf me kmijss - Më laj këmishën	

Fjalorthi i Arnold von Harfit

Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve është një fletë me tekst në **gjuhën shqipe**, e gjetur në një dorëshkrim greqisht të shekullit XIV, por që sipas gjuhëtarit **Xhevat Lloshi** daton nga **shekulli XVI**. Teksti, i shkruar me **alfabet grek** dhe në dialektin e jugut, përmban një fragment nga Ungjilli i Mateut dhe një këngë pashkësh.

Që nga shekulli XVI e deri sot, **gjuha shqipe** ka vijuar të përdoret në shkrim përmes veprave fetare, letrare, shkencore e shkollore, duke dëshmuar një zhvillim të pandërprerë.

Studiuesit shqiptarë theksojnë se dokumentet e shkruara për gjuhën shqipe janë të vonshme në krahasim me gjuhët e tjera, por ndërtimi dhe struktura e saj dëshmojnë një lashtësi dhe autoktoni të dukshme. **Eqrem Çabej** shprehet se gjuha shqipe ka pasur një zhvillim të saj të brendshëm dhe të pavarur brenda familjes së gjuhëve indoevropiane. **Idriz Ajeti** e vlerëson "**Formulën e pagëzimit**" si një nga dëshmitë më të çmuara të shqipes së shkruar, që tregon përpjekjen për përdorimin e gjuhës amtare në jetën fetare dhe shoqërore. Ndërsa **Shaban Demiraj** e cilëson shqipen si një gjuhë me rëndësi të veçantë historike, që pasqyron vazhdimësinë gjuhësore të shqiptarëve ndër shekuj.



Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve

**Të mos harrojmë!**

- **Gjuha shqipe** është një gjuhë e lashtë, me zhvillim të brendshëm dhe autokton në Ballkan.
- Dokumentet më të hershme të saj janë: **Formula e pagëzimit** (1462), **Fjalorthi i Arnold von Harfit** (1497), dhe **Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve** (shek. XVI).
- Letra e Brokardit (1332) dëshmon se shqiptarët kishin libra në gjuhën shqipe që herët, edhe pse ato ende nuk janë zbuluar.
- Vepra e parë e plotë në **gjuhën shqipe** është **Meshari i Gjon Buzukut** (1555), i zbuluar në Vatikan dhe i shtypur në Venedik.
- Dokumentet e hershme janë thelbësore për të kuptuar vazhdimësinë historike dhe gjuhësore të shqipes.

**Sa kuptove?**

- Cili është dokumenti më i vjetër i njohur në gjuhën shqipe?
- Çfarë dëshmon letra e Brokardit për gjuhën shqipe në shek. XIV?
- Çfarë përmban “Meshari” dhe ku është zbuluar ai?
- Kush ishte Arnold von Harfit dhe çfarë përmban mini-fjalori i tij?
- Në cilin dialekt dhe me çfarë alfabeti është shkruar Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve?
- Cili është vlerësimi i studiuesve për rëndësinë e shqipes së shkruar?

**Kuptimi i fjalëve të reja**

- **Meshar** – një libër fetar që përmban pjesë nga mesha e kishës katolike.
- **Perikope** – një fragment i shkurtër nga Bibla që lexohet në raste të caktuara fetare.
- **Kodiku** – dorëshkrim i vjetër që përmban tekste fetare ose të shenjta.
- **Autokton** – që është i lindur dhe i zhvilluar në vendin e vet, vendas.
- **Prelat / klerik** – person me detyrë të lartë në hierarkinë fetare, zakonisht në kishë.
- **Konsoliduar** – i përforcuar, i zhvilluar dhe i bërë i qëndrueshëm me kalimin e kohës.
- **Ipeshkëv** – përfaqësues i lartë i Kishës Katolike që udhëheq një zonë kishtarë.
- **Arkiv** – vend ku ruhen dokumente historike apo të rëndësishme.

GJUHËSIA (LINGUISTIKA)

GJUHËSIA DHE DEGËT KRYESORE TË SAJ

Gjuhësia është shkencë që merret me studimin e gjuhës. Ajo analizon se si është ndërtuar gjuha, si funksionon dhe si përdoret nga njerëzit në jetën e përditshme për të shprehur mendime, ndjenja dhe për të komunikuar mes tyre. Në të kaluarën, para se të njëhej si shkencë më vete, gjuhësia ishte pjesë e filozofisë. Vetëm në gjysmën e parë të shekullit XX, ajo filloi të trajtohej si një shkencë e pavarur, me objekt dhe metodë të qartë studimi – veçanërisht pas botimit më 1916 të veprës "**Kurs i gjuhësisë së përgjithshme**" të Ferdinand de Sossyrit, e cila vendosi themelet e qasjes moderne ndaj gjuhës. Që nga ajo kohë, gjuhësia u veçua nga filozofia dhe u zhvillua si shkencë më vete në kuadër të shkencave humane.


Fillimisht, gjuhësia është marrë kryesisht me gjuhën e shkruar, duke u përqendruar te rregullat normative dhe aspektet formale. Më vonë, qasjet e reja shkencore e zhvendosën vëmendjen te përdorimi i gjuhës në jetën e përditshme, duke e parë atë si një dukuri të gjallë dhe dinamike që shfaqet në marrëdhëniet ndërnjerëzore.

Sot, gjuhësia studion gjuhën si sistem, pra si një strukturë të organizuar që përbëhet nga njësi të ndryshme (si: tinguj, fjalë, fjali), dhe ligjërimin, që është përdorimi i kësaj gjuhe në situata konkrete nga individë të veçantë.

Duhet theksuar se gjuha nuk është thjesht një listë fjalësh që duhet të mësohen për t'u folur. Ajo është një sistem i ndërlikuar, ku secila njësi ka vendin e vet dhe lidhet me njësi të tjera përmes rregullave. Tingujt (fonemat), pjesët e fjalës (morfemat), fjalët, fjalitë dhe tekstet – të gjitha janë pjesë e këtij sistemi. Kur përdorim gjuhën për të komunikuar, ne nuk bëjmë gjë tjetër veçse e vëmë në funksion këtë sistem nëpërmjet ligjëritimit.

DEGËT KRYESORE TË GJUHËSISË (LINGUISTIKËS)

Gjuhësia (linguistika) ka disa degë kryesore: fonetikën, fonologjinë, leksikologjinë dhe gramatikën.



Fonetika

Fonetika (nga greq. *phonetikós*, *phonē* = tingull, zë) është një degë e gjuhësisë që merret me studimin e tingujve të gjuhës, duke i shqyrtuar ata nga të gjitha aspektet: mënyrën si nyjëtohen, veçoritë e tyre akustike dhe fiziologjike, si edhe ndryshimet që pësojnë gjatë përdorimit në të folur. Shembull: tingulli **ll** në fjalën **mall** shqiptohet ndryshe nga tingulli **l** në fjalën **mal** – fonetika analizon këtë ndryshim në shqiptim.

Fonologjia

Fonologjia (nga greq. *phōnologia* – *phōnē* = zë, tingull + *logia* (*lógos*) = fjalë ose dituri për tingullin, pra fonetikë funksionale) është një degë e veçantë e fonetikës, e cila merret me funksionet e tingujve në gjuhë. Shembull: fjalët **natë** dhe **patë** ndryshojnë vetëm për një tingull, por kanë kuptime të ndryshme – këtë e studion fonologjia.

Leksikologjia

Leksikologjia (nga greq. *léxis* = fjalë + *lógia* = shkencë, dituri për fjalët) është degë e gjuhësisë që studion fjalët e një gjuhe. Ajo merret me shqyrtimin e kuptimit dhe përdorimit të fjalëve, veçorive të tyre, vlerave që marrin në kontekst, shtresave të fjalorit, njësive frazeologjike dhe ngarkesave emocionale që ato mund të shprehin. Shembull: Fjala **kokë** përdoret në kuptimin e saj të zakonshëm si pjesë e trupit (më dhemb koka), por mund të ketë edhe kuptim figurativ (është **kokë e madhe në punë** = është i zoti në punë). Gjithashtu, ajo është pjesë e shumë njësive frazeologjike si: *i punon **koka*** (është mendjemprehtë) apo ***ka kokë të fortë*** (nuk pranon këshilla). Leksikologjia studion këto përdorime dhe ndryshimet kuptimore që marrin fjalët në kontekste të ndryshme.

Gramatika

Gramatika (nga greqishtja *grammatikē téchne*, që do të thotë "arti i të shkruarit" ose "arti i fjalës") është një nga degët kryesore të gjuhësisë. Ajo merret me rregullat që tregojnë si ndryshojnë fjalët dhe si bashkohen ato për të formuar fjali. Struktura gramatikore e një gjuhe nuk është krijuar brenda natës. Ajo është formuar gradualisht gjatë shekujve, bashkë me zhvillimin e mendimit dhe jetës shoqërore të njerëzimit. Duke qenë thellësisht e lidhur me përvojën gjuhësore të një populli, kjo strukturë është bërë pjesë e brendshme e gjuhës dhe ndryshon ngadalë, në përputhje me ndryshimet në vetë shoqërinë. Prandaj, thuhet se gramatika është një ndërtim i gjatë i mendimit njerëzor. Gramatika na ndihmon të flasim dhe të shkruajmë drejt, qartë dhe bukur gjuhën tonë amtare. Në kuptimin e ngushtë, gramatika ndahet në dy pjesë kryesore: **morfologjinë** dhe **sintaksën**.



Në kuptimin më të gjerë, përveç këtyre dy degëve, në gramatikë përfshihen edhe **fonetika** me **fonologjinë**, si dhe **leksikologjia**, bashkë me **semantikën** dhe **fjalëformimin**. Për arsye praktike dhe mësimore, gramikat shkollore zakonisht përfshijnë këto katër degë kryesore: **fonetikën**, **morfologjinë**, **sintaksën** dhe **leksikologjinë**.



Morfologjia (nga greq. *morphōlogia* – *morphē* = trajtë, formë + *lógos* = fjalë ose dituri për trajtën) është degë e gramatikës që merret me studimin e formave të fjalëve dhe kategorive gramatikore që ato shprehin. P.sh.: Nga folja **luaj** dalin trajtat *luajta*, *luajmë*, *luan*, *luaje* – morfologjia i shqyrton këto trajta sipas kategorive gramatikore të saj, si: **koha**, **veta**, **mënyra** dhe **numri**. Njëjtë, edhe nga emri **djalë** dalin format *djalë*, *djali*, *djem*, *djemve* – morfologjia i analizon këto forma sipas kategorive të emrit, si: **gjinia**, **numri**, **rasa** dhe **trajta**.

Sintaksa (nga greq. *śyntaxis* = bashkërenditje fjalësh) është degë e gramatikës që merret me studimin e rregullave se si lidhen fjalët për të formuar togfjalësha, fjali dhe njësi më të mëdha si fjalitë e përbëra (periudhat). Ajo shqyrton ndërtimin e njësive sintaksore, mjetet ndihmëse të shprehjes së tyre,

si: intonacioni, renditja e fjalëve, fjalët shërbyese, funksionin sintaksor të pjesëve të ligjëratës dhe kategorive gramatikore, si rasat tek emrat, ose koha dhe mënyra te foljet. P.sh.: fjalia: *Nxënësi shkruan një vjershë të re* ka ndërtim të rregullt sintaksor, por nëse themi: *Të re nxënësi një vjershë shkruan*, kuptimi bëhet i paqartë, sepse ndërtimi nuk është i rregullt – këtë e studion sintaksa.



Të mos harrojmë!

- **Gjuhësia** është shkenca që studion gjuhën, ndërtimin dhe përdorimin e saj në komunikim.
- Ajo u zhvillua si disiplinë e veçantë shkencore në fillim të shekullit XX, pas veprës së Ferdinand de Sossyrit.
- **Gjuha** është një sistem i organizuar që përbëhet nga njësi të ndërlidhura si tinguj, fjalë, fjali e tekste.
- **Ligjërimi** është përdorimi i gjuhës nga një folës në një situatë konkrete.
- **Degët kryesore të gjuhësisë** janë: fonetika, fonologjia, leksikologjia dhe gramatika.
- **Gramatika** na ndihmon të flasim dhe të shkruajmë qartë, drejt dhe bukur në gjuhën amtare.
- Rendi i fjalëve në fjali mund të ndikojë në kuptim dhe qartësi, prandaj është pjesë e rëndësishme e sintaksës.



Sa kuptove?

- Çfarë është gjuhësia dhe çfarë studion ajo?
- Si ndryshon gjuha nga ligjërimi?
- Pse nuk mjafton të dimë vetëm fjalët për të folur drejt një gjuhë?
- Cilat janë disa nga degët kryesore të gjuhësisë?
- Si ndikon renditja e fjalëve në kuptimin e një fjalie?



Kuptimi i fjalëve të reja

- **Shkencë humane** – disiplinë që studion njeriun dhe shoqërinë.
- **Normative** – që përcakton rregulla ose mënyra të pranura si të drejta.
- **Qasje** – mënyra se si afrohemi për të kuptuar një dukuri.
- **Strukturë** – ndërtimi i brendshëm i një sistemi ose njësie.
- **Njësi gjuhësore** – pjesë të gjuhës si fonemat, fjalët, fjalitë etj.
- **Dinamike** – që ndryshon, përshtatet dhe është në zhvillim të vazhdueshëm.



Ushtrime

Përshkruaj në fletore dhe rretho përgjigjen e saktë!

1. Çfarë është gjuhësia?
 - a. Rregull drejtshkrimi.
 - b. Një fushë e filozofisë.
 - c. Shkenca që studion gjuhën dhe përdorimin e saj.
 - ç. Mënyrë për të përkthyer tekste.
2. Cila fjali tregon kuptimin e drejtë të ligjëritit?
 - a. Grup rregullash për shqiptimin.
 - b. Të gjitha fjalët që dimë në një gjuhë.
 - c. Përdorimi i gjuhës në një situatë konkrete.
 - ç. Tekst i shkruar me alfabet të veçantë.
3. Cili është dallimi mes fonetikës dhe fonologjisë?
 - a. Njëra merret me drejtshkrim, tjetra me stil.
 - b. Fonetika shqyrton tingujt fizikisht, fonologjia funksionin e tyre.
 - c. Fonetika merret me fjalitë, fonologjia me tekstet.
 - ç. Janë dy emra për të njëjtën shkencë.
4. Cila degë e gjuhësisë merret me fjalët dhe kuptimin e tyre?
 - a. Morfologjia.
 - b. Fonetika.
 - c. Leksikologjia.
 - ç. Sintaksa.

**Kuptimi i fjalës: i drejtpërdrejtë apo figurativ?**

Shkruani në fletore **i drejtpërdrejtë** nëse fjala ose fjalët me shkronja të trasha janë përdorur në kuptimin e zakonshëm, dhe shkruani **figurativ** nëse janë përdorur në kuptim të figurshëm.

Mund të përdorni edhe shkurtime **D** për **i drejtpërdrejtë** dhe **F** për **figurativ**.

Shembull:

Ai ka **zemër të madhe** dhe është gjithmonë i gatshëm të ndihmojë të tjerët. **figurativ / F.**

1. Më dhemb **koka** prej zhurmës. _____
2. E ka **kokën e madhe**, por nuk e përdor. _____
3. Ai ka **barkun plot**, por përsëri ankohet. _____
4. Nxënësja foli me **gojën plot** dhe me vetëbesim. _____
5. Ai ka **duar të arta**, çdo gjë që prek e bën bukur. _____
6. Djali im mban **syze** për të parë më mirë. _____
7. Po më **zien koka** nga problemet. _____

FONETIKË DHE FONOLOGJI

OBJEKTI I FONETIKËS

NDËRTIMI I FJALËVE ME TINGUJ

Nga atje ai shikonte atë që kishte parë në ëndërr: majën e Malit të Krojeve të mbuluar me një mjegull të zezë, nga brendia e së cilës shkëlqenin rrufe të njëpasnjëshme. Ai priste të fillonte ndonjë shi i rrëmbyeshëm, ashtu siç ndodhte rëndom kur këtë mal e mbulonin retë. Mjegulla u lëshua mbi qytet dhe rrëshqiti drejt Urës së Gurit, e mbuloi atë dhe pastaj Sylja nuk mund të shihte si degëzohej ajo nëpër rrugicat e ngushta të Çarshisë së Madhe.

— Kim Mehmeti

Tingujt (fonemat) janë njësitë më të vogla të gjuhës së folur. Kur bashkohen sipas rregullave të gjuhës, ato formojnë fjalë me kuptim. Çdo fjalë është ndërtuar nga një grup tingujsh të caktuar. P.sh.: fjalët: **Nga atje ai shikonte atë** (të shkëputura nga fragmenti i mësipërm), veç kuptimit, kanë edhe formën ose ndërtimin e fjalës me tinguj ("matematikën e tingujve") që fonetikisht shprehet në këtë mënyrë:

nga	ai
n + g + a	a + i
atje	shikonte
a + t + j + e	sh + i + k + o + n + t + e
	atë
	a + t + ë

SI FORMOHEN TINGUJT?

Vetëm njerëzit, nga të gjitha qeniet e gjalla në planet, kanë aftësinë për të komunikuar përmes gjuhës së folur. Kjo ndodh falë një mekanizmi të veçantë që e bën të mundur shqiptimin e tingujve. Tingujt formohen në organet e aparatit të të folurit, të cilat përfshijnë: **buzët, dhëmbët, gjuhën, qiellzën (e fortë dhe të butë), uvulën (njerithin), laringun, tejzat e zërit dhe mushkëritë**. Këto organe, edhe pse kanë funksione të tjera jetësore, si: frymëmarrja apo përtypja, kur vihet në lëvizje procesi i të folurit, bashkëpunojnë për të krijuar tingujt që dëgjojmë.

Fonetika (nga greq. *phonetikós*, *phonē* = tingull, zë) është degë e gjuhësisë që merret me studimin e tingujve të të folurit. Ajo analizon se si formohen, si dëgjohen dhe si ndryshojnë tingujt gjatë të folurit. Tingujt e një gjuhe, përfshirë edhe ata të gjuhës shqipe, studiohen nga tri pikëpamje:

1. Sipas nyjetimit (artikulimit). Kjo pikëpamje shqyrton mënyrën se si prodhohen tingujt përmes organeve të të folurit, si: **gjuha, buzët, qiellza, goja** etj. Ky proces quhet **nyjetim**. Për tinguj të ndryshëm përdoren organe të ndryshme ose të njëjtat organe vendosen në pozicione të ndryshe. Për shembull: gjuha mund të jetë më lart ose më poshtë, më përpara ose më prapa, në varësi të tingullit që po shqiptohet. Kjo veçori e tingujve të të folurit quhet **fiziologji e tingujve**.

2. Sipas veçorive akustike. Çdo tingull që prodhohet dëgjohet nga veshi dhe krijon një përshtypje të veçantë. Kjo përshtypje, që ka kuptim për dëgjuesin, quhet **vlerë akustike e tingullit**. Ajo lidhet me lartësinë, forcën ose zgjatjen e tingullit.

3. Sipas ndryshimeve që pësojnë gjatë përdorimit. Disa tinguj ndryshojnë kur fjala kthehet në një formë tjetër, zakonisht në shumës ose në forma gramatikore të tjera. P.sh.: dorë → duar (zanorja o zberthehet (diftongohet) në ua), e madhe → të mëdha (a kthehet në ë në numrin shumës), krahaso: zog → zogj; plak → pleq etj. Këto dukuri (fonetike) të tingujve quhet **ndryshime fonetike**.

Këto ndryshime ndodhin në mënyrë të natyrshme gjatë të folurit dhe përbëjnë fushë studimi të fonetikës.

Llojet e fonetikës. Fonetika, sipas mënyrës si i studion tingujt, ndahet në disa nëndegë:

1. Fonetika përshkruese (deskriptive)

Kjo degë merret me përshkrimin e tingujve të një gjuhe në gjendjen e saj të sotme. Ajo studion se si shqiptohen tingujt në të folmen standarde dhe në variante të tjera të gjuhës.

2. Fonetika historike (diakronike)

Shqyrton se si kanë ndryshuar tingujt gjatë kohës, nga fazat më të vjetra të gjuhës deri në formën që kanë sot. Ajo ndihmon për të kuptuar zhvillimin e gjuhës.

3. Fonetika eksperimentale

Studion tingujt përmes matjeve dhe pajisjeve shkencore. Ajo analizon veçoritë fizike të tingujve dhe mënyrën se si funksionojnë organet e të folurit gjatë shqiptimit.

4. Fonetika e përgjithshme

Merret me parimet e përbashkëta të tingujve në të gjitha gjuhët. Ajo kërkon të kuptojë rregullsitë që i bashkojnë gjuhët në aspektin tingullor.

5. Fonetika normative (drejtshqiptimi)

Kjo degë përcakton normat e drejtshqiptimit në gjuhën standarde. Ajo udhëzon si duhet të shqiptohen saktë tingujt në komunikimin zyrtar, në arsim, në media etj. Fonetika normative kërkon që fjalët të shqiptohen sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Për shembull, fjalët **bukë** dhe **ujë** duhet të shqiptohen me tingullin ë në fund, edhe pse në të folmen e përditshme shpesh thuhet, si: ***buk** dhe ***uj**. Shqiptimi i plotë është i domosdoshëm për të ruajtur qartësinë dhe saktësinë në gjuhën standarde shqipe.

Fonetika ka lidhje të ngushtë me **fonologjinë**, **morfologjinë**, **sintaksën**, **leksikologjinë**, **semantikën** dhe **drejtshkrimin**.

RËNDËSIA E STUDIMIT TË FONETIKËS

Studimi i fonetikës ka një rëndësi të madhe si në gjuhësi, ashtu edhe në fusha të ndryshme të jetës praktike. Ajo ndihmon në përvetësimin e **normës drejtshkrimore (ortografisë)** dhe të **normës drejtshqiptimore (ortoepisë)**, duke siguruar një të shkruar dhe një shqiptim të saktë në gjuhën standarde.

Fonetika ka rëndësi edhe në fushën e **etimologjisë**, pasi ndihmon në zbërthimin dhe kuptimin e prejardhjes dhe zhvillimit historik të fjalëve. Ajo luan një rol të veçantë edhe në **mësimin e gjuhëve të huaja**, duke lehtësuar shqiptimin e saktë përmes njohjes së sistemit tingullor të gjuhës që mësohet.

Gjithashtu, fonetika ndihmon në **procesin e mësimdhënies për persona me dëmtime të dëgjimit ose me vështirësi në të folur**, duke u mbështetur në analizën e prodhimit të tingujve dhe në punën me organet e të folurit për të ndërtuar shqiptimin e drejtë. Përveç këtyre, fonetika ka zbatim edhe në **fushat teknologjike**, si në telefoninë, radioteknikën dhe sistemet moderne të njohjes së zërit. Ajo ndihmon në krijimin e pajisjeve që funksionojnë me komandë zanore, si dhe në zhvillimin e programeve për përkthim automatik përmes të folurit.

OBJEKTI I FONOLOGJISË

Fonologjia është degë e gjuhësisë që studion tingujt nga pikëpamja funksionale, pra rolin që ata luajnë në ndërtimin dhe dallimin e fjalëve në gjuhë. Ndryshe nga fonetika, e cila merret me aspektin nyjësor (artikulimin) dhe akustik të tingujve, pra me mënyrën se si formohen dhe si dëgjohen ata, fonologjia përqendrohet në funksionin që kanë tingujt brenda sistemit të gjuhës.

Objekti kryesor i fonologjisë është **fonema**. Fonema është njësia më e vogël tingullore e gjuhës që nuk ka kuptim më vete, por që shërben për të ndërtuar formën tingullore të fjalëve dhe për të dalluar fjalët nga njëra-tjetra. Ajo ka dy funksione themelore:

Funksion ndërtues, pasi merr pjesë në ndërtimin e fjalës përmes bashkimit të tingujve. P.sh.: fjala **shkolla** përbëhet nga fonemat: **sh + k + o + ll + a**, ndërsa fjala **nxënësi** përbëhet nga: **n + x + ë + n + ë + s + i**.

Funksion dallues, sepse ndërrimi i vetëm një foneme sjell ndryshim kuptimi. Shembuj të tillë janë fjalët: **mal – mall, plakë – pllakë, punë – gunë** etj.

Për ta kuptuar më mirë këtë **funksion dallues të fonemave**, po e ilustruam me një shembull konkret. Në fjalët **bjeshkë** dhe **pjeshkë**, që kanë ndërtim të njëjtë përveç tingullit të parë, kemi një kundërvënie midis fonemave **b** dhe **p**. Të dyja janë tinguj dybuzorë, pra formohen me mbylljen e të dy buzëve, por **b**-ja është **e zëshme**, ndërsa **p**-ja është **e pazëshme**. Pikërisht kjo ndryshueshmëri bën që ato të jenë fonema të veçanta dhe të krijojnë fjalë me kuptime të ndryshme.

Kundërvënia fonologjike nuk ndodh vetëm në fillim të fjalës, por edhe në pozicione të tjera. Shembuj: **verë – derë, baj – laj, mend – vend – send, tek – tel, gusht – gisht** etj.

Fonologjia, pra, studion funksionin e tingujve në gjuhë dhe mënyrën se si ata ndërtohen dhe dallojnë kuptimet. Ajo merret me fonemat si njësitë më të vogla të sistemit gjuhësor, të cilat, edhe pse nuk kanë kuptim të pavarur, janë thelbësore për ndërtimin dhe kuptimin e fjalëve në gjuhën e folur.

Nga sa u tha më sipër, del se **gjuha standarde shqipe ka 36 fonema**, të cilat janë të njohura për të gjithë folësit e shqipes, pavarësisht të folmeve që

përdorin. Ato janë pjesë e sistemit tingullor të shqipes dhe nuk ndryshojnë nga një zonë në tjetrën. Fonemat i përdorim në të folur, ndërsa në të shkruar i paraqesim përmes **grafemave**, domethënë me shkronjat që përfaqësojnë këta tinguj. Shqipja ka një sistem të rregullt shkrimi, **ku çdo tingull ka grafemën e vet** dhe çdo grafemë përfaqëson një tingull të vetëm. Disa fonema shënohen me një shkronjë të vetme, si: **b, t, a, k, i** etj.; të tjera shënohen me dy shkronja, si: **dh, gj, ll, sh, rr, xh, zh, nj** etj. Edhe pse në të shkruar përbëhen nga dy shkronja, në të folur ato shqiptohen si një tingull i vetëm. Prandaj themi se **alfabeti i gjuhës shqipe ka 36 grafema, që përputhen plotësisht me 36 fonemat e saj**.

VARIANTET E FONEMAVE (ALOFONET)

Në të folur, një fonemë mund të shqiptohet ndryshe, varësisht nga vendi që zë në fjalë ose nga tingujt përreth saj. Këto forma të ndryshme quhen **alofone** ose **variante të fonemës**. Edhe pse ndryshojnë nga mënyra e shqiptimit, ato nuk ndryshojnë kuptimin e fjalës. Te fjala **motër**, tingulli **m** shqiptohet si **dybuzor**, sepse pas tij vjen zanorja **o**.

Ndërsa te fjala **amfiteatër**, **m**-ja shqiptohet si **buzore-dhëmbore**, për shkak të afërsisë me tingullin **f**. Edhe pse shqiptimi është i ndryshëm, në të dyja rastet kemi të bëjmë me të njëjtën fonemë, e cila shqiptohet ndryshe sipas vendit ku ndodhet në fjalë. Këto ndryshime janë të natyrshme dhe nuk paraqiten si fonema më vete, sepse nuk ndikojnë në ndërtimin apo dallimin e kuptimit. Prandaj quhen variante të fonemës, jo fonema të ndryshme.



Të mos harrojmë!

- Tingulli është zëri që dëgjohet gjatë shqiptimit të fjalëve.
- **Fonema** është njësia më e vogël gjuhësore që dallon kuptimin e fjalëve (p.sh. **mal** – **mall**).
- Gjuha standarde shqipe ka **36 fonema** dhe po aq **grafema** (shkronja). Disa fonema paraqiten me një shkronjë (b, t, a) disa me dy (sh, rr, gj).
- **Fonetika** studion shqiptimin e tingujve; **fonologjia** shqyrton rolin e tyre në ndërtimin dhe dallimin e fjalëve.
- **Alofonet** janë variante të shqiptimit të një foneme që nuk ndryshojnë kuptimin e fjalës.



Sa kuptove?

- Cili është dallimi midis tingullit dhe fonemës?
- Pse fonema konsiderohet njësi funksionale në gjuhë?
- Çfarë është një alofon? Jep një shembull?
- Si ndihmon fonetika në të folur dhe në të shkruar?
- Si ndërtohet një fjalë përmes tingujve?
- Cili është ndryshimi midis fonetikës dhe fonologjisë?



Përdorni përgjigjet për të rishikuar njohuritë. Përgjigjuni vetë para se t'i lexoni.

1. Tingulli është zëri që dëgjohej gjatë shqiptimit, ndërsa fonema është njësi gjuhësore që dallon kuptimin.
2. Sepse ndërrimi i një foneme e ndryshon kuptimin e fjalës (p.sh. mal – mall).
3. Alofoni është mënyrë e ndryshme e shqiptimit të të njëjtës fonemë, pa ndryshim kuptimi (p.sh. m në motër dhe m në amfiteatër).
4. Ndiemon në shqiptimin e qartë dhe të saktë të fjalëve dhe në përvetësimin e drejtshkrimit.
5. Përmes bashkimit të fonemave sipas rregullave të gjuhës (p.sh. sh + k + o + ll + ë = shkollë).
6. Fonetika shqyrton shqiptimin e tingujve, ndërsa fonologjia funksionin e tyre në gjuhë.



Kuptimi i fjalëve të reja

- **Tingull** – zëri që prodhohet gjatë të folurit dhe që dëgjohej nga veshi. Ai është përbërësi themelor i gjuhës së folur prej të cilit ndërtohen fjalët dhe realizohet komunikimi.
- **Fonemë** (greq. *phōnēma* – “tingull dallues”) – njësia më e vogël gjuhësore që nuk ka kuptim më vete, por shërben për të dalluar fjalët nga njëra-tjetra. P.sh.: *dhatë* dhe *thatë* ndryshojnë vetëm nga një fonemë (dh/th), por kuptimi i tyre është krejtësisht i ndryshëm.
- **Grafemë** (shkronjë, germë) (greq. *graphein* – “shkruaj”) – shkronja me të cilën paraqitet një tingull (fonemë) në të shkruar.
- **Ortografi** (drejtshkrim) (greq. *orthos + graphē* – “shkrim i drejtë”) – mënyra e drejtë e të shkruarit sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- **Ortoepi** (drejtshqiptim) (greq. *orthos + epos* – “shqiptim i drejtë”) – mënyra e drejtë e shqiptimit të fjalëve sipas gjuhës standarde.


MËNYRA E ARTIKULIMIT (NYJËTIMIT) TË TINGUJVE

Të folurit është një nga veprimet më të zakonshme që bëjmë çdo ditë, shpesh pa e menduar fare. Por, në të vërtetë, njeriut i është dashur një periudhë shumë e gjatë zhvillimi për të arritur aftësinë për të folur. Kjo aftësi nuk është e lindur e gatshme, por është ndërtuar ngadalë përmes evolucionit dhe përmirësimit të organeve të trupit, si dhe zhvillimit të mendjes dhe të vetëdijes.

Tingulli i nyjëtuar, si njësi themelore e të folurit, krijohet përmes një procesi të ndërlikuar psiko-fiziologjik. Kjo do të thotë se për të prodhuar një tingull gjuhësor nevojitet bashkëveprimi i mendjes dhe i trupit. Pjesa psikike lidhet me formimin e mendimit dhe me qëllimin për të shprehur diçka, ndërsa pjesa fiziologjike, e cila është më e lehtë për t'u kuptuar, përfshin veprimin e organeve të të folurit.

Në këtë proces marrin pjesë **mushkëritë**, të cilat dërgojnë ajrin drejt laringut, ku gjenden **kordat (tejzat) zanore** që krijojnë zërin. Pastaj, zëri kalon nëpër **zgavrën e gojës dhe të hundës**, ku formësohet në tinguj të dallueshëm. **Gjuha, buzët, dhëmbët dhe qiellza** janë organet që kryejnë veprimin përfundimtar të formimit të tingullit. Këto organe përbëjnë tërësinë që quhet **aparati i të folurit**.

Edhe pse sot të folurit na duket i lehtë dhe i natyrshëm, pas tij fshihet një mekanizëm i ndërlikuar dhe një histori e gjatë zhvillimi që e ka bërë njeriun të vetmin qenie që flet me gjuhë të artikuluar.



CILAT JANË ORGANET E TË FOLURIT DHE SI NDAHEN ATO?


Organet e të folurit, përveç funksioneve të tyre biologjike, marrin pjesë në procesin e të folurit. Ky funksion lidhet me fonetikën, e cila i studion tingujt e gjuhës. Ato, pra organet e të folurit, ndahen në tri pjesë kryesore: **pjesa e poshtme, pjesa e mesme dhe pjesa e sipërme.**

Pjesa e poshtme përbëhet nga **mushkëritë, bronket, gabzherri (trakea) dhe diafragma**. Këto organe shërbejnë për frymëmarrje, por janë të domosdoshme edhe për prodhimin e zërit. Ajri që qarkullon gjatë frymëmarrjes lëviz përmes bronkeve dhe gabzherrit drejt pjesëve të sipërme të aparatit të të folurit.

Pjesa e mesme përfshin laringun, ku ndodhen **tejzat e zërit, "molla e Adamit"** dhe **epiglota** (kapaku i gabzherrit). Tejzat e zërit janë dy muskuj të hollë që vibrojnë kur kalon ajri, duke krijuar tingullin themelor të zërit. Laringu është, pra, vendi ku përftohet zëri.

Pjesa e sipërme përfshin **zgavrën e gojës, zgavrën e hundës dhe buzët**. Brenda zgavrës së gojës ndodhen organet që formësojnë tingujt: **gjuha, qiellza e fortë dhe e butë me njerithin (uvulën), dhëmbët, nofullat dhe trysat**. Goja dhe zgavrat e hundës veprojnë si hapësira rezonatore ku tingulli merr formën përfundimtare.

Gjuha dhe buzët janë organet më aktive në nyjetim. Gjuha, për shkak të lëvizshmërisë dhe elasticitetit të saj, përshtatet për formimin e tingujve të ndryshëm. Për çdo tingull krijohet një hapësirë e veçantë në gojë, ku organet bashkëveprojnë për të prodhuar tingullin e dëshiruar. Prandaj thuhet se goja është "**fabrika e tingujve**".





Të mos harrojmë!

- Të folurit është një proces i ndërlikuar, që realizohet përmes bashkëveprimit të mendjes dhe organeve të trupit.
- Tingulli krijohet nga ajri që del nga mushkëritë, kalon në laring (ku formohet zëri), dhe formësohet në gojë e hundë përmes gjuhës, buzëve dhe organeve të tjera.
- Organet e të folurit ndahen në tri pjesë:
 - **Të poshtme** – mushkëritë, bronket, trakeja dhe diafragma.
 - **Të mesme** – laringu me tejzat e zërit dhe epiglotën.
 - **Të sipërme** – zgavra e gojës e hundës, gjuha, qiellza, dhëmbët, buzët dhe njerithi.
- Goja është “fabrika e tingujve” – çdo tingull krijohet përmes një veprimi të saktë të organeve të të folurit.



Sa kuptove?

- Cili është roli i trurit dhe i organeve në të folurit?
- Cilat janë tri pjesët kryesore të aparatit të të folurit?
- Çfarë ndodh në laring kur flasim?
- Pse është gjuha një organ shumë i rëndësishëm në artikulum (nyjëtim)?
- Si vepron goja për të formuar tinguj të ndryshëm?



Kuptimi i fjalëve të reja

- **Tingull** – zëri që krijohet nga dridhjet e ajrit gjatë të folurit.
- **Artikulum** (lat. *articulare*, “lidh, nyjëtoj”) – mënyra si formohet një tingull përmes organeve të të folurit.
- **Laring** (greq. *larynx*) – pjesë e fytit ku krijohet zëri.
- **Tejza të zërit** – fije të holla në laring që vibrojnë dhe prodhojnë zë.
- **Epiglota** – “kapaku” që mbyllet kur hamë, për të mos lejuar ushqimin të shkojë në rrugët e frymëmarrjes.
- **Njerith (uvula)** – pjesa e vogël që varet në fund të qiellzës.
- **Trysa** – faqet e brendshme të gojës, ndihmojnë në artikulum.
- **“Molla e Adamit”** – fryrje e dukshme në fytyrë, veçanërisht te meshkujt, pjesë e laringut.



Ushtrime

Shkruaj në fletore fjalitë e mëposhtme dhe plotësoji me fjalën e duhur.

- a) Organet e të folurit ndahen në _____ pjesë kryesore.
- b) Ajri nga mushkëritë kalon në _____, ku ndodhen tejzat e zërit.
- c) Gjuha dhe _____ janë organet më aktive në formimin e tingujve.
- ç) Hapësirat rezonatore janë zgavra e gojës dhe zgavra e _____.

Rretho përgjigjen e saktë:

1. Laringu bën të mundur:
 - a) frymëmarrjen.
 - b) përtypjen e ushqimit.
 - c) formimin e zërit.
 - ç) tretjen.
2. “Molla e Adamit” është:
 - a) pjesë e tejzave të zërit.
 - b) një muskul i gjuhës.
 - c) fryrje në laring që dallohet te meshkujt.
 - ç) pjesë e hundës.
3. Procesi i të folurit nis me:
 - a) lëvizjen e gjuhës.
 - b) fryrjen e buzëve.
 - c) daljen e ajrit nga mushkëritë.
 - ç) hapjen e gojës.

Përdor shigjetat për të lidhur organet me funksionin përkatës:

Organi**Funksioni**

Mushkëritë	a)	1. E formojnë tingullin duke u dridhur.
Gjuha	b)	2. E shtynë ajrin që shërben për krijimin e tingullit.
Tejzat e zërit (kordat zanore)	c)	3. Ndhmon në nyjëtimin e tingujve në pozicione të ndryshme.
Epiglota	ç)	4. E mbyll gabzherrin gjatë gëlltitjes për të mbrojtur rrugët e frymëmarrjes.

SISTEMI FONETIK DHE GRAFIK I GJUHËS SHQIPE

Gjuha standarde shqipe ka **36 tinguj (fonema)**. Në të shkruar, çdo tingull (fonemë) paraqitet me një shkronjë të veçantë dhe çdo shkronjë përfaqëson një tingull të vetëm. Kështu, sistemi grafik i gjuhës shqipe është i rregullt dhe i kuptueshëm.

Tridhjetë e gjashtë fonemat e gjuhës shqipe ndahen në:

- **7 zanore:** a, e, ë, i, o, u, y.
- **29 bashkëtingëllore:** b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh.

DALLIMET KRYESORE MIDIS ZANOREVE DHE BASHKËTINGËLLOREVE

Kur shqiptojmë **zanoret**, rryma e ajrit kalon lirshëm nëpër gojë, pa u penguar nga asnjë organ i të folurit. Për këtë arsye, zanoret janë tinguj të qartë dhe të plotë që mund të formojnë rrokje edhe vetë. P.sh.: **e**-rë, **u**-jë etj.

Kur shqiptojmë **bashkëtingëlloret**, rryma e ajrit pengohet për një çast nga organet e të folurit, si: buzët, gjuha, dhëmbët ose qiellza. Kjo pengesë ndihmon në formimin e tingullit.

Zanoret formojnë rrokje. Bashkëtingëlloret nuk mund të formojnë rrokje pa një zanore.

Zanoret janë më të zëshme dhe më të qarta, sepse ajri kalon lirshëm, pra pa pengesa në gojë. **Bashkëtingëlloret janë më të dobëta**, sepse krijohen me pengesa dhe nuk dëgjohen po aq qartë kur shqiptohen veçmas. Ky ndryshim vërehet qartë edhe kur shqiptojmë fjalë, si:

- **det** – zanorja **e** dëgjohet qartë dhe është më e zëshme se bashkëtingëlloret **d** dhe **t**.
- **yll** – zanorja **y** mbart zërin kryesor të fjalës; **ll** është më e butë dhe më pak e dëgjueshme.

ZANORET DHE KLASIFIKIMI I TYRE

Gjuha standarde shqipe ka shtatë zanore: **a, e, ë, i, o, u, y**.

Zanoret janë tinguj të gjuhës që prodhohen kur rryma e ajrit del lirshëm nga goja, pa u penguar nga organet e të folurit. Klasifikimi i tyre bazohet në:

- **Pozicionin e gjuhës** gjatë shqiptimit (në dy drejtime: përpara–prapa dhe lart–poshtë).
- **Pozicionin e buzëve.**

1. Sipas pozicionit të gjuhës në drejtim horizontal (të radhës)

Kur gjuha lëviz përpara ose prapa (horizontalisht), zanoret ndahen në:

- **të përparme: i, y, e** – maja e gjuhës afrohet te dhëmbët e poshtëm, kurse pjesa e mesme e saj, ngrihet drejt qiellzës së fortë.
- **të mesme (qendrore): ë, a** – e gjithë shpina e gjuhës ngrihet në mes të gojës, pa u shtyrë shumë as përpara, as mbrapa.
- **të prapme: u, o** – gjuha tërhiqet prapa, maja e saj largohet nga dhëmbët e poshtëm, kurse pjesa e pasme e shpinës së gjuhës ngrihet drejt qiellzës së butë.

2. Sipas pozicionit të gjuhës në drejtim pingul (vertikal) – ngritjes së gjuhës drejt qiellzës

Gjuha ngrihet ose ulët në gojë, duke bërë që goja të hapet më shumë ose më pak gjatë shqiptimit të zanoreve. Në bazë të këtij pozicioni, zanoret ndahen në:

- **të mbyllura: i, y, u** – gjuha ngrihet lart, kurse goja është pak e hapur.
- **gjysmë të hapura: e, ë, o** – gjuha është ngritur mesatarisht drejt qiellzës, kurse goja është pak më e hapur se te zanoret e mbyllura.
- **të hapura: a** – gjuha është në pozicionin më të ulët dhe goja hapet më shumë se për çdo zanore tjetër.



Në figurën e dhënë tregohet qartë se në cilat pjesë të gojës formohen zanoret e shqipes. Duhet pasur parasysh se gjatë shqiptimit të zanoreve **u, y** dhe **o**, përveç lëvizjes së gjuhës, marrin pjesë edhe buzët.

3. Sipas pozicionit të buzëve

Gjatë nyjetimit të zanoreve buzët mund të rrumbullakosen e të zgjaten përpara. Në bazë të pozicionit të buzëve zanoret ndahen në:

- **të buzorëzuara (labiale): y, u, o** – buzët rrumbullakosen dhe shtyhen përpara.
- **të pabuzorëzuara (jolarbiale): i, a, e, ë** – buzët nuk lëvizin, qëndrojnë natyrshëm.

GRUPET (TOGJET) E ZANOREVE DHE DIFTONGJET

Në gjuhën shqipe, kur takohen dy zanore njëra pas tjetrës, ato mund të shqiptohen:

- secila më vete, në rrokje të ndara → **grup (tog) zanoresh**.
- së bashku, në një rrokje të vetme → **diftong**.

Çfarë janë grupet (togjet) e zanoreve?

Grup (tog) zanoresh kemi kur secila zanore shqiptohet veçmas dhe formon një rrokje të veçantë.

Grupet më të zakonshme të zanoreve në gjuhën standarde shqipe janë:

- **ie** → *diell, fier, përziej*.
- **ua** → *dua, grua, përrua*.
- **ue** → *mësues, dëgjues, tregues*.
- **ye** → *fyell, përlyer, thyer*.

Ndahen në rrokje kështu: *gru-a* (2 rrokje), *më-su-es* (3 rrokje), *fy-ell* (2 rrokje).

Po diftongu çfarë është?

Diftong kemi kur dy tinguj zanorë shqiptohen së bashku brenda një rrokjeje të vetme. Në këtë rast, njëri prej tyre, zakonisht i ose u, nuk shqiptohet si zanore e plotë, por merr vlerën e një gjysmëzanoreje. Prandaj diftongu nuk ndahet në dy rrokje.

Shembuj:

- *kau, lau, thau*.
- *babai, vëllai*.
- *shkoi, ftoi, punoi*.

- *kuadër, kualifikoj.*
- *ia tha, ia mori.*

Nuk themi *ka-u* (2 rrokje), por *kau* (1 rrokje). Po ashtu, *vëllai* ka **dy rrokje** (vë-llai), jo tri: *vë-lla-i* — sepse **ai** formon diftong në një rrokje. Edhe tek ***ia tha***, trajta e shkurtër e shkrirë e përemrit vetor ***ia*** është **një rrokje e vetme**, jo *i-a*.

Si t'i dallosh lehtë?

- Kur zanoret shqiptohen ndaras dhe formojnë rrokje të veçanta → kemi tog zanoresh.
- Kur zanoret bashkohen dhe formojnë një rrokje të vetme → kemi diftong.



Të mos harrojmë!

Gjuha shqipe ka **36 tinguj të veçantë (fonema)**:

- **7 zanore.**
- **29 bashkëtingëllore.**

Çdo **fonemë** shënohet me **një shkronjë**, dhe çdo **shkronjë** përfaqëson **vetëm një tingull**. Ky është një nga tiparet më të qarta dhe më të rregullta të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Zanoret janë tinguj që krijohen kur **ajri del lirshëm nga goja**, pa u ndalur ose penguar nga ndonjë organ i të folurit. Ato **mund të shqiptohen edhe vetëm** dhe formojnë **rrokje më vete**. (Shembuj: *a-jo, u-jë*).

Bashkëtingëlloret krijohen kur **ajri përplasat për pak kohë me buzët, gjuhën, dhëmbët apo qiellzën**. Ato **nuk mund të shqiptohen vetëm**, por gjithmonë së bashku me një zanore.

Zanoret ndahen sipas:

- **Pozicionit të gjuhës në gojë** (përpara, në mes apo prapa dhe lart apo poshtë).
- **Pozicionit të buzëve** (nëse janë të rrumbullakosura apo jo).



Sa kuptove? (Për t'i përvetësuar më mirë këto njohuri, përgjigjet janë dhënë menjëherë pas pyetjeve)

- 1. Sa fonema ka gjuha standarde shqipe?**
 - › 36 fonema: 7 zanore dhe 29 bashkëtingëllore.
- 2. Cilat janë 7 zanoret e gjuhës shqipe?**
 - › a, e, ë, i, o, u, y.
- 3. Çfarë ndodh me ajrin kur shqiptojmë një zanore?**
 - › Ai kalon lirshëm nga goja, pa u ndalur nga asnjë pjesë e aparatit të të folurit.
- 4. Pse bashkëtingëlloret nuk mund të qëndrojnë vetëm në një rrokje?**
 - › Sepse nuk mund të shqiptohen pa ndihmën e një zanoreje.
- 5. Si e dallojmë një zanore të përparme?**
 - › Gjuha shtyhet përpara dhe pjesa e saj ngrihet drejt qiellzës së fortë (shembuj: i, y, e).
- 6. Cilat zanore shqiptohen me buzë të rrumbullakosura?**
 - › u, o, y.
- 7. Jep një shembull fjale ku zanorja është më e zëshme se bashkëtingëlloret.**
 - › Te fjala “det”, zanorja “e” dëgjohet më qartë se “d” dhe “t”.



Mos i ngatërroni!

✗ **M** nuk është rrokje – është vetëm një bashkëtingëllore.

✓ **Ma** është rrokje, sepse ka zanore.

✗ *Shkronja* dhe *tingulli* **nuk janë e njëjta gjë.**

– Shkronja është shenjë që e shkruajmë.

– Tingulli është ajo që e dëgjojmë.

✗ Jo të gjitha zanoret shqiptohen njësoj.

– **a** është e hapur.

– **u** është e mbyllur dhe e buzorëzuar.



Ushtrime

Përshkruaj në fletore dhe:

1. Nënvizoz zanoret në fjalët e mëposhtme:

yll, erë, rrugë, oborr, këngë, ajo, ikonë.

–

2. Ndaj fjalët në rrokje:

<i>banane</i>	→	ba-na-ne
<i>nxënës</i>	→	_____
<i>ujëvarë</i>	→	_____
<i>gjimnaz</i>	→	_____
<i>autobus</i>	→	_____
<i>babai</i>	→	_____
<i>punoj</i>	→	_____

BASHKËTINGËLLORET DHE KLASIFIKIMI I TYRE

Bashkëtingëlloret janë tinguj që shqiptohen kur vala e ajrit pengohet në pjesë të ndryshme të zgavrës së gojës. Kjo pengesë krijon zhurmë, ndaj bashkëtingëlloret nuk mund të qëndrojnë vetëm në shqiptim dhe gjithmonë mbështeten te një zanore për të formuar rrokje.

Për ta kuptuar më qartë ndërtimin e tyre dhe për t'i shqiptuar drejt, bashkëtingëlloret ndahen sipas tri tipareve kryesore: **vendit ku formohen, mënyrës si formohen dhe nëse përfshihet ose jo zëri gjatë shqiptimit.**

1. Bashkëtingëlloret e shqipes së sotme standarde, sipas vendit të formimit, ndahen në:

Buzore: p, b, m, f, v.

p, b, m janë dybuzore, sepse shqiptohen me të dyja buzët.

f, v janë buzore-dhëmbore, sepse buza e poshtme takon dhëmbët e sipërm.

Dhëmbore: t, d, th, dh, ll.

Shqiptohen me pjesëmarrjen e gjuhës dhe dhëmbëve të sipërm.

Alveolare: c, x, n, s, z, l, rr, r.

Formohen menjëherë pas dhëmbëve, në pjesën e sipërme të gojës.

Paraqiellzore: ç, sh, xh, zh.

Shqiptohen midis alveolës dhe qiellzës së fortë.

Qiellzore: q, gj, nj, j.

Formohen kur gjuha ngrihet drejt qiellzës së fortë.

Prapaqiellzore: k, g.

Formohet kur pjesa e pasme e gjuhës ngrihet dhe afrohet drejt qiellzës së butë.

Grykore: h.

Formohet në grykë, në pjesën e pasme të gojës.

2. Bashkëtingëlloret e shqipes së sotme standarde, sipas mënyrës së formimit, ndahen në:

Mbylltore (shpërthyese): p, b, t, d, k, g, q, gj, c, x, ç, xh.

Ajri ndalet plotësisht dhe pastaj del me shpërthim.

Shtegore (fërkimore): f, v, s, z, sh, zh, h, th, dh, l, ll, j.

Ajri kalon nëpër një shteg të ngushtë duke krijuar zhurmë.

Hundore (nazale): m, n, nj.

Një pjesë e ajrit kalon nëpër hundë.

Dridhëse: r, rr.

Maja e gjuhës dridhet. **Rr**-ja ka më shumë dridhje se **r**-ja.

3. Bashkëtingëlloret e shqipes së sotme standarde, sipas përfshirjes së zërit, ndahen në:

Të zëshme: b, d, dh, g, gj, v, z, zh, x, xh, l, ll, r, rr, j, m, n, nj.

Zëri dëgjohet qartë dhe tejzat e zërit marrin pjesë në shqiptim.

Të pazëshme (të shurdhëta): p, t, th, k, q, f, s, sh, c, ç, h.

Tingujt shqiptohen pa zë, vetëm me zhurmë.

GRUPET (TOGJET) E BASHKËTINGËLLOREVE

Në shumë fjalë shqipe ndodhin dy bashkëtingëllore pranë njëra-tjetrës, të cilat shqiptohen së bashku. Këto quhen **grupe (togje) të bashkëtingëlloreve**.

P.sh.:

mb → mbaj, mbaroj, ëmbël;

nd → nder, këndoj, vend;

ng → ngarkoj, këngë;

ngj → ngjyros, thëngjill, qengj.



Sa kuptove?

1. Pse bashkëtingëlloret nuk mund të qëndrojnë vetëm?
2. Cilat janë tri mënyrat e klasifikimit të tyre?
3. Cilat janë bashkëtingëlloret hundore?
4. Çfarë janë grupet e bashkëtingëlloreve?



Ushtrime

1. **Shkruaj në fletore nga tri fjalë që kanë:**

një bashkëtingëllore buzore

një grup të bashkëtingëlloreve

2. **Shkruaj në fletore përgjigjen e saktë. Cila nga këto fjalë përmban një bashkëtingëllore hundore?**

a) dita.

b) mëngjes.

c) qetë.

ç) shkrim.

NDRYSHIMET FONETIKE TË TINGUJVE

Tingujt e gjuhës nuk qëndrojnë gjithmonë të njëjtë. Gjatë të folurit, ata mund të ndryshojnë në shqiptim, të bien, të ndryshojnë vend, ose të ndikohen nga tingujt përreth. Këto quhen **ndryshime fonetike** dhe ndahen në dy grupe kryesore: **ndryshime historike** dhe **ndryshime të gjalla**.

NDRYSHIMET HISTORIKE

Ndërrimet historike janë ndryshime që kanë ndodhur në të kaluarën gjatë zhvillimit të gjuhës. Ato janë ruajtur në forma të ndryshme fjalësh që përdorim edhe sot, por nuk ndodhin më si procese në fjalë të reja. P.sh.:

I. Ndërrimet metafonike të zanoreve

a > e: *dash/desh, plak/pleq, natë/net, marr/merr, dal/del, thërras/thërret, pashë/pe, lashë/le.*

e > i: *merr/mirrni, dredh/dridhni, fsheh/fshihni, flet/flisni, pres/prisni, vete/vini, ngre/ngrini, fle/flini.*

ie (je) > i: *ndiej/ndihet, ziej/zihet, përziej/përzihet, shpie/shpihet.*

o > e: *shoh/sheh, njoh/njeh, i vogël/të vegjël.*

II. Ndërrimet apofonike të zanoreve

a > o: *dal/dola, marr/mora.*

e > o: *zgjedh/zgjodha, hedh/hodha, mbledh/mblodha, them/thotë.*

je > o: *djeg/dogja, mjel/mola, nxjerr/nxora, pjek/poqa, rrjedh/rodha, sjell/solla, vjedh/vodha, vjel/vola, vjell/volla.*

III. Qiellzorizime e bashkëtingëlloreve

k > q: *mik/miq, ujk/ujq, peshk/peshq, fik/fiq, rrezik/rreziqe.*

g > gj: *zog/zogj, gardh/gjerdhe, i vogël/të vegjël, djeg/dogja.*

NDYSHIMET E GJALLA

Ndryshimet e gjalla janë ndërrime të tingujve që ndodhin sot gjatë të folurit. Ato ndodhin kur një tingull ndikon te një tjetër pranë tij, për ta shqiptuar më lehtë dhe më rrjedhshëm. Ndryshimet e gjalla quhen edhe **ndërrime (ndryshime) kombinatorike**. Ato nuk janë të njëjta në të gjitha të folmet, por disa prej tyre janë të pranishme edhe në gjuhën standarde. Ndryshimet e gjalla ndihmojnë në rrjedhshmërinë dhe lehtësinë e shqiptimit.

QIELLZORIZIMI, BUZORËZIMI, VELARIZIMI

Bashkëtingëlloret mund të ndryshojnë vendin e shqiptimit sipas zanoreve që vijnë pas tyre:

Qiellzorizimi: bashkëtingëlloret [k], [g] bëhen më të buta (qiellzore) para [i] ose [y] – *kile*, *ky*, *gips*, *gyp*.

Buzorëzimi: bashkëtingëlloret si [d], [z], [g], [t], [s], [k] shqiptohen duke rrumbullakuar buzët kur pasohen nga [y] ose [u] – *dy*, *zyrë*, *gyp*, *tytë*, *sytë*, *ky*, *gur*, *supë*, *kur* etj.

Velarizimi: zanorja [i] në kontakt me bashkëtingëlloren [l] shqiptohet si prapagjuhore – *ujelli*, *dielli*, *qielli*.

Edhe te zanoret vërehet dukuria e **qiellzorizimit**: *qengji* > *qingji*, *gjëmon* > *gjimon*, *dhembje* > *dhimbje*, ***qëroj*** > ***qiroj*** dhe e **buzorizimit**: *kripë* > *krypë*, *hipi* > *hypi*, *rripi* > *rrypi*, ***krimbi*** > ***krymbi*** etj.

ASIMILIMI

Asimilimi është ndërrimi fonetik që pëson një zanore ose bashkëtingëllore në kontakt me një tjetër brenda një fjale: *numër* > *numur*. Asimilimi mund të jetë:

- **i plotë** (tingujt bëhen plotësisht të njëjtë):

numër > *numur*,
çarape > *çarape*,
fytyrë > *fëtyrë*,
mitraloz > *mitroloz*.

- **i pjesshëm** (tingujt afrohen në disa tipare):

m + *pas* → [*mbas*],
s'dua → [*z'dua*] etj.

- **progresiv** (i pari modifikon të dytin):

m + prapa → [mbrapa],

m + pas → [mbas].

- **regresiv** (i dyti modifikon të parin):

asgjë → [azgjë],

hidhte → [hithte],

punofsha → [punovsha],

ekzekutoj → [egzekutoj],

ngas → [ʔgas],

ngre → [ʔgre],

qenka → [qeʔga],

ngjitem → [ʔgjitem],

ngjaj → [ʔgjaj].

Ky tip asimilimi është më i shpeshtë në shqipen standarde.

DISIMILIMI DHE HAPLOLOGJIA

Disimilimi është dukuri e kundërt me asimilimin. Si rezultat i disimilimit, dy tinguj me tipare të njëjta ose të afërta bëhen të ndryshëm ose largohen në këto tipare: arbitër > albitër, bilbil > birbil, gjarpër > gjalper, pritte > priste, budrum > budrun. Është dukuri dialektore, pra, jo dukuri e shqipes standarde.

Në qoftë se, si rezultat i disimilimit, njëra nga dy rrokjet e njëjta të një fjale bie, kemi dukurinë e **haplologjisë**:

- rëndësia e kësaj **çështjeje** > rëndësia e kësaj **çështje**, shija e kësaj **pijeje** > shija e kësaj **pije** etj.

SHTESAT E TINGUJVE

Shtesat e tingujve mund të jenë në fillim, në mes dhe në fund të fjalës:

- Kur një tingull shtohet në fillim të fjalës, kemi **dukurinë e protezës**:

bletë > *mbletë*,

drejt > *ndrejt* etj.

- Kur një tingull shtohet në trup të fjalës, kemi **dukurinë e epentezës**:

mrekulli > *mbrekulli*,

zemra > *zembra*,

barakë > *barangë*,

të mëdhenj > *të mbëdhenj*.

- Kur një tingull shtohet në fund të fjalës, kemi **dukurinë e epitezës**:

sapun > sapund,
kallam > kallamb,
shkumë > shkumbë,
i lartë > i lartër.

Të gjitha këto janë dukuri dialektore.

RËNIET E TINGUJVE

Rëniat e tingujve mund të jenë në fillim, në mes dhe në fund të fjalës:

- Kur një tingull bie në fillim të fjalës, kemi **dukurinë e aferezës**:

Agimi > Gimi,
Mehmeti > Meti.

- Kur një tingull a grup tingujsh bie në trup të fjalës, kemi **dukurinë e sinkopës**:

shtëpi > shpi,
kështu > kshu,
atëherë > aherë,
ngrihu > ngrihi,
përsesh > pshesh.

- Kur një tingull a grup tingujsh bie në fund të fjalës, kemi **dukurinë e apokopës**:

ishte > ish,
kishte > kish,
erdhi > erth,
gjeti > gjet,
pruri > pru,
kilogram > kilo,
kinema > kino.

Të gjitha këto janë dukuri dialektore.

ELIZIONI

Kur bie një zanore e patheksuar fundore e një fjale, që ndodhet përpara një zanoreje nistore të një fjale tjetër, kemi **dukurinë e elizionit**:

punë e bukur > pun'e bukur,
derë e madhe > der'e madhe.

Tingulli që elidohet më shpesh është ë-ja e patheksuar. Kjo pasqyrohet edhe në rregullat e drejtshkrimit:

M'i dha. ***T'i*** thuash. Do ***t'i*** shkruaj. Do ***t'u*** tregosh. Do ***t'u*** thuash.



Të mos harrojmë!

- **Ndryshimet fonetike** janë ndryshime që pësojnë tingujt gjatë zhvillimit të gjuhës ose gjatë të folurit.
- Ndahen në:
 - › **Ndryshime historike** – kanë ndodhur në të kaluarën (p.sh. dal/dola).
 - › **Ndryshime të gjalla** – ndodhin sot në shqiptim (p.sh. kripë > krypë).
- Llojet kryesore të ndryshimeve janë: **metafonia, apofonia, qiellzorizimi, buzorizimi, asimilimi, disimilimi, haplologjia, shtesa dhe rënia tingujve, elizioni.**
- Shumë prej tyre janë pjesë e të folmeve dialektore, por disa ndodhin edhe në shqipen e sotme standarde.



Sa kuptove?

1. Çfarë është një ndryshim fonetik?
2. Cilat janë dallimet midis ndryshimeve historike dhe të gjalla?
3. Jep nga një shembull për:
 - apofoni,
 - qiellzorizim,
 - elizion.
4. Çfarë ndodh në një haplologji?
5. Në cilin rast ndodh asimilimi i plotë?

THEKSI

ÇFARË ËSHTË THEKSI?

Theksi është shqiptimi i një rrokjeje të fjalës me më shumë fuqi, me më shumë lartësi dhe me më shumë gjatësi se rrokjet e tjera. Rrokja që dallohet nga rrokjet e tjera përmes shqiptimit më të fortë, më të lartë dhe më të gjatë quhet **rrokje e theksuar**, ndërsa të tjerat **rrokje të patheksuara**. P.sh.: fjala *gëzím* (fjala *gëzim* ka dy rrokje: *gë-zim*, dhe theksi bie mbi rrokjen e dytë, *-zim*), *lirí* (*li-rí*), *kalá* (*ka-lá*) etj.

Në përdorimin e zakonshëm të gjuhës së shkruar, shenja e theksit nuk përdoret. Ajo përdoret vetëm në fjalorë, tekste ndihmëse ose materiale shkencore për të treguar shqiptimin e saktë të fjalëve. Theksi shënohet me një vijë të shkurtër (') mbi zanoren e rrokjes së theksuar, si te: gjimnáz, gjimnazíst, maturánt, matematíké, matematikán etj.

VEÇORITË E THEKSIT NË GJUHËN STANDARDE SHQIPE

Në gjuhën standarde shqipe, theksi është:

- **dinamik**, sepse theksi përcaktohet nga **forca (fuqia)** me të cilën shqiptohet një rrokje krahasuar me të tjerat. P.sh.: Në fjalën **bótë**, rrokja **-bó** shqiptohet me më shumë forcë sesa **-të**.
- **i lëvizshëm / i lirë**, sepse theksi nuk ndjek një rregull të njëjtë për të gjitha fjalët. Ai mund të bjerë mbi rrokjen e fundit, të parafundit ose të tretën nga fundi, varësisht nga fjala. P.sh.:
 - ▶ **kalá** → theksi mbi rrokjen e fundit;
 - ▶ **shkóllë** → theksi mbi rrokjen e parafundit;
 - ▶ **kúmbulla** → theksi mbi rrokjen e tretë nga fundi.
- **i palëvizshëm / i qëndrueshëm**, sepse, edhe kur fjala merr forma të ndryshme gramatikore, theksi qëndron në të njëjtën rrokje. P.sh: **mál** → **máli** → *i (e)* **málit** → **málet**.

VENDI I THEKSIT NË FJALË

Në gjuhën standarde shqipe, theksi nuk bie gjithmonë në të njëjtën rrokje të fjalës. Ai mund të bjerë mbi rrokjen e fundit, mbi rrokjen e parafundit ose, më rrallë, mbi rrokjen e tretë nga fundi.

Kur theksi bie mbi rrokjen e fundit, quhet fundor (oksiton): *ushtrí, barí, livádh* etj.

Kur theksi bie mbi rrokjen e parafundit, quhet parafundor (paraoksiton): *shkóllë, bánues, móllë* etj.

Kur theksi bie mbi rrokjen që ndodhet dy ose më shumë rrokje para asaj të fundit, quhet tejfundor (proparaoksiton): *plúhuri, fshéhurazi, kúmbulla* etj. Në gjuhën shqipe, shumica e fjalëve kanë theks fundor ose parafundor. Theksi tejfundor është më i rrallë.

THEKSI I FJALISË

Në gjuhën standarde shqipe, përveç theksit të fjalës, përdoret edhe theksi i fjalisë, i cili bie mbi fjalët që mbartin kuptimin kryesor dhe i japin ngarkesën themelore mendimit. Zakonisht theksohen **foljet, emrat, mbiemrat dhe ndajfoljet**, ndërsa **nyjat, parafjalët, pjesëzat dhe lidhëzat** shqiptohen pa theks. Vendi i theksit të fjalisë ndryshon sipas asaj që dëshiron të nxjerrë në pah folësi: në fjalinë: Ai **lexon** librin, theksi bie mbi foljen lexon, sepse theksohet veprimi; në: Lexon **librin**, theksi kalon mbi emrin librin, sepse vihet në dukje objekti; kurse në rastin: Kush lexon? **Ai** lexon librin, theksi vendoset mbi kryefjalën Ai, për të veçuar kryerësin e veprimit. Në këtë mënyrë, theksi i fjalisë nuk është i fiksuar, por varet nga pjesa e mendimit që kërkon të theksojë folësi.

FJALË QË NUK KANË THEKS

Në gjuhën standarde shqipe nuk kanë theks (nuk theksohen) disa fjalë të vogla shërbyese, si: **nyjat (i, e, të, së)**, trajtat e shkurtra të përemrave vetorë (**më, të, i, e, u**), parafjalët e shkurtra (**në, me, mbi, nën, ndër, nga, te**), pjesëzat (**nuk, mos, ja, të, u**), lidhëzat njërrrokëshe (**e, dhe, se, kur, si, ku, që**), si edhe përemrat pyetës dhe lidhorë (**ç', që**). Këto fjalë nuk theksohen veçmas, por shqiptohen së bashku me një fjalë tjetër të theksuar. Ato kanë funksion ndihmës në ndërtimin e fjalisë dhe nuk mund të qëndrojnë të pavarura në shqiptim.

FJALË PROKLITIKE DHE ENKLITIKE

Në të folur, vetëm fjalët kuptimplote (*emrat, mbiemrat, foljet me kuptim të plotë dhe ndajfoljet*) mund të formojnë fjalë fonetike më vete. Fjalët shërbyese (*nyjat, parafjalët, pjesëzat*) nuk qëndrojnë të vetme, por bashkohen me një fjalë kuptimplote. Fjala kuptimplote bëhet boshti i shqiptimit. Në fjalinë: *Sot do të shkoj në treg*, fjalët shërbyese **do, të, në** nuk mbajnë theks më vete dhe lidhen me fjalët përreth. Këto fjalë të patheksuara quhen **klitike**. Sipas pozicionit ndaj fjalës bosht ndahen në: **fjalë proklitike dhe fjalë enklitike**.

Kur klitiket ndodhen para fjalës kuptimplote, quhen **proklitike**. P.sh.: **i-** *bukur*, **te-** *shkolla*, **me-** *librin*, **e-** *lexova*, **po-** *ujen*, **më-** *tha*, **kam-** *mësuar*.

Kur klitiket ndodhen pas fjalës kuptimplote, quhen **enklitike**. Këto janë zakonisht trajta të shkurtra përemrash që lidhen pas foljes si një trup i vetëm. P.sh.: *ndihmoje!*, **-e** është klitika; *hiqe!*, përsëri klitika **-e**; *përvishju...*! klitika është **-ju**. Në shqiptimin mohues, klitiket nuk lidhen pas foljes, por qëndrojnë para saj si fjalë më vete, si: *mos e ndihmo!*, *mos e hiq!*, *mos iu përvish!*.

Në shqiptim, klitiket dhe fjalët kuptimplote bashkohen në një tërësi dhe ndajnë një theks të vetëm. Pozicioni përpara quhet **proklizë**, ndërsa ai pas fjalës quhet **enklizë**.

VENDI I THEKSIT NË FJALËT E PARME, TË PREJARDHURA DHE TË PËRBËRA (KOMPOZITAT)

Në gjuhën shqipe, vendi i theksit lidhet me mënyrën e formimit të fjalëve. Në **fjalët e parme**, theksi bie në rrënjë të fjalës dhe ruhet në të gjitha trajtat (format) gramatikore, khs.: *djálë, djáli, djálin, djálit*, ose: *qén, qénin, qénit*.

Në **fjalët e prejardhura me prapashtesë**, theksi zakonisht kalon nga rrënja te prapashtesa, khs.: (púnë) *punój, puním, punëtór* dhe (mál) *malór* etj. Përfundimisht bëjnë fjalët me prapashtesat **-as, -ës dhe -je**, ku theksi mbetet në rrënjë, si te *gjlánas, nxénës dhe blérje*.

Në **fjalët e prejardhura me parashtesë**, theksi mbetet në rrënjë, khs.: *përplás, stërgjýsh, mosbesím, nënkuptój*.

Në **fjalët e përbëra (kompozitat)**, theksi vendoset në elementin e dytë formues të fjalës, khs.: *botëkuptím* (botë+kuptim), *mirësjéllje, kryeqytét*.

ROLI FONOLOGJIK I THEKSIT

Dallimi kuptimor i fjalëve në gjuhën shqipe ndonjëherë bëhet edhe me anë të theksit të zanoreve të fjalëve. Kjo ndodh te ato fjalë që kanë të njëjtën përbërje tingujsh dhe përputhen plotësisht në të gjithë tingujt, por nuk përputhen në vendosjen e theksit në një zanore, prandaj ato marrin kuptime të ndryshme. P.sh.: **kursé** (folje në mënyrën urdhërore: *Kursé para!*) dhe **kúrse** (lidhëz me kuptimin *ndërsa*: *Ai mëson, kúrse unë punoj*); **dhé** (emër: *Preku dhéun*) dhe **dhe** (lidhëz: *Uji dhe toka*); **ká** (emër: **Në fshat ka ká**) dhe **ka** (folje: *Ai ka një shtëpi*). Po ashtu, te disa emra, ndryshimi i theksit dallon kuptimin: **bári** (me theks në rrokjen e parafundit, bima) është tjetër nga **barí** (me theks në rrokjen e fundit, ruajtësi i bagëtive). Në këto raste, gjatësia dhe fuqia e rrokjes së theksuar marrin vlerë fonologjike dhe bëhen mjet dallimi kuptimor të fjalëve.

Shënim. Te numërori **dy**, theksi ndryshon në varësi të gjinisë së emrit që pason: përdorim **dý** me *theks të shkurtër* para emrave mashkullorë, si: *dy djem*, dhe **dý** me *theks të mesëm* para emrave femërorë, si: *dý vajza*. Te **grupet (togjet) e zanoreve**, theksi zakonisht bie mbi zanoren e parë, si në: **díell**, **qíell**, *fyell*, *míell*, **mía** (shoqet e **mía**), **ftúa**, *fitúes*, *mësúes* etj.



Të mos harrojmë!

- **Theksi** është shqiptimi i një rrokjeje me më shumë forcë, lartësi dhe gjatësi se të tjerat.
- Në gjuhën shqipe, theksi është: **dinamik**, **i lirë** dhe **i qëndrueshëm**.
- Vendi i theksit në fjalë mund të jetë: **fundor**, **parafundor**, ose **tejfundor**.
- Disa fjalë shërbyese nuk theksohen më vete (*nyja*, *parafjala*, *pjesëza*, *lidhëza*).
- Në fjalinë, theksi bie mbi fjalët që mbartin kuptimin kryesor.
- Ndryshimi i theksit mund të sjellë **ndryshim kuptimi** te disa fjalë (**dhé** emër / **dhe** lidhëz).



Sa kuptove?

1. Çfarë është theksi dhe cilat janë veçoritë e tij në gjuhën shqipe?
2. Jep shembuj të fjalëve me theks fundor, parafundor dhe tejfundor.
3. Çfarë ndodh me theksin në fjalët e prejardhura me prapashtesë?
4. Cilat fjalë nuk mbajnë theks më vete në shqiptim?
5. Jep një shembull ku ndryshimi i theksit ndryshon kuptimin e fjalës.



Mendo dhe shpjego

Shqipto me zë fjalët: **bári** dhe **barí**.

- A kanë të njëjtën kuptim?
- Çfarë ndryshon?



Vëzhgo dhe zbulo rregullin

Përgjigjet e mëposhtme të ndihmojnë ta kuptosh rregullin!

Shqipto me kujdes këto fjalë: *shkóllë, shkóllat, shkóllës, shkóllave*.

Çfarë vëren për theksin në këto fjalë (*shkóllë, shkóllat, shkóllës, shkóllave*)?

- Vërejmë që theksi bie gjithmonë në të njëjtën rrokje, te rrënja e fjalës **shkóll**: ë.
- A ndryshon vendi i theksit kur ndryshon forma e fjalës?
 - ▶ Jo, vendi i theksit nuk ndryshon, mbetet i njëjtë në të gjitha format/trajtat gramatikore.
- Cili rregull i theksit në shqip e shpjegon këtë dukuri?
 - ▶ Rregulli që e shpjegon është se **theksi në gjuhën shqipe është i palëvizshëm / i qëndrueshëm** – ai ruhet në të njëjtën rrokje edhe kur fjala ndryshon trajtën.



DRJETSHKRIM DHE DREJTSHQIPTIM

DREJTSHKRIMI I SHKRONJËS Ë

Përdorimi i shkronjës ë shpesh krijon pështjellim dhe gabime në gjuhën shqipe. Prandaj, nxënësit/nxënëset bëjnë shpesh gabime gjatë përdorimit të kësaj shkronje. Kjo ndodh se në disa raste ë-ja nuk është thjesht zanore, por shërben për të shënuar gjatësinë e zanores paraprake. Për shembull: kunat-kunatë¹ (kunaat), plak-plakë (plaak), lum-lumë² (luum), (unë) të dëgjoj-(ai/ajo) të dëgjojë (dëgjooj) etj.

Shkronja ë përdoret edhe për të treguar shumësin te disa emra. Për shembull: *një mjek – dy mjekë, një student – dy studentë, një punëtor – dy punëtorë, një mekanik – dy mekanikë, një profesor – dy profesorë*. Pra, ë-ja na ndihmon të kuptojmë kur një fjalë është në njëjës dhe kur është në shumës.

Ja disa nga rregullat e përdorimit të kësaj shkronje:

ZANORJA Ë E THEKSUAR

Shkruhen dhe shqiptohen me ë të theksuar të gjitha fjalët që në gegërisht dalin me a të theksuar (pra, me a-hundore). Khs.

Gjuhë standarde shqipe: Gegërisht:

- bëj	- baj
- nënë	- nanë
- (kam) dhënë	- (kam) dhanë
- (i, e) ëmbël	- (i, e) amël
- ëndërr	- andërr
- mbrëmje	- mbramje
- më (pak)	- ma (pak)
- nëntë	- nantë
- (kam) ngrënë	- (kam) ngranë
- një	- nja

¹ kunat – gjinia mashkullore; kunatë – gjinia femërore.

² lum – ndjenjë gëzimi: **Jam shumë lum** (=i lumtur); lumë – rrjedhë uji: **Një lumë kalon mes fshatit**.

Me ë shkruhen dhe shqiptohen edhe të gjitha fjalët e prejardhura ose të përbëra prej tyre, pavarësisht nga lëvizja e theksit, si:

dëmtoj (*damtoj* – në disa të folme), dhënie (*dhanie*), frëngjisht (*frangjisht*), gojëdhënë (*gojëdhanë*) etj.

Por këto fjalë shkruhen me a e jo me ë, si: bamirës (pra, jo **bëmirës*), bamirësi, dhanore, (i, e) mangët, ranor, ranishte, shmang, shmangem, shmangie, zanë, zanore etj.

ZANORJA Ë E PATHEKSUAR

Shkruhen me ë të patheksuar:

- fjalët që kanë ë në rrokjen e parë³ dhe janë fjalë të prejardhura⁴ prej tyre: bërryl, gërryej, këlysh, këmishë, kënaq, kënetë, këput, të këqij, kërcëj, këshill, të mëdhenj, dëlir, kësaj, lëkund, mësyj etj.
- fjalët e formuara nga një temë me -ë dhe ndiqen nga një prapashtesë a temë tjetër që nis me bashkëtingëllore:
anëtar (anë), atëror (atë), bardhësi (i bardhë), botëror (botë), burrëri, burrërore (burrë), copëtoj, copëzoj (copë), drejtësi (i drejtë), anëshkrim (anë), atëherë (atë), bashkëpunoj (bashkë), dhjetëfishoj (dhjetë), i jashtëzakonshëm (jashtë), mirëdita (mirë) etj.
- fjalët e prejardhura nga tema që mbarojnë me bashkëtingëllore, ku zanorja ë është si zanore mbështetëse, si:
armiqësi (armiq), besnikëri (besnik), bujarësi (bujar), djallëzi (djall), harkëtar (hark), kombësi, kombëtar (komb), lajmëtar, lajmëroj (lajm), mjekësi, mjekësor (mjek) etj.

Nuk shkruhen me ë të patheksuar:

- fjalët: amtar (e jo: **amëtar*), besnik, fillestar, furrtar, kishtar, lojtar, meshtar, nevojtar, ngatërrestar, pishtar, rojtar, zyrtar, atdhe etj.
- përemrat, ndajfoljet dhe lidhëzat e përngjitura që kanë si pjesë të parë fjalët gjithë ose kurrë: gjithçka (e jo: **gjihtëçka*), gjithçmos,

³ Khs.: **bë-rryl** – theksi bie mbi rrokjen e dytë, mbi y-në, jo mbi ë-në, prandaj quhet zanore e patheksuar (ë e patheksuar).

⁴ Edhe pse **ë-ja është e patheksuar** dhe ndodhet në rrokjen e parë, ajo **shqiptohet dhe ruhet** në të gjitha format e prejardhura, sepse është pjesë e temës së fjalës, si: **bërrylor**, **bërrylas** etj. Fjalët e prejardhura = fjalë të reja që formohen nga fjalë të tjera me anë të parashtesave, prapashtesave, kompozimit ose konvertimit. P.sh.: **kënetë**, **kënetor**, **kënetëzim**, **kënetëzoj** etj.

gjithfarë, gjithherë, gjithkah, gjithkund, gjithkush, gjithmonë, gjithnjë, gjithsa herë, gjithsecili, gjithsekush, kurrfarë, kurrgjë, kurrkush, kurrkund, kurrsesi etj.

- c) fjalët e përbëra, ku tema e dytë fillon me zanore: bashkautor, bashkudhëtar (bashkë), gojëmbël (gojë), kokulur (e jo: *kokëulur) (kokë), i shumanshëm (shumë) etj.

Por shkruhen me ë: i njëanshëm, zëëmbël (e jo: *zëmbël), sepse ë-ja fundore te tema e parë është e theksuar, si: **një'anshëm** (një'-an-shëm), **zëëmbël** (zê-ëm-bël).

DREJTSHQIPTIMI I ZANORES Ë

► Rregull drejtshqiptimor

Shkronja ë në fund të fjalës shqiptohet vetëm kur është e theksuar. P.sh.:

▲ **Theksohet:** nënë, plakë, (ai/ajo) të shikojë, fëmijë, bukë etj.;

▼ **Nuk theksohet:** këmbë, kënaqësi, drejtësi, gojë, dritë etj.;

Kur ë-ja gjendet në një rrokje të theksuar, ajo shqiptohet qartë – kjo quhet **pozicion i fortë fonetik**, si te fjala **nënë**, **plakë** etj. Por kur është e **patheksuar** dhe ndodhet në fund të fjalës, në një **pozicion të dobët fonetik**, ajo zakonisht nuk shqiptohet, edhe pse shkruhet, si te fjala **këngë**, **gojë** etj.



Të mos harrojmë!

- Shkronja **ë** ndonjëherë është e theksuar (dëgjohet qartë), ndonjëherë jo.
- Edhe kur nuk është e theksuar, **duhet ta shkruajmë**. P.sh.: **këlysh** e jo: *klysh.
- Ajo (pra ë-ja) **ndryshon kuptimin** e fjalës (*plak* – *plakë*) dhe **tregon shumësin** (*mjek* – *mjekë*, *profesor* – *profesorë*).
- Mos harro t'i shkruash me **ë** në fund fjalët, si: matematikë (e jo *matematik), fizikë, muzikë, pikturë, është (e jo *është), këngë, unë (e jo *un) etj.

DREJTSHKRIMI I FJALËVE KU TAKOHEN DY ZANORE

Qarkoni fjalët e shkruara saktë: *diell, e djel, ndiej, nxierr, alkol, pavijon, ndiva, përkthyer, kaisi, aksion, miljon, portier, trajner, medalie, parandjenja, e ndieshme, edukues, i vazhdueshëm, arsyje, ngjyjej.*

Shkruhen me ie:

Emrat tek të cilët grupi i zanoreve ie ndiqet nga një prej bashkëtingëlloreve I, II, r: *e diel, diell, miell, qiell, fier, diellore* (këtu: emër fetar, “diellore e shenjtë”, jo mbiemër si te: “kalendar diellor”) etj.

Të gjitha fjalët e formuara prej tyre, si: *miellës, miellzoj, qiellor, qiellzë, diellishtë, diellzoj* etj.

Foljet te të cilat ky grup zanoreve ndiqet nga mbaresat -j: *përziej, përzierë, ziej, ziente, ndiej, (kam) ndier.*

Shkruhen me je:

Të gjitha fjalët e formuara nga folja **ndiej**: *i ndjeshëm, ndjesi, ndjenjë, parandjenjë* etj.

Fjalët e huaja me -oo- shkruhen me -oo- edhe në gjuhën shqipe: *alkool, kooperativë, koordinatë, zoolog, zoologji, zoologjik, kooperim, kooptim* etj.

Zanoret e njëjta

Në disa fjalë të gjuhës shqipe shpesh hasen njëra pas tjetrës dy zanore të njëjta. Në këto raste ato shkruhen që të dyja: *i paaftë, i paafrueshëm, i paanshëm, i paautorizuar, paanësi, paaftësi* etj.



Mos i ngatërroni!

- **ndiej** (folje), **ndjesi** (emër) dhe **i ndjeshëm, e ndjeshme** (mbiemra) – **jo**: *ndjej, ndiesi, i ndieshëm, e ndieshme.*
- **diell** me *ie* (sepse përfundon me II), por **e diel** (dita) shkruhet ndryshe – **jo**: *djell, dita e djel.*
- **milion** – **jo**: *miljon.*
- **alkool** me *oo*, – **jo**: *alkol.*
- I shkruajmë të dyja zanoret kur janë të njëjta:
- **(i, e) paaftë, paarsye, (i, e) paarsimuar** – **jo**: *paftë, parsimuar.*

DREJTSHKRIMI I FJALËVE QË KANË GRUPET YE, UA, UE

Grupi i zanoreve **ye**:

Shkruhet i plotë te fjalët:

arsye, *i arsye*shëm, **dye**, *fyell*, **lyej**, *p***yes**, *p***yetje**, *th***yej**, *th***yesë** etj.

Grupi i zanoreve **ua**:

Shkruhet i plotë në trup të emrave dhe mbiemrave:

ftua, *grua*, *muaj*, *përrua*, *i hua*j, *i për***muajshëm** etj.

Shkruhet i plotë te foljet me temë me -ua:

shkruaj, *shkrua*jme, *shkrua*ni, **bluaj**, *blua*jme, **bluani** etj.

Shkruhet i plotë në numrin shumës të kohës së kryer të thjeshtë, te habitorja dhe te pjesoret e foljeve me temë me -o:

mësuam, *punu***at**, *lexu***an**; *mësu***akam**, *punu***ake**; *mësuar*, *punu***ar**, *lexu***ar** etj.

Grupi i zanoreve **ue**:

Shkruhet i plotë tek emrat dhe mbiemrat foljorë, të formuar me prapashtesat:

-s, -shëm:

*eduko*j – *eduku***es**;

*gatu***aj** – *gatu***es**;

mësoj – *mës***ues**;

*ndërto*j – *ndërt***ues**;

*shkru***aj** – *shkru***es**;

afroj – *i af***rueshëm**;

*gëzo*j – *gëzu***eshëm**;

*vazhdo*j – *vazhd***ueshëm**;

shoqëroj – *shoqër***ueshëm**.

DREJTSHKRIMI I FJALËVE TË HUAZUARA NGA GJUHËT E HUAJA

Fjalët me prejardhje të huaj që kryesisht i takojnë terminologjisë tekniko-shkencore, shkruhen sipas rregullave të mëposhtme të gjuhës shqipe.

FJALËT ME BURIM NGA GREQISHTJA E VJETËR DHE LATINISHTJA

Shkruhen me **d, t** dhe jo me **dh, th** fjalët ndërkombëtare me burim nga greqishtja e vjetër: *dekagram, dekametër, demokraci, diplomë, hidrogjen, ortopedi, pedagog, antipati, antologji, aritmetikë, etnografi, liturgji, maratonë, telepati, terapi, **termik*** etj.

Shkruhen me **d, t** edhe emrat e përveçëm grekë e romakë, si: *Adanis, Afërdita, Alkibiadi, Dedali, Delfi, Demokriti, Demosteni, Driadat, Fedra, Iliada, Pelidi, Pindari, Leonida, Etiopia, Itaka, Maratona, Metodi, Prometeu, Skitia, Tesalia, Tezeu, Trakia, Zakinti* etj.

Bëjnë përjashtim nga ky rregull fjalët dhe emrat e përveçëm të përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me **th, dh** dhe jo me **t, d**, si: *dhaskal, dhespot, dhisk (tabaka), dhjak, idhull, themel, Dhimitër, Dhimosten, Athina, Kleanth, Thanas, Themistokli, Theodhor* etj.

Shkruhen me **l** dhe jo me **ll** fjalët e huaja me burim nga greqishtja e vjetër ose latinishtja: *alfa, algoritëm, ambulancë, analogji, antologji, atlas, balonë, balsam, bilanc, biolog, bulon, dialog, diplomaci, filologji, ideologji, kolos, lustër, tablo, spekuloj, zoologji* etj.

Shkruhen me **l** edhe emrat e përveçëm grekë e romakë, si: *Apoloni, Atlantida, Atlantik, Babilonia, Lukiani, Pelagonia, Peloponezi, Penelopa, Platoni, Salusti, **Shila*** etj.

Përjashtim nga ky rregull janë fjalët dhe emrat e përveçëm të përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me **ll**, si: *apostull, ballkanik, ballkon, bllok, busull, çokollatë, dishepull, idhull, gorillë, galloshe, kabllo, kapitull, konsull, orakull, llogari, protokoll, sallë, vullkan* etj.

Fjalët me burim nga latinishtja dhe greqishtja të cilat në gjuhën shqipe kanë një **c** të ndjekur nga zanorja e ose i shkruhen me **c**: *acetik, acetilen, celebrim, celulë, centimetër, central, cerebral, certifikatë, kancelar, koncert, koncesion, proces, agjenci, agjitacion, ciklamin, cinik, citat, deficit, konciz, recension* etj.

Po ashtu, edhe emrat e përveçëm të kësaj kategorie shkruhen me **c**: *Barcelonë, Centauri, Cezari, Cincinati, Horaci, Lukreci, Marciali, Mecena, Sicilia* etj.

Përrjashtim nga ky rregull janë fjalët e përdorimit popullor që prej kohësh shqiptohen me **ç**, si: *biçikleta, çiklist, çiklizëm, çimento, motoçikletë* etj.

FJALËT ME BURIM NGA ANGLISHTJA

Shkruhen me I disa fjalë me burim nga anglishtja, si: *gol, golf, kloun, klub* etj.

Shkruhen me II disa fjalë me burim nga anglishtja, si: *basketboll, futboll, hendboll, penallti, volejball* etj.

FJALËT ME BURIM NGA GJUHËT SLLAVE

Shkruhen me I disa fjalë me burim nga gjuhët sllave, si: *bolshevik, kolkoz, polak, polka* etj.

Shkruhen me II disa fjalë me burim nga gjuhët sllave, si: *bjellorus, sllav, sllovak, slloven, Bjellorusi* etj.



Kuptimi i fjalëve të reja

- **Apostull** – ndjekës dhe përhapës i mësimave të Jezu Krishtit; përdoret edhe për dikë që përhap me përkushtim një ide a bindje.
- **Dishepull** – ndjekës besnik i një mësuesi, ideje ose doktrine.
- **Idhull** – figurë ose person që adhurohet si hyjni ose që nderohet në mënyrë të tepruar.
- **Konsull** – përfaqësues zyrtar i një shteti që vepron në një qytet të huaj për të mbrojtur interesat e shtetasve të tij.
- **Orakull** – vend i shenjtë ku besohej se fliste zëri i perëndive; më gjerësisht, njeri që konsiderohet si burim i pakundërshtueshëm i së vërtetës.
- **Protokoll** – rregullat që përcaktojnë mënyrën e sjelljes dhe zhvillimit të veprimeve në marrëdhënie zyrtare ose ceremoniale.
- **Algoritëm** – varg veprimesh të caktuara që ndjekën për të zgjidhur një problem, sidomos në matematikë dhe informatikë.
- **Bulon** – element metalik cilindrik me filetë që shërben për të lidhur pjesë të ndryshme mekanike.
- **Dhaskal** – mësues në shkollat e vjetra, shpesh me përkatësi fetare.
- **Dhjak** – ndihmës i priftit në kishën ortodokse që kryen shërbesa ndihmëse fetare.
- **Galloshë** – këpucë gome që vishen mbi këpucët për t'i mbrojtur nga uji apo balta.
- **Kolkosz** – fermë bujqësore kolektive në ish-Bashkimin Sovjetik, ku prona ishte e përbashkët.
- **Polka** – valle popullore me ritëm të shpejtë, me origjinë nga Evropa Qendrore; përdoret edhe për të përshkruar stilin muzikor të saj.

PËRDORIMI I SHKRONJËS SË MADHE

- Nënvizoni rastet e përdorimit të shkronjës së madhe.
- Argumentoni përdorimin e tyre për çdo rast duke u mbështetur në njohuritë tua të fituara gjatë shkollimit nëntëvjeçar.

Një mëngjes të ftohtë janari, Arbri mori lajmin se në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë do të mbahej një ekspozitë për historinë e letërsisë shqipe. Profesori i gjuhës shqipe, zoti Jon Sulejmani, i cili jepte mësim në gjimnazin "Zef Lush Marku" të qytetit të Shkupit, vendosi të çonte klasën e tij në Tiranë për të marrë pjesë në ekspozitë. Gjatë rrugës, ndaluan edhe në Elbasan për të vizituar kalanë dhe Muzeun Etnografik.

Në sallën kryesore të ekspozitës, nxënësit panë dorëshkrime të vjetra të autorëve të Rilindjes Kombëtare. Pjesë e ekspozitës ishin edhe dorëshkrimet e Naim Frashërit, Sami Frashërit dhe Jeronim de Radës. BKSH-ja ka edhe koleksione të rralla të gazetave të viteve 1912–1944, ku ndër të tjera gjenden edhe shkrime për Luftën e Parë Botërore dhe ngjarjet që lidhen me Shqipërinë e asaj kohe.

Pas vizitës, të gjithë shkuan në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe u ndalën për foto pranë godinës së kryeministrit.

Kjo përvojë mbeti gjatë në kujtesën e Arbrit. Ai vendosi që për projektin e radhës në lëndën e gjuhës shqipe të shkruante për figurën e De Radës dhe ndikimin e tij në identitetin shqiptar.

Me shkronjë të madhe fillon:

- një tekst;
- një paragraf;
- një fjali.

Me shkronjë të madhe janë shkruar (në tekstin e mësipërm):

- **Emrat e përveçëm, si:** Arbri, Jon Sulejmani, Sami Frashëri, Jeronim de Rada (De Rada), Shqipëria, Elbasan, Shkup, Tiranë;
- **Institucionet dhe organizatat, si:** Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, BKSH-ja, Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Muzeu Etnografik;
- **Ngjarjet historike, si:** Rilindja Kombëtare, Lufta e Parë Botërore;
- **Emrat e vendeve publike dhe rrugëve, si:** bulevardi "Dëshmorët e Kombit", gjimnazi "Zef Lush Marku".

Me shkronjë të vogël janë shkruar (në tekstin e mësipërm):

- **Emrat e përgjithshëm, si:** profesor, nxënës, klasë, sallë, ekspozitë, udhëtim, lëndë, projekt, dorëshkrim, foto, godinë etj.

KUR PËRDORET SHKRONJA E MADHE?

Në gjuhën shqipe, shkronja e madhe përdoret për të dalluar emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm. Ajo përdoret gjithashtu në fillim të çdo teksti, paragrafi dhe fjalie.

Me shkronjë të madhe shkruhen:

1. Emrat dhe mbiemrat e njerëzve

Gjergj Kastrioti, Shaban Tërstena, Majlinda Kelmendi, Yll Sulejmani etj.

2. Epitetet:

Leka i Madh, Akili Këmbëshpejti etj.

3. Nofkat dhe pseudonimet e autorëve:

Pleshti, Çajupi, Migjeni, Dema, Lumo Skëndo etj.

4. Emrat e figurave mitologjike e fetare dhe tregimeve popullore:

Ademi, Eva, Apoloni, Diana; Borëbardha, e Bukura e Dheut, Kukudhi, Gjergj Elez Alia etj.

5. Emrat e kafshëve (kur janë të përveçëm):

Balozi, Maçoku Plak, Baloja, Akela, Kiti, Tigri etj.

6. Emërtimet e planetëve, yjeve dhe trupave qiellorë:

Dielli, Hëna, Toka, Plutoni, Arusha e Madhe, Rrugë e Qumështit etj.

7. Emrat e vendeve dhe hapësirave gjeografike:

Maqedonia e Veriut, Shkupi, Kumanova, Tetova, Gostivari, Struga, Kërçova, Manastiri, Liqeni i Ohrit, Kosova, Prizreni, Shqipëria, Elbasani, Evropa, Amerika Veriore, Alpet, Drini, Deti i Zi, Rrafshi i Dukagjinit, Qafa e Thanës etj.

8. Emrat e shesheve, rrugëve dhe lagjeve:

Sheshi Skënderbeu, Sheshi Nëna Terezë, Çarshia e Vjetër, Sheshi i Flamurit, Sheshi Iliria, Blloku, Lagjja Dardania etj.

9. Emërtimet e ngjarjeve dhe të dokumenteve historike:

Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore, Lufta e Ftohtë, Rilindja Kombëtare Shqiptare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Kuvendi i Lezhës, Kongresi i Manastirit, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, Pakoja e Ahtisarit, Deklarata e Pavarësisë, Monumenti i Shpalljes së Pavarësisë, Programi i Lidhjes së Pejës etj.

10. Emërtimet zyrtare të institucioneve dhe organizatave:

Republika e Kosovës, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Tetovës, Universiteti "Nënë Tereza", Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

11. Emërtimet e festave:

28 Nëntori, 17 Shkurti, Tetë Marsi (8 Marsi), Dita e Mësuesit, 1 Maji – Dita Ndërkombëtare e Punës, Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, Bajrami i Madh, Pashkët, Dita e Verës etj.

12. Titujt e veprave dhe botimeve:

Në tituj shkruhet me shkronjë të madhe vetëm fjala e parë dhe çdo emër i përveçëm brenda tij: "Historia e Skënderbeut", "Komedia hyjnore", "Jeta arbëreshe" "Kronikë në gur", "Jeta e përditshme në Shqipëri" etj.

13. Shkurtime të institucioneve dhe organizatave:

RTK, FIFA, OKB, BE, SHBA, RSH (Radio Shkupi), TVM, MASH, UNESCO etj.

**Rregull drejtshkrimor**

Kur emri i huaj thuhet i plotë, fjalët, si: *de, van, da*, shkruhen me shkronjë të vogël, si te: **Jeronim de Rada, Robin van Persi, Leonardo da Vinçi, Ludvig van Betoven** etj. Por, kur përdorim vetëm mbiemrin, ato shkruhen me shkronjë të madhe, si: **De Rada** ishte poet, **Van Persi** futbollist, **Da Vinçi** piktor dhe **Van Betoveni** kompozitor i njohur.

**Të mos harrojmë!**

- Shkronja e madhe përdoret në fillim të çdo **teksti, paragrafi dhe fjalie**.
- Me shkronjë të madhe shkruhen **emrat e përveçëm, vendet, festat, institucionet, ngjarjet historike, titujt e veprave dhe shkurtime të zyrtare**.
- Te emrat e huaj, fjalët *de, da, van* shkruhen **me të vogël** kur **emri** jepet i plotë (*Jeronim de Rada*), por me **të madhe** kur përdoret vetëm **mbiemri** (*De Rada ishte poet*).

**Kuptimi i fjalëve të reja**

- **Ekspozitë** – vend ku shfaqen libra, piktura, sende historike etj.
- **Dorëshkrim** – tekst i shkruar me dorë, zakonisht i vjetër dhe me vlerë historike.
- **Institucion** – organizatë zyrtare që kryen një funksion të rëndësishëm për shoqërinë (si shkolla, ministria, biblioteka).
- **Epitet** – cilësi që i bashkëngjitet një emri për ta përshkruar më mirë (si "i Madh" te Leka i Madh).
- **Monument** – zakonisht do të thotë një objekt i ndërtuar për kujtim (si një shtatore), por **në këtë tekst**, ka kuptimin e një **dokument historik me vlerë të madhe kombëtare**, siç është "**Monumenti i Shpalljes së Pavarësisë**", që përmban tekstin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë më 1912.

SHKRIMI I FJALËVE NJËSH, NDARAS DHE ME VIZË NË MES

Në gjuhën shqipe, disa fjalë shkruhen gjithmonë bashkë (njësh), sepse përbëjnë një njësi leksikore të vetme, të pandashme dhe me kuptim të plotë. Disa të tjera shkruhen ndaras, sepse janë ndërtuar nga fjalë të pavarura që ruajnë vlerën e tyre të veçantë dhe nuk krijojnë një fjalë të vetme. Ndërkaq, disa të tjera me vizë në mes që shërben për të bashkuar fjalë që kanë kuptim të ndërlidhur.

FJALËT QË SHKRUHEN NJËSH

Shkruhen bashkë fjalët që kanë kuptim të plotë dhe formojnë një njësi të vetme.

1. Fjalët me parashtesa:

mospërfillje, kundërvënie, nëndrejtor, parafytyrim, parashkollor, sipërmarrje, riatdhesim etj.

2. Fjalët e përbëra me kuptim të plotë dhe të qëndrueshëm:

bashkatdhetar, bashkëjetesë, besëlidhje, bojëbizele, botëkuptim, datëlindje, dëmshpërblim, dobiprurës, dritëshkurtër, duarkryq, dyujeçar, elektromagnetik, faqebardhë, fjalëformim, fjalëkryq, flokëgështenjë, flokëpakrehur, fotoekspozitë, fuqiplotë, frymëmarrje, kokëfortë, krahëhapur, kryemjek, kryeqytet, kundërpërgjigje, letërnjoftim, liridashës, luledele, marrëveshje, ndihmësmjek, orëndreqës, paqedashës, paraardhës, parathënie, pikëmbështetje, pikënisje, pjesëmarrës, i porsaardhur, procesverbal, projektbuxhet, qymyrguri, syshqiponjë, ultratingull, vendburim, vendkalim, zëvendësministër etj.

3. Fjalët e përbëra me lidhje këpujore:

dritëhije (kupto: dritë dhe/e hije), hekurbeton, juglindje, këmbadoras, marrëdhënie, pulagjel, shitblerje, shurdhmemec, veriperëndim, veshmbathje etj.

4. Emra të përngjitur tradicionalë:

farefis, fëshfëshe, gjëgjëzë, qoftëlargu, rraketake, shtojzovalle, taketuke, thashetheme etj.

5. Numërorë të përngjitur:

njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë, nëntëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë, (i,e) njëqindmijtë (p.sh.: kilometri i njëqindmijtë), (i,e) pesëqindënjëzetënjëtë, (i,e) njëzetënjëtë (p.sh.: është nxënësi i njëzetënjëtë në radhë) (i,e) njëqindënjëzetënjëtë (p.sh.: banesa ndodhet në katin e njëqindënjëzetënjëtë) etj.

6. Përemra pacaktuar të përngjitur:

asgjë, cildo, çdonjëri, diçka, dikush, disa, gjithçka, gjithkush, gjithsecili, kurrfarë, kurrgjë, kushdo, ndokush, ndonjë, secili, secilido, sekush, sikush, tjetërkush etj.

7. Ndajfolje dhe parafjalë të përngjitura:

anëmbanë, askund, askurrë, asnjëherë, asodore, aspak, atëbotë, atëherë, brendapërbrenda, buzagaz, duarplot, gjithandej, gjithherë, gjithkah, gjithkund, gjithmonë, menjëherë, pardje, pareshtur, përpara, përpjetë, përqark, përreth, përsëri, prapëseprapë, rrallëherë, sakaq, sakaqherë, sidokudo, tekdo, vetvetiu etj.

8. Lidhëza të përngjitura:

derisa, domethënë, gjersa, kurse, megjithatë, megjithëse, meqenëse, meqë, mirëpo, ndërsa, ndonëse, ngaqë, qëkurse, sesa, siç, sikur, veçse etj.

9. Pjesëza të përngjitura:

kushedi, pikësëpari, pothuaj, pothuajse, seç, thuajse etj.

10. Pasthirrma të përngjitura:

obobo, ububu, faleminderit, lamtumirë, mirëdita, mirupafshim, tungjatjeta etj.

FJALËT QË SHKRUHEN NDARAS

Shkruhen ndaras ato fjalë që janë pjesë e një grupi emëror, e një shprehjeje ose e një emërtimi të përbërë.

1. Grupi emëror: emër në rasën emërore + emër në rasën rrjedhore:

bar blete, bar miu, lule sahati, vaj peshku, lule blete, lule gjaku, lule dhensh etj.

2. Grup emëror me kuptim mbiemëror të përbërë nga emrat "bojë"/"ngjyrë" + emër në rasën rrjedhore:

bojë (ngjyrë) argjendi, bojë (ngjyrë) ari, bojë (ngjyrë) dheu, bojë (ngjyrë) ulliri, bojë (ngjyrë) uthulle, bojë (ngjyrë) vaji etj.

3. Ndajfoljet dhe shprehjet ndajfoljore:

së afërmi, së bashku, së fundi, së jashtmi, së larti, së paku, së pari, së toku, më së miri, për së afërmi, për së gjalli, më dysh, më tresh, për dy, për tre etj.

4. Shprehjet ndajfoljore të formuara nga dy fjalë të njëjta ose të ndryshme, të lidhura në mes tyre me një parafjalë ose me lidhëzën e:

këmbë mbi këmbë, ditë me ditë, buzë më buzë, gojë më gojë, ca nga ca, rrugë pa rrugë, brez pas brezi, herë pas here, aty për aty, ballë për ballë, mes për mes, mot për

mot, pikë për pikë, vit për vit, fund e krye, kokë e këmbë, lesh e li, qesh e ngjesh, shkel e shko, rreth e rrotull, veç e veç, rreth e (për)qark etj.

5. Numërorë themelorë të formuar me pjesëmarrjen e fjalëve mijë, milion, miliard etj., si dhe pjesët përbërëse të një numri themelor, të lidhura me lidhëzën e:

një mijë, pesëmbëdhjetë mijë, një milion, pesë milionë, një miliard, dhjetë miliardë, njëzet e një, tridhjetë e katër, dyzet e katër, njëqind e pesëdhjetë etj.

6. Shprehje parafjalore ose lidhëzore:

aq sa, ashtu si, deri ku, duke qenë se, edhe pse, edhe sikur, gjer kur, gjer në, gjer te, kaq sa, kështu që, mjaft që, në qoftë se, në mënyrë që, po qe se, po të jetë se, tekdo që sido që, vetëm se etj.

7. Shprehje pasthirmore për përshëndetje, urime, falënderime, ngushëllime etj.:

Mirë se vini!, Mirë se erdhe!, Mirë ardhshi!, Mirë ju gjetshim!, Për shumë vjet gëzuar!, Me shëndet!, Shëndet paçi!, Ju falemi nderit!, Të rrosh vetë!, Si urdhëroni! Natën e mirë! Ditën e mirë! etj.

DREJTSHKRIMI I FJALËVE ME VIZË NË MES/VIZË LIDHËSE

Viza lidhëse përdoret për të bashkuar dy fjalë që kanë kuptim të lidhur. Ajo ndihmon të formojmë fjalë të përbëra, të përsëritura ose që shprehin lidhje mes pjesëve. Me vizë lidhëse në mes shkruhen:

1. Formimet e përfutuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajta të ndryshme:

copë-copë, duar-duar, fije-fije, fletë-fletë, grupe-grupe, herë-herë, kokrra-kokrra, kuti-kuti, lara-lara, lloj-lloj, ngjyra-ngjyra, palë-palë, petë-petë, pika-pika etj.

2. Formimet e përfutuara nga bashkimi i dy antonimeve:

aty-këtu, hyrje-dalje, pritje-përcjellje, vajtje-ardhje etj.

3. Formimet e përfutuara nga bashkimi i dy numërorëve themelorë, për të treguar një sasi të përafërt:

dy-tri (orë), dhjetë-pesëmbëdhjetë (vjet), katër-pesë (veta), pesë-gjashtë (ditë) etj.

4. Formimet onomatopeike të përfutuara nga përsëritja e një fjale në të njëjtën trajtë ose në trajtë të ndryshuar:

bam-bam, ciu-ciu, ham-ham, hum-hum, kuak-kuak, llap-llap, bam-bum, fap-fup, gau-giu, paf-puf, tik-tak, gëk-mëk etj.

5. Emërtimet e përbëra të njësive të matjes⁵:

ditë-punë, kuaj-fuqi, kilovat-orë, orë-makinë, orë-normë, ton-kilometër, vit-dritë etj.

6. Emërtimet e tipit:

bar-bufe, hotel-restorant, kafe-restorant, dhomë-muze, shtëpi-muze, dyqan-shtëpi, hotel-pension etj.

7. Formimet kryesisht mbiemërore që shprehin marrëdhënie plotësuese ose të ndërsjella:

historiko-geografik, politiko-kulturor, analitiko-sintetik, afro-aziatik, anglo-amerikan, austro-hungarez, shqiptaro-grek, trako-ilir etj.

8. Formimet që përmbajnë pjesëzën ish- përpara emërtimeve të ndryshme:

ish-drejtor, ish-ministër, ish-komandant, ish-nxënës, ish-ndërtesa e gjimnazit etj.

9. Emërtimet e përbëra të pikave të horizontit, të formuara prej një fjale të thjeshtë dhe prej një fjale të përbërë:

jug-juglindje, jug-jugperëndim, lindje-verilindje, perëndim-jugperëndim, veri-verilindje etj.

10. Emrat e përbërë të krahinave e të fshatrave:

Fushë-Krujë, Zall-Dajt, Gazi-Babë, Fushë-Kosovë, Shën-Naum, Kriva-Pallankë, Kopačin-Doll etj.

11. Numërorët rreshtorë kur vetë numri ose një pjesë e tij shkruhet me shifra arabe:

klasa e 2-të, viti i 1-rë, kreu i 4-t, e 9-ta A, Kongresi i 6-të, shekulli i 21-të, i 50-mijëti, 400-shi, 500-shi, 300 000-shi ose 300-mijëshi etj.

12. Emërtimet e përvjetorëve dhe formimet e ngjashme me to, kur numërori shënohet me shifër:

100-vjetori i Pavarësisë; shkolla 9-vjeçare; 15-ditëshi i parë i shtatorit; 30-vjetëshi i parë i shekullit XXI etj.

13. Mbaresat tek emërtimet e shkurtuara të institucioneve, të zyrave, të organizatave etj.:

korrespondentët e ATSH-së (Agjencisë Telegrafike Shqiptare), punonjësja e MASH-it (Ministritë së Arsimit dhe Sportit), nxënësit e ZLM-së (Zef Lush Markut), studentët e UT-së (Universitetit të Tetovës) etj.

14. Fjalët që kanë një fund të përbashkët shkruhen me vizë, duke përmendur vetëm një herë pjesën e përbashkët. P.sh.:

(paketa) katër-a pesëkilogramëshe; (ndërtesa) një-a shumëkatëshe.

⁵ Përdorim vizën për të treguar matje që bëhen me ndihmën e dy fjalëve të lidhura mes tyre. Këto fjalë zakonisht tregojnë njësinë dhe mënyrën e matjes (p.sh.: ton me kilometër, kuaj me fuqi etj.).

Ky rregull përdoret për të mos përsëritur të njëjtën pjesë në fund të disa fjalëve. Në vend që të themi: *paketa katërkilogramëshe dhe pesëkilogramëshe*, shkruajmë më shkurt: *(paketa) katër-a pesëkilogramëshe*, ose *ndërtesa njëkatëshe dhe pesëkatëshe*, shkruajmë shkurt: *(ndërtesa) një-a shumëkatëshe*. Pjesët e para ndahen me vizë lidhëse, ndërsa fundi i përbashkët (në këtë rast: kilogramëshe) shkruhet vetëm një herë.

FJALË QË NUK SHKRUHEN ME VIZË LIDHËSE

- Nuk vendosim vizë lidhëse tek emërtimet gjeografike që si pjesë të parë kanë një nyjë të përpame në gjuhët përkatëse, si: **La, Los, Le** etj.:
 - › *La Paz* (e jo: La-Paz), *La Plata*, *Los Anxhelos*, *Le Mans*, *Le Kaj* (Les Cayes) etj.
- Emrat e huaj me pjesëza si: **d' da, de, von** shkruhen veç:
 - › *Dora d'Istria* (emër letrar i Elena Gjikës), *Leonardo da Vinçi*, *Lope de Vega*, *Gi de Mopasan*, *Sharl de Gol*, *Fridrih von Shiler* etj.



Dora d'Istria.

SHENJA TË PIKËSIMIT

PËRDORIMI I DREJTË I SHENJAVE TË PIKËSIMIT

Shenjat e pikësimit mund t'i ndajmë në shenja pikësimi që përdoren brenda fjalisë dhe në shenja pikësimi që përdoren në fund të saj.

SHENJAT E PIKËSIMIT
QË PËRDOREN BRENDË FJALISË

PRESJA ,

Presja , është një shenjë që përdoret në gjuhën e shkruar për të ndarë a veçuar fjalë a grupe fjalësh të një fjalie:

Kënga e saj, sado që u interpretua bukur, nuk më la mbresa.

Në gjuhën e folur, ajo i përgjigjet një pushimi të shkurtër.

PIKËPRESJA ;

Pikëpresja ; ndan më prerë se presja pjesë të ndryshme të pavarura të një fjalie të përbërë:

Ky me katër veta u vendos kundrejt portës kryesore të kështjellës; të tjerët kundrejt livadhishtave nga ana e Shkupit.

Në gjuhën e folur, ajo shënon një pushim më të gjatë se presja.

VIZAT DHE THONJËZAT – („...” ”...”)⁶

Vizat dhe thonjëzat – „ ... ” kryesisht shërbejnë për të dalluar fjalët e një ose më shumë bashkëbiseduesve në një ligjëratë të drejtë. Për shembull:

– *Ja dhe lajmin Edonit?*

– *Po. Unë i thashë: „Kemi lajme të reja”.*

⁶ Thonjëzat më të zakonshme në gjuhën shqipe janë „ ... ”, që hapen poshtë majtas dhe mbyllen lart djathtas. Thonjëzat e larta, të quajtura edhe angleze ”...”, përdoren më shpesh në kompjuter, sepse ato dalin automatikisht gjatë shtypjes. Kur shkruani me dorë, përdorni thonjëzat e zakonshme të shqipes: „ ... ” – dy poshtë për hapje dhe dy sipër për mbyllje.

Nga dy vizat e përdorura në këtë dialog, kuptojmë që bëhet fjalë për dy folës të ndryshëm. Pjesa e futur mes thonjzave është një riprodhim i saktë i fjalëve të përdorura nga folësi në një situatë tjetër komunikimi.

Thonjzat përdoren për të mbyllur fjalë me ngarkesë emocionale apo me kuptim të veçantë:

Fjala „nënë” është fjala më e dashur në botë.

Thonjzat përdoren për të veçuar emrat e përveçëm a grupet e fjalëve që emërtojnë:

■ **Libra, gazeta, revista, vepra muzikore:**

Në tavolinë mbante pesë numra të gazetës „Koha”.

Ai mbante në dorë librin „Gjuha shqipe 8”.

■ **Rrugë, shkolla, bulevarde, sheshe, lagje, hotele, stadione etj.:**

bulevardi „Dëshmorët e Kombit”, shkolla „Avni Rustemi”, hotel

„Hamburg” etj.

■ **Tituj, urdhra, kur vijnë pas këtyre fjalëve:**

Presidenti e nderoi me urdhrin „Nderi i Kombit”.

DY PIKAT :

Dy pikat : lajmërojnë një shpjegim, një varg shembujsh etj.:

Ata që morën pjesë në shfaqjen e shkollës ishin: nxënësit, familjarët, mësuesit, drejtuesit e shkollës etj.

Dy pikat përdoren midis numrave që tregojnë orët, minutat dhe sekondat:

Kaloi në orën 13:30:05.

Në gjuhën e folur, dy pikat shënojnë një pushim që zgjat thuajse sa pikëpresja.

KLLAPAT ()

Kllapat () shërbejnë për të dalluar, shquar dhe veçuar një grup fjalësh që shprehin një sqarim ose një mendim të ndërkallur:

Më është dashur të dal hapur (mirë apo keq nuk e di) si një luftëtar i lirisë.

Kllapat përdoren për të mbyllur fjalët që zbërthejnë një emërtim të shkurtuar, ose për pseudonimet, për nëntitujt dhe emërtimet e dyta:

Ata u nisën për në OKB (Organizatën e Kombeve të Bashkuara).

Milosh Gjergj Nikolla (Migjeni);

„Dasmë pa nuse” (Komedi).

Përdoren për të mbyllur vitin e lindjes dhe të vdekjes së një autori:

Naim Frashëri (1845–1900).

Në gjuhën e folur, ato shënojnë një pushim të shkurtër, si presja.

SHENJAT E PIKËSIMIT QË PËRDOREN NË FUND TË FJALISË

PIKA .

Pika . shënon mbarimin e një fjalie që **nuk shqiptohet as me intonacion pyetës, as me intonacion thirrëmor**. Në ligjërimin e folur, asaj i përgjigjet një pushim relativisht i gjatë midis fjalive.

Vihet pikë:

a. Në fund të një fjalie dëftore:

Ja, kështu po ngrihej Shqipëria e re, e pavarur, demokratike.

Nuk e përfytyronte dot ndryshe Erlisin, veçse të qeshur e hokatar.

b. Pas një fjale a togu fjalësh ose pas një pjesëze me vlerën e një fjalie, kur nuk shqiptohen me intonacion pyetës a thirrëmor:

Buzëqeshje. Shpërthime të qeshurash. Duartrokitje.

c. Në fund të një fjalie nxitëse jothirrëmore, që shpreh këshillë, porosi, propozim, lejim ose pranim:

Dëgjomëni mua. T'i doni prindërit.

Le t'i diskutojmë propozimet tuaja.

ç. Në fund të një fjalie të përbërë (periudhe):

Ai vetë s'e kuptoi dot ç'e ngriti në këmbë.

Pyete kur do të vijë.

PIKËPYETJA ?

Pikëpyetja ? shënon përfundimin e një fjalie që shqiptohet me intonacion ngjites:

Kur do ta pranosh se kjo është e vërteta?

A do të shkojmë në kinema?

PIKËÇUDITJA !

Pikëçuditja ! shënon përfundimin e një fjalie që shqiptohet me intonacion të veçantë për të shprehur një emocion (gëzim, hidhërim, kundërshti, zemërim):

Sa ma bëtë qejfin që erdhët!

Pikëçuditja vihet pas një thirrori ose një pasthirrme në krye të një fjalie, për t'u vënë në dukje më shumë, për t'u theksuar më shumë:

Tina! Tina! Tina! – thirrën njëzëri.

Pas një onomatopeje që përdoret më vete:

Pam! Pam! Pam! – u dëgjua një krismë.

Ha-ha-ha! – u dëgjuan të qeshura nga jashtë.

TREPIKËSHI ...

Trepikëshi shënon lënien jashtë tekstit të një pjese të tij për arsye të ndryshme:

Atëherë nesër në mesditë...

Në gjuhën e folur, trepikëshi shënon ndërprerjen e ligjërit.

APOSTROFI '

Apostrofi ' është një shenjë si presje, e cila vendoset sipër rreshtit:

T'i hedh uthull sallatës?

Apostrofi përdoret:

Për të shënuar rënien e tingullit ë te fjalët *më* dhe *të*:

m'i tregoi, ***t'i*** lexoi, do ***t'i*** mësoj, për ***t'i*** pasur, me ***t'i*** thënë, do ***t'u*** përgjigjet, për ***t'u*** lexuar, me ***t'iu*** afruar, ***t'ju*** ftojme, ***t'ju*** ndihmojmë, ***t'ua*** sjell, ***t'jua*** sjell, ***t'u*** shtoftë, ***t'u*** realizoftë etj.

Pas pjesës mohuese *s'*:

s'arritëm (dhe jo: sarritëm),

s'erdhi (dhe jo: serdhi),

s'e njoh (dhe jo: senjoh).

Pas përemrit *ç'*:

ç'e do? (dhe jo: çedo?),

ç'është? (dhe jo: çështë?),

ç'donte? (dhe jo: çdonte?).

KUJDES!

Shkruhen pa apostrof:

Përemrat: **çdo** dhe **çfarë** dhe fjalët e formuara prej tyre: **çfarëdo**, **çdonjëri**, **çdokush** etj.

çdo djalë, çdo vajzë, çfarë dëshiron, nuk kuptoj çfarë thua, në çfarëdo kushtesh, çdonjëri nga ne e di, çdokush nga ne etj.



Ushtrime

Shkruaji në fletore alternativat dhe rretho përgjigjen e saktë.

- | | |
|------------------------|---------------------------|
| a. çdo vajzë e klasës | a. do t'ju ndihmoj |
| b. çdo vajzë e klasës | b. do t'ju ndihmoj |
| a. s'e njoh atë nxënës | a. do t'jua sjell nesër |
| b. se njoh atë nxënës | b. do t'jua sjell nesër |
| a. s'arritëm në kohë | a. t'u plotësoftë dëshira |
| b. sarritëm në kohë | b. tu plotësoftë dëshira |
| a. me ti thënë | a. çfarë mendon? |
| b. me t'i thënë | b. çfarë mendon? |
| | a. e njihte çdokush |
| | b. e njihte çdo kush |

NDARJA E FJALËVE NË FUND TË RRESHTIT

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit bazohet në ndarjen e tyre në rrokje, por duhet të ruajë gjithashtu kuptimin dhe ndërtimin e fjalës. Ajo nuk bëhet sipas dëshirës, por sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Andaj, për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit ka disa rregulla:

- **Nuk ndahen fjalët me vetëm një rrokje**, si: *lis, qen, jam*, sepse nuk kanë si të ndahen.
- **Nuk ndahen shkronjat e një dyshkronjëshi**, si: *ll, rr, nj, sh, th, dh, xh, zh, gj*.
Gabim: *mol-la*; drejt: *mo-lla*.
Gabim: *bur-ri*; drejt: *bu-rri*.
- **Nuk lihet një shkronjë vetëm** në fund ose në fillim të rreshtit.
Gabim: *b-uka, buk-a*; drejt: *bu-ka*.
- **Nuk ndahen shkurtimet**, si: *RMV, NATO, RSH, RKS, SHBA, d.m.th., p.sh.*
- **Njësitë e matjes qëndrojnë bashkë me numrin**: *5 kg, 3 m, 100%*.
- **Shenjat e pikësimit, kllapat dhe thonjëzat** nuk qëndrojnë të vetme në fund të rreshtit dhe **nuk kalojnë të shkëputura** në fillim të rreshtit tjetër. Ato duhet të shkruhen **bashkë me fjalën që i përkasin**.
- **Fjalët me më shumë se një rrokje ndahen sipas rrokjeve**:
li-bër, dru-ri, më-su-es-ja, zë-ven-dë-si
Gabim: *pro-fe-so-resh-a*; drejt: *pro-fe-so-re-sha*
- **Kur ka dy a më shumë bashkëtingëllore midis dy zanoresh**, njëra rri me zanoren para, tjetra me të pasmen:
lod-ra, pos-ta, për-parim.
- **Fjalët e përbëra, të prejardhura dhe të përngjitura ndahen sipas pjesëve që i formojnë**:
 - ▶ Të përbëra: *breg-det, këpucë-bërës*.
 - ▶ Të prejardhura: *ri-shikoj, punë-tor*.
 - ▶ Të përngjitura: *para-dite, për-vit*.
- **Te fjalët me vizë lidhëse**, nëse pjesa e dytë kalon në rreshtin tjetër, viza përsëritet në fillim të rreshtit:
vajtje-/ardhje, hyrje-/dalje, lexim-/shkrim, veshje-/zhveshje
- **Lejohet ndarja e dy shkronjave të njëjta që qëndrojnë pranë**:
ko-operativë, pa-arsyeshëm, e gjet-të (e mira).

DREJTSHKRIMI I DATAVE

Në gjuhën shqipe, datat shkruhen sipas disa rregullave të veçanta që përcaktojnë mënyrën e shënimit **të ditës, muajit dhe vitit**, si dhe **përdorimin e shenjave të pikësimit** dhe të parafjalës **më**, sidomos në rastet formale dhe zyrtare.

1. Kur muaji shënohet me shifra (arabe ose romake), pas ditës dhe muajit vihet pikë.

✓ **Shkruhet kështu:** 24.VI.2007 ose 24.6.2007.

✗ **Jo kështu:** 14/6/2007 ose 24-VI-2007.

2. Kur muaji shkruhet me shkronja, nuk përdoret asnjë shenjë ndarëse midis ditës, muajit dhe vitit.

✓ **Shkruhet kështu:** 24 *shtator* 1981, 14 qershor 1977.

✗ **Jo kështu:** 24. *shtator*. 1981, ose 14; qershor; 1977.

3. Në dokumente zyrtare, pas emrit të vendit vihet presje dhe data paraprihet nga parafjala më.

✓ **Shkruhet kështu:** *Shkup, më* 24.6.2007, Vlorë, më 28 nëntor 1912.

✗ **Jo kështu:** *Shkup, 24.6.2007* ose Vlorë, 28 nëntor 1912.

4. Parafjala "më" përdoret gjithmonë kur data është pjesë e një fjalie dhe shpreh kohë.

✓ **Shkruhet kështu:** *Mbledhja u mbajt të premten, më* 24 qershor 1981; Viti i ri shkollor filloi të hënën, **më** 1.IX.2025 (ose: 1.9.2025).

✗ **Jo kështu:** *Mbledhja u mbajt të premten 24 qershor 1981; Viti i ri shkollor filloi të hënën, 1.IX.2025.*



Të mos harrojmë!

Mos përdor vijën pjerrake (/) apo vizën ndarëse (-) për të shënuar datën.

✗ 14/6/1977 apo 24-VI-1981

✓ 14.6.1977 ose 24.VI.1981

Mos harro parafjalën "më" në dokumente ose në fjali që shprehin kohë.

✗ Shkup, 24.6.2007

✓ Shkup, më 24.6.2007

Në gjuhën standarde shqipe, **dita dhe muaji shkruhen pa zero përpara.**

✓ **Shkruhet kështu:** 6.6.2007

✗ **Jo kështu:** 06.06.2007

FJALËT E SHKURTUARA (AKRONIMET) DHE SHKURTESAT

Fjalët e shkurtuara (akronimet) përbëhen nga shkronjat e para të fjalëve që formojnë një emër të përbërë. Ato shkruhen me shkronja të mëdha, pa vendosur pika ndërmjet shkronjave, dhe shqiptohen si një fjalë e vetme.

Shembuj:

- **UNESCO** – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (*United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization*);
 - **SHBA** – Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
 - **BE** – Bashkimi Evropian;
 - **RSH** – Republika e Shqipërisë;
 - **RKS** – Republika e Kosovës;
 - **RMV** – Republika e Maqedonisë së Veriut;
 - **ZLM** – Zef Lush Marku;
 - **ASHSH** – Akademia e Shkencave të Shqipërisë;
 - **UT** – Universiteti i Tetovës;
 - **SHMQSH** – Shkolla e Mesme e Qytetit të Shkupit;
 - **ITSHKSHSH** – Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup etj.
- ✗ Jo kështu: *U.E.F.A.*; *SH.M.Q.SH.*
- ✓ Po kështu: **UEFA**; **SHMQSH**.

SHKURTESAT

Shkurtesat janë forma të shkurtuara të fjalëve që **shënohen me pikë në fund**. Ato **shqiptohen sipas fjalës që përfaqësojnë**, jo si fjalë të reja.

Shembuj:

- **prof.** – profesor;
- **kujd.kl.** – kujdestar klase;
- **p.sh.** – për shembull;
- **b.f.** – bie fjala;
- **fq.** – faqe;
- **etj.** – e të tjera.



Të mos harrojmë!

- **Fjalët e shkurtuara (akronimet)** shkruhen me **shkronja të mëdha, pa pikë** dhe shqiptohen si një fjalë.
Shembull: SHMQSH, SHBA, BE
✗ *S.H.M.Q.SH.* ✓ **SHMQSH**
- **Shkurtesat** shkruhen me **pikë** dhe shqiptohen sipas **fjalës që përfaqësojnë**.
Shembull: prof. – profesor, p.sh. – për shembull, b.f. – bie fjala
- **Mos i ngatërro!**
SHBA është fjalë e shkurtuar.
p.sh. është shkurtesë.

TË DËGJUARIT, TË LEXUARIT DHE TË SHKRUARIT

Në jetën e përditshme ne komunikojmë në mënyra të ndryshme: duke dëgjuar, duke lexuar dhe duke shkruar. Këto tri aftësi janë të domosdoshme për të kuptuar informacionin që marrim dhe për të shprehur mendimet tona. Komunikimi i suksesshëm varet nga aftësia jonë për të kuptuar mesazhet dhe për t'i përshtatur ato në situata të ndryshme.

TË DËGJUARIT PËR TË KUPTUAR

Dëgjimi nuk është vetëm pranimi i tingujve me vesh, por një proces aktiv, gjatë të cilit ne përqendrohemi te fjalët, idetë dhe kuptimi i tyre.

- Gjatë dëgjimit duhet të dallojmë faktet kryesore, detajet dhe idetë më të rëndësishme.
- Informacioni i dëgjuar shpesh na ndihmon të marrim vendime ose ta përdorim në situata të tjera.

P.sh.:

Nëse dëgjon një njoftim në shkollë:

“Nxënësit e vitit të parë, nesër në orën 10:00, do të marrin pjesë në një orë poetike në sallën e bibliotekës”, duhet të kuptosh:

- kush do të merr pjesë (nxënësit e vitit të parë),
- kur (nesër, në orën 10:00),
- çfarë aktiviteti dhe ku do të zhvillohet (ora poetike në sallën e bibliotekës).

TË LEXUARIT PËR TË KUPTUAR

Leximi është më shumë se shqiptimi i fjalëve. Ai përfshin kuptimin e tekstit, dallimin e fakteve dhe përmbledhjen e ideve kryesore.

- Lexuesi i mirë arrin ta kuptojë mesazhin dhe ta shpjegojë me fjalët e veta.
- Tekstet mund të japin informacion edhe në forma të tjera, si tabela, grafikë, harta, të dhëna statistikore ose diagrame.

P.sh.:

Në një tabelë që tregon numrin e nxënësve sipas klasave, lexuesi duhet të jetë në gjendje të thotë se sa nxënës janë në klasën e parë dhe ta krahasojë atë numër me klasat e tjera.

TË SHKRUARIT E TEKSTEVE

Të shkruarit është një aftësi themelore për të komunikuar me të tjerët në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme. Përmes shkrimit, mendimet dhe idetë tona bëhen të kuptueshme edhe për ata që nuk janë të pranishëm në momentin e komunikimit.

Shkrimi përdoret në situata të ndryshme dhe, sipas rastit, ai mund të jetë:

- **zyrtar**, kur përdoret për të përcjellë informacion serioz dhe kërkon gjuhë formale;
- **jozyrtar**, kur shërben për komunikim të lirshëm dhe më afër gjuhës së përditshme.

FORMATET E SHKRESAVE TË KOMUNIKIMIT ZYRTAR

Në jetën shoqërore dhe institucionale një pjesë e madhe e komunikimit zhvillohet në mënyrë zyrtare. Për këtë arsye përdoret stil i veçantë gjuhësor që quhet **stili administrativ (shtetëror-zyrtar)**. Ky stil përdoret në dokumentet e shtetit, të shkollës, të institucioneve e të organizatave, sepse garanton **qartësi, saktësi dhe rregull**. Karakteristikat e teksteve zyrtare janë:

- Gjuha është **formale** dhe e saktë.
- Fjalët janë të zgjedhura me kujdes, pa shprehje të panevojshme.
- Dokumentet kanë strukturë të rregullt: titull, datë, marrës, subjekt, përmbajtje, nënshkrim.

Formatet kryesore të shkresave të komunikimit zyrtar janë:

1. Tekstet ligjore

– ligje, vendime, urdhëresa, udhëzime, rregullore.

Shembull: Ligji për arsimin parauniversitar.

2. Shkresat zyrtare

– vërtetime, deklarata, autorizime, kërkesa, përgjigje zyrtare, fletë qarkore, letra administrative, procesverbale.

Shembull: Një nxënës bën kërkesë për një vërtetim shkolle.

3. Aktet ekonomike-tregtare

– kontrata, marrëveshje, raporte.

Shembull: Një kontratë pune mes një punonjësi dhe një kompanie.

4. Formularët

– dokumente të gatshme që plotësohen me të dhëna: formularë postarë, formularë regjistrimi, fletëprovime.

5. Aktet diplomatike

– nota, letra, mesazhe, protesta, peticione.

Shembull: Një notë proteste që i dërgohet një shteti tjetër.

Si duket një lutje zyrtare

Modeli 1

SHMQSH “Zef Lush Marku”- Shkup

Data: 15 shtator 2025

Drejtuar: Drejtorit të shkollës

Subjekti: Lutje për përdorimin e sallës së bibliotekës

Përmbajtja:

I nderuar drejtor,

Unë, nxënësi **Jon Sulejmani** i klasës II/1, ju drejtohem me këtë lutje për të më lejuar, së bashku me grupin e klasës, të përdorim sallën e bibliotekës më 20 shtator 2025, në orën e pestë, për zhvillimin e një pune praktike në lëndën e gjuhës shqipe.

Ju falënderoj për mirëkuptimin!

Me respekt,
Jon Sulejmani

_____ (këtu duhet me dorë të nënshkruajë nxënësi)

Modeli 2

SHMK “28 Nëntori”- Dibër

Data: 20 shtator 2025

Drejtuar: Kujdestares së klasës I/1

Subjekti: Lutje për kalimin nga klasa I/1 në I/5

Përmbajtja:

E nderuar kujdestare,

Unë, nxënësi **Edon Basha** i klasës I/1, ju drejtohem me këtë lutje për të kaluar nga klasa I/1 në klasën I/5. Kalimi do të më ndihmonte të bashkëpunoj më lehtë me shokët e klasës dhe të arrij rezultate më të mira shkollore.

Duke shpresuar se kjo lutje do të shqyrtohet me mirëkuptim dhe do të pranohet, ju falënderoj që tani për kujdesin dhe mbështetjen tuaj.

Me respekt,
Edon Basha

_____ (këtu duhet me dorë të nënshkruajë nxënësi)

Si duket një kërkesë zyrtare

Gjimnazi “Ismail Qemali”- Vlorë**Data:** 5 shtator 2025**Drejtuar:** Drejtorit të shkollës**Subjekti:** Kërkesë për pajisje mësimore**Përmbajtja:**

I nderuar drejtor,

Unë, nxënësi **Yll Sulejmani** i klasës III/1, ju drejtohem me këtë kërkesë për të siguruar mjete shtesë mësimore (bojëra, letër pune dhe mjete të tjera të nevojshme) për zhvillimin e orëve të artit figurativ. Këto mjete janë të domosdoshme për realizimin e detyrave mësimore dhe për mbarëvajtjen cilësore të procesit edukativo-arsimor.


Me shpresë se kërkesa ime do të shqyrtohet dhe për të njëjtën do të vendoset pozitivisht, që tani ju falënderoj!

Me respekt,
Yll Sulejmani

_____ (këtu duhet me dorë të nënshkruajë nxënësi)

**Të mos harrojmë!**

- **Kërkesa:** shkruhet për të marrë një **dokument** ose **shërbim** (p.sh. vërtetim shkolle, autorizim).
- **Lutja:** shkruhet për të kërkuar **lejim** ose **përrjashtim nga një detyrim** (p.sh. mungesë nga orët, kalim në një klasë tjetër).
- **Dallimi kryesor:**
 - ▷ kërkesa është **më e drejtpërdrejtë**,
 - ▷ lutja është **më e përlulur dhe mirënjohëse**.



KOMUNIKIMI ZYRTAR NË PRAKTIKË

Udhëzim për mësimdhënësin:

Në përfundim të njësisë, organizoni një aktivitet praktik me nxënësit. Aktiviteti mund të zhvillohet sipas këtyre hapave:

1. **Shfaqni dhe shpjegoni një formular të gatshëm të shkollës** (p.sh., një kërkesë ose një lutje).
2. **Sqaroni** elementet kryesore të shkresës: data, marrësi, subjekti, përmbajtja, nënshkrimi.
3. **Hartoni së bashku** me nxënësit një lutje ose kërkesë konkrete (p.sh., kërkesë për përdorimin e sallës së bibliotekës, kërkesë për përdorimin e sallës së sportit për aktivitete jashtë orarit, lutje për organizimin e një ore poetike ose aktiviteti letrar, lutje për lirim nga një orë mësimore etj.).
4. **Organizoni punë në grupe** ku secili grup harton një shkresë të ndryshme (lutje, kërkesë, ankesë, procesverbal të shkurtër).
5. **Diskutoni në klasë** punimet dhe bëni krahasimin me mënyrën e komunikimit jozyrtar (p.sh., mesazhe në rrjetet sociale).

Kështu, nxënësit mësojnë jo vetëm teorinë, por edhe **praktikojnë shkrimin e dokumenteve zyrtare**, duke përdorur shembuj realë nga shkolla.

FORMATET E SHKRESAVE TË KOMUNIKIMIT JOZYRTAR

Përveç komunikimit zyrtar, i cili përdoret në shkresa dhe dokumente administrative, ekziston edhe komunikimi **jozyrtar**. Ky është një komunikim i lirshëm, pa rregulla të ngurta të gjuhës dhe të shkrimit. Përdoret kryesisht për të shprehur mendime, ndjenja dhe për të shkëmbyer informacion në jetën e përditshme.

Formatet kryesore të komunikimit jozyrtar janë:

- **Letra jozyrtare** – i dërgohet një shoku ose një të afërmi, zakonisht me ton miqësor e personal.
- **Mesazhi elektronik (e-mail joformal)** – përdoret për komunikim miqësor ose shoqëror, ndryshe nga e-mail-i zyrtar.
- **Mesazhi në rrjetet sociale** – është forma më e shpeshtë sot, shpesh me fjali të shkurtra, me emotikone (ikona emocionesh), shkurtesa ose gjuhë të lirshme.

Dallimi midis komunikimit formal dhe joformal

■ Komunikimi formal (zyrtar):

- ▶ Përdor gjuhë të rregullt dhe të normuar.
- ▶ Ka strukturë të përcaktuar (titull, datë, marrës, subjekt, përmbajtje, nënshkrim).
- ▶ Është serioz dhe zyrtar (p.sh. një kërkesë a lutje drejtuar drejtorit të shkollës).

■ Komunikimi joformal (jozyrtar):

- ▶ Përdor gjuhë të lirë, të afërt me të folmen e përditshme.
- ▶ Nuk ka strukturë të detyrueshme.
- ▶ Shpesh përdor emotikone (ikona emocionesh, shenja), shkurtesa ose shprehje bisedore (p.sh. mesazh në rrjete sociale).

Si duket një letër jozyrtare:

Përsëndetje Besa,
Shpresoj të jesh mirë! Po të shkruaj për të të treguar që u hap konkursi i poezisë në shkollë dhe do të ishte bukur të merrnim pjesë bashkë. Çfarë mendon?
 Me përqafime,
 Andrra

Si duket një mesazh elektronik (joformal):

Nga: Rron123@gmail.com
 Për: Leonën
 Subjekti: Projekti
 Hej Leona, a po takohemi nesër në bibliotekë për projektin? Kam disa ide që dua t'i ndaj me ty 😊.

Si duket një mesazh në rrjetet sociale:

"Hej, ku je? 😊 Nesër a shkojmë bashkë në provë? Se s'po di çka me marrë me vete lol."



Të mos harrojmë!

- Dokumentet zyrtare shkruhen në **stil administrativ**.
- Ky stil kërkon **qartësi, saktësi dhe gjuhë formale**.
- Struktura e dokumenteve zyrtare është e rregullt: **titulli, data, marrësi, subjekti, përmbajtja, nënshkrimi**.
- Komunikimi jozyrtar është **i lirshëm** dhe përdoret kryesisht në jetën e përditshme.
- Formatet kryesore të komunikimit joformal janë: **letra jozyrtare, mesazhi elektronik joformal, mesazhi në rrjetet sociale**.
- Dallimi kryesor midis komunikimit formal dhe atij joformal është tek **stili i gjuhës dhe struktura e shkrimit**.

**Sa kuptove?**

1. Përmend tri lloje dokumentesh që shkruhen në stilin administrativ.
2. Cili është dallimi mes një letre zyrtare dhe një mesazhi në rrjetet sociale?
3. Pse është e domosdoshme të përdorim gjuhë formale në dokumentet shtetërore?
4. Përmend tri format e komunikimit joformal.
5. Cilat janë dallimet kryesore mes një letre zyrtare dhe një letre jozyrtare?
6. Jep një shembull të shkurtër të një mesazhi joformal që do t'ia dërgoje një shoku në rrjetet sociale.

**Kuptimi i fjalëve të reja**

- **Administrativ** – që lidhet me punët e shtetit ose të institucioneve.
- **Procesverbal** – dokument ku shënohen zhvillimi dhe vendimet e një mbledhjeje.
- **Formular** – dokument i gatshëm me rubrika që plotësohen me të dhëna.
- **Peticion** – kërkesë e nënshkruar nga një grup njerëzish që i dërgohet një autoriteti.
- **Diplomatik** – që lidhet me marrëdhëniet dhe komunikimin ndërmjet shteteve.
- **Letër** – tekst i shkruar që i dërgohet një personi ose institucioni për komunikim.
- **Lutje** – kërkesë e shprehur në mënyrë të përlulur dhe me gjuhë formale.
- **Kërkesë** – shkrim zyrtar me të cilin dikush paraqet nevojën ose dëshirën për diçka.
- **Diagram** – vizatim me vija ose forma që paraqet të dhënat në mënyrë të kuptueshme (p.sh. grafik me shtylla).
- **Tabelë** – paraqitje e të dhënave në rreshta dhe kolona për t'u lexuar më lehtë.
- **Statistikë** – të dhëna të mbledhura dhe të shprehura me numra për të dhënë informacion.
- **Formal** – gjuhë e rregullt, sipas normave, që përdoret në dokumente dhe në komunikim zyrtar.
- **Joformal** – gjuhë e lirshme, e afërt me të folurit e përditshëm (p.sh. në biseda mes shokëve ose në mesazhe).
- **Ikona emocionesh (emotikone)** – shenja ose figura të vogla që shprehin emocione në komunikimin elektronik (p.sh. 😊, 😄, 🤔 etj.).
- **Shkurtesa** – fjalë të shkurtruara ose simbole që përdoren për të shkruar më shpejt në komunikimin elektronik (p.sh. “lol”, “po vi”).
- **Mesazh elektronik (e-mail)** – formë e komunikimit me shkrim përmes internetit.

**Ae dini se...?**

Në shqipen e vjetër, në vend të fjalës **model** përdorej edhe fjala **gjedhe**, me kuptimin *shëmbëlltyrë, shembull, tipar për t'u ndjekur*. Sot fjala **model** është bërë më e zakonshme dhe përdoret në tekstet zyrtare e shkollërore, ndërsa **gjedhe** mbetet si dëshmi e pasurisë së gjuhës shqipe.

Letërsi,

të shprehurit dhe krijimtaria

TEORIA E LETËRSISË

■ ARTI DHE ZANAFILLA E TIJ

■ SHKENCA E LETËRSISË

- NDARJA E LETËRSISË
- GJINITË DHE LLOJET LETRARE
 - LIRIKA
 - TROPET DHE FIGURAT STILISTIKE
 - EPIKA
 - DRAMATIKA
- LLOJET LETRARE - SHKENCORE

■ LETËRSIA POPULLORE

NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR ARTIN

ARTI DHE ZANAFILLA E TIJ

NJERIU, si qenie e lirë, është përballur me shumë vështirësi gjatë përshtatjes së jetës në natyrë. Duke mos pasur ndonjë shpjegim për dukuritë e natyrës, gjithçka e interpretonte sipas fuqive mbinatyrore, ndonëse e kuptoi që pasuritë e mjedisit jetësor kishin vlerë të rëndësishme për të. Sipas kësaj bindjeje, njeriu primitiv sajoi besime të ndryshme dhe shpesh veprat që i krijonte, përpos si dëshirë vetjake, i bënte i shtyrë prej perëndive. Në përpjekjet për mbijetesë krijoi *vegla pune* për të siguruar ushqim, veshmbathje dhe strehim që të mbrohej nga i ftohti apo nga rreziqet e jetës.


PUNA ka qenë shtysë kryesore në zhvillimin e aftësive të njeriut, me ç'rast ai ka ndjerë nevojë për t'i shprehur ndjenjat dhe mendimet. Punën, përpos si shkathtësi për mbijetesë e mirëqenie e vuri në shërbim të dëshirave dhe imagjinatës së tij, jo vetëm për të plotësuar çdo nevojë jetësore, por edhe për procesin e krijimtarisë artistike, duke e ndjerë *motivimin artistik*, gjë që e bëri atë më të ndërgjegjshëm. Falë punës, njeriu bëhet qenie e vetëdijshme shoqërore dhe zotërues i natyrës, ndërsa kohën e lirë përpiquej ta përmbushte sa më shumë me krijimtari artistike.

MENDIMI (sikurse edhe aktiviteti fizik-puna) e ka nxitur zhvillimin shpirtëror të njeriut dhe i ka mundësuar jetë më të begatshme e të lumtur, si individ dhe si pjesë e bashkësisë. Me kalimin e shekujve, ai e ka pasuruar horizontin e dijeve dhe përvojën e trashëguar prej paraardhësve, të cilën e kthen në qëllim më kuptimplotë të ekzistencës së vet. Kjo nuk mjaftoi për të, pasi natyra kureshtare e nxiti për të krijuar vepra individuale, të cilat janë të dobishme dhe të bukura. Në këtë proces, njeriun e ndihmoi shumë edhe imagjinata.


Imagjinata është **aftësia e njeriut** për të krijuar në mendje: përfytyrime, figura, ngjarje, ide ose botë që nuk janë të pranishme në realitet, duke u mbështetur në përvojën dhe në njohuritë e fituara - **aftësia krijuese e mendjes**.

Imagjinata është e lidhur ngushtë me procesin e **të menduarit** dhe **ndjenjat**.

Qysh në kohët primitive, dëshira për ta shijuar të bukurën e bën njeriun të dëshmohej në disa rrafshe:



Njeriu, si pjesë e shoqërisë, bëhet pjesëmarrës i të gjitha manifestimeve të jetës. Ai kishte nevojë të shprehte gjithçka që përjetonte dhe shihte, e po ato ndjesi mundohej t’ua përcjellë të tjerëve. Si rezultat i **zhvillimit mendor**, lindi nevoja e bashkëbisedimit dhe bashkëveprimit me individë që i takonte në gjueti, në peshkim, në situata të rrezikshme në natyrë apo në ditë gazmore, me ç’rast shprehte: gëzim, hare, pikëllim, frikë, kënaqësi..., duke e reflektuar më qartë gjendjen shpirtërore. Gjatë jetës dhe punës së përditshme, ai nisi ta përdorte gjuhën për t’u marrë vesh me njerëzit. Në fillim përdorte gjuhë të thjeshtë (të paartikulluar mjaftueshëm), por më vonë e pasuroi atë me fjalë e shprehje të reja, gjë që shënoi hap shumë të rëndësishëm në zhvillimin e tij. Me kalimin e kohës, filloi t’i shprehë mendimet, ndjesitë, dëshirat, imagjinatën dhe përjetimet, përmes gdhendjeve dhe vizatimeve nëpër muret e shpellave.



— Platoni (mendimtar antik)



— Aristoteli (mendimtar antik)

“E bukura është shkëlqim i së vërtetës”. — **Platoni**

“Mos harro se vepra dhe fjala të bëjnë dhe të zhbëjnë njësoj”! — **Sokrati**

“Ideja e përsosmërisë arrihet kur përpiqesh të jesh gjithnjë i shkëlqyer”. — **Aristoteli**

“Shkathtësia e mendjes ose zgjuarësia, është virtyt për të fituar gjithmonë”. — **Homeri**

Format më të hershme të artit që tregojnë se si njerëzit e lashtë e përjetonin botën përreth tyre, janë **vizatimet - ideogramet dhe piktogramet**. Ata pikturonin shtazë të ndryshme nga gjuetia dhe përvijonin ngjarje të përditshme, jo vetëm si zbukurim (nëpër shpella), por edhe për të përcjellë porosi apo për të lënë kujtime dhe gjurmë nga jeta në të kaluarën.



Stela e kalorësit dardan

— Materiale të zbuluara nga gërmimet arkeologjike në Dardani (Kosovë).



— Pllakë me mbishkrimin "Dardanus" (nga shek. VI), e gjetur në varrezat e vjetra të Shkupit.

Çdo krijimtari artistike ka për synim shprehjen e mendimeve dhe ndjenjave të njeriut përmes veprave artistike, duke vënë theks të veçantë tek e bukura në tërësinë e përmbajtjes. Deri më sot, dijetarët kanë shprehur një varg mendimesh për atë se çfarë është e bukur, megjithëse arti e ka magjinë që të mos veprojë njësoj me të gjithë njerëzit.

Gjuha është fuqia e shprehjes së **mendimit** dhe **ndjenjës**.

GJUHA, gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore, ka mundësuar që aftësitë shprehëse të njeriut të bëhen më të qëndrueshme dhe më të begatshme. Edhe **krijimtaria artistike**, me anë të gjuhës, i shfrytëzon të gjitha mundësitë shprehëse të ligjërimit për ta pasqyruar më të plotë jetën.

Gjuha është mjet kryesor i bashkëbisedimit, si një bashkësi simbolesh, e cila na shërben për t'u shprehur në dy forma: **trajtën e folur** dhe **trajtën e shkruar**.

Përmes gjuhës, si mjet më i përsosur i bashkëbisedimit ndërmjet njerëzve, realizohen:

- **mënyra e shprehjes;**
- **përshkrimi i situatës;**
- **porosia (mesazhi).**
- **Gjuha e folur** mundëson komunikim me bashkëbiseduesin (dhënës- marrës) dhe realizohet përmes artikulimit të fjalëve, gjeleve dhe zëshmërisë (intonacionit). Ajo mbështetet në gurrën e pashtershme të së folmes popullore, si trashëgimi e traditës sonë kulturore dhe vlerave artistike.
- **Gjuha e shkruar** mundëson komunikim përmes shkronjave dhe realizohet përmes grafemave, shenjave të pikësimit dhe rregullave të drejtshkrimit. Gjuha e shkruar mbështetet në normat e përdorimit standard dhe dëshmon për nivelin kulturor të individit dhe të popullit.

Gjuha kombëtare (shqipe) është gjuha, me të cilën identifikohet një popull gjatë përkalimeve të veta historike dhe përmes së cilës ka lënë gjurmë të rëndësishme nga tradita dhe kultura e vet. Në këtë proces, ndër shekuj është krijuar dhe zhvilluar **Gjuha kombëtare shqipe**.

Kombi e ka jetike ekzistencën e gjuhës, pasi ajo shërben në ndërtimin e identitetit kombëtar dhe ndërveprimin gjuhësor, të dobishëm në të gjitha sferat e jetës. Bashkëveprimi shpirtëror dhe kulturor i popullit reflektohet përmes gjuhës, e cila lind nga vetë populli dhe zhvillohet mbi bazën e përdorimit të përditshëm, duke e pasqyruar ndjenjën, mendimin dhe të shprehurit e tij.

Grani e mjedra

Një njeri qi enbiell fare të mirë end arë tëh tij.

E sih enfjetnë njerëzitë, vjen anëniku i tij dhe enbiell manë mjedhëra (mjedra) endër për drithët. Kur u rrit drithët e zuu meh zanë frujt, ashtu atëh herrë u dëftuonë dhe manëmjedhëratë. E shërbëtorëtë e atit (të) fëmijësë (e zotit të shtëpisë) thanë: Zot as enbolle tihdrithë tëh mirë end arë tënde; Sih tash u enbush plot manëmjedhëra? E aih u tha atyne: Nierii qii anshtë anëmik banih atëh. Shërbëtorëtë hi thoshnëh: A doh (që) nah tëh vemte tih qërojmë? E aih u thah: Joh për seh ju tue dëllirunë manëmjedhëratë mos shkulinjtë edheh drithëtë. Le të ritetë njani e tjetëri djerjeendë e korrë, e ende mot tëh korrët (të korrjeve) u tëh thoem korrëset (korrësve): Emblidhni parëmanëmjedhëratë e hi bani fashë për tëh djegunë e drithëtë enbasandajh enbëlidhnieh endë sojnicët teme.

Fjalorth:

are (ë) - farë për mbjellje;
manëmjedhëratë - mjedra;
dëllirunë - dëllirë, pastruar;
djerje - deri, gjer;
sojnicë - grunar, drithnik, hambar.

Prozë e shkurtër: "Meshari", Gjon Buzuku (1555).

ARTI

Arti është forma më e harmonizuar e shprehjes për të bukurën dhe kënaqësisë shpirtërore, si mjet i rëndësishëm për ta shfaqur realitetin, në dobi të zhvillimit dhe përparimit të shoqërisë. Sapo vëmë re ndonjë vepër arti, në vetëdijen tonë zgjohet një varg ndjenjash.

Zanafilla e artit paraqitet nga: **puna - mendimi - gjuha.**

Fjala **art** vjen nga fjala latine **ars**, që nënkupton: mjeshtëri, shkathtësi, aftësi, zotësi, sikurse fjala greke **tehne**. Arti lindi si nevojë shpirtërore dhe u zhvillua bashkë me mendjen e njeriut, duke e ndihmuar atë për ta shprehur botën e brendshme. Në kohët e vjetra, mjeshtëritë kanë qenë të ndërlidhura me nderimet ndaj perëndive (këngë, valle, interpretime instrumentale, rituale etj.), duke i shprehur dëshirat e tyre, teksa besonin se ata kanë fuqi magjike.

Dijetarët, për fillet dhe gjurmët e artit, janë mbështetur në burimet arkeologjike ku kanë zbuluar vizatime, vegla pune, armë dhe mjete tjera të periudhës parahistorike.

Arti, burim kryesor e ka vetë **njeriun, natyrën dhe jetën.**

Objekt i studimit të artit është individ dhe **jeta shoqërore**. Vetë njeriu, me botën e tij shpirtërore dhe horizontin e dijeve, e fisnikëron jetën dhe ushtron ndikim të fuqishëm edukativ.

Të shprehurit e gjendjes shpirtërore të njeriut, përmes shkathtësive e paraqet **individin/artistin**, i cili në një formë të përzgjedhur e shpreh mendimin dhe e përshkruan ngjarjen.

Arti cilësohet me **ulera estetike** (vepër e bukur që prek ndjenjat) dhe **ulera morale** (vepër, që na frymëzon dhe ndihmon ta kuptojmë realitetin e jetës).

Krijimi artistik mundësohet si shtytje e brendshme e njeriut dhe aftësive të tij për ta shprehur mendimin dhe gjendjen emocionale.

Për shembull: Pamje mahnitëse hasim kudo në natyrë: *kopshte me lule të shumta, pamje piktoreske të natyrës, shkëmbinj të thepisur, lumenj që rrjedhin rrëmbyeshëm, brigje të mrekullueshme, fusha të gjera plot gjelbërim etj.*, mirëpo këto pamje, edhe pse janë tejet të bukura, nuk mund të quhen vepra artistike derisa të marrin trajtë përmes ndonjë krijuesi që do t'i përjetësojë ato.

Krijimtaria artistike ka për qëllim shprehjen e **mendimeve** dhe ndjenjave të njeriut përmes **krijimeve artistike**. Ndjenjat për të bukurën, të cilat vijnë përmes pasqyrimin të dukurive natyrore dhe shoqërore, marrin forma të caktuara dhe e zgjojnë ndjenjën *e rregullit* apo *harmonisë*.

E bukur, quhet vepra që ka një harmoni të përsosur në vetvete.

Si formësohet një vepër artistike

Gjendja shpirtërore e individit është e lidhur fort me përfytyrimin e së bukurës dhe vepron mbi vetëdijen e tij me një fuqi të jashtëzakonshme e që bashkë me gjendjen emocionale e përbëjnë thelbin e ndjenjës estetike. Këto vepra formësohen me anë të mjeteve të caktuara, si: *fjala* e shkruar dhe e folur, *toni*, që prodhohet nga zëri i njeriut dhe veglat muzikore, si dhe *ngjyrat*, *vijat*, *lëvizjet*, që në një farë forme e interpretojnë **ndjesinë e njeriut - artist**.

Vepër artistike është çdo hartim i mendjes së njeriut që mund të zgjojë ndjenjën e së bukurës, pra ndjenjën estetike, duke krijuar harmoni të përsosur në vetvete. Një vepër artistike krijohet lirshëm, po njësoj edhe mund të lërë përshtypje te njerëzit, varësisht nga shija që ata kanë për artin.

- Çdo pamje e natyrës nuk mund të jetë vepër artistike

Në periudhën e antikitetit, për t'u krijuar një vepër arti kërkohej baraspeshë (ekuilibër) në të gjitha aspektet e shkathtësive dhe përvojës njerëzore.

Parimi i idesë së përsosmërisë ishte **vendosja e ekuilibrit** në art, arsim, shkencë, arkitekturë, politikë, psikologjinë njerëzore etj.

- Të bukurit natyror dhe të bukurit artistik


Të bukurit natyror është përshkrim i drejtpërdrejtë i natyrës që shohim (*lule të bukura, qiell i bukur, natyrë e bukur*), ndërsa **të bukurit artistik** qëndron në shkallë më të lartë prej natyrës, pasi përfaqëson bukurinë që lind në shpirt dhe realizohet në vepër (*lule të mrekullueshme, qiell i kristaltë, natyrë magjepsëse*).

Arti, në të cilin gërshetohen elemente të më shumë llojeve të artit, njihet si **art sinkretik** (lëvizjet ritmike, kënga - muzika, fillet e teatrit dhe fjala).

Në jetën e individit dhe shoqërisë cilësitë thelbësore janë **vlerat estetike**, etike dhe **përsiatëse**, të cilat edhe pse ndryshojnë ndërmjet vete, në veprën artistike janë në bashkëpunim të ngushtë dhe të ndërsjellë. Veprat artistike marrin trajtë nga shkathtësitë e artistit, i cili i zbukuron hollësitë e natyrës dhe përmes imagjinatës së vet u jep formë të veçantë.

E bukura, si krijim, mbetet i vetmi qëllim i artit që e ngacmon ndjenjën estetike të njeriut ndaj jetës dhe fisnikërimin e ndjenjave të tij.

Arti është pjesë e pandashme e jetës, pasi e pasqyron, e plotëson dhe e zbukuron atë.



Arti, gjithashtu na ndihmon **ta shprehim vetveten**, **ta kuptojmë botën** dhe **të bashkëveprojmë** me të tjerët, prandaj është e rëndësishme që të mësojmë për artin, ta vlerësojmë dhe ta mbështesim atë. Ai e begaton, me ide e ndjenja, jetën e individit, i cili këtë kreativitet e manifeston në shoqëri.

ANALIZË



INTERPRETIM:

- Përkufizoni njeriun, punën dhe mendimin!
- Cili është objekti i studimit të artit?
- Nënvizoni disa karakteristika të mendimit dhe gjuhës, pastaj shpjegoni ndikimin e tyre te njeriu!
- Si lindi njeriu - artist dhe si ndikoi te ai puna dhe mendimi?
- Çka paraqet gjuha kombëtare, si u krijua gjuha shqipe?
- Çfarë synon krijimi artistik?
- Çfarë paraqet e bukura për ju, tregoni për shkathtësitë tuaja!
- A është imagjinata - aftësi përkufizuese e juaja, si e shprehni atë?
- Si i kuptoni shprehjet: motivim artistik dhe krijimtari artistike?



PËRFORCIM NJOHURISH:

Përshkruani në fletore dhe rrethoni vetëm pohimet e sakta në fjalitë e mëposhtme:

- Gjuha është mjet komunikimi i njeriut që nga koha primitive dhe ndahet në gjuhë të folur dhe gjuhë të shkruar.
- Synimi fillestar i paraqitjes së artit ishte krijimi i veprës artistike.
- Puna, mendimi dhe gjuha paraqesin zanafillën e artit.
- Të bukurit natyror dhe të bukurit artistik janë kategori e njëjtë e së bukurës në art.
- Artisti është njeri i zakonshëm.
- E bukur, mund të quhet çdo vepër artistike, e cila ka një harmoni të përsosur në vetvete.
- Arti sinkretik nuk gërshetohet me elemente të llojeve të tjera të arteve.
- Arti është pjesë e pandashme e jetës, pasi e pasqyron, e plotëson dhe e zbukuron atë.



SPROVË LETRARE:

- Përshkruani zanafillën e artit dhe rolin e njeriut në këtë proces!
- Bëni një krijim të shkurtër, me temë: "Arti e zbukuron jetën"!

LLOJET E ARTIT

Njeriu, natyra dhe jeta janë frymëzim për artistin.

Artisti, përmes veprës së artit apo **krijimit artistik**, e plotëson qenien e tij dhe reflekton në nivelin kulturor të shoqërisë. Çdo artist e përjeton thellësisht veprën, lidhet emocionalisht me të dhe përmes fuqisë së imagjinatës e jetëson bashkë me mendimet dhe ndjenjat e veta. Në këtë mënyrë, ai sjell një të vërtetë të re që ka vlerë dhe qëndron në kohë.



Artisti frymëzohet nga përditshmëria. Diçka që e prek emocionalisht dhe ngjall te ai **ndjenjë** të veçantë formësohet në **ide**, të cilën më pas e shndërron në **vepër** arti.

Idetë dhe shijet e artistëve janë të ndryshme, prandaj një vepër artistike nuk mund të veprojë me të njëjtën fuqi tërheqjeje apo interesimi të të gjithë njerëzit. Çdo njeri nuk është i lindur për art e për këtë arsye, nëse në vetëdijen e tij nuk e ka të formuar ndjenjën etike dhe qëllimin e vërtetë të veprës artistike, ai nuk mund ta kuptojë dhe shijojë atë vepër arti.


Arti gjithmonë cilësohet me shprehjen “i bukur”.

Arte të bukura cilësohen: poezia, muzika, piktura, skulptura, arkitektura, baleti, drama dhe pantomima. Këto arte, edhe pse si pikë të përbashkët e kanë **të bukurën** ndryshojnë midis tyre, ngase krijohen me **mjete** dhe **forma** të ndryshme. **P.sh.:** piktori, për realizimin e veprës së tij përdor **ngjyra** (piktura), muzikanti i përdor **tonet**, ndërsa poeti e përdor **fjalën**.

Artet janë dy llojesh kryesore: **arte plastike (vendore - statike)** dhe **arte tonike (kohore)**.

- 1. Artet plastike - vendore**, lëndë bazë për krijimin dhe realizimin e tyre e kanë materialin, pasi mund të preken, janë të dukshme dhe u nënshtrohen **rregullave të simetrisë**. Krijohen në hapësirë të pakufishme vendore, prandaj quhen arte vendore, por meqenëse përforcohen dhe janë të palëvizshme, quhen edhe statike.

Në grupin e arteve statike bëjnë pjesë: **arkitektura, skulptura, piktura** dhe më vonë edhe **arti filmik** (kinematografia).



• **Arkitektura** është art, ku mendimet dhe ndjenjat e artistit shprehen nëpërmjet masës dhe shpërndarjes së rregullt të vijave mbi të.

Karakteristikë kryesore e arkitekturës është stolisja e pamjes së jashtme dhe të brendshme të objekteve, si: tempujt e perëndive, faltoret madhështore, tregjet e mbuluara, teatrot antike, kishat e katedralet, pallatet mbretërore, objektet ekonomike dhe shtëpitë.

Ndërtimi arkitektonik është pasqyrim i kohës, pasi është zhvilluar dhe ngritur në stile të veçanta: stili antik, stili romak, stili gotik, renesanca, baroku dhe stili modern, të cilat realisht e përfaqësojnë artin e qëndrueshmërisë.

Në të gjitha periudhat kohore kemi dëshmi të kryeveprave të arkitekturës të realizuara nëpër botë, siç janë: Piramidat e Egjiptit, Akropoli i Athinës, Kulla e Pizës, Pallati i Versajës, Notër - Dam, Kisha e Shën Sofisë, në Stamboll (Aja Sofia), Kështjella e Gjergj Kastriotit, në Krujë, Pallati Belvedere, në Vjenë, Shtëpia e Bardhë, në Uashington etj.

Teatri i Dodonës ishte një nga teatrot më të mëdhenj të botës antike. Ai u ndërtua në shek. III p.e.s nga Pirroja i Epirit, pranë shenjëtores së famshme të Dodonës, kushtuar Zeusit. Në territoret ilire dhe epirote janë zbuluar disa teatro antike: **Teatri i Bylisit**, **Teatri i Apollonisë**, **Teatri i Butrintit**, **Teatri i Dodonës**, nëpër të cilët janë zbuluar elemente shumë të vjetra ritualesh, si: maskat e karnavaleve, lojërat rituale, ritet e stinëve (festat e motmotit), këngët dialoguese etj.



— Teatri antik i Dodonës.

- **Skulptura** formësohet mbi shfaqjen e trajtave, gjegjësisht gdhendjen e objekteve, figurave të njerëzve e shtazëve dhe pamjeve të natyrës. Figurat skulpturore krijohen prej formave të gurit, metalit dhe drurit, nëpërmjet të cilave skulptori e riprodhon jetën. Në kohët e lashta, skulpturën më së shumti e kanë zhvilluar popujt e Lindjes, pastaj edhe grekët e vjetër dhe romakët.

Njerëzimi, përmes skulpturës ka trashëguar një varg veprash me vlerë të qëndrueshme, qoftë origjinale, qoftë të kopjuara, të cilat i stolisin monumentet historike, ndërtesat, muzetë, galeritë dhe sheshet e qyteteve anembanë botës.

- **Piktura** krijon pamje të ndryshme të natyrës në vizatime, portrete, peizazhe, kompozime figurash e pikturash murale, përmes të cilave piktori i shpreh mendimet dhe ndjenjat. Si mjet të shfaqjes i ka vijat dhe ngjyrat, me anë të të cilave është në gjendje të vizatojë çdo gjë që e rrethon. Fillet e këtij arti janë që në kohët e lashta, kur njeriu vizatonte nëpër muret e shpellave figura të ndryshme dhe shumë motive që e prezantonin natyrën.

Simonidi i Seosit, në shek. VI para Krishtit, shprehej:

“Piktura është poezi e heshtur, ndërsa poezia pikturë që flet”. — **Plutarku**

Shënim: Simonidi i Seosit (rreth 556 - 468 p.e.s.) ishte një poet lirik i Greqisë së Lashtë, i lindur në ishullin Seos (Kea). Ai njihet për poezinë e tij lirike, elegjitë dhe epigramet, si edhe për mendimet e urta mbi artin dhe letërsinë.

***Piktura dhe poezia** janë dy forma të ndryshme arti që shprehin të njëjtën bukuri dhe të njëjtat ndjenja.*

Piktura i shpreh ato me ngjyra, forma dhe pamje, pa përdorur fjalë, ndërsa poezia i shpreh me fjalë, duke krijuar pamje në imagjinatën e lexuesit.

Piktura “flet” me pamje, ndërsa poezia “pikturon” me fjalë. Të dyja synojnë të zgjojnë emocione dhe ta paraqesin bukurinë.

• **Arti kinematografik** është njëri prej arteve moderne, i cili ka filluar të zhvillohet në fund të shekullit XIX me shpikjen e kamerës. Filmat janë një formë e avancuar e artit, ku kombinohen pamjet, fjalët, tingujt dhe ngjarja për të shprehur ide dhe emocione. Pas paraqitjes së kinemasë (filmit) shkrimtarët, përvojën pamore përmes teknikave, si: montazhi, kontrapunti, fleshback-u, e shndërruan në një marrëdhënie midis reales dhe imagjinare.

2. Artet tonike (kohore) lidhen me tingullin dhe kohën, prandaj veprat e krijuara prej tyre nuk janë materiale, por tingullore. Ato nuk mund t'i prekim, por i dëgjojmë ose i ndjejmë përmes ritmit dhe melodisë, e pasi kanë lidhje me kohën, quhen dhe arte kohore.

Arte të tilla janë: **muzika** dhe **poezia**.

• **Arti muzikor** është art shumë i vjetër, i cili mbështetet në lëndën zanore (akustike) që prodhohet nga dridhjet e zërit (tonit).

Bazën materiale të muzikës e përbëjnë tre elemente kryesore: **ritmi**, **melodia** dhe **harmonia**. Muzicentët, përmes këtij arti, me kombinimin e toneve që kanë lartësi, zgjatje, fuqi dhe ngjyrë të ndryshme, si dhe me harmonizimin e tyre sajojnë kompozime muzikore, me anë të të cilave shprehin mendime dhe ndjenja. Arti muzikor ndikon drejtpërdrejt në ndjenja dhe shprehet përmes tingujve.

Muzika ndahet në dy degë: **muzikë vokale** (interpretim me zë) dhe **muzikë instrumentale** (interpretim me vegla muzikore).

• **E para** përfshin muzikën që riprodhohet nëpërmes zërit të njeriut;

• **E dyta** përfshin muzikën që realizohet me anë të veglave muzikore, si: violinë, piano, flaut, kitarë, saksofon, violonçel etj.

Muzika është “art i zemrës” — Hegeli



• **Arti dramatik** si mjet shprehjeje e ka **fjalën, mimikën dhe gjestet** dhe realizohet në teatër apo në skenë, prandaj quhet **arti skenik**. Aktorët, rolet e tyre i interpretojnë në skenë, ku edhe e vendosin ngjarjen. Ky art lindi në Greqinë e Vjetër dhe kryesisht realizohej nëpër teatro dhe arena.

- **Drama** ndahet në **komedi dhe tragjedi** (për shkak të flijimit të perëndisë Dionis, në festat e pranverës). Në teatër, aktorët luajnë role dhe përçojnë mesazhe te publiku.

- **Opera** është arti që e bashkon **muzikën, teatrin dhe interpretimin**. Opera është vepër muzikore dramatike që luhet në skenë, me orkestër e me këngëtarë, e ndërthurur edhe me pjesë baleti.

- **Baleti** (vallëzimi) është art i posaçëm, i cili njihej qysh nga njeriu primitiv (kërcimi). Baleti shprehet me ndihmën e lëvizjeve të harmonizuara të trupit dhe të gjymtyrëve të vallëzuesit – vallëzueses dhe gjithmonë përcillet me muzikë.

• **Poezia** është lloji i artit, përmes të cilit mendimet dhe ndjenjat formësohen në vargje, me anë të fjalës si mjet shprehës. Lënda e poezisë është njeriu dhe natyra, prandaj merret si një trajtë e veçantë e vetëdijes shoqërore, pasi ka liri shumë më të gjerë veprimi se artet tjera.

Fjala **poezi** vjen nga fjala greke **poiesis**, që do të thotë **krijim**.

Poezia ka një kuptim edhe më të gjerë shprehës. Ajo paraqet **artin e të shkruarit**, duke përfshirë çdo letërsi që ka cilësi artistike, qoftë në poezi ose në prozë, përndryshe njihet edhe si letërsi.

ANALIZË



INTERPRETIM:

- Si mendoni, çfarë e paraprin zanafillën e artit?
- Kur u krijua vetëdija e njeriut për artin?
- Cilat janë llojet e arteve, përshkruani karakteristikat e tyre?
- Si e kuptoni artin e fjalës dhe artet e bukura?
- Si u zhvillua arti dramatik?
- A e plotëson artin letrar mendimi dhe imagjinata?
- Ku qëndron dallimi midis poezisë dhe arteve tjera: pikturës, dramës, filmit?
- Përshkruani karakterin e ndërthurur (sinkretik) të poezisë dhe muzikës!
- Zgjidhni dhe analizoni një poezi që ju pëlqen!



PËRFORCIM NJOHURISH:

Shkruani në fletore fjalët artistike, pastaj me to krijoni fjali:

filmi		skulptura	
libri		gjuha	
arti		muzika	
dituria		poezia	
koha		folklori	
baleti		teatri	

Shembuj:

- **Filmi** më i bukur shqiptar është ai kushtuar Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, ku trajtohet jeta dhe lufta e tij kundër Perandorisë Osmane. **Filmi** titullohej “Luftëtari i Madh i Shqipërisë - Skënderbeu” dhe është realizuar në vitin 1953.

- Shkrimtari përdor një **gjuhë** të pasur artistike. **Gjuha** shqipe është pasuria jonë kombëtare. Sa më shumë ta duam **gjuhën**, aq më të mbrojtur dhe krenarë do ta bëjmë atdheun.

SHKENCA E LETËRSISË

SHKENCA E LETËRSISË DHE NDARJA E SAJ

Mendimi dhe përvoja njerëzore janë dy linja thelbësore të zhvillimit të letërsisë dhe shkencës. Ato e plotësojnë njëra-tjetrën në përpjekjen e përbashkët për ta kuptuar jetën, botën dhe vetë njeriun, ndonëse funksionojnë në mënyra të ndryshme.

Letërsia - si art, është një nga format e shprehjes së ndërgjegjes shoqërore që e pasqyron jetën nëpërmjet figurave artistike të krijuara me anë të fjalës, duke shprehur qëndrim të caktuar ideor dhe estetik. Ajo ka rëndësi të madhe në jetën shoqërore, pasi ka karakter **njohës** dhe **edukues** të të gjithë krijimtarisë shpirtërore, me vlerë të përgjithshme artistike dhe shoqërore.

Letërsia - arti i të shkruarit është mjeshtëri (sikurse edhe artet tjera), e cila kërkon nga shkrimtari t'i përvishet punës me zell, dashuri e durim.

Shkenca e letërsisë bën renditjen dhe rindarjen e materialit shkencor, i hulumton ligjet dhe shpreh gjykime shkencore në lidhje me objektin që e studion. Ajo u krijua nga interesimi dhe përpjekja e dijetarëve për ta shpjeguar problematikën e artit letrar dhe për ta qartësuar dhe vërtetuar atë, gjë që ata e bënë me anë të metodave studimore dhe hulumtuese të tërë asaj që ka qenë dhe është krijimtari artistike, në të gjitha etapat kohore.

Ndërthurja e letërsisë me shkencën është thelbësore.

Në sistemin arsimor, letërsia ndihmon në ndërtimin e komunikimit më të mirë shkencor, pasi gjuha artistike mund të shpjegojë më qartë dhe më bukur koncepte të vështira mbi teoritë shkencore.

Përgjatë periudhave kohore krijuesit kanë bërë vepra të mëdha arti, veçmas vepra letrare të frymëzuara nga ndjesia e së bukurës, si edhe nga zhvillimet shkencore. Shkenca, përgjithësisht ka përfituar nga intuita dhe këndvështrimet filozofike që ofron letërsia, duke ndikuar në mënyrën se si studiuesit i qasen realitetit. Kjo tejmasë i ndihmon lexuesit për t'i kuptuar e zbërthyer sa më mirë veprat letrare, ideologjitë e autorëve, ndërlidhjet kohore dhe rëndësinë e përmbajtjes tematike të veprave.

Shkenca e letërsisë ndahet në tri degë:

- **Historia e letërsisë;**
- **Teoria e letërsisë;**
- **Kritika letrare.**

Secila prej tyre ka karakteristika dhe metodologji të veçanta studimore.

Ndjeshmëria humane që ofron letërsia, si dhe arsyeja (racionalja) që ofron shkenca janë baraspesha e domosdoshme e harmonisë së pikëpamjeve më të qarta, në të cilat njeriu e vrojton botën.

- **E para** e shpreh botën e brendshme shpirtërore;
- **E dyta**, shkenca, ofron shpjegime logjike, të cilat e argumentojnë ndërtimin e dijes mbi realitetin individual dhe shoqëror.



Thënie me vlerë:

“Të dish, është ta dish se s’di asgjë. Kjo është domethënia e diturisë së vërtetë”! — **Sokrati**

“Arti përpiqet të nxjerrë në pah dhe në mënyrë sa më të plotë aspekte të botës, në mënyrë që secili, si përmes një velloje të hollë, ta lexojë kuptimin që kanë gjërat dhe që filozofia e kërkon”.

— **Jeronim de Rada**

“Përhapja e diturive në popull duhet bërë nëpërmjet thjeshtësimit të shkencës”!

— **Sami Frashëri**

“E vërteta në art e rikrijon të vërtetën në realitet”.

— **Dritëro Agolli**

“Nuk më duket i lirë ai njeri, që nganjëherë nuk bën asgjë”!

— **Marsel Prust**

Shkruani një temë, duke i ndërthurur fjalët e dhëna:

(Shkruani në fletore detyrën e dhënë)!

Fjala, mendimi, letërsia...

HISTORIA E LETËRSISË

Panorama më e qartë e paraqitjes dhe ecurisë zhvillimore të letërsisë, në të gjitha epokat kohore, nuk kuptohet vetëm nga rrëfimi i autorëve dhe veprave të tyre, por nga shënimet kronologjike që argumentojnë se si letërsia qysh kur është krijuar ndërvepron me rrethanat e kohës.

Historia e letërsisë - objekt studimi e ka zhvillimin historik të letërsisë, ku përfshihen të gjitha veprat letrare të një populli ose të më shumë popujve. Ajo i analizon marrëdhëniet shoqërore gjatë epokave të ndryshme historike, kur janë paraqitur, si janë formuar dhe si kanë vepruar shkrimtarët.

Historia e letërsisë e trajton paraqitjen dhe ndikimin e epokave (periudhave), lëvizjeve dhe rrymave letrare, si dhe përfaqësuesit e letërsisë, shkollat letrare, mënyrën e të shkruarit dhe shijet estetike të shkrimtarëve.

Periudha letrare paraqet një hark kohor të mirëpërcaktuar nga dy data në skaje (fillim-mbarimi i një linje kohore).

Lëvizja letrare është një tërësi rregullash apo praktikash letrare, të zbatuara nga shkrimtarë që kanë pasur pikëpamje ose referenca të përbashkëta.

Rryma letrare është prirje ose drejtim i përgjithshëm “transhistorik”.

Historia e letërsisë e ndërton logjikën e qartë të zhvillimit letrar nga letërsia gojore dhe epike, humanizmi, iluminizmi, romantizmi, realizmi, modernizmi dhe postmodernizmi. Në këtë aspekt, përfshin analiza të hollësishme periudhash letrare, duke i përvijuar lidhjet e brendshme dhe ndryshimet thelbësore midis tyre. E përmbledh letërsinë e një kombi, me autorë dhe vepra, të cilët e identifikojnë historinë e atij kombi, si: letërsia shqipe, letërsia greke, letërsia angleze, letërsia gjermane etj.

Letërsia shqipe, parë nga prizmi i historisë së letërsisë, është e lidhur ngushtë me zhvillimet kombëtare dhe shoqëro-politike. Ajo përfshin, përpos krijimtarinë individuale të shkrimtarëve të shquar, edhe përpjekjet për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar përmes fjalës artistike. Me studimin e kësaj fushe, mësojmë, jo vetëm për autorët dhe veprat, por edhe për rrugët e formimit të vetëdijes kombëtare, ndikimin e ideologjive dhe mënyrën se si letërsia ka ndihmuar në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme.

Historia e letërsisë kombëtare ka për qëllim të bëjë kërkime, t'i analizojë dhe vlerësojë veprat letrare dhe tërë aktivitetin kulturor e shpirtëror të kombit dhe të secilit shkrimtar, në veçanti.

Historiani i letërsisë e realizon periodizimin e letërsisë kombëtare gjatë hartimit të historisë së saj, prandaj duhet të ketë njohuri shumë të gjera të ngjarjeve dhe periudhave nga lëmi të ndryshme.

Historia e letërsisë krahasuese (komparative) është disiplinë shkencor-letrare, e cila e mundëson krahasimin e letërsisë së një populli me letërsinë e popujve tjerë, duke filluar nga periudhat më të hershme letrare, si: mitologjia, antikiteti, renesanca, iluminizmi, romantizmi, realizmi etj.

Historia e letërsisë është arkiv kalendarik i ngjarjeve, si një formë letraro-artistike ku përshkruhet jeta e njeriut, duke e përvijuar atë përmes shkrimit dhe leximit të botës që ai ndërton. Ajo e jep pasqyrën e zhvillimit letrar dhe punën e shkrimtarëve të rëndësishëm.

TEORIA E LETËRSISË

Teoria e letërsisë është një degë e lashtë e shkencës e formësuar nga një varg rregullash e përgjithësimesh, të cilat i përkasin krijimtarisë letrare. Ajo i përcakton ligjshmëritë që kanë të bëjnë me krijimin, thelbin dhe trajtën e veprave letrare, gjithmonë e ndihmuar nga shkencat tjera, për të qenë sa më normative.

Teoria e letërsisë - objekt studimi e ka shpjegimin se ç'është letërsia dhe cili është funksioni i saj, cili është roli shoqëror i saj dhe si duhen çmuar veprat letrare. Ajo synon të krijojë kornizë të qartë për ta kuptuar funksionimin e gjuhës artistike. Gjithashtu, përpiket të kuptojë se çfarë e bën një tekst "letrar", cilat janë mjetet që përdor autori për të ndikuar te lexuesi dhe si ndërtohet kuptimi në veprën artistike.

Filozofët e antikitetit, ndër të parët, dhanë mendime dhe përkufizime teorike për artin. Qysh në kohën e Demokritit dhe të Platonit janë trajtuar probleme të artit letrar. Një traktat të veçantë, kushtuar teorisë së letërsisë, shkroi Aristoteli (384-322 p. e. r), në "Peri poetika" ("Mbi artin poetik"). Nga kjo vepër, sot ka mbetur vetëm pjesa për poetikën - "Poetika". Gjithashtu, kanë shkruar edhe Aristofani (rreth shek. 446-386 p. e. s.) në veprën "Bretkosat" dhe Kuint Horaci (65-8 p. e. r.) në veprën "Mbi artin poetik" etj. Përveç aspekteve teorike të poetikës, studiuesit e hershëm i kanë dhënë mjaft rëndësi edhe mjeteve themelore stilistike të gjuhës dhe poezisë, gramatikës dhe oratorisë.

Që nga koha e Aristotelit, i cili e trajtoi letërsinë si një formë e imitimit (mimesis) të realitetit, deri te qasjet moderne si: strukturalizmi, formalizmi, semiotika etj., teoria e letërsisë ka kaluar përgjatë zhvillimeve që pasqyrojnë ndryshime në mënyrën e të menduarit për artin dhe shoqërinë. Kjo fushë është bërë gjithnjë e më e ndërlidhur, duke përfshirë elemente nga filozofia, sociologjia, psikologjia, antropologjia dhe shkenca të tjera.

Teoria e letërsisë, si qëllim kryesor e ka ofrimin e mjeteve për interpretimin dhe vlerësimin kritik të teksteve, pa u kufizuar vetëm në preferenca estetike. Ajo parashtron pyetje të rëndësishme, si: Çfarë është autori? A ka kuptim objektiv një tekst? Si ndikon lexuesi në krijimin e kuptimit?

Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve, jo vetëm që e pasurojnë të kuptuarit e letërsisë, por edhe ndikojnë në mënyrën se si ajo mësohet, interpretohet dhe vlerësohet nëpër shkolla.

KRITIKA LETRARE

Vetëdija është shtysa e parë nëpërmjet të cilës vlerësohet një krijim, qoftë në aspektin shkencor apo atë artistik. Shkrimi kritik për një vepër letrare duhet të jetë një shkrim i argumentuar.

Kritika letrare është degë e rëndësishme e shkencës së letërsisë që merret me analizën, interpretimin dhe vlerësimin e veprave letrare. Ajo nuk kufizohet vetëm në dhënien e mendimeve personale, por kërkon njohuri të thella teorike dhe metodologjike për ta kuptuar në mënyrë të drejtë thelbin dhe cilësinë e një vepre artistike.

Kritika letrare shërben si një pasqyrë për krijimtarinë letrare dhe në të njëjtën kohë, si mjet edukimi për publikun. Ndikon në formimin e shijes estetike të lexuesve dhe në ngritjen e vetëdijes për vlerat kulturore e artistike. Roli i saj është që ta ndihmojë lexuesin të orientohet në botën e gjerë letrare dhe të dallojë cilësinë, vlerat estetike dhe mesazhet që përcjell një vepër.



Përveç ndikimit të lexuesit, kritika është e domosdoshme edhe për vetë autorët. Kritikët ndihmojnë në pasurimin e letërsisë përmes sugjerimeve të tyre, e nxitin zhvillimin e stileve të reja dhe përcaktimin e periudhave letrare. Kështu, kritika nuk është thjesht një koment mbi veprat, por një akt krijues më vete që kontribuon në vazhdimësinë dhe cilësinë e letërsisë.

Letërsia, në përgjithësi, pra edhe ajo shqiptare, njohu vepra të ndryshme, të stileve individuale dhe një trajtim kritik të këtyre veprave. Kjo qasje mundësoi komunikim më të thellë letrar, duke e krijuar vetëdijen për krijimin artistik, veçantinë dhe vlerën e tij.

Kritiku letrar duhet t'i njohë mirë teoritë letrare, historinë e letërsisë, stilistikën, strukturën narrative, si dhe të jetë i aftë të bëjë krahasime midis veprave të ndryshme. Gjithashtu, duhet të jetë i paanshëm, objektiv dhe i bazuar në argumente të forta.

Shënim: Kritika letrare mund ta shqyrtojë veprën nga këndvështrime të ndryshme, varësisht nga qasja që ndjek kritiku (shih grafikunin)!

Në kohën moderne, kritika është shtrirë edhe në medie të ndryshme: revista, portale on line, rrjete sociale etj. Megjithatë, kjo ka sjellë edhe sfida, pasi shpeshherë opinioni subjektiv maskohet si kritikë letrare. Dallimi në mes kritikës së mirëfilltë dhe opinionit të rastësishëm mbetet një sfidë për lexuesin. Përfundimisht, kritika letrare është një fushë që kërkon përkushtim, pavarësi intelektuale dhe pasion për artin e fjalës së shkruar.

ANALIZË



INTERPRETIM:

- Mbi përjetimin e brendshëm të rrëfimitarit (nga fragmenti i dhënë më poshtë),
- Mbi formën artistike dhe tiparet estetike,
- Mbi shprehjet më të veçanta gjuhësoro-artistike.



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Çfarë studion shkenca e letërsisë dhe cilat janë degët e saj?
- Pse historia e letërsisë është e rëndësishme për shkencën e letërsisë?
- Si përkufizohet letërsia kombëtare shqiptare?
- Përshkruani detyrën e historianit, teoricienit dhe kritikut letrar!
- Me çfarë merret teoria e letërsisë, cili është objekti i studimit të saj?
- A ndikon kritika letrare te lexuesi dhe pse? Si janë marrëdhëniet midis tyre?
- Sa është e rëndësishme kritika objektive e një vepre letrare?



SPROVË LETRARE:

Lexoni fragmentin e dhënë dhe shprehni përshtypjet tuaja, duke përdorur disa lloje të kritikës letrare!

“Jeta humbte ngjyrat e bukura, zverdhej, mbulohej me hije të zeza. Ajo skutë fatbardhësie, që duert e njoma të Nushës do të lulëzonin përditë me drandofile të përvesuem, a thue kishte për t’u zhdukë si andërr e avullt që fshin drita e diellit? Libri origjinal, vepra e thellë që do të përtërinte psikikën e kalamajve shqiptarë tue ngjallë e forcue instinktët ma të shëndosha të kombit, kishte për të mbetë vallë dëshirë e pafuqishme e një mëngjesi vetëm me rreze shpresash?”

(Vepra me tregime: “Hija e maleve”, Ernest Koliqi).

NDARJA E LETËRSISË

GJINITË LETRARE DHE LLOJET E TYRE

Dijetarët, të cilët janë marrë me studimin e artit letrar kanë shfaqur mendime të ndryshme në lidhje me klasifikimin e veprave letrare në gjini dhe lloje. Sot, këto dilema janë tejkaluar dhe mbizotëron mendimi se tërë letërsia mund të ndahet në gjini dhe lloje letrare.

ÇFARË ËSHTË LETËRSIA DHE SI NDAHET?

Letërsia përfshin shumëllojshmëri tekstesh, të cilat kanë funksion estetik (greqishtja e vjetër **asthetikos** - **ndjenjë, perceptim shqisor**) që te lexuesi shkaktojnë kënaqësi shpirtërore të një lloji të veçantë.

Gjini letrare quhet ndarja ose grupimi i letërsisë në tri togje. Pavarësisht, nëse veprat letrare janë të shkruara në vargje apo në prozë, ato ndahen në tri gjini themelore: **lirika, epika dhe drama**.

- **Lirika**, në thelb e ka rrëfimin e ngjarjes dhe karakteristikë mbizotëruese e saj është **subjektiviteti**.

- **Epika**, në thelb e ka rrëfimin e ngjarjes, ndërsa karakteristikë mbizotëruese e saj është **objektiviteti**.

- **Drama** është vepër, në të cilën autori rrëfen përmes **personazheve** ose aktorëve në skenë, karakteristikë e saj është **dialogu**.

Tipar i përbashkët i gjinive është **synimi** për ta shfaqur **realitetin** përmes **mjeteve artistike**.

Gjinitë letrare (sipas shkrimtarit Johan Wolfgang Göte) nuk janë thjesht ndarje teknike, por shprehje të mënyrave të ndryshme se si njeriu e përjeton **botën** dhe ia komunikon atë të tjerëve, qoftë me anë të **ndjenjës, arsyes** apo **veprimit**.

Çdo vepër letrare i përket një gjinie, për arsye se veçoritë themelore si ndjeshmëria poetike, rrëfimi i ngjarjeve apo paraqitja e konflikteve përmes dialogëve e bëjnë veprën të dallueshme, përpos nga përmbajtja edhe nga mënyra e formësimit dhe e trajtimit të temave.

LIRIKA, VEÇORITË DHE LLOJET E SAJ

Të mësojmë:

- lirikën dhe llojet e saj;
- si t'i dallojmë format e lirikës;
- strofën dhe vargun;
- prozën poetike.
- * lirikën peizazhiste (të natyrës);
- * lirikën erotike (të dashurisë);
- * lirikën patriotike (atdhetare);
- * lirikën sociale (shoqërore);
- * lirikën refleksive (meditative-mendimtare).

Zanafilla e lirikës e vendos atë, si **ndër më të lashtat e krijimeve letrare**. Gjurmët e hershme të lirikës shihen qysh kur njeriu u bë i vetëdijshëm, filloi të mendojë dhe të përdorë gjuhë të artikuluar. Në fillet e veta, poezia lirike kishte lidhje sinkretike me melodinë, muzikën dhe lojën.

Origjina e lirikës është te këngët korale, të cilat i shprehnin ndjenjat shpirtërore si gëzimet dhe hidhërimet që janë e përbashkëta e njerëzve. Në këtë lloj të poezisë nuk ka personazhe, as nuk përshkruhen ngjarje të caktuara dhe nuk ka një rrëfim linear; në vend të këtyre, poeti i flet vetes dhe botës përmes emocioneve, përjetimeve apo mendimeve të tij më intime.

Fjala “**lirikë**” rrjedh nga fjala “**lyra**”, një **vegël muzikore me tela**, me të cilën ekzekutoheshin këngët në antikitet. Që nga ato kohë të hershme, lirika është shquar për formën e shkurtër e të ndjerë, duke u bërë mënyra më e përshtatshme për të shprehur ndjenja dhe përjetime të thella personale. Kjo formë poetike arriti të fitojë vend të rëndësishëm në Greqinë e Lashtë dhe më vonë u zhvillua edhe në formën e ditirambit, i cili u këndua në nderim të hyjnive dhe të satirës që vinte në pah të metat e individit apo shoqërisë.

Mjetet e formësimit të krijimit lirik, përveç fjalës si element kyç, janë vargu dhe strofa.

Vargu është elementi bazë i lirikës, si forma më e përhapur poetike, e cila përbëhet nga fjalë të vendosura në mënyrë të rregullt, të shkruara në rreshta.

Strofa përbëhet nga dy e më shumë vargje që bashkohen në njësi më të mëdha, si rezultat i **sistemimit të ideve** dhe ndjenjave në **njësi kuptimore**. Strofa mund të ketë numër të ndryshëm vargjesh, si forma më të zakonshme janë: katërvargëshi, gjashtëvargëshi, tetëvargëshi, por sigurisht nuk mungojnë as llojet tjera të vargjeve. Në vargjet lirike shpesh përdoret **rimimi**, sidomos në rastet kur poezia ruan një ritëm të rregullt, duke i dhënë muzikë dhe bukuri shprehjes.

Poezia lirike ndjek **rregulla ritmike** që lidhen me **theksin** dhe rrokjen.

Në gjuhën shqipe, më së shpeshti hasen vargje me numër tek rrokjesh, ku theksi i rëndësishëm bie në rrokjet: 1, 3, 5 dhe 7, duke krijuar ritëm të rregullt

dhe harmonik. Një ilustrim tipik është poezia e Naim Frashërit, ku ndihet qartë theksi në këto rrokje, duke krijuar rrjedhë të natyrshme të tingullit poetik. Nga ana tjetër, në vargjet me numër çift rrokjesh, për të shmangur ritmin e ngurtë e të pandryshueshëm, theksi vendoset në rrokjet çift: 2 dhe 6, për ta ruajtur rrjedhën e butë dhe të këndshme për dëgjuesin apo lexuesin.

Lirika është më shumë se një mënyrë shprehjeje, ajo është pasqyrim i shpirtit njerëzor, i kthyer në art përmes **fjalës së bukur dhe ritmit**. Lexuesi, për të kuptuar një vepër të tillë duhet të ketë njohuri, jo vetëm mbi gjuhën – si normë e gjuhës letraro-artistike, por edhe mbi emocionet e njeriut dhe ndjeshmërinë që kërkon ky lloj arti.

Rima e puthitur:

Mëmëdhe quietë toka	a
ku m'ka rënurë koka,	a
ku kam dashur mëm' e atë,	b
ku më nje dhe gur' i thatë.	b

(Poezia: "Mëmëdheu", Çajupi).

Rima e alternuar:

Veç zemrat e njerzve të lanun	a
me të rektuni prralla rrejnë:	b
mbi barrat e jetës së namun	a
që shpirt dhe korriz thejnë.	b

(Poezia: "Lagja e varfun", Migjeni).

Rima e kryqëzuar:

Jakë, mejtim, jakë,	a
Dua të mejtohem,	b
Të rri të qetohem,	b
Edhe të qanj pakë.	a

(Poezia: "Të vdekunit", Naim Frashëri).

Llojet letrare të poezisë lirike

Poezia lirike, qysh në fillet e paraqitjes, e ka shfaqur qëllimin shprehës përmes tematikës së caktuar. Tema e lirikës është një realitet i veçantë që lidhet me botën shpirtërore, me subjektiven ose me gjërat thelbësore të jetës së njeriut, si: **jeta - dashuria - vdekja**.

Tipari themelor i poezisë lirike është lidhja e fuqishme e elementeve të të gjitha shtresave: tingullore, leksikore, kuptimore. Poezia lirike shkruhet nga pozicioni i unit poetik të krijuesit. Ajo hartohet në forma të shkurta, prandaj edhe ndryshon në pikëpamje të kompozicionit nga llojet e ndryshme të poezisë epike dhe dramatike.

Llojet e lirikës janë: lirika përshkruese, lirika e dashurisë, ditirambi, elegjia, lirika patriotike, lirika sociale, himni, oda, lirika satirike, lirika reflektive, epigrami, epitafi, epigrafi, gnoma, idila, epitalami, ekloga dhe epistula.

***Lirika peizazhiste (e natyrës)** është poezi (këngë) lirike, përmes së cilës poeti shpreh ndjenja të thella në përshkrimin e natyrës dhe dukurive të ndryshme që shfaqen në të. Frymëzimi i poetit për natyrën dhe pamjet mahnitëse, zgjon te ai ndjenjën e kënaqësisë dhe dëshirës për ta shijuar çdo imazh të saj.

Qysh në kohët e lashta bukuria magjepsëse e natyrës e ka tërhequr vëmendjen e poetit, duke e frymëzuar që të krijojë një mori këngësh, kryesisht për kohët e vitit - stinët, kohët e ditës (mëngjesi, dreka... deri në mesnatë) dhe të gjitha pamjet piktoreske të natyrës.

Lirika e peizazhit e sheh objektin e saj si model që ndikon me bukurinë e vet në ndjeshmërinë e poetit dhe përshkohet vetëm nga mesazhi estetik.

Në letërsinë shqipe, lirika peizazhiste kanë shkruar poetët: Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Kristo Floqi, Filip Shiroka, Luigj Gurakuqi, Asdreni, Çajupi, Lasgush Poradeci etj.

Dremit liqeri

Mi zall të pyllit vjeshtarak
Dremit liqeri pa kufi
Ay ndaj fundesh u përflak
Posi me zjarr e me flori.

Posi me flakë u ndes e kroi
E vetëtiti plot magji,
E yll' i ditës perëndoi
Në qetësi dhe dashuri.

Tashti po shuhet nënë mal
Qytet' i ngrysur në të zi.
Po ndizen yjtë dalngadal
Plot bukuri! Plot fshehtësi!

Në këtë ças perëndimor,
Ndaj po më dehen sytë e mi,
Kuptoj se shpirtin vjershëtor
Ma frymëzon një mall i ri.

(Poezia: "Dremit liqeri", Lasgush Poradeci).

Natyra

Ah! sa më pëlqen bari
Dhe mburimi si ari
Që rieth tatëpjetë
Me nga dal'edh' i qetë.
Dhe zogjtë kur qëndrojnë
Nër degët e këndojnë,
Mi drurët me fletë shumë
E s'të lenë ndë' gjumë.
Oh! sa bukuri kanë
Kur je edh' i sheh pranë!

Brigjet bukur stolisur
Gjith me lule qëndisur,
Pylli kudo me hie
Që të k'ënda kur bie,
Dhe fletët kur përpiqen
Sytë që atje s'të hiqen
Aq është e pëlqyer
E bukur pa dëftyer
Natyra kur përtrihet
Është punë që s'mfshihet!

Hëna kur nëpër brigjet
Del si dyllë që digjet,
Dhe ndrit me ëmbëlsirë
Çdo gjëje i jep hirë.
Natën e bën të artë
Me dritën e zjartë,
Rehtë, si edhe çdo vënt
I ngjyron gjith me ergjënt
Sa pëlqim sa bukuri
Që s'e mohon as njeri!

(Poezia: "Natyra", Asdreni).

Anës liqenit

Nata po afrohet. Drita e ditës tretet dalëngadalë, e, mbi tjegullat e shtëpive, mbi dërrasat e rrugëve, mbi fletët e pemëve, mbi trupat e epët të çupave, që shkojnë, një ngjyrë manushaqeje - një ngjyrë gushëpëllumbi, si thonë në ca male tona - shtrihet e i mbështjell. Mbasandaj, pak nga pak manushaqet shfletohen, ngjan. Hijet bëhen më të dendura, më të zeza. Njëri pas tjetrit, yjtë shpojnë qiellin e pikëlojnë dritë. Nata u afrua. Nata erdhi.

E kur afrohet nata, kur vjen nata, më pëlqen të vete të rri anës liqenit. S'është si liqeni i Ohrit, me ujëra të kulluara si të një rrëkeje, si liqeni i Janinës, që shkëlqen si një fushë e shtruar me pasqyrë, si liqeni i Shkodrës, det i vogël, i rrahur tej - këtej nga lundra të moçme sa Shkodra e në anë të cilit gjallojnë malësorë të rreptë. Është një liqen nuk m'i madh se një kopsht, në mes të një pylli të punuar, liqen i ndyrë e i bukur, i ndyrë me ujë të qelbët, i bukur se pemët që e rrethojnë varin degët e tyre gjer mbi faqe të tij, edhe mbi faqe të tij hëna ndrit e lot. Në pushim të natës bretkosat këndojnë. Herë - herë një peshq, e një tjetër, e një tjetër, shumë peshq tinglojnë ujën. Uji përsëri pushon e fle. Po një erë e ngadaltë (oh, shumë e ngadaltë!) unjet mbi liqen e i zhubravit faqen.

(Proza poetike: "Anës liqenit", Faik Konica).

Magjia e shndërrimit të krimbit të mëndafshit në flutur

Në nëntor të vitit 1979 e kisha lëshuar me dy gishtërinj një flutur të verdhë të cilën e kisha shtënë në dorë nja katër vjet më parë, në lojën të cilën e quajmë dashuri. E kisha zënë, isha argëtuar me të deri sa isha ngopur, dhe sikundër ndodh shpesh, po me këta gishtërinj e kisha lëshuar të fluturojë atje tek e kisha zënë, në ajër. Ku ta dish çka kish ndodhur pastaj - a më kish shituar bukuria e saj, a pse e mbaja mbyllur në herbarium dhe s'e lija të marrë frymë, atë ditë që e kisha lëshuar, unë kisha ndjerë se po bëja krim duke e mbajtur të lidhur peng për dhembjet e mia tmerrësisht të llahtarshme. Në nëndije ndërkaq, unë sikur po sprovoja besnikërinë e saj: e kisha lënë të fluturojë (me mend thosha ajo patjetër do të kthehet këtu, në plagët e mia të tmerrshme), kurse rezultati, e kisha humbur përgjithmonë.

E pra, i shndërruar edhe vetë në krimb mëndafshi, unë ç'prej asaj dite në të vërtetë s'bëj asgjë pos që e gjurmoj këtë krijesë të ëndërruar. Prej atëherë e deri më sot, mua më ka mbetur një ves i mbrapsht që, kudo që shkoj dhe çka do që bëj, i lëviz gishtërinjtë e dorës së djathtë, i lëviz ata dy gishtërinj të mi të zinj të cilët dikur e kishin zënë dhe pastaj lëshuar atë flutur, kurse kjo do të thotë se, sa herë i shtrëngoj e i liroj gishtërinjtë, faktikisht sikur bëj një akt shlirimi, po kaq sa edhe akt ngarkimi të shpirtit, nga ajo barrë e vdekshme, ankthit tim të pritjes së përgjithmonshme. Ndërkaq, sytë e mi përherë përlohen duke e parë horizontin si boshatiset tek s'e shoh gjatë përsëritjes së atij Akti të Përherëshëm të Harxhim-Ngarkimit Shpirtëror, njëlloj si vdekja. Dhe, për ngushëllim, gjithnjë vetëmashtrohem me tone lirike. Janë këto çaste kur në horizontin tim të shprazët, e shoh të vegulluar objektin tim të ëndërruar herë si pragmë sofistike, e herë si krimb mëndafshi, dhe me këtë sikur dëgjoj:

- Shqipëri o Mëma lme të shqiptuara nga kjo zanë imja prej fluturë.
- Shqipëri o Mëma lme, pëshpërisin engjujt e mi të mirë duke fluturuar rreth e rrotull meje.
- Shqipëri o Mëma lme, ajgëtohen fjalët e shenjta të Naimit ndër kodra, livadhe e qiej gjer te dhembjet e mia pa fund.

Tash e njëzet vjet rresht, i bërë edhe vetë në krimb mëndafshi, unë për po kaq kohë, në fakt luaj gishtërinjtë e dorës sikur e improvizoj jetën që kam humbur, duke e imagjinuar krijesën e ëndërruar dhe duke e balsamosur atë me të vërtetën absolute.

Oh flutura ime, këndova unë atë ditë,
ti je dhembja e ime e bukur që përjetë s'do t'm'u japësh përgjigje tmerreve të mia të pritjes,
ti je ai fluror shpirti që sot e gjithë ditën m'i mban kallur shqisat, m'u jep zjarr të gjitha rrugëve
pa mbarim dhe m'i mban valë ëndrrat,
ti je ai narkotiku që sot e gjithë ditën më dikton që të mos bëj asgjë, pos...

(Vepra me tregime: "Alga e dalë nga deti", Nehas Sopaj).

• **Poezia idilike** është poezi lirike ku, në mënyrë të idealizuar, poeti shpreh kënaqësinë ndaj jetës së qetë dhe pa brenga të njeriut në natyrë, duke vënë në pah vetëm të mirat e saj.

Eidyllion (greq.) - skicë, fotografi e vogël, përmes së cilës krijohet pamje (imazh) për jetën intime dhe familjare në qytet ose fshat dhe gjithçka që ishte e lidhur ngushtë me natyrën. Ndjesia që e përshkon poezinë idilike është ndjenja e dashurisë dhe përjetimi ndaj jetës blegtorale dhe bujqësore që reflekton me ndjenja gëzimi, lumturie e kënaqësie për jetën në natyrë.

Themelues i poezisë idilike është poet grek, Teokriti, i cili ka jetuar në shek. III para erës sonë.

Në poezinë shqipe idila kanë shkruar: Naim Frashëri, Kristo Floqi, Lasgush Poradeci etj.

(fragment)

Tek buron ujët e ftohtë edhe fryn veriu në verë,
Tek mbin lulja me gas shumë dhe me bukuri e m'erë,
Ku i fryn bariu xhurasë, tek kullosin bagëtija,
Ku mërzen cjapi me zile, atje i kam ment e mija.
Atje lint diell' i qeshur edhe hëna e gëzuar,
Fat' i bardh' e mirësija në atë vënt janë mbluar;
Nat' atje 'shtë tjetër natë edhe dita tjetër ditë,
Në pyjet' e gjelbëruar, atje rrinë perënditë.

Mendje! merr fushat e malet, jashtë, jashtë nga qyteti,
Nga brengat, nga thashethemet, nga rrëmuja, nga rrëmeti.

Tek këndon thëllëza me gas edhe zogu me dëshirë,
E qyqja duke qeshur, bilbili me ëmbëlsirë,
Tek hapetë trëndafili, atje ma ka ënda të jem,
Bashkë me shpest edhe unë t'ia thërres këngës e t'ia them;
Të shoh kedhëri' e shqerrat, deshtë, cjeptë, dhëntë, dhitë,
Qjellin' e sbukuruar, dhenë me lul'e me dritë.

(Poema: "Bagëti e bujqësi", Naim Frashëri).

***Lirika e dashurisë (erotike)** i përkushtohet ndjenjave më të rëndësishme në jetën e njeriut, ndjeshmërisë dhe dashurisë, andaj është emërtuar nga fjala: **Eros-dashuri**.

Në poezinë lirike të dashurisë poeti i këndon ndjenjës intime, me nota të forta e të singerta, ndaj atij/asaj që e dashuron. Në të, përshkruhen ndjesitë e të rinjve të dashuruar nga çastet e lumtura deri te vuajtjet shpirtërore të tyre, me një larushi dhe pafundësi motivesh brenda tematikës së saj.

Letërsia shqipe është e pasur me lirikën e dashurisë, ndër periodha të shumta kohore kanë shkruar: Zef Serembe, Naim Frashëri, Çajupi, Migjeni, Ali Asllani, Hilë Mosi, Lasgush Poradeci, një ndër lirikët më të mëdhenj të letërsisë sonë që i ka kënduar ndjenjës së dashurisë.

Bukuria (fragment)

* * *

Do të këndonj Bukurinë
E të lëvdonj Perëndinë,
Perëndin' e bukurisë,
Q'i dha shijë gjithësisë!
Perëndija bukuroshe!

* * *

Në fytyrët tënde gjeta Bukurinë,
Si ajy që gjeti në malt Perëndinë
Lulezët e Majit sa janë të mira!
Po përpara teje m' erdhë të pështira.

* * *

Edhe yjt' e hëna si të shëmëtuat
M'u duknë, kur pashë atë syn' e shkruar,
Purtek' e florinjtë! shigjet' e ergjëntëe!
Zemrënë m'a dogje, m'i përndave mëntë!

Ty të falem e të lutem
Më vjen në gji të të futem
O Zonja përkëdheloshe!
Që më je si mbretëreshë,
Të keqen o pëllumbeshë.

Kur shoh fagezët' e tua,
Ç' vleft' i mbetet trëndafilin,
Zëri yt shpirt më jep mua,
Nuk' i le shijë bilbilit.

Do të vdisnja me shumë gas,
Të paskështa pakë shpresë,
Se do të thuash ti më pas,
Vdiq, për mua, pastë ndjesë.

(Poezia: "Bukuria", Naim Frashëri).

• **Ditirambi** është poezi lirike e gëzueshme, në të cilën poeti shprehet plot shend, ndjesi e ritëm të gjallë për gëzimet e jetës.

Ditirambi është lloj i lashtë i poezisë lirike dhe emërtohet nga fjala greke: **dithyrambos**. Në filltet e veta i shtohet si mbiemër emrit të Dionisit, kurse më vonë e mori kuptimin e këngës që këndohej për nder të tij. Nga ky lloj i poezisë lirike u zhvillua edhe **lirika anakreontike**, e emërtuar për nder të poetit grek Anakreontit (të njohura ndryshe edhe si këngë verërash).

Në letërsinë shqipe, ditirambin e ka trajtuar Naim Frashëri në poezinë "Ujë e bekuar".

Kopshti i dashurisë

O pëllump'i shkruar,
do t'të marr në duar
dhe duke kënduar
gjetkë do t'të shpie:

afër tek një lumë
ku ka lule shumë,
të biem në gjumë,
hëna të na ndrijë;

yjtë të shukojnë,
zoqtë të këndojnë
edhe të na zgjojnë
dita kur të vijë.

Pa ngrën' e pa pirë
s'metemi moj Mirë,
se u'ndaj të gdhirë
dërgoj e na sjellin:

në një vënt t'uruar
dhe të lulëzuar
në uj' të kulluar
edhe nënë hie;

qumështë të d'hirë
dhe djathë të mirë,
pa uj' e pa hirë
dhe rrush kur të vjelin;

Ngjalë nga Janina,
Mjaltë nga Kanina,
Verë nga Voshtina,
Ujë nga Sopot;

mollë nga Horia,
mish nga dhënt' e mia,
desh nga Labëria, -
na e faltë Zoti!

(Poezia: "Kopshti i dashurisë", Andon Z. Çajupi).

• **Elegjia** është poezi lirike e shkurtër me nota vajtuese, e cila njihet qysh nga kohët më të lashta. Kuptimi i saj vjen nga fjala greke **elegos**, që do të thotë: **gjëmë, vajtim**.

Tematika e kësaj lirike përshkohet me ndjenjë të hollë pikëlluese, përmes së cilës shprehej melankoli, pikëllim, dëshpërim ose vajtim për humbjen e njeriut të dashur. Në antikitet ishte i njohur **distiku elegjiak** (dyvargëshi elegjiak).

Lirika elegjiake shqipe është shumë e trajtuar, ndër më të njohurat janë: "Vaje" e Çajupit; "Vaj", "Një lul' e fishkurë, a një vashëz' e vdekurë", "Koh' e shkuarë" të Naim Frashërit; "Syrgjyn - vdekur", "Shpell" e Dragobisë dhe "Thomsoni dhe kuçedra" të Fan Nolit; "Shegës së kopshtit" e Hilë Mosit etj.

Vaje

Që ditën që vdiqe, që kur s'të kam parë,
Lotët që kam derdhur s'më janë dhe tharë!
Shumë vjet u bënë, sot u mbushën dhjetë,
që kur më ke lënë dhe s'të shoh në jetë!
Në ç'kopshte me lule ke qëndruar vallë?
S'të vjen keq për mua? S'të vjen mall për djalë?
O ëngjëll i bukur, mos mëno në botë,
kthehu të të shomë, të na mbeten lotë.
S'rrojmë dot pa tynë, ti si rron pa neve?
Motëmoi që rrojtëm bashkë s'më hureve.
Atje tek rri janë qipariz' e varre...
kthehu të të shomë, mos na le për fare!
Mos na le të gjojë, me zemër të ngrirë,
kthehu të gëzohesh kur të shoq të birë:
e ke lënë foshnjë, tani u bë burrë,
s'arrite ta rritje, s'të ka parë kurrë!
Për ty shumë herë çoj do të më thotë,
po s'mund t'i përgjigjem, se më mbytin lotë!
Kthej kokën mënjanë dhe vështroj përpjetë,
duke psherëtitur te zo' i vërtetë.

O zot i vërtetë, s't'erdhi keq për djalë,
kur i more mëmën dhe më le të gjallë?
Të më keshe marrë do të qe më mirë
dhe të rronte mëma të rriste të birë.
Me se rrojnë foshnjat? Ç'i rrit çilimitë?
Dashuri e mëmës dhe përkëdhelitet.
O zot, të jam falë, mos më le të mjerë,
dërgom' Evgjeninë ta shoh dhe një herë!
"Pse s'kuvendon mirë more punëbardhë
cili vdiq një herë dhe prapë ka ardhë?
Gjith' humbasën gruan, mëmën a babanë,
po ata që mbeten si ti nukë qanë:
të vdekurin lotët s'e bien në jetë,
po lutu dhe falu të rriç djalën vetë".
Doje drit', o qiell, more dritën time
dhe më mbushe jetën plot me hidhërime!
Tani rroj pa shpresë, ndaj s'dua të rroj,
se dhe perëndinë tani s'e besoj!

(Poezia elegjiake: "Vaje", Andon Z. Çajupi).

***Poezia patriotike (atdhetare)** është poezi lirike, në të cilën poeti shpreh dashurinë e zjarrtë ndaj kombit, atdheut ose vendlindjes. Ka vlerë artistike, si dhe rëndësi të madhe shoqërore e politike.

Poezia patriotike është ndër më të lëvruarat nga poetët e të gjitha kohëve. Përmes saj i këndohet me dashuri atdheut dhe bukurive natyrore të tij, kombit, gjuhës dhe çdo tematike që lidhet me atdhedashurinë. Në shek. XIX dhe XX, kjo lloj poezie është trajtuar shumë, pasi ishte kohë kur ndodhte edhe formimi i kombeve.

Në letërsinë shqipe dallohen: Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Asdreni, Çajupi, Filip Shiroka, Mihail Grameno, Ali Asllani, Lasgush Poradeci, Fan Noli etj.

Mëmëdheu

Mëmëdhe quietë toka
ku më ka rënurë koka,
ku kam dashur mëm' e atë,
ku më nje dhe gur'i thatë,
ku kam pasurë shtëpinë,
ku kam njojtur Perëndinë,
stërgjyshët ku kanë qënë
dhe varret q'i kanë vënë,

ku jam rritur me thërime,
ku kam folur gjuhën time,
ku kam fis e ku kam farë,
ku kam qeshur, ku kam qarë,
ku rroj me gas e me shpresë,
ku kam dëshirë të vdesë.

(Poezia: "Mëmëdheu", Andon Z. Çajupi).

Atdheu

Atdheu është dhimbje, është dhimbje.
Një prill i pikëlluar në shpirt.
E mban dhe të mban në shpirt.
Atdheu është kryqi, është kryqi.

Atdheu është toka e premtuar.
Të shkel si një zot dhe s'e ke ndën këmbë.
Atdheu s'ka fjalë, ka sy të trishtuar.
Vdes dashuria në dashuri që të çmend.

Atdheu është buka e uritur.
Të ikën nga duart dhe dot nuk e ngop.
Ëndërr dhe ankth dhe shpresë e sfilitur.
Me sytë n'erësirë vetveten kërkon.

Atdheu është varr i hapur, është varr.
Një jetë drejt tij shkon me besë që bind.
Në një pikë loti mbyt lotin fatvlarë,
Në një pikë loti lirinë e lind.

Atdheu yt i vogli, i vogli,
Ai hyjnori i pavdekshmi - loti.

(Poezia: "Atdheu", Fatos Arapi).

***Poezia sociale (shoqërore)** është poezi lirike, ku poeti shpreh qëndrimin dhe botëkuptimin e vet ndaj shoqërisë, dukurive të ndryshme të jetës shoqërore dhe marrëdhënieve të njerëzve. Kjo poezi frymëzohet nga realiteti shoqëror, ndasitë klasore, gjendja sociale e popullit e shkaktuar nga sundimet e huaja, revolta dhe notat protestuese kundër padrejtësive dhe shkaktarëve të gjendjes së vështirë të shoqërisë.

Poezinë shoqërore e kanë krijuar shumë poetë të botës, në çdo etapë kohore.

Lirika shoqërore kanë shkruar shkrimtarët shqiptarë: Naim Frashëri: “Të varfërit”; Ndre Mjeda: “I mbetuni”, “Shtegtari”, “Andrra e jetës”; Çajupi: “Fshati im”, “Kurbeti”, “Misiri”, “Korriku”; Migjeni: “Lagja e varfun”, “Baladë qytetse”, “Recital’ i malsorit”, “Kanga e dhimbës krenare”, “Fragment” etj.

Lagja e varfun

Krahët e zez të një nate pa fund
e vorrosën lagjen pranë,
dritë, jetë, gjallsi - askund,
Vetëm errsinë e skam.

Njerzit ndër shtëpija flejnë
me gjoksa të lekurtë e të thatë
e grave fëmi po u lejnë
pa ushqim në gji, pa fat.

Veç zemrat e njerzve të lanun
me të rrektunt prralla rfejnë:
mbi barrat e jetës së namun
që shpirt dhe korriz thejnë.

Prralla mbi fëmi rrugaça
bark-jashtë e me hundë të ndyta
që dorë shtrijnë me vjedhë,
me lypë e ngihen me fjalë të ndyta.

Kështu lagj’e varfum pëshpritë
dhe errsinës hallet tregon.
Një gjel i unshëm, me dritë
të hanës i rrejtun, këndon.

Hesht! or gjel kryengritës
i lagjes së varfun. - Këtu
nuk zbardh për ty drita e ditës...
i gjikuem je me ngordhë n’u.

(Poezia: “Lagja e varfun”, Migjeni).

• **Himni** është poezi lirike ku poeti lëvdon e madhështon diçka që i zgjon admirim. Njihet qysh nga kohët e lashta dhe u kushtohej heronjve legjendarë, figura e të cilëve meritonte respekt e lavde.

Interpretimi i himnit bëhet me një zë madhështor, por ka një ritëm solemn të ngadalshëm.

Në fillim, himni ishte **ujershë e kultit**, kur në Greqinë antike **hyjnizoheshin** ose **laudëroheshin hyjnitë** ose **heronjtë legjendarë** (Zeusi, Dionisi, Apolloni, Demetra, Hermes, Prometeu), e cila këndohej me përcjellje muzikore. Himnin, që lidhej me ceremonitë fetare dhe i lavdëronte hyjnitë e ndryshëm e kanë njohur dhe

interpretuar, përgjithësisht popujt e lashtë: indasit, kinezët, egjiptasit etj., (në Egjiptin e Lashtë këndohej për lavdinë e diellit). Në kohët e mëvonshme, himni, plot frymëzime poetike e atdhetare, u bë simbol shtetëror që këndohet nga kori dhe shoqërohet me muzikë instrumentale. Himne të këtilla kanë të gjitha kombet e botës.

Në letërsinë shqiptare janë të njohura: “Himni i flamurit” i Fan Nolit, “Himni i flamurit” i Asdrenit etj.

Himni i flamurit

O Flamur gjak, o flamur shkabë,
O vënd e vatr' o nën' e babë,
Lagur me lot, djegur me flagë,
Flamur i kuq, flamur i zi.

Fortesë shkëmbi tmerr tirani,
S'të trëmb Romani, as Venecjani,
as Sërb Dushani, as Turk Sulltani,
Flamur i math për Vegjëli.

Flamur që linde Shën Kostandinin,
Pajton Islamn' e Krishtërimin,
Çpall midis feve vllazërimin,
Flamur bujar për Njerëzi.

Me Skënderben' u lavdërove
Dhe në furtun' i funtmi u shove,
Me Malon prapë lart vrapove,
Yll i pavdekur për Liri.

Sa shpesh pastaj përdhë u shtrive
Me zjarr e zi u ndeze u nxive,
Po çdo mizor me shpat' e grive,
O fushë-kuq, o shkabë-zi.

Përpjetë prie Shqipërinë,
Përlintja shpirtin dhe fuqinë,
Diell për vllanë, yrnec për fqinë
Për botën ëndr' e qjell i ri.

(Poezia: “Himni i flamurit”, Fan Noli).

• **Oda** është poezi lirike, plot delir dhe lirizëm të thellë, përmes së cilës poeti thur lavde për ndonjë individ, ngjarje apo dukuri madhështore të natyrës dhe shoqërisë njerëzore.

Fjala **ode (aoide)** - (këndim, këngë) e ka origjinën në vjershat korale të Greqisë së Vjetër. Haset qysh në shkrimet e poetëve të shek. V para epokës sonë.

Tematika e odes ka shtrirje më të gjerë se ajo e himnit. Shkruhet për nder të dikujt që është mjaft i afërt dhe i dashur me poetin, pra dikujt që meriton adhurim e lavdërime, për shkak të një veprë të madhe ose të një fitoreje të rëndësishme. Dallojmë tri lloje të odes: **heroike, filozofike dhe shpotitëse**.

Në poezinë shqipe janë të njohura odet: “Nji lule vjeshtet” e Gjergj Fishtës dhe “Fuqia e Uratës” e Vinçens Prenushit.

Koroneut

Luftëtar nis, se Kreta të pret
Ku liria gjëmon e trondit dhenë;
Flamujt, duke shkëlqyer n'ajër venë,
Ishulli skuqet dhe me topat flet.

O sa lufta, o sa gjak! Sa vjete shkuan
Që ndënj vejushë e mjerëza Greqi:
Ata, që i muarrën dije e bukuri,
të mjerën Nënë gjer më sot harruan.

Po fati u ndërrua, se pushka sot
Me llahtar gjithë Evropën po mbulon
Dhe turku po kthen krahët duke qarë.

U kthye edhe një herë koha e parë:
Deti zbardhon dhe pa një re gëzon
Dielli që i qesh grekut q'është' në lot.

(Poezia: "Koroneut", Zef Serembe).

• **Poezia satirike** paraqet krijim lirik, në të cilën poeti kritikon dhe vë në tallje të metat e një njeriu ose të një shoqërie. Satirën e shoqëron kurdoherë humori, me ç'rast poeti i sulmon në mënyrë të rreptë veset dhe të metat e ndryshme të njerëzve. Stili i saj është i mprehtë, shpirtëror dhe therës.

Satira rrjedh nga fjala latine: **satira** (enë e mbushur me gjithfarë pemësh), gjurmët e saj gjenden nga letërsia klasike romake. Satiristë të njohur janë: Simonidi, Arkiloku, Horaci, Juvenali etj.

Lirika satirike është dy llojesh: **personale dhe shoqërore**.

Satirë personale është kur poeti i tall dhe i thumbohen vetëm veset e individëve të ndryshëm, ndërsa satirë shoqërore, kur i kritikon dhe i përqesh të metat e mbarë shoqërisë. Mjetet shprehëse të satirës janë: **hiperbola, alegoria, ironia dhe sarkazmi**.

Në letërsinë shqipe, poezi satirike kanë shkruar: Hasan Zyko Kamberi: "Paraja", Trahani"; Ali Asllani: "Hanko Halla"; Çajupi: "Sulltani", "Punërat e Perëndisë"; Filip Shiroka: "Si po prishet gjuha shqipe", "Nji andërr"; Fan Noli: "Marshi i Barabbajt", "Kënga e Salep-Sulltanit", "Shën Pjetri mi mangall" etj.

Marshi i Barabbajt

Allalla, o rezil e katil, allalla,
Shtroni udhën me hithr' e me shtok trufanda,
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, batërma,
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

Në budrum, nëpër llom' e kufom' u mallkofsh,
Në skëterrën, katran e tiran, u harbofsh,
Me tam-tam e allarm e me nëm' u shurdhofsh,
Në zëndan mbretërofsh: Hosanna, Barabba!

Tradhëtor, ti na nxive, na le pa atdhe,
Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe,
Varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe,
Derbeder, ujk e derr: Hosanna, Barabba!

O stërnip i Kainit, tepdil si bari,
Ti na shtyp e na shtrydh e ti gjakun na pi,
Ti na ther e na grin e për qejf na bën fli;
O kukuth e lubi: Hosanna, Barabba!

O i çgryer, i zhyer, i vyer për hu,
Turpe-ndot-kundërmonjës të krusen mi gju
Dallkaukët, kopukët e turmat pa tru,
Zëmër-krund-e-gërdhu: Hosanna, Barabba!

Allalla, o rezil e katil, allalla,
Shtroni udhën me hithr' e me shtok trufanda,
Gumëzhit, o zinxhir e kamçik, batërma,
Lehni, laro, kaba: Hosanna, Barabba!

(Poezia: "Marshi i Barabbajt", Fan Noli).

***Lirika reflektive (meditative - mendimtare)** është poezi lirike që shpreh mendim të caktuar ose raport emocional ndaj ndonjë të vërtete që ka të bëjë me njeriun dhe jetën. Në këtë krijim, poetin e ndihmon shumë imagjinata dhe përsiatja, andaj shumë poetë të së kaluarës, duke dashur ta zbërthejnë kuptimin e jetës, kanë gjetur ngushëllim në teologji ose filozofi.

Poezia reflektive vendoset në radhën e llojeve më të larta të poezisë lirike, me të drejtë edhe quhet **lirikë e kulluar**.

Në letërsinë shqipe, poezi reflektive kanë shkruar: Pjetër Budi, Zef Serembe, Pjetër Zarishi, Leonard de Martino, Naim Frashëri, Migjeni etj.

Parathanja e parathanjeve

Përditë përndojnë zotat
dhe rrëshqasin trajtat e tyne
mbi vjet e shekuj
dhe tash s'po dihet ma kush asht zot e kush njeri.
Ndër tru të njerzimit zoti galuc ka ndejun.
Vetvetes me gisht tamthat i ka biruemun
në shej të pendimit
dhe bërtet në kulm të hidhnimit:
çka, çka krijova?
-E njeriu nuk e di:
a asht zoti pjell a e tij
apo ai - vetë pjella e zotit?
Por e shef se asht kot i kotit
me mendue mbi një idhull
që nuk përgjegj.
Dhe tash s'po dihet ma kush asht zot e kush njeri.
Ka ardhë një kohë
në të cilën njerëzit po kuptohen fare mirë
për me ndërtue Kullën e Babiloni, -
dhe në majë Kullës, në majë të majës së fronit
ka me hypë njeriu
dhe ka me thirrë:
Perendi! Ku je?

(Poezia: "Parathanja e parathanjeve", Migjeni).

Vrapojnë zemërat

Me sulm të ri, me shpirtin plot
Ti bën një vrap për t'udhëtuar.
Bën edhe një si vjet dhe sot,
Dhe një dhe mot e papushuar.

Dhe nuku pyet për ngaj po shkon,
Që ngaj po vjen ngaj të fryn era.
Veç udhëton veç përparon,
Si vjet e sot e mot përhera.

Dhe ik... e ik... e ik...e ik...
E ja! këputet zemr' e shkretë
E ja! përshembet vrap' i lik
Et bje përmbys përgjithëjetë.

E pa t'u tharë pika lot,
Vrapojnë zemrat e tjera,
Me sulm të ri, me shpirtin plot,
Si vjet e sot e mot përhera.

(Poezia: "Vrapojnë zemërat", Lasgush Poradeci).

• **Epigrami**, poezi lirike, e cila shpreh përbuzje ose thumbon dikë. Është formë e shkurtër e llojit lirik, delikate dhe shpuese (therëse).

Epigramma - mbishkrim, fjalë e lëvruar në Greqinë e Vjetër, qysh në shek. VI para erës sonë. Meqë ka kuptimin e mbishkrimit, përdorej si titull vepre artistike ose gdhendej mbi përmendore ose pllakat e varreve. E kishte formën e distikut, që më vonë kaloi në vjershë të shkurtër satirike.

Poetë të shquar në krijimin e epigramit janë: Safoja, Arkilogu, Marciali, La Fonteni, Lesingu, Gëteja etj., pasi ky lloj lirik kërkon aftësi dhe mendjemprehtësi të madhe poetike që brenda pak vargjesh të shprehet gjendja shpirtërore dhe t'i jepet një përfundim, me të cilin duhet befasuar lexuesi.

Në letërsinë shqipe, me epigrame dallohet Filip Shiroka: "Te vorri i Kajmekamit", "Atdhe dashuni", "Sipri vorrit të një grekomani".

Te vorri i kajmekamit

Qante i mjeri Alushi i Hasanit
Përsipri gurit t'vorrit t'Kajmekamit;
-Pse qan? - e pyeti katundari 'i ditë,
-Qaj - thotë - se unë n'bukë t'tij jam rritë!
-Or, t'marrtë djalli! - katundari i thotë,
Pse po hup kohën tue qa ktu me lotë!
Silli tash sa t'holla sipri gurit t'tij,
Edhe Kajmekami çohet përsërij!!...

Sipri vorrit të një grekomani

N'ket vorr po kalben eshtnat t'nji qyqari,
Qi turpnisht jetën e vet e ka shkue;
Shqyptar, për fat t'zije edhe bir Shqyptari,
Punoi për
Grekët Shqypninë me tradhtue:
Tradhtuer emnohen, sa ish gjallë ky i shkretë,
E tradhtues emnin m'e pasë për jetë.

(Poezitë: "Te vorri i Kajmekamit") dhe ("Sipri vorrit të një grekomani"), Filip Shiroka.

• **Epitafi** është poezi lirike tejet e shkurtër, në formën e mbishkrimit të gdhendur mbi rrasën apo gurin e varrit që me pak fjalë a me dy a tri vargje, ta paraqesë sintezën e jetës.

Epitaphion (greq.) - mbishkrim, shënim varri, megjithëse epitafet e para i hasim në Egjiptin e Lashtë, duke u përhapur më vonë edhe te popujt tjerë. Për shënimin e epitafit zgjidhet mendimi i ndonjë filozofi ose poeti.

Këtu eshtnat u la breznive për kujtim
dhe truëllin e vet me gjak e ujiti.
Këtu mbuell lulen e kuqe për lulzim
e rrugën e errtë, si kandil na ndriti

Kur më shihni se jam tretur,
Mos pandehni se kam vdekur,
Jam i gjallë e jam ndë jetë,
Jam në dritë të vërtetë.

(Poezia: "Këtu pushon" e Enver Gjergjekut).

(Poezia: "Fjalët e qiririt", Naim Frashëri).

• **Epigrafi** është poezi lirike sa një shënim i shkurtër në vargje që vendoset në fillim të ndonjë vepre letrare ose në krye të çdo kapitulli të saj.

Epigraphe (greq.) - mbishkrim, nënkupton një trajtë të bukur aforistike. Përdoret si citat i shkurtër ose si ndonjë varg, të cilin shkrimtari e merr prej ndonjë vepre ose autori tjetër dhe e vendos në veprën e vet.

Gjith here n'mend u kam, malet e dashtnue,
E zemra e ime n'dhena t'hueja keq lëngon;
Tridhetë vjet të gjata, o male, kam kalue,
Tridhetë vjet qi zemra e ime po u dishron!...

(Poezia: "Malli", Filip Shiroka).

• **Gnoma** është poezi lirike tejet e shkurtër, përmes së cilës poeti shpreh mendim të thellë, njëjtë si me fjalën e urtë që shpeshherë e hasim brenda ndonjë teksti me cilësi të larta artistike.

Gnoma (greq.) - fjalë e urtë (këshillë) si një fjalë e mençur.

Fjala e ambël thrret miq,
Ajo zbut, pajton anmiq.

Urti popullor

Punë, punë, nat' e ditë,
Që të shohim pakës dritë!

Naim Frashëri

• **Epistula** është poezi lirike, në të cilën poeti shfaq botëkuptimet mbi jetën, shoqërinë, artin ose ndonjë çështje tjetër të rëndësishme të veprimtarisë shoqërore.

Epistula (lat.) - letër dhe për herë të parë është përdorur te poetët romakë. Horaci e përdori ndër të parët.

Në letërsinë shqipe, epistula haset te shkrimtarët romantikë: Filip Shiroka, Luigj Gurakuqi, Hilë Mosi, Ndre Mjeda etj.

ANALIZË



INTERPRETIM:

- Përshkruani rëndësinë e përdorimit të figurave stilistike?
- Analizoni gjuhën poetike dhe stilin e poezisë “Marshi i Baabbajt” të Fan Nolit”!
- Bashkëbisedoni për rëndësinë e poezisë “Lagja e varfun” të Migjenit!
- Cila është porosia e poezive: “Te varri i kajmekamit” dhe “Sipri vorrit të një grekomani”?
- Tregoni dallimin midis epigramit dhe epitafit!
- Përshkruani tematikën e poezisë suaj të parapëlqyer!
- Pse themi se figurat stilistike i japin jetë krijimit?



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Cila është zanafilla e lirikës, përshkruani veçoritë e saj!
- Çfarë është gjuha poetike, vargu dhe strofa?
- Cilat janë llojet e rimave poetike, trego skemën e tyre?
- Cilat janë llojet e poezisë lirike?
- Si është krijuar himni, ditirambi dhe elegjia?
- Cili shkrimtar shqiptar e shkroi himnin e flamurit tonë kombëtar?
- Çfarë është proza poetike, përshkruani karakteristikat e saj?
- Si krijohet lirika peizazhiste (jepni shembuj poetikë)?
- Si krijohet lirika shoqërore (jepni shembuj poetikë)?
- Ku qëndron dallimi midis lirikës së dashurisë dhe lirikës refleksive?
- Nënvizoni lidhshmërinë e lirikës me përjetimet e njeriut dhe traditën popullore!
- Çka është epigrami, epitafi, epigrafi dhe epistula, shpjegoni kuptimin reflektiv (ndjesor) të tyre?



SPROVË LETRARE:

***Bëni një provë individuale, duke krijuar shembuj të ngjashëm të poezive lirike!**

TROPET DHE FIGURAT STILISTIKE

Njeriu, gjatë jetës së tij, ndjenjën e thellë, përfytyrimin dhe nxitjen e imagjinatës i shpreh me anë të fjalës, mirëpo fjala, përpos kuptimit të saj themelor merr edhe një varg domethëniesh apo kuptimesh tjera plotësuese. Këto fjalë-mjete të të shprehurit janë dy llojesh: **trope** dhe **figura**.

Fjala figurë - figura (lat.) është e folur e figurshme me një formë tjetër të zëvendësimit apo zbukurimit të fjalës.

- **Figurshmëria** është tipar i krijimtarisë artistike, veçmas i poezisë. Figurat në poezi janë fjalë artistike që e ngjallin ndjenjën estetike.

Shkrimtarët mendojnë se me anë të figurave e fuqizojnë më tepër fjalën, si formë e përzgjedhur e të shprehurit të tyre, përderisa figurat dhe gjuha figurative e përcaktojnë stilin e shkrimtarit.

- **Kuptim figurativ** kemi sa herë që një ose më tepër fjalë marrin kuptime të reja.



Stil poetik quhet ajo **mënyrë e të shkruarit**, e cila ka një **harmoni të përsosur** ndërmjet **formës** dhe **përmbajtjes**.

Sa më e përzgjedhur të jetë gjuha figurative, aq më i bukur dhe i veçantë do të jetë stili i shkrimtarit (poetit).

◇ TROPET

Tropet, përpos vlerës artistike, kanë rëndësi të madhe gjuhësore. Sajohen përmes krahasimit të dy dukurive, nga të cilat, e para shërben për ta sqaruar më mirë të dytën.

Shembull: *kjo bukë qenka e bardhë si bora.*

Ngjyra e bardhë e bukës na e kujton borën, prandaj edhe e vëmë në pah këtë cilësi.

Trop quhet **kthimi i fjalës** nga **kuptimi** i saj i **natyrshëm** në një **kuptim të ri**.

Tropet më të përdorura janë: krahasimi, epiteti, perifraza, metafora, aluzioni, personifikimi, alegoria, metonimia, eufemizmi, ironia, sinekdoka, hiperbola, litota, katakreza, simboli dhe antonomazia.

- **Krahasimi** (lat. **comparatio** - **krahasim**) është figurë shumë e përdorur në krijimtarinë artistike dhe në komunikimin e përditshëm, përderisa krahasojmë një mendim, një send apo një dukuri me një tjetër, duke i vënë në pah tiparet e tyre të përbashkëta.

Bukuria jote, leshërat e tua
posi pëndë korbi, të gjata mi thua,
ballëtë si diell, faqetë si mollë,
qafa jot' e gjatë, mesi yt i hollë,
sisët si shegë, dhëmbët si thëlpënjë,
buzët si burbuqe, sytë si gështenjë...

("Dashuria", A. Çajupi).

- **Antiteza** (greq. **antithesis** - **kundërshti**) është figurë e përbërë nga dy njësi kuptimore, lidhja e të cilave kryhet me kundërvënie. Kundërvënia mund të bëhet ndërmjet fjalëve, fjalive ose kuptimit të tyre. Ajo ndërtohet shpesh nga antonimet:

Ku e lam e ku na mbeti
Vaj-vatani e mjer-mileti
Anës detit i palarë,
Anës dritës i paparë,
Pranë sofrës i pangrënë,
Pranë dijes i panxënë,
Lakuriq dhe i brengosur,
Trup e shpirt i sakatosur?

("Anës lumenjve", F. Noli).

Personazhet e një vepre shpesh ndërtohen në antitezë me njëri-tjetrin, si: Skënderbeu me sultanin në poemën "Historia e Skënderbeut" të Naim Frashërit, Otelloja me Jagon në tragjedinë "Otello" të Shekspirit etj.

• **Epiteti** (greq. *epitheton* - **e shtuar/ndajshtim**) është figurë stilistike që përdoret për të përshkruar më mirë një personazh apo ngjarje. Shton ngjyrë dhe emocion në rrëfim, duke i dhënë lexuesit përshtypje më të gjallë për atë që përshkruhet. Në letërsi, epitetet përdoren shpesh për të lavdëruar figura të rëndësishme historike apo letrare.

Përshembull: në poezinë e Naim Frashërit për Skënderbeun, bashkëluftëtarët e tij përshkruhen me epitetet (si në vargjet e dhëna më poshtë).

Po ashtu, në veprën e lashtë “Iliada”, heroi Akil quhet “këmbëshpejti”, për të treguar forcën dhe shkathtësinë e tij (shih vargjet).

Ishte Uran bukuroshi
Dhe Tanushi kordhë-lartë
Hamzaj, uzakë djaloshi.

(*“Histori e Skënderbeut”, Naim Frashëri*).

Zymtë e shikoi Akil këmbëshpejti e i foli:
“Hektor i urryer, mos më fol për kushte,
pse besë nuk lidh luani me njeriun,
ujku e qengji nuk bëjnë paqe mes tyre,
po i sajonnë kobe gjithnjë njëri-tjetrit.
Kështu ne të dy kurrë miq nuk do të bëhemi,
as njëri-tjetrit besë nuk do t'i japim,
pa rënë vdekur njëri prej të dyve
me gjak të vet të ngopë mizorin Ares.”

(*Fragment nga “Iliada” e Homerit*).

Epitetet, personazhit i japin tipare që dallohen lehtë, sidomos në letërsinë epike dhe lirike. Ndonjëherë ato janë të stërzmadhuara për të treguar madhështinë e heroit. Në letërsinë shqipe, përveç Naim Frashërit dhe eposit kreshnik, epitetet shfaqen edhe në krijimet e Fishtës dhe Poradecit. Në këngët e kreshnikëve, heronjtë përshkruhen me epitete që e theksojnë trimërinë dhe bukurinë.

• **Metafora** (greq. *metaphorá* - **bartje**, ndërrim kuptimi) është figura më e njohur që nga lashtësia antike greke dhe sajohet kur një send apo një dukuri e emërojmë me emrin e një sendi a dukurie tjetër. Që nga lashtësia njihet si mbretëreshë e figurave. Ajo ka përdorim të gjerë, jo vetëm në gjuhën e artit letrar, por edhe në të folurit e përditshëm dhe në folklor.

Metafora të tilla hasim në dy vargjet e strofës së parë të poemës “Andrra e Jetës” të Ndre Mjedës:

*Molla t'kputuna një deget
dy qershija lidhë n'ji rrfanë, ...*

Si **metaforë** mund të përdoren emri, mbiemri, folja dhe një shprehje e tërë. Në bazë të kësaj, dallojmë **metaforë emër** (buzë mali, grykë pushkësh, qafë

shisheje, kreu i shtetit); **metaforë mbiemër** (qielli i trishtuar, natyra e mrrolur, dashuri e pastër); **metaforë folje** (rruga gjarpëron, qielli vajton, deti tërbohet, lumi ecën, natyra u vesh) dhe **metaforë shprehje** (gardhi ka sy e muri vesh; dardha ka bisht; këmbët e lehta, faqja e bardhë; prej trëndafilit del gjembi; kali i mirë e shton tagjinë; kush s'punon, dheut i randon) etj.

- **Personifikimi** (greq. **persona** + **facere** = **person**, **njeri** + **të bësh**, të veprësh si njeri) është figurë e përfytyrimit. Sajohet kur gjërave të pashpirt u japim gjallëri e i shpirtëzojmë, pra sendeve a dukurive në natyrë, botës bimore e shtazore u mvishen veti njerëzore

Kjo figurë është shumë e vjetër dhe është trashëguar që nga fazat e hershme të ekzistimit të njeriut, atëherë kur njeriu vinte re tipare ngjashmërie midis vetes dhe dukurive të natyrës. Ai bashkëbisedonte me natyrën, kurse sendeve, kafshëve e bimëve u jepte tipare të njeriut, i ndërgjegjësonte dhe i bënte të kryenin veprime njerëzore. Kështu, në mitologjinë e lashtë me anën e personifikimit dashuria, urtësia, lufta, deti etj., kishin marrë emra njerëzish (Erosi - dashuria, Minerva - urtësia, Marsi - lufta, Posejdoni - deti).

Sa për ilustrim japim një strofë të poezisë “*Toka ime, kënga ime*” nga Dritëro Agolli, ku janë personifikuar flamuri dhe toka:

- Ç'ke, o flamur, që s'valon?
- Jam sëmurë e po rënkoj,
jam goditur brinjë më brinjë,
që kur sollën Italinë...
Tokë e dashur,
ti diçka ke kërkuar nga unë.
“Ndryshomë, o bir”- më ke thirrur nga grykat e maleve”

- **Apostrofa** (greq. **apo** - larg + **strophe** - kundërshti) është figurë stilistike që krijohet kur poeti apo ligjëruesi i drejtohet ndonjë sendi, dukurie ose ideje abstrakte dhe kuvendon me të sikur të ishte i gjallë e të mund të merrte përgjigje.

Poeti, dëshiron t'ua tërheqë vëmendjen të tjerëve në atë që e shquan, e veçon, pra e apostrofon.

O lejlek o shpend udhtar,
 Qi prej s'largut je tiu mbërri,
 Pash njat frymë qi merr e t'bar,
 Ndaluj'herë n'njiket shkreti,
 Nji fjalë t'vetme due me t'pvetë,
 O lejlek, o shpend i shkretë.

(*"I tretuni", Ndre Mjeda*).

Ndre Mjeda, përmes figurës së shpendit e apostrofon shtegtarin, për ta orientuar atë në atë drejtim të sugjerimit emocional dhe mendor të lexuesit. Këtë figurë e hasim dendur në poezitë e Mjedës, Migjenit, Lasgushit, por edhe shumë poetëve tjerë.

• **Simboli** (greq. **symbolon** - **shenjë**) sajohet kur një ide abstrakte ose një dukuri e konkretizojmë, duke e zëvendësuar me një gjësend, i cili merr një kuptim të caktuar.

Simboli, përpos në folklor, haset edhe në poezinë "Bilbili" të Naim Frashërit dhe në tërë letërsinë shqipe.

Shembuj:

Bleta - simbol i punës,

Ulliri - simbol i pages,

Shqiponja - simbol i fuqisë,

Kali i Trojës - simbol i tradhtisë.

Nji sokol qi ishte mësue,
 Bate zhego te nji prure.
 Shkoni filanxa me pushue.
 Fllanxën ma ka rrejtun gjumi.
 Thotë sokoli: un' i lumi!

(*këngë popullore*)

• **Alegoria** (greq. **allos** - (tjetër) kundërshti dhe **a-oreio** - flas) është një mendim i zgjeruar, me kuptim më të thellë, pra jo i drejtpërdrejtë dhe sipërfaqësor.

Fillimisht, rrëfimi apo ngjarja duket e thjeshtë, por në të vërtetë ajo flet për një temë më të thellë, duke e fshehur mendimin konkret. **Për shembull:** temat për politikën, fenë apo moralin janë çështje që nuk mund të diskutohen hapur në çdo kohë apo në çdo vend, andaj përdoret alegoria.

Tradhëtor, ti na nxive, na le pa atdhe,
 Ti na çthure, na çkule, na çduke çdo fe,
 Varfëri, poshtërsi, robëri ti na dhe,
 Derbeder, ujk e derr: Hosanna, Barabba!

O stërnip i Kainit, tepdil si bari,
 Ti na shtyp e na shtrydh e ti gjakun na pi,
 Ti na ther e na grin e për qejf na bën fli;
 O kukuth e lubi: Hosanna, Barabba!

("Marshi i Barabbajt", Fan Noli).

• **Metonimia** (greq. **meta** - mbas + **onoma** - emër, pra **metonymia** - ndërrim emrash, zëvendësim) sajohet kur emri i një gjësendi zëvendësohet me emrin e një sendi tjetër, shumë të afërt me kuptimin e të parit.

Për shembull:

Trimërija, trimërija!

Mban lirin' e mëmëdhenë,... (njerëzit trima, heronjt).

Atëherë, metonimia sajohet në bazë të varësisë logjike që kanë midis tyre dy sende, ide ose dukuri (e jo të ngjashmërisë si te metafora). Përdorimi i metonimisë është shumë i dendur në shprehje, si: *Nusja ishte veshë në mëndafsh; Punëtori e fiton bukën me djersën e ballit; E lexon Naimin etj.*

Metafora konsiderohet **figurë e poezisë**, ndërsa **metonimia figurë e prozës**.

• **Eufemizmi** - (greq. **euphemein** - me përdorë fjalë me kuptim të mirë, me kuptim **zbutës**) krijohet kur një fjalë të rëndë, të shëmtuar a të turpshme, e zëvendësojmë me një tjetër shumë më të njerëzishme e të hijshme.

Ky trop përdoret kur poeti, me maturi, kujdeset të mos e fyejë dikë. Nëpërmjet eufemizmit zbutet vetëm mënyra e të folurit, kurse kuptimi i idesë që duam ta shfaqim mbetet po ai.

-Ia priton pak punës (përtac);

-S'i pëlqen fort tymi i barotit (frikacak);

-Nuk e mban përherë fjalën e dhënë (i pabesë).

• **Ironia** (greq. *eironeia* - **shtirje**, me u shtirë) është figurë stilistike që krijohet kur një mendim ose ndjenjë e shprehur është në kundërshti të plotë me atë që mendojmë në të vërtetë, pra thuhet e kundërta e asaj që mendohet, me qëllim talljeje, kritike ose e lëvdon atë që është për t'u përbuzur.

Për shembull:

Seç u-çpor xhumhurieti,
Seç u-rahatos mileti,
Se Sulltanin prap e gjeti
Se, që-kur e humbi, s'fjeti!

(*"Kënga e Salep - Sulltanit"*, Fan Noli).

ose

"Të fala, moj shoqe, nga ferri i lumnisë..."

(*"Parathanje e parathanjes"*, Migjeni).

Fjala "**lumni**" (lavdi, lumturi) këtu përdoret me ironi për të treguar realitetin e dhimbshëm dhe mjerimin - një "ferr" që quhet "lumni".

• **Sinegdota** (greq. *synekdoke*: **syn** - **bashkë** dhe *ekdehomai* - kuptoj, marr vesh) sajohet kur një fjalë e zëvendësojmë me një tjetër, me qëllim që të shprehim me të një kuptim më të gjerë ose më të ngushtë nga ideja që duam ta shfaqim.

Ajo figurë mbështetet mbi *zëvendësimin* e gjërave e të dukurive mbi bazën e sasisë, pra përdoret pjesa në vend të tërësisë e tërësia në vend të pjesës; realizohet atëherë kur përdoret numri njëjës në vend të shumës, ose anasjelltas (*shqiptari karakterizohet me besën*); kur përdoret tërësia në vend të pjesës, ose anasjelltas (*ai mbeti pa kulm mbi kokë-pa shtëpi*), kur e përdorim një fjalë për të shprehur një ide të plotë.

Për shembull: **Bota** u çudit me punët e shqiptarit - në vend të: **njerëzimi** u çudit me punët e shqiptarit; **Migjenët** janë të njohur për emocionet - në vend të: **autorët si Migjeni** janë të njohur për emocionet; sa më pa i qeshi fytyra - në vend të: sa më pa u gëzua shumë etj.

Shqipërinë e mori turku
I vu zjarr,
Shqiptar, mos rri po duku,
Shqiptar!

(*Andon Zako Çajupi*).

• **Hiperbola** (greq. **hyper** - mbi dhe **bola** - ve) është figurë letrare që ndërtohet mbi bazën e zmadhimit tej mase të qenieve, të sendeve, të vetive, të dukurive etj., zakonisht nëpërmjet krahasimit, për të theksuar më shumë një mendim a një ide dhe për të bërë përshtypje më të madhe te lexuesi. *Hiperbolë letrare. E shpreh me një hiperbolë.*

Zmadhim tej mase që i bëhet diçkaje kur u flasim të tjerëve. Flet me hiperbola.

- Një mijë herë të kam thënë mos shko vetëm.
- I dëgjohet zëri në kupë të qiellit.
- Gjergjit i duhet një javë për të shkue nga shtëpia për në shkollë.

• **Litota** (greq. **litotes/litos** - i thjeshtë) që do të thotë "**thjeshtësi**" dhe rrjedh nga fjala (**litos**), që do të thotë: i thjeshtë, i vogël ose i varfër.

Litota, në mënyrën klasike njihet si antenanciozë ose moderator që është figurë stilistike dhe formë ironie, ku një pohim i zbutur përdoret për të theksuar një pikëpamje, duke shprehur një mohim, që në fakt, afirmon diçka, por shpesh duke shprehur mohim të dyfishtë për efekt. Si një formë e pohimit të zbutur, litota shfaqet gjithmonë e qëllimshme për të vënë theksin, megjithëse interpretimi i mohimit mund të varet nga konteksti, përfshirë atë kulturor.

◇ FIGURAT STILISTIKE

Figurat stilistike janë figura të mendimit dhe ndryshojnë prej tropeve për shkak se veprojnë mbi lexuesin ose dëgjuesin vetëm nëpërmjet të një lidhjeje të veçantë fjalësh, duke mos e ndryshuar aspak kuptimin e natyrshëm të fjalëve, kurse **tropet**, bashkë me formën e ndërrojnë edhe kuptimin e fjalëve.

Figura stilistike quhen ato mjete shprehëse, të cilat i japin gjuhës një trajtë pak a shumë të ndërruar dhe një theksim të veçantë, duke e bërë këtë më të gjallë, më të fuqishme dhe më të hijshme.

"Teoria e letërsisë", G. Luboteni.

Figurat stilistike ndahen në: **figura materiale** dhe **figura formale**:

- **Figurat materiale** (figura të mendimit) janë: elipsa, reticenca, asindet, polisindet, gradacioni, akumulacioni, inversioni, pretericioni,

interrogacioni, eksklamacioni, korrekcioni, obsekracioni, eksekracioni, hipotipoza, përsëritja epike, anafora, epifora, palilogjia, epizeuksa, refreni dhe simploka.

- **Figurat formale** (figura tingullore) eufonia, onomatopeja, aliteracioni, asonanca dhe rima.

Rima është përsëritja tingullore në fund të vargjeve. Në bazë të kësaj kemi: poezi **me rimë** dhe poezi **pa rimë**.

- **Elipsa** (greq. **elleipsis** - **me heq**, me lënë jashtë) është figurë stilistike, e cila përftohet duke hequr ose duke “e heshtur” një pjesë të fjalisë ose të ligjëratës, të cilën më vonë vetë lexuesi do ta marrë me mend dhe do ta plotësojë, duke e përqendruar vëmendjen në fenomenin e nënkuptuar.

Gjatë përdorimit të elipsës, duhet të kemi kujdes që pjesët e lëna jashtë, të mos e vështirësojnë kuptimin tjetër të fjalisë. Kjo figurë i jep elegancë dhe dendësi fjalisë dhe përdoret më tepër kur njeriu është i shqetësuar dhe i lë jashtë përdorimit fjalët e parëndësishme:

Krahët e zez'të një të pafund
E varrosën lagjen pranë
Dritë, jetë, gjallsi - askund
Vetëm errësir e skam.

(“Lagja e varfun”, Migjeni).

- **Paradoksi** (greq. **para** - kundër dhe **doxa** - **mendim**) është figurë që e shpreh mendimin e vërtetë të krijuesit dhe bie ndesh apo në kundërshtim me mendimin e përgjithshëm. Pra, është shprehje apo ide që bie në kundërshtim me logjikën e përditshme, por që shpesh përmban një të vërtetë të thellë.

Për shembull:

E di që nuk di asgjë! (Sokrati).

Të rrosh a të mos rrosh - kjo është çështja! (Shekspiri).

Në buzë qesh, në shpirt vajton... (Migjeni).

- **Asindet** (greq. **asyndeton** - **e pa lidhur**, jo e lidhur) është figurë sintaksore, e cila ndërtohet pa i përdorur lidhëzat midis fjalëve e fjalive, por ndahet vetëm me një presje. Me të, vargu ka rrjedhshmëri, elegancë dhe mjaft dinamikë:

Ku e lamë e ku na mbeti
 Vaj vatani e mjer mileti
 Anës detit (por) i palarë
 Anës dritës (por) i paparë
 Pranë sofrës (por) i pangrënë
 Pranë dijes (por) i panxënë,
 Lakuriq dhe i dreqosur
 Trup e shpirt i nakatosur.

("Anës lumenjve", F. Noli).

• **Polisindeti** (greq. **polysyndeton** - lidhje e dendur, me lënë jashtë) është figurë poetike sintaksore e kundërt me asindetin. Ndërtohet duke e shtuar numrin e lidhëzave, të cilat nga ana gramatikore nuk janë aspak të nevojshme, por me qëllim që të ngadalësohet intonacioni, pra për ta shtuar fuqinë e fjalës poetike dhe për t'i spikatur fjalët:

dhe më le mua...
 dhe më le arën...
 dhe më le selishten...
 atë natë kur...
 atë natë kur...
 ose
 Duart e tua që u rëgjuan nga puna
 Dhe gishtërinjtë që zunë kallon nga këmbët e dyfekëve
 Dhe supet që u varën nga xhokja e nga puna
 Dhe mesin që u hollua nga gjerdanët e fishekëve...

("Nënë Shqipëri", Dritëro Agolli).

• **Gradacioni** (lat. **gradatio** - **shkallëzim**) me lënë jashtë ose shkallëzimi) është figurë kur renditen fjalët, mendimet, shprehjet emocionale, duke e pasur parasysh shkallën e fuqisë së tyre. Qëllimi i saj është të shtojë intensitetin e mesazhit.

Shembull:

I dha erë trëndafililit,
 I dha dritë bukurisë,
 I dha këngët bilbilit,
 I dha shijë gjithësisë.

("Fyelli", Naim Frashëri).

Gradacioni i jep fuqi dhe bukuri të madhe stilit, prandaj e gjejmë mjaft shpesh në veprat e shkrimtarëve të ndryshëm, veçmas në letërsinë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

- **Anafora** (greq. *anaphora* - **bartje** përpara, përsëris) është figurë që krijohet kur fjala, e cila ndodhet në fillim të vargut, përsëritet edhe në fillim të vargut pasues (vijues). Pra, anafora është përsëritja (vendosja) e fjalëve ose e shprehjeve të njëjta në fillim të vargjeve. Ajo e përforcon shprehshmërinë kuptimore të fjalës që përsëritet disa herë ose të shprehjeve të reja që përdoren pas tyre.

Për shembull:

Kan' nis kangën e po këndojnë,
Kan' nisë lodrën e po lodrojnë,
Kan' nis gurrat e po i turbullojnë,...

(*këngë popullore*)

Qajnë! Po kush nuk qa?
Qajnë burra, qajnë gra,
Qajnë maletë për pyje,
Qajnë fushatë për lule!

(*"Sulltani", Çajupi*).

Te poezia *Punët e Perëndisë* e Çajupit folja **bëre** ... është nistore e 16 vargjeve. Anaforën me mjeshtëri e përdorin edhe autorë të tjerë. (*Vargjet e kësaj poezi i shihni më lart*).

- **Epifora** (greq. *epiphora* - **përmbyllje**, përfundim) është figurë, e cila krijohet kur përsëritja e fjalëve apo e shprehjeve të njëjta, në fund të dy a më tepër vargjeve, vijnë njëra pas tjetrës. Epifora është e kundërta e anaforës. Edhe kjo figurë i jep fuqi të madhe shprehëse dhe e shton forcën emocionale të vargjeve.

Shembull:

Se aty janë tri zana t'idhta,
T'u mriyue ndoshta qillojnë;
t'u u flladit; ndoshta qillojnë,
me kalue shndosh nuk u lshojnë!

(*këngë popullore*).

- **Onomatopeja** (greq. *onoma* - **emër** dhe *poieo* - **bëj**) është figurë që sajohet kur poeti i imiton tingujt e ndryshëm të natyrës nëpërmjet gjuhës, duke krijuar fjalë të atilla, të cilat burojnë prej tingujve të ndryshëm që i dëgjon në natyrë. Fjalët që u ngjasojnë tingujve, quhen **fjalë onomatopeike**.

Në gjuhën tonë, si onomatope janë: blegërima, cicërima, gurgullima, bubullima, hingëllima, vrungullima etj.

Po troket çekani
Po kërcet mejdani
Dor' e këmb' i çpon,
Kryshtin kryqëson.
Me tërbim goditin
Me gjëmim e ngjitin
Turma ulërin
Nëna blegërin.

("Kryqësimi", Fan Noli).

• **Aliteracioni** (greq. **elleipsis** - **me heq**, me lënë jashtë) është figurë që sajohet kur brenda një ose më shumë vargjeve përsëriten bashkëtingëlloret e njëjta ose togjeve të tingujve, me ç'rast rritet edhe fuqia shprehëse e një krijimi poetik:

Vendi dridhej, ay mbeti
Se s'tronditej nga tërmeti,
Dif-dragoi i Dragobisë,
Trim tribun i vegjëlisë.

("Shpell' e Dragobisë" nga Fan Noli).

• **Asonanca** (lat. **assonantia** - **përgjasim tingujsh**) është figurë që krijohet me përsëritjen e po atyre zanoreve, të cilat ndodhen ndërmjet bashkëtingëlloreve të ndryshme të dy fjalëve që gjenden në fund të vargjeve. Kjo figurë shpeshherë zë vendin e rimës, sidomos në letërsinë popullore dhe në vargjet e lira.

Mori e mira, flokët e gjata
Shkurtoi pak se t'duket qafa.

(këngë popullore).

• **Paranomaza** (greq. **para** - pranë dhe **onoma** - emër) është figurë stilistike e tingullit që krijohet duke vënë afër në një fjali ose në një varg dy fjalë me përbërje tingujsh të ngjashëm, por që në vetvete janë me kuptim të ndryshëm/të kundërt. Paranomaza bazohet në **përdorimin e fjalëve me tingëllim të ngjashëm**. Ajo ndryshon nga aliteracioni, sepse te aliteracioni tingujt ose rrokjet përsëriten në fjalët që vijnë njëra pas tjetrës, ndërsa te paranomaza tingujt e ngjashëm mund të jenë të tipit zanor ose bashkëtingëllor: *mishërim - mishërim, afrojt - ofroj, flas për trimëri, jo për trima të rremë* etj.

Paranomaza përdoret në poezi, oratori dhe në lojëra fjalësh për të tërhequr vëmendjen dhe për të shtuar estetikë në tekst.

EPIKA, VEÇORITË DHE LLOJET E SAJ

Gjinitë letrare, ashtu sikurse lirika edhe epika e drama, duke qenë letërsi artistike, karakterizohen me *llojet e veta letrare*.

Epika rrjedh nga fjala “*epos*” (greq.) që do të thotë “*fjalë*” apo “*tregim*”. Kjo gjini, (si lirika) prejardhjen e ka te këngët korale, përndryshe shquhet për objektivitetin dhe distancën kohore ndaj ngjarjeve që rrëfen. I kushtohet rrëfimit të ngjarjeve, ideve dhe përjetimeve të njeriut në kohë dhe hapësirë, shpesh duke paraqitur personazhe heroike dhe ngjarje të jashtëzakonshme.

Gjininë epike e përbëjnë veprat, në të cilat autori rrëfen ngjarje (vetë ose nëpërmjet personazheve) dhe mund të jenë të shkruara në **vargje**: epi, epopeja, poema heroike, cikle këngësh dhe në **prozë**: skica, tregimi, novela, romani, legjenda, përralla.

Epika është nga format më të hershme të shprehjes letrare, kur këngët interpretoheshin në formën gojore. Këto këngë ishin korale dhe të kënduara në grupe, sikurse kur një këngëtar i shoqëruar me instrument i rrëfente ngjarjet në mënyrë ritmike, ndërsa të tjerët i përsërisnin vargjet për ta ruajtur kujtesën.

Tema - vepra epike, element thelbësor e ka ngjarjen, rrëfimin, pra syzheun dhe formën narrative. Me zhvillimin e shoqërisë, këngët epike filluan ta pasqyrojnë më shumë ndjenjën e përkatësisë së fisit apo popullit. Nga format e para orale, epika u zhvillua në një formë më të strukturuar me rapsodë që ishin të specializuar në tregimin e historive. Përmes tyre, ruheshin kujtimet kolektive të ngjarjeve të rëndësishme, të cilat shtjelloheshin në përmbajtje dhe shërbenin si vlerë tematike.

Motivi është shprehja e emocionit dhe ndjenjave kolektive që gjithmonë ishin në funksion të tregimit dhe heronjve të tij.

Ideja - Veprat epike sjellin në vëmendje një botë të madhe ngjarjesh dhe konfliktesh, të ndara në mënyrë të qartë ndërmjet të mirës dhe të keqes. Karakterizimi i idesë së epikës bëhet nga prania dhe qëndrimi i heronjve të mëdhenj, të cilët shpesh bëhen bartës të vlerave morale dhe kombëtare.

Poeti epik (rrëfimtari) nuk rrëfen nga përjetimi vetjak, si poeti lirik, por përpiqet t’i paraqesë qëndrimet e personazheve dhe të shoqërisë në mënyrë më objektive. Ai, ndonëse veprën e formëson artistikisht, qëndron në prapaskenë dhe u jep zë personazheve në shfaqjen e qëndrimeve dhe veprimeve të tyre.

Botëkuptimi i shkrimtarit kuptohet nga mënyra se si e përshkruan në vepër ngjarjen ose njeriun, gjë që vë në pah **faktin artistik** dhe **faktin jetësor**. Në kohën e lulëzimit të poezisë epike, krijuesit kanë qenë njëkohësisht edhe përhapës (interpretues) të këtyre krijimeve. Te grekët, kanë qenë të njohur **aedët** dhe **rapsodët**, te francezët janë njohur **truverët** dhe **zhonglerët**, te shqiptarët ishin **rapsodët**, **lahutarët** etj.

Heroi a **protagonisti** është personazhi kryesor rreth të cilit zhvillohet krejt veprimi i epit.

Personazhi - individualiteti i krijuar nga shkrimtari në një vepër letrare, nëpërmjet tipareve vetjake, të të cilit mishërohen disa anë tipike të një karakteri shoqëror, të kuptuara dhe të vlerësuara sipas një botëkuptimi të caktuar ideologjik.

Fjalor i Shqipes së Sotme

Kompozicioni i një vepre epike, hartohet kur, përpos elementeve të personazhit dhe ngjarjes që zhvillohen në një kohë dhe në një vend të caktuar, formësohet ndërtimi i brendshëm sipas disa njësive: ***njësia e veprimit, njësia e interesit, rrëfimi, dialogu dhe përshkrimi***. Kompozicioni është mënyra se si është ndërtuar një vepër letrare.

Dallojmë **kompozicion të jashtëm** dhe **kompozicion të brendshëm**.

Narracioni - rrëfimi është mënyra e rrëfimit të ngjarjeve në një vepër letrare, ku përfshihet përshkrimi i ngjarjeve, personazheve, vendit dhe kohës në të cilën zhvillohet veprimi.

Format e narracionit/rrëfimit janë: retrospeksioni, introspeksioni dhe prospeksioni.

Retrospeksioni është kthimi pas në kohë, për të kujtuar ngjarje nga e kaluara (flashback), p.sh.: ngjarje nga fëmijëria, shkolla, lufta etj.

Introspeksioni është procesi i vëzhgimit të brendshëm të mendimeve, ndjenjave dhe gjendjes shpirtërore të personazhit (reflektimi i personazhit në vetvete për një vendim të ndërmarrë).

Prospeksioni është parashikimi ose pritja e ngjarjeve që mund të ndodhin në të ardhmen (një ditë, për të cilën personazhi nuk e dinte se do t'ia ndryshonte jetën).

Narratori - rrëfimtari është zëri ose figura që e rrëfen ngjarjen në veprën letrare. Ai mund të jetë pjesë e ngjarjes (narrator i brendshëm, në vetën e parë) ose dikush nga jashtë saj (narrator i jashtëm, në vetën e tretë). Narratori është ai që e sjell rrëfimin te lexuesi.

Epika, sipas përmbajtjes dhe trajtimit, klasifikohet në disa lloje.

Dallohen: ***epi historik***, që rrëfen ngjarje dhe figura të vërteta nga e kaluara; ***epi fetar*** që përqendrohet në besimin dhe mitologjinë; ***epi romantik*** që ndjek ndjenja të thella dashurie dhe përkushtimi; dhe ***epi idilik*** e paraqet jetën dhe natyrën me një qasje më të qetë dhe harmonike.

Në letërsinë shqipe, epika është përfaqësuar denjësisht nga Naim Frashëri me veprën “Historia e Skënderbeut”, e cila përfaqëson epikën historike dhe atë fetare, si dhe nga Gjergj Fishta me “Lahutën e Malcis”, e cila është ndër veprat më të plota të epikës shqiptare.

LLOJET EPIKE NË VARGJE

Gjinia epike në vargje është lloj letrar, ku autori përveçse i rrëfen ngjarjet, ai edhe i shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij. Të këtij lloji janë: **epi**, **epopeja** dhe **poema heroike**.

- **Epi** është krijim epik ku pasqyrohet realiteti objektiv i ngjarjeve, nëpërmjet të cilit shkrimtari e përshkruan jetën e njeriut dhe të popujve, përgjatë periudhave kohore të mbushura plot me ngjarje.

Fjala **epos** do të thotë: **fjalë, tregim, histori**. Këtu e kanë edhe burimin termat epope dhe ep.

Kumtimi, dialogu dhe përshkrimi janë elemente me marrëdhënie të ndërsjella, që kanë rëndësi për *kompozicionin stilistik* të epit, duke sajuar një njësi më të gjerë - **skenën epike**.

Zhvillimi i veprimit të epit kalon nëpër disa etapa: *paraqitja e veprimit (ekspozicioni)*, *thurja e veprimit*, *kulminacioni*, *peripecia* dhe *shthurja e veprimit*. Këto etapa e tregojnë natyrshmërinë e zhvillimit të veprimit në çdo vepër letrare, duke e ruajtur edhe karakterin kronologjik të ngjarjes.

Cikël quhet një grumbull këngësh epike, të cilat bëjnë fjalë për një ngjarje historike, periudhë ose hero të caktuar.

“Teoria e letërsisë”, G. Luboteni

-Amanet mori motër, pse po kan?!
Zemrën dysh, mori motër, pse ma dan?!
Gjergji i yt tjetër pushim nuk ka,
Veç si gjeth i ahit n'log t'shullanit.

Kumtimi i shkurtër vjen fill pas disa pyetjeve të Gjergjit:
Sa mirë motra vllaut po m'i përgjegj:
Dorën e vllaut tu balli e paska vndue...

(Këngë popullore epike: “Gjergj Elez Alia”).

- **Epopeja** është poemë epike ose vepër e gjerë tregimtare, ku përshkruhen bëma legjendare a ngjarje të rëndësishme historike të jetës së një populli. Prejardhja e poemës qëndron në epikën e antikitetit dhe mesjetës. Epopetë i kanë ruajtur të gjitha vetitë e këngëve të zakonshme epike, në të cilat manifestohen fuqishëm idealet dhe dëshirat e një populli brenda një kohe të caktuar.

Tema e epopesë përmbledh ngjarje të rëndësishme dhe heroike, zakonisht të lidhura me personazhet legjendare. Për nga tematika dallojmë dy lloje të epopesë: **epope popullore** (e krijuar nga populli në kohë shumë të lashta) dhe **epope artistike** (e krijuar nga individ i njohur, si fryt i imagjinatës dhe punës së një njeriu).

Krijuesit e epopeve, pavarësisht se në to përshkruhen ngjarje kolektive, mbeten të panjohur (anonimë), pasi koha kur janë shkruar ato nuk e veçonte individin nga kolektivi.

• **Poema heroike** është krijim ose ep historiko - heroik që përshkruan ngjarje të një periudhe të gjerë kohore, e cila në thelb e ka **heroin** ose vetë **ngjarjen**, pra bazohet në konceptin “**poemë**” dhe “**hero**”. Fillimisht shqyrtohen secila veç e veç, pastaj kombinohen kuptimet e tyre. Ajo, mbi të gjitha, është vepër arti me elemente folklorike që ka ekzistuar nga antikiteti dhe karakterizohet nga shumë kultura.

Karakteristikat e poemës si zhanër letrar janë: **komploti** (skena dhe ngjarja); **gjerësia e shfaqjes** (ndonjëherë përfshin vitet dhe gjeneratat) dhe **imazhi i hapur** i heroit lirik. Epi më i vjetër heroik është “**Eneida**” e Virgjilit.

Edhe letërsia shqipe shënon epe të njohura.

Historia e Skënderbeut

(fragment)

Skenderbeu u tmerrua
Dhe zëmëra q'ë kish trime,
Ju doq e ju përvëlua,
Ju bë cop edhe thërrime.
Me tmerr e me breng' u zgjua,
Burr' i math e trim i mirë,
Dhe ndënj pak'
E u mejtua,
Kur sheh që posa ish ngdhirë
Qieillin' e kishin zënë
E gjithë qarkunë retë,
Dukej sikur kishte rënë
Një zi e madhe ndë jetë.
Derën' e tëndës' e hapnë,
Një kalorës po thërriste,
Kali kishte marrë vrapnë,
Ajo, sa mundte, bërtiste.
Vinte nga kryeqyteti,
Nga Adrinopoj' e shkretë,
Sillte kartënë nga mbreti,
Që s'kish fjalë të vërtetë.
Skënderbeu e këndoiti,
E mori vesh pabesinë
Dhe një shërbëtor dërgoiti
E thirri vetë njerinë
I tha: “Kartë pse s'më prure
Nga im at', apo s'të dhanë?”
At'i ra të zi prej ure
Posa i zu ngoje t'anë,
Po e mblodhi s'u rrëfye,
Tha “Vetëm këtë më dhanë”
Edhe fytyra ju kthye,

Djersë të ftohta i ranë.
I tha: “Po nga Shqipëria
Nonjë fjalë s'ke dëgjuar?”
Ajo mblodh supat e tija,
Dhe vu dorën në krahëruar:
Skënderbeu tha: “Ç'më thua?
Tim vëllezrë s'i ke parë
Dhe s'të thanë gjë për mua?
Këjo punë s'është e mbarë.”
Ajo me gjuhët të trashë
Tha: “S'i njoh, t'u ngjattë jeta!
E s'të them dot se i pashë,
Se s'fshihetë e vërteta.”
Trimi më tej nuk' e shpuri,
Po qëndroj e u mejtua,
Ëngjëlli ndër mënt ja pruri
Dhe lott' i vanë si krua.
Më s'ndenj, po që atë ditë
Mblodhi pleqt' e parësinë
Urdhëroj, bënë gatitë,
Të parë la një të tinë.
Mblodhi pleqt e parësinë
E dëgjuan ushtëtarët
Që ikën te Skënderbeu,
Pa gjith' i mori të qarët,
Thanë “Të na pikë dheu!”
Më nesëret gjith' u ngrinë,
Edhe pleqt' e parësija
Skënderbeut po i vinë
Brënda në tëndët e tija.

(“Poema e Skënderbeut”, Naim Frashëri).

LLOJET EPIKO-LIRIKE

Në gjininë epike dallohen dhe llojet epiko-lirike ku autori, përveçse i rrëfen ngjarjet, i shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij, siç janë: poema, romanca, balada. Në llojet epike rrëfimi bëhet përgjithësisht në vetën e tretë, por edhe në vetën e parë.

Poema është krijim epik, i gërshetuar me mjaft elemente lirike.

Në letërsinë shqipe, poema është hartuar nga disa shkrimtarë, si: Jeronim de Rada "Këngët e Milosaos", "Këngët e Serafina Topisë"; Gavril Dara i Riu "Kënga e sprasme e Balës"; "Naim Frashëri "Bagëti e bujqësia", "Ndre Mjeda "Andrra e jetës", si dhe një plejadë e tërë e shkrimtarëve bashkëkohorë.

Andrra e jetës

(fragment "Lokja")

Dimri i egër ia zë vendin vjeshtës. E strukur afër vatrës, Lokja vajton për fatin e saj dhe sjell ndër mend Trinën. Ajo po i ngryset ditët e saj të fundit në mjerim, pa njeri, pa ndihmë...

I.
E n'ballkue mbaruemun lulet,
shurdhë a vendi e shpia tytë;¹
Jo, me Loken një e dytë
nëpër shpi ma nuk u gjet.

Vetun zbardh e vetun erret
me krye n'hi e shuemja plakë;
nji dorë krande me i ba flakë,
përmbi votër kush s'ja qet.

E dishprohet me vetvedi
qi nuk bani kurrnji djalë;
sot e reja² i kishte dalë
bashkë me dritë për dru në shpat.

Kish mbajtë zjarmin ndezë mbi votër,
ja kish njomë njat bukë e mjera,
edhe Lokja me gjith tjera
kishte dalë me petka n'shtat.

Kish shkue motin si premdvera
me ndoj fëmijë tu' e kalamendun³
ishte knaqë tui e përmendun
tash e tash⁴ ferishta⁵ n'djep.

E dishprohet ke i ve mendja
orë e ças te Trina e shkreta!
ja lyp mordës n'ankime t'veta,
por mizorja nuk ja nep.

U shty vjeshta e krisantemi⁶
vetun vorreve lulzon;
landë e pyje, gjith ku kemi,
tui fry veri po i cungon.

Ndrrojnë prej dimnit landa veshen
e lëshon gjeth qi para pat;
e, për mshirë, duhitë që ndeshen,
ja çojnë t'vorfnit me i ba shtrat.

Binte bor' e frynte veri
tui çue akull për gjith' vis;
nalt orteku ushton për mneri,
tui fundue çetinë e lis.

Me dy cokla n'votër plaka
rri gjith natën e vajton,
rri me duer kah ndezet flaka,
porsi njeri kur uron.

E shikjon një dritë t'venitun,
vron pasqyrën e jetës s'vet,
e larg Morden tui kositon
e kujton e pranë e thrret.

U ndie 'j frymë përmbrenda shpie
porsi erë që vjen pa shkas
e n'at muzg, një vegim
hijet Lokes n'votër letë ju qas:

përmbi plaken krahët i uli
e ngrykë t'shuemen e shtrëngoi;
e buzët t'shpulpueme n'ballë ia nguli,
u ndal drita e ajo mbaroi.

(Poema: "Andrra e jetës", Ndre Mjeda).

¹ E zbrazët. ² nusja. ³ duke e tundur në djep.

⁴ herë pas here. ⁵ foshnja. ⁶ lule.

• **Romanca** është krijim letrar që i bashkon elementet epikë dhe lirikë, në të cilën trajtohen ngjarje të veçanta ose histori dashurie, heronjsh apo ndodhi të jashtëzakonshme, duke i shprehur ato me një gjuhë të pasur figurative dhe plot emocione. Në këtë krijim, përveç rrëfimit të ngjarjes (epika), autori i shpreh edhe ndjenjat e veta ose të personazheve (lirika). Shfaqet me nota optimizmi, gëzimi e hareje, por shpesh kanë edhe përfundim tragjik (fatal).

Ku shtrohet vala...

(romancë)

Ku shtrohet vala përmi zall
E frym një këng' e pakuptuar,
Të pashë, motër, plot me mall,
Më pe më shpirt të llaftuar.

Q'ahere silleshim më nge
Gjith vet-i dytë, vet-e dytë...
Dh'i shtinja sytë gjith përdhe –
Gjithë përdhe m'i shtinje sytë...

Po me t'u ndarë vet e vet,
Më s'kishim turp që s'kishte fjalë...
Na ritej malli posi det,
Posi një det që vjen me valë:

E prapë silleshim më nge
Gjith vet-i dytë, vet-e dytë;
E prapë sytë gjith përdhe,
Gjithë përdhe pikonin sytë.

Q'ahere qamë plot me mall
Atë vështrimin e kaluar,
Ku shtrohet vala përmi zall
E fryn një këng' e pakuptuar.

Se kish kuptim, që s'kish kuptim,
Kuptim' i fellë-i mallit t'tonë;
Se malli jon' ish zotërim,
Që robëron përgjithëmonë.

Se s'dashuronja-as un' as ti,
Po dashuronte dashurija:
Një dashuri, një fshehtësi
M'e fshehur sesa fshehtësija.

(Poezia: "Ku shtrohet vala",
Lasgush Poradeci).

Kot më vihet Erosi prapa

erosi është kapur për perden time
e nuk hiqet
plot dhomën e ka mbushur me shigjeta
dhe shtatin tim të munduar
larg atje korfuzi i bardhë noton si anije
e prej tij ti e hedh unazën e premtuar
në shkumën e ylbhtë të detit
përreth shtëpisë së heshtur të babait
lozin tingujt e cicërimave të ëmbla të trumcakëve
dhe era e luleve të bajameve
po gjithkund
gjithkund hidhëtia është e prekshme
me shijen e vetmisë
e s'e di pse erosi nuk hiqet se nuk hiqet
nga perdja ime me lule manushaqe

(Vepra poetike: "Vetë përballë Erosit", Lindita Ahmeti).

• **Balada** është formë e veçante e letërsisë gojore, në të cilën janë të gërshetuara elementet epike e dramatike, por me zotërim të elementeve lirike. Në fillet e saj, përbëhej nga tri strofa, dy të parat me nga tetë vargje dhe strofa e tretë me katër vargje dhe e kishte kuptimin e këngës lirike korale që shoqërohej me valle.

Fjala **baladë** e ka prejardhjen nga folja neolatine **ballare** (vallëzohj-kërcej).

Tema qendrore e baladës, nuk është tema kolektive e heroike, por tragjika individuale, pasi koncept themelor e ka pasur nderin dhe besën e dhënë. Përmbajta e baladës nuk strukturohet nga rendi kronologjik i përshkallëzimit epik, por përqendrimi në situata të zhvillimeve psikologjike.

Baladë për Malin e Thatë

Është një mal në Jug
Në mes dy liqenesh
I thonë Mal i Thatë

Dhe askush s'di të thotë
Si mbeti ky mal
I thatë edhe pranë lotëve

Mal i Thatë
Pa bimë, pa drurë, pa zogj
I vdekur për së gjalli.

Dhe askush s'di të thotë
Si mbeti ky mal
I thatë midis ujërash

Është një mal në Jug
Me emrin Mal i Thatë
Në mes dy liqeneve

Si një njeri
I tharë nga malli.

Pranë tij shtrihet një lëndinë
Me emër të çuditshëm
Lëndina e Lotëve

Dhe askush s'di të thotë
Përse mbeti ky mal
I etshëm ndanë ujërave

(Vepra poetike: "Bota sillet rreth Jugut",
Agim Vinca).

Baladë

(në frymë popullore)

Fryn veriu në mal të thatë,
Thotë vasha lele ngriva.

Vjen e bën një vap' e rëndë,
Thotë vasha bubu plasa.

Trim më more-edhe më shtrove,
Trim më ngrove-e më pushtove,
Trim më puthe-e më mbarove,
Trim o trim seç trimërove!

Duro, vashë, të durojmë,
Si duron mali dëborën.

Duro, vashë, të durojmë,
Si duron kallir 'i pjekur.
Në më arthç o moj në hije,

Atje lart në mal të thatë
Zoti Krisht bëke një kishë.

Në të shtënça moj në dorë,
Do të ngroh si top dëborë.

Do t'i puth prej dhembshurije,
Do t' skuq t'i ndes qirije,
Do t'i nxi t'i bëj mavije
Vate dimri, vate vere,
Ato buzë gjak-qershije.

N atë kishë ç'pashë brenda
Qënke trimi edhe vasha!
Trimi ç'paske dhëndëruar,
Vasha ç'paske nusëruar,
Zotin ç'paskan lavdëruar,
Jetën ç'paskan trashëguar,
Shpirtin ç'paskan shentëruar.

Fryn një erë-e shkundërmuar,
Thotë vasha çeli molla.

Çeli, vashë, le të çelë
Si çel malli mun në zemër.

Vate dimri, vate vere,
Vate vjeshta pe'r ngahera.

Në m'a dhënç moj bel' e hollë,
Do të thyej si mënjollë,
Do të shtryth posi një mollë.

(“Baladë”, L. Poradeci).

LLOJET EPIKE NË PROZË

Epika në prozë është lloj letrar ku jeta pasqyrohet nëpërmjet rrëfimit për ngjarje dhe njerëz që kanë marrë pjesë në to, për sjellje dhe emocione të tyre në rrethana të ndryshme.

Llojet e veprat epike janë: **skica, tregimi, novela, romani** etj.

Poezia epike në prozë është një zhanër me rrënjë të lashta që daton nga koha antike. Ajo përfshin forma të ndryshme letrare si tregimi, novela dhe romani, të cilat dallohen nga njëra-tjetra për nga struktura, përmbajtja dhe mënyra e trajtimit të ngjarjeve dhe personazheve.

- **Skica** është një tregim letrar tejet i shkurtër, në të cilin shkrimtari i përshkruan tiparet kryesore të personazhit ose të ngjarjes pa u ndalur në përshkrimin e hollësirave, por duke e përqendruar gjithë vëmendjen e tij në pasqyrimin e ngjarjes kryesore. Ky krijim, nuk thellohet në përshkrimin e karakterit të personazhit, por i paraqet vetëm linjat përvijuese të tij.

Në letërsinë shqipe, më të suksesshëm në lëvrimin e skicës kanë qenë Migjeni dhe Nonda Bulka.

Luli i vocër

Askush s'e njef Lulin. As shokët e tij, që përpara tij lozin, nuk e njofin. Ma mirë me thanë se e njofin, por ata lozin për hesap të vet e Luli i shikon për hesap të vet. Sot gjithkush ka punët dhetelashet e veta, ashtu edhe fëmijt, ashtu edhe Luli. - More Lul! Shum herët ke fillue me shikue punën tande.

Kur Luli hyn n'oborr të shkollës, buza i qeshet nga pak, por askuj asnjë fjalë s'i thotë. Ecën ngadalë tue shikue djathtas e majtas, por gjithnjë tue ecë, deri sa të mrrijë në cak të vet. Aty te dera e ruginës shkollore shum i pëlqen të qëndrojë. Aty asht caku i tij, i praruem me rrezet e ngrofta të diellit në këto ditët e vjeshtës. Mshtetet Luli për mur, grushtat e vegjël i shtje ndër xhepa, hundën picrrake të kuqun nga të ftohtit e mëngjezit ja sjell diellit dhe... shikon. Gjaja që ma tepër ja tërhjek vrejten janë çizmet, që i kanë të veshun disa shokë të tij. Sa të bukra janë! Si shkëlqejnë! - mendon Luli dhe pa dashje i shkojnë syt ndër tollumbat e veta, nëpër të cilat shifon fare mirë të pesë gishtat e kambve të zbathuna. Nga kureshta i afrohet një shoku që ka çizmet ma të reja. Ulet dhe shef në lustrin e çizmës kambët e veta të zbathuna - aq shumë shkëlqejshin çizmet!!! Mbasi shoku me çizme fluturoi, Luli ngadalë shkoi te caku i vet, në diell, t'i ngrofi kambët. - Po kur nuk ka diell, si ja bën i shkreti Lul? Ndoshta ja bajnë disi hallin apostujt e mëshirës dhe të dashunis'...

Ndoshta, ndoshta...

Nga një herë i afrohet mësuesi Lulit. Dhe kur e ka ftyrën e dlirtë dhe pa puça, mësuesi ja ledhaton faqet, gushën, e Luli i afrohet, ja merr dorën, e shikon me sy pllumbi dhe kishte dashtë t'i fali diçka mësuesit. Por vjollca nuk ka. E Luli i vocër çka mund t'i fali mësuesit tjetër? Veç në ja faltë tollumbat e veta që kanë hapun gojën si me dashtë me e hangër mësuesin. Po, po, tollumbat e Lulit të vocër kanë me e hangër mësuesin.

Skicë: "Luli i vocër" ("Novelat e qytetit të Veriut"), Migjeni.

- **Tregimi** është vepër e shkurtër në prozë që paraqet një situatë apo ngjarje të vetme me një ose disa personazhe. Ngjarja e tregimit nuk është shumë e ndërlikuar, zakonisht përmban vetëm ndonjë episod të jetës së njeriut dhe nuk zhvillohet më.

Tregimi ka përmbajtje më të strukturuar, më të lidhur e të qëndrueshme dhe realizohet me këto pjesë kryesore: **hyrja, zhvillimi i përmbajtjes dhe përfundimi.**

Letërsia shqipe është e pasur me shkrimtarë, të cilët e kanë lëvruar këtë lloj të epikës, si: Konstandin Kristoforidhi, Mitrush Kuteli, Migjeni, Nonda Bulka... më vonë: Zija Çela, Naum Prifti, Anton Pashku, Murat Isaku, Ramiz Kelmendi, Rexhep Zllatku, Kim Mehmeti etj.

Këpucëtari

Atë ditë vjeshtë, - si prorre - mbasi u ngjesh e u mbath mirë e mirë, doli në dyqan.

Bryma i kishte zbardhue shpatet e Sharrit. Frynte një acar - një erë ndjellakeqe, që gjithmonë binte shi dhe rrenim. Mori një dy gaca zjarr të fqinjës e parë, i mblodhi turrë midis tagarit të truellit e u vu përmbi do lëmishte, kashta dhe krande. Mbasi i fryni disa herë djathtas e majtas zjarri u kall. I ngrofi pak duert e skuquna dhe e fërkoj fytyrën si me dashtë t'i derdhte gjakut pak ngrohtësi.

Përmbi pullazet e qytetit zhदारitej lodrueshëm tufa e sorrave.

-Ishalla me të mirë, - prozhmoi në vetëvete, dhe vazhdoi ta rrihte thumbin e këpucës së një zonje...

Ma vonë - aty kah drekët e mëdha ushtoi - bubullima. Fitilat e zjarrtë të vetëtimave, që shkrepshin varg, ja mirrshin sytë... në fillim ranë do kokrra të mëdha shiu, që i ngjajshin breshnit të pranverës. Njerëzit - kush hyni nëpër streha e kush vrapimthi u drejtue nga shtëpia - u rralluen në shesh. Xha Aliu e zgjati kryet në derë dhe sharoj në kujtimet e veta. Asnjherë, si për inat, jeta s'i kishte përkëdhelë. Kishte qenë bari, rrogëtar, kallajxhi. Së fundit u vendos në këtë dyqan. Malit ja dinte fare mirë rrobet, e dinte se si merr frymë secili dru, si gjakon secili gur... Shiu vinte nga kreshta e Sharrit me rrëmbin. Paralajmëronte fatkeqësi... Këte e dinte mirë... Për pak gjethet fërfëlluen qiellit, era si dredhë i plapuriste dhe i mërgonte kushedi kah... Shiu ja grahi me rrëshekë. Ashklat, si të plyryna, pluskuen mbi ujë. Llofkat, disi si të përgjakuna, gurgulluen dhe çurgje-çurgje u mblodhën në shesh, prej kah dallgë-dallgë shpërndareshin qytetit. Të parën herë u mbushën brazat, hendeqet, mandej uji, pa kurrfarë përfilljeje dhe mëshire, nisi të gërmojë në temelet e shtëpive dhe dyqaneve...

Lumi gumzhiti, solli me vete angullimën e egër të qenve të barijeve... Ama mbushej, me të shpejtë. Vrushkujt e parë, t'egër dhe të njimbasnjishëm iu vërsulën urës së gurtë - urë e vjetër, për të cilën katundarët kishin thurë shumë gojdhana...

Një suvalë e rrufeshme i ra derës së dyqanit, ku këpucëtari i mblidhte këpucët, i bante dy nga dy dhe i varte nëpër gozhdën të dërrasave, që të mos i mirrte uji. Veglat ma t'imita të punës i ngjeshin për rreth shokës. Çekanin e madh dhe mëkambëzënë i shtini rrëshqitas në shekat e tirqve...

Njerëzit, pleq e të rij, vrapuen nga ura për ta mbrojtë, nga se po të shprishej ajo, fort randë kishte të shpëtonte jeta e lagjes së vogël, që gjindej mu në rranzë të lumit.

Këpucëtari i përvoli krahët deri mbi bërryla dhe iu kapërthye si bollë e vrame njanës dërrasë që po lakohej. Vendosi të zvarritej drejt përpjetë tue u zhagitë dërrasës, mbasi rrenimi gjithnjë

e ma tepër rritej dhe mbushte dyqanin me zall dhe degurina. Iu kujtue se çdo orvatje për të shpëtue jetën mbrenda në dyqan ishte e kotë. Prandej i mblodh edhe fuqitë e fundit dhe vendosi të hypte naltë në pullaz të tij, prej kah, nëse i kërcënohej rreziku, do të kalavarej në degët e mollës, të cilat prej frutit atë vjet ishin lakue deri në tjegulla. Dha e mori disa herë, por si të vepronte ndonji fuqi e mëshehtë kundra tij, trupin ia tërhiqte kryengulthi teposhtë. Binte si tru pth i sharruem në llokoçamën e ujit. Njiherë ai i mbërinte deri në kërçikë, por ma vonë rritej gjithnji e ma tepër.

Të fundit herë kur ra, uji ja mbuloi kambët, ijet dhe një pjesë të krahnorit... i zgurdulloi sytë dhe i këqyri si për të fundit herë këpucët që lundrojshin pizgërr nëpër rrenim.

-Hej, milet! - u shqerr gërhamë e tij e përmbytun dhe pa kurrfarë, shprese. Kundrat e zeza me take të nalta janë të... nisi t'i numrojë pronarët e këpucëve tue ndjekë rendin e tyne përpara syve.

-The qafën, marroq iu ngërmue njeni prej qytetarëve, që vrapoi të shkepi ndonji dërrasë në dyqanin e tij për ta ndalë lumin.

-Dyqanin, dritën e synit, amanet ja la nipit!... - ja priti ai i kapun për dërrase si kitër.

-Veni kambët mbi supët e mia dhe kapu në qoshin e kulmit briti qytetari me të shpejtë, tue mos ja shkepë sytë urës.

Këpucëtari, tue u shilarë pullazit, shikonte me supin e tij, mandej tue u kolovitë në pezullim, e vu edhe tjetrën dhe u kap për tabanin e kulmit.

-Bafsh hajr! - përshpëriti, tue shtue se me të dalë rrënimin një palë këpucë pa kurrfarë page ka për t'ja arnue dhe meremetue.

Njeriu e luhati vetëm pashin e krahut të majtë në shenjë mospërfilljeje për këtë cikrrimë, dhe trupoi kah ura.

Këpucëtari, tue u shilarë pullazit, shikonte me tmerr rrënimin që bahej gjithnji e ma i tërbuem. I pështuem lemerie i ngriti duert përpjetë, tue e lutë qiellin që t'ja shpëtonte këpucët e myshterijve. Nji valë ruzgjer ja fërshëllini sytë. E fshiu mjekrën me jakën e këmishës dhe e trusi kësulën në puç të kresë.

Nji guri i madh dhe i rumbullakët, ku pushojshin katundarët ditëve të pazarit, luejti vendit. U rrokullis rrëmbimthi dhe, mbasi bani disa rrukullisje, iu përplas me fuqi dyqanit. Çatmja u dridh si prej trandjeve të tërmetit, mandej, tue u luhatë si shtizë flamuri, nisi të lakohet nga kalldërmi i rrugës.

Plaku i hapi kambët dhe disi iu ngjiti majës së degës, e cila përplasej prej njenës në tjetrën anë. Mbas një kohe, kur dërrasat filluen të shkepen, ai u kap në majën e kulmit dhe i erdh mullarthe disa herë si të dëshironte të kërkojë ngushullim.

Njerëzit vazhduen punën e vet. S'ishte gja e lehtë me vu penda dhe me i dhanë krye ujit nga krahuri i majtë, nga ajo anë e cila ishte ma e naltë se kjo përpara dyqanit të këpucëtarit. Po të rrëzohej ura, atëherë tejet vështirë do t'ishte të mbrohej një pjesë e madhe e qytetit prej vërshimës.

Xha Aliu rrinte i shastisun dhe mendonte se si munden aq fort t'i dalin zot urës e ta harrojshin ate që aq fort i kishte nderue dje, dhe s'u kishte ba asnjë të keqe. Kur i lau duert ma prej ndihmës, belbëzoi:

- Jo, këtu e tutje edhe unë do të mendoj soll për vete e s'do ta çaj ma kryet për ta!...

Kah e vona, shiu u ndal. Njerëzit, të pehatun nga stërmundimi, u renditën nën strehë, tue i fshi krahët dhe tue i shkundë rrobet.

Njenit i shkoi ndërmend xha Aliu dhe pyeti të tjerët, e ata i rrudhën krahët tue i ngulitë sytë në zallin e anit.

Tue rrëshqitë trungut të mollës teposhtë, Aliu zihej në vete:

Jo, jo, nuk vdes këpucëtari aq kullaj, që t'ua lajë miraz dyqanin. Edhe nëse vdes, njikaj ta qitni dhambin, nuk do të mund ta shtini dorën aty pari...

(Vepra me tregime: "Unaza e djerrinës" Murat Isaku).

- **Novela**, në krahasim me tregimin, paraqet një strukturë më të zgjeruar përmbajtësore ku përshkruhet një ngjarje e veçantë e jetës së njeriut. Ajo përfshin më shumë ngjarje dhe personazhe të zhvilluara, duke lejuar analizë më të thelluar të situatave dhe marrëdhënieve njerëzore.

Novela, rrjedh nga fjala italiane **la novella** (e re, e vogël, shpoti) dhe është njohur shumë herët në letërsinë italiane, por edhe në letërsinë greke qysh në shek. II - IV të epokës sonë. Forma e saj është e mbyllur, prandaj nuk është ndonjë krijim i përshtatshëm për të bërë analiza të gjera shoqërore, por përshkruhet fati i njeriut dhe gjendjet e ndryshme shpirtërore të tij.

Novela shkruhet në të gjitha letërsitë e botës, ndërsa në letërsinë shqipe veçohen: Mihal Grameno, Lasgush Poradeci, Migjeni, Shefqet Musaraj, Hivzi Sulejmani, Ramiz Kelmendi, Anton Pashku etj., të cilët kanë prezantuar një kontekst shoqëror të caktuar, ku personazhet janë të ndërtuar me kujdes psikologjik dhe shpirtëror.

Oxhaku

(fragment)

Çështja e martesave midis njerëzve të shtresave të ndryshme shoqërore i preokupoi shumë shkrimtarët tanë të traditës, që nga De Rada e këndej. Një temë e këtillë trajtohet edhe në novelën "Oxhaku" të Mihal Gramenos. Ngjarja e kësaj novele vendoset në Shqipërinë e Jugut, në kohën e sundimit të Ali Pashë Tepelenës.

Malo beu, i biri i feudalit të madh Rushan beut, martohet me të bijën e çifçiut të tij të varfër, Vahidenë. Këtë martesë e kundërshton me këmbëngulje i ati Rushan beu, sepse ishte në kundërshtim me normat morale të asaj kohe. Duke përfituar nga mungesa e të birit, që kishte shkuar të luftojë kundër grekëve, Rushan beu jep urdhër të digjet shtëpia ku strehohej Vahideja me të birin e mitur Rexhepin, që kështu ta shuajë atë "farë të turpit" të derës së tij të madhe. Shtëpia digjet, por arrijnë të shpëtojnë Vahideja me të bijën e qehajit dhe qehaji me Rexhepin. Duke pandehur se djali iu dogj në zjarr, sepse nuk dinte për shpëtimin e tij, Vahideja çmendet. Kur kthehet nga lufta dhe mëson për tragjedinë e familjes, Maloja del në mal si cub, grabit të pasurit e ndihmon të varfërit. Edhe Rushan beun, shkrimtari e bën ta ndjejë fajin e vet në mënyrë religjioze, i cili kthehet në bamirës dhe rasti e sjell që, si i këtillë, të marrë në mbrojtje edhe Rexhepin e Vahidenë, pa i njohur se kush ishin. Në një luftë kundër hajdutëve Rexhepi zihet rob prej tyre dhe at e bir rinjihen nga një hajmali e florinjë. "Lumturia kthehet përsëri në shtëpinë e Rushan beut: Vahideja shërohet, Rexhepi martohet me vajzën e qehajit, "Oxhaku" sigurohet.

Pjesa e parë Krye I

Më 1821, në kohën e Ali Pashës gjithë Shqipëria, dhe më shumë Toskëria gjendeshin në rrëmuje. Katunde edhe qytete shkretoheshin dhe njerëzia mërgoheshin në vende të huaja, duke lënë shtëpitë, plaçkat e gjithë ç'kishin dhe vështtronin vetëm si e si të shpëtojnë nga rreziku shpirtin e tyre.

Aso kohe, qyteti Korça kishte zënë të lulëzojë, duke qenë më parë një qytet i vogël edhe i padëgjuar siç është sot, po njerëzia dridheshin nga frika se mos kenë gjithë atë fat që kishin edhe të tjerët, të cilët ngryseshin të gjallë e gdhieheshin të vdekur. Andaj, me të perënduar dielli, mbylleshin nëpër shtëpitë edhe nuk dinin ç'bëhesh natën në qytet. Nga ky shkak nuk kishin vërejtur që "shtëpia e zezë" prej ca kohe mbante njerëz brenda.

"Shtëpia e zezë", siç e quanin qytetarët, ishte një shtëpi e madhe, ndërtuar me gurë edhe rrethuar me gjithë anët me avlli edhe fortesa edhe ishte mbanë qytetit pranë kroit të Abdi beut. Prej shumë kohe, kjo shtëpi ishte epandenjur edhe e shkretuar, se gjithë sa kishin ndënjur, gjithë atë fat kishin pritur që të shuhen me gjithsej, edhe nga ky shkak kishte arritur të jetë fole e kukumjaçkave edhe e galave, se njerëzia jo vetëm që nuk guxonin të hyjnë brënda, por edhe kur shkonin pranë asaj shtëpie do të falëshin me tmerr, duke iu lutur zotit t'i shpëtonjë edhe t'i mpronjë nga nonjë gjëmë e madhe.

Në të këtilla frikëra gjendeshin korçarët, kur një natë të marsit frynte një erë e marrë edhe dëgjojnë të zbrazura prej pushkësh. Të gjithë mbetnë të tmerruar, se pandehnin që afrojtë edhe për ata fundi i jetës. Andaj që të gjithë faleshin, duke kërkuar nga nonjë vënt të fshehtë për shpëtimin e shpirtit, edhe asnjë nuk guxonte të dalë përjashta që të mësonjë shkakun e pushkëve.

Po sa vinte më shumë dëgjoheshin të zbrazura prej pushkësh, pastaj dëgjoheshin edhe zëra prej njerëzish, të cilët bërtisnin sa muntnin që të vraponin të shuanin zjarrin që diqte shtëpinë e zezë, se ishte shumë frikë mos përhapet zjarri mi gjithë qytet.

Po sa vinte më shumë dëgjoheshin të zbrazura prej pushkësh, pastaj dëgjoheshin edhe zëra prej njerëzish, njerëzinë t'i shpëtojnë të vetmin djalë që kishte, i cili flinte në katin e dytë, meqë ajo nuk munte nga flagët e zjarrit ta shpëtonjë!

Vetëm atëhere njerëzia, si u siguruan që nuk është tjetër rezik përveç zjarrit, të cilin e pandehnin t'ja ketë vënë nonjë njeri mëndjeshkurtër, vraponin me ujë, dhiqelë e sëpata, edhe me çfarë muntnin për të shuar zjarrin.

Po, me t'u afruar pranë shtëpisë së zezë që digjesh, mbetnë të nemitur kur vështtronin sot krerë njerëzish në dritaret e shtëpisë, të cilët u luteshin edhe u kërkonin ndihmë që t'i shpëtojnë që të mos digjen të gjallë.

Një grua e re dhe e bukur, që dukesh fare mirë në dritare të flagëvet me leshrat e lëshuar edhe të pakrehura, me sy të zgurdulluar, veshur me rrobën e natës si ç'ishte ngritur me tmerr nga gjumi, zgjate duar, duke lutur njerëzinë t'i shpëtojnë të vetmin djalë që kishte, i cili flinte në katin e dytë, meqë ajo nuk munte nga flagët e zjarrit ta shpëtonjë!

Po njerëzia gjithë mbetnë të shurdhër në blegërimet e në lutjet e kësaj gruaje, mënjanë nga

frika e zjarrit që nuk muntnin t'afroheshin, më tjetër anë nga tmerri që vështronin njerës në atë shtëpi, të cilën e dinin të pandenjur edhe të shkretuar. Andaj vështronin që të mos zgjatet zjarri më tjetër shtëpi, duke lënë të brençmit në duart e Perëndisë!

Ah, sa keq është të vështrosh shpirta që digjen edhe të mos mundësh t'i shpëtosh!

Zërat që brenda pushuan së bërtituri edhe së kërkuari ndihmë edhe nuk dëgjohesh përveç trak-trak! nga drurt edhe nga dhegat që digjeshin, se zjarri sa vinte po përhapte flagët më të gjitha anët, kur dëgjohej pas pakëzë, për të fundit herë, një buçim i math përzierë me një zë të thellë edhe pastaj bëhet një heshtje e madhe, se çatia me dyshemetë e gjithë ç'kishte shtëpia, ranë të gremisura, edhe zjarri më s'kishte fuqi.

Qytetarët ndenjën të gjithë pranë zjarrit gjer më të gdhirë, për të ruajtur mos kërcerijë nonjë shkëndijë afër, edhe pyesnin njëri-tjetrin në dinte gjësendi që kur rronin njerës në këtë shtëpi po asnjë prej syresh nuk e dinte ç'njerës rronin që kur kishin ardhur në atë shtëpi, edhe sa ishin. Andaj, me gjithë helmin që ndjenin për ata që u bënë therorë të zjarrit, gëzoheshin më tjetër anë se zjarri i vuri funt asaj shtëpie së zezë, që kishte shuar kaqe njerës, edhe të cilën e nëmëronin si shkakun e gjithë të ligave që ngjisinin në qytet!...

Krye VIII

Shkuan dy tre muaj pas t'ikurit të Malos në luftë, edhe asnjë shënim nuk dukesh që t'u ketë mësuar nonjë njeri këtë fole kaqë të fshehur edhe të tmeruar nga qytetarët.

Po spiunët e Rushan beut nuk kishin tjetër punë, përveç të gjesdisin me të gjitha anët, duke mos lënë katund e qytet, për të mësuar folenë e Vahidesë, duke ndryshuar robat e duke bërë çfarëdo tregëti gjer sa arrinë në Korçë.

Atje nuk lanë vër'e vërushkë, po me gjithë pyetjet edhe vërimet që bënin, nuk mësuan gjësendi. Andaj të pashpresuar dëshirojnë të shkojnë gjetkë, kur një mbrëmje posa ishte ngrysur, e njerëzia pa mbyllur nëpër shtëpitë, vështrojnë një njeri të huaj pshtjellë me një gunë të gjatë, që tregëtonte në trek.

Ky njeri u bëri një vërejtje të veçantë edhe, duke mos e lënë nga sytë, e gjurmuan gjersa hyri te shtëpia e zezë, se nuk ishte tjetër, përveç Rustemi, i cili delte nganonjëherë për të tregëtuar, ngrysur kur njerëzia ishin fort të rrallë përjashta.

Të nesërmet u lajmëruan nga fqinjët që ajo shtëpi ishte e pandenjur prej shumë kohe, edhe kjo i siguroi më shumë që atje kishte folenë Vahideja. Andaj pritnë sa u ngrys dhe hynë në avlli, q'andej panë Vahidenë me djalin edhe shërbëtorët, me anë të një vëreje të dritares.

Të gëzuar e të kënaqur për të gjeturit e Vahidesë, shkuan në Frashër edhe lajmëruan Rushan beun, i cili hidhej nga gazi për këtë sihariq; të nesërmet u kthyen në Korçë edhe i vunë zjarrë "shtëpisë së zezë", duke besuar që bashkë me shtëpinë ishin djegur të gjithë të brençmit.

(Novela: "Oxhaku", Mihail Grameno).

- **Romani** është vepër e madhe tregimtare ose forma më e plotë e prozës epike, ku zhvillimi i karaktereve, i ngjarjeve dhe i temave trajtohet në një formë të ndërlukuar, pasi përfshin një numër të madh personazhesh, duke pasqyruar realitete të ndryshme shoqërore, historike e psikologjike.

Novela - fjalë angleze për histori, ngjarje, lajm, që rrjedh nga latinishtja: **novella** (*novellus - novus*, që do të thotë “i ri”).

Është një vepër e zgjeruar e trillimeve narrative e shkruar në prozë. Njihen disa lloje të romanit: romani historik, aventuror, shoqëror, natyralist, psikologjik, didaktik, pedagogjik, filozofik, satiriko - humoristik, pastoral etj.

Romani, si formë letrare, është unik në aftësinë e tij për të përfshirë botën e jashtme dhe të brendshme të njeriut, për të analizuar jetën në shumë dimensione, për të ndriçuar psikologjinë e individit, konfliktet e brendshme dhe sfidat shoqërore të kohëve të ndryshme.

Romani modern ka njohur kulmin e vet gjatë shekullit XIX dhe XX, me shkrimtarë të shumtë evropianë e botërorë.

Në letërsinë shqipe, romanet e para janë: “Shkodra e rrethuar”, Ndoc Nikaj; “Për mbrojtjen e atdheut” dhe “Lulja e kujtimit”, Foqion Postoli; “Çlirimtarët”, Dhimitër Shuteriqi; “Njerëzit”, Hivzi Sulejmani; “Këneta”, Fatmir Gjata etj. Romani më i zhvilluar i kohës moderne u realizua nga shkrimtarët, si: Ismail Kadare “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, Jakov Xoxa, Shefqet Musaraj, Dritëro Agolli, Nazmi Rrahmani, Murat Isaku, Zija Çela, Fatos Kongoli, Ibrahim Kadriu, Ridvan Dibra etj., të cilët kanë krijuar vepra me strukturë narrative të pasur, duke eksploruar ngjarje historike, drama njerëzore dhe fatin kolektiv të popullit.



Gjenerali i ushtrisë së vdekur (fragment)

Në hotel "Dajti"

Në hotel "Dajti" gjenerali e ndjeu veten mirë. Ai shkoi në dhomën e tij dhe ndërroi uniformën. Pastaj zbriti në holl dhe porosi një bisedim telefonik me shtëpinë.

Gjenerali, prifti dhe tre shqiptarët u ulën në një tavolinë. Ata biseduan për gjëra të ndryshme dhe të parëndësishme. U shmangeshin bisedave politike dhe shoqërore. Gjenerali ishte shumë serioz dhe i sjellshëm. Prifti fliste pak. Gjenerali dha të kuptonte se ai ishte kryesori, megjithëse prifti fliste më pak. Ai foli për traditat e bukura që ka krijuar njerëzimi në lidhje me varrimin e ushtarëve. Përmendi grekët e trojanët, që varrosnin njerëzit me aq madhështi në pushimet midis luftërave. Ai ishte shumë entuziast për misionin e tij. Do ta kryente shumë mirë këtë mision të rëndë dhe të shenjtë. Mijëra nëna prisnin bijtë e tyre. Ato kishin njëzet e ca vjet që prisnin. Është e vërtetë se kjo pritje ndryshonte pak nga ajo pritja tjetër, kur ato shpresonin t'u ktheheshin të gjallë bijtë e tyre, por, sidoqoftë, edhe të vdekurit priten. Ai do t'u çonte nënave eshtrat e bijve të tyre, që gjeneralët budallenj nuk ditën të udhëhiqnin në luftë. Ai ishte krenar për këtë. Ai do të bënte çmos.

- Zoti gjeneral, telefoni... Gjenerali u ngrit plot gjallëri.

- Me falni, zotërinj. Me hapa të gjatë dhe madhështorë shkoi në portinerinë e hotelit. Po aq madhështor u kthye. Shkëlqente i tëri. Në tryezë pinin konjak dhe kafe. Biseda ishte më e ngrohtë.

Gjenerali përsëri dha të kuptohej se ai ishte kryesori në këtë mision, sepse prifti, megjithëse kishte gradën kolonel, në këtë rast ishte vetëm një përfaqësues shpirtëror. Ai ishte kryesori dhe mund të hapte çfarë që të donte: për konjakët, kryeqytetet, cigaret. E ndiente veten shumë mirë në këtë sallën hoteli, me këto perde të rënda, me këtë muzikë të huaj, bile, më tepër se të huaj. Ai u habit dhe vetë nga i erdhi kështu papritur kjo dashuri për konfortin, për të gjitha objektet që shikonte rreth e rrotull në sallën e hotelit, duke filluar nga kolltukët e rehatshëm e gjer te zhurma a këndshme që bënte makina e ekspresit të kafes. Më tepër se dashuri ndoshta ishte një ndjenjë malli të parakohshme për diçka që e ndiente se do ta braktiste për një kohë të gjatë.

Gjenerali ishte i gëzuar. Shumë i gëzuar. As vetë nuk e dinte përse i erdhi kjo valë gëzimi e papritur. Ky ishte gëzimi i udhëtarit që gjen një strehë pas një udhe të rrezikshme në mot të keq. Ajo gota e vogël e verdhë e konjakut nisi t'i dëbonte përherë e më shumë pamjen e imosur e kërcënuese të maleve, që edhe tani në tavolinë e shqetësonte herë pas here. "Si një shpend krenar i vetmuar..." Befas e ndjeu veten tepër të fuqishëm. Trupat e dhjetëra mijëra ushtarëve, të futur në tokë, pritën kaq vjet ardhjen e tij dhe ja, ai erdhi që t'i ngrinte ata nga balta dhe t'ua kthente prindërve dhe të afërmve. Ai erdhi si një Krisht i ri, i pajisur me harta, lista dhe shënime të pagabueshme. Gjeneralët e tjerë i udhëhoqën këto kolona të pafundme ushtarësh drejt disfatave dhe asgjësimit, kurse ai erdhi që t'ua shkëpuste harrimit dhe vdekjes atë diçka që kishte mbetur prej tyre. Ai do të endej varrezë më varrezë, kudo, mbi ish-fushat e luftëtarëve, me qëllim që t'i gjente të gjithë të zhdukurit dhe të humburit. Në luftën e tij me baltën nuk do të njihte disfatë, sepse ai ishte pajisur me forcën magjike të statistikave të përpikta.

Ai përfaqësonte një vend të madh e të qytetëruar dhe prandaj puna e tij do të ishte madhështore. Në punën e tij kishte diçka nga madhështia e grekëve dhe e trojanëve, diçka nga funeralet homerike. O, si do të mbeteshin me gojë hapur shqiptarët, që mbanin kaq shumë ombrella në duar.

Gjenerali ktheu edhe një gotë. Dhe që atë natë e tutje, çdo ditë, çdo mbrëmje, atje larg në vendin e tij, të gjithë ata që prisnin, do të thoshin për të: Ai tani kërkon. Ne shkojmë nëpër kinema, në restorante, në kafe, ndërsa ai i bie kryq e tërthor tokës së huaj dhe kërkon. Kërkon, hap varre. Oh, punë të rënda ka, por ai do të dijë t'ia dalë mbanë. Jo më kot dërguan atë. Zoti e ndihmoftë!

(Romani: "Gjenali i ushtrisë së vdekur", Ismail Kadare).

ANALIZË



INTERPRETIM:

- Bashkëbisedoni në klasë rreth formave letrare: skica, tregimi, novela, romani... pastaj, tregoni veçoritë dalluese të tyre!
- Si ndikojnë pikëpamjet e shkrimtarit në shpalosjen e një ngjarjeje shoqërore përmes veprës së tij?
- Analizoni novelën "Oxhaku" dhe tregoni qëllimin e autorit!
- Zgjidhni një fragment të romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" dhe bashkëbisedoni rreth përmbajtjes së tij, stilit dhe personazheve!



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Përshkruani zanafillën e krijimit epik dhe veçoritë e tij?
- Cilat janë llojet e krijimit epik dhe shpjegoni ato?
- Çka është romani, novela e skica, si përkufizohen ato?
- Përshkruani karakteristikat e temës dhe idesë në veprën epike!
- Si frymëzohet krijuesi epik, ku e gjen lëndën e krijimtarisë së tij?
- Çfarë është kompozicioni?
- Çfarë është romani, përshkruani elementet formuese?
- Si krijohet skica dhe si tregimi, ilustroni me shembuj!
- Sa është i rëndësishëm angazhimi i shkrimtarit në jetën shoqëro-politike në interes të atdheut?
- A e ka arritur këtë Mihail Grameno përmes novelës "Oxhaku"?



SPROVË LETRARE:

- Bëni një provë individuale, duke krijuar shembuj të ngjashëm të krijimeve epike!
- Përshkruani përse këto forma letrare vlerësohen si krijime artistike dhe ngjarje reale të kohës, njëkohësisht!
- Si e ndërton shkrimtari portretin e plakës Nicë dhe të gjeneralit?

MITI

Epika gojore, në formën e saj të shprehur përmes letërsisë, përfshin një gamë të gjerë të shprehjeve artistike, duke përfshirë epikën legjendare dhe historike, si dhe prozën gojore. Në prozën gojore dallojmë disa forma të shprehjes: përrallat, fabulat dhe anekdotat. Këtu përfshihen gjithashtu edhe fjalët e urta dhe gjëgjëzat, të cilat shpesh lidhen edhe me poezinë.

Botëkuptimi ndaj jetës dhe natyrës dhe marrëdhëniet shoqërore të njerëzve në kohën antike kanë ndryshuar rrënjësisht prej marrëdhënieve dhe botëkuptimit të njerëzve të epokave të mëvonshme.

Mendimi mitologjik i popujve të lashtë gjeti shprehje edhe në artin e tyre. Duke mos i njohur mjaftueshëm ligjet dhe dukuritë e ndryshme të natyrës, ata, hyjnitë dhe perënditë e kohës antike i paraqisnin si njerëz të rëndomtë, përpos që ishin më të mëdhenj e më të fuqishëm dhe ua atribuonin pavdekshmërinë.

Me fjalën **mitologji** kuptojmë historinë përrallore të hyjnive, gjysmëhyjnive dhe heronjve të kohës së lashtë.

- **Miti** është lloj i veçantë i krijimtarisë gojore popullore, rrëfenjë për qenie të mbinatyrshme, për heronj legjendarë, për ngjarje a dukuri të çuditshme, ku pasqyrohen parafytyrimet primitive të njerëzve për prejardhjen e botës e të jetës mbi tokë, për natyrën dhe shoqërinë, rrëfenjë e trilluar, për diçka që nuk ka qenë e nuk është e vërtetë.

Imagjinata është proces psikik që ka të bëjë me aftësinë e vetëdijes së njeriut në ndërrimin, përtërirjen dhe gërshtimin e përfytyrimeve të mëparshme, duke i kthyer ato në përfytyrime të reja.

“Teoria e letërsisë”, G. Luboteni

- **Legjenda** është rrëfim (tregim) i shkurtër popullor që flet për një ngjarje ose figurë historike mbështetur në imagjinatën e popullit, por me nuanca vërtetësie.

Përmbajtja e legjendave reflekton në një nivel psikologjik, që simbolikisht përfaqëson besimin popullor dhe përvojat kolektive, në shërbim të vlerave të zakonshme të traditës. Rrëfimet, në këtë zhanër, përshkruajnë vlera e cilësi njerëzore, të cilat i japin vërtetësi rrëfimit të ngjarjes, edhe pse ajo përmban elemente fantastike.

Legjendat, sipas tematikës janë dy llojesh: me përmbajtje **mitologjike** dhe **historike**. Ato dallohen nga mitet, pasi kanë të bëjnë me qeniet njerëzore si personazhe kryesore dhe jo perënditë dhe nganjëherë në atë që kanë një lloj baze historike.

Vëllezërit Grim e përkufizuan legjendën, si: *“përrallë të bazuar historikisht”*.

Legjendat shqiptare më të përhapura janë: “Gjergj Elez Alia”, “Besa e Konstandinit”, “Aga Ymeri” etj.

- **Përralla** është tregim i shkurtër, i cili i përket zhanrit folklorik, ku përshkruhen ngjarje të trilluara që zakonisht paraqesin magjepsje dhe qenie mitike ose fantastike. Ato dallohen nga tregimet e tjera popullore, duke mos u bazuar në vërtetësinë e ngjarjes, por në fabulat e kafshëve.

Përrallat zakonisht nuk përmbajnë më shumë se të dhëna sipërfaqësore për njerëzit, vendet, ngjarjet, botëkuptimet, fenë dhe as saktësinë kohore, por zhvillohen **“një herë e një kohë”**. Në mënyrë bisedore, termi “përrallë” mund të nënkuptojë çdo histori të largët pa elemente vërtetësie. Përderisa legjendat perceptohen si reale brenda kulturës së tyre, përrallat mund të shkrihen në legjenda.

Përrallat janë tregime popullore të përfshira me elemente mitologjike, të cilat lidhen me tre faktorë kryesorë: **personazhin, vendin dhe ngjarjen e caktuar**. Këto tregime kanë origjinë të hershme, të cilat dëshmojnë nga fryma mitologjike dhe fantastike që i karakterizon. Ato u krijuan në një kohë kur njeriu pësonte shumë nga fenomenet natyrore: tërmetet, përmytjet, thatësiat, epidemitë dhe fatkeqësitë, pa e pasur mundësinë t'i kuptonte shkaqet e tyre. Më vonë, shoqëria u bë një faktor shkatërrues, duke shfaqur forma të shtypjes dhe padrejtësisë që ua privonin njerëzve lirinë, jetën dhe lumturinë prandaj, thelbi i përrallave është lufta e së mirës kundër së keqes, qoftë natyrore apo shoqërore.

Personazhet në përralla janë të ndarë në dy kategori të qarta: **të mirët dhe të këqijtë**. Ata pozitivë, mbajnë cilësi të pandryshuara nga fillimi deri në fund, të tilla si guximi, trimëria dhe mençuria, ndërsa ata negativë karakterizohen nga frika, pasiguria, egërsia dhe arroganca. Midis këtyre personazheve zhvillohet një luftë e përhershme, e cila përfundon gjithmonë me triumfin e së mirës dhe së drejtës. Personazhet pozitive shërbejnë si simbole të virtyteve, ndërsa ato negative përfaqësojnë intrigën dhe ligësinë. Hiperbola dhe personifikimi janë figura të shpeshta që i bëjnë këto tregime më të pasura. Përrallat kanë një rëndësi të madhe edukative, duke i mësuar lexuesit se si të luftojnë për të mirën dhe ta kundërshtojnë të keqen.

- **Fabulat** janë të shkurta si përralla apo tregimi, të shkruara në vargje dhe më rrallë në prozë, me përmbajtje edukuese. Ky zhanër ka si personazhe më së shumti kafshët.

Fabulat janë një formë e prozës gojore, ku personazhet janë kafshë ose bimë, të cilat sillen si njerëz. Këto tregime ofrojnë mësimet morale për sjelljen e duhur, duke promovuar vlera si e vërteta, drejtësia dhe virtyti dhe duke kritikuar të këqijat si gënjeshtria, egoizmi dhe arroganca.

Për shembull: *luani simbolizon një tiran, ndërsa bleta e përfaqëson punëtoren e zellshme.*

Fabulat janë të thjeshta dhe të kuptueshme, me një gjuhë të pasur figurative.

Fabulisti i parë, qysh nga antikiteti grek, njihet **Ezopi**. Ai jetoi në shekullin e VI p. e. r. dhe studiuesit e përshkruajnë se “*vetë qenia e tij është fabul*”. Ezopi, nuk është artist që e kultivon fabulën si një gjini letrare, por e përdor atë nëpërmjet veprimtarisë shoqërore, pasi me rrëfenjat e tij kërkon të ndikojë në jetën e popullit, ku kafshët përfundimisht e fitojnë vlerën e simbolikës së tyre si përfaqësues të virtyteve e të metave njerëzore.

- **Anekdotat**, në kulturën shqiptare, janë një formë e rëndësishme e trashëgimisë gojore të përdorura shpesh për të përçuar mençuri popullore përmes shakave ose ndodhive të mençura. Janë tregime të shkurta që e përdorin humorin dhe satirën për t'i kritikuar të metat e njerëzve. Ato shpesh përqendrohen në figura të njohura ose në tipare negative të përgjithshme, duke vënë në pah padrejtësitë shoqërore ose veset e këqija si koprracia, mendjelehtësia dhe gënjeshtria.

***Shembuj të dhënë nga: legjenda, përralla, fabula, anekdota.**

Legjenda e Rozafës

(fragment)

Motit të motit, tre vëllezër vendosën të ndërtonin një kala në majë të një kodre, pranë qytetit të Shkodrës, aty ku bashkohen lumenjt Buna, Drini dhe Kiri. Ata punuan gjithë ditën, por kur vinte nata, gjithçka që kishin ndërtuar rrëzohej. Kështu ndodhi për tri net me radhë.

Të dëshpëruar, ata kërkuar ndihmën e një plaku të urtë. Plaku tha:

- kjo kala nuk do të qëndrojë në këmbë, po nuk flijuat një qenie të gjallë në themelet e saj. Duhet të muroni gruan e njërit prej jush, por pa ia treguar asaj qëllimin.

Vëllezërit ranë dakord që, të nesërmen në mëngjes, të murosej ajo grua që do t'u sillte e para bukën. U betuan që të mos i tregonin askujt për marrëveshjen.

Të nesërmen në agim, erdhi gruaja e vëllait më të vogël - ishte Rozafa. Në duar mbante bukën dhe djathin, dhe fëmijën e saj të vogël e kishte lënë në djep, në shtëpi.

Kur pa që burrat ndaluan punën dhe fytyrat u mbushën me trishtim, Rozafa kërkoi të dinte ç'kishte ndodhur. Kur ia treguan të vërtetën, ajo nuk bërtiti, as nuk qau. Veçse tha:

- Nëse ky është fati im, e pranoj. Por kam një lutje: kam një djalë të vogël në djep. Ju lutem, lëmë një sy jashtë që ta shoh, një dorë që ta përkund, një gji që ta ushqej, dhe një këmbë që t'i dal përpara kur të qajë.

Vëllezërit e dëgjuan me lot në sy. Ashtu bënë: ngritën muret rreth saj, duke lënë jashtë gjërat që kërkoi.

Plaku dhe djali

(përrallë)

Ishte njëherë një plak i urtë dhe kishte një djalë të vetëm. Një ditë, plaku u sëmur rëndë dhe i tha djalit:

-Biri im, s'kam pasuri me të lanë, por kam një këshillë: kurrë mos e jep fjalën pa menduar, e kurrë mos gjyko vetëm me atë që sheh.

Pas pak ditësh, plaku vdiq. Djali e mbajti në mend porosinë, por jeta e shtyri të endet për të kërkuar punë.

Një ditë, në një fshat të largët, ndodhi një zënkë: një tregtar tha se një bari ia kishte vjedhur një qyp me florinj, që ia kishte dhënë për pak kohë ta ruante. Barinjtë ishin të varfër, dhe djali që e kishte dëgjuar zënkën, kërkoi të gjykojë vetë çështjen.

Ai tha:

-Sillma qypin që thua se ishte me flori.

Kur ia sollën, ai e hodhi në ujë. Qypi lundroi.

Djali tha:

-Ky s'ka qenë me flori. Po të ishte, do të fundosej. Tregtari gënjen!

Të gjithë u habitën dhe e lavdëruan për mençurinë. I zoti i fshatit e mori afër vetes si këshilltar, dhe djali u bë i nderuar për urtësinë e tij.

Dhelpra dhe rrushi

(fabul)

Një dhelpër e uritur, duke shëtitur në një vreshtë, pa një hardhi me rrush të pjekur lart në një degë. U përpoq të hidhej për t'i kapur, por nuk ia arriti. U përpoq prapë, u ngrit në këmbë, por rrushtë nuk i arrinte dot.

Kur pa që nuk mund t'i merrte, tha me vete:

-S'paskan qenë as të pjekur mirë! Janë të thartë!

Dhe u largua e zemëruar, duke bërë sikur nuk i donte.

I dituri

(anekdotë)

Njëherë, në një fshat, u mbledhën burrat e urtë për të zgjedhur një njeri që do t'i përfaqësonte në qytet. U ngrit njëri dhe tha:

-Duhet me zgjedhë njeriun ma të ditur!

Tjetri tha:

-Jo, duhet me zgjedhë njeriun që punon ma shumë!

U ngrit një plak i mençur dhe tha:

-Po i zgjodhëm vetëm të diturit, do na lodhin me llafe; po i zgjodhëm vetëm punëtorët, s'kanë kohë me mendu! Duhet një, që din e punon - se veç dija pa punë, e puna pa mend, s'çojnë kurrkund!

Legjenda e Rozafës tregon për ndërtimin e kalasë së Shkodrës, muret e së cilës rrënoheshin çdo natë. Një plak i urtë u tha tre vëllezërve se kalaja do të qëndronte vetëm nëse flijohej njëra nga gratë e tyre. Dy vëllezërit e mëdhenj e thyen besën, ndërsa më i vogli e mbajti. Gruaja e tij, Rozafa, pranoi të flijohej për të mirën e familjes dhe të vendit. Ajo kërkoi që t'i lireshin jashtë murit, njëri gji, një dorë, një këmbë dhe një sy, që të mund ta ushqente, përkëdhelte, përkundte dhe shihte foshnjën e saj. Pas flijimit të saj, kalaja u ngrit dhe mbeti e qëndrueshme.

Legjenda e lartëson besën, sakrificën dhe dashurinë e nënës, duke u bërë një nga krijimet më të njohura të trashëgimisë sonë popullore.

Mesazhi:

Besa, sakrifica dhe dashuria e nënës janë vlera që i japin kuptim dhe qëndrueshmëri jetës dhe shoqërisë. Vetëm me ndershmëri, besnikëri dhe përkushtim mund të krijohen vepra që mbeten ndër breza.



ANALIZË



INTERPRETIM:

- Çka dini për legjendat shqiptare?
- Interpreti gojarisht ose përshkruani (në fletore) ngjarjen e legjendës!
- Kush i ktheu rrjedhat e jetës në këtë ngjarje?
- Çka simbolizon Rozafa, vini në pah disa cilësi të saj?
- Çka përfaqëson urtia (i dituri - plaku i mençur) në tregimet popullore shqiptare?
- Pse vëllai i vogël karakterizohet me besnikëri dhe besë?
- Cila është porosia e legjendës?



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Pse Rozafa u bë simbol i flijimit?
- Cila ishte kërkesa e saj para muosjes, portretizoni figurën e saj si nënë!
- Njeriu i mençur a duhet të gjykojë me nxitim?
- Tregoni një përrallë nga treva juaj?
- Pse njeriu i paafte shpesh e përçmon atë që nuk e arrin?
- Sa janë edukative fabulat, rrëfeni një fabul që dini!
- Pse dituria dhe puna duhet të jenë në bashkëveprim?
- Përshkruani disa veçori të anekdotave, si rrëfenja edukuese!
- Nënvizioni: personazhet, fabulën, temën dhe idenë në këto krijime epike!
- Përshkruani qëndrimin e tre vëllezërve!
- Shkruani diçka të ngjashme dhe bëni krahasime midis tyre!
- Përshkruani dallimin midis legjendës, përrallës dhe fabulës?
- Gjeni elementet fantastike dhe tregoni karakterin mitologjik të krijimeve epike?



SPROVË LETRARE:

Temat:

- “Porositë e të mençurve janë pasuria më e madhe”!
- “Flijimi është i patjetërsueshëm për të ngritur diçka të rëndësishme e të dobishme në jetë”!

DRAMATIKA, VEÇORITË DHE LLOJET

Poezia dramatike është ndër krijimet më të lashta, pasi nismën e saj e gjejmë qysh te këngët korale. Në shoqëritë e hershme njerëzore, kjo lloj poezie ka pasur lidhje të ngushtë me teatrin dhe është interpretuar në formë lojërash skenike për shfaqjen e ndjenjave dhe në nderim të hyjnive (recitime himnesh e lutjesh), në këtë mënyrë duke i vënë themelet e artit dramatik.

Prejardhja e poezisë dramatike është në antikitet, ku edhe gjenden ngjarje e veprime që lidhen me fatin e individit dhe ritualet kolektive. Në njohuritë e hershme të lidhjes së njeriut me perënditë janë shënuar ngjarje të veçanta, siç është ajo për Dionisin - perëndinë e natyrës (ringjalljes së tokës në pranverë dhe të verës - hardhisë së rrushit). Festat ishin shumë të njohura dhe organizoheshin në stinën e pranverës. Ato interpretoheshin në formë të lojërave, kur njerëzit festonin dhe argëtoheshin nëpër rrugë, të maskuar si cjep ose dema, me ç'rast kryenin rituale për të përjetuar lidhjen me natyrën dhe perënditë.

Sipas mitologjisë, Dionisi (një gjysmëperëndi), pasi u kishte treguar njerëzve fshehtësi të perëndive dhe përndiqej nga Hera (gruaja e Zeusit), ishte shndërruar në cja për të shpëtuar nga rreziku. Kjo festë simbolizonte linjën e jetës dhe të vdekjes; pranverën dhe ripërtërirjen e natyrës, ku cja - përfaqësues i pjellorisë, vera dhe rikthimi i perëndisë në jetë janë figura qendrore në këtë ritual që dëshmonin për ciklin e natyrës: jetë - vdekje - ringjallje. Në këto raste, njerëzit këndonin këngë plot gëzim, të quajtura **ditirambe**, përmes të cilave i shprehnin vështirësitë dhe gëzimet e jetës.

Vuajtjet e Dionisit, gjatë përndjekjes, interpretoheshin nga Korifeu-udhëheqësi i korit dhe nga ky përshkrim në formë dialogu u krijua tragjedia, ndërsa nga shfaqjet dhe argëtimi i njerëzve nëpër rrugë, nga veshja dhe mënyra qesharake e interpretimit u krijua **komedia**.

Vepra dramatike është ndërlidhje e veçorive karakteristike të poezisë lirike dhe epike e krijuar për t'u vënë në skenë, gjë që e lidh ngushtë me artin skenik ose teatrin. Në këto vepra, ngjarja jetësore paraqitet me veprimet dhe dialogët e personazheve që ngjiten në skenë dhe veprojnë përmes interpretimit artistik. Shprehjet: veprim dhe vepër e krijojnë "dramën".

Drama është gjini e letërsisë artistike që e pasqyron jetën përmes veprimit skenik të personazheve dhe të dialogëve e monolëgëve të tyre. Ajo përfshin: **dramën** (vepër me karakter serioz), **tragjedinë** (vepër me karakter tragjik) dhe **komedinë** (vepër me karakter komik-qesharak).

Subjekt trajtëse e dramës janë kundërthëniet jetësore që zhvillohen me anë të dialogëve të personazheve, të cilët prekin thellë me interpretimin e tyre dhe synojnë gjithmonë një zgjidhje. Në të kaluarën, drama duhej të përmbushte tre elemente të domosdoshme: njësinë e veprimit, të kohës dhe të vendit, të cilat realizoheshin në skenë nëpërmjet aktorëve, sipas pikëpamjeve të regjisorit, skenografit dhe kostumografit.

Kompozicioni i veprës dramatike përbëhet nga pesë elemente:

- **Parashtrimi - ekspozicioni** (lat. - exposition) që në fillet e dramës njëhej si prolog (paralojë), pjesa hyrëse në një vepër letrare që e lidh lexuesin me temën e veprës;
- **thurja-kolizioni** (lat. - collision) pra ndeshja, përballja, kundërshtimi i personazhit kryesor me personazhet tjera;
- **kulminacioni** - arritja e pikës kulmore të ashpërsisë së konfliktit dramatik;
- **peripecia**- paralajmërimi i mbarimit të dramës, fitorja (triumfi) ose humbja e personazhit kryesor;
- **zgjidhja - shthurja (epilogu)** pjesa përmbyllëse (përfundimtare) e problemit apo subjektit të veprës letrare.

Vepra dramatike, me kalimin e kohës e pasuroi letërsinë, duke u bërë ndër gjinitë më të rëndësishme të saj. Ajo ka gjithmonë karakter të gjallë dhe konkret ku gjithçka përjetohet përmes artit skenik.

Skena është pjesë e ngritur e teatrit, ku luajnë aktorët a valltarët; tërësia e dekoreve që paraqesin vendin ku zhvillohet veprimi i një pjese teatrale.

Dramaturgu është autori i veprës dramatike që krijon dialogë mes personazheve për të ndërtuar situata të forta dramatike, plot tension dhe ndonjëherë edhe komike ku gjithçka sillet rreth një ngjarjeje qendrore. Ai e përgatit tekstin, bazuar në parime të mirëfillta artistike dhe poetike, gjë që e vë në lëvizje tërë mekanizmin e teatrit. Personazhet janë bartës të veprimit, të ndjenjave dhe të konfliktit. Përmes tyre zhvillohet ngjarja, që perceptohet si një realitet i drejtpërdrejtë nga publiku.

Vepra ndahet në akte dhe secili akt përmban një seri skenash që fillojnë me hapjen e perdes dhe mbylljen e saj. Ngjarjet zhvillohen përmes bisedave dhe dialogëve midis personazheve. **Heroi kryesor**, shpesh shfaqet edhe përmes monologëve, duke folur drejtpërdrejt me publikun për ndjenjat dhe mendimet e tij, do të thotë se përqendrohet në një ngjarje të vetme, që zhvillohet në periudhë të shkurtër kohore dhe ndodh në një vend të vetëm. Shekspiri, është i pari që i theu këto rregulla, duke i dhënë hapësirë veprimit që shtrihet në kohë dhe vend të ndryshëm, gjë që më vonë u bë normë në dramaturgjinë botërore.

Vepra dramatike vepron mbi shikuesin me një fuqi të madhe dhe zgjon në vetëdijen e tij gjithfarë mendimesh dhe ndjenjash, e përmes idealit estetik të autorit e edukon, ia zgjeron horizontin e dijes dhe ia fisnikëron ndjenjat.

LLOJET E VEPRËS DRAMATIKE

Si lloje të veprës letrare njihen: tragjedia, komedia dhe drama.

Nga koha e antikitetit, si forma të lashta të interpretimit të ngjarjeve me anë të personazheve, njihen tragjedia dhe komedia, ndërsa drama zhvillohet më vonë në letërsinë evropiane, veçmas pas mesjetës dhe vazhdon të jetë ndër llojet dramatike më të rëndësishme në letërsi.

- **TRAGJEDIA** rrjedh nga fjala greke “tragos”, që do të thotë cjac. Si një nga gjinitë më të lashta, e ka prejardhjen nga festat e organizuara në nderim të perëndisë Dionis, ku përfshiheshin këngë rituale që simbolizonin përballjen e njeriut me fatin, shpeshherë me fund të dhimbshëm.

Subjekti i tragjedisë u ndërtua mbi bazën e këngëve dhe motiveve folklorike, por më pas u zhvillua në një formë të përpunuar letrare, që përfshinte aktorët dhe korin dhe i komentonte veprimet. Shpesh, këto tema merreshin nga mitet, përrallat dhe rrëfimet heroike, të cilat përçonin mesazhe të thella për jetën, vdekjen, nderin dhe drejtësinë. Tragjeditë trajtonin konflikte të mëdha midis individit dhe forcave të jashtme, si: fati, hyjnitë apo shoqëria dhe përballjen e individit me veten në çaste vendimtare.

Qëllimi i tragjedisë, nuk ishte thjesht të tregonte një ngjarje, por të zgjonte ndjenja të fuqishme te njerëzit, duke nxitur te ata përjetime të frikës dhe mëshirës që i shtynte drejt pastrimit shpirtëror, proces i njohur si katharsis.

Tragjeditë janë shkruar në vargje dhe në prozë, me një gjuhë të zgjedhur e stil të lartë.

Tragjediani më i njohur është Eskili, i cili trajtoi një shtrirje të madhe tematike, sikurse edhe Shekspiri në kohën e tij.

Thellësia e konfliktit në tragjedinë “Hamleti” shfaq realitetin e hidhur në një mbretëri e shoqëri pa vlera morale. Me shqipërimin e Fan Nolit, njihet detyra e vështirë e Hamletit që kishte jetuar midis librave, studimeve dhe arteve të bukura, si princ i përkëdhelur, bir i një mbreti heroik e që tani përballlej me anën tjetër të medaljes, me vrasjen, dyftyrësinë, intrigën... ndërkohë që ai nga maja e fronit kishte parë vetëm lumturi, bukuri dhe madhështi.

***“Kjo bot’ u çthur! O prapësi o dreq,
Që unë paskam lindur të të ndreq!”***

Zbulimi i ngjarjes dhe intrigës, përmes demaskimit të dy personave më të dashur për të, si e ëma dhe i ungji, që ishin shkaktarë për vdekjen e babait, është zhgënjimi më i madh i Hamletit.

Monologu dhe dialogu, si forma rrëfimore mjaft intensive janë fuqia shprehëse e tërë ngjarjes.

Monolog quhet biseda, të cilën e zhvillon personazhi kur flet me veten (shfaqja e unit personal).

Monologu, sado që nuk është ndonjë trajtë e zakonshme e ligjërimit të njeriut, sërish shkrimtarët e përdorin në rastet kur personazhi e ka të nevojshme për ta shprehur atë që e ndien dhe mendon (në rastet kur nuk mundet t'ia hapë zemrën gjithkujt). Ja, si në rastin kur Ofelia flet me veten, pasi Hamleti e qorton rëndë dhe i thotë se nuk ka ndërmend të martohet me të.

* * *

Oh, çfarë mëndj' e lartë u përmbys këtu!
Oh, çfarë sy e çfarë gjuh' e shpatë
Ushtari, oborrtari dhe shkollari,
Q'ish trendafil e shpres' e shtetit bukur,
M'i pam' i pamësve, krejt, krejt përdhe!
Dhe unë, gruaja m'e mjer' e botës,
Që ia thëthita mjaltën e muzikën
Nga dashuri' e zemrës, po ia shoh
Bujarën e sovranën sqojtësi
Si zile t'ëmbël të rrëzuar poshtë
Që krisi, u çtingëllua dhe u ngirr.
Këtë fytyr' e lul' e trim pa shoq
Q'u thurr nga marrësia! Mjera unë, oh!
Që pash' ato që pash' e shoh ato që shoh!

(Tragjedia: "Hamleti", Shekspiri).

Dialog quhet biseda që zhvillohet midis dy ose më tepër personazheve.

* * *

Bankua: Or bir, sa është ora vallë?
Fleanci: ka perënduar hëna, po s'dëgjova
Sahatin të trokasë.
Bankua: po hëna perëndon më dymbëdhjetë.
Fleanci: Pra, do të jetë doemos më vonë.
Bankua: Na, mbajma shpatën - Qielli bën kursime;
E shoj kandilin. Merre dhe këtë
Qepallat, gjumi m'i rëndon si plumb,
Po prapë s'dua të kaloj të fle.
Fuqi mëshirë-plotë! Mbytmiiini
Mejtimet e mallkuara të zeza,
Që na lëshon natyra nëpër ëndërr.

(Tragjedia: "Makbethi", Shekspiri).

Në letërsinë shqipe, tragjedia përfaqësohet me poetët dhe dramaturgët si Çajupi me “Burri i dheut” dhe Mihail Grameno me “Vdekja e Pirros”, ndërsa më vonë, në kohën e dy luftërave botërore do të dallohet Ethem Haxhiademi, me veprat: “Uliksi”, “Akili”, “Abeli”, “Aleksandri”, “Pirrui”, “Diomedë”, “Skënderbeu” të cilat trajtuan tema kombëtare e historike me pathos të theksuar.

Tragjedia, ndonëse në formë të shkurtër apo të gjatë, mbetet një nga format më të fuqishme të shprehjes artistike. Ajo është shkruar për t'u interpretuar në skenë, por ndikimi i saj shpesh e tejkalon atë hapësirë, duke mbetur e gjallë në ndërgjegjen e lexuesit apo shikuesit.

ANALIZË:

*Lexoni fragmentin e tragjedisë “Hamleti” të Shekspirit dhe përshkruani përjetimet e princit Hamlet pas zbulimit të vrasjes së babait!

- **KOMEDIA**, sikurse tragjedia, është lloj i lashtë i gjinisë dramatike, i njohur qysh në kohën e antikitetit. Rrjedh nga fjala greke **komedios** - lojë argëtuese, zbavitëse që lidhej me këngët dhe vallet rituale, të cilat luheshin në nderim të Dionisit, perëndisë së verës e të gëzimit. Në fillim, komedia kishte **karakter zbavitës** e më vonë mori edhe **karakter shoqëror**.

Skena komike realizohej nga aktorë të maskuar (**comos** - të veshur në mënyrë qesharake), të cilët interpretonin këngë kushtuar Dionisit dhe ripërtërirjes së pranverës dhe shoqëroheshin me gosti, ushqime e pije... pra me këngë gaztore dhe shpoti.

Qëllimi kryesor i komedisë ishte që ta zbaviste publikun, ndërsa më pas edhe ta edukonte, duke vënë në pah të meta apo dukuri negative, si: dyftyrësia, gënjeshtria, xhelozia, koprracia, mendjelehtësia etj. Është gjini letrare që karakterizohet me shpalosjen e situatave të përditshme në mënyrë humoristike, shpesh me një fund të lumtur. Në këtë mënyrë argëtohej publiku, veçmas kur dëgjonte barsleta dhe shaka, nëpër festat e rrugëve dhe shfaqje të improvizuara.

Komedia përshkruan edhe histori dashurie ose konflikte familjare, kurse personazhet ishin përgjithësisht të klasës së mesme ose të ulët. Më vonë, komedia u zhvillua në teatrin romak dhe gjatë mesjetës dhe rilindjes, dramaturgët evropianë shkruan shumë komedi.

Analizë e shkurtër e komedisë “Pas vdekjes”, e Andon Zako Çajupit

Komedia “Pas vdekjes” e Andon Zako Çajupit është libër i komedisë së zezë, i shkruar në vitin 1902 dhe e botuar në vitin 1910.

Është një vepër satirike që i kritikon zakonet dhe besëtytnitë shqiptare rreth vdekjes dhe jetës pas saj. Ngjarja tregon fatin e shpirtit të njeriut pas ndarjes nga jeta, përmes një satire të thellë, që përballë gjykimit hyjnor vë mëkatet dhe virtytet njerëzore.

Kjo është një dramë që i vë në lojë personazhet, karakterin dhe veset e tyre. Përmes një ndodhie imagjinare në botën e përtejme, autori shfaq një panoramë qesharake të hipokrizisë dhe interesave personale që mbizotërojnë edhe pas vdekjes.

Personazh kryesor është doktor Adham-Uti, që është i dashuruar me Lulushen, një vajzë të re të martuar me një tjetër. Personazhet janë tipike për realitetin dhe kohën e ngjarjes. Marrëzia e doktorit shkon deri në atë pikë, teksa mendon se ka gjetur një ilaç që mund t'i ringjallë të vdekurit dhe do ta përdorë për të sjellë sërish në jetë Lulushen, pasi ajo vdes nga një sëmundje. Ai nuk e di se Lulushja nuk dëshiron të kthehet në jetë me Adham-Utin. Përgjithësisht, personazhet bëhen “viktimë” e interesit vetjak.

Me një stil të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, Çajupi përdor ironinë për të nxjerrë në pah sjelljet absurde të njerëzve, duke nxitur reflektim mbi vlerat e vërteta të jetës.

Drama është një kritikë e ashpër e shoqërisë së kohës që ishte e prapambetur dhe e sunduar nga traditat dhe paragjykimet dhe paraqet një përballje të fortë midis moralit të pastër dhe atij të shtirur. Kjo komedi, megjithëse e shkurtër, bart një mesazh të fuqishëm për moralin dhe shoqërinë.

Pas vdekjes
(fragment)

VETA

ZONJËZA LULUSHE, mësuesja për çupa.

ZOTI ADHAM-UTI, shëronjës, shkronjëtar.

ZOTI VURKO, gazetë-shkronjës

ZENELI, shërbëtor i Klubit Selanikut, nën kriesi të Shëndo beut, drejtor i "lirisë", gazetë e xhon - turqvet.

Ndë Klub të Shqiptarëve të Selanikut, mbë 1910.

PUN' E VETËME

I

ZENELI, ADHAM-UTI

(Ryjnë bashkë nd' odë të Klubit ku gjënden do karreklla, një truezë në mes ngarkuar me gazeta, me dorë-shkrime. Më të djathtë, një dollap, më të mëngjër, një telefon në mur).

(ADHAM-UTI *(me zëmërim)*): Çudë! S'mund të marr vesh! Yt zot, Kryetar i klubit, më dha fjalë të piqemi këtu me 8 pas dreke, dhe ti më thuaj që s'ka dhe ardhë! I the, bre, se kush jam unë? a i tre-gove që jam unë, doktor Adham-Uti që po rri e pres?...

ZENELI *(duke qeshur nën buzë)*: Doktor efendi, nuk' i thashë gjësend beut se s'është këtu sot!

ADHAM-UTI: dreqi të martë!...

ZENELI: Qysh? mos e thuaj prapë këtë fjalë se..

ADHAM-UTI: Ma paske gjuhnë si bilbil!

ZENELI *(me vetëhe)*: Qënka i çmëndur!

II

ADHAM-UTI, VURKUA, ZENELI

VURKUA *(duke rytur me rëmbim)*: Zenel, a erdhi Skëndo-beu?

ZENELI: Jo! zoti Vurko, po s'besoj të mënojë. Prit pakëz në mos ke punë.

VURKUA *(duke ndëgjuar)*: Do t'a pres të vijë.

ADHAM-UTI *(madhështor)*: Dotë rri dhe pakëz si-do që kam punë shumë!

VURKUA *(në vesh të Zenelit)*: Kush është ky?

ZENELI *(duke folur fort)*: Si! S'e njojtke, a? zotënia është A-dha-mu-ti! nga Frashëri, nga katund' i Naim beut dhe...

ADHAM-UTI *(i pret fjalën)*: Naimi ishte nga katundi im! msou të flaç!...

ZENELI *(duke qeshur nën buzë)*: Më ndje, zotëni, po... *(duke ulur kryet)* më ndje, doktor Adham-Uti!

VURKUA *(duke qeshur)*: Lot a qesh, o Zenel? Ç'farë emër ky, më qafsh?

ADHAM-UTI *(i vërenjtur)*: Duket s'të pëlqen!

VURKUA *(me butësi)*: Jo, Zotëni fort i bukur, për besë! Adham-Uti yn' i pari dhe Uti - emër i dyt' i Udhisit, si thotë Omiri -.

ZENELI *(i habitur)*: A! se ç'do me thënë të jesh i ditur! Un' i gjori këtë emër e pandej Shqip... dhe duke me ditur se doktori është i Krishtënë po mendonëshë se ç'ditë luset Shënt Adham-Uti që të vejë t'a urojë dhe t'i thoshë: për shumë mot gëzuar!

ADHAM-UTI *(i rëndë)*: Si-do që duket ky emër *(këqyr Vurkon)* un'e kam nderuar!

ZENELI (*veshtron Vurkon*): Vërtet! vërtet! Zotënia është shëronjës i ndëgjuar!

ADHAM-UTI: Dhe shkronjëtor, vjershëtor! VURKUA (*duke unjur*): Tu ngjatë jeta, doktor Adham-Ui! besa gëzohem që të njohta sot zotërinë t'ënde! nder i math, për Zonë! Unë jam Vurkua, korespondent i gazetës "Rrufeja".

ADHAM-UTI: A! qënkej gazetar!

VURKUA: Ndaj të lutem të më thuash ç'mendonën njerst' e mëdhenj për Shqipërinë që të shkruaj në gazetën t'one.

ADHAM-UTI: Do-me-thënë, ti kërkon sot nga unë "interview"?

VURKUA: Po, zotëni, që ta botoj te "Rrufeja"¹.

ADHAM-UTI: Mos thuaj Rrufeja, po thuaj Rrufe! rrufe, rrufe; liri, liria dhe jo lirija! Dot' i them dhe Skëndo beut. Kjo gjuhë që përdorni ju sot s'është shqip! Pun' e gjuhës ka rënë ndë duart të liga dhe kurrë s'ka për të vatur mbarë!... Abetari që përdorni ju sot s'është për të qënë!...

VURKUA (*i mbirë*): Qysh! Po e ka vendosur Kongres' i Manastirit...

ADHAM-UTI (*me rrëmbim*): Kongres' i Manas-tirit! Ç'është Kongres' i Manastirit? Kush vate? a vajta unë?

VURKUA (*duke qeshur*): Pse s'vajte, or zot? ADHAM-UTI: A! a! Përpara më thoshe: doktor efendi! tani qënkam vetëm zot, se fola të vërtetën! Thash' ato që janë! dhe guxon të më kërkosh "Interview", Jo! jo! S'kam zakon unë të ap "interview", jo, për gazetën tuaj.

VURKUA: S'pandëjë kurrë... s'të dijë për armik të gazetavet!

ADHAM-UTI: Ja ku e msove tani! dhe thuaje të gjithë botë me anë të "Rrufesë", në ka njers të këndojnë të tillë fletë!... Këto janë fjalët e fundit!

VURKUA: Janë mjaft për t'u çuditur!

ADHAM-UTI (*me zemërim*): Pse për t'u çuditur? Fundi, fundi s'më dërsin veshi për botë, mua! Dreq of punë! Ndëgjjo: Ç'fitim do të kem unë kur të shkruash ti për mua: "Doktor Adham-Ui, shëronjës i çkëlqyer, që ka botuar kaqë vepra të bukura, që ka gjetur një bar të ri për ethet, një tjetër bar më të çuditshim, më të nevojshim, për gratë shterpa, ka sot gati për të botuar, një abetar fort të mbaruar për Shqipen me letra të ra, dhe për këtë abetar është munduar dhetë vjet dhe tre muaj? Gazetat, mua s'më rryjnë në punë! lëvduta nukë dua nga kurkush! po të kërkoj të tilla gjepura, mo zot dotë të marrë sot me të mirë dhe dotë të rrëfejë se për ç'punë kam ardhë sot te Skëndo beu... t'i tregoj vetëm këtë abetar dhe të msoj a mund të jet' i pëlqyer te xhon-Turqit, a u vjen mbarë që të përhapet dhe të përdoret ndë skolla të Shqipërisë; a duan të m'a blejnë; a mund të shpresoj nga Qeveria ndë Stamboll no-një punë të mirë për këtë shërbim të math! Skëndo beu më tha t'a sjell sot ndë klub abetarin t'a këqyrin bashkë me zonjëzën Lulushe q'është mësonjëse për çupa dhe po të jetë që t'a gjëjë kjo për mbarë, dota vërë përpara ndë skollë të çupavet; dhe m'u dorëzua për xhon-Turqit se dotë kënaqen tepër dhe diç dotë bëjnë për mua: mund që të më dërgojnë deputet ndë Stamboll!..

VURKUA: Po ky abetar pse dotë viret vetëm ndë skolla të çupavet?

ZENELI: Vërtet, pse?

ADHAM-UTI (*fodull*): Po s'e kupëtoni, a? VURKUA: Për syt' e ballit, jo!

ZENELI (*me gas*): Un' e gjeta! se çupat janë femëra, u pjell mëndja!...

ATHAM-UTI: Ç'del nga kjo gjë?

ZENELI: Qysh? janë më të zgjuara se nga djemtë dhe dotë nxënë më mirë abetarin... S'kam arrësye? S'është vërtet?

VURKUA: Si dy e dy bëjnë katrë.

ADHAM-UTI (*i rëndë*): U kripsha trutë!... shkak i vërtetë është ky: çupat bënen gra... dhe burrat bëjnë si thonë gratë... Për këtë send kam shkruar një libër të gjer' e të gjatë.

¹ "Rrufeja", gazette që dilte në Fajum të Egjiptit më 1909, nën drejtimin e Jani Vruhos (shën. ynë).

VURKUA: Ahere, zoteni, pun' e Abetarit është në dorë të zonjës Lulushe?

ADHAM-UTI: Edhe në dorë të Skëndo beut, se ky e ka fort mirë me xhon-Turqit; i ka miq me të Vërtetë.

VURKUA (*i habitur*): I ka miq

ADHAM-UTI: Prandaj, si të thashë, as pyes fare për njers të tjerë (dhe për lepushkat tuaja!...

VURKUA: As për "Bashkimin e Kombit"², as për "Diellin"?

ADHAM-UTI: Jo!

VURKUA: As për "Rrufenë", as për "Shkopin"³?

ADHAM-UTI: As pak!.. Mor zot, pse bën dëm fjalët? S'kërren dot fjalë nga unë... s'pres nder nga njeri kurrë... lëvdata s'dua! Si-do që të thonë, shëronjës si unë janë të rrallë: shëroj sy, veshë, hundë, duar, këmbë! Ç'do lëngatë druet nga unë!... Do të thuash që s'kam shumë "myshterinj"! Kurrë mos arçin! Lei të vuajnë! Kush u ka faj?

VURKUA: Po abetarin pse kërkon t'a sheq te xhon-Turqit? pse s'ja fal Shqipërisë?

ADHAM-UTI: Ah! ta fal!... Të vras mëndjen, unë! Të punoj dhetë vjet dit' e natë... dhe pastaj t'a fal!... dhe kujt? Shqipëtarëvet!... dhe të mos m'a dinë! sa vjet që punojnë Shqipëtarët për gjuhën shqip! dhe s'gjejnë dot një abetar për të qënë!... Unë vetëm e gjeta! dhe tek e kam ndë Xhep! Zonjës (Lulushe, në ka dy koqe mënd, dotë çuditet kur t'a këndojë! dotë lërë mëntë!...

VURKUA: S'ka dyshim! Dotë vijë dhe ajo sot këtu?

ADHAM-UTI: Posi, po! Skëndo beu më dha fjalën.

VURKUA: A e nje zonjës Lulushe?

ADHAM-UTI: Po si s'e njo! Tërvit kish t'ëmën me pak ethe. Për këtë lëngatë kam gjetur, si të thashë, një bar të çuditshim: Kush është për të shëruar shëronet, në mos po vdes në gjumë pa kupëtuar, pa u munduar aspak. Kështu pra, kur e piu e ëm' e Lulushe.

VURKUA DHE ZENELI (*bashkë*): U shërua!

ADHAM-UTI: Vdiq! vdiq në gjumë, si ç'keshë thënë!...

ZENELI: Bar' i mirë: një me një!...

ADHAM-UTI (*te Vurkua*): Këto janë, zotëni, veprat e mia! Lëviata s'dua! fjalët i merr era!... Punë, punë!... Ç'del nga gazetë? Kurrëgjë... Prandaj mos u mundo kot, mos humb kohën: nuk këren dot as një fjalë prej meje!

VURKUA (*duke qeshur pak*): Mjaft janë këto që fole, zotëni! Tani, t'u ngjatë jeta! lamtumirë, doktor efendi!.. (*del jashë me vrap*).

ADHAM-UTI (*me inat*): Ah! i mallëkuar më bëre të flas shumë! pa dashur të dhashë "interview"! po të mos më dalç përpara syve tjetër herë!

VI

ZENELI, PASTAJ ZONJEZA LULUSHE

ZENELI (*vetëm*): Adham-uti dotë kënaqet fort: ca njers, kur shonë gjë-send të shtypur, e quajnë të vërtetë, si ungjill e koran... i marroftë Zoti!... (*Zonjës Lulushe hyn duke thënë. Mirë dita Zenel!*).

ZENELI: Qofsh zonj' e madhe! im zot s'ka dhe ardhur, po rri t'a preç pakëz se mund të vijë. Dhe që të mos mërzitesh duke pritur, shko e rri pranë truezës dhe këndo do shkrime a gazeta, sa të ndërtoj pak odën.

ZONJA LULUSHE (*duke parë shkrimet, gjeti artikullin e Haxhi Aliut dhe briti*): Haxhi Aliu pa ska vdekur! fat ziu deputet! sa keq më vjen!

ZENELI: Mos të vijë kaqë rëndë zonjës, se kemi shpresë...

² "Bashkimi i Kombit", gazetë që dilte në Manastir (1909-1910) ndërsa „Dielli” zëvendësoi më 1909 gazetën "Kombi" që del edhe sot në Boston, nga Jani Vruho.

³ "Shkopi" gazetë satirike që dilte në Kajro, më 1907-8.

ZONJA LULUSHE: Shpresë! shëronjësit mos dot' a ngjallin përsëri!

ZENELI: A! në pritshin nga shëronjësit.

ZONJA LULUSHE: Po ahëre?...

ZENELI: Haxhi Aliu s'ka dhe vdekur!

ZONJA LULUSHE: Zoti e shpëtoftë! Burr' i mirë, si kam ndëgjuar të thonë. Po kur s'paska vdekur/ pse kini bërë këtë shkrim vdekje?

ZENELI: Se është në buzë të varrit dhe ja bë më gati jetë-shkrimin që të mos ndodhemi gafil kur të vdesë!

ZONJA LULUSHE: Po n'u shëroftë?

ZENELI: Ahëre shkrimi vlonet këtu bashkë me të tjerë dhe botonet kur t'i vijë sëral... Duet të dish, moj zonjëzë se njerstë me rëndësi, burra a gra qofshin, kanë këtu gati shkrimin për ditën e vdekjesë, si mbretret, mbretëreshat, deputenjtë... se nukë diet kur e përdredhin... bishtin!

ZONJA LULUSHE (*me zëmërim*): I bukur zakon ky? U hiqni të mbarën!

ZENELI: S'u bëjmë të keqe... i lëmë të vdesën kur të duan. Neve kemi detyrë të bëhemi gati që të mundim t'i lëvdojmë pas vdekjes.

ZONJA LULUSHE: Thuaj si të duash: nukë dolë më vinte mirë fare, unë gjall' e me të gjallë, të kem gati shkrimin e vdekjes?

ZENELI: Oh! për një grua si zotnin tënde, mos pande se im zot s'ka bërë gati një shkrim! ZONJA LULUSHE: Ka shkruar dhe për mua?

ZENELI: S'ka dyshim se nukë je e pakët... ZONJA LULUSHE (*me vetëhe*): Ç'mund të ketë shkruar për mua? më ka lëvdur? më ka sharë? Ç'mund të thonë për mua kur dotë mos jem në jetë? (*te Zeneli*): Beson ti Zenel se kanë shkruar dhe artiklin t'im që tani?

ZENELI: Në besoj, thotë! e di fort mirë... si bukën që ha...

ZONJA LULUSHE: Ndëgjo pra, të lutem!

ZENELI: Folë, zonjëzë, ç'urdhëron?

ZONJA LULUSHE: A mund të m'a tregosh?

ZENELI (*shtiret se s'kupëton*). Ç'të të tregoj?

ZONJA LULUSHE: Shkrimin e vdekjesë!...

ZENELI (*tund kokën*): Punë që s'bënet.

ZONJA LULUSHE: Pse?

ZENELI: Se dotë ndëgjoj fjalë të tharta!...

ZONJA LULUSHE: Të lutem, Zenel, për mua...

ZENELI: Kërko gjë-send tjetër, po këtë jo, kurrë! im zot dotë më kërrejë nga klubi! jo, jo!...

ZONJA LULUSHE: Qysh dot' a msojë? Vetëm t'a këndoij dhe pastaj vëre prapë ndë vend. Për këtë mundim ke pesë mexhite!

ZENELI: Pese mexhite, the? ndërron fjala! punë që bënet, paça Zonë!

ZONJA LULUSHE: Të lumtë! Më kënaqe! Tani vete me vrap të tboj qeren që më pret jashtë se sho një mike të sëmurë dhe ti kërko, kërko... mos humb kohën, më rrofsh! (*del*).

- **DRAMA** (greq.) dráma - “veprim” është gjini letrare, e cila pos epikës dhe lirikës është shtylla e tretë e letërsisë. Veprat dramatike njihen edhe si drama. Drama është teatër i shprehur me fjalë.

Me termin e përgjithshëm - **dramë** nënkuptojmë atë krijimtari letrare që shkruhet për t’u shfaqur në teatër. Për këtë arsye autorët i ftillojnë rregullat e saj të ngurta, pa zbatimin e të cilave ajo nuk mund të jetë e suksesshme në skenë. Drama është një nga gjinitë kryesore të letërsisë artistike dhe ashtu si përralla, tregimi, romani edhe drama ka një ngjarje kryesore.

Në kohët e hershme mbizotëronte shkrimi i dramës në vargje, por sot ajo shkruhet në prozë, pasi proza i ofron më shumë mundësi shprehëse se sa poezia. Tematika e dramës është e afërt me atë të prozës (temë historike, temë shoqërore, temë erotike, temë filozofike etj.). Në varësi të tematikës kemi disa lloje dramash: dramë historike, dramë shoqërore etj.

Konfliktet e dramës janë **konflikte të zakonshme**, të cilat dalin nga jeta e njerëzve.

Drama e parë origjinale e letërsisë shqiptare merret “Emira” (1885) e Anton Santorit. Ndër dramat e para, gjithashtu përmenden: “Besa” e Sami Frashërit, “Sofonisba” e Jeronim de Radës etj.

Pahintikë në ëndërr (fragment)

SKENA E PARË

Trëndelina, pastaj Barkshi.

(Trëndelina, vetëm, ulur në rrah, me kokë ulur përdhe, fytyrën e mban me të dy duart dhe dritat e purpurta i bijnë në teshat e saja të bardha. Dëgjohet një bisedë. Fjalët janë shumë të qarta, por duket se vijnë prej së largu).

Kutia muzikore që nuk duket

Tash vjen e bëhet gjithnjë e më e qartë biseda e inçizuar në kutinë muzikore, e cila nuk duket. Pastaj heshtje e pas saj përsëri muzikë e lehtë. Më vonë dëgjohet fare qartë biseda! Zëri i femrës thotë: »Kishte dhjetë vjet. Me flokë kaçurrela, me faqet si mollë dhe bërtiste: mos xhaxhi, mos... mos shtjer...« Zëri i mashkullit pyet: »Po a shtiu?« Zëni i femrës përgjigjet: »Po«! Zëri i mashkullit pyet: »Ç'ndodhi, pastaj?« Zëri i femrës përgjigjet: »Fëmija ra përdhe, pa frymë. Zëri i mashkullit nuk dëgjohet më. Dëgjohet vetëm muzika që vjen duke gumëzhuar më fort. Dritat fiken. Dëgjohet lehje e llahtarshme qeni dhe vaj i lemerishëm fëmije. Fashitet pastaj e tërë kjo dhe heshtja e terri marrin kuptimin e tyre. Dritat përsëri ndizen dhe rrezet bien në teshat e bardha të Trëndelinës që rri në mes të skenës. Zëri i femrës përsëri shpjegon »rrinin në verandë dhe ushtari e solli një zezak dhjetëvjeçar. Togeri, e shoqja me të dy vajzat që rrinin në verandë, qeshnin me zë. Pastaj togeri urdhëroi ushtarin: »Lëshoje le të rroket me Reksin. Ku është Reksi? Ej Reksi, Reksi... « dhe qeni i madh, me një halkë të bukur rreth qafe ia arriti me të shpejtë e iu sul fëmijës. Filloi lufta për jetën lakuriqe. Pas pak çastesh, fëmija u la në gjak. Qeni kafshonte dhe kafshonte, e në çastin kur dukej se jeta e fëmijës mori fund, zezaku i vogël i mblodhi të

gjitha fuqitë, u ngrit në këmbë, ia ngjiti për turiri qenit, ia përdrodhi kryet, e qeni ra i co të para këmbëve të tij. Instinkti dhe dëshira e madhe për jetë fituan. Togeri u çmerit. Nxori revolver, por fëmija ia dha këmbëve me të katrat, ndërsa togeri iu sul prapa. Kur e pa fëmija, filloi të bërtasë; mos, mos xhaxhi! Por togeri gjuajti. Fëmija ra. Togeri iu afrua dhe i zbrazti edhe plumbat tjerë në trupin e njomë të fëmijës.

Pastaj që të gjithë qeshën... «

(Në skenë ndizen dritat)

TRËNDELINA: Kush është? Cili flet kështu?

ZËRI I BARKSHIT: Unë!

TRËNDELINA: Kush?

ZËRI I BARKSHIT: Unë, unë! A nuk më njeh? (Trëndelina çohet në këmbë dhe kërkon nëpër skenë si e hutuar). Ja, po vij. Këtu jam (Barkshi futet në skenë). Eeee, bija ime e dashur, sa më ka marrë malli të të shoh. (Niset kah Trëndelina, kurse ajo sprapset si e frikësuar). Po, pse po ik, moj e uruar, a më paske harruar, ë? Po unë, jam moj, unë... Ja shikomë. Këmbë e krye jam unë vetë (Një çast kundrojnë njëri-tjetrin pa bërë zë. Heshtje). Erdha prej Kallate.

TRËNDELINA: Prej Kallate?

BARKSHI: Po. Prej Kallate.

TRËNDELINA: Kallata?! Po ç'është kjo? Kallata?

BARKSHI: Është një qytet diku në botë.

TRËNDELINA: Po me kënd bisedoje parëz

BARKSHI: Me Varrtarin. Ishte me mua në Kallatë. Bashkë shkuam e bashkë u kthëm.

TRËNDELINA: Po ajo femra? Dëgjova një zë femre.

BARKSHI: Balerina.

TRËNDELINA: E ku mbeti?

BARKSHI: Po fle.

TRËNDELINA: Ty ta ka ënda të hash, e di. Ha patate, ha mish të pjekur, bukë të elbtë, ha mish thiu e mish kaprolli, pi ujë të ftohtë, e pastaj - fle. Balerina fle - gjithashtu e pastaj - kërcen. Ah, sa bukur di ajo të vallëzojë! Varrtari, e ai? Varrtari hap hurdha varresh. Po ju keni mundur ta shëtisni mbarë botën lehtë.

BARKSHI: U endëm e u endëm e u kthëm përsëri.

TRËNDELINA: A hëngre shumë?

BARKSHI: Shumë, besa. Jam ngopur. Shihe këtë bark.

TRËNDELINA: Po balerina a vallëzoi shumë?

BARKSHI: Mund të thuhet se po.

TRËNDELINA: E Varrtari?

BARKSHI: Ai, i gjori, u këput. T'ia shohësh shuplakat... Si lëvozhgë qarri, madje më të trashë e ka lëkurën e tyre. Ka hapur më shumë se një mijë e një gropë. Po ai as që mund t'i mbërrinte t'i mbulojë të gjitha. I mbulonte njëfarë lumi.

TRËNDELINA: Cili lumë?

BARKSHI: Gangu.

TRËNDELINA: Ishin shumë të uritur.

BARKSHI: Ishin edhe të marrë edhe të uritur. Unë, për vete, ua zura për të madhe. Se, këtë e shijova vetë, kishte shijen e mishit të derrit. Pra ishte më i shijshëm se mishi i kalit. Kurse ata i hidhnin në lumë. E ishte edhe shumë nxehtë e mishi prishej. Zot o zot, gjithë ai mish i prishur e këndej njerëzit vdisnin urie. Edhe vetë shndërroheshin në mish të prishur. Si mos t'ua zërë njeriu për të madhe. Në një kazan të madh, se ujë e drunj kishte sa të duash në botë, mund të zienin mish. Shiko, s'ka kurrfarë rreziku prej infektimit, kur mishi zihet në një mijë gradë celsius. Ja shihe barkun tim (i bie me duar). Hëngra e hëngra, po asnjëherë nuk m'u prish. Nja njëmijë i hëngra vetë, nja njëmijë i mbuloi Varrtari, kurse balerina i digjte në turra drunjsh. Gjithsej: tre mijë.

TRËNDELINA: E pse u kthyet?

BARKSHI: Na ndoqën.

TRËNDELINA: Mendoni se këtu nuk do t'ju njohin?

BARKSHI: Ti mos kij dert. As ndërmend më s'na shkon të hamë e të pimë. Do të jetojmë si e do adeti shekullor i këtij vendi, se edhe këtu vdesin njerëz. Vërtet në lumë nuk i hedhin, por për të varrosur dihet se i varrosin. Varrtari do t'i varrosë, kurse balerina do t'i stolisë varret e tyre me lule, do të këndojë për shpirtrat e tyre. E kur të vijnë ndër varre me bukë e djathë, mish e ëmbëlsi, rrush e petë, edhe për mua do të teprojë diç sa për ta lagur gojën. A po sheh, çdo gjë është në rregull.

TRËNDELINA: Thua: s'na bie ndërmend të hamë e të pimë?

BARKSHI: Thashë, por jo edhe të vdesim urie. Këtu populli thotë: askush s'ka vdekur nga uria. A është e vërtetë se thuhet kështu?

TRËNDELINA: Po, e vërtetë është

BARKSHI: Atëherë as ne nuk do të vdesim urie, as unë as varrtari, as Balerina. Do të jetë pak më vështirë, por neve as mendja nuk na shkon për gosti. Sa për idare. Kaq.

TRËNDELINA: Megjithatë do të jetoni si hienat. Do të prisni vetëm vdekjen e tjetrit.

BARKSHI: Është ligj i të madhit zot: gjithkush që është lindur duhet edhe të vdesë. Askujt nuk i ka mbetur kjo botë e as që do t'i mbesë. Kryesorja ne nuk i mbysim. Vetë i kam parë si i therin me singi, nëpër botë, vetë i kam shikuar se si i lenin trotuareve të heqin shpirt, pa pasur asnjë pikë ujë t'i zbusin buzët e plasaritura e të thara. Po për të gjitha këto vendos tjetërkush. Është një fuqi tjetër mbi kokat tona: fuqia hyjnore.

* * *

(Drama: "Pahintikë në ëndërr", Xhabir Ahmeti).



STRUKTURA E VEPRËS LETRARE

PËRMBAJTJA DHE FORMA E VEPRËS LETRARE

Vepra letrare paraqet tërësi të pandashme tematike, me ç'rast **letërsia** është **forma**, në të cilën pasqyrohet jeta e njerëzve, ndërsa **përmbajtja** është baza **ideore-tematike** që e zgjedh shkrimtari nga jeta. Për të pasur vlera të mirëfillta artistike një vepër letrare duhet të realizojë në mënyrë të suksesshme tre elemente thelbësore: përmbajtjen, formën dhe mjetet shprehëse. Me bashkëveprimin e harmonishëm të këtyre elementeve krijohet tërësia unike që autorit i siguron vlerësim pozitiv nga kritika letrare dhe lexuesit.

Me fjalën **përmbajtje**, në artin letrar, kuptojmë lëndën që është përfshirë në një vepër letrare, ngjarjen, realitetin shoqëror, ashtu siç e ka kuptuar dhe pasqyruar artisti.

Me fjalën **formë**, në letërsi, kuptojmë mënyrën e pasqyrimin të jetës së skicuar (pikturuar) përmes personazheve të përfshirë në një vepër letrare, pra karakteret me gjithë larminë e sjelljeve dhe përjetimeve të tyre.

Kur flasim për përmbajtje, e kemi fjalën për materialin apo lëndën që autori e merr nga realiteti i jashtëm apo ai i brendshëm shpirtëror, material ky, që e përfshin botën e autorit, përjetimet e tij, ndodhitë nga jeta shoqërore, sikurse edhe ndjesi të brendshme, të cilat pasqyrohen në vepër nëpërmjet formës artistike. Përmbajtja përfshin ngjarjen ose dukurinë rreth së cilës ndërtohet vepra dhe në të shfaqen, jo vetëm rrethana dhe ndodhi konkrete, por edhe karakteret, tiparet psikologjike dhe morale të personazheve.

Personazhet, të tipizuar me mjeshtëri, përfaqësojnë ide dhe qëndrime të caktuara të autorit për jetën, për këtë arsye shpesh thuhet se personazhet janë bartës të formës dhe përmbajtjes. Karakteret, mund të jenë si pozitivë, ashtu dhe negativë, gjë që e reflekton realitetin individual dhe shoqëror, pikërisht se njeriu është pjesë aktive e shoqërisë dhe e shpalos me saktësi këtë realitet.

Përmbajtja dhe forma janë të pandashme dhe ndikojnë thellësisht mbi njëra-tjetrën. Nuk mund të imagjinohet një përmbajtje pa formën që e mishëron atë, ashtu siç nuk mund të ketë formë pa një përmbajtje që e mbush me kuptim.

“LAHUTA E MALCIS”

(analizë e shkurtër)

Vepra e Gjergj Fishtës “Lahuta e Malësisë” (“Lahuta e Malcis”) është një ndër veprat klasike të letërsisë shqiptare, si dhe kryevepra e autorit. Në tridhjetë këngët e veprës në vargje portretizohet historia e popullit shqiptar, nga Lidhja e Prizrenit deri në Pavarësinë e Shqipërisë më 1912.

Përmbajta e veprës pasqyron çështje të rëndësishme kombëtare ku përshkruhet lufta e shqiptarëve për pavarësi, kundër robërimit të Perandorisë Osmane dhe kundër copëtimit të truallit etnik shqiptar nga Mali i Zi dhe Serbia. Ngjarja nis me këndimin e heroizmave shqiptare për të mbrojtur tokat e veta nga sulmet malazeze dhe paraqet një histori të gjatë që përmes vargut popullor shpreh epopenë e luftës për liri e pavarësi.

Në vepër, me një forcë të rrallë epike, mbështetur në kodin poetik popullor trajtohet realiteti i kohës, duke e vendosur në një nivel të lartë artistik poezinë tonë të traditës. Jepet përshkrimi i një krahine, për t’u zgjeruar në tërësinë etnike shqiptare dhe vazhdon me trajtimin e burrërisë së një ambienti për të arritur te koncepti i kombit.

Vepra përbëhet nga tri lloje këngësh: historike, kreshnike dhe autoriale, me një ndërtim të brendshëm dramatik, ku përshkruhet gjendja reale dhe përjetimet e popullit shqiptar.

Personazhet/heronj janë të shumtë: Oso Kuka, Marash Uci, Dedë Gjo Luli, Tringa, Abdyl Frashëri, Ali Pashë Gucia... të ngjashëm në çështjen e heroizmit dhe atdhetarizmit.

“Lahuta e Malcis” është epopeja e parë në letërsinë shqiptare, pasi poeti e krijoi atë, duke u mbështetur në poetikën e modelit epik të poezisë popullore. Me një strukturë artistike të eposit heroik popullor dhe me një traditë të lashtë të eposit shqiptar, kjo vepër del e njëjtë me epopetë e vjetra të letërsisë botërore, pasi edhe ato lidhen me traditën epike popullore.



TEMA DHE IDEJA E VEPRËS LETRARE

Letërsia, si pasqyrim artistik i realitetit, trajton çështje të rëndësishme për jetën e njeriut dhe për shoqërinë, duke u dhënë atyre kuptim më të thellë dhe dimension shpirtëror.

Vepra letrare, në përmbajtjen e saj, ka një shumësi temash dhe motivesh, të cilat shkrimtari i harmonizon në një rrëfim të plotë që shpesh ka në thelb një problem kryesor, të cilin ai dëshiron ta trajtojë. Kjo përmbajtje ka lidhje të ngushtë me temën dhe idenë.

Tema është ajo që trajtohet, ndërsa ideja është ajo që përçojnë përmbajtja dhe trajtimi artistik i saj. Në disa vepra, tema dhe ideja janë të lidhura ngushtë dhe të dukshme, në disa raste tjera ato kërkojnë lexim më të thelluar për t'u kuptuar. Është e rëndësishme ta bëjmë dallimin midis temës dhe idesë së veprës.

Me fjalën **temë**, kuptojmë një rreth të caktuar dukurish që shkrimtari zgjedh nga realiteti dhe që i përgjithëson në vepër.

Me fjalën **ide**, kuptojmë mendimin kryesor që buron prej ngjarjeve, të cilat i përshkruan shkrimtari në veprën e vet.

“Teoria e letërsisë”, G. Luboteni.

Tema e veprës e prezanton çështjen kryesore që trajtohet thellësisht, duke reflektuar marrëdhënie midis individit dhe shoqërisë, botës shpirtërore dhe realitetit konkret. Kjo është arsyeja pse në shumë raste tema është edhe pasqyrë e kohës dhe rrethanave ku është shkruar vepra.

Tema mund të jetë aktuale dhe joaktuale.

Ideja e një vepre është e lidhur ngushtë me idenë e shkrimtarit.

Ideja është mendimi thelbësor që lind nga trajtimi i temës dhe që shpesh bart një mesazh të caktuar për jetën dhe gjithçka që përfshihet në të. Në veprat lirike, për shembull, ideja shprehet përmes emocioneve, ndjesive dhe përjetimeve të autorit apo subjektit lirik, ndërsa në veprat epike dhe dramatike ideja zakonisht del përmes zhvillimit të ngjarjeve dhe fateve të personazheve.

Në letërsinë shqipe, shumë autorë kanë trajtuar tema të rëndësishme për kombin.

Për shembull: Naim Frashëri në poezinë “Bagëti e bujqësi” e trajton me dashuri jetën rurale shqiptare dhe punën e ndershme të bujqve, ndërsa Çajupi, në komedinë “Pas vdekjes” i shqyrton problemet e martesës së rrejshme e të imponuar, duke demaskuar realitetin e shoqërisë patriarkale. Ndërkohë, Migjeni, përmes poezisë së tij të fuqishme dhe tragjike jep zërin e të mjerëve, të varfërve, të popullit, duke e ngritur problemin social në një nivel të lartë artistik.

Letërsia, në vetvete, është një fushë ku ndërthuren të menduarit artistik dhe ideor. Një vepër letrare nuk është vetëm një tregim i bukur, por edhe një përpjekje për ta kuptuar jetën dhe botën. Në këtë kuptim, ideja e veprës merr vlerë estetike dhe filozofike, duke e pasqyruar, jo vetëm mendimin e autorit, por duke dhënë porosi universale që i flasin çdo brezi dhe çdo kohe.

Ndër poemat më të bukura në letërsinë shqipe është **“Poema e mjerimit”** e Migjenit.



SPROVË LETRARE:

***Lexoni me kujdes “Poemën e mjerimit” dhe përshkruani se cila është tema dhe ideja!**

Poema e mjerimit

Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,
kafshatë që të mbetë në fyt edhe të zë trishtimi
kur shef ftyra të zbeta edhe sy t'jeshilta
që t'shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita
edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin
të tan jetën e vet derisa të vdesin.
E mbi ta n'ajri, si në qesendi,
therin qiellën kryqat e minaret e ngurta,
profetët dhe shejtët në fushqeta të humngjyrtë shkëlqejnë.
E mjerimi mirfilli ndien tradhti.

Mjerimi ka vulën e vet t'shëmtueme,
asht e neveritshme, e keqe, e turpshme,
balli që e ka, syt që e shprehin,
buzët që më kot mundohen ta mshefin -
janë fëmijtë e padijes e flitë e përbuzjes,
t'mbetunat e flliqta rreth e përqark tryezës
mbi t'cilën hangri darkën një qen e pamshirshëm
me bark shekulluer, gjithmonë i pangishëm.
Mjerimi s'ka fat. Por ka vetëm zhele,
zhele fund e majë, flamujt e një shprese
t'shkyem dhe të coptuem me t'dalun bese.

Mjerimi tërbohët n'dashuni epshore.
Nëpër skaje t'errta, bashkë me qej, mij, mica,
mbi pecat e mykta, t'qelbta, t'ndyta, t'lagta
lakuriqen mishnat, si zhangë; t'verdhë e pisa,
kapërthehen ndjenjat me fuqi shtazore,
kafshojnë, përpijnë, thithen, puthen buzët e ndragta
edhe shuhet uja, dhe fashitet etja
n'epshin kapërthyes, kur mbytet vetvetja.
Dhe aty zajnë fillin t'marrët, shërbtorët dhe lypsat
që nesër do linden me na i mbushë rrugat.

Mjerimi në dritzën e synit t'kërthinit
dridhet posi flaka e mekun e qirit
nën tavan t'tymuem dhe plot merimanga,
ku hije njerzish dridhen ndër mure plot danga,
ku foshnja e smume qan si shpirt i keq
tu' ndukë gjitë e shterruna t'zezës amë,
e kjo prap shtazanë, mallkon zot e dreq,
mallkon frytn e vet, mallkon barrn e randë.
Foshnj' e saj nuk qesh, por vetëm lëngon,
e ama s'e don, por vetëm mallkon.
Vall sa i trishtueshëm asht djepi i skamit

ku foshnjën përkundin lot edhe të fshamit!
Mjerimi rrit fëmin në hijen e shtëpive
të nalta, ku nuk mrrin zani i lypsis,
ku nuk mund t'u prishet qetsia zotnive
kur bashkë me zoja flejnë në shtretët e lumnis.

Mjerimi pjek fëmin para se të burrhoet,
don ta msojë t'i iki grushtit q'i kërcnohet,
atij grusht që n'gjumë e shtërngon për fytit
kur fillojnë kllapitë e etheve prej unit
dhe fetyrën e fëmis e mblon hij' e vdekjes,
një stoli e kobshme në vend të buzqeshjes.
Nji fryt kur s'piqet dihet se ku shkon
qashtu edhe fëmia n'bark t'dheut mbaron.

Mjerimi punon, punon dit e natë
tu' i vlue djersa në gjoks edhe në ballë,
tue u zhigatun deri n'gjujë, n'baltë
e prap zorrët nga uja i bahen palë-palë.
Shpërblim qesharak! Për qindenjë afsh
në ditë - vetëm: lekë tre-katër dhe "marsh!"

Mjerimi kaiher' i ka faqet e lustrueme,
buzët e pezmatueme, mollzat e ngjyrueme,
trupin përmendore e një tregtis s'ndytë,
që asht i gjikuem të bijë në shtrat vet i dytë,
dhe për at shërbim ka për të marrë do franga
ndër çarçafë, ndër fëtyra dhe në ndërgjegje danga.

Mjerimi gjithashtu len dhe n'trashigim
-jo veç nëpër banka dhe në gja të patundshme,
por eshtnat e shtrembta e n'gjoks ndoj dhimbë,
mund që t'len kujtim ditën e dikurshme
kur pullaz' i shpis u shemb edhe ra
nga kalbsin' e kohës, nga pesha e qiellit,
kur mbi gjithçka u ndi një i tmerrshmi za
plot mallkim dhe lutje si nga fund i ferit,
ish zan' i njeriut që vdiste nën tra.
Kështu nën kambët'randë t'zotit t'degërsuem-
thotë prifti -vdes ai që çon jetë të dhunuem.
Dhe me këto kujtime, ksi lloj fatkeqësinash
mbushet got' e helmit në trashigim brezninash.



Mjerimi ka motër ngushlluese gotën.
Në pijetore të qelbta, pranë tryezës plot zdrale
të neveritshme, shpirti me etje derdh gotën
n'fyt për me harrue nandhetenand' halle.
E gota e turbull, gota satanike
tu' e ledhatue e pickon si gjarpni-
dhe kur bie njeriu, si gruni nga drapni,
nën tryezë qan-qeshet në formë tragjikomike.
Të gjitha hallet skami n'gotë i mbyty
kur njiqind i derdh një nga një në fyt.

Mjerimi ndez dëshirat si hyjet errsina
dhe bajnë tym si hejt q'i ban shkrum shkrepitima.
Mjerimi s'ka gëzim, por ka vetëm dhimba,
dhimba paduruese që t'bajnë t'çmendesh,
që t'ap in litarin të shkojsh fill' e t'varesh
ose bahe fli e mjerë e paragrafesh.

Mjerimi s'don mshirë. Por don vetëm të drejt!
Mshirë? Bijë bastardhe e etënve dinakë,
t'cilt n'mnyrë pompoze posi farisejt
i bijnë lodërtinës me ndjejt dhelparak
tu' ia lëshue lypsi një grosh të holl' n'shplakë.

Mjerimi asht një njollë e pashlyeme
n'ballë të njerzimit që kalon nëpër shekuj.
Dhe këtë njollë kurr nuk asht e mundshme
ta shlyejnë paçavrat që zunë myk ndër tempuj.

SUBJEKTI DHE KOMPOZICIONI I VEPRËS LETRARE

Vepra letrare, si një tërësi artistike përbëhet prej një varg elementesh, në të cilën shkrimtari pasqyron njeriun dhe dukuritë e ndryshme shoqërore. Me qëllim që ta përshkruajë realitetin sa më bukur, ai sajon tablo dhe personazhe të ndryshme, duke marrë lëndën nga realiteti dhe përvoja e vet jetësore.

Fjala “subjekt” rrjedh nga lat. *subjektus*, që do të thotë “i vendosur poshtë” dhe në varësi të llojit të veprimtarisë ku përdoret, merr kuptime të ndryshme. Kur bëhet fjalë për veprat artistike në përgjithësi, pa përcaktuar ndonjë zhanër, kuptimi i saj është i ngjashëm me atë të fjalës “temë”. E kur i referohemi krijimtarisë letrare me termin “subjekt” nënkuptojmë përmbajtjen që shpreh dhe ndërton vepra letrare. Në këtë kontekst, termi “subjekt” nuk lidhet aq me idenë, por me formën me anë të së cilës shfaqet përmbajtja, pra është më konkret dhe më narrativ.

“**Subjekt** quajmë tërësinë, sistemin e ngjarjeve të një vepre epike, epiko-lirike ose dramatike, që shkaktohen nga marrëdhëniet e personazheve. Këto ngjarje jetësore janë të lidhura midis tyre dhe zhvillohen vazhdimisht (nga pika e lidhjes deri në zgjidhjen). Marrëdhëniet dhe veprimet reciproke të njerëzve që tregohen në këtë ngjarje, zbulojnë tipare të ndryshme të karakterit njerëzor, sjelljen dhe emocionet personale, historinë e zhvillimit të karakterit, rritjen e tij. Në *subjekt* pasqyrohen konfliktet dhe kontradiktat që janë karakteristike për jetën, marrëdhëniet e ndërsjella të njerëzve, si dhe qëndrimi që mban shkrimtari ndaj tyre”.

Fjalorth termash letrare

Subjekti i veprës përbëhet nga një rrjedhë ngjarjesh të lidhura me njëra-tjetrën që ndërtojnë karakteret dhe marrëdhëniet e tyre në mënyrë të ndërsjellë. Ky përkufizim i jep subjektit dimension të qartë rrëfimtari dhe strukturor. Edhe fjala “syzhe” që vjen nga frëngjishtja “sujet” përdoret për të njëjtin kuptim, si lënda apo përmbajtja thelbësore e një vepre letrare apo shkencore.

Syzhe quajmë një varg ngjarjesh kryesore të një vepre, të cilat i zgjedhin shkrimtarët për t'i dhënë mundësi heroit dhe personave të tjerë që të shfaqin karakterin e tyre.

“Teoria e letërsisë”, G. Luboteni.

Në letërsi, subjektet janë të ndryshme dhe ndikohen nga tematika, koha dhe zhanri i krijimtarisë. Ato mund të jenë aktuale ose të shikojnë në të kaluarën, mund të mbështeten mbi fakte reale ose të jenë krejtësisht imagjinare. Subjekti nuk është i rastësishëm, por pasqyron mendësinë, qëndrimet dhe realitetet e shoqërisë që përfaqëson.

Kompozicioni artistik i veprës letrare ndërlidhet me subjektin, pasi ai e përcakton mënyrën sesi ndërtohet vepra.

Fjala “kompozicion” - compositio (lat.) nënkupton radhitje dhe sistemim.

Kompozicioni është struktura e brendshme e veprës, mënyra si lidhen pjesët e saj në një të tërë harmonike dhe funksionale. Ai ndihmon, jo vetëm në zhvillimin e subjektit, por edhe në shpërfaqjen e idesë që autori dëshiron të përcjellë.

Në kompozicionin e një vepre përfshihen mënyra se si paraqiten: karakteret, zhvillimi i ngjarjes, përdorimi i dialogëve, përshkrimi i mjedisit dhe organizimi i kohës e hapësirës.

Këto elemente e ndërtojnë tërësinë artistike që i jep veprës lidhshmëri dhe efekt emocional. Ndaj, kompozicioni nuk është vetëm teknikë shkrimi, por pjesë thelbësore e strukturës estetike të çdo krijimi letrar, ku çdo detaj luan rol në formësimin e mesazhit të autorit dhe përjetimit të lexuesit. Atëherë, subjekti dhe kompozicioni nuk janë thjesht, pjesë përbërëse të një vepre, por shtyllat që e mbajnë atë artistikisht të qëndrueshme, të kuptueshme dhe të ndjeshme për publikun. Brenda çdo subjekti ka përshkrime peizazhesh.

Peizazhi është përshkrimi i hollësishëm i natyrës ku zhvillohet veprimi. Ky përshkrim i jep hijeshi dhe freski veprës, po të përdoret me masë dhe në vendin e duhur.

**Përshkrim peizazhi nga proza e shkurtër e Faik Konicës.*

Në liqen


Fletët, të thata e të verdha, kanë rënë, nga lisat rreth e rrotullma, mbi liqen, dhe duken si njolla ari mbi një pasqyrë të vjetër. As erë, as zë zogu. Një pushim i trishtueshëm. Vetëm, larg së largu, ushtrimi i çapeve ndonjë ëndërrimtari... Remat, herë-herë, e në një hop që të dyja, i bien ujit: qarke hapen, që venë duke u zmadhuar e duke shtyrë fletët: shuli shket duke u shuluar. Edhe nata po bie. Përtej, u ndez një dritë, që rrënjën në një copë të liqenit.

(Proza poetike: “Në liqen”, Faik Konica).

Episodi është ngjarje plotësuese (e dorës së dytë) që ndonëse nuk ka lidhshmëri të ngushtë me ngjarjen kryesore, ai e ndihmon shprehjen e mendimit kryesor dhe i jep gjallërinë e duhur përshkrimit.

Të gjitha elementet ndërlidhëse të përshkrimit, të vendosura në një tërësi të rrumbullakësuar mirë, e sajojnë kompozicionin ose ndërtimin e veprës letrare.

- Në grafik shihet vendosja e tyre



STILI DHE GJUHA E VEPRËS LETRARE

Stili është mënyrë e të shprehurit apo e shfaqjes së kreativitetit, për botëkuptimin dhe ndjeshmërinë e individualitetit krijues. Në përgjithësi, stili është shprehje e mendimeve dhe shkathtësive individuale të krijuesit, i cili i jep ngjyrë, karakter dhe përmbajtje tekstit. Lidhet ngushtë me përdorimin e gjuhës, figuracionin dhe ritmin e veprës.

Fjala stil vjen nga greq. e vjetër „*stylos*”, ose lat. “*stilus*”, e cila emëronte një vegël (prej metali ose ashti) me majë të mprehtë që përdorej për të shkruar në copa dërrasash të lyera me dyll, ndërsa koka e tij ishte e shtypur dhe shërbente për t’i fshirë gabimet gjatë shkrimit.

Stili është tërësia e veçorive themelore ideo-artistike, e mjeteve dhe mënyrës së shprehjes, të cilat bien në krijimtarinë e një artisti (shkrimtari), të një rryme a të një epoke.

Fjalori i shqipes së sotme

Teoria e letërsisë është shkenca, e cila merret me studimin e stilit letrar. Dallojmë dy lloje stilesh letrare: stili shkencor dhe stili artistik.

Midis stilit dhe personalitetit të autorit ekziston një lidhje e ngushtë, prandaj mendimtarë të ndryshëm theksonin se: “**stili është vetë njeriu**”. Kjo mënyrë e të kuptuari të stilit është mjaft e kufizuar dhe nuk e merr parasysh ndikimin e epokës, rrethanave historike dhe ambientit kulturor në formësimin e tij. Stili, në fakt, është rezultat i një përzierjeje midis individualitetit të krijuesit dhe kushteve konkrete shoqërore, estetike apo filozofike që ndikojnë në periudhën kur ai krijon. Çdo epokë sjell vlera, ide dhe ndjeshmëri, të cilat pasqyrohen në stilin e veprës letrare, duke krijuar kështu shumëllojshmëri shprehëse që e pasuron kulturën njerëzore.

“Stili është **ndërlidhja** midis **formës** dhe **përmbajtjes** së një vepre që përmbledh në vete harmoninë e të gjitha elementeve që e përbëjnë këtë.

“Teoria e letërsisë”, G. Luboteni

Stili poetik është harmonia e përsosur midis formës dhe përmbajtjes. Ai e fiton hijeshinë e duhur kur stoliset me fjalë e shprehje *të fytyrzueme* a konkrete dhe me *gjallni a lëvizje*.

Përshkrimet e fuqishme të shkrimtarit arrijnë të krijojnë një lloj imazhi piktural ku shpesh vendosen një varg ngjyrash, lëvizjesh, dridhjesh, përthyerjesh, të cilat i japin vlerë artistike veprës së shkruar. Sa më i fuqishëm të jetë iluzioni i realitetit, aq më të thella do të jenë përjetimet përderisa piktura e poetit do t'i afrohet edhe më fort jetës dhe së vërtetës, duke e ruajtur vlerën dhe rëndësinë.

Në letërsinë tonë kombëtare, si shkrimtarë më të dalluar për nga stili artistik janë: Faik Konica, Fan Noli, Gjergj Fishta, Mitrush Kuteli, Migjeni, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Anton Pashku e shumë të tjerë.

Gjuha poetike është arti që realizohet përmes fjalës. Kjo gjuhë poetiko-artistike nuk është vetëm mjet komunikimi, por edhe mjet krijimi dhe përjetimi estetik. Fjalët, në një tekst poetik, nuk janë vetëm bartëse kuptimesh, por janë edhe burim muzikaliteti, tingujsh dhe ritmesh që ngjallin ndjesi dhe imazhe të fuqishme te lexuesi apo dëgjuesi.

Gjuha poetike nga gjuha e përditshme, përveçse dallon në përdorimin e figurave letrare, dallon edhe në mënyrën se si ndërtohet dhe si funksionon fjala në kontekstin poetik, andaj kemi dy mënyra të shprehjes: të folme të natyrshme dhe **të folme figurative**. Ndryshe nga gjuha e zakonshme, ajo poetike karakterizohet nga përdorimi i veçantë i fjalëve, në mënyrë të përzgjedhur që i shpreh më thellë ndjenjat, idetë dhe realitetin, duke i dhënë fjalës fuqi të pazakontë shprehëse.

Poeti është krijuesi (artisti), i cili nëpërmjet artit të shkruarit e pasqyron jetën e njëmendtë të njeriut dhe shoqërisë, të cilën e përshkruan në mënyrë të ndjeshme dhe bindëse. Ai, nuk e përshkruan në trajtë pikturë vetëm njeriun, por edhe natyrën dhe dukuritë e ndryshme që ndodhin në të.

Poeti, nuk është qenie e veçantë me prirje të mbinatyrshme, por është individ me aftësi krijuese për ta pasqyruar jetën e tij dhe mjedisin, përmes fjalësh, tablosh, personazhesh dhe simbolesh. Të tillë qenë: Jeronim de Rada, Gavril Dara i Ri, Naim Frashëri, Ndre Mjeda, Andon Z. Çajupi, Lasgush Poradeci, Fan Noli, Faik Konica, Gjergj Fishta, Migjeni etj.

- **E folmja e natyrshme** ndodh kur fjalët e përdorura e ruajnë kuptimin e vet themelor dhe i përgjigjen plotësisht idesë a mendimit që duam ta shfaqim me atë rast. (**“Teoria e letërsisë”, G. Luboteni**).

Në shembujt e dhënë kemi një të folme të natyrshme, pasi fjalitë e kanë ruajtur kuptimin e tyre themelor: *Gjergji është kryehero i shqiptarëve; Dritarja e hapur lë depërtimin e dritës; Blini priste në oborrin e shkollës; Andrra ishte nxënësja më e mirë.*

- **E folmja figurative** ndodh kur fjalët dhe shprehjet e përdorura e humbin domethënien e tyre themelore dhe marrin kuptime të reja, me ç'rast ndryshon edhe kuptimi i mendimit të shfaqur. ("**Teoria e letërsisë**", G. Luboteni).

Vargjet e kësaj poezie të Nolit tregojnë se poeti ua ndërron kuptimin fjalëve, duke u dhënë vështirime të reja:

Tradhëtori dinak, hipokrit e kusar
Na u ngrit gjer në kulm, dhe u bë kryetar;
Nënë zgjedhën besnikët për vdekje lëngojnë.
Se mëkat dhe mallkim kryengritjen kujtojnë...

(„*Krishti me kamçikun*“, F. Noli).

Shkrimtari përmes gjuhës, si art i fjalës, shpreh ndjeshmërinë e vet të brendshme, duke krijuar një realitet të ri artistik, i cili shpesh ndikon më thellë sesa realiteti konkret. Ai, përpos që e shpreh mendimin dhe ndjesinë, në realitetin e vet krijues përpiqet ta bëjë lexuesin që ta përjetojë ndryshe botën dhe jetën. Gjuha, nuk është vetëm argëtuese, por ajo synon të bindë, të magjepsë, të ndriçojë dhe të frymëzojë. Në këtë mënyrë, vepra artistike shndërrohet në univers të veçantë, ku fjala është më shumë se mjet komunikimi, është art i fjalës. Për shkrimtarin, kënaqësia më e madhe nuk është shkrimi në vetvete, por muzika e brendshme që krijojnë fjalët. Çdo shkrimtar, në veprën e vet, shpreh një ideal të caktuar që përpiqet ta sendërtojë dhe ky është ideali estetik, nëpërmjet të cilit autori ndikon në formimin e vetëdijes shoqërore të njerëzve.

Shkrimi është një akt krijimi, një veprim estetik që synon të prekë ndjenjat dhe mendimet, përtej të zakonshmes. Kjo e veçon gjuhën poetike nga profilet tjera shkencore. Në veprat letrare fjala poetike merr një dimension të ri, duke u shndërruar në figurë interpretuese, e cila me forcën e vet shprehëse krijon hapësirë të re të përjetimit artistik.

Pasuria dhe pastërtia gjuhësore në veprën letraro-artistike

Gjuha është arritje e zhvillimit të gjatë historik dhe kulturor. Ajo është përsosur në periudha të gjata kohore bashkë me shoqërinë njerëzore, prandaj nuk konceptohet vetëm si bashkësi fjalësh dhe rregullash gramatikore, por përmban në vete të kaluarën, përvojën, kulturën dhe shpirtin e një populli ku ruhen dhe përcillen brez pas brezi traditat, besimet, vlerat dhe zakonet.

Në të kaluarën është theksuar se, vepra letrare krijohet vetëm përmes gjuhës, ngase ajo i jep vlerë të veçantë. Pasuria dhe pastërtia gjuhësore vjen pikërisht nga përzgjedhja dhe përdorimi i kujdesshëm i fjalëve, duke krijuar kështu një harmoni të veçantë shprehëse, e cila është tipike për letërsinë artistike.

Në letërsi, përdorimi i gjuhës duhet të jetë i qartë, i pastër, i saktë dhe i konkretizuar për ta shmangur mjegullimin e kuptimit dhe për të siguruar komunikim të qartë dhe të ndjeshëm me lexuesin. Kjo kërkon një gjuhë të kapshme, të pasur e të harmonizuar me përmbajtjen që përcillet.

Pastërtia dhe bukuria e gjuhës vjen si rezultat i punës artistike me të, duke e përpunuar atë për të arritur një stil të veçantë dhe të dallueshëm. Vetëm në këtë mënyrë krijohet një gjuhë letrare që përçon emocione, ngjall ndjenja dhe u jep jetë personazheve e botës së tyre.

Shkrimtari duhet ta njohë mirë përbërjen e gjuhës, ndikimin artistik, përshtatshmërinë e fjalëve dhe shprehjeve, rrjedhshmërinë e natyrshme të përshkrimit, si dhe harmoninë e përmbajtjes dhe formës. Të gjitha këto dhe jo vetëm, janë thelbësore për një vepër të suksesshme letrare.

Gjuha letrare e njësuar përbën bazën e edukimit kombëtar dhe të ndërtimit të dijes. Autorët duhet të tregohen të kujdesshëm në zgjedhjen e fjalëve dhe ta shmangin përdorimin e fjalëve të panevojshme, të huazimeve të paarsyeshme, si dhe të atyre që nuk i përshtaten stilit të veprës. Përzgjedhja e fjalorit poetik apo prozaik duhet bërë me shumë vëmendje, pasi fjalët e papërshtatshme, të huaja e të panevojshme e cenojnë pastërtinë dhe bukurinë e gjuhës letrare.



"Është shumë më e vështirë të kuptosh veprat e natyrës, se veprat e një poeti"!

- **Leonardo da Vinçi**

"E çfarë është poeti? Një njeri i palumtur që e fsheh ankthin e pafund në zemër, por buzët e të cilit janë formuar në atë mënyrë që psherëtimat dhe qarjet të tingëllojnë si një muzikë e bukur".

- **Soren Kirkegard**

"Artisti nuk ka kohë t'i dëgjojë kritikët. Ai që dëshiron të shkruajë nuk ka kohë t'i lexojë kritikën".

- **Uilliam Folkner**

"Dora shkruan dhe vazhdon të shkruajë. Nuk ka mëshirë apo mirësi në botë që të fshijë qoftë një gjysmë rreshti të vetëm".

- **Omar Khajam**

KRAHASONI TEKSTIN

Analizoni:

- Dallimet ndërmjet dy teksteve, të shkruara në stilin artistik dhe atë shkencor!
- Nënvizoni pikat dalluese midis tyre!

Gjuha e zjarhtë

O gjuhë - e shenjtëruar, o mall me shpirtin plot
 O vetëtim' e qjellit që fërfëllon me flakë
 O djellë - i llaftaruar që ndrin si pikë lot...
 Si pikë lot e ndritur po ndrij në rreze tuaj
 Po ndrij e papandehur, po qaj pak e nga pakë
 Sepse prej botës suaj kam mbetur kaq i huaj...
 Kam mbetur kaq i huaj, dh'i ndrydhur edh'i shkret!
 Prej ligjëratës sate që më çudit, o zjarr!
 Me gjuhëra prej flake ti djeg... ti flet... ti pret...

(Poezia: "Gjuha e zjarhtë", Lasgush Poradeci).

Gjuha

Gjuha, përbën një sistem simbolesh dhe informacionesh, që paraqesin një ndërthurje të thellë midis ndjenjës dhe veprimit. Si një burim drite, gjuha reflekton në ndërgjegjen njerëzore duke nxitur ndjesi, kujtime e përvoja, ngjashëm me një rreze drite që depërton në një pikë loti. Gjendja emocionale, në kontakt me fjalën e shkruar ose të shqiptuar mund të krahasohet me përndritjen mendore, ku ndërfuten "rrezet e gjuhës". Kur individ i përqafton këtë kod gjuhësor në mënyrë të vetëdijshme, ai bëhet një bartës i kuptimit semantik të saj, që përcillet si një mesazh kuptimplotë.

Gjuha është bartëse e trashëgimisë kulturore, prandaj mund të konceptohet si "sistem i koduar i dritës" Në fund, gjuha është një sistem energjie, që pulson si zemra dhe e ndriçon vetëdijen tonë, dhe nëse nuk kuptohet thellësisht, ajo mbetet një fuqi e paemërtuar.

(tekst shkencor)

PËRSHKRUANI

Mendoni dhe shkruani mbi fragmentin e dhënë:

- Përshkruani gjendjen sociale dhe emocionale të personazhit!
- Zbërtheni qëllimin e tij kur e krahason veten me artistët botërorë!
- Si e quante veprën e tij monumentale?

“Vdekja më vjen prej syve të tillë”
(fragment)

“Ishte rritur në një familje së cilës i kishin munguar edhe qylymi në dysheme, edhe hallva e buka e grurit natën e madhe, por atëherë nuk ishte ankuar se as të tjerët s’i kishin të gjitha. Në qoftë se atëherë jetohej edhe ashtu, se kurrkush s’e tregonte me gisht, në këtë kohë nuk ishte e thënë të vuante edhe për gjërat për të cilat nuk vuanin disa prej kolegëve të tij, që e kishin kaluar lumin dhe qeshnin në breg. Ia merrte mendja se veprat e rëndësishme artistike nuk i kishin bërë ata që kishin jetuar për gazep dhe nuk ngurronte të pohonte se Mikelangjeloja, Bethoveni, Gëteja, Tolstoi, dhe Pikasoja, kishin bërë ç’kishin bërë pse s’e kishin lodhur kokë për ato për të cilat detyrohej ta lodhte ai. E Nderimi donte të krijonte një vepër të rëndësishme, të madhe, një vepër për krijimin e së cilës i duheshin edhe koha, edhe gjatësia, edhe hapësira, edhe mirëkuptimi i të tjerëve. Këtë vepër madhore, monumentale, jetësore, ai e quante trilogji”.



(Romani: “Vdekja më vjen prej syve të tillë”, Rexhep Qosja).

ANALIZË



INTERPRETIM:

- A ndihmon gjuha, stili dhe tematika e një shkrimtari që një vepër letrare të arrijë sukses?
- Cili shkrimtar ju pëlqen, a e bën stili të veçantë veprën e tij?



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Cila është përmbajtja në "Poemën e mjerimit" të Migjenit?
- Si e përvijon Migjeni karakterin e lypësit dhe si e skicon varfërinë?
- Çfarë është stili, përshkruaj llojet e stilit?
- Ku dallojnë stili letrar dhe ai shkencor?
- Si krijohet stili poetik?
- Çfarë është zhanri dhe në çka ndikohet ai?
- Çfarë është zyzheu dhe çka episodi?
- Kush është shkrimtari dhe si krijohet shkrimi?
- Ku qëndron dallimi midis gjuhës letrare dhe gjuhës poetike?
- Çka është e folmja e natyrshme dhe çka ajo figurative?
- Çfarë elementesh përmban analiza e një vepre letrare?
- Përshkruani subjektin në tekstet: "Gjuhë e zjarrtë" dhe "Gjuha"!



SPROVË LETRARE:

***Krijoni tekste të ngjashme dhe bashkëbisedoni rreth tyre!**

Temat:

- "Gjuha - vepër madhore e identitetit kombëtar."
- "Gjuha shkruhet me ngjyrat më të bukura të jetës."

LLOJET LETRARE - SHKENCORE

Krijimtaria letrare njih hartime ose shkrime, të cilat kanë afri të madhe me letërsinë dhe shkencën dhe janë quajtur **lloje letraro-shkencore**, pasi përmbajnë veti të letërsisë dhe të shkencës. Ajo që i afon këto lloje shkrimesh me artin letrar është përfytyrimi i personave, pasqyrimi i ngjarjeve dhe dukurive të ndryshme. Ky pasqyrim, nuk është një përshkrim i thatë, por një paraqitje e gjallë dhe e ndjeshme, plot përjetime të fuqishme dhe ndjenja të zjarra.

Gjuha dhe stili i këtyre krijimeve, sikurse edhe i veprave letrare, duhet të jenë një pasqyrim i plotë i realitetit. Ato shkruhen me gjuhë të zgjedhur e të stolisur me një varg tropesh dhe figurash stilistike.

Autori i këtyre krijimeve përshkruan individë, ngjarje ose dukuri të ndryshme, duke i shprehur ndjenjat, mendimet dhe kujtimet e veta, veti të cilat këtyre hartimeve u japin karakter letrar. Sigurisht se, krijimet letraro-shkencore nuk mund të jenë kryesisht hartime letrare ose shkencore, por qëndrojnë midis të dy llojeve. Studiuesi letrar duhet ta përshkruajë ngjarjen në mënyrë sa më reale dhe me besnikëri, ndërsa studiuesi shkencor, duhet të bëjë gjurmime dhe studime, pastaj të nxjerrë përfundime.

Si tema shtjelluese mund të jenë: ngjarjet historike, viset e largëta, traditat, doket dhe jeta e një populli, vetitë etnike të një mjedisi jetësor, jeta e ndonjë personaliteti, veprimtaria atdhetare e ndonjë figure historike etj. Këto duhet të jenë përshkrime ngjarjesh reale dhe jo trillime, siç mund edhe të sajohet shkrimtari, pra imagjinata e shkrimtarit nuk e ka lirinë e plotë, sikurse në letërsi.

Në këtë togshkrimesh bëjnë pjesë: kronika, ditari, memoaret, udhëpërshkrimi, reportazhi, biografia, nekrologjia, autobiografia, fejtoni dhe eseja.

BIOGRAFIA

Biografi a jetëshkrim është shkrimi, në të cilin vendosen të dhënat jetësore dhe veprimtaria e një njeriu. Meqenëse, biografia i përshkruan vijat jetësore të njeriut, i cili ka jetuar në një kohë të caktuar, atëherë në të duhet përfshirë edhe ngjarje dhe epoka historike, shoqërore e kulturore, në të cilat ka marrë pjesë ai.

Ky lloj shkrimi është shumë i vjetër, pasi njihet që nga lashtësia. Plutarku me veprën e tij “Njerëzit e famshëm” njihet si biografi i parë qysh nga koha antike.

Biograf është personi që bën përshkrimin e jetës së dikujt, zakonisht të ndonjë personaliteti të njohur e të rëndësishëm për shoqërinë dhe kombin, si: burrështetas, politikan, shkrimtar, piktor, skulptor, muzikant, shkencëtar, filozof, mjek etj. Ai, kryesisht duhet të jetë historian (i letërsisë) që të mundet në mënyrë profesionale dhe objektive t’i ilustronjë ngjarjet, t’i argumentojë dhe t’i japë gjykimet e veta.

Jetëshkrimi i njerëzve duhet të shkruhet në bazë të burimeve dhe fakteve të sigurta, prandaj duhet marrë parasysh edhe kohën dhe rrethanat shoqëroro-politike, në të cilat ka jetuar personi.

Vlera artistike e një biografie varet shumë prej aftësisë së biografit. Ai duhet të zgjedhë me kujdes sa më shumë karakteristika të jetës së personit që jetëshkrimi të jetë i plotë dhe interesant. Këtu hyjnë: njohja personale, dokumentet, letrat, tregimet e farefisit dhe bashkëkohësve të tij, anekdotat, kujtimet etj. Të gjitha këto burime biografike, duhet t'i gjurmojë e t'i vërtetojë personalisht. Zakonisht, biografia shkruhet pas vdekjes.

Jetëshkrimi i ka sjellë shërbime të çmueshme kulturës politike dhe historike të njerëzimit. Ai e ka ruajtur nga harresa dhe e ka popullarizuar jetën dhe veprimtarinë e personave të shquar. Në letërsi dallohen biografitë: "Maria Antoneta", "Betoveni", "Mikelandxhelo", "Bajroni", "Naim bej Frashëri e Mid'hat Frashëri", "Jetëshkrimi i Konstandin Kristoforidhit" e Simon Shuteriqit etj.

AUTOBIOGRAFIA

- **Autobiografia** është shkrim, në të cilin vendosen të dhënat jetësore dhe veprimtaria personale nga vetë shkruesi/autori.

Autobiografi apo vetëjetëshkruesi, megjithëse e njeh mirë jetën e vet, sërish është punë e vështirë ta shkruash autobiografinë në mënyrë të çiltër e objektive. Kjo vështirësi lind për arsye se gjithkush ngurron ta vërë në pah veprimtarinë e vet dhe t'i pohojë botërisht anët pozitive dhe negative të karakterit të vet. Për fat të mirë, në këtë pikëpamje kemi edhe përjashtime.

Biografia dhe autobiografia mund të shërbejnë si burim për jetën e njeriut të rëndësishëm si pjesë e një shoqërie. Në letërsi kemi një varg autobiografish, midis të cilave dallohen ato të hartuarat nga shkrimtarët dhe shkencëtarët e mëdhenj.

KRONIKA

- **Kronika** është krijim letrar-shkencor, në të cilin rrëfimi i ngjarjeve bëhet në mënyrë kronologjike, sipas radhës së ngjarjeve. Zakonisht, nëpër kronika nuk jepen kurrfarë sqarimesh mbi lidhjen e shkaqeve të ngjarjeve.

Kronisti është shënuesi i ngjarjeve, të cilat i radhit për nga rëndësia sipas bindjeve të tij. Në kohën e sotme, rolin e kronistëve e kryejnë fletoret e shënimeve ose regjistrat. Për shembull:

- **Ana Komnena - "Aleksiada"** (shek.XII) përshkruan ngjarje historike dhe e përmend Arbërinë dhe arbërit;
- **Gjergj Akropoliti - "Historia"** (shek.XIII) jep të dhëna për Arbërinë dhe zhvillimet politike;

- **Marin Barleti - "Rrethimi i Shkodrës"** (1504), kronikë e ngjarjeve të rrethimit të Shkodrës nga osmanët.

Në kronikat (fletoret e shënimeve) e kohës sonë shqyrtohen dhe shënohen çështje të rëndësishme nga jeta publike, si në sferën shoqëro-politike, ekonomike, kulturore etj. Në shkrimet publicistike (gazetareske), temat më të rëndësishme shënohen si kryeartikuj nëpër revista ose programe lajmesh.

DITARI

- Ditari është lloj i krijimit letraro-shkencor ku shënohen ngjarje të përditshme që i përkasin një kohe më të shkurtër ose më të gjatë të jetës së autorit, në varësi të vullnetit apo dëshirës së tij. Në ditar shkruhet rregullisht, pothuajse gjithçka që ka ndodhur dhe është pjesë e mendimeve dhe ndjenjave të shkruarit. Zakonisht, ditari shkruhet në mbrëmje, pasi në atë periudhë të ditës veç më janë shtresuar një grumbull ngjarjesh dhe përvojash.

Gjuha e përdorur në ditar mund të jetë e thjeshtë, pa ndërhyrje stilistike, pasi në këtë mënyrë ruhet pastërtia ndjesore dhe çiltërsia e përjetuesit (autorit), pra për të qenë pasqyra më besnike e tij. Në ditar, në çdo përshkrim të ngjarjes, në çdo fletë shënohet edhe data dhe vendi (ku realizohet ditari) që më vonë të shërbejë si një lloj dokumenti për jetën, ndodhitë dhe përjetimet e një njeriu.

Rëndësia e ditarit varet prej aftësisë përshkruese të autorit dhe rolit që luan ai në jetën shoqërore. Nëse ai ka kryer ndonjë funksion të rëndësishëm në jetë, atëherë ditari i tij mund të shërbejë si dokumentim apo arkivim ngjarjesh të një periudhe të caktuar. ("Ditari i Ana Frankut" dhe ngjarjet për luftën).

MEMOARE

- **Memoare** janë rrëfimet e një personaliteti të rëndësishëm, për ngjarje të ndryshme të kohës së vet, në të cilat ka marrë pjesë aktive ose ka qenë dëshmitar i tyre.

Fjala memoar rrjedh nga fjala frënge *mémoire*, që do të thotë kujtim.

Memoaret shkruhen në formë kujtimesh (pa përdorur material arkivor), ku në formë të skicuar përshkruhet jeta, ngjarjet, koha dhe ambienti ku ka jetuar memoaristi. Zakonisht shkruhen nga fundi i jetës, kur njeriu ka më shumë kohë t'u rikthehet kujtimeve nga e kaluara, siç ndodh me personalitete të rëndësishme: burrështetas, kryeministra, diplomatë, gjeneralë, historianë, albanologë, shkencëtarë, filozofë e portrete profesionesh të ndryshme.

Memoaret, si shkrime letraro-shkencore kanë vlerë të madhe dokumentare, si për njohjen ashtu edhe për studimin e historisë kombëtare, kulturore, politike dhe shoqërore të një populli. (Janë të njohura memoaret e Jul Cezarit apo nga letërsia shqipe, vepra "Kryengritja shqiptare" e Mihal Gramenos).

Autor më i hershëm i shkrimit të memoareve njihet:

- **Gjon Muzaka - "Kujtimet"** (Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi), (1510) - një burim me vlerë për historikun e familjeve fisnike shqiptare.

"Unë jam vetëm lënda e librit tim."

Mishel de Montaigne

ESEJA

- **Ese** është hartimi ku trajtohet ndonjë çështje e shkencës, artit, kulturës ose jetës shoqërore, me një notë të thellë subjektive, përmes së cilës autori e shpreh qëndrimin e tij, duke dhënë gjykime.

Tematika e esesë është shumë e gjerë. Në të mund të trajtohen çështje a problematika që përkojnë me jetën e njeriut dhe veprimtarinë shoqërore të tij. Zakonisht, eseja nisët nga një dukuri e caktuar që e trajton, e shkoqit dhe e argumenton nga çdo pikëpamje.

Eseisti nuk i argumenton pohimet e veta në bazë të studimeve dhe mendimeve të dijetarëve që janë marrë me gjurmimin e asaj çështjeje dhe nuk përmend kurrfarë burimesh shkencore në mënyrë rigoroze, pra nuk mbështetet mbi studimin e ndonjë shkencëtari, apo pa e shënuar bibliografinë përkatëse. Stilin e eseistit e karakterizon fuqia e fjalës dhe nota e thellë personale, plot mendime dhe përsiatje të fuqishme. Gjuha e esesë është e zgjedhur dhe e stolisur me një varg tropesh, figurash dhe shprehjesh të fuqishme emocionale.

Eseja e ka prejardhjen e vet në Francë. Atë, në veprën "Eseje" e ka përdorë i pari Mishel Montenji, filozof moralist, i cili është marrë me trajtimin e problemeve të jetës shpirtërore, politike dhe fetare të kohës së vet. Më pas, ese kanë shkruar shumë dijetarë, historianë, teoricienë dhe kritikë të letërsisë dhe të arteve të tjera, si: Fransis Bekon, Samjuel T. Kolrixh, Xhorxh G. Bajron, Virxhinia Vulf, Stefan Cvajg, Andre Zhid etj.

Në letërsinë shqipe, eseja ka filluar të lëvrohet më vonë. Eseistët shqiptarë shpeshherë e gërshetojnë këtë lloj shkrimi me elementet e studimit.

Eseistë të njohur shqiptarë janë: Faik Konica, Mit'hat Frashëri, Branko Merxhani, Arshi Pipa, Martin Camaj, Rexhep Qosja, Ismail Kadare, Aurel Plasari, Preç Zogaj...

"Eseja është biseda e lirë e mendjes me vetveten".

"Eseja nuk jep gjithmonë përgjigje; ajo zgjon pyetje".

"Në ese, mendimi bëhet art dhe fjala reflektim".

"Eseja nuk synon ta mbyllë mendimin, por ta hapë atë".

*Shembuj të llojeve letraro - shkencore



BIOGRAFIA

PJETËR BUDI (1566 - 1622)

Pjetër Budi është personalitet i shquar i letërsisë shqipe të shek. XVII.

Ishte predikues fetar, veprimtar atdhetar dhe diplomat.

Lindi në Gur të Bardhë të Matit (1566), në fisin e Budëve të vjetër. U edukua në frymën kishtarë dhe kombëtare. Veprimtaria atdhetare e tij është mjaft e pasur, nga e cila veçohet zgjedhja e tij në Kuvendin e Prokupljes (1616), për të hartuar planin për kryengritjen shqiptare.

Veprat: **“Doktrina e kërshenë”** (1618); **“Rituali Roman”** (1621); **“Pasqyra e të Rrëfyemit”** (1621) dhe **“Kush thotë meshë këtë kafshë i duhet me shërbyem”** (1621).

Vdiq në mënyrë tragjike, në vitin 1622.



AUTOBIOGRAFIA

FAIK KONICA (1875 - 1944)

Unë jam **Faik Konica**, i lindur më 15 mars të vitit 1875 në Konicë. Që i ri u mahnita pas dijes dhe kulturës, prandaj udhëtova për të studiuar në Francë, Belgjikë dhe më vonë në Universitetin e Harvardit, në SHBA.

Gjatë jetës sime iu përkushtova gjuhës, kulturës dhe çështjeve kombëtare shqiptare.

E themelova dhe udhëhoqa revistën “Albania”, ku u përpoqa të zgjoj ndërgjegjen kombëtare të bashkëkombësve të mi. Vepër letrare më të përzemërt e kam **“Doktor Gjilpëra”**.

Kam shërbyer edhe si përfaqësues diplomatik i Shqipërisë, në SHBA.

Vepra ime është dëshmi e dashurisë për kombin tim.

ANALIZË



SPROVË LETRARE:

*"Shpikjet e mia" është një tekst informues, nga i cili mund të bëni sprovë, duke krijuar: ditar, biografi, kronikë, apo ndonjë lloj tjetër të formave letraro-shkencore!

"Shpikjet e mia"

(fragment)

Zhvillimi përparimtar i njeriut varet përjetësisht nga shpikja. Ai është prodhim i rëndësishëm i trurit të tij krijues. Qëllimi përfundimtar i saj është sundimi i plotë i mendjes mbi botën materiale, vënia në shërbim të njeriut e forcave të natyrës.

Ky është një mision i vështirë për shpikësin, i cili shpesh keqkuptohet dhe nuk shpërblehet. Mirëpo, ai gjen ngushëllim të mjaftueshëm në ushtrimin e këndshëm të aftësive të tij dhe në vetëdijen sa i përket asaj klase, jashtëzakonisht të privilegjuar, pa të cilën njerëzimi do të ishte zhdukur prej kohësh në luftën e ashpër kundër elementeve të pamëshirshme.

Metoda ime është e ndryshme. Nuk nxitoj të kaloj menjëherë në punë praktike. Kur më vjen një ide, filloj menjëherë ta formësoj në imagjinatën time. Për mua nuk ka aspak rëndësi, nëse e vë turbinën time në lëvizje në mendje apo në punishten time. Madje, mund të kuptoj edhe nëse nuk është në balancë. Nuk ka dallim: rezultatet janë të njëjta.

(Vepra "Shpikjet e mia", Nikolla Tesla).

Shkruani temat:

- "A e ndryshojnë librat mënyrën se si e shohim botën"?
- "Liria e mendimit - një e drejtë apo përgjegjësi"?
- "A është dështimi hapi i parë drejt suksesit"?
- "A mundet një njeri ta ndryshojë i vetëm shoqërinë"?

LETËRSIA POPULLLORE

Populli shqiptar, përgjatë lashtësisë së ekzistencës së vet mijëravjeçare, ka kultivuar dhe ka ruajtur vlera shpirtërore shumë të begatshme, të bartura brez pas brezi. Kjo trashëgimi shpirtërore dhe artistike e popullit, e përbën kategorinë e veçantë të folkloristikës, e cila quhet **krijimtari gojore**.

Letërsia gojore ka një të kaluar të lashtë historike, pasi gjurmët e saj gjenden qysh në kohën primitive kur njeriu e ndjeu nevojën për të komunikuar me të tjerët për të shprehur emocionet dhe dijet e veta për jetën. Krijimtaria e ruajtur gojë më gojë, shpesh ka hasur edhe në vështirësi në ruajtjen e krijimeve, por ajo ka mbijetuar dhe nuk është shterur si krijimtari. Edhe sot, studiuesit e çmojnë si thesar popullor këtë pasuri të madhe folklori.

Krijimtaria gojore njeh një gamë të gjerë tematike me motive nga linjat jetësore të njeriut, të shkruara nga krijuesi popullor (anonim, i panjohur) me çiltërsi e lumturi drejt ëndrrës për liri e jetë më të mirë, duke reflektuar mbi interesin kolektiv, dhe jo vetëm atë personal.

Vlerësuar në aspektin estetik, krijimet gojore kanë kompozicion të ndërtuar mjeshtërisht, me strukturë tematike e ideore të hartuar mirë, me figuracion të pasur, me përmbajtje temash shoqërore që i karakterizon një frymë optimizmi, duke shfaqur kështu, jo vetëm dukshmërinë artistike, por edhe porosinë, në të cilën përshkohet gjithë realiteti i kohës.

FOLKLORISTIKA DHE VEÇORITË E SAJ

Tërë pasuria gojore, e ngritur në periudha të shumta kohore, si tërësi e krijimeve artistike populllore quhet **folklor**. Nga mënyra përshkruese e krijimit të saj njihen dy tipare: **tipari individual** dhe **tipari kolektiv**.

Folkloristikë quhet shkenca që merret me studimin e folklorit, ndërsa mbledhësi dhe studiuesi i folklorit është **folkloristi**.

Letërsia gojore është përplot pasuri materiale dhe shpirtërore, të cilat shpesh përbëjnë fakte për llojet tjera të krijimtarive, si: letërsia, historia e muzikës, koreografia, muzika, vallja, kënga... që e kanë prejardhjen te ngjarjet dhe dukuritë e pasqyruara në folklor.

Pasuria e madhe e kësaj krijimtari gojore nga studiuesit njihet si “**gurra e pashtershme populllore**”, e cila është ruajtur në kujtesën populllore brez pas brezi dhe për nga përmbajtja dhe mënyra e pasqyrimin ndahet në dy gjini: **gjinia e lirikës gojore** dhe **gjinia e epikës gojore**.

Gjinia e lirikës gojore: **lirika familjare** dhe **lirika shoqërore**.

Mbledhësit e folklorit shqiptarë: Zef Jubani “Përlindja e Shqipnisë” (1871), Thimi Mitko “Bleta shqiptare” (1878), Frang Bardhi “Fjalori latinisht-shqip” (1635), Anton Santori etj.



Në kohën e sotme, folklori, përpos se në formën individuale, mbledhet, studiohet dhe ruhet edhe në forma institucionale të profesionalizuara: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Kulturës Popullore, Instituti i Folklorit dhe Instituti për Trashëgimi Kulturorë, në Shkup etj.

LIRIKA GOJORE

Lashtësia e lirikës gojore është mjaft e madhe dhe në të shprehet bota e brendshme shpirtërore e krijuesit, ndërsa në epikën gojore krijuesi përshkruan ngjarje të tjerëve, duke i vështruar nga jashtë pa qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në to.

1. Lirika familjare përfshin krijime që kanë shtrirje kohore në linjën jetë-vdekje, ku bëjnë pjesë: ninullat, këngët e dasmës dhe vajet.

***Ninullat** - Jeta e njeriut, ruajtja dhe shtimi i familjes përtërihet përmes trashëgimtarëve, siç është lindja e fëmijës. Në traditën e familjeve shqiptare, ardhja në jetë e fëmijës pritet me shumë hare e lumturi. Shprehja e dashurisë, përpos me rite të shumta, bëhet edhe me anë të këngëve që këndohen nga ditët e para të jetës së foshnjës, këngë të cilat njihen si këngë djepi ose nina-nana.

Përmbajtja e ninullave është plot fjalë të bukura, të përzgjedhura (zog, pëllumb, trim; pëllumbeshë, shegë, mollë, lule...) e me figuracion poetik, si: krahasimi, metafora, personifikimi, hiperbola etj., të cilat këndohen gjatë vënies në gjumë të fëmijës.

*Fli, mori cucë, mbylli sytë
Kur t'm'i çelësh, çelsh si yjtë.*

Ninulla përcillet me një vijë melodike që shpreh optimizëm, dëshira e urime nga më të bukurat, siç mund të burojnë zakonisht nga zemra e nënës ose e gjyshes.

Gjumi, gjumi rahatshumi

Nina - nana, more bir
Flej se gjumi të ban mirë.
Të ban mirë e t'rahaton,
Shtatin bir ty ta drejton.
Gjumi, gjumi rahatshumi
Vjen me t'marrë posi pëllumbi.
Ninë e nine sheqer në letër,
M'u bafsh bir ti plak i vjetër.
Plak i vjetër, zotni i pshtetun,
Zotni i pshtetun e i pvetun.
Me t'vetë se çka me ba,
Çka me ba, çka me punue,
Plak i vjetër me urdhnuë.

Nina - nana vajzë e nanës

Nina - nana, vajzë e nanës,
mori cucë për bukuri,
u bafsh si lule për hijeshi!
Flej si qengj e çou si rrunxë,
qingja e nanës, ninani!
Vajzë, u rritsh e u fejojsh,
u martofsh dhe u lulëzofsh!
Ti na qofsh me faqe të bardhë,
gjithkush të pat lakmi, të paste!
Dalsh ti, bij-o me hijeshi
e u përmendsh-o për urti!
lu rritsh nanës e naltë me shtat,
t'u bafsh shtati si bajrak
e t'u mbushtë ftyra me gjak!
Flej, mori cucë e mbylli sytë
kur t'mi çelsh, e i çelsh si yjtë,
i çelsh si yjtë e i çelsh si hanë,
Ani të rrisin babe e nanë.



SPROVË LETRARE:

- Rikujtoni ninulla dhe këngë dasmash, me ndihmën e prindërve dhe njerëzve të fisit!
- Shënmoni këngët në fletore, pastaj bëni një analizë stilistike, duke i gjetur figurat e krahasimit!

*Këngët e dasmës-dasma i ka ritet dhe këngët e saj, të cilat fillojnë e këndohen në disa etapa: fejesa dhe festa të ndryshme gjatë periudhës së fejesës, martesë etj.

Ritet familjare fillojnë me aktin e fejesës, me ardhjen e shkuesit-mësitit (personit ndërmjetësues për krushqi), përmes të cilit shkëmbehen dhurata simbolike (shami, unazë, peshqir...). Ritet lidhen me tradita shumë të vjetra, përcillen me melodi dhe instrumente muzikore popullore dhe ruajnë një pasuri të madhe të lirikës gojore.

Këngët e dasmës kanë përmbajtje të ndryshme tekstuale për vajzën (nusen) dhe për djalalin (dhëndrin). Për vajzën këndohen këngë për aktin e nusërimit dhe gëzimet e jetës, këngë satirike (shpotitëse), këngët e gjerdekut, si dhe këngë gjatë përcjelljes së rriteve. Për dhëndrin këndohen këngët e shamisë së beqarit (djegia e shamisë), këngë për krushqit, për shoqërinë etj. Edhe këto këngë janë të pasura me figura stilistike, veçmas krahasime, metafora e personifikime që e begatojnë tekstin e këngës.

Bien tri dahire

Bien tri dahire, moj nanë
të triat njisoj,
a s'e din, mori nana ime, se un nesër shkoj.
a s'e din, mori nana ime, se un nesër shkoj.

Edhe ti në shkofsh mori bijo, të qoft' rruga e mbar'
t'u bezdis gjergjefi, moj bijo, tuj mi bo çorap'.

Ç'ajo dere huj, mori bijo, mi o shum' e randë
sa t'jet dit e lumja moj bijo ti do't rrih në kambë
edhe caullve t'djepit mi bijo marrish temena.

Kur do t'vish te nana jote do t'rrish si mikeshë
Kur do t'hahet bukë mori bijo te magja s'un vesh
kur do t'pihet uj-o mori bijo shtamën s'un e prek.

Ene si gjith shoqet moj nano, ene un' do shkoj
gjersa t'jem un' gjallë, mori nano, fjalët s'ti harroj
gjersa t'jem un' gjallë mori nano fjalët s'ti harroj.

- *Këngë popullore shqiptare*
(version i kënduar nga këngëtarja e madhe e këngës popullore
Hanife Sejfulla Reçani).

Fjalorth:

dajre - (daire, dahire), vegël muzikore popullore;

t'u bezdis - t'u mërzi;

gjergjefi - mjet për qëndisje pëlhurash;

magja - (magje) govatë e drunjë ku ngjishet brumi për të bërë bukë;

shtamë - enë balte për ujë, e gjerë në mes, me grykë të ngushtë (në kohët e vjetra ka shërbyer për të pirë ujë);

caullve - fëmijëve (foshnjave të djepit).

ANALIZË

Eja çikë ta qesim kanën

Hajde çikë me ne për darkë,
 Se po t'pret ty stoli thatë.
 E muer stolin, nejt me nanën,
 Hajde çikë ta qesim kanën.
 T'qesim kanën pika - pika,
 T'ka pasë nana bajrak ner çika.
 T'qesim kanën me pika t'kuqe,
 Ty t'shtjen nana bajrak ner nuse.
 T'qesim kanën me pika t'm'dha
 Ty t'shtjen nana bajrak ner gra.
 Dul e po kan n'prag t'hambarit,
 Fort iu dhimbt loja e bajramit.
 Kaj, moj çikë, e kaj pa pra
 Sonte ner çika, nesër ner gra.

Çvish rrobat e djalërisë

Çvish rrobat e djalërisë,
 Çvish rrobat e dhëndërisë,
 Djalë më s'të thonë kurrë,
 Se të gjejnë djemat mb'udhë,
 Edhe të zënë me gurë,
 Me ta nuk llafosesh kurrë,
 Të kesh mall për djalëri,
 Se djalë më s'bënesh ti.
 Kur të shikosh djem beqarë,
 Do t'i shikosh duke qarë.



SPROVË LETRARE:

- Përshkruani ndjenjën kur këndohen këngët e vjetra të traditës popullore dhe çfarë paraqesin ato për jetën e të rinjve?
- Nëse dini këngë dasmash, tregoni disa veçori të tyre, duke i nënvizuar ato brenda një kënge të zgjedhur për analizë!
- Tregoni disa figura stilistike që shërbejnë për përshkrimin e vajzës apo të djalit, në poezitë e dhëna!

***Vajet**-Përfundimi i jetës dhe gëzimeve të saj mbyllet me vdekjen, një proces i pandalshëm, por mjaft i dhimbshëm për familjarët që humbin një person të afërt e të çmuar për ta, i cili përgjithmonë ndahet nga familja dhe rrethi shoqëror. Këto momente përcillen me këngë të njohura si këngë vajtimi-vaje. Natyrisht, këto përmbajnë pikëllim e nota elegjiake, britma dhe melodi të dhimbshme, e për familjarët tërë kjo ndodhi shndërrohet në tragjedi.

Vajet interpretohen nga ndonjë grua-vajtorja, por në disa krahina bëhet edhe nga burrat-vajtues. Përmbajtja e tyre është mallëngjyese, duke e rikthyer në kujtesë gjithë figurën dhe virtytet e të vdekurit.

Refreni dhe vokacioni janë figurat më të shpeshta të vajeve.

Ajkuna kjan Omerin

Çka ba , zot, Gjeto Bash Muji?
 Dymbdhetë shokë trimi i ka marrë,
 N'lugje t'verdha kur ka dale
 djalit shkjetë ja paskan vra...
 -Qyqja nana e padjalë!
 Ka nis grueja me bërtitë,
 sa shpejt jashta Muji e paska qitë.
 Qyqe vetëm rrugën ma paska marrë,
 Ka xanë vendi hyjt vajin për me e ndie.
 Kur ka dale ndër Lugje t'verdha
 at'herë hanën nana ka mallkue:
 -T'u shkimtë drita ty, o mori han-e
 qi s'ma cove at natë një fjalë,
 n'Lugje t'verdha shpejt me dale,
 bashkë me hi n'nji vorr me djalë!
 Ndoshta vorri t'dyve s'na kish xanë,
 ndoshta djali ngjat nuk m'kishte lane,
 një vorr t'ri, por kishe çilë për bri...
 Mallkue kjosh, e mori hanë,
 qysh me e lane nanën t'padjalë?
 Kur ka shkue te vorri djalit,
 ka pa ahintreqind vjeç,

ahi ishte rrema-rrema,
 pikon lodja mbi vorr t'djalit,
 kanë lane kangën zogjt e malit,
 kanë lane kangën me vështue!
 Po a nuk din se kush ka ardhë
 qi nuk çohesh për m'u falë,
 morei miri nanës-ooo,
 Amanet, e more bir,
 del një herë ksi burgut t'errët,
 fol me nanën qi t'ka rritë,
 s'm'ke lanë kurr kaq shumë me pritë!
 A thue gjogun me ta pru?
 Del ndoiherë për me lodrue
 bjen ndër gurra me u freskue,
 kërkon majet bashkë me zana
 se ty vorrin ta rue nana,
 more i miri i nanës-ooo!
 Orët e bjeshkës ma s'und p'e ndiejnë
 fjalën n'gojë po ja këtthejnë dale,
 zemrën s'rrahmija kanë ndalë,
 lott ndër sy mire po ja krijnë,
 ftyrën lotsh mire po ja shijnë,
 vetë e bajnë e e çojnë n'Jutbinë.

2. Lirika shoqërore përfshin krijime lirike të problematikës shoqërore, të cilat e pasqyrojnë jetën në shumë dimensione për të cilat populli shpreh mendime dhe ndjenja.

Larmia tematike e këtyre këngëve përafron me shumëllojshmërinë e jetës, familjes dhe shoqërisë, siç janë: këngët e dashurisë, këngët e mërgimit (kurbetit), këngët sociale, politike, këngët e nizamëve, motivet për natyrën etj.

*Këngët e dashurisë (erotike) janë këngët me motive për ndjenjat e të rinjve, lidhjeve intime e emocionale të çifteve gjinish të ndryshme që u këndohen atyre me sinjeritet e dëlirësi ndjenjash. Këto janë këngë të lashta, andaj edhe janë të përshtatura me ambientin real ku edhe janë krijuar, si: fshati, ambientet blegtorale, natyra idilike, baritore... gjithçka që ofron origjinalitetin e një ndjenje të lindur dashurie. Mirëpo, jo gjithmonë këto dashuri kishin fund të lumtur, pasi shpesh për shkak të mospërputhjes së shtresave shoqërore ato ndaloheshin dhe përfundonin tragjikisht.

Përshkrimi i bukurisë së të rinjve bëhet përmes gjuhës metaforike, shprehjeve të përzgjedhura dhe vargut tetërrokësh që i karakterizon ato.

Tundu bejkë e bardhë tundu

-Duke tundur zbret nga zalli
me shaminë hedhur ballit;
tundu, bejkë e bardhë tundu,
natënë me hënë duku;
bejkë e bardhë e bore e malit
ti je ilaç i çobanit.
-Gjithë natën e beharit,
cula dëgjohet te stani;
bëj të fle, gjumi s'më zë,
cula bie ëmbëlë
e dëgjon e gëzon xhani
i bie djalë çobani.
-Kopeja na kullot malit,
ato hanë majën e barit...
Në mëngjes pa gdhirë mirë
do takohem me barinë.

bejkë - dele e bardhë;
cula - vegël muzikore popullore.

*Këngët e kurbetit (të mërgimit) janë fondi lirik i këngëve, të cilat e përshkruajnë realitetin e kohës me të gjitha vështirësitë e jetës, gjë që i shpalos plagët e shoqërisë. Shkaktarët e largimit të të rinjve (burrave) për në kurbet ishin të shumta: gjendja e rëndë ekonomike, varfëria e skajshme, largimi nga përndjekjet, burgimet ose vrasjet, si gjatë kohës së Perandorisë Osmane, ashtu edhe gjatë pushteteve tjera politike. Kurbeti ka qenë dhe vazhdon të mbetet plagë e rëndë e shoqërisë shqiptare.

* * *

O të fala dheu ynë,
Të fala se po të lë
E s'kam për të parë më!...

* * *

Qani nëna sa të shëmbi
Mundim i djemve që bëni,
U vate për dhjamë qeni.

*Këngët e nizamëve përmbajnë tematikë mjaft të ndjeshme dhe na shpien në një periudhë të hershme kohore, në një plagë tjetër të popullit shqiptar.

Këngët e njohura si këngë nizamësh (nizam-ushtar/rekrut) janë krijuar gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, e cila në vitin 1839 nxori ligj dhe në mënyrë të dhunshme i merrte djemtë nga familjet e tyre dhe i dërgonte në vende të largëta e të rrezikshme ku zhvillonte luftëra për pushtimin e tokave të reja. Këto këngë ishin edhe më të ndjeshme për popullin, prandaj përmbajtjen e tyre, përpos dhimbjes e frikës e karakterizonte edhe urrejtja për armikun, si një dukuri shoqërore e padrejtë që popullin e mbante në pikëllim e vuajtje.

Dal në breg e vështroj fshatin

Dal në breg e vështroj fshatin:

Derë më derë po qajnë,
U vane djemtë nizamë!...
-Në pyeti, nëna për ne,
mësojmë...
ngremë gurë e ngremë dhe;
në fushë të Manastirit
ndreqim vendin e talimit;
vend' e talimit ndërtojmë,
pot ë zezat nëna ç'thonë?
Qani, o nëna, na qani,
shami të zeza të mbani,
sa të vimë nga nizami!
Qani, moj të zeza gra,
është shtatë vjet dava!

talim - vendi i stërvitjeve ushtarake.

EPIKA GOJORE

Gjinia epike popullore ka shtrirje të gjatë kohore të krijimit të saj dhe tematikë që përshkruan ngjarje të një periudhe të vështirë. Epika ka karakter tregimtar dhe përmes rrëfimit na përshkruan ngjarjen.

Epika gojore, sipas përmbajtjes njihet dy lloje këngësh:

- Këngët epike legjendare (heroike);
- Këngët epike historike.

Këngët epike legjendare janë këngë kushtuar bëmave të kreshnikëve dhe ngjarjeve që janë të lidhura ngushtë me ta, ndryshe njihen edhe si këngë heroike, ndërsa në popull njihen si këngët e kreshnikëve.

Janë këngë të cilat thelbin e përmbajtjes e kanë heroizmin e treguar pas shumë vështirësish e sakrificash në mbrojtje të vendlindjes apo atdheut. Vendi ku zhvillohen është krahina e Jutbinës dhe 30 agallarët e saj, bashkë me Mujën dhe Halilin, prandaj ndryshe quhen **këngët e Mujit dhe Halilit**.

Kreshnikët e Jutbinës kanë zhvilluar luftë të vazhdueshme me kapedanët, harambashët dhe ushtarët e krajlive (mbretërive). Ata bënë dëme të mëdha në popullatë: plaçkitnin, digjnin, vritnin, pra në mënyrë të dhunshme e nënshtronin popullin, duke ua marrë tokat, kullotat, bagëtitë etj. Mosdurimi i dhunës dhe plaçkitjes së vazhdueshme ishte arsyeja pse u organizuan agallarët e Jutbinës: Arnaut Osmani, Zuko Bajraktari, Tali prej Rudime, Omeri, Ajkuna, Tanusha e Dizdar Osmani, në krye me Gjeto Basho Mujën dhe vëllain e tij, Halilin.

Përmbajtja e këngëve të kreshnikëve ishte e gjatë, diku midis 200 - 1000 vargjeve të thurura plot ngjarje tërheqëse, megjithëse në to mund të ketë imagjinatë apo trillime, si vetë historia e Mujës, (*...ishte një çoban i varfërt, por duke pirë qumshtin e zanave mori fuqi të madhe, sa e ngrinte edhe gurin 1000 okësh*).

Kreshnikët ishin burra të fortë që ndihmoheshin nga qeniet mitologjike, të cilat ua shëronin plagët. Ata jetonin nëpër kulla, kryesisht merreshin me blegtori e gjueti dhe i përdornin mjeshtërisht armët e ftohta, topuzin e shpatën.

Këngë të njohura të kreshnikëve janë edhe ato me tematikë: idilike, erotike dhe elegjiake, si: përshkrimi i bukurisë dhe dashurisë së Tanushës, vaji dhe mërzia e Ajkunës për vrasjen e të birit, Omerit, këngët e Ymer Agës etj.

Një ndër këngët më popullore kushtuar bëmave të kreshnikëve është ajo për Gjergj Elez Alinë, e vlerësuar nga shumë studiues si kënga më e mirë ideo-artistike që sjell një frymë heroike për atdhetarizmin dhe fljimin në luftën e popullit për liri.

Fragmente nga këngët epike heroike*Fuqia e Mujit**

Lum e lum për t'lumin zot,
mu' jem kanë e zoti na ka dhanë!
Kur ish kanë Muja djalë i ri,
ma kish çue baba n'rrogë tu një zotni.
Çoban lopësh zotnia e ka ba.
Për gjithë ditë bjeshkët Muja tu i kërkue,
për gjithë ditë ndër gurra tu u freskue,
për gjithë ditë ndër mriza tuj pushue:
rrugë e shtek pa njoftë nuk ka lanë
m'i çon lopët gjithherë ku s'in kanë.
'I natë lopët çobanit i paskan hupë
e tu shpija nu' ka mujtë me dredhë.
Buzë një shkambi m'u ndalë asht ngushtue,
asht ulë djali aty për me fjetë,
paj dy djepa aty kin qillue,
e kanë marrë brimën e tuj kajtë.
M'asht avitë Muja me i shikjue,
m'asht avitë Muja me i pajtue.
Po i pajton tuj i përkundë
e të dy djepat i ka vu në gjumë.
Bardhë si drita dy zana at'herë kanë ardhë.
- Ty qysh të thonë, Mujon e kanë pvetë.
Zo', ç'të ka pru n'ket vend e shka t'ka tretë!
Kqyre Muja at'herë shka u ka thanë:
- Rrogtar lopësh un kam qillue,
për gjithë ditë k'to bjeshkë i kam kërkue;
mue rreziku sot ka ardhë me më ndeshë,
m'kanë hupë lopët e askund s'kam mujtë me i gjetë,
k'tu m'xu nata e u ugja për me fjetë,
s'mbylla sy prej vajit qi kam ndie,
ishin tuj kajtë këta dy fmij,
kurrkund çajre fmija nu' m'kan lanë.
M'u kanë dhimtë e jam hudhë me i pajtue,
i pajtova e sa grima n'gjumë i ka vdue.
Po zo', shka jeni me gjithë ket dritë?
- Zana jemi, Mujo, tuj shetitë,
tu u sjellë na njerzvet me u ndimue.
Ti çfarë nder, Mujo, po na lypë,
qi dy djepat na i ke vu në gjumë?
A don forcë, Mujo, me qindrue?
A don luftë, Mujo, me luftue?
A don gja, Mujo, a don mall?
A don dije, Mujo, a don gjuhë?
Lyp shka t'duesh, Mujos te i kanë thanë.
Kqyr Muji atherë ç'ka qitë e ka thanë:
- Shpesh po m'gucin çobania,
shum inat çobajt si më kanë,
paj me forcë me jau kalue un due.
Njana shoqes zanat atherë i kanë thanë:
- Tamel gjiut Mujit për me i dhanë.

Tamel gjiut i kanë dhanë me pi,
me tri pika djalin ma kanë ngi
e i ka falë zoti kaq fuqi
sa me e luejtë shkambin ma t'madhin.
- Kape gurin, zanat i kanë thanë:
Nji mi okësh e ma guri ish' kanë.
E ka kapë gurin një mi okësh,
badihava peshue me duer e ka,
der nyje t'kamës na mujt ma.
Njana shoqes zanat atherë i kanë thanë:
- Edhe do tamël, Mujos me ja dhanë.
E ka marrë tamlin Muji e e ka pi,
e ka kapë gurin me e peshue
deri në gju ai gurin e ka çue;
e ka ugjë prap n'tokë e ka pushue.
Kqyre zana sa mirë ka thanë:
- Edhe pak gji Mujos me ja dhanë.
I kanë dhanë prap gji për për me pi,
sa don zoti t'i ka dhanë fuqi,
e e ka marrë gurin me e peshue
deri në shogë gurin e ka çue.
E kanë pa zanat, e kanë kqyrë,
njana tjetrën prap te i ka thanë:
- Opet Mujit gji lypet me i dhanë.
E ka marrë Muji gji me pi,
ose ç'po i ep edhe zoti fuqi
kenka ba si me kanë drangue.
Ka marrë gurin me e peshue,
n'cep të krahit Muji e ka vdue,
një mi okësh gurit i ka qindrue.
Njena shoqes zana çka i ka thanë?
- Tjetër gji Mujit mos me i dhanë.
Pse, tjetër gji Mujit për me i dhanë,
e batisë dynjanë anëmanë...
Kqyre zanat Mujit shka i kanë thanë!
- Probatin na, Mujo, duem me të xanë.
Fol ti, Mujo, tash qysh po thue?
- Tu t'jem ngusht, zanat, me m'ndihmue!
N'Fushë t'Jutbinës Muji kur a ra
bytn shokët e mbledhun i ka pa,
kqyre seri Muji shka ka ba!
Ja ka nis me çobaj me ladrue,
send ma t'fortin me dorë e ka kapë
pesë konopë përpjetë i ka dhanë.
Askurrkush me folë nuk po flet.
Prej zotnisë, tha, Muji asht largue,
ka dredhë n'shpi, tha, nanen për me e pa.
Tha, ja ka nisë Muji taj punue
tha, ja ka nisë Muji tuj luftue
e, n'sa lufta Muji si po bjen,
ai gjithherë me nderë si po del.

Gjergj Elez Alia

Trim mbi trima ay Gjergj Elez Alia!
 Qe nand' vjet nand'n; shtrat m'i ka
 Veç një motër nat' e ditë te kryet,
 ja lan varrat me ujt e gurrës nandvjeçe.
 Ja lan varrat me ata lott e syve,
 Ja terr gjakun me ata flokët e ballit,
 shtatin vëllait ja shtrëngon m'rubat të nanës
 n'petka t'babës trupin ja hijeshon,
 armët e brezit ja vëndon mbi krye!
 Saherë trupin motra p'e tërnueke,
 dhimba e varrëve vllau krejt e harrueke!
 A dalë zasi e paska marrun dhenë,
 Se 'i balozi zi a dalë prej detit.
 Trim i prapët e belagji qi ish' kanë
 ja ki' qitun dheut një rreng të randë,
 "Tim për tim kah një dash të pjekun,
 tim për tim kah një vashë me ja djergun, 3)
 dtë për ditë kah një kreshnik me premun,
 javë për javë kah një krahinë me djegun!"
 Edhe Gjergjit rendite i ka ardhë,
 me lot faqet trimit m'iu kanë mbushë.
 Erzi i shpisë qysh lshohet n'dorë t'balozit?!

Jaka nisë e motra e po bërtet,
 krejt me lot Gjergjin p'e loton:
 -Po qysh mordja, o vlla, me na harrue?
 Nanë e tatë kah kalben për nan bli,
 trupi i vllaut vorrue qe nandë vjet në shpi,
 trupi i motrës n'dorë t'balozit t'zi?!

Qysh s'u shemka kulla me na zanë,
 qysh s'u kthyea shpija n'nji murine
 me t'pshtue erzin, mori e zeza nanë!
 Dy copësh zemra djalit iu ka da,
 dy sytë në ballë motrës ja ka lshue,
 dy riga lot për faqe te i kanë shkue.
 Dy fjalë kullës djali ja ka fjakrue:
 -Hej, ju u nxisha, mori sarajet e mija,
 me lymashk u mbloshi n'fund e n'krye,
 brevë e gjarpën paçi motër e vlla.
 Pikët ndër shtroje kaq shpejt qysh m'i lshuet?!

-Jo, more, vlla, lum motra, i ka përgjegjë,
 t'kahlodhë jermi e s'po di ç'je kah folë;
 se përjashta shi nuk asht tuj ra,

sytë e motrës po t'pikojnë more vlla!
 Q'atherë Gjergji dorën ja ka shtrëngue,
 mirë po e limon me ato duert e shtatit,
 mirë po e kqyrë me ata dy sytë e mallit!
 Kurr ma thekshëm djali s'i ka folë:
 -Amanet, mori motër, pse po kan?
 zemrën dysh, mori motër, pse ma dan?
 Qe nandë vjet, qi trupi a t'um'u kalbë,
 Gjergji yt tjetër pushim nuk ka,
 Veç si gjeth i ahit n'log t'shullanit.
 A thue s'pate me ngranë e me pi?
 A t'la ty vllau për veshë e mbathtë?
 A mos t'u randue, ndoiherë, me fjalë,
 motërzezës vllau me iu mërzitë,
 huj për burrë ndoshta qi me t'ra?
 Sa mirë motra vllaut po m'i përgjegjë,
 dorën e vllaut tu balli e paska vndue:
 -Amandet ku je, mori njomzëja o ahit,
 po a kaq fort, thue, jermi t'ka ngushtue?
 Hisha gjallë në dhe, n't'u martue motra!
 Mjaft kam pasë, o vlla, me ngranë, me pi,
 mjaft kam pasë me veshë edhe me mbathë,
 kurr ma randë se sot ti folë nu' m'ke!
 Tjetër babë nuk kam, as tjetër nanë,
 amanet, more vlla, mos me m'pasë randë,
 për një dert qi sot po due me t'kajtë!
 qysh s'u njom ky shtat qe nande prandvera!
 Si s'u mkamb ky trup me dalë tu dera!
 Si s'u tha kjo motër, thafta - vera,
 po un balozit qysh i shkojtu dera?
 Braf në kambë por djali konka çue.
 -T'e marrsh gjogun, motër, të mejdanit,
 fill n'gjjtet me te, motër, të mbijsh
 et'më shkojsh tu nallban probatini!
 "Falëmeshndet, thuj Gjergji të ka çue,
 me ma mbathë me patkoj prej tumakut,
 me m'ja shti thumbat prej çelikut,
 se n'mejdan balozit due me i dalë!"
 S'u gjegj gjogun vllathi me ta mbathë,
 hypi atit, bjeri n'derë jaranit.
 E në sheher çika konka ra
 edhe a' shkue tu nallbanprobatini.
 -Puna e mbarë të kjoftë, more kumbar!
 Të mbarë paç ti mori vasha e largë!

Fjalorth:

varra - plaga;**muranë** - grumbull gurësh në vendin ku
është vlarë ose ku është varosur një njeri;**erzin** - nderin;**brevë** - gjarpër johelmues;**tumakun** - hekur i fortë.

Këngët epike historike janë këngë të shkruara mbi ngjarje reale e të konkretizuara mbi vendin dhe etapat kohore para, gjatë dhe pas pushtimit të Perandorisë Osmane. Në këto këngë përshkruhet fati i popullit shqiptar vështirësitë, vuajtjet dhe pesha e rëndë e këtij sundimi shekullor.

Tematika e këtyre këngëve ka një hark të gjerë shtrirjesh, si kohore, ashtu edhe hapësinore, gjatë së cilës dalin në pah heronj të shumtë, trimëria e të cilëve jo vetëm që i jep shpresë dhe krenari popullit, por edhe e ushqen në vazhdimësi dellin artistik. Kështu krijohen dhjetëra këngë kushtuar trimërive të këtyre djemve shqiptarë që atdheun dhe lirinë e kanë më të çmuar se jetën.

- **Këngët historike të luftës 25 vjeçare**, të periudhës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut;
- **Këngët historike të kryengritjes shqiptare**, para dhe pas Reformave të Tanzimatit, të vitit 1839;
- **Këngët historike të periudhës së Rilindjes Kombëtare**, nga Lidhja e Prizrenit (1878) deri te Pavarësia e Shqipërisë (1912).

**Fragmente nga këngët epike historike*

Gjorgj Golemi

Ky Sulltani qan me lot:
 -Kam edhe një Skender n'Sopot!
 Në Mal Plak në një breg,
 Gjorgj Golemi thotë "jam mbret";
 në Mal Plak e në Sopot,
 Gjorgj Golemi kryezot!
 Njëzet vjet me te luftoi,
 asqerin ma turpëroi!
 Gostivaras more evlat,
 shkon n'Sopot e fle një natë!
 -Unë fjeta dhjetë vjet;
 Gjorgj Golemi, trim me fletë,
 n'Galigat shkon dy net;...
 do të shkojë me gjithë ushtri.
 Kjo maria tha një fjalë
 mu te mani paska dale:
 -Ti, o prind, mos hyp në kalë,
 Do vijë turke të na marrë!
 Ndal, o at, ku po shkon?

Do vij' turke na pushton,
 n'Moll' të kuqe ai na çon!
 Ti, o at dëgjomë këtë herë,
 Se vjen turku e na ther!...
 -Unë do shkoj në Shmëri.
 -Në mëngjes sa zbardh mali,
 më kërkoi cicë djali,
 Mark Millosi në liqe
 luan shpatën pors dre;
 luan shpatën si dragoi
 edhe turqit i coptoi.
 Shtiva sytë në Shkallë Kurorë,
 po vjen asqeri si flogje bore!
 Ti o Bos, o sypërpetë,
 tyja fara most ë mbetë,
 Sopotare moj të ngrata,
 rrokni thika, rrokni shpata!
 A do ikim të shpëtojmë,
 a do rrimë të luftojmë?
 -Ne do rrimë të luftojmë,
 Gjorgj Golemin s'e turpërojmë!

- **Gjorgj Golemi** - Gjergj Arianiti, një ndër princat shqiptarë më me autoritet, vjehëri i Gjergj Kastriotit - Skënderbeut.

Hajredin Pasha po vjen Radikës

Hajredin Pasha, po vjen Radikës,

pyet ku janë mallet e Dibrës:

-Vallë, ku janë mallet e Dibrës?

Bajnë xhilis në Fushë t'Gjuricës,

bajnë xhilis e lidhin besën

"Hajredin Pashën do ta presim!"

-Moj Gjuricë, moj kasaba

çon pasha e ban rixha,

po rixhaja s'iu ka digjou

i ktheu topat me luftou.

Sheh Zerqani fjalë ka çou:

-Thoj Kaloshit me na ndimou

Grikn e Madhe e kanë rrethou

për rreth Drinit tu luftou,

xhimca mbet, xhimca pjagou.

Ditën e martë u zou nizaja,

Hajredin Pashën e xhet belaja

e xhet belaja si e ka xhetë

shtatë taboret i jonë shkret.

Nandë mijë vorret kushi boni?

Të nandë mallet e Sheh Zerqani.

Fjalorth:

Hajredin Pasha - komandant turk, që u dërgua në Dibrë të Madhe, më 1844, për t'i zbatuar reformat;

Radika - lumë afër Dibrës;

Xhilis - kuvend, mbledhje;

Në Fushë t'Gjuricës - toponim afër Dibrës;

Sheh Zerqani - udhëheqës i malësorëve dibranë;

Grikn e Madhe - një nga katër grykat e Dibrës;

Xhimca - gjysma.



INTERPRETIM:

- Prezantoni letërsinë popullore dhe traditën e saj ndër shekuj?
- Çfarë paraqet letërsia popullore dhe si ndahet ajo?
- Si formohen motivet e këngëve popullore, ku merret lënda e tyre?
- Përshkruani frymëzimin e autorit dhe ndjenjat e personazheve në lirikën tonë popullore?



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Si përshkruhet zanafilla e epikës legjendare?
- Rikujtoni disa karakteristika të epikës historike!
- Gjeni figurën e krahasimit dhe hiperbolës në këngët e epikës historike!
- Shënoni disa ninulla apo këngë dasmash nga treva juaj!
- Pse janë të veçanta këngët e kurbetit?



HISTORIA E LETËRSISË SHQIPTARE

— LETËRSIA E VJETËR SHQIPTARE

- DOKUMENTIMI I SHQIPES SË SHKRUAR
- HUMANIZMI NË LETËRSINË SHQIPTARE
- LETËRSIA FILOBIBLIKE
- ALAMIADA SHQIPTARE

LETËRSIA E VJETËR SHQIPTARE

Letërsia shqiptare është thesar kulturor i shqiptarëve, si popull vendas (autokton) në trojet e Ballkanit dhe Gadishullit Ilirik, me një trashëgimi të lashtë si vazhdimësi e traditës ilire. Identiteti kulturor i shqiptarëve përshkruhet përgjatë shekujve, duke u mbështetur në kulturën popullore, e cila i bën ballë kohës, shkatërrimit nga pushtimet e huaja dhe asimilimit që drejtpërdrejt prekte gjuhën, simbolet dhe vlerat tona kombëtare. Këto janë disa arsye pse gjurmët e shkrimit shqip janë më të vonshme, megjithëse përpos dëshmimeve gjuhësore dhe dokumenteve të deritanishme, të vendosura nëpër libra, vazhdojnë zbulimet rreth artefakteve që e përjetësojnë kulturën e lashtë të popullit tonë.

Shumë dijetarë me origjinë iliro-shqiptare kanë kontribuar për zbulimin e fakteve rreth shkrimit, duke filluar nga Shën Jeronimi, megjithatë shqipja e shkruar dëshmohet nga shekulli XIV-XV e më vonë (edhe pse ekzistojnë hipoteza e janë gjetur edhe dëshmi më të hershme).

Letërsia shqipe është zhvilluar në disa periudha historike: Letërsia e Vjetër Shqiptare, Romantizmi dhe Rilindja Kombëtare, Realizmi, Letërsia midis Dy Luftërave Botërore, Letërsia Bashkëkohore. Ndër to, Letërsia e Vjetër Shqiptare përfaqëson periudhën më të gjatë dhe më të hershme të krijimtarisë shqipe, që fillon në shekullin XVI me veprën e Marin Barletit dhe Gjon Buzukut e përfshin krijime deri në shekullin XIX, kur nis periudha e Rilindjes me veprën “Milosao” të Jeronim de Radës.

Letërsia e Vjetër Shqiptare, përmes veprave dhe autorëve të kësaj periudhe, dëshmon për kulturën shkrimore të shqiptarëve, si një ndër popujt më të lashtë. Në këtë fazë të hershme kemi dokumente të rëndësishme të humanizmit shqiptar si dëshmitë për fillimin e letërsisë shqiptare, siç janë: dëshmia e Guilelm Adaes (1332), letra e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut dërguar princit Gjon Antonio Orsini (1460) dhe vepra e Marin Barletit “Rrethimi i Shkodrës” (1504), si dhe dëshmitë se gjuha shqipe ka filluar të shkruhet para se të shkruheshin libra, siç janë: dokumenti i Pal Engjëllit (1462), fjalorthi i udhëtarit gjerman Arnold von Harfit (1497) dhe Ungjilli i Pashkëve (shek. XV-XVI).

Të gjitha këto dëshmi dhe të tjera, flasin për ekzistencën e shkrimit në gjuhën shqipe para vitit 1332, për të cilën dëshmon Guilelm Adae (murgu Brokad), për **kronikat** që flasin për epirotët (shqiptarët) para vitit 1460 (Skënderbeu) dhe për **analet** e shkruara në gjuhën e vendit që flasin për një periudhë shumë të vjetër, atë të kalasë së Rozafës, në Shkodër (Barleti).

Dokumentet e para të shqipes së shkruar janë:

- Formula e Pagëzimit (1462);
- Fjalorthi i Arnold von Harfit (1497);
- Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve (fundi i shek. XV-fillimi shek. XVI).

Dëshmitë e kësaj periudhe i përfshijnë rregullat e Pal Engëllit dhe kronikat për Skënderbeun, por veçmas veprën e Gjon Buzikut (1555), Lekë Matrëngës e të tjera, në të cilat vërtetohet fillimi i përdorimit të gjuhës shqipe dhe historia jonë në dokumente zyrtare për qëllime kishtarë apo kulturore.

Letërsia e Vjetër Shqiptare përbën një nga etapat më të rëndësishme të zhvillimit të kulturës dhe të gjuhës sonë kombëtare. Ajo dëshmon përpjekjet e para të klerikëve shqiptarë për ta përdorur gjuhën shqipe si gjuhë të shkruar dhe për ta ruajtur atë në kushtet e vështira historike. Veprat e kësaj periudhe nuk kanë vetëm vlera fetare e didaktike, por edhe rëndësi të madhe gjuhësore, historike dhe kulturore.

Autorët: Gjon Buzuku, Lekë Matrënga, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Jul Variboba dhe të tjerë, me krijimtarinë e tyre, hodhën themelet e traditës së shkrimit shqip dhe ndihmuan në pasurimin e gjuhës e të kulturës kombëtare. Nëpërmjet veprave të tyre u përcollën ide, këshilla moralizuese, njohuri për botën dhe dashuri për gjuhën e atdheun.

Letërsia e Vjetër Shqiptare është një dëshmi e qëndresës shpirtërore të shqiptarëve dhe e rolit të madh që ka luajtur fjala e shkruar në ruajtjen e identitetit kombëtar. Ajo mbetet një pasuri e çmuar e trashëgimisë sonë kulturore dhe një pikënisje e rëndësishme për zhvillimin e mëvonshëm të letërsisë shqipe.

PAL ENGJËLLI

(1417 - 1470)

Formula e pagëzimit (1462) është dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe, i cili përbëhet nga një fjali e shkurtër: *“Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit”* (gjendet në një qarkore të shkruar në latinisht), në vitin 1462.

Pal Engjëlli lindi në vitin 1417 në familjen fisnike Engjëlli, e cila kishte zotërime në Shqipërinë e Mesme. Mendohet të ketë lindur në Drisht të Shkodrës. Ishte kryepeshkop i Durrësit, humanist, diplomat dhe një nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ai shërbeu si këshilltar dhe i dërguar diplomatik i Skënderbeut në misione të ndryshme në Evropë, duke kërkuar mbështetje kundër pushtimit të Perandorisë Osmane.



Gjatë një vizite në Mat, ai vuri re çrregullime në punët e ushtrimit të fesë dhe me këtë rast mbajti një kuvend për t'i tejkaluar vështirësitë. Pas luftërave të gjata kundër pushtimit osman, popullsia e Arbërisë ishte rënduar ekonomikisht dhe shpirtërisht e në këto kushte, Pal Engjëlli, ndërmori udhëtime të shpeshta për të vizituar kishat e dioqezës së tij. Në Kuvendin e Matit, të mbajtur më 8 nëntor 1462, në kishën e Shën Trinisë, ai la me shkrim disa porosi dhe udhëzime për klerin katolik, gjegjësisht veprën “Rregullat” (1462). Në të e kishte vendosur edhe “Formulën e pagëzimit”: *“Unte paghesont premenit Atit et birit et spertit senit”*. Në rrethanat e vështira të kohës, meqë ai udhëtonte shpesh nëpër dioqezë për t'i ndihmuar besimtarët dhe për të lehtësuar jetën fetare të popullsisë propozoi që në mungesë të priftërinjve, pagëzimi i fëmijëve të bëhej në gjuhën shqipe dhe kështu lindi fjalia historike: *“Unë të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit të Shenjtë”*.

Pal Engjëlli besonte se me anë të frazës së mësipërme, prindërit shqiptarë vetë mund t'i pagëzonin fëmijët e tyre, në rastet kur nuk kishin mundësi t'i dërgonin në kishë kur vendbanimi nuk kishte prift, apo në kushte shumë të vështira, kur ishte mot i keq dhe kisha ndodhej larg.

Formula është shkruar me alfabetin latin dhe në dialektin e veriut (gegërisht).


“Formula e pagëzimit” është gjetur në Bibliotekën “Laurentiana” të Firencës nga historiani i njohur rumun Nikolla Jorga dhe është botuar prej tij në vitin 1915 (në “Notes et extraits pour servir l'histoire des croisades au XV siecle IV, 1915”). “Formula e pagëzimit” e Pal Engjëllit, e shkruar në vitin 1462, është një dëshmi e rëndësishme për historinë dhe zhvillimin e gjuhës sonë, si dhe përpjekje për të ruajtur fenë dhe kulturën shqiptare përmes shkrimit.

FORMULA E PAGËZIMIT

Origjinali: Vnte paghesont prememit Atit et birit et spertit senit.

E transliteruar: Unë të pagëzont pr' emënit Atit e t'birrit e t'shpertit shenj.

E transkribuar: Unë të pagëzonj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit të Shenjtë.



— Formula e pagëzimit.

"FJALORTHË" I ARNOLD VON HARFIT

Dëshmi tjetër me rëndësi është ajo e Arnold von Harfit.

Arnold von Harfi ishte një kalorës gjerman, nga Këlni, i cili më 1496 i kishte filluar udhëtimet e tij drejt vendeve të shenjta të Palestinës. Në vitin 1497, gjatë lundrimit me anije nëpër Detin Adriatik u ndal në viset shqiptare: Ulqin, Durrës e Sazan ku ra në kontakt me banorët vendas dhe për të komunikuar me ta, ai shënoi disa fjalë në gjuhën shqipe, gjithsej: 26 fjalë, 8 shprehje dhe 12 numërorë, duke u vënë përbri edhe fjalët në gjuhën gjermane.

Arnold von Harfi e krijoi fjalorin dygjuhësor që njihet si Fjalorthi shqip-gjermanisht. Këto shënime, në vitin 1860, i gjeti Von Grote dhe i botoi në të njëjtin vit, duke lënë kështu një dëshmi të hershme të shkrimit të gjuhës sonë, në dialektin e gegërishtes.

Edhe ky dokument ka rëndësi për gjuhësinë dhe i vërteton veçoritë e dialektit të veriut nga është vjelur leksiku. Autori, për shkrimin e gjuhës shqipe, e përdor alfabetin latin të tipit gotik.

PERIKOPEJA E UNGJILLIT

Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve ose Ungjilli i Pashkëve është një tjetër dokument i shkruar shqip (me shkronja greke) i gjetur brenda një kodiku greqisht të shek. XIV. Mendohet se dokumenti i përket periudhës së fundit të shek. XV apo fillimit të shek. XVI dhe është përkthim (autor anonim) i një pjese të Ungjillit të Shën Mateut, kaptina XXVI, paragrafët 62-66 dhe një këngë pashkësh.

Përkthyesi i panjohur, për të cilin mendohet se ka qenë ndonjë prift shqiptar që ka ditur pak greqisht (pasi hasen gabime), solli një pjesë të ungjillit në dialektin toskërisht. Ky është përkthimi më i hershëm biblik në gjuhën shqipe, si një fletë e gjetur brenda kodikut, e zbuluar nga studiuesi Spiridon Lambros, në Bibliotekën e Milanos, në vitin 1906.

- 1... ..
- 2... ..prej shin Matthe
3. ungjill, anagnosmë: evan(gjel) shintë e Premte e Madhe.
4. e më nesër, që (n)esër, që ishte më të Prempte, u mbë-
5. lodhi e priftëri edhe farisej e thanë Pilati(t):
6. Zot e kujtuam se ai u plan; edhe kur i(sh) engj-
7. allë, tha se pre tre dit përiremit, urdhuro
8. ashtu, nqiellshi Zot t'u mbilletë varri mos pikej
9. e vinë natë(n) ai avtu mathitai e vjedhin
10. ata pra thonë lausit se u ngre se vdekuri
11. e është ma kejq se prapa e kejqe se para.
12. Pra tha Pilati: kejni kustodhi prinin mbi-
13. llë(ni) varrënë si e pat e sfragjiseni gur me të
14. gjithë kustodhie. Shum vjetë, zoti nun.



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Lexoni tekstet me kujdes dhe bëni krahasimet e fjalëve në dialekte, duke prezantuar rolin dhe rëndësinë e shkrimeve të hershme të gjuhës shqipe!
- Bëni një listë librash (nga biblioteka juaj personale), sipas kronologjisë së botimit, duke filluar nga libri më i vjetër!

HUMANIZMI NË LETËRSINË SHQIPTARE

Humanizmi është një ndër lëvizjet më të rëndësishme kulturore, shkencore, filozofike, letrare e artistike e periudhës së Rilindjes. Kjo lëvizje u zhvillua si reagim ndaj botëkuptimit mesjetar, i cili në qendër e kishte fenë dhe jetën pas vdekjes, duke e lënë nën hije njeriun dhe nevojat e tij tokësore.

Në aspektin shoqëroro-ekonomik, humanizmi lindi në një kohë kur feudalizmi po binte dhe krijoheshin kushtet për një rend të ri borgjez. Me zhvillimin e qyteteve, zejeve të ndryshme, tregtisë dhe shtypit të librit, u krijuan kushtet për përhapje më të gjerë të ideve të reja mbi konceptin human. Njerëzit, nuk ishin më thjesht, nënshtetas të një feudi apo një mbreti, por qytetarë të lirë që kërkonin arsimim, drejtësi, jetë më të mirë e të dinjitetshme.

Humanizmi e vendosi njeriun në qendër të gjithçkaje, si subjekt veprues dhe qenie e lirë, e pajisur me mendje dhe ndjenja me të drejtën për ta kuptuar botën përreth dhe për ta përmirësuar atë.

Përfaqësuesit e kësaj lëvizjeje nuk e mohuan Zotin apo fenë, por ata kërkuan që Zoti të kuptohej përmes arsyes dhe natyrës, jo vetëm përmes dogmave kishtare. Prandaj, humanizmi nuk kishte domosdoshmërisht frymë antifetare, por ishte lëvizje që kërkonte ta zgjerojë horizontin njerëzor përtej kufizimeve kishtare dhe autoritare të kohës.

Humanizmi lindi në Itali, ndërsa në fund të shekullit XIV dhe gjatë shekujve XV dhe XVI u përhap në tërë Evropën. Si lëvizje synonte rikthimin të kultura me vlera, ajo klasike greko-romake, duke marrë si model virtytet, dijet, artin dhe filozofinë e antikitetit. Humanistët i lexonin, përkthenin dhe studionin me pasion veprat e Ciceronit, Platonit, Aristotelit, Homerit, Virgjilit etj., të cilat përmbanin urtësi të thella dhe ishin udhërrëfyese për një jetë më të ndritur.

Ndër përfaqësuesit më të shquar të humanizmit evropian veçohen: Dante Aligieri, Françesko Petrarka, Xhovani Bokaço dhe shumë të tjerë. Këta intelektualë i hodhën themelet për një mënyrë të re të menduarit ku njeriu duhej të ishte i lirë të mësonte, të pyeste dhe të shprehej pa frikë.

Në pikëpamjen kulturore, kjo lëvizje ndikoi në zhvillimin e arteve të bukura, letërsisë, filozofisë dhe shkencës.

Si humanistë shqiptarë, me veprat e tyre u dalluan: Gjini Gazuli (1400-1465) shkencëtar: matematikan e astronom, që jetoi në Raguzë; Nikollë Leonik Tomeu (1456-1531), mjek dhe filozof, i lindur në Venedik; Mikel Maruli (1453-1500), poet i humanizmit shqiptar dhe evropian, i lindur në Konstadinopojë; Martin Segoni (1440/45-1485) shkrimtar tregimesh historike, i lindur në Kotorr (për vendlindjen e tij ka hamendësime); Marin Beçikemi - Shkodrani (1468-1526), filozof e orator i lindur në Shkodër; Marin Barleti Shkodrani (1460/63-1512/13, historiograf etj. Këta intelektualë, shpesh të lidhur me qendra evropiane studimi, ishin mbrojtës të kulturës shqiptare dhe ndërmjetës të dialogut midis Lindjes dhe Perëndimit.

Humanizmi shqiptar zhvillohet në dy faza: në fillim brenda territoreve shqiptare dhe më vonë jashtë tyre.

Faza e parë nis rreth vitit 1479 dhe përfshin përpjekjet e intelektualëve për të ruajtur vlerat kulturore dhe identitetin kombëtar në kushtet e pushtimeve të huaja, të cilët lanë shkrime ku përshkruhet heroizmi shqiptar dhe historia e luftërave për liri.

Faza e dytë e humanizmit shqiptar zhvillohet kryesisht jashtë trojeve shqiptare, në qendrat kulturore të Italisë dhe vendeve të tjera evropiane. Humanistët shqiptarë, të mërguar, pas rënies së vendit nën pushtetin osman, krijuan vepra me vlera historike, letrare dhe shkencore. Në to e pasqyruan historinë, kulturën, traditat dhe qëndresën shqiptare, duke e bërë të njohur çështjen kombëtare në Evropë. Përfaqësues më i shquar i kësaj faze ishte Marin Barleti, krahas figurave si Marin Beçikemi, Mihal Artioti dhe Dhimitër Frangu.

Kjo lëvizje, megjithëse e zhvilluar në kushte më të vështira për shkak të pushtimit osman, solli figura të ndritura si Marin Barleti e të tjerë. Humanizmi nuk ishte vetëm një rrymë kulturore, por një lëvizje që e ndryshoi mënyrën se si njerëzit e shihnin botën, Zotin, vetveten dhe njëri-tjetrin, duke i dhënë njeriut zërin e munguar, guximin dhe dijen për ta ndriçuar mendjen, për të vënë themele të reja e të qëndrueshme për kulturën.

MARIN BARLETI - SHKODRANI

(1460/3 - 1512/3)

Marin Barleti njihet si humanisti dhe historiografi më i shquar shqiptar. Humanizmi ndikoi shumë në formimin e tij atdhetar, pasi ideja humaniste bazohej te arsyeja, përvoja dhe liria personale për të krijuar mendim të pavarur dhe origjinal.

Fillimisht, humanistët në shkrimet e tyre e përdorën gjuhën latine, por më vonë filluan të shkruajnë edhe në gjuhët kombëtare për ta afruar dijen më pranë popullit.

Jeta e Marin Barletit, vendlindja dhe të dhëna të tjera janë të pamjaftueshme për ta përshkruar figurën e tij madhore. Dihet se në moshë të re, në vitin 1478 mori pjesë në rrethimin e parë të Shkodrës, kur ky qytet fortifikues u sulmua nga osmanët. Aty u njoh nga afër me heroizmin e madh të bashkëkombasve dhe u frymëzua për t'i përshkruar ato ngjarje në veprat që botoi.



Barleti ishte historian dhe prift katolik nga Shkodra, edhe pse disa studiues mendojnë se vendlindja e tij ishte Barleta ose Raguza. Dy dokumente pak më të vonshme, njëri nga një noteri e Padovës, i shkruar më 1496, ku përmendet emri Marinus Barleta Scodrensi dhe i dyti, në një testament të vitit 1501, ku përmendet emri Marinus Scodrensi (Marin Shkodrani) dëshmojnë për prejardhjen e tij. Çmohet si historiani i parë dhe bëhet i njohur me dy veprat: "Rrethimi i Shkodrës" dhe "Historia e Skënderbeut".

Besohet të ketë lindur rreth viteve 1460-63 dhe jetoi në një periudhë të trazuar për Shkodrën. Mendohet se ka qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë i rrethimit të qytetit në vitin 1479 dhe i luftërave heroike të shqiptarëve.

Barleti u lind dhe u rrit në Shkodër, atëherë pjesë e Republikës së Venedikut. Në veprat e tij e quan veten *scodrensis* (shkodran) ku më pas e barazon të qenit shkodran me të qenit *epirotas*.

Më 1474, Barleti duhet të ketë marrë pjesë në mbrojtjen e Shkodrës në rrethimin e parë nga ushtria osmane, ashtu si edhe në të dytin, më 1478, ngjarje për të cilat shkroi në librin "Rrethimi i Shkodrës". Prindërit e tij u vranë gjatë rrethimeve. Kur Venediku ia lëshoi Shkodrën Perandorisë Osmane, me traktatin e Kostandinopojës më 1479, Barleti vajti në Venedik, ku u bë studiues i historisë, letërsisë klasike dhe i gjuhës latine. Më 1494, pas studimeve teologjike në Venedik dhe Padovë, u emërua famullitar në kishën e Shën Shtjefnit në Piovene.


Gjatë qëndrimit në Venedik e botoi veprën e parë "Rrethimi i Shkodrës", më 1504 dhe më 1508-'10, në Romë e boton veprën e dytë "Historia e Skënderbeut". Shekulli XV ishte periudhë vendimtare për kulturën shqiptare, pasi përkonte me

kulmin e përpjekjeve për mbrojtjen e territorit shqiptar nga zgjerimi osman. Të dyja veprat e theksuara të Barletit, i përshkruajnë luftërat e Skënderbeut, të cilat përveç ndikimit politik dhe ushtarak sollën edhe konsolidimin e identitetit kombëtar shqiptar.

Në veprën **“Rrethimi i Shkodrës”** (1504), Barleti i përshkruan me gjallëri këto ngjarje, duke ofruar një perspektivë emocionale dhe të detajuar. Në të përshkruhet lufta dramatike për jetë a vdekje e banorëve të qytetit, të rrethuar nga osmanët, nga viti 1478-1479.

Historiani dhe prifti katolik nga Shkodra është figura më e njohur për dokumentimin e jetës së Skënderbeut, përmes veprës së tij të famshme: “Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis” pra, “Historia e jetës dhe bëmave të Skënderbeut, princit të Epirit”. Vepra u botua për herë të parë në vitin 1508-1510, në Romë dhe u shndërrua në një dokument të rëndësishëm për njohjen e Skënderbeut dhe rezistencën shqiptare kundër pushtuesve osmanë.

Vepra “Historia e Skënderbeut”, përbëhet nga 13 libra, një përmbledhje historike, në të cilën afirmohen vlerat humaniste, si: liria, dinjiteti, drejtësia dhe atdhedashuria. Gjithashtu, theksohet rëndësia e mendimit të lirë dhe gjykimit të drejtë që përmes Skënderbeut thekson fjalë që e bartin thelbin e humanizmit: **“Veç mendjes dhe gjykimit njerëzor nuk ka gjë më të lartë”**. Barleti gjithashtu e promovoi konceptin e luftës së drejtë, duke e dalluar atë nga luftërat pushtuese dhe të padrejta. Sipas tij, lufta për liri është sakrificë sublime që vjen nga dashuria për vendin dhe njerëzit.




Në portretizimin e Skënderbeut, Barleti i harmonizon virtytet fizike, morale dhe intelektuale, duke e bërë atë, jo vetëm udhëheqës ushtarak, por edhe figurë të ndritur kulturore. Ai arrin të ndërthurë emocionin me arsyen dhe shpirtin me mendimin kritik. Karakteri heroik dhe rëndësia për mbrojtjen e krishterimit, në Evropën e asaj kohe, shpaloset jo vetëm nga betejat e Skënderbeut kundër osmanëve, por edhe në aftësitë diplomatike të tij.

«Historia e Skënderbeut» e Barletit u bë burimi më i rëndësishëm prej ku patriotët shqiptarë e mësonin historinë e luftërave të lavdishme të popullit tonë nën udhëheqjen e Skënderbeut dhe frymëzoheshin për përpjekjet e tyre për shpëtimin dhe lirinë e Shqipërisë. Shumë të dhëna, autori mori në mjediset e të mërguarve shqiptarë, disa prej të cilëve kishin qenë bashkëluftëtarë të Skënderbeut. Kështu fitoi njohuri për epokën e heroit dhe luftën e madhe të popullit për liri, të cilat i zgjeroi edhe më tej me të dhënat e kronikave.

Me këtë vepër historiografike, të një rëndësie dokumentare, Barleti qëndron në fillet e letërsisë shqiptare, e cila e nis udhën e saj me një vepër të përmasave të mëdha. Është shkruar në latinisht, që asokohe ishte gjuha e kulturës në Evropë, i përket kulturës shqiptare, jo vetëm se është shkruar nga një dijetar shqiptar, por se është bota shqiptare që i ka dhënë jetë këtij argumenti madhështor të kulturës së hershme të popullit tonë të lashtë.

Koncepti i lartë i Marin Barletit për historinë, e lartëson atë si një mendimtar të shquar, te i cili kleriku zhduket prapa humanistit; historia për të ishte fryt i veprimit të njerëzve dhe jo të fuqive hyjnore. Veprën, ai e mendonte si një përmendore që ia kushtonte luftës për liri të atdheut dhe popullit të vet. Konsiderohet ndër historianët më të rëndësishëm të periudhës, duke dokumentuar me pasion ngjarjet e mëdha të qëndresës shqiptare kundër pushtuesve osmanë.

Vepra për Skënderbeun u përkthye në shumë gjuhë dhe u bë burim kryesor për të gjitha studimet e mëvonshme. Humanisti Barleti, nuk ndihmoi vetëm në ndërtimin e kujtesës kombëtare, por u bë edhe mbështetës i zhvillimit kulturor dhe shkencor në nivel evropian dhe përmes qendrave akademike e ndihmoi kulturën njerëzore me vepra të vlerësuara. Asnjë vepër shqiptare nuk është ndërkombëtarizuar dhe përhapur si ajo, në tërë botën e qytetëruar.



Letër e Skënderbeut, me vulën e tij.

LIBRI I DYTË

Fjalimi i Skënderbeut

Tani do të vijë në fjalën e Skënderbeut, i cili, pasi u grumbulluan gjithë sa ishin thirrur për në mbledhje në faltoren e madhe, ia fillojë të flasë kështu*

“Etër dhe princër fort të nderuar,

Unë sot sigurisht do të turbullonja qetësinë e atdheut, si një iniciator, ndoshta, i urryer i një lufte të re, dhe nuk do t'u shtynja ju me ngut në këtë vështirësi dhe rreziqe të luftë për interesat e larta, sikur Gjon Kastrioti, babai im i dëgjuar e nga ana tjetër një princ shumë i urtë, të mos i kish zënë aq fort besë dikur këtij Murati të pabesë, kur, nën pretekstin e paqës, arriti t'ia merrte rob e peng për siguri të bijtë menjëherë pasi i kërkoi... Vetëm për një gjë më vjen keq, për fatin e popullit tim, që kam nën sundim dhe për gjakun e pafajshëm të qytetarëve; s'ma duron zemra që ata të mbeten pa krye, pa mbrojtës, dhe t'i shkojnë armikut si kurban për t'u therur e unë të harroj besën që ata treguan para pak kohe kundrejt meje dhe që s'e kanë shkelur kurrë. Por pse, për perënditë e pavdekshme, të vepronja kështu, që të flas më si lirisht me ju? Mos do të ishte, pra, më e drejtë që bashkëqytetari juaj të qëndronte përgjithmonë i mërguar larg atdheut, në skllavëri pranë Muratit, në mes gjithë atyre rreziqeve e në një fe të dënuar apo mos do t'i duhej më mirë ta ngryste jetën në Epir dhe të shikonte të përlyhej e të poshtërohen edhe më gjatë atdheu i stërgjyshërve, mbretëria atërore, varret, tempujt, vetë perënditë nën sundimin e barbarëve? Më në fund ç'mendoni për Krujën? A mos vallë një qytet kaq i fortifikuar, kaq i përmendur për mjetet dhe fuqinë e tij, ka qenë për t'i lënë në duar të armikut, sikur të mos kishim pikë dashurie për atdhe? Kruja, zemra e fuqisë së Arbërit dhe e vetmja që është ndërtuar nga të parët tanë me të gjitha avantazhet si për luftë e e për paqë. Këtë sigurisht në rast se unë s'ia bëj qefin vetes, zor që mund ta mohoni, o etër fort të nderuar... Por, sidoqoftë në këtë mes, ne të pakën s'kemi për t'u penduar për qëllimin tonë, sepse unë, gjatë gjithë asaj kohe që jetova bashkë me armikun, ia mësova dhe ia di shumë mirë lëkurën, dhelëpëritë, mashtrimet e gjithë zakonet me radhë, gjë që konsiderohet zakonisht shumë e rëndësishme në punët e luftës...

Ejani, pra, kryetrima, merrni hakun, mbronni me laudinë më të madhe atdhenë, gratë, fëmijët dhe të mirat tuaja, silluni atyre qetësinë e vërtetë të lirisë. A e ndjeni se ne ç'turp po jetoni? Se cili mund të jetë fundi për lirinë dhe për ju? Në qoftë se, megjithkëtë, ju duket e durueshme gjendja juaj, atëherë me shumë të drejtë duhet t'i rrokni armët për mua jo si për ndonjë arbëror, jo si për një bir princi, jo si për një të

* Katedrale - kryekisha e Lezhës.

gjaku tuaj por si për një të krishterë, si për të një të ikur. Unë nuk flas, o princër, me njerëz që i mohojnë luftrat e drejta... Por, o etër të kuvendit, edhe ju, siç kujtoj unë, kini për t'i dalë zot mbrojtjes. Dhe me të vërtetë, përse jeni mbledhur këtu të ftuar me kaq zjarr veçse për luftë? Dhe unë po i shoh tani zemrat e të gjithëve të ndezura dhe brenda në këto zemra të ndezura urrejtjen për armikun. Po vërej me admirim fytyrat krenare dhe më duket se po ju shoh që tani të armatosur. Mos prisni, veç ju lutem, atë gjendje të vështirë, mos prisni gjersa të jetë ndoshta vonë për t'ju kërkuar juve këtë ndihmë, tani t'i bashkojmë forcat dhe armët tona dhe kështu ta presim armikun, do të vërsulet shumë shpejt, ose t'i vërsulemi vetë. Dhe, kur të na shikojë të bashkuar, ai ose do të pendohet për planin e vet, ose, po vazhdoi të bëjë këmbë përpara, do të heq dorë nga lakmia e vajtuar për të dalur fitonjës me kërdrinë që do të pasojë por ndonjëri nga ju ka pastaj frikë dhe kolovitet nga dyshimi se Murati nuk do të dërgojë kundër nesh një ushtri të vetme e të dobët, por më tepër e shumë të fuqishme, se, ndoshta, do të vijë edhe vetë me qëllim që të shpaguhet për këtë goditje të tmerruar, kurse ushtria jonë s'barazohet me forcat e tij; megjithëkëtë, unë ruhem t'u zotohem diçka njerëzvet që dyshojnë; sepse e ardhmja nuk duket sheshit dhe çdo përfundim i saj qëndron i fshehur. Për sa i përket veç mendjes dhe gjykimit njerëzor, unë mund ta tregoj se ato janë një mjet i sigurt për të gjitha punët, sepse asgjë s'është aq e vështirë, sa që të mos mund të zgjidhet nga mendja e njeriut....

Ngrihuni, pra, o etër të pathyeshëm, tregohuni më në fund të denjë para të gjithë brezavet që do të vinë këtej e tutje. Falenderimet nga unë për mirësinë e sotme pritni të armatosur, me përkrenare në krye, para flamujvet, në djersë, në pluhur, dhe do t'i kini sipas ndihmavet, që do të jepni për luftë".

Me t'i dhënë fund fjalës Skënderbeu, princërit të gjithë u drejtuan nga ai dhe, duke ia afruar me gojë dhe me zë të qartë mendimin, po e laudëronin fort e po e ngrinin në qiell si shpëtimtarin e lirisë dhe të të gjithë laudisë. Dhe kështu, pasi i lanë atij të gjithë me radhë dhe me vullnet të lirë dhe ia kaluan gati si me dorë pushtetin, popujt, ushtritë, dhe pasi i besuan drejtimin suprem të të gjithë gjendjes dhe kujdesin e luftës, e zgjodhën kryetar dhe kapidan të tyre të vetëm...

ANALIZË



INTERPRETIM:

- Si dokumentohet ekzistenca e lashtësisë së gjuhës së shkruar shqipe?
- Flisni për lidhjet midis Pal Engjëllit dhe familjes së Kastriotëve, veçmas me Gjergj Kastriotin!
- Bashkëbisedoni në klasë për përmbajtjen dhe rëndësinë gjuhësore dhe kulturore të dokumenteve të para të shqipes së shkruar! Tregoni përshtypjet tuaja!



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Cilat dokumente të hershme dëshmojnë për fillimet e letërsisë shqiptare?
- Kush ishte Pal Engjëlli?
- Çfarë dëshmon për gjuhën shqipe “Formula e Pagëzimit” e Pal Engjëllit?
- Çfarë rëndësie ka dëshmia e Guilelm Adaes?
- Cila ishte ndihmesa e Anonimit të shekujve XV-XVI, në cilin dialekt ishte shkruar?
- Pse letra e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut merret si dokument me vlerë historiografike?
- Çfarë roli luajti vepra “Rrethimi i Shkodrës” e Marin Barletit në çështjen e dokumentimit të shqipes së shkruar?
- Në cilin vit filloi mbretërimi i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe kur përfundoi?
- Si i flet Gjergji të birit në fjalimin e tij?
- Çfarë rëndësie ka figura e Barletit në humanizmin shqiptar?



SPROVË LETRARE:

- Shkruani për vlerat historiko-letrare të dokumenteve në gjuhën shqipe!
- Portretizoni figurën e Gjergjit, përshkruani virtytet e kryetrimt shqiptar!

GJON BUZUKU

Gjon Buzuku, me veprën “Meshari” i ka bërë shërbim të madh historisë së letërsisë shqipe, duke shkruar një vepër monumentale, ndaj merret si themeluesi i letërsisë së shkruar shqipe.

Vepra “Meshari”, sikurse dhe vepra të tjera, i përket periudhës së Reformacionit, kur Vatikani e lejoi botimin e veprave në gjuhët kombëtare. Deri atëherë, përdorimi i gjuhëve kombëtare në çështjet e kishës dhe të Kundërreformacionit, përkrah latinishtes dhe Vulgatës romake të viteve 1568, 1570, 1592 dhe 1598, ishte i ndaluar, madje më 1559 u përpilua indeksi me 75 libra të ndaluar, fatin e të cilave mund ta ketë pasur edhe “Meshari”.

“Meshari”, edhe pse në këtë kohë ishte përfunduar, për shkak të rrethanave të theksuara nuk u botua deri në vitin 1555, gjë që dëshmon se autori e dinte mirë rrezikun, duke e bërë botimin fshehurazi e duke lënë fare pak të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e tij, përpos asaj që ka përmendur shkurtimisht në fund të librit. Me të drejtë, Eqrem Çabej, për Mesharin thotë: *“është më i pari monument i literaturës shqiptare që na është ruajtur, dhe i përket një kohe të reformacionit shqiptar”*.



Gjon Buzuku, meshtar i devotshëm dhe dijetar atdhetar, analizuar në kontekstin kohor i takon rrethanave historike të shek. XV dhe XVI, pra të periudhës së rezistencës së Skënderbeut (1443-1468) ndaj Perandorisë Osmane, dhe të kohës pas tij (1468-1478) kur Arbëria u bë forcë e rëndësishme për të mbrojtur besimin, kulturën dhe mënyrën e jetesës së shqiptarëve, për t’u bërë ballë sulmeve të fuqishme e të pareshtura të perandorisë.

Për jetën dhe veprimtarinë e tij ka pak të dhëna, përpos atyre të vendosura në përmbyllje të “Mesharit” ku thuhet se Gjon Buzuku është i biri i Bdek (Benedikt) Buzukut, se ka qenë meshtar i një kishe dhe se më 20 mars 1555, ai e kishte përfunduar së shtypuri librin. Po aty thuhet: *“Unë, don Gjon Buzuku, e përktheva këtë libër që të kishin këta që nuk dinë latinisht...”*.

Studiues të shumtë janë marrë me mbledhjen e të dhënave jetësore të Buzukut.

Gjuhëtari austriak, Norbert Jokli, besonte se Gjon Buzuku vinte nga veriu i Shqipërisë, për shkak të tipareve të caktuara dialektore që i përdori në vepër.

Marko La Piana, vuri re se Buzuku shkruante “u” në vend të “ue” në disa raste, gjë që e lidh me zonën veriore.

Justin Rrota dhe Eqrem Çabej e mbështetën idenë se autori i “Mesharit” e përdorte diftongun “uo” që i tipizonte të folmet verilindore.

Për jetën e Buzukut, siç kuptuam, nuk kemi shumë të dhëna: nuk dihet saktësisht kur dhe ku lindi, ku u shkollua apo si e kaloi jetën. Nga vetë teksti i “Mesharit” mësojmë se ai ishte prift dhe se e përktheu këtë vepër për dy arsye: së pari, sepse nuk kishte libra të shenjtë në gjuhën shqipe dhe së dyti, për të ndihmuar popullin e tij ta kuptonte më mirë fenë në gjuhën amtare. Meqenëse, “Meshari” u ndalua zyrtarisht dhe emri i autorit u fsheh për shekuj, për shkak të këtij ndalimi, jeta dhe vepra e Buzukut mbetën të pastuduara për një kohë të gjatë.

Vepra “Meshari” gjatë studimeve që janë bërë mbi të, shënon një kronologji ngjarjesh për ekzistencën dhe vlerësimin e librit. Kështu, pasi libri që kishte filluar më 20 mars 1554 dhe kishte mbaruar më 5 janar 1555 (siç pohon edhe vetë autori) kishte pasur fat të vështirë. Mendohet se për shkak të ndalesës së Kundërreformacionit, ky libër ishte fshehur pa u përmendur gati dy shekuj, derisa në vitin 1740 e zbuloi studiuesi gjakovar Gjon Nikollë Kazazi, i cili gjeti një ekzemplar të dëmtuar, nga 220 fletë gjithsej sa kishte pasur libri i mungonin 32 faqe. Gjithashtu, ka munguar edhe ballina (frontespisi) ku zakonisht shënohen të dhënat e librit: emri i autorit, titulli i librit, vendndodhja, viti, botuesi etj. Meqë as titulli i librit nuk dihej, atëherë Gjon Nikollë Kazazi, i shkruan Gjergj Guxetës (i cili më 1734 e kishte formuar Seminarin arbëresh të Palermos), ku e njofton se kishte gjetur një libër “*krejt të grisur nga vjetërsia*” dhe sipas këshillave të Guxetës, edhe duke u bazuar në përmbajtjen që kishte si një libër meshash, vendosi ta titullonte “Meshari”.

Edhe për vendbotimin e librit ka hamendësime. Studiuesi Mahir Domi mendon se është botuar në Tivar, Norbert Jokli thotë se është botuar në Shkodër, Justin Rrota mendon se është botuar në Obod, kurse Eqrem Çabej dyshon se është botuar në Venedik. Libri “Meshari”, me vjetërsinë e vet kohore dhe me rëndësinë jetike që ka, gjithmonë do të mbetet objekt studimi për shumë arsye.

Përmbajtja e veprës: “Meshari” ka përmbajtje liturgjike: rituale liturgjie, lutje, mesha dhe pjesë nga Bibla. Po ashtu, ka edhe disa lloje poezish, si himne e psalme që Buzuku i përkthen në prozë, të cilat E. Çabej i quan *proza poetike*. “Meshari”, me pasurinë e vet përmbajtësore ka mundësuar, jo vetëm dëshminë mbi shqipen e shkruar të shekullit XVI, por edhe studimin e fonetikës, morfologjisë apo dialektologjisë së saj historike.

Gjuha e veprës: “Meshari” ka rëndësi të jashtëzakonshme për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, pasi në të e gjejmë shqipen e shkruar të shek. XVI me gjithë pasurinë e saj leksikore. Ky libër shënon edhe fillimin e letërsisë së vjetër shqiptare.

Vepra u botua gjatë periudhës së Reformacionit, një kohë kur përdorimi i



gjuhëve vendase në liturgji lejohej, por edhe një periudhë e kontrollit të ashpër të Kishës Katolike, e cila i ndaloi përkthimet që nuk përputheshin me versionin zyrtar të Vulgatës.

"Meshari", nuk është një përkthim i thjeshtë, por përshtatje e teksteve liturgjike në prozë shqipe. Buzuku, nuk ishte vetëm një përkthyes, por një krijues, pasi përdori alfabet të zhvilluar, ku vendosi tinguj të rinj që mungonin në sistemet ekzistuese.

Gjuha e veprës është një ndër versionet më të vjetra "arkaike". E përdor diftongun ou (kulturou), përdor grupet bashkëtingëllore kl që më vonë, përmes një g-j janë shndërruar në gl (klenë-k-jenë-qenë) ose k (klenë-kenë), ndërsa g-j dhe g-j në gj (gjuha, g-juha, gjuha) ose gj në g (gjuha-guha). Ndryshimet fonetike që prezantoi (si kalimi i "gj" në "g", "k" në "c", ose diftongu "uo") janë thelbësore për ta kuptuar zhvillimin historik të gjuhës shqipe.

Gjon Buzuku i ka dhënë vlerë historisë së gjuhës, andaj mbetet, jo vetëm një thesar fetar, por edhe një shtyllë themeli e gjuhësisë shqiptare.

Pasthënia

(e transkribuar)

U Donih Gjoni, biri hi Bdek Buzukut tue u kujtuom shumë herë seh gluha jonëh nukë kish gjaa tëh endigluom en sëh shkruomit shenjntë, en sëh dashunit sëh botësë sanëh, desha me u fëdigunëh, për saa mujta meh ditunëh, meh zditunë pak mendetë e atyne qi të engiluonjinëh, për seh atah tëh mundë mernëh (të marrin vesh, të kuptojnë) saa hi naltë e hi mujtunë (i pushtetshëm, i madhnueshëm) e hi përmishëriershim anshtë Zotynë (ndaj) atyne qi ta duonë em (me) gjithë zemërë. U lus enmbas sodi maa shpesh tëh uini (të hyni, të veni) em klisëh përseh ju kini meh gjegjunë ordhëninë e Tinëzot. E atëh neh enbarofshih, Zotynëh tëh ketëh mishërier enbi juu e atah qi u monduonëh djerje tash maa mos u mondonjinëh. E ju t ini tëh zgiedhunitë e Tinëzot. E për herrë Zotynë maa meh klenëh meh juu: ju tueh endjekunë tëh dërejtnë e tueh lanë tëh shtrembënë. E këta dueh baam Zotynë ka meh shtuom endër juu seh (që) tëh korëtë tajh tëh englatetëh djerje en sëh vjelash e tëh vjelëtë djerje en sëh enbjellash. E u maa duo tëh enbaronj vepërënëh teme Tinëzot tue pëlqyem. Endëh vjetët M.D.L.III. njëh zet dit endëh mars zuna enfill enbarova ndëh vjetët M.D.L.V. endëh kallënduor V dit. E seh për fat nëh keshe kun enbëh endonjë vend fëjyem u duoh, tuk tëh jetëh fajtëh, aih qi tëh jetë maa ditëshim seh u, atah fajh (ate faj) e lus tah trajtonjëh endë e mirë. Për seh nukë çuditëm seh nëh paça fëjyem, këjo tueh klenëh maa e para vepërë e fort vepër e fort e fështirëh për tëh vepëruom enbëh gjuhët tanë. Për seh atah qi shtamponjinëh kishnëh tëh madheh fëtigë e aqë nukë mundë qëllonjinë seh fajh të mos banjinë, për seh për herë endajh tah nukë mundëh jeshëh; e tueh enbajtunëh njëh klisëh enbëh tëh dyy anët mëh dukee (duhej) meh shërbyem. E tash u jam enfalëh gjithëve e lutëni Zotnën endeh (edhe) për moh.

"Meshari" (1555), Gjon Buzuku.

Gjyqi i Salamonit

Ent ato diterdhnëh dy graa teh këqia tek Salamoni. Tue klenë përpara atii thah njanah en sosh: E teh lus, Zot, tih të më endigloinsh: u e këjo gruoh ishnjim endëh njëh shtëpi, e nah tueh enbetunëh bashkë, u levah njëh djalë. E enbasih. enbasih u leva tëh tretënë ditë bani djalëtëh edheh këjo gruo. E ishnjim teh dy vetëmë e s ish kush meh nee endëh shtëpii, maaseh nah teh dy. E vdiq djalëtehe kësaih gruoh natënëh, për seh ajoh tue enfietunë e enbytih endeh gjumet. engriti endeh miseseh natët e muor djalëtëh tem qi ish endaj muoh e u shërbëtoreja joteh enflenëh e ajoh e shtiu ende gjii teh sajh; e vu djalëtëh e sajh endeh gjii tem qi ish vdekunëh. E u tue u engritunë ndënatënet meh dhanë gjitëh djalit tim, e gjeta vdekunë; e atah paqëh qyrë mirë endënatënet e paae seh nukë ish biri em qi u keshë lenë. E u përgjegj ajo jetëra gruo: Joh, por djalëtëh tem anshtë atah qi anshtë gjaall e uitih anshtëh aih qi anshtë vdekunë. E ajoh thah: joh, por ajh qi anshtë vdekunë anshtë yjtih e i gjalli anshtë emi. E endë këtë mëndyrë qertonjinë teh dya përpara regjit. E thah regji: këjo thotë seh djali em anshtë aih qi anshtë gjaall e biri yjt vdiq e këjo thotëh: Jo, por djali yjt vdiq e emih gjëllin. Birimë shpatënë muo! E hi përuneh shpatënëh regjit përpara. E tha regji: danih djalëtë e gjallëh për vjedmis en dy pjesësh e epënih njanënë gjimsësh njanësësh e tjetërënë tjetërësësh. E thah gruojaq qi djalëtë ish hi sajh regjit (përseh iu dhimtih zemërah për enbii djalët teh sajh: O Zot u tyy të lus epia djalëtë e gjallëh asajh e ateh mos ban teh envrasënëh. É ajo jetëra thah: As muo as tyy teh mos epetëh, por le tah danëh. E u përgjegj regji e thah: Epëni djalëtëh e gjallë e mos e envritënëh për seh këjo anshtë e amah e tii.

Proza: "Gjyqi i Salamonit", "Meshari" (1555), Gjon Buzuku.

Kënga e dytë

Hinje se ky vjen tue shkuo përmbi malt, e tue kërcyem përmbi sukat; mbë këtë mëndyrë ashtë i dashuni em, porsi kaprolli o mangu i sutës. Hinje se jet mbas murit tue pasunë qyrë n fënjeshttrashit, tue pasunë qyrë n birash së murit. E muo më foli i dashuni em, tue më thashunë; ngreu, mam eme e bukura, e eja. Hinje se dimëni shkoi, e shiu vote. E hinje se luletë zunë me u dukuni përmbi dhet, e hera me kiem u afëruo; e zani u turtullit u gjegj ndë dhet tanë; fiku zu me lëshuam të tijtë, e rdhitë zumë me bam grestënë, e lëshuonë erënë e endet tyne. Ngreu e eja, e dashura eme, e e bukura eme, uite ti. Pollumbi em ndë plasët të gurit, nde e fshehurat të gjiedhevet, dëftomë të klenëtë tat, banmë u ty të të gjegjem zanë tand; përse uit ashtë i amblë, e të panëtë ashtë të dëshëruom.

Gjon Buzuku

Fjalorth:

hinje - qe, ja;
mangu - zogu (i vogli);
gënjeshttra - dritarja;
rdhitë - hardhitë;
grestën - bulëzën (kalaveshi);
endet - ëndjet;
të gjegjën - të dëgjoj;
uit - yt;
me kiem - me kie, me krasitë;
të panëtë (asnjërës) - pamja.



SPROVË LETRARE:

- Çka përfaqëson emri i Gjon Buzukut për letërsinë shqiptare?
- Çfarë vlerash historiko-gjuhësore dhe artistike përmban libri "Meshari"?
- Analizoni ngjarjen në prozën "Gjyqi i Salamonit" dhe përshkruani karakterin e personazheve!
- Tekstin e dhënë "Kënga e këngëve II" përpikuni ta lexoni me ndihmën e fjalorthit!

LEKË MATRËNGA

(1567 - 1619)

Lekë Matrënga ishte një prift arbëresh, përkthyes dhe shkrimtar i letërsisë shqiptare që shkroi në dialektin e toskërishtes, me emrin e të cilit lidhet historia e kolonisë shqiptare në Itali.

Matrënga lindi në Hora të Arbëreshëve (Piana degli Albanesi), rrethi i Palermos, në Sicili, më 1567. Hora ishte themeluar në vitin 1488 nga arbëreshët (emigrantët shqiptarë të dëbuar dhunshëm nga trojet e veta, në kohën e Perandorisë Osmane), veçmas ata që u shpërngulën pas vdekjes së Skënderbeut (1468 - 1479).

Leka ishte nga familja e Matrëngajve, e cila shquhej si familje bujare dhe kishte stemën e vet.

Të dhënat për jetën e Lekë Matrëngës janë të pakta. Dihet se ka marrë mësim fillestare në vendlindje, pastaj shkon në Romë, në Kolegjin e Shën Athanasit, të cilin e kishte themeluar papa Gregori XIII që në vitin 1577. Atje qëndron pesë vite, pastaj nga viti 1582 - 1587 ndodhet në vendlindje.



Vepra: “E mbësua e krishterë” është shkruar në vitin 1592 dhe paraqet dokumentin e parë të toskërishtes së shkruar dhe të dytin të shqipes, fill pas “Mesharit” të Gjon Buzukut. Përbëhet nga 28 fletë të përkthyer në gjuhën shqipe (nga italishtja), nga libri i priftit Ladesma. Përkthimi prej 28 faqesh të shtypura në format të vogël, së bashku me një letërkushtesë italisht e me një këngë të përshpëritshme (tetëvargëshe) shqip e italisht dhe katekizmin, shënon veprën e shkrimtarit të parë arbëresh, duke shënuar zanafillën e shkrimit të arbërishtes.

Rëndësia e veprës: “E mbësua e krishterë”, një vepër e shkruar në shek. XVI, prej 479 faqesh (sipas studiuesit Kolë Ashta), në kohën kur përdorimi i gjuhës kombëtare ishte i ndaluar (Kundërreforma), sigurisht se ka rëndësi të madhe, nga njëra anë bëhet dorëzanë e vijimësisë së shkrimit shqip dhe në anën tjetër, luan rol parësor si shkrim i shqipes të arbëreshët. Megjithëse, veprat e shkruara shqipe, fillimisht të lejuara në përdorim të mësimdhënies gojore të katekizmit (mësimi përmes parashtrimit: pyetje-përgjigje) e më vonë duke autorizuar

përkthimet e teksteve të katekizmit, nën kontrollin e rreptë të censurës kishtare, i bëhej pengesë e madhe mësimi të gjuhës shqipe. Botimi i veprës “Meshari” thuhet se: *e shkundi nga mugullimat e kohës gjellimin e shqipes*, ndërsa vepra “E mbsuame e krishterë”, *i zgjeroi hapësirat e shqipes së shkruar*.

Rëndësia e përcaktimeve historike dhe gjuhësore, nuk është arritje e vetme, pasi libri përçon edhe dëshmi tjera, si fillësën e traditës letrare të variantit të arbërishtes që ka mbetur nën hije; shqyrtimin e tekstit të poezisë dhe të letërkushtesës që përveç tjerash bartin shenjime artistike.

“Kënga e përshpirtshme” është poezi, me anë të së cilës Lekë Matrënga na e jep ligjëratën e parë poetike në letërsinë tonë, megjithëse edhe Buzuku me psalmet e himnet që i ka përkthyer në proza poetike, nuk është larg ligjëratës poetike.

Poezia “Kënga e përshpirtshme” është një oktavë në formën e strambotës popullore me rimën ABABABAB, me vargun njëmbëdhjetërokësh të formës trokaike e jambike, me theksat ritmike të strukturës 4, 8, 10 dhe 6, 10 ku rrokjet e fundit (trokaiket) dhe të parafundit (jambiket) janë të theksuara. Secili varg ka një tërësi kuptimore, ndërsa së bashku paraqesin një motiv didaskalik fetar. Në dy vargjet e para bëhet ftesa për devotshmëri, në vargun e tretë nevoja për devotshmëri, në vargun e katërt e të pestë jepet një porosi etike për njeriun e kësaj bote dhe në tri vargjet e fundit krijohet përfytyrimi për botën qiellore ku besimtarët do të shpërblehen për devotshmërinë në këtë botë.

Gjuha - Matrënga, ndonëse vjen pas Buzukut, gjuha e veprës së tij shpreh një fazë parabuzukiane, fazën kur dy kryedialektet nuk ishin të larguar shumë nga njëri-tjetri, falë ngjashmërive të përbashkëta. Dialekti i toskërishtes i pjesës më jugore, me dialektin e Buzukut, gegërishten veriore të Matrënga dhe gjuha e veprës së tij ka shumë pikëtakime me atë të Buzukut.

“Katekizmi” i Lekë Matrëngës është dëshmi se në mjediset e arbëreshëve ishte hapur shkolla e parë shqipe.

Dijetari arbëresh, Lekë Matrënga, thekson: “Unë sa të jamë gjallë nuk do të mongoj ... të ndihmoj fëmijët për hirë të tyre të bëhem edhe vetë fëmijë që ata të përfitojnë sa më shumë.

*“Katekizmi”, Lekë Matrënga
(përktheu: Dr. Jashar Rexhepagiç).*



Fletëskushtesa

Unë mirëfilli, duke e pasë kuptuar qëllimin aq të mirë e aq të njohur të cilin Zoti ynë në sajë të mëshirës së vet u denja denja me ia lënë në dorë Zotërisë suaj shumë të ndritur e shumë të nderuar për ndihmë të shpirtënve përgjithësisht e t veçan për vasalët tuaj arbëreshë, kam menduar se do të ishte diçka e pëlqyeshme për Zotërinë tuaj, në qoftë se do të ia hyja një pune për shpirtënt e vasalëve të grekërve arbëreshë, që i ka Zotëria juaj në këtë vend.

Prandaj duke e ditur se Zotëria juaj shumë i ndritur e shumë i nderuar e ka aq në kujdes që djemtë e vajzat të mësohen me doktrinën e krishterë, kam dashur të bëj një përkthim të saj në gjuhën amtare arbëreshe, mbasi italishtja që dëgjohet përreth nuk është kuptuar mirë prej tonëve. Këtë punë e mora me një qëllim aq të mirë sa që mendoja se Zotëria juaj shumë e ndritur do ta çmonte si një vepër fort të frytshme. Dhe ka filluar të mësohet (vepra) me madhëri, me aq gëzim e kënaqësi prej popullit, sa që jam i sigurt, se po të të ishte (Zotëria juaj) këtu, do të merrte hov nga gëzimi shpirtëror. E tash shumë djem të moshës së vogël, sa që çuditet populli, e kanë kuptuar një pjesë të mirë (të doktrinës) e çka të bën çudi, është se edhe vajzat janë ushtruar aq mirë tashmë, sa ia kanë kaluar edhe djemve në numër e në përvetësim.

Kam dashur këto përpjekje të mia të ia kushtoj Zotërisë suaj shumë të ndritur, porsi atit e mbrojtësit tim, duke shpresuar se do të pëlqehen prej jush; dhe (përpjekjet e mia) jo vetëm do të jenë të vlefshme për popullin e grekërve, por do të jenë të pëlqyeshme edhe për qindra fshatrash që janë në Kalabri e në Pulje, të banuara nga arbëreshët. Të dënjohet pra Zotëria juaj shumë i ndritur e shumë i nderuar që të marrë (këtë vepër) nga një shërbëtor i veti shumë i vogël që po i vjen afër po me të njëjtin gëzim, me të cilin ia dhuron; sigurisht një gjë tjetër s'më ka shtyrë veçse lavdia, të cilën do ta ketë (nga ky punim) Zoti ynë, si edhe gëzimi, që do të keni ju, duke e pranuar. Në mënyrë që kjo vepër e vogël të mund të mirret në dorë prej të gjithëve, kam bërë dy punë për dy vështirësitë që hasen në të shqiptuarit e kësaj gjuhe shqipe. Së pari kam vënë sipas greqishtes së shkruar, theksat mbi fjalët që do t ndihmojnë shumë për shqiptim të mirë. Së dyti ia kam vënë mendjen një vështirësie të madhe, që kanë grekët arbëreshë për shprehjen e një farë tingulli, që gati gjendet në çdo fjalë. Në mënyrë që Zotëria juaj shumë i ndritur t'i marrë vesh fill e për pe të gjitha, do ta kujtoj se arbëreshët gati për çdo fjalë kanë një farë tingulli që bëhet me hundë, e pra nuk është ndonjë zanore e zakonshme dhe e veçantë sikurse a ose e, u, por vetëm si një farë tingulli, që disa herë bëhet me hundë, sikurse kam thënë. Pra kam përdorur si shenjë kur duhet ky tingull ose kjo zanore e shqiptuar me hundë, një a (=ae) diftong. Këtë kanë për ta kuptuar mirë arbëreshët me anë të kësaj vërejtjeje, gjersa ta fitojnë shqiptimin me anë të praktikës.

Të gjitha këto kanë qenë të nevojshme të shënohen në këtë kushtimin tim që kjo puna ime e vogël të jetë më e dobishme e të përdoret më me lehtësi. E unë, gjersa të jem gjallë, si kam bërë gjatë këtyre krezhmave, kam për të qenë pranë fëmijëve, e për dashuri të atij, që për ne u bë fëmijë, dua të bëhem edhe unë fëmijë, kështu që të përfitojnë vasalët tuaj shërbëtorë, ashtu si kanë përfituar gjer tashti; gëzimi i të gjithëve pa dashje dilte, kur përgjigjeshin (me doktrinën) me shumë zell të krishterë; është vërtet çudi se nëpër rrugët tona nuk dëgjohet, veçse zëri i fëmijëve duke e thënë doktrinën në gjuhën arbëreshe. Mbi të të gjitha i qoftë lavdi Zotit tonë, prej të cilit kërkoj hilet më të mëdha për Zotërinë tuaj shumë të ndritur e shumë të nderuar. Nga Piana dei Greci, më 20 mars 1592. Shërbëtori shumë i vogël i Zotërisë suaj shumë të ndritur e shumë të nderuar, Lukë Matrënga.

ANALIZË



PËRFORCIM NJOHURISH:

(Shkruani në fletore detyrën e dhënë!)

Lekë Matrënga lindi në _____, në vitin _____.
Ai ishte shkrimtar, klerik dhe një nga autorët më të hershëm të _____.
I përkiste kolonisë _____ së Italisë.

Në vitin _____ e botoi veprën _____, e cila përbëhet nga: _____, ndërsa poezia e tij _____ është krijimi më i hershëm poetik në gjuhën shqipe.

Lekë Matrënga shkroi në dialektin _____ dhe dha kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e _____ shqiptare.

Ai vdiq në _____, në vitin _____.

Tekstin e këngës përshkruaje në fletore dhe ktheje në gjuhën standarde!

Kënga e përshpirtshme

Gjithëve u thëres, kush do ndalesë _____
Të mirë në kreshtë, bura e gra _____

Mbë fjalët të tinëzo të shihi meshë _____
Se s'ishtë njeri nesh që mkatë s'ka _____

E lum kush e kujton se ka të vdesë _____
E mentë bashkë mbë tënëzonë i ka _____

Se Krishti ndë prrajsit i bën pjesë _____
E bën për bir të ti e për vëlla. _____

Lekë Matrënga

PJETËR BUDI

(1566 - 1622)

Pjetër Budi, një nga figurat më të shquara të letërsisë dhe kulturës shqiptare, të shekullit XVII, portretizohet si predikues fetar, përkthyes, veprimtar atdhetar e diplomat, i cili u angazhua me vetëdije për çlirimin shpirtëror dhe kombëtar të shqiptarëve.

Budi lindi në Gur të Bardhë të Matit rreth vitit 1566, në shtëpinë e Budëve të vjetër, siç e quante ai më vonë me krenari. I edukuar në një familje të tillë, me traditë e ndikim në jetën kishtare, si dhe me edukatë të shëndoshë kombëtare, ai pati mundësi herët të kyçet në shërbim të disa ipeshkvive të vendit, ku mori dituri. Mungesën e shkollimit të rregullt, ai vetë e përmend në veprën “Pasqyra e të rrëfyemit”, ku thotë: *“shkollënë e kolegjenë veçse nda kam paam n'cë lerg oo gjegjuni emënitë, ndish as ndonjë fjalë të vetëmenë ndër to xanë s'e kam, as gjegjuni...”*. Megjithatë, studiuesit mendojnë se ai duhet të ketë mbaruar Kolegjin e Loretos, pasi nuk do të ishte meshtar ose ipeshkv, sepse nuk lejonin kanonet kishtare.



Në moshën 21 vjeçare u emërua meshtar në Kosovë dhe Maqedoni, ndërsa më pas shërbeu si famullitar, dhe si vicar apostolik në Dioqezën e Sapës dhe të Sardës, ku për vite me radhë punoi për përhapjen e fesë dhe të dijes në gjuhën shqipe. Ishte kjo kohë, kur krahas veprimtarisë përkthyesë dhe origjinale, merrej edhe me çështje të interesit kombëtar.


Në vitin 1599 mbahet Kuvendi i Matit dhe një vit më vonë ai i Dukagjinit, ku përcaktohen delegatët që do të shkonin në Romë, për të njoftuar për planin e kryengritjes. Më 1616, Budi merr pjesë në Kuvendin e Prokupljes, ku u vendos që të kërkohet ndihmë nga Vatikani, Franca e Spanja, për mbështetjen e kryengritjes. Në kuvendin me 2000 delegatë, Budi zgjidhet përfaqësues dhe më pas shkon dy herë në Vatikan, më 1616 dhe 1618, për t'u takuar me papën. Pasi papa nuk e pranoi në takim, me arsyetimin se ndodhej në një udhëtim në Spanjë, ai i shkroi një letër kardinal Gocadinit, më 14 shtator 1621, ku e njoftonte për një kryengritje kombëtare dhe ballkanike.

Në vitin 1618, Budi vendoset në Romë dhe atje zhvillon veprimtari të rëndësishme për komunitetin shqiptar dhe për Kishën Katolike. Në këtë kohë, filloi edhe të shkruante e të përkthente.

Veprimtaria atdhetare e Pjetër Budit është mjaft e çmuar, ai u emërua ipeshkv në Zadrimë, më 29 janar 1622, mirëpo kjo detyrë i krijoi konflikt me

pretendentin Gjergj Bardhi, i cili e kishte mbështetjen e Vatikanit. Për këtë gjë, armiqtë e Budit përpiqeshin t'i hakmerren, derisa më 25 dhjetor 1622, atë e mbysin, duke kaluar me varkë mbi lumin Drin. Pavarësisht përfundimit të jetës së Budit në mënyrë tragjike dhe lënies përgjysmë të misionit të tij atdhetar, ai do të mbetet personalitet tejet i rëndësishëm i letërsisë shqipe.

Veprat letrare të Budit janë kryesisht në poezi dhe prozë. Gjatë qëndrimit disavjeçar në Romë shkroi dhe botoi vepra të rëndësishme: “Doktrina e Kërshtenë” (1618), “**Rituali Roman**”(1621), “**Pasqyra e të Rrëfyemit**” (1621) dhe “**Kush thotë meshë këtë kafshë i duhet me shërbyem**” (1621). Të gjitha i boton ndërmjet viteve 1618 -1621, në Romë.



Rëndësia e veprës

Budi është poeti i parë dhe më i rëndësishmi i letërsisë së vjetër, me një krijimtari prej 3200 vargjeve, me motive biblike dhe didaktike. E përdor alfabetin e Buzukut, me pak ndryshime, p.sh.: edhe ai e përdor diftongun *uo*, por jo edhe grupet e bashkëtingëlloreve *kl* e *gl*. Me përkushtim u qaset temave fetare dhe morale, por gjithmonë me një ndjeshmëri të thellë për realitetin shqiptar dhe për sfidat e kohës.

Budi është një personalitet shumëdimensional (poliedrik). Vepra e tij ka vlerë të jashtëzakonshme gjuhësore, letrare dhe historike, sepse për herë të parë, pas Gjon Buzukut, letërsia shqipe fiton një zë të qartë e orientues. Ishte dijetar me qëllime sublime për zhvillimin kulturor dhe lirinë e shqiptarëve. Ai nuk e konceptonte përkthimin e veprave fetare vetëm si një akt kishtar, por si mundësi për përhapjen e dijes dhe për forcimin e identitetit kombëtar.

Vepra e Pjetër Budit zë një vend të rëndësishëm në historinë e letërsisë shqiptare. Ajo e pasuroi gjuhën shqipe me tekste fetare, poetike dhe prozaike, duke dëshmuar përpjekjet e autorit për ta zhvilluar shkrimin në gjuhën amtare. Në krijimtarinë e tij gërshetohen fryma fetare, ndjenja atdhetare dhe shqetësimi për gjendjen e popullit shqiptar.

Budi është ndër autorët e parë që shkroi poezi origjinale në shqip, duke i dhënë letërsisë sonë një drejtim të ri. Veprat e tij kanë vlerë të madhe historike, gjuhësore, letrare e artistike, ndaj konsiderohet një nga themeluesit e letërsisë së vjetër shqipe.

Parathënia e “Pasqyrës”

Të ndritëshimë e shumë të ndeershimë zotëni e shokë e vëllazënë!

Maa ndë e vonë, disa tue qenë vetëmë e paa vesht aqë ndjerë nd'anët, disa tue mos qenë kush ndimë, qishmos kundërshtarë e shtiekëqij, asndoonjë kafshë s'u mbaruo jashtë ancoo Doktrine qi me saa fëdigë e t'idhun mbzij bana me shtampuom. Të cijnë, mbasi e dërgova, kuur maa tue paam se asndonjë tjetërë ndimë s'jesh i zoti me baam, i mplasa gjithë kafshëtë veshunë si pelegrij¹ vojta kaha munda me mbërrijm vizitova visetë e devotshime² mb'Shën Jakob të Galicisë. E andej, mbas 18 muojsh, përsëri mbë Romë tue kthym, gjeta letërë atit shumë ncë ndershim, fra Gjoani Koleshit, upeshkëpi cë Arbënit... E kështu, mbas saa helmi e n c'idhuni, ndë e vonë, m'u desh me votë jashtë Romësë, ke një frat gjuhu conë andej Rastënitë,³ anë cë Kruusë, ke i cili, tue votë me të madh dëshijr, posikur ndoonjë i etshim mbë gurrët të ftohtë, me u nginjëunë, kur sosa me shpëresë se kaa me marrë ngrykë e me më ngushëlluom me qishdo fjalë t'ambila, sikundërse ashtë zakoni i fratënet e i priftënet, e aqë maa tepër kuur mpiqenë kund, ashti si na aty ndë dhe të huoj, mirë tue më njoftunë se kush jam e kaha jam, e për qish zyrë kam ardhunë: ke saa më paa ke ju afruoshë me folë jo veçësë s'desh me folë me muo oo ndë faqet me më shukuom, si a zakoni i nierëzet, po ashtu ende më kthej shpinënë faqe gjithë kuvendit fratënet...

Saa e madhe ndimë e dritë e gazimend e ngushëllim kish me qenë i atij populli, ai maa të shumënë u vduorë ende po vdaarenë të mjerëtë, veçësë aqij ncë mituni e ncë paadijtuni, tue mos qenë kush t'i ndimon e të pron; e aqë maa tepër do letërorë e të mëdhenj dies, qi letërenë e dijnë e të pak frujt me ta kallëzonjënë, e se, ndë dashinë ashtuu gjaakafshë me baam oo me kallëzuom, e ata herë cë keqe cë tynet, s'e banjënë ndoone mbë gjuhu të vet, ke dijnë se ashtë maa tepër zyra e nevoja, po mbë të tjera gjuhu, ke asndoonjë nevojë s'ashtë, mb'arrësye të ndonjij qi të baan ujë e të shtij ndë deet, o të ndonjë tjetëri, qi të shpij vobëzjnë e vet me falë ndë kurt t'begatëvet zyra e nevoja s'ashtë as për nder s'i quhetë, e vëllazënetë e gjënjnë e vet e lee me u vdjerrë n'zi e unie, e gjithë duorshi cë nevojëvet.

¹ **Pelegrij** - vizitor në vendet e shenjta (haxhi).

² **E devotshme** - e shenjta.

³ **Rastënitë** - fshat afër Krujës.

ANALIZË



INTERPRETIM:

- Pse Pjetër Budi konsiderohet një nga autorët më të rëndësishëm të letërsisë së vjetër shqiptare?
- Cilat janë vlerat kryesore gjuhësore dhe letrare të veprës së Pjetër Budit?
- Pasqyroni ndjenjat atdhetare dhe kontributin e tij për lëvizjen kombëtare!
- Shpjegoni dallimet e krijimtarisë së Budit me atë të autorëve tjerë të kohës!
- Përshkruani rëndësinë e veprave të Pjetër Budit, sot, në historinë e gjuhës dhe letërsisë shqiptare!



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Cilat janë veprat letrare të Budit, kur janë botuar ato?
- Shkruani disa fjali për rëndësinë dhe vlerat letrare të krijimtarisë së Budit!
- Krahasoni kontributin e Pjetër Budit dhe Lekë Matrëngës, si dhe dialektin e përdorur në veprat e tyre!
- Shpjegoni pse Budi konsiderohet një figurë e rëndësishme e kulturës kombëtare shqiptare?
- Gjeni në bibliotekë ose në internet një poezi të autorit dhe përshkruani shkurt temën dhe porosinë e saj!
- Plotësoni një tabelë me titujt e katër veprave kryesore të Pjetër Budit dhe vitin se kur janë botuar!



SPROVË LETRARE:

- Provoni të krijoni një udhëpërshkrim me të dhënat për Pjetër Budin!
- Diskutoni për vështirësitë e aktivitetit të tij atdhetar!

FRANG BARDHI


(1606 -1643)

Frang Bardhi, një humanist e dijetar i shquar, shkroi vepra shkencore në fushën e leksikografisë dhe folklorit, duke e ngritur letërsinë shqiptare në një nivel më të rëndësishëm. Edhe në rrjedhat e neoklerikalizmit, përmes “Fjalorit” dhe përkthimit biblik, por edhe si njohës i veçorive etnografike, antropologjike e psikologjike dha një ndihmesë të madhe për letërsinë dhe kulturën shqiptare.

Bardhi lindi në Kallmet të Zadrimës, në vitin 1606, në një familje të njohur fisnike, ku edhe i mori dituritë e para. Studimet i vazhdoi në Loreto më 1628 e më pas në Kolegjin e Propagandës Fide në Romë, në vitin 1633. Në vitin 1635 i përfundoi studimet dhe filloi t'u përkushtohet shkrimeve.

Në prill të vitit 1636 u nis nga Roma për në Shkodër, ku do të merrte detyrën e peshkopit të Sapës dhe Sardës. Si peshkop, Bardhi u përball me sfida të mëdha, përfshirë konfliktet me pushtuesit osmanë dhe përpjekjet për të mbrojtur interesat e komunitetit katolik. Në vitin 1642, ai u përfshi në një mosmarrëveshje me Pjetër Budin, një ngjarje që e tronditi thellë.

Frang Bardhi ndërroi jetë në vitin 1643.



Veprat letrare: Botoi dy vepra me rëndësi të veçantë për letërsinë: “Fjalorin latinisht-shqip” (“Dictionarium latino - epiroticum”) dhe pjesa leksikografike dhe apologjinë “Libri mbi Skënderbeun” që e botoi në Venedik.

Fjalori latinisht-shqip ishte një projekt për ruajtjen e gjuhës shqipe, me ç’rast në parathënien e tij, Bardhi shpjegon dy motivet kryesore:

- Qëllimi kombëtar: të ndihmonte në ruajtjen e gjuhës shqipe nga zhdukja;
- Qëllimi fetar: ta lehtësonte përkthimin e teksteve të shenjta për priftërinjtë.

Fjalori përmban 2.544 fjalë shqipe (47 fjalë turke dhe vetëm 4 për qind janë të sferës kishtarë) sipas statistikës leksikore të studiuesit Kolë Ashta dhe është i formësuar si dy gjuhësh (latinisht - shqip), megjithëse në disa raste përmban edhe përkthime në italisht dhe turqisht. Ai përdor një sistem të rregullt për shënimin e foljeve (cogitare - me kujtuem) dhe emrave (nomen - emër) dhe një

pjesë të begatshme gramatikore, si: numërorët, ndajfoljet, lidhëzat, pasthirrmat, si dhe 113 proverba dhe dy proza folklorike.

Vepra “Gjergj Kastrioti” (1636) është e shkruar në latinisht dhe e botuar në Venedik. Përmbajtja e librit nuk është një histori e thjeshtë e Skënderbeut, por një polemikë shkencore kundër pretendimeve të Tomë Margnaviqit, i cili pohonte se Skënderbeu kishte prejardhje boshnjake.

Bardhi, duke u mbështetur në burime të besueshme, si në veprën e Marin Barletit dhe autorëve të huaj, i hedh poshtë këto pretendime dhe e vërteton origjinën shqiptare të heroit tonë kombëtar. Vepra ndahet në dy pjesë: një pjesë mbi prejardhjen e familjes së Margnaviqëve dhe një pjesë mbi prejardhjen e Kastriotëve.

Gjuha e veprës është në dialektin e gegërishtes, me ndikime të dialektit verior dhe përdorimin e diftongjeve.

Frang Bardhi mbetet një nga figurat më të shquara të shekullit XVII, jo vetëm si leksikograf dhe historian, por edhe si mbrojtës (apologjet) i identitetit kombëtar. Veprat e tij janë burime të pazëvendësueshme për studimin e gjuhës, historisë dhe kulturës shqiptare.

Parathënia e Fjalorit

Tue pasunë ditë e përditë, të dashunitë e mi, (mbasi hina ndë Kolegjë) kujtuem me qish copë librë keshë me ndimuem mbë njaanë gjuhënë tanë, qi po bdaretë¹ e po bastardhoheetë² saa maa parë të ve; e maa fort me ndimuem gjithë atyne qi janë nd'urdhënitë tinë Zot e të Shintesë Kishë Katolike e s'dijnë gjuhënë latine, paa të sijet as kush s'munë shërbenjë si duhetë paa të madh error³ e faj...

Prashtu mbasi u dashë Kolegjiet cë zonjëse ndë Lurijt, e ershë mb'Romë... hina ndë Kolegje te janë shkollarët... Zuna fill tue këthyem këtë ditionaar mbë gjuhët tanë. E këthevansi gjithë qish mujta e mbasi e sosa m'u duk i pakë e i vogëlë...

U lus gjithëve me të prunjëtë të më ndieni and të më shkuzoni⁴ përse s'mujta maa mirë me e nkëthyem me e mbushunë e me e ndërequnë; disa tue qenë gjithë hereë nzanë ndë letërë e ndë studie e disa tue mos pasunë shumë mot me ka me razënuem e me folë mbë gjuhët tanë, posi kuur harruem s'm'erdhnë ndë mend shumë emëna e shumë fjalë me i vuom arbënisht. E zini ma besë se hina me e lanë e me mos vote paretë me ta; maa mbë tjetëret anë kujtova e me dy maa mirë me nkëthyem gjaa kafshë se as gjaa përse ndë mos ngënjehem mëndjetë se ndët t'errëtit e pakë dritë vëjen e kushton shumë.

Prej Rome, dit ndë maj 30 ndë vjetë të Krishtit 1635.

Shërbëtori i zotëniisë saaj

Unë d. Frangu i Bardhë shkollar ndë Kolegje të Shintesë Fee.

¹ **bdaretë** - humbet

² **bastardhoheetë** - prishet.

³ **error** - gabime.

⁴ **shkuzoni** - falni.

Dictionarium latino - epiroticum (Fjalor latinisht - shqip)

Desiderare - me deshëruem

Mercenarius, mercenario - rogëtar, turkike argat

Unus, uno - Nja, turqisht bir

Primus - i pari

Filius, figlio - biir, turk. oğlan

Proverb

Shukomë shtanë, ani të bametë.

Mbasi të kesh nxanë, ani mbso.

Njana dorë laan tjetërënë e të dyja
laanjënë faqenë.

My mirë me heshtunë se shumë me
folë.

Kush ve ndë mullinj domos do
përmilletë.

Dita e mirë njifet ndë natëne.

Molla nukë rëzohetë large mollet.

Kush ve kadalë ve shëndoshë.



PËRFORCIM NJOHURISH:

Frang Bardhi lindi në _____, në vitin _____. Ai ishte
_____ dhe një nga përfaqësuesit
më të shquar të letërsisë së vjetër shqiptare.

Në vitin _____ e botoi _____ fjalorin
e parë latinisht-shqip, me rreth _____ fjalë. Ai ishte autor edhe
i veprës _____, në të cilën e mbrojti figurën e
_____.

Veprat e Frang Bardhit kanë rëndësi të madhe për historinë e
_____, të _____ dhe të
_____ shqiptare. Ai mblodhi dhe përfshiu në veprën
e tij edhe _____ shqiptare, duke dëshmuar pasurinë e kulturës popullore.

Frang Bardhi vdiq në _____, në vitin _____.

ANALIZË



SPROVË LETRARE:

- Shënoni argumentet e Bardhit, në mbrojtje të prejardhjes së Skënderbeut!
- Gjeni disa proverba dhe krahasoni me ato që shënoi Frang Bardhi!
- Përshkruani vlerat letrare dhe gjuhësore të “Fjalorit”!



PJETËR BOGDANI

(1630 - 1689)

Pjetër Bogdani, një personalitet i shquar në kulturën shqiptare dhe figurë e veçantë e shek. XVIII, u dëshmuar në veprimtari të shumanshme, si: dijetar, shkrimtar, teolog, nismëtar i letërsisë së shkruar, si dhe atdhetar i vendosur në luftën për çlirimin e popullit shqiptar nga Perandoria Osmane.

Bogdani lindi në Gur të Hasit, afër Prizrenit, në vitin 1630. Jetoj dhe veproi në një kohë të trazuar nën sundimin osman, ku shkrimi shqip ishte akt guximi dhe rezistence.

I rritur në familjen e Bogdanajve që kishte nxjerrë mjaft njerëz të ditur, iu krijuan rrethanat që t'i përkushtohej shkollimit dhe ngritjes intelektuale, veçmas i ndihmuar nga i ungji Andrea Bogdani.

Qysh në rini tregoi interes dhe përkushtim të madh ndaj dijes, veçanërisht në fushën e teologjisë, filozofisë dhe letërsisë, çka i hapi rrugë drejt studimeve të larta në Itali, në Kolegjin e Propagandës Fide në Romë. Në këtë institucion të rëndësishëm të formimit katolik, ai shfaqti shkathtësi të jashtëzakonshme intelektuale dhe arriti të përgatitet thellësisht në fushat e shkencave humane. Pas përfundimit të studimeve, si i doktoruar në teologji dhe filozofi, më 1656 u kthye në atdhe për të ushtruar detyra të larta kishtarë. Fillimisht, u emërua ipeshkv i Shkodrës dhe më pas Arqipeshkv i Shkupit dhe administrator i Kosovës. Në këto pozita, ku më parë kishin qenë Pjetër Budi e Frang Bardhi, ai luajti një rol të rëndësishëm, jo vetëm në udhëheqjen shpirtërore të popullsisë, por edhe në nxitjen e vetëdijes kombëtare dhe ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare në kohë të errëta të sundimit të huaj.

Bogdani, si një intelektual i formuar, bënte mobilizimin e masave për kryengritje dhe vetë vihet në krye të lëvizjes. Për shkak të qëndrimeve të tij për gjuhën shqipe dhe veprimtarisë atdhetare, iu rrezikua jeta, duke u bërë njëri ndër prelatët më të përndjekur të kohës, gjë që e vërteton edhe një relacion i Stefan Gaspërit, se në vitin 1671 *"Pjetër Bogdanin e kishin futur në burgun e sarajeve të pashait të Shkodrës, prej ku e shpëtuan një natë fshehurazi vëllezërit shkodranë Pepë dhe Nikollë Kostori, duke e shpëtuar nga rreziku që i rrinte mbi kokë"*.

Bogdani nuk reshti kurrë së punuari për veprimtarinë atdhetare, gjë që e dëshmoi për 21 vite sa jetoj në Shkodër, si përhapës i ideve për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe kulturës kombëtare.




“Çeta e profetëve” (“Cuneus prophetarum”) është vepra e parë origjinale e letërsisë shqipe dhe një nga krijimet më të rëndësishme të kohës.

Bogdani shkroi shumë *relacione*, sikurse: Pjetër Budi, Frang Bardhi, Lekë Mazreku, Andrea Bogdani... dhe i dërgonte në Vatikan, për të njoftuar për gjendjen e dioqezës së tij. Relacionet i shkruante nga Shkodra, e më vonë edhe nga Shkupi, ndërsa më 24 mars 1684 shkoi vetë në Romë, për ta prezantuar gjendjen para Vatikanit dhe Venedikut.

Kontributi i Bogdanit për kombin shqiptar është i pamatur, por ajo që e bën edhe më të rëndësishëm është vepra e tij letrare “Çeta e profetëve”, e botuar në vitin 1685 në Padovë të Italisë. Libri shënon një moment themelor në historinë e letërsisë shqipe, si vepra më e hershme në prozë me karakter filozofik, teologjik dhe estetik e shkruar në gjuhën shqipe. E ndërtuar mbi bazën e rrëfimeve biblike, vepra bart një përmbajtje universale dhe është shkruar në dialektin gegë me një pasuri të qartë e të ngjeshur fjalësh. “Çeta e Profetëve” nuk është thjesht tekst fetar, por pasqyrë e thellë e mendimit filozofik dhe humanist të kohës, një kryevepër që ndërthur besimin, dijen dhe atdhedashurinë.

Roli i Bogdanit nuk kufizohet vetëm në rrafshin intelektual. Gjatë Luftës Austro-Turke (1683 -1699), ai mori pjesë aktive në përpjekjet për çlirimin e tokave shqiptare nga sundimi osman. Me shpresën e aleancës së krishterë të udhëhequr nga Austria, Bogdani udhëtoi nëpër Kosovë, Shqipëri e vise të tjera, duke predikuar ndër shqiptarët për bashkim dhe qëndresë. Ai përpigjej të ngjallte një ndjenjë të përbashkët kombëtare dhe t’i motivonte shqiptarët të bashkoheshin me ushtritë perëndimore për të fituar lirinë. Kjo përpjekje e tij ishte e jashtëzakonshme për kohën dhe tregonte se ai ishte një figurë, jo vetëm kishtarë, por edhe politike dhe strategjike. Fatkeqësisht, aktiviteti i tij i dendur atdhetar u ndërpre kur u kap nga osmanët dhe, sipas shumë burimeve historike, e helmuan në burg, në vitin 1689. Vdekja e tij shënoi humbjen e një mendimtari të madh, por emri dhe vepra e tij vazhduan të jetojnë në kujtesën kulturore të shqiptarëve dhe të ndikojnë brez pas brezi në zhvillimin e identitetit tonë kombëtar.

Bogdani është vlerësuar si pararendës i Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe vepra e tij është konsideruar si një ndër gurët themelorë të letërsisë kombëtare. Për shumë studiues, “Çeta e Profetëve” është vepra e parë shqiptare me vlera të mirëfillta letrare, artistike dhe gjuhësore. Stili i tij është i ngjeshur, me fraza të strukturuar bukur, plot figuracion dhe me një fjalor (vokabular) të pasur. Ai nuk e përdor gjuhën, thjesht për të dhënë mësim fetar, por për ta ngritur kulturën shqiptare në një nivel të ri, për të dëshmuar se shqipja është gjuhë e denjë për



të shkruar histori, filozofi dhe poezi. Bogdani nuk ishte vetëm një ipeshkv apo një teolog, ai ishte një vizionar që ndër të parët e kuptoi se identiteti kombëtar ndërtohet mbi gjuhën, librin dhe kujtesën. Ai mbetet një figurë emblematike për historinë e letërsisë shqiptare, por edhe për frymën e rezistencës, dijes dhe dashurisë për atdheun.

Burrënija e malësorëve

Shofëmë ndër këta malësorët tanë gjithësej ma të shëndoshë e të fortë se gjytetësit. Këjo punë anshtë përse vollendohenë së paku.¹ Me një thembër buke melakuqe e një të pijmë ujë, kacenjënë posi dreni. Herodiani?² (lib. 2 Cesarum) shkruan se perandori Cesar August' dëshëronte fort me pasunë ndë ushtërij të tijna t'Arbëneshëtë, përse thoj se pësonjënë shumë e nukë druenë për huu e për het, e se janë ma zemërorë se të tjerëtë. Po si duketë se bani Leka i Madh, Skënderbegu,³ e 300 Maqedonas kundër t'panjefunet ushtërij të Kserksit. E nd'e vonë (si përsipër) malësorët tanë, të sijtë kurraj nukë përvihenë⁴ ndërë ndanët sanxhakëvet, qefatij të një kaqi t'madhi mizuer, qi ban me djersunë gjithë shekullinë...

Kush mundetë mej raam mboh se ma i vobek kje Vuça Pasha i silli për të mbëledhë një ushtërij 12 mijë vetesh, nuk'i mbashtuenë shumë milionj aar, se Kelmendasitë tanë, të sijtë me një zaan': Eja kush anshtë trim mbëledhunë afërë 500 vetë vraanë Veçe Pashënë, vjetit të Krishtit 1639 E ndë nevoja psuen me granë lëkuren'e qarrit posi të begatëtë majen e miellit, e ndë atyne ajo gjellë ma shijje u kaa, se pashallarëvet e sanxhaqevet mishi i qingjavet e vjetavet njomë, pa ndiem kurraj të ginë, tue granë për gjithë hore e tue votë reth ndëpër raje të tyne posi tha Profeta: Kanë me ardhunë reth gjytetsë e kanë me pesuem unij posi qentë, e gjithë herë ma fort dëshërojnë.

¹ **vollendoshenë së paku** - kënaqen me pak.

² **Herodiani (170 - 240 pas e.r.)** - historian grek, shkroi një histori precize.

³ **Skënderbegu** - mendohet në Aleksandrin e Madh.

⁴ **nuk përvihen** - nuk nënshtrohen.

Krijimi i rruzullimit

Parëse Qiellja, Dheu, Deti e zjarmi
Ishte: kje Zjarmi, Dheu, Qiellja e Deti;
Ma shempton Qiellja Dhenë e Detinë Zjarmi;
Se ku ish Qiellja Dheu, Zjarmi e Deti,
Aty ish Dheu, Qiellja, Deti, e Zjarmi:
Dheu Qiellnë mbëlton e Zjarminë Deti;
Qiellja Deti ende Zjarmi ishte ende Dhet,
Dheu, Zjarmi, ende Qiellja ishte ndë Det.

Mbë Qiellt' nuk 'ishte, as Yll, as Diellij,
Qi me dritetë vet zbardhen drite të ree,
As Hana delte me dy të rgjanta brii,
As prej Qiellshit vinte ndonji reze për dhe
As Dheu si Shqype nalt' qëndron e rii,
As Niegulle me shii, as breshen'as Refee,
As Deti me vale epte të madhe gjame;
As lymenatë meBreg, ishin zanë.

Shkupi,

(i quajtur nga grekët e vjetër Heraklea, seli metropolitane dhe kryeqendër e Sërbisë.

Shkupi, Orbelia e Luboteni janë emra sinonime dhe dëftojnë malet Rodope, shumë të adhuruara nga poetët (Virgjili). Pikërisht në rrëzën e këtij mali shtrihet Shkupi, qytet i njohur, që ka marrë emrin nga mali Scopo, por nga grekët i quajtur Heraklea. Plini (Libr. 4 i historisë) e quan “notabilis urbs Romanorum” (qytet i njohur i romakëve), ngase ishte koloni e romakëve dhe fort i ngjashëm me Romën për nga kodrinat mbi të cilat shtrihet, dhe me lumin Aksios, nga populli i quajtur Vardar, i kalueshëm, me një urë të mermerit, shumë i përshtatshëm për komunikacion dhe me bukuri të shumta, duke i ujitur livadhet, kopshtet dhe të mirat e tjera të qytetit. Ky lum kalon nëpër rrafshina dhe lugina dhe, duke ecur në një gjatësi rruge prej katër ditësh, derdhet në det afër Selanikut, kështu që krijon kushte të mëdha për tregti ndërmjet tij dhe Shkupit. Vardari është i lundrueshëm për anije të vogla prej Selanikut deri në Shkup. Mbi Shkup, në drejtim të malit Orbelia, larg nga një mile, gjendet një anije e madhe dhe shumë e përshtatshme për transport. Aty gjendet edhe një kështjellë me 30 shtëpi në të cilat jetojnë disa jeniçerë. Po aty gjendet edhe një garnizon me 100 jeniçerë. Muret janë pjesërisht të rrënuara. Në anën jugore ndahet nga Vardari, kurse nga ana perëndimore mbi mure shihet stema e Shën Markut, në formë të luanit, e dëmtuar nga barbarët, shkatërruesit e përhershëm të gjerave të vjetra me vlerë. I ka pesë shenja (?), të radhitura për tokë. Shkupi nën juridikcionin e vet i ka 1.000 shtëpi katolike, kurse në qytetin e hapur jetojnë 20.000 shtëpi turqesh dhe 200 shtëpi grekesh e serbesh. Udhëheqësia e qytetit kujdeset për popullin e thjeshtë. Ndërkaq, në kohën e luftës me Hungarinë, qyteti ishte i hapur dhe pa kurrfarë kujdesi, por i mbajtur nga Selaniku.

Në afërsi të Shkupit gjenden minierat e arit dhe të argjendit dhe përpunohen monedhat. Shkupi ishte rezidencë e bejlerbeut, mirëpo u ndalua për shkak të jetës së pafrenueshme e të paturpshme të bejlerberëve. Klima është e shëndoshë, kurse rritjen e bimëve e ndihmon lugina shumë e përshtatshme e lumit. Në drejtim të malit Orbelia, toka është pjellore, drunjtë e lartë të malit shërbejnë për punë mjeshtërie e për çdo nevojë tjetër. Përreth shtrihen vreshtat e mëdha e të panumërta, kështu që nga këto prodhohet vera e cilësisë së mirë, si e bardha, ashtu e zeza dhe mushti.

Durrësi gjendet larg Shkupit pesë ditë rrugë, kurse tregtia me lesh dhe lëkura të punuara bëhet përmes disa rrugëve. Mendohet se kjo mbretëri ka pranuar fenë e shenjtë në kohën e sundimit të papës Nikollë I. Në Gjeografinë e shenjtë është shkruajtur në kujtim: “Ursinus archiepiscopus Scuporum subscripsit consilio Sardicensi”. (Ursikini, argjipeshkv i Shkupit, është nënshkruar në kuvendin e Sardës).



SPROVË LETRARE:

- Portretizoni figurën shumëdimensionale (poliedrike) të Pjetër Bogdanit!
- Lexoni dhe diskutoni rreth tekstit të dhënë: kush ishte Leka i madh, Cezari, Vuçe pasha, kelmendasit, pashallarët etj.
- Përshkruani krijimin e rruzullimit, si është krijuar toka, uji, qielli, zjarri, sipas Bogdanit?

JUL VARIBOBA

(1724 - 1788)

Jul Variboba, përfaqësues i rëndësishëm në letërsinë shqiptare të shek. XVIII dhe një ndër zërat më të veçantë të traditës letrare arbëreshe, është i lidhur me kohën, qëndresën dhe kulturën shqiptare. Ai dhe shumë intelektualë të kohës e ruajtën vazhdimësinë e pastër etnike që ndikoi në ruajtjen e gjuhës dhe traditave kombëtare.

Variboba, ishte me prejardhje nga familjet e shpërngulura në kohën e vdekjes së Skënderbeut (1468), kur shqiptarët e dëbuar nga Shqipëria Jugore u vendosën kryesisht në jug të Italisë, në Sicili, kurse ata të Shqipërisë së Veriut, në Italinë veriore, për të shpëtuar nga sundimi osman.

Lindi në fshatin Mbusat, rrethi i Kozencës, në Kalabri (Itali), në vitin 1724. U shkollua në Kolegjin e Shën Benedeto Ulianos. Pas shkollimit u kthye në vendlindje, ku si prift filloi ta propagandonte katolicizmin te fshatarët. Puna si klerik ndikoi ndjeshëm në tematikën dhe frymën e veprës së tij, ku përzihet ndjeshmëria fetare dhe kombëtare, me përkushtim ndaj gjuhës shqipe. Në kishën e fshatit e mbante korin e vajzave, të cilat këndonin këngë që i thurte Variboba për Shën Mërinë.

Rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen e etnisë arbëreshe patën edhe dy kolegjet arbëreshe, që u hapën në shek. XVIII, Shën Benedeto Uliano, në Kalabri (1731) dhe në Palermo, në Sicili (1734).



GHIELLA
E
S. MVRIS
VIRGHIVR

Scrutur mbe vici Arterist eaa gae Prift puru i
Arberes per ndecti asaj Regin e par spals
te atire divotrave , cia se duan te chen-
dognan, chenoh' namurije ; ma duan
te jcen chenoh' Spiritual. mbe
trij maneres : mbe Calimeer ,
mbe cangbiell' e mbe go'
ater fort chendimmi Lu-
sist: VERGINE SELLA .



ROMM' MDCCLXII.
MD. LECENZ. T. P. MAISTRIE.
Scitren Aliaffas qea Nijfi.

Vepra letrare: “Gjella e Shën Mërisë Virgjër”
(1762) e shkruar në të folmen arbëreshe është vepra më e njohur e Jul Varibobës dhe përbën monument të rëndësishëm të letërsisë së hershme shqiptare, jo vetëm për përmbajtjen fetare dhe poetike, por edhe për përdorimin mjeshtëror të gjuhës shqipe.

Vepra është strukturuar në formën e poemës epiko-lirike, me rreth 4700 vargje, ku rrëfëhet jeta e Shën Mërisë dhe jeta e Shën Bambinit (birit të saj), megjithëse ngjarja dhe personazhet janë nga Bibla. Poema përbëhet nga dy këngët e para (hyrëse) dhe nga dy pjesë që i këndohen Marisë dhe Bambinit.

Përmbajtja e veprës ndërtohet mbi ngjarje, e cila sa është origjinale, po aq është edhe temë biblike. Ndonëse, personazhi kryesor është personazh biblik,

dhe përshkrimi i saj si nënë është po njësoj, pra ajo shfaqet indiferente, pa ndjesi e pa keqardhje... ndërkaq Mëria e Varibobës, është një grua tipike arbëreshe. Ajo, shfaqet si nënë e vërtetë, plot dashuri e kujdes për të birin Jezuin, e mban në kraharor, i këndon ninulla, e vë në gjumë, e lanë, i jep sisë, e puthë, e mban në duar... Ajo sillet si një nënë e vërtetë.

Pjesa tjetër flet për Jezu Krishtin, Bambinin (të birin) ku shkrimtari e përshkruan si fëmijë të zakonshëm që do të luajë, i do shokët dhe e duan, ata i sjellin dhurata për festa, ai e ndihmon të ëmën në shtëpi... Më vonë fillojnë vështirësitë e tij, misioni që

kishte ndaj Zotit, deri te kryqëzimi dhe ngritja e shpirtit të tij në qiell.

Poema dallon për ndjeshmërinë lirike, për figuracionin e pasur dhe për tonin e thellë përkushtues.

“Gjella e Shën Mërisë Virgjër” ka rëndësi historike dhe letrare, sepse përfaqëson përpjekjen e vetëdijshme për të ruajtur dhe zhvilluar gjuhën shqipe në një kohë kur kjo gjuhë nuk kishte status zyrtar dhe ishte e kufizuar në përdorim. Në të njëjtën kohë, ajo është shprehje e shpirtit kulturor të komunitetit arbëresh dhe e përkushtimit të tij për të mbajtur gjallë identitetin shqiptar përmes fesë, gjuhës dhe letërsisë.

Jul Variboba vdiq më 1788, por emri i tij mbetet në historinë e letërsisë shqipe, si një ndër zërat më të hershëm poetik që treguan dashurinë për gjuhën dhe traditën shqiptare.

Më e bukura kopile

Më e bukura kopile
që e nguqën si trëndafile,
jet ti, zonjë e Sh. Mëri
si je ti nëng ë njeri...
Jan di ilës ata si,
piot amur e lipisi;
këdo ruan e namurar,
këdo sheh e rikriar.

Më e bukura vajzë

Më e bukura vajzë,
që skuqesh si trëndafile je ti,
zonja Shën Mëri
si je ti nuk është njeri.
Janë dy yje ata sy,
plot mëshir'e dashuri;
këdo vëren, të dashuron,
këdo sheh ti e gëzon.

Oj biri im

“...Oj biri im,
oj malli im, oj jeta ime,
oj belic, oj kutendic
Oj parrajs, oj drita ime,
Mir se m'erdhe, eja të t'puthënj,
eja të t'lusënj u dit e vjet;
vet t'e lidhënj vet t'e zgjidhënj,
dua këtë jet u vet, vet.
Vetëmith dua e t'ë shtrëngonj
e t'e dërtonj belicën time.
Ai ish imi, ju mos m'e ngini;
u të t'mbanj, zëmëra ime”.
Kështu i fjit jëma e bekuar,
kur ndë duar të bir e kish,
por e lëmon, por e shtrëngon,
e pas e puthën e i jep sis.

Oj biri im

"... O biri im
o dashuria ime, o jeta ime,
o bukuri, o kënaqësi,
o parrajs, o drita ime.
Mirë se më erdhe, eja të të puth
eja të të lus unë dit'e vjet;
vetë ta lidh, vetë ta zgjidh,
dua këtë botë unë vetëm vetë".
Vetëm unë dua ta shtrëngo
dhe ta ndërtoj bukurinë time.
Ai është imi, ju mos ma ngisni;
unë të të mbaj, zemra ime.
Kështu i fliste nën'e bekuar,
kur ndër duar të birin kish.
Gjithnjë e lëmon, gjithnjë e shtrëngon,
gjithnjë e puth dhe i ep sisë.

Shën Mëria qan të birin

Biir, si të vranith?
 Mua ku më lanith?
 Si s'të pan lipisii?
 Si s'të ndihu mosnjeri?
 Biir, si të shënuanith?
 Biir, si të furnuanith?
 Ku të vate ajo belic,
 Çë më jep aqë legric?
 Ruaj si të nxiitin
 Shih si të pështitin!
 Si të bën, biir-oo,
 gjith gjag, mjerta u'oo!
 Mund t'erth kjo kuroor?
 Kush t'e theri ate door?
 Këto këmb të ngriqasuara,
 cila gozhd t'i la të shpuara?
 Edhe zëmërën t'e shpuan,
 me një lënkhia t'e sbuluan!
 Oi, biir, e saa pen!
 Mirrëm mua me vet'hen!
 Paa biir u'i të ronj?
 Këtë thik si t'e duronj?
 Me tij, biir, dua të shihem,
 nde këtë varr dua të
 mbëllihem!

Bir si të vranë?
 Mua ku më lanë?
 Si s'patnë mëshirë?
 A s'të ndihmoj asnjeri?
 Bir, si të qëlluan?
 Bir, si të mbaruan?
 Ku të vajti gjithë ajo bukuri,
 që m'epte aq gëzim?
 Vë re si të kanë nxirë!
 shih si të kanë pështyrë!
 Si të bënë, biro,
 Gjithë gjak, mjera un' oo!
 Nga t'erdhi kjo kurorë?
 Kush ta preu atë dorë?
 Këto këmbë të kryqësuar,
 cila gozhdë t'i la të shpuara?
 edhe zemërën ta shpuan,
 me një ushtë ta zbuluan!
 O bir, o ç'dhëmbje!
 Më merr mua me vehte!
 Pa birin si të rroj?
 Këtë thikë si ta duroj?
 Me ty bir dua të fshihem,
 në këtë varr dua të mbyllem!

ANALIZË



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Kush ishte Jul Variboba, ku u shkollua ai?
- Cila është vepra letrare e Jul Varibobës?
- Pse “Gjella e Shën Mërisë Virgjër” konsiderohet një vepër me vlera të veçanta artistike?
- Si paraqiten personazhet biblike?
- Çfarë elementesh të poezisë popullore arbëreshe dallohen në krijimtarinë e Varibobës?
- Si e pasuron gjuha arbëreshe vlerën artistike të veprës?
- Shpjegoni me fjalët tuaja pse autori e paraqet Shën Mërinë si një nënë me ndjenja njerëzore?
- Krahasoni poezitë: “Më e bukura kopile” dhe “Më e bukura vajzë”!
- Përshkruani poezinë “Moj e bukura vajzë”!
- Analizoni poezinë “O biri im”!
- Tregoni cila figurë stilistike është vendosur në vargjet e para të poezisë “Oj biri im”!
- Gjeni figurën e paradoksit në strofën e fundit të poezisë “Oj biri im”!
- Çfarë porosit (mesazhi) jep autori përmes poezisë!



SPROVË LETRARE:

- Shkruani disa fjali, duke e përmbledhur në pak rreshta rëndësinë e kësaj vepre letrare!
- Krahasoni Shën Mërinë-nënë, si figurë biblike dhe si nënë e rëndomtë arbëreshe!

ALAMIADA SHQIPTARE

Letërsia e vjetër shqiptare është krijuar në një shtrirje të gjatë kohore. Në gjysmën e dytë të shek. XVIII, në Shqipëri, shfaqet një rrymë e re letrare e njohur si Alamiada shqiptare, e cila zgjati deri në fillim të shek. XIX.

Alamiada shqiptare* solli risi në letërsinë e vjetër shqipe, duke u krijuar si rezultat i disa kushteve të veçanta historike: kërkesa për ta shkruar shqipen si gjuhën e vendit dhe për ta përdorur atë edhe në praktikën fetare e për t'u çliruar nga ndikimet e kulturave të huaja.

Alamiada ishte rrymë letrare me tipare origjinale të tematikës shoqërore, e shkruar me alfabet arab. Shkrimtarët e kësaj rryme u quajtën **alamiadistë**, por edhe **bejtexhinjë**, nga fjala arabo - turko: **bejte** - poezi/vjershë (thumbuese).

Letërsia alamiadiste shquhet për pasuri motivesh dhe formash artistike, si: poezi, prozë, traktate, përkthime fetare..., si dëshmi madhore e përpjekjeve të hershme për të shkruar në gjuhën amtare dhe për të ruajtur identitetin kombëtar, përmes përhapjes së dijes dhe përkushtimit fetar në gjuhën e popullit (në kohën kur nëpërmjet fesë dhe kulturës islame synohej të arrihej nënshtrimi i shqiptarëve, kur pushtuesi hapte shkollat e veta, ndërkaq e ndalonte hapjen e shkollave shqipe).

Letërsia e bejtexhinjve pati dy faza në zhvillimin e saj: faza e parë zgjati deri në fund të shekullit XVIII ku gjeti shprehje fryma laike, kurse faza e dytë vazhdon nga fundit i shekullit XVIII dhe fillimi i shekullit XIX, ku mbizotërojnë tema me karakter fetar. Në krijimet me tema laike mjaft poetë bejtexhinj, në frymën e poezive orientale i kënduan dashurisë, bukurisë së natyrës e të gruas, e lartësuan virtytin, punën, diturinë ose fshikulluan mburrjen e kotë për pasurinë e fisin, e goditën ambicjen, hipokrizinë dhe shfrytëzimet klasore, duke dhënë një tablo të gjendjes së popullit.

Përfaqësues të alamiadës shqiptare janë: Muçi Zade, Nezim Frakulla, Sulejman Naibi, Dalip e Shahin Frashëri, Hasan Zyko Kamberi, Zenel Bastari, Muhamet Kyçyku Çami, Dervish Salihu, Said Najdeni, Rexhep Voka etj.

Rëndësia letrare dhe kulturore

Alamiada shqiptare përfaqëson krijimtarinë e autorëve shqiptarë që shkruan në gjuhën shqipe, por e përdorën alfabetin arabo-turk, pasi edhe në shekullin XVIII e deri në fillim të shekullit XX, viset shqiptare vazhdonin të mbeteshin nën pushtimin osman.

* **Alamiada**, është fjalë me burim arab, *al-agamiyya*, që do të thotë joarabe. Këtë shprehje e përdorën myslimanët e Andaluzisë për të shënuar gjuhët romane të Veriut të Gadishullit Iberik. Aty kah shekulli i mesëm mori përmbajtje tjetër, shënonte gjurmët që shkruhej jo me alfabet latin, por me alfabet arab. Kjo letërsi, e shkruar në gjuhën e vendasve, por me albet arab, u quajt letërsia alamiada.

Krijimtaria e kësaj periudhe do të trajtojë tema fetare, morale, filozofike e shoqërore, në të cilën ndërthuren tradita islame me elemente të kulturës dhe gjuhës shqipe, duke dëshmuar pasurinë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve të asaj kohe.

Letërsia alamiadiste zë një vend të rëndësishëm në historinë e letërsisë shqipe, sepse dëshmon vazhdimësinë e shkrimit në gjuhën shqipe edhe në rrethana të vështira historike. Ajo e pasuroi fondin letrar kombëtar me vepra poetike e didaktike dhe ruajti shumë veçori gjuhësore, leksikore e stilistike me vlerë për studiuesit.

Kjo letërsi ka rëndësi edhe si urë lidhëse ndërmjet kulturës shqiptare dhe qytetërimit oriental. Përmes saj u shprehën ndjenjat, besimet dhe botëkuptimi i një pjese të shoqërisë shqiptare, ndërsa autorët e saj kontribuan në zhvillimin e traditës letrare dhe në pasurimin e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Alamiada shqiptare është një dëshmi e rëndësishme e historisë sonë letrare dhe kulturore. Ajo tregon se gjuha shqipe është kultivuar e shkruar në rrethana të ndryshme historike dhe me alfabetë të ndryshme, duke e ruajtur identitetin kombëtar dhe vlerat shpirtërore të popullit shqiptar. Studimi i saj na ndihmoi ta kuptojmë më mirë zhvillimin e letërsisë shqipe dhe larminë e traditave që kanë ndërtuar kulturën tonë kombëtare.

NEZIM FRAKULLA

(1680/5 - 1760)

Nezim Frakulla është poet i veçantë në letërsinë e Alamiadës, me një krijimtari origjinale, në të cilën shpreh hapur pakënaqësinë dhe revoltën ndaj shoqërisë së kohës, gjë që i solli një përfundim tragjik të jetës.

Lindi në fshatin Frakull të Beratit, në një familje me prejardhje feudale, prandaj pati mundësi të shkollohet, fillimisht në mejtepin e fshatit. Medresenë e kryen në Berat, atë kohë një qendër e kulturës islame, për të cilën udhëpërshkruesi turk Evlija Çelebi, i cili e vizitoi më 1670, shkruan se kishte 30 lagje, 5 medrese... një qytet me intelektualë të shumtë.

Nezim Frakulla disa vite largohet për në Stamboll për të studiuar, por nuk dihet se ku apo çfarë studioi. Gjatë kësaj kohe shkruan divane dhe poetikë letrare. Pas mbarimit të studimeve, në vitin 1731 kthehet në Berat ku krijoi një traditë pozitive krijuese, merrej me aktivitete letrare dhe organizonte një garë të përvitshme poetike.

Me talentin e tij poetik, ai bëri adhurues e dashamirë, po aq bëri edhe rivalë e armiq. Në një konflikt të vitit 1739 (kur nga detyra e shkarkojnë mulla Aliun, me diktat nga Stambolli) Nezimi akuzohet për shpifje. Për t'u shfajësuar i shkruan këto vargje:

***Ç'faj paçë, o Mulla Ali
Pse ju mburra me nasiat
e ujdís t'i bëhesh asi
Shehut që ka marrë bejat.***

Polemikat e këtilla ia vështirësuan qëndrimin në Berat, andaj më 1746 u largua për në Stamboll ku nuk gjeti qetësi dhe e internojnë për në Besarabi. Ai vazhdoi të jetë një kritik i hapur i padrejtësive shoqërore, madje deri te sundimtari. Për këtë arsye, me urdhrin e sulltanit arrestohet dhe dërgohet në Stamboll ku torturohet derisa nga dhuna çmendet dhe jeta e tij përfundon tragjikisht, në vitin 1760.

Vepra "Divani" ndonëse i kushtohet dashurisë hyjnore, për nga përmbajtja mund të ndahet në: poezi me çështje të poetikës letrare, nostalgjike, shoqërore, përshkruese dhe me temë etiko-morale. Kjo vepër e ngriti atë si poeti i parë i bejtexhinjve shqiptarë, ku në një poezi ai e përshkruan këtë ndjesi:

***Divan kush pat folurë shqip?
Ajan¹ e bëri Nezimi.
Bejan² kush e pat folurë shqip?
Insan³ e bëri Nezimi.***

¹ **ajan** - e shpalli.

² **bejan** - këtu/gjuhë poetike.

³ **Insan** - njeri.

Në mbujtjen e Nezimit-poet ka pasur ndikim kultura perse. Vjershërimin e filloi në vitin 1731 dhe deri në 1736 e hartoi *Divanin* shqip (me 110 gazele e kaside), si dhe dy divane, më vonë shkroi në osmanisht e persisht.

Tematika e krijimeve është e larmishme, si edhe bota e ndjenjave e shprehur përmes gazeleve, kasideve dhe ilahive. Në to gjejmë nota lirike, por edhe: zemërim, pikëllim, dëshpërim, ironi... krahas gëzimit, ngazëllimit, shpresës që e kanë burimin te realiteti i kohës, po ashtu edhe te brengat e shqetësimit që e shoqëruan tërë jetën. Në gazelet e Nezimit i këndohet bukurisë dhe dashurisë, si dhe problematikës morale, raportet me miqtë, diturinë, jetën. Në to pasqyrohet botëkuptimi oriental, por hasen edhe ide pozitive. Me nota kritike goditen vese, sulmohen me përbuzje miqtë e rremë, ambiciozët e smirëzinjtë. Krahasuar me poezinë e atëhershme dhe modelet orientale, autori solli elemete të reja që e pasqyronin jetën në Shqipëri.

Krijimtaria e Nezimit, megjithëse e pashkëputur nga modelet orientale, e zgjeroi tematikën e poezisë së kohës. Konsiderohet si poet me frymëzim e talent, por që shkroi me alfabet arab, e si e tillë, e shkruar në një gjuhë që konsiderohej si gjuhë e pushtuesit turk, ndikoi përgjithësisht që kjo pjesë e letërsisë shqiptare të mos vlerësohej realisht.

Gjuha e rënduar nga fjalët e huaja e dëmton vlerën e poezisë, edhe kur në të ka figura e mjete shprehëse mjaft të goditura, megjithëse vargjet kanë edhe elemente dhe figura që burojnë nga realiteti shqiptar.

Në kushtet e shthurjes së sistemit feudal, poeti hutohet dhe mbetet i tronditur midis së vjetrës që shembej dhe së resë që po lindte. Në vjershën **“Ankimet mbi gjindjen e kohës”** të krijon përshtypjen e një bote të shqetësuar, të një atmosfere të pasigurt, ku është e vështirë të lidhësh miqësi, ku bëhet një ndeshje e egër për të dalë në krye e njeriu nuk e zë vendin që i takon sipas virtyteve dhe zotësisë. Edhe sikur këto motive të jenë të marra nga letërsia orientale, sidoqoftë ato lidhen me realitetin e kohës.

Jeta e zbrazët dhe parazitë e bejlerëve dhe e të pasurve pasqyrohet në vjershën **“Teferiçi në Bilçë”**. Nëpërmjet përshkrimit të një pikniku në Bilçë, poeti tregon për qejfet dhe tekat e feudalëve dhe pasanikëve, për shpenzimet pa kufi, për të mirat e pasuritë që i kanë grumbulluar në kurriz të popullit. Me interes është edhe një vjershë që e shkroi kur disa shokë të tij niseshin për në Stamboll. Në të gjejmë dashurinë për atdheun dhe brengën e dhembjen e një mërgimtari për vendin e lindjes.

Frakulla, jo vetëm me pasurinë frymëzuese të shpirtit të tij, por edhe me aftësinë për të përkapur realitetin e një shoqërie plot njerëz, të cilët pasurinë materiale e çmojnë më shumë se gjendjen e tyre shpirtërore, tregohet i veçantë dhe me formim të lartë etik. Në një studim të Von Hahnit, kur ai zgjodhi t'i botojë disa poema, më 1854, këtë poet e quajti *Anakreonti shqiptar*.

*Disa shembuj nga poezitë e Nezim Frakullës:

Ankimet nga gjindja e kohës

Në këtë hall që është sot
myshqil me ta miqësia
të mos bënsh s'ë memqyn¹ dot,
na mburrnoftë Perëndia...!

Me një njeri që ndë tinet
s'i është dhënë istidad,²
si me atë mysahebet³...
ai në Rum, ti në Bagdad!

Mjaltë ejllëqetë⁴ t'ja bënsh,
zeher i trazon në gojë,
tahminë ku t'ja gjenjsh
të punojsh si të dojë.

Sora sot ngaha bilbili,
nukë ndahetë dot ej vah,
posi alimi,⁵ xhahili,⁶
ç'ë ky hiqmet,⁷ Allah-Allah!

Ganxhei nalane firak
qaj e mos pusho o bilbil!
Gjerçë ymri fort është pak
një çejrek kush bën tahamyl⁸!

As mjaft këto fjalë o Nezim,
as mjaft se na trete fare,
ej biqare,⁹ Allah qerim,
dikur na bënjenë çare!

Fort jam edhe unë mail,
Asaj pune që më thua,
Unë nakis, ti je qamil¹⁰
Ku ta gjenj atë që dua!

U zbukurua dynjaja

Behari u lulëzua,
u zbukurua dynjaja;
jeta në shenllëk u mbulua,
gëzonjenë fukaraja.

Heq alem¹ kush është akil
malet e fushatë jeshil;
tekdo është një karanfil
si yllit ju çel likaja.²

Bahçetë u donatisnë,
si nusët u stolisnë;
bilbilëtë u shastisnë
tepër u shtua sevdaja...

Nashti ti kasavet mos ki,
Zëre xhamn' e ashkut e pi;
Bejtetë derdhi si inxhi
t'i shohënë shyeraja³.

¹ **alem** - hidhërim.

² **likata** - fytyroja.

³ **shyeraja** - poetët.

¹ **memqyn** - e mundur.

² **Istidad** - gatishmëria, guximi.

³ **mysahebet** - fatkeqësi

⁴ **ejllëqetë** - rrogat.

⁵ **alimi** - i dituri.

⁶ **xhahili** - injorant.

⁷ **hiqmet** - çudi.

⁸ **tahamyl** - durim.

⁹ **b iqare** - i gjorë, i mjerë.

¹⁰ **qamil** - i përsosur.

Behari

A s'e shihni ju në dynja
 Manushaqenë,
 nëpër male, nëpër sahara
 çeli faqenë?
 u lulëzua
 U zbukurua dynjaja.
 Jeta në shenllëk u mbulua,
 gëzojnë fukaraja.

Bahti ynë

Shyqyr edhe bahti ynë,
 në këtë zeman në dynja,
 prej gjumit e çeli synë...

Urdhëroi e bëri himet¹
 erdh e na bëri ziaret²
 i kam rixha këtë adet
 ngaherë ta bëj ixhra³.

¹ **himet** - mirësinë.

² **ziaret** - vizitë.

³ **ixhra** – veprim.



PËRFORCIM NJOHURISH:

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë!)

- Çfarë e karakterizon veprën poetike "Divani"?
- Në cilën të folme janë shkruar poezitë e Nezim Frakullës?
- Cili motiv tematik trajtohet në poezinë "Bahti im"?
- Çfarë vargu përdoret në poezinë "Behari", nënvizoji vargjet më të bukura!
- "U zbukurua dynjaja", cilit lloj të poezisë i takon?
- Përshkruaje gjendjen shpirtërore të poetit në poezitë refleksive!
- Për çfarë vlerësohet krijimtaria poetike e Nezim Frakullës?

HASAN ZYKO KAMBERI

(1743 - 1810)

Hasan Zyko Kamberi është përfaqësuesi më i njohur i kësaj rryme letrare dhe një ndër poetët më të talentuar të Alamiadës. Tematika e krijimeve të tij poetike paraqet interes të veçantë, sepse i bëri jehonë gjendjes shpirtërore dhe pakënaqësisë së masave fshatare mbi të cilat rëndonte pesha e vuajtjeve dhe shfrytëzimi i egër feudal.

Shënimet për jetën e Hasan Zyko Kamberit janë të pakta, sikurse edhe për shumë alamiadistë të tjerë. Ishte lindur në fshatin Starje të Kolonjës, në një familje të varfër, me gjendje jo të mirë ekonomike. Si shumë të rinj të asaj kohe, të lodhur nga jeta e vështirë, do të marrin pjesë në Luftën Turko-Austriake mbi Danub (në Smederevë), në vitin 1789, në grupin e mercenarëve të valiut të posaemëruar të Janinës (1788) Ali Pashë Tepelenës. Në këtë fushatë, jo vetëm që nuk e rregulloi dot gjendjen ekonomike, por u kthye me një zhgënjim të madh që e përshkruan në poezitë e tij. Vdiq në fillim të shekullit XIX, në vitin 1810.

Vepra poetike “Dervish Kamberi” vlerësohet për mendimin filozofik, larminë e madhe të temave dhe tipologjinë e llojllojshme letrare. Njihen afër 60-të vjersha lirike, me vlerë të rëndësishme gjuhësore, letrare e kulturore. Shkroi edhe poezi fetare, por më të veçanta janë poezitë me temë laike. Krijimtaria e tij mund të jetë edhe më e gjerë, mirëpo mungojnë të dhëna konkrete, përpos se një dorëshkrim i tij me ilahi u gjet në Korçë, nga Dervish Aliu, i shkruar në Leskovik më 1827/8.

Ai është një nga autorët më të rëndësishëm të letërsisë shqipe me alfabet arabo-turk. Në krijimet e tij përshkruan jetën e varfër të popullit e kritikon korrupsionin dhe padrejtësitë shoqërore, duke përdorur ironi dhe gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për të gjithë. Si poezi më goditëse, me tematikë jofetare janë: “Paraja”, “Trahani”, “Lufta mbretërore” (Seferi humajun), “Bahti im”, “Gratë e va”, “Gjerdeku i vashës”, “Ty bota zili të kanë”, “Munafiku”. E dalluar është edhe vepra “Vasietnameja” (Testamenti) që ua kushtoi miqve, në ditët e fundit të jetës.

Në poezinë “Paraja”, autori vë në shënjestër të kritikës shtresën feudale, duke e matur përmes pangopësisë ndaj parasë si në vargjet: *Kadiu, t'i rrëfesh paranë, ters e vërtit sherihanë, për para ç'e shet t'anë, ia di kimenë parasë*. Forca e parasë i shtyn njerëzit të veprojnë kundër ndërgjegjes dhe nën “shkëlqimin” e parasë ata harrojnë etikën, karakterin, humanizmin.

Fenomeni i parasë ka dimension social, i ndan njerëzit në shtresa klasore.



Të pasurit janë: mbreti, vezirët, bejlerët, agallarët, kaditë, tregtarët, zejtarët edhe disa struktura fetare që veprojnë nën pushtetin e parasë dhe shtresa e varfër: **populli**, që e bart në kurriz gjithë hipokrizinë, keqpërdorimin dhe përbuzjen e shtresës së parë.

Poezia “**Bahti im**” është poezi refleksive, flet për jetën e poetit, individin e përhumbur në një shoqëri analfabete. Autori, edhe pse vetë ishte intelektual, pothuajse tërë jetën nuk arriti asgjë, andaj lexuesit, përmes pyetjes retorike i parashtron pyetje: si bëhet njeriu i lumtur, përderisa nuk mjafton puna, dituria, sakrifica... Mos vallë gjithçka është te fati apo te trashëgimia familjare?

Poezia “**Lufta mbretërore**” (Seferi humajun) sjell përshkrime nga vuajtjet shpirtërore të mercenarëve, të cilët mbesin të zhgënjyer për shfrytëzimin e tyre në luftëra të pakuptimta dhe gjendjen e rëndë materiale, në të cilën ndodhen pas kthimit nga lufta. Poezia është një këshillë njerëzore se, mercenari nuk mund të gjej lumturinë e tij, përderisa e merr jetën dhe lumturinë e të tjerëve. Edhe shumë poezi të tjera si këto u bënë shumë popullore dhe u përhapën gojë më gojë në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

Gjuha e përdorur në poezi është më e zhdërvjellët dhe më origjinale se ajo e poetëve tjerë bejtexhinj, por dhe poeti më i thellë i temës sociale, i cili gjendjen e mjeruar të masave e skicoi në mënyrë reale.

Letërsia e bejtexhinjve, më tepër duhet të ketë mbetur në dorëshkrime në alfabetin arab, ndoshta edhe për vetë synimin e bejtexhinjve që të mos botonin libra, por që t’i fiksonin në letër krijimet e tyre të destinuara për deklamim. Kontakti i kësaj letërsie me publikun kryhej në mjedise si *teqe* ose *çajhane* ku mblidhej *mileti* (populli) që t’i dëgjonte poetët, teksa i recitonin krijimet e tyre.

Trahani

More shokë dë këtë alem
drejt vete cupa e djem,
se pun’e ti s’hyn dë kalem;
dritë kush bëri trahananë.

Aferim ç’bëri dëngozi¹
muar qumësht prej kosi,
me miell e nakatosi,
dritë kush gjeti trahananë!

Fort ka qënë i diturë,
s’ka qënë ndonjë i miturë,
dritë kush e ka gjeturë.
dritë kush gjeti trahananë!

Tete muaj gjithë ç’janë,
që e zjejnë dhe e hanë,
fukarasë ua bën hajanë,²
dritë kush gjeti trahananë!

Të majarëtë hizmeqarë
do të ecinë duke qarë,
cili për derr e cili d’arë,
dritë kush bëri trahananë!

Edhe rixhal e ajanë,
për trahan bëjnë denë,
gjer e pjekin si kafenë,
dritë kush bëri trahananë!

D’atë shtëpi që s’ka trahan,
gjithë ajo shtëpi po qan,
po Zotynë bëftë derman!
dritë kush bëri trahananë!

Si trahani gjellë nuk gjen
kur ta hash, barkun ta nxen,
si vera tep qef e të nxen,
dritë kush bëri trahananë!

Trahananë kur e ndërtojmë,
me qumësht e trazojmë,
me gjalpë e përvëlojnë,
dritë kush bëri trahananë!

Trahananë ta shijosh dë tas,
të kesh edhe bukënë has,
piperr’ e zi t’ja besh takas,³
dritë kush gjeti trahananë!

Trahananë, ay që mer vesh,
është për dë rixhal⁴ përshesh,
kur ta yiesh ta bësh përshesh.
Dritë kush gjeti trahanë!

- ¹ **dëngozi** - i urituri.
- ² **hajanë** - jetën.
- ³ **takas** - shtosh.
- ⁴ **rixhal** - njerëz të shquar.

Paraja

"Mbreti, q'urdhëron dynjanë,
Që ka vënë taraphanë¹
E i presënë paranë,
Ja di kimenë parasë.

Dhe veziri, q'është veqil,²
Zë sikur të bënet adil³
E mos thotë dot kal-y-kil,⁴
Ja di kimenë parasë.

Sheh Islami, q'ep fetfanë,⁵
Që di qitapëtë ç'thanë,
Nukë kaçirdis⁶ paranë,
Ja di kimenë parasë.

Myfti edhe myderizë⁷
Edhe kyrra e vaizë⁸
Kanë ujdisur'iblizë,⁹
Ja di kimenë parasë.

Dhe kadiu i mehqemesë,¹⁰
Që rri sipër sixhadesë,
Edhe shehu i teqesë,
Ja di kimenë parasë ...

Dhe pashallarë, bejlerë,
Edhe avamë¹¹ të tjerë,
Për para apënë krerë,
Ja di kimenë parasë ...

Kadiut,¹² t'i rrëfesh paranë,
Ters e vërtit sherianë,¹³
Për para se ç'e shet t'anë,
Ja di kimenë parasë.

Për para janë sarhoshë,¹⁴
Bënenë bota kodoshë,¹⁵
Dhe çifçiu që mbjell groshë
Ja di kimenë parasë.

Po s'ka gjë të gjallë
Që të mos ia ketë mallë,
Turli esnaf' e bakallë,
Ja di kimenë parasë.

Edhe foshnja q'është në djep
Zgjat dorënë, të thotë "nep",
Ta marrë ta verë në xhep,
Ja di kimenë parasë.

Edhe gala që nukë flet,
Lëshoja një para në dhet,
E merr e shpie në folet,
Ja di kimenë parasë.

Paraja në këtë alem,
Paraja djeg pleq edhe djem,
E digjenë në xhehenem
Ja di kimenë parasë.

Gratë e va

Ndigjoni Hasani se ç'flet,
se ka dalldisurë ndë det,
ka gjetur në alamet,
kam qarë hall' e grave të va.

Se ashtu më bën e flas
s'jam për të bërë gavas
pse ato s'i shoh n; gasë
kam qarë hall' e gravet va

Pra, kur bënet dasm' e valle,
Se ç'iu bienë shumë halle,
Thosh' o burrë pse s'u ngjalle,
Kam qarë hall' e grave të veja.

¹ **taraphanë** - punëtori ku priten paratë.

² **veqil** - zëvendës.

³ **adil** - i ndershëm.

⁴ **kaly - kil** - thashetheme.

⁵ **fetfanë** - përgjigje.

⁶ **kaçirdis** - praps.

⁷ **myderrizë** - mësimdhënës në medrese.

⁸ **vaizë** - predikues fetarë.

⁹ **iblizë** - djalli, dreqi.

¹⁰ **mehqemesë** - gjyqit.

¹¹ **avamë** - turmë.

¹² **kadiut** - gjykatësit.

¹³ **sherianë** - ligjin.

¹⁴ **sarhosh** - pijanecë.

¹⁵ **kodoshë** - të paturp.

Gjerdeku i vashës

Çupatë po rrinë syqyt
s'vështrojnë asnjëri në syt,
po thonë: "Vallë, ku na mbyti!
Vallë, ku kemi meqanë?"¹

Çupatë po bëjnë fiqir;²
„Vallë, ku e kemi takdir?”³
I martojnë me të pahir,
Se ymër në dorë s'kanë.

Djalit kur t'i vijnë nishan,
e merr, e nxjerr në mejdan,
zë valle, këng', e bën
xhevelan,⁴
zë jorgan e tamburanë.⁵

Si të zihet i ziu djalë,
në kurbet po rreh të dalë,
haj me këmbë, haj me kalë,
rreh të fitonjë paranë.

Çupa vë gjergjefn' e qëndis,
kryetë hiç nukë lëviz,
po me vetëhe murmuris:
“S'duhet as të rri pranë”.

Djali ven e ve terzitë,
i dërgon i sjellë evgjitë,
e bën aheng nat, e ditë,
gjersa të sosën vadanë⁶

Djali dhëndërë nisetë
vesh robatë e stolisetë
posi mashkulli ndizetë
me krushq e me
dambullhanë.

¹ **meqanë** - vendbanim.

² **fiqir** - mendje.

³ **takdir** - është thënë.

⁴ **xhevelan** - rrëmujë.

⁵ **jorgan e tamburanë** - vegla muzikore.

⁶ **vadanë** - afatin.



PËRFORCIM NJOHURISH:

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë!)

- Cilat dukuri shoqërore i kritikon Hasan Zyko Kamberi në krijimtarinë e tij poetike?
- Cila tematikë trajtohet në poezinë “Paraja”?
- Sipas fragmentit të poezisë “Trahani”, në ç’kohë vendoset ngjarja e përshkruar?
- Çfarë vargu përdoret në poezinë “Gratë e va”, përshkruani situatën e tyre!
- Si përshkruhet poezia “Gjerdeku i vashës”, çfarë mesazhi jep autori?
- Sa ishte realist autori në krijimtari?

MUHAMED KYÇYKU ÇAMI

(1782/3 - 1844)

Muhamed Kyçyku është një nga figurat më të shquara të letërsisë. Ai ishte një dijetar i shkencave islame, pedagog dhe poet, veprat e të cilit e pasqyrojnë traditën e pasur kulturore dhe shpirtërore të Shqipërisë në shekujt XVIII dhe XIX, duke trajtuar tema universale si dinjiteti njerëzor, vuajtja dhe qëndresa. Kontributi i tij në letërsinë shqipe shkon përtej shprehjes artistike, ato shërbejnë si një urë midis traditës islame të diturisë dhe lëvizjeve letrare në gjuhën popullore.

Është lindur më 9 korrik 1784, në Konispol, fshat i Gjirokastrës (rajoni i Çamërisë, Shqipëri e Jugut), arsyë për të cilën e mban edhe pseudonimin Çami. Në vendlindje, mësoi në mejtep (mekteb) (4 vite), pastaj në medresenë lokale (6 vite), ndërsa studimet për teologji, filozofi dhe letërsi i vazhdon në Kajro (Egjypt) ku qëndroi 11 vite, i mbështetur nga Pasha i Janinës dhe nga Mehmed Ali Pashë Kavalla, i cili e kishte çliruar Misirin nga robëria turke. Rruga e tij intelektuale u ndikua thellësisht nga dija klasike islame dhe nga traditat gojore poetike të Shqipërisë. Pas përfundimit të studimeve iu përkushtua mësimdhënies, punoi si hoxhë dhe myderriz dhe shkroi vepra letrare.

Deri në fund të jetës, rreth vitit 1844, ka jetuar dhe vepruar në vendlindje, në Konispol.

Veprat, për nga përmbajtja ndahen në dy kategori: *poezi fetare* dhe *poezi jofetare*. Veprat fetare, shpesh të shkruara në një stil didaktik dhe filozofik, pasqyrojnë angazhimin e thellë të autorit me mendimin sufist, duke theksuar dashurinë hyjnore dhe natyrën e përkohshme të jetës tokësore.

Kyçyku ka qenë ndër bejtexhinjtë më të njohur, autor i disa veprave. Ndër më kryesoret janë: **“Erveheja”** e shkruar më 1820 (e botuar më 1888), me 814 strofa, dhe **“Jusufi dhe Zelihaja”**, një rrëfenjë moralizuese me 2430 vargje, mbështetur në historinë e rrëfyer në Kuran, mbi përpjekjen e gruas së Azizit për ta joshur e bërë për vete Jusufin a.s. Një poemë tjetër është **“Muri i vdekjes”**, që përshkruan vdekshmërinë dhe pashmangshmërinë e fatit të njeriut, ndërsa poema **“Gurbetlinjtë”**, vajton fatin e shqiptarëve të detyruar të largohen nga atdheu, duke e përzier trishtimin personal me hidhërimin kolektiv.

Tërë krijimtaria e Kyçyikut karakterizohet nga humanizmi i thellë, duke trajtuar tema ekzistenciale si mërgimi (kurbeti), luftërat e njerëzve të thjeshtë dhe padrejtësitë, me të cilat ballafaqohesh shoqëria shqiptare nën sundimin osman. Vargjet e përshkruajnë trishtimin e ndarjes nga atdheu, vështirësitë e migrimit për punë dhe qëndresën e shpirtit njerëzor.

Poema “Erveheja” mbetet ndër poemat më të dalluara të Kyçyikut. Më 1888, Jani Vreto, e botoi “Ervehën” të përshtatur si përrallë dhe të pastruar

nga leksiku oriental. Tema e poemës është një idilë familjare, në të cilën u gjend personazhi kryesor Erveheja, gruaja e bukur dhe e pastër moralisht, të cilën valët e jetës e përballën me vështirësi të shumta që vijnë si rezultat i krizave shoqërore dhe morale. Personazhet tjerë janë të tipit bardhë e zi, kush është i mirë mbetet i tillë, dhe kush është i lig, mbetet i tillë deri në fund.

Letërsia shqipe e shkruar me grafi arabe nuk lind rastësisht. Ajo lind në mjediset urbane ku kishte intelektualë dhe një masë që dinin shkrim - leximin arab, në mjediset ku ishin formuar qarqet kulturore e ndodheshin medrese të shumta. Ajo lindi si nevojë e kohës, pasi ata krijues që deri dje krijonin në gjuhët orientale e panë se për të komunikuar me masat duhej krijuar në gjuhën amtare.

Në një epokë trazirash kulturore dhe politike, zëri i Kyçkut mbetet dëshmi e fuqisë së përhershme të letërsisë për të ndriçuar, ngushëlluar dhe ndryshuar. Në shkrimet e tij, është e ngushtë lidhja midis formave letrare klasike (osmane) me traditat popullore shqiptare.

Veprat e Muhamed Kyçkut u ruajtën përmes recitimeve gojore dhe qarkullimit të dorëshkrimeve, duke ndikuar te poetët dhe intelektualët shqiptarë të brezave të mëvonshëm. Në shekullin XX, dijetarët e vlerësuan kontributin e autorit, duke e cilësuar atë si figurë kyçe të Rilindjes Shqiptare, një lëvizje që synonte të përcaktonte dhe ruante identitetin shqiptar përmes gjuhës dhe letërsisë.

Erveheja (Fragment)

Pa dëgjoni një hiqajet¹
në zemanëra të parë,
Në Revza e bën rivajet²
punëra që kanë ngjarë.

Në vaki Beni Israil³
si ngjau pun' e Ervehesë,
kush ish i urtë dhe akil⁴
prej hiqajetn të merr pjesë.

Erveheja qe një grua,
që s' kish shoqe nd'atë ditë:
vajzë dhe si u martua,
posi hëna që bën dritë...

Bukurinë e kish mehshur
fort qe një konj e ndershurë;
burrën e kish bërë mamur,⁵
edhe huje të bukurë.

.....
Burr' i saj e kish në nazar⁶
që s'e duaj vetëhenë,
as më tjetër bën karar
grua, veçse Ervehenë.

Erdhi rasti që kish adet,
burr' i saj do dil' në gurbet,
dërgon të vëllajt e i flet,
gruan t'i ler' amanet.

"Ti vëlla, bënu mukajet
maksus për gruan time,
që t'i gjendeç në çdo hizmet,
të mos i lipset as qime;

se u'ja që vura tahmin
të vete n' udhë të gjatë,
dhe tek ti u bë emin⁷
që t'i gjendeç dit' e natë.

- ¹ **hiqajet** - tregim.
- ² **rivajet** - tregim.
- ³ **Beni Israil** - bijve të Israelit.
- ⁴ **akil** - i mençur.
- ⁵ **mamur** - të lumtur.
- ⁶ **nazar** - në sy të mirë.
- ⁷ **emin** - besova.

Jusufi dhe Zulejhaja

Kur erdhi Jusufi ndë dunja,
ju dha me shur bukuria.
Jakupi e kish ndë sevda,
s'e ndan hiç nga dashuria.

Kur vate trembëdhjetë vjet,
Nur'e tij shumë e çtoi;
i jati i bën muhabet,
tjatrë se këtë s'duai.

Kish tamam dimbëdhjetë djelm,
ga gjashtë gra që kish marrë,
të gjithë me shur ndë alem,
Bilbili ish më i parë.

Dhe një natë, gaha netë,
Jusufi she nd'ëndërrime
ile tamam njëmbëdhjetë
hëne e diell iu zdriqnë.¹

Përpara ndë dhe i ranë,
pa sikur i bënë sexhde,
feksi dunjaja anembanë,
kaqë nur i madh ra mbi dhe.

Ndë vakt seharit² u zgjua,
babait ja bë ifade;
- Çdo të jetë, as më thua,
pashë sikur ranë mbi dhe.

Njëmbëdhjetë il të feksurë,
më ranë diell e hënë
me shum'iqram³ të bukurë
të gjithë sezhe më bënë.

Dhe Jakupi u sillois,
i tha: - Këjo është ilhami;⁴
një e mirë për ty u nis,
të mos e marrë vesh njeri.

Se këtë po ta dëgjojnë
të tjerëtë birazerrë,
mirë do ta kupëtojnë,
haset i madh do t'u bjerë.

Se shejtani nukë qëndron,
vesvesetë s'i pret kurrë,
gaha si t'u prishë vështon
me çdo hile të fshehurë.

I tha: Mos dëfto, more bir,
këtë ruja që ka parë.
Një nga një ia bëri tabir,
kundr'i tha gjithë me radhë.

Tek e bënë këtë sohbet⁵
i biri dhe me të jatnë,
i dëgjoi nën'e djelmet
gjithë fjalëtë që thanë.

Jakupi s'e kupëtoi,
që i mban vesh më një anë,
djelmet vate u dëftoi,
kundr'e bë'tabir rujanë.

Të gjitha ua dëftoi,
se ç'dëgjoi atë sahat,
të gjitha se se ç'kuvendoi
Jusufi bashkë me të jat.

Dhe ata vetë e ksiqisnë⁶
ëndërrënë që kish parë
shumë tertip të lik nisë,
bënë tahmin⁷ për të vrarë.

Thanë: Babai s'a vështon,
sa të ketë këtë djallë,
me një tertip ta pastrojmë
të mos ta lëmë të gjallë.

Se si ta presë umidhë,⁸
Jusufinë të mos t'e ketë,
tjatërë s'ka se ç'të bijë,
do s'do neve do na detë.

Se këtë na po t'e lëmë,
të mos i kimë çarenë,
babai e le në këmbë,
pa hise do na kërrejë.




PËRFORCIM NJOHURISH:

(Shkruaj në fletore detyrën e dhënë!)

- Si karakterizohet portreti i shkrimtarit Myhamed Kyçyku - Çami?
- Në strofën e tretë të fragmentit "Erveheja", autori flet për:
 - ☐ besnikërinë ☐ mençurinë ☐ fenë (religjionin)
- Vepra „Erveheja” e Muhamet Kyçyikut - Çamit, sipas formës dhe strukturës letrare është:
 - ☐ roman ☐ këngë lirike ☐ poemë
- Me çfarë alfabeti është shkruar kjo vepër?
 - ☐ grek ☐ latin ☐ arabo-turk
- Përshkruani fatin jetësor dhe karakterin e Jusufit, si personazh!
- Cila është rëndësia e letërsisë së Alamiadës shqiptare?

- ¹ **zdriqnë** - zbritën.
- ² **seharit** - mëngjesit.
- ³ **iqram** - nderime.
- ⁴ **ilhami** - frymëzim.
- ⁵ **sohbet** - bisedë.
- ⁶ **ksiqisnë** - shkoqitën.
- ⁷ **tahmin** - mendim.
- ⁸ **umidhë** - shpresën.



HISTORIA E LETËRSISË BOTËRORE

— PERIODIZIMI I LETËRSISË BOTËRORE

— LETËRSIA ANTIKE

— HUMANIZMI DHE RENESANCA NË LETËRSINË EVROPIANE

LETËRSIA BOTËRORE

PERIODIZIMI I LETËRSISË BOTËRORE

Periodizimi i letërsisë botërore shënon ndarjen dhe zhvillimin e saj në periudha kohore, e cila përcaktohet me veçori të përbashkëta: tematike, stilistike, ideologjike dhe kulturore. Çdo periudhë pasqyron ecurinë kohore, ndihmon në të kuptuarit më të mirë të lëvizjeve të letërsisë dhe përfaqësohet nga autorë dhe vepra që kanë ndikuar në ngritjen e mëtejshme të saj në aspektin historik, kulturor, shoqëror dhe filozofik.

Drejtimit themelore letrare dhe karakteristikat e tyre:

Letërsia antike (e lashtë) përfshin periudhën e hershme kohore, kur krijohet dhe interpretohet në formën gojore, sipas llojeve epike, lirike dhe dramatike. Arti dhe kultura e paraqitur në këtë kohë u njoh si qytetërim (civilizim) antik: sumer, egjiptian, grek, romak etj.

Në epoka dhe kultura të ndryshme janë krijuar vepra të mëdha epike, nga të cilat veçohen: “Gilgameshi”, në Babiloni; “Mahabharata” dhe “Ramajana”, në Indi; “Iliada” dhe “Odiseja”, në Greqinë e Lashtë; “Këngët e Rolandit”, në Francë; “Këngët e Nibelungëve”, në Gjermani; “Eda”, në Islandë dhe “Kalevala”, në Finlandë. Këto vepra kanë kaluar nga brezi në brez dhe duke u bërë pjesë e mbamendjes kolektive të popujve kanë ndikuar në letërsinë botërore. Poetë të mëdhenj, të mëvonshëm, si Virgjili me poemën “Eneida”, Miltoni me “Parajsën e humbur” etj., sollën vepra epike që e ruajnë strukturën tradicionale, ndonëse i japin asaj kahe të re shpirtërore, fetare apo romantike.

Mesjeta është periudhë kohore e zhvillimit kulturor dhe letrar, e cila fillon nga shekulli V-XV ku mbizotëronte letërsia fetare me praninë e kishës dhe temave të besimit, jetës së përtejme dhe moralit. Në këtë periudhë u shkruan: Bibla (përkthime të hershme nga Dhjata), “Kënga e Rolandit”, “Komedia hyjnore” (Dante Aligieri), “Dekameroni” (Xhovani Bokaço) etj.

Rilindja është lëvizje e gjerë politike, shoqërore e kulturore me karakter kombëtar, e cila filloi në shek. XV në Itali dhe u përhap në tërë Evropën. Rilindje, nënkupton ripërtëritje e idealeve të antikitetit klasik dhe e thekson rëndësinë e njeriut, natyrës dhe përparimit shpirtëror e shkencor, duke sjellë zhvillime në art, filozofi e letërsi. Me anë të humanizmit dhe renesancës u rikthye besimi te fuqia e arsyes dhe përparimi i shkencës, në dobi të njeriut dhe jetës.

Autorë të njohur janë: Uilliam Shekspir, Migel de Servante Saavedra, Nikolo Makiaveli, Fransua Rable etj.

Baroku dhe klasicizmi është drejtim letrar dhe artistik që lindi në Francë, në shek. XVII, i frymëzuar nga modeli i letërsisë dhe i artit të lashtë greko-romak. Është një ndërlidhje midis: emocionit, simbolizmit dhe kontrastit të fortë (baroku) dhe rregullit, harmonisë e frymëzimit. Letërsia klasiciste kërkon unitet të formës dhe përmbajtjes.

Autorët më të dalluar janë: Pjer Kornej, Zhan Rasin, Zhan Batist Poklen-Molieri, Xhon Milton etj.

Illuminizmi është lëvizje filozofike, kulturore dhe letrare e shek. XVIII, që promovon arsyen, dijen, shkencën dhe lirinë e mendimit, si mjete për përmirësimin e shoqërisë. Në letërsi, iluminizmi u shfaq me satirë, ese, roman filozofik dhe dialog, duke kritikuar fanatizmin, tiraninë dhe paragjykimet. Qëllimi kryesor ishte ndritja e mendjes njerëzore përmes arsimit dhe diturisë.

Si përfaqësues iluministë njihen: Fransua Mari Arue (Volteri), Zhan Zhak Ruso, Deni Didëro etj.

Romantizmi është rrymë letrare dhe artistike që u zhvillua në fund të shek. XVIII dhe në gjysmën e parë të shek. XIX, si reagim kundër rregullave të rrepta të klasicizmit dhe mendimit racional të iluminizmit. Ai vë në qendër ndjenjat, imagjinatën, natyrën, individualizmin dhe shpirtin rebel kundër normave shoqërore. Letërsia romantike shpesh e përshkruan heroin e jashtëzakonshëm, të ndjeshëm dhe të papërputhshëm me shoqërinë.

Përfaqësues të kësaj periudhe janë: Johan Volfgang fon Gëte, Xhorxh Gordon Bajron, Persi Bish Shelli, Viktor Hygo etj.

Realizmi dhe natyralizmi është rrymë letrare, që u shfaq në gjysmën e dytë të shek. XIX, si kundërvënie ndaj idealizmit të romantizmit dhe synon ta paraqesë jetën dhe shoqërinë në mënyrë të vërtetë dhe objektive, pa zbukurime a idealizime. Realistët e përshkruajnë gjendjen e përditshme, duke u përqendruar në problemet sociale, klasat e ulëta dhe ndikimin e mjedisit në fatin e njeriut.

Autorë më të dalluar janë: Onore de Balzak, Gustav Flober, Çarls Dikens, Lev Toltoj, Emil Zola.

Modernizmi është rrymë letrare dhe kulturore, e cila u zhvillua në fund të shek. XIX dhe në gjysmën e parë të shek. XX, si reagim ndaj ndryshimeve të mëdha shoqërore, industrializimit dhe krizave shpirtërore. Karakterizohet nga eksperimentimi me gjuhën, strukturën dhe format letrare, duke theksuar subjektivitetin, vetëdijen individuale, shqetësimet e brendshme të njeriut. Modernistët, shpesh i thyjnë format tradicionale dhe e eksplorojnë absurdin, kohën e pandërlidhshme dhe gjendjen psikologjike. Forma dhe stili i veprave kanë një thellim psikologjik deri në absurd. Në këtë periudhë u shfaqën lëvizjet, si: simbolizmi, futurizmi, ekspresionizmi, dadaizmi.

Autorë më të njohur janë: Franc Kafka, Xhems Xhojs, Marsel Prust, Tomas Sterns Eliot, Virxhinia Vulf etj.

Letërsia bashkëkohore dhe postmoderne e përfshin periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, deri në ditët e sotme. Ajo është e larmishme, eksperimentale dhe shpesh e fragmentuar, ndërlidhet me postmodernizmin, i cili i vë në dyshim të vërtetat absolute, e përziën realen me imagjinaren dhe përdor: ironi, lojëra gjuhësore, metafiksjon dhe ndërtekstualitet.

Përfaqësuesit kryesorë janë: Samuel Becket, Horhe Luis Borhes, Umberto Eko, Ismail Kadare, Haruki Murakami etj.

Arti i letërsisë, pavarësisht periudhës në të cilën është paraqitur dhe zhvilluar, ndikon thellë në emocionet tona, po aq sa edhe në formësimin e mendimit, duke na pajisur me shkathtësinë për ta kuptuar sa më mirë shoqërinë dhe marrëdhëniet njerëzore.

LETËRSIA ASIRO - BABILONASE

Kultura më e vjetër në historinë e njerëzimit është ajo asiro - babilonase, e cila prezanton një trashëgimi të pasur të qytetërimeve të Mesopotamisë (rajoni midis lumenjve Tigër dhe Eufrat). U zhvillua rreth mijëvjeçarit të dytë dhe të tretë p.e.s., kur Asiri dhe Babilonia ishin shndërruar në djep kulture për popujt e lashtë.

Letërsia, si fond i rëndësishëm i kësaj kulture, u shkrua në gjuhën kadishte (akade) në shkrimin kunioform, mbi pllaka argjili. Ajo, për nga tematika, ishte e lidhur ngushtë me fenë dhe kultin e perëndive ku priftërinjtë shpesh ishin edhe shkrimtarë. Këto tema, ngjarjet dhe personazhet janë bartur dhe kanë ndikuar edhe në fetë e mëvonshme, përfshirë traditat hebraike, greke, romake, ilire etj.

Letërsia asiro - babilonase përfshin disa zhanre:

- **Epikë:** shkrime, në të cilat trajtohet tema e pavdekësisë, miqësia dhe kuptimi i jetës, ku më i njohur është “Epi i Gilgameshit”;
- **Mite dhe krijime:** miti i krijimit të botës dhe i zotave, si “Enuma Elish”;
- **Himne dhe lutje:** u kushtohen perëndive: Marduku, Ishtari, Enlili etj.;
- **Letërsi urtësie:** përfshin proverba, këshilla morale dhe dialogë filozofikë, ku njihet “Dialogu i pesimistit”;
- **Tekste ligjore dhe historike,** si “Kodi i Hamurabit”, një nga kodet më të vjetra ligjore.

Në letërsinë e lashtë, miti dhe simbolika luanin rol të madh në mënyrën se si shpjegohej bota dhe jeta njerëzore.

LETËRSIA E LASHTË HEBRAIKE

Kultura hebraike është krijuar në hebraishten e lashtë, gjuhë në të cilën është shkruar libri “Tora” pesë librat e Moisiut (Musait) me përmbajtje për krijimin e botës, ligjet, jetën e patriarkëve, daljen nga Egjipti. Në librat: **Zanafilla**, **Eksodi**, **Levitiku**, **Psalmet** dhe **Profetët** shpjegohet besimi i popullit (besimi në një Zot), jeta e profetëve, marrëdhëniet e njerëzve me Zotin, si dhe psalme, proverba, poezi e urti. Letërsia hebreje është baza e traditës judeo-kristiane dhe ka ndikim të thellë në etikën, ligjin dhe letërsinë botërore.

BIBLA DHE KURANI

Në historinë e popujve me besim monoteist (besim në një Zot), Bibla dhe Kurani janë librat më të rëndësishëm me përmbajtje fetare, të konsideruar si libra të shenjtë. Në to përshkruhet: besimi dhe rregullat; udhëzime morale për jetën e njerëzve; histori shpëtimi rrëfyer përmes profetëve etj.

BIBLA është libër i shenjtë i të krishterëve, i përbërë nga dy pjesë:

- “**Dhjata e Vjetër**” u përket hebrenjve dhe përmban libra që flasin për krijimin e botës, historinë e popullit të Izraelit, ligjet, profetët dhe psalmet.
- “**Dhjata e Re**” (“Testamenti i Ri”) përmban jetën dhe mësimet e Jezu Krishtit, veprat e apostujve dhe shkrimet e shenjta të besimtarëve të hershëm krishterë.

KURANI është libër i shenjtë i myslimanëve dhe besohet se iu shpall profetit Muhamed nga Zoti, përmes engjëllit Xhebrail. Është shkruar në arabishten e vjetër.

Përbëhet nga 114 kapituj (sure) që përmbajnë vargje (ajete) të pandara në mënyrë kronologjike, por që trajtohen sipas shpalljeve.

Përmbledhje të përbashkëta të këtyre dy librave të shenjtë janë: besimi në një Zot (monoteizmi absolut); udhëzime për jetën shpirtërore, morale dhe shoqërore si: Dita e gjykimit, mëshira dhe drejtësia e Zotit; jeta e përjetshme; parajsa (xheneti) dhe ferri (xhehnemi).

LETËRSIA E LASHTË INDASE

Letërsia e lashtë indase i përket qytetërimit të Indisë të lashtë, ku si gjuhë kulturore ishte sanskritishtja. Në këtë gjuhë është lënë trashëgimi e pasur tekstesh filozofike, fetare dhe epiko-poetike që u krijuan nga mijëvjeçari i dytë p.e.s. dhe u interpretuan me gojë, pastaj edhe me shkrim.

Shkrimet e hershme indase kishin përmbajtje: himnesh, lutjesh, formula sakrale dhe filozofi.

Llojet e letërsisë indase janë:

- Vedat janë tekstet më të vjetra të hinduizmit (rreth 1500 - 1200 p.e.s.) dhe përmbajnë: himne, lutje, urti etj.;
- Upanishadet janë tekste filozofike që e trajtojnë natyrën e shpirtit-**Atman** dhe gjithësinë-**Brahman**, si themel i mendimit metafizik dhe filozofik indas;
- Epet janë këngë me tematikë të gjerë për: jetën, punën, virtytin, dashurinë... Më të njohura janë: “**Ramajana**” dhe “**Mahabharata**”, pra tekste letraro-filozofike ku përshkruhet dija dhe tradita e indasve të lashtë;
- Shkrime për rregullat dhe moralin: p.sh.: “**Dharma Shatra**”, që përmban ligje, rregulla dhe udhëzime për sjelljen shoqërore.

Nga kjo pasuri e lashtë shkrimore, përshkruhet përpjekja e njeriut për ta njohur veten, midis sfidave të shumta, si: drejtësia, e vërteta, besimi, morali, karma, virtytet, shpëtimi shpirtëror etj.

LETËRSIA ANTIKE GREKE DHE ROMAKE

Letërsia antike greke dhe romake e përbën bazën e letërsisë klasike.

Letërsia antike nuk ishte vetëm zbavitje, por kishte funksion arsimor, fetar, moralizues dhe filozofik. Ajo përbën një pasuri të madhe shpirtërore që ndikoi në të gjitha periudhat letrare pas saj. Zhvillimi i letërsisë antike është themeli mbi të cilin u ndërtuan traditat letrare të mëvonshme, duke i trajtuar temat: dashuria, lufta, drejtësia, jeta dhe vdekja. Fillimisht, ishte krijimtari gojore, me tregime, mite dhe këngë të përcjella brez pas brezi.

Për krijimin e kulturës së tyre shkrimore, grekët e përdorën alfabetin fenikas të përshtatur, ndërsa romakët shkrimin kunioform, të përshtatur në alfabet latin.

Letërsia greke fillon me epet e Homerit “Iliada” dhe “Odisea” që tregojnë histori heroike nga lufta e Trojës. Autorë të tjerë të njohur janë Eskili, Sofokliu dhe Euripidi, që shkruan tragjedi, si dhe Aristofani që shkroi komedi. Filozofët, Platoni dhe Aristoteli dhanë një ndikim të madh në mendimin botëror.

Letërsia romake u frymëzua nga ajo greke, por solli edhe elemente të reja. Shkrimtarë të njohur janë Virgili, me veprën “Eneida”; Ovidi, me “Metamorfozat”; dhe Ciceroni, me fjalimet dhe veprat filozofike. Kjo letërsi është e njohur për stilin e saj të qartë dhe mendimet mbi ligjin, moralin dhe shtetin.

Këto dy letërsi ndihmuan në formimin e kulturës perëndimore dhe kanë ndikuar shumë në art, filozofi dhe shkrime, deri në ditët e sotme.

“Iliada” dhe “Eneida” kanë mjaft trajtesa të përbashkëta:

- **Tema e luftës dhe heroizmit:**

Veprat përqendrohen në ngjarje të lidhura me luftën, “Iliada” e përshkruan luftën e Trojës, ndërsa “Eneida” e përshkruan rrugëtimin e heroit, Eneut, drejt Italisë, pas rënies së Trojës dhe luftërat për themelimin e një qyteti të ri.

- **Heroi qendror dhe udhëtimi i tij:**

Akili në “Iliadë” është hero luftarak, i drejtuar nga nderi personal dhe hakmarrja, përderisa Eneu në “Eneidë” është hero i devotshëm (i përkushtuar ndaj fatit, familjes dhe perëndive), që ndjek një mision hyjnor për ta themeluar Romën.

- **Ndërhyrja e perëndive:**

Në të dyja veprat, perënditë ndërhyjnë drejtpërdrejt në ngjarje, i ndihmojnë ose i pengojnë heronjtë, sipas interesave të tyre, si Zeusi, Athina, Aresi, në veprën “Iliada”, ndërsa Jupiteri, Junona, Venusi (nëna e Eneut), në veprën “Eneida” etj.

- **Tematika e fatit:**

Të dy autorët, Homeri dhe Virgjili e trajtojnë fatin si të pandryshueshëm. Heronjtë duhet ta pranojnë dhe ta ndjekin atë. Në “Eneidë” theksohet më shumë misioni dhe përmbushja e fatit hyjnor të Eneut për ta themeluar Romën.

- **Struktura epike dhe stili:**

Këto vepra janë epope të shkruara në vargje dhe i ndjekin format klasike të poezisë epike. Në to, përdoren: katalogë luftërash, krahasime epike dhe përshkrime të hollësishme të betejave.

- **Përballje mes heronjve:**

Heronjtë që përballen janë Akili dhe Hektori, në “Iliadë”, ndërsa Eneu dhe Turni, në “Eneidë”.

Përmbledhje: **“Eneida”** është vazhdim dhe pasqyrim romak i traditës homerike, duke pleksur elemente nga të dy veprat e Homerit: “Iliada” me temën e luftës dhe “Odisea” me udhëtimin pas mbarimit të luftës.

*Analizë e shkurtër për veprat antike

POEMA: "EPI I GILGAMESHIT"

Epi i Gilgameshit është një poemë epike nga tradita letrare sumero-babilonase, e cila daton nga viti 2100-1800 p.e.s., e shkruar në pllaka argjili. Në të, dëshmohet për një botë sa e lashtë, po aq edhe e pasur ku shprehet jeta njerëzore dhe bota e perëndive, nga të cilët përcaktohet fati i njerëzve dhe qenieve tjera. Është vepra më e vjetër letrare e shkruar dhe e zbuluar deri më sot.

Përmbajtja: "Epi i Gilgameshit" dëshmon për një botë të lashtë, por shumë të pasur me tradita të veçanta. Historia letrare e **Gilgameshit** fillon me pesë poema sumeriane rreth "Bilgamesh"-it (emri në gjuhën sumere për "Gilgamesh"), mbret i Urukut. Ngjarja e përshkruan botën e perëndive, hyjnive dhe të njerëzve e shtazëve.



Rrëfimi ndahet në dy pjesë: gjysma e parë e tregimit flet për Gilgameshin-gjysmëperëndi, një sundimtar tiran dhe Enkiduin, një njeri i egër i krijuar nga zotat për të ndaluar Gilgameshin të mos e shtypte popullin e vet. Pas një luftimi midis të tyre, Gilgameshi dhe Enkidui bëhen miq të ngushtë dhe më pas bëhen bashkë kundër së keqes. Ata do të udhëtojnë bashkë në Malin Cedar për ta mposhtur Humbabën, mbrojtësin monstruoz të malit. Më vonë, e vrasin edhe Demin e Qiejve, të cilin perëndesha Ishtar e dërgoi për ta dënuar Gilgameshin, pasi e refuzoi afrimin me të. Si një ndëshkim për këto veprime, perënditë e dënojnë Enkiduin me vdekje. Meqë, vdekja e mikut të tij ishte e papranueshme për të, ai nis për të kërkuar barin e pavdekësisë (dhunti që u takonte vetëm perëndive), mirëpo pas të gjitha peripecive, aventurave e sfidave, ai e kupton se vdekja nuk mposhtet, vetëm duhet pranuar atë.

Stili—poemë e shkruar në stilin kunioform të shkrimit sumer. Në 12 pllaka argjili është vendosur poema e llojit epik, me ton solemn dhe mitologjik. Është përdorur simboli, metafora dhe përsëritja tipike për letërsinë gojore.

Personazhet janë të përzgjedhur në përputhje me ngjarjen dhe kohën, si: **Gilgameshi**, mbreti heroik, gjysmëperëndi, që vihet në kërkim të kuptimit të jetës dhe mposhtjes së vdekjes; **Enkidui**, mik i ngushtë i Gilgameshit, simbol i natyrës dhe njeriut të egër; **Ishtari**, perëndeshë e dashurisë, që zemërohet me Gilgameshin, kur ai e refuzon. Gjithashtu, janë edhe Utnapishtimi, Humbaba dhe personazhe të tjerë, prania e të cilëve e bën më intriguese dhe tërheqëse poemën.

POEMA “ILIADA” E HOMERIT

Përmbajtja përqendrohet në javët e fundit të luftës dhjetëvjeçare të Trojës. Ngjarja ka lidhje me mitologjinë dhe e trajton temën: lufta, nderi, hakmarrja, fati, ndikimi i hyjnive në njerëz. Udhëheqës i luftës është Agamemnoni, mbreti grek, i cili e tërheq në luftë edhe Akilin, mirëpo pas një konflikti midis tyre, Akili largohet. Një moment i njëjtë i ngjarjes së Gilgameshit, si në retrospektivë na vendoset edhe në Iliadë, kur Gilgameshi vendos të hakmerret për Enkiduin, ashtu edhe Akili do të kthehet në betejë që të hakmerret për shokun e tij, Patroklin, të cilin e vrau Hektori, i biri i Priamit – mbretit të Trojës.

Epopeja mbyllet me vrasjen e Hektorit dhe kthimin e trupit të tij, te i ati, Priami. Në këto ngjarje edhe Zotat ndërhyjnë drejtpërdrejt në betejat njerëzore, kjo e pasqyron bindjen mitologjike se fati i njeriut është i lidhur ngushtë me vullnetin e hyjnive.

Stili i poemës është epik dhe tradicional, me një gjuhë të lartë, stil solemn e shprehje poetike. Në dialogë të gjallë dhe përshkrime epike janë përdorur pa fund krahasime e epitete. Forma narrative është e paanshme, teksa rrëfyesi qëndron larg, nuk ndërhyr emocionalisht. Poema ka një strukturë të ndërthurur rreth temave të nderit, hakmarrjes dhe fatit.

Personazhet:

Agamemnoni, mbret i Athinës, sundimtar tiran; **Akili**-luftëtari më i fuqishëm grek; **Hektori**-princ i Trojës, luftëtar i ndershëm dhe i guximshëm; **Patrokli**-mik i ngushtë i Akilit, vdekja e tij e ndez konfliktin; **Priami**-mbreti i Trojës, simbol i dhembjes prindërore.

Në të dy poemat, në “Epin e Gilgameshit” dhe në “Iliadë”, zotat ndërhyjnë vazhdimisht në ngjarje, i ndihmojnë ose i pengojnë heronjtë (sado që prania e tyre është e padukshme), ata kanë preferencat e tyre në konflikt.

TRAGJEDIA: “ANTIGONA” E SOFOKLIUT

Përmbajtja-“Antigona” është tragjedi greke ku përshkruhet konflikti midis ligjit hyjnor dhe ligjit shtetëror. Pas luftës civile në Tebë, mbreti Kreont e ndalon varrimin e Polinikut, vëllait tradhtar të Antigonës, megjithëse ajo, në kundërshtim me urdhërin, e varros vëllain sipas ligjeve të zotave. Antigona dënohet me vdekje, gjë që çon në tragjedi të mëtejme, pasi përpos dënimit që merr, tragjedia vazhdon me vetëvrasjen e Emonit (të fejuarit të saj), i biri i Kreontit dhe nënës së tij (gruas së Kreontit). Në tragjedinë “Antigona” trajtohen tema si, përballja në mes ligjit hyjnor dhe atij njerëzor, moraliteti, krenaria dhe tragjedia familjare.

Tri njësitë e zhvillimit të veprës, sipas Aristotelit janë: koha, vendi dhe veprimi (ngjarja).

- **Njësia e kohës:** ngjarja zhvillohet brenda **një çasti**, një dite, në një kohë të përqendruar, pa ndarje të gjata kohore;

- **Njësia e vendit:** ngjarja ndodh në një vend të vetëm, zakonisht para pallatit mbretëror në Tebë;

- **Njësia e veprimit (ngjarjes):** tragjedia ka një veprim të vetëm kryesor: konflikti midis ligjit të shtetit (Kreonti) dhe ligjit hyjnor/moral (Antigona).

Momenti tragjik ndodh kur Kreonti e kupton vonë gabimin dhe niset ta shpëtojë Antigonën, por ajo është vetëvrarë. Kjo ngjarje ndikon në vetëvrasjen e **Emonit** dhe **Euridikës**. Ky është kulmi i fatkeqësisë dhe momenti kur ai humbet gjithçka.

Stili, tragjedi klasike greke me strukturë korale (kor, stasima, episode). Trajton tema morale, fetare dhe politike, me një stil tragjik dhe filozofik që vë në pah zhvillimin e fuqishëm të karakterit. Personazhet janë komplekse në përballje me fatin, por thjeshtësia gjuhësore me thellësia e mendimit i bën ata të veçantë e të paharrueshëm, përpos ngjarjes.

Ironia tragjike: publiku e di fatin, personazhi jo, kjo krijon tension dramatik.

Personazhet: Antigona është heroina kryesore, e cila mbetet simbol i guximit dhe besnikërisë ndaj ligjit hyjnor.

Konflikti moral: **Antigona** beson se nderimi i të vdekurve është detyrë ndaj zotave, ndërsa Kreonti e mbron autoritetin e shtetit; Kreonti-një mbret autoritar që e vendos ligjin e shtetit mbi gjithçka; **Ismena** (motra e Antigonës), figurë e kujdesshme dhe bindëse; **Emoni**, bir i Kreontit dhe i fejuari i Antigonës; **Korifeu** (kori) përfaqëson qytetarët dhe ndërgjegjen kolektive dhe përdoret për reflektim moral dhe shoqëror.

Personazhi tragjik është Kreonti, një mbret me pushtet dhe autoritet. Tragjikja e tij qëndron në kokëfortësinë dhe besnikërinë e verbër ndaj ligjit të shtetit, duke e shpërfillur ligjin hyjnor dhe moral. Ai merr vendime që sjellin pasoja fatale për Antigonën, për të birin Emonin dhe gruan e vet Euridikën.

Katarza është pastrimi emocional përmes ndjenjës së frikës dhe mëshirës. Shfaqja e një ndjenje reflektimi dhe mësimi moral: respektimi i ligjeve hyjnore dhe balancimi i drejtësisë me mëshirën janë thelbësore.

KOMEDIA: “BRETOKOSAT” E ARISTOFANIT

Përmbajtja: Komedia “Bretkosat” është komedi e njohur antike, e shkruar dhe e vënë në skenë në vitin 405 p. e. s., në Athinë. Ajo është ndër veprat më të famshme të Aristofanit dhe trajton tema të rëndësishme për kohën, përfshirë gjendjen e teatrit, artit dhe politikës në shoqërinë athinase.

Ngjarjet në komedinë “Bretkosat” rrotullohen rreth perëndisë Dionis, i cili është një adhurues i teatrit dhe artit dramatik. I shqetësuar për gjendjen e artit pas vdekjes së dy tragjedianëve të mëdhenj, Euripidit dhe Eskilit, ai vendos të zbresë në botën e nëndheshme (Hadi) për ta kthyer në jetë njërin prej tyre.

Pjesa më e njohur e veprës është debati komik dhe satirik mes Eskilit dhe Euripidit, për të vendosur se cili prej tyre është tragjediografi më i mirë. Ata krahasojnë stilin, idetë dhe ndikimin e tyre në publikun athinas. Në fund, ai zgjedh Eskilin si më të denjë për t’u kthyer, duke kuptuar se shoqëria e kohës ka nevojë për udhëheqje të forta dhe vlera të qëndrueshme.

Stili: Aristofani e përdor humorin për të kritikuar realitetin politik dhe kulturor të kohës, gjegjësisht ironinë dhe satirën. Pavarësisht origjinalitetit në formën rrëfimore, ai e ka ruajtur strukturën klasike të tragjedisë, duke përcaktuar njësinë e kohës, vendit dhe veprimit. Përdorimi i elementeve mitologjike dhe fantastike, gjatë udhëtimit në botën e nëndheshme, nuk e ndryshon formën autoriale të stilit vetanak.

Parodi letrare: Shkrimtari i imiton me ironi deri në tallje veprat e tragjedianëve të mëdhenj, kur shfaq rivalitetin midis Eskilit dhe Euripidit. Vendosja e korit të bretkosave në skenë, me atë tingullin karakteristik “brekekekekeks koks”, mbetet një pjesë humoristike shumë e njohur. Po ashtu edhe përfshirja e dialogëve që sjellin gjallëri përmes batutave, përçojnë ide të thella përmes një gjuhe të lehtë e të kuptueshme për publikun.

Parodia është një formë krijuese ose artistike që imiton në mënyrë qesharake apo ironike stilin, temën ose veprën e dikujt tjetër, shpesh me qëllim për të nxjerrë në pah ndonjë mangësi, për të satirizuar apo për të argëtuar.

Personazhet: Dionisi, perëndia e teatrit dhe protagonist i veprës, paraqitet si qesharak, frikacak dhe me vendime të dyshimta, por me një qëllim serioz-ta shpëtojë artin; Ksantiasi, shërbëtori i Dionisit, shpesh më i guximshëm se i zoti, përfaqëson ironi ndaj rendit shoqëror; **Eskili**, tragjedian konservator dhe tradicional; **Euripidi**, tragjedian më modern që e provon realizmin dhe e analizon jetën e zakonshme; Plutoni, perëndi i botës së nëndheshme; Kori i bretkosave, përdoret për të krijuar atmosferë komike.

*Elementet e konfliktit në komedinë “Bretkosat”

1. Konflikti kryesor:

Eskili - Euripidi

- **Konflikt letrar dhe ideologjik**, për të përcaktuar kush është tragjediografi më i mirë.
- Eskili përfaqëson **traditën, moralin dhe rëndësinë** qytetare të artit.
- Euripidi përfaqëson **realizmin, modernen dhe përmbysjen e normave** klasike.
- Konflikti është intelektual, por zhvillohet në mënyrë teatrale dhe plot humor.

2. Konflikti i Dionisit me veten

- Ai është në **dysim të vazhdueshëm**, nuk është i sigurt se cili tragjedian duhet të kthehet në botën e të gjallëve.
- Paraqitja e **konfliktit të brendshëm** midis dëshirës për art të ri dhe nevojës për vlera të qëndrueshme në një Athinë në krizë.

3. Konflikti i klasave: Dionisi dhe Ksantiasi

- Në shumë raste, shërbëtori **Ksantias** është **më i mençur** dhe **më i guximshëm** se Dionisi, i cili është perëndi.
- Kjo përmbysje e roleve shoqërore krijon një konflikt të nënkuptuar mes rendit të zakonshëm dhe sjelljes së personazheve.

*Elementet komike të personazheve dhe situatave

1. Dionisi

- Shfaqet si një **perëndi frikacak, i pavendosur dhe naiv**, që përdor kostume qesharake (si të Herkullit)
- Kjo **sjellje absurde** dhe **dialogë të tejzgjatur me absurditet komik**, sidomos në përpjekjen për të hyrë në botën e nëndheshme.

2. Ksantiasi

- **Shërbëtori që bën humor me zotin e tij**, i mençur dhe sarkastik.
- Ndryshimi i veshjeve dhe rolet në mes tij dhe Dionisit krijojnë **situata komike tipike të teatrit farsor (farsa)**.

3. Kori i bretkosave

- Tingulli i tyre **“brekekekeks koks”** është nonsens komik, i përsëritur në mënyrë humoristike, një satirë ndaj korit tradicional të tragjedive.

4. Debat komik midis Eskilit dhe Euripidit:

- Ata përdorin **parodi të stilit të njëri-tjetrit**, duke e ironizuar mënyrën si kanë shkruar tragjedi.
- Shumë pjesë të debatit janë **analiza të thelluara letrare**, por të bëra në mënyrë qesharake.

5. Situata komike me Plutonin dhe Hadin

- Vetë fakti, që një perëndi si Dionisi “udhëton në ferr” për të kthyer një shkrimtar është një **absurditet humoristik**.

POEMA: "ENEIDA" E VIRGJILIT

"Eneida" është poemë epike, e shkruar nga Publio Virgilio Maroni (Virgjili) në shek I p.e.s., e frymëzuar nga "Iliada" dhe "Odisea" të Homerit.

Vepra është cilësuar si një epike kombëtare romake, në të cilën Virgjili, botëkuptimin e së mirës dhe së keqes i ka mësuar në shkollën epikuriano-lukreciane (Epikuri dhe Lukreci) në Napoli. Ky drejtim i shkollimit, të cilin e udhëhiqte Sironi (filozof epikurian), në atë kohë, edukonte nxënës në frymën e rrymës materialiste, por që e pranonte ekzistencën e perëndive.

Përmbajtja: Poema "Eneida" përmban 12 këngë ose libra, me subjekt të ndarë në dy pjesë.

Në **pjesën e parë** (I-VI) rrëfihen endjet (bredhjet) e Eneut ndërsa në **pjesën e dytë** (VII-XII) përshkruhen luftërat e tij në Itali. Secila pjesë është ndarë në 6 libra ku tematika, në përgjithësi, i ngjason poemave "Iliada" dhe "Odiseja" të Homerit.

Heroi kryesor është Eneu, një princ trojan, i cili shpëton gjallë nga rënia e Trojës. Pas kësaj nis udhëton për në Itali, prej ku edhe fillon odisejada e tij për të ndërtuar një qytet të ri (pararendës i Romës). Në këtë udhëtim, ai përballet me shumë sfida: stuhitë, dashuria me Didonën, beteja me latinët etj.

Fati i tij ishte një bekim nga perënditë, si i përzgjedhur për ta themeluar Romën, ndërkaq ai dëshmohej si një njeri besnik ndaj perëndive, familjes dhe detyrës (misionit të tij). Po ashtu, përshkruhet edhe marrëdhënia tragjike me mbretëreshë Didonën, në Kartagjenë, sakrifica dhe lavdia e heroit. Në fund, Eneu arrin në Latium, ku lufton kundër mbretit Turn, për të siguruar fatin e tij hyjnor: themelimin e qytetit - Romën.

Personazhet: „Eneida” është e mbushur me personazhe mitologjike dhe historike.

Eneu: hero i kryesor, princ trojan. Ai i udhëheq të mbijetuarit nga Troja, për ta gjetur vendin ku do të themelohet Troja.

Ankisi: babai i Eneut, i mençur dhe këshilltar. Gjatë udhëtimit ai vdes, por rishfaqet më vonë në botën e nëndheshme për t'ia treguar të birit të ardhmen e Romës.

Askani: djali i Eneut, i cili do të bëhet stërgjyshi i dinastisë së Julëve, në Romë.

Didona: mbretëresha e Kartagjenës, që bie në dashuri me Eneun, por ai e braktis për t'iu përmbajtur fatit të tij.

Turnusi (Turn): princ i rutilëve në Itali, kundërshtari kryesor i Eneut deri në fund të poemës.

Latini: mbreti i latinëve, që i ofron Eneut tokë dhe bijën Laviniën.

Lavinia: bija e mbretit Latin, e cila bëhet shkas për luftën midis Eneut dhe Turnusit.

Jupiteri (Zeusi) kryezoti që e mbron ekuilibrin dhe fatin e paracaktuar të Eneut.

Poema “Eneida” vlerësohet si një vepër botërore, ndonëse me një histori aventureske, por si një manifest kombëtar për Romën, me një përsiatje të thellë për fatin, perënditë dhe sakrificën njerëzore.

*Shembuj veprash nga letërsia e lashtë

POEMA: “EPI I GILGAMESHIT”

Kënga e parë

- Çdo gjë vërente hyu i kësaj toke,
askund njeri nuk kishte që s’e njihte
dijen e tij dhe veprën që kish bërë -
nuk kishte gjë që ai nuk e kuptonte.
- 5 Të gjithë njer’zit në vrojtim i mbante,
dhe heshtas n’dritë qitte gjëra t’fshehta.
Si hon të thellë e t’qartë e kish urt’sinë
ta sjellë kumtin para mbytjes t’madhe.
Në rrugë t’gjera, t’pafund qe filluar,
- 10 me shumë vuajtje e bëri udhëtimin
të stërmundimshëm shtegtimin e pati.
Pikëllimin me kunja e shkruante,
e n’rrasa t’gurit i skalitte veprat,
e n’rrasa t’urit gdhente t’gjitha vuajtjet;.
- 15 Mbret Gilgameshi, trimi ngadhnjimtari,
ndërtoi muret rreth e rreth Urukut
një tempull t’henjtë, sikur majë mali,
që ngritet përgjyhetin e ndërtuar
themelesh t’forta, thua nga çeliku,
- 20 dhe me shtëpi të larta mirë i mbrojtur
hyu i qiellit n’atë vend banonte.
E gjerë shtrihet grurishta e qytetit
e pasur shumë, drithnike madh’shtore.
Sa fort shkëlqen edhe më shumë shndrit
- 25 pallati i mbretit krejt i zbardhëlluar;
n’bedena sogjetarët rrinë ditën,
ndërsa ushtarët natën roje bëjnë.
E treta e Gilgameshit është njeri,
ndërsa hyjnore dy t’tretat i ka.
- 30 Të trembur e t’mahnitur qytetarët
pamjen e trupit ia vrojtojnë atij
një qenie t’atillë askush s’kish parë
as për nga forca e as nga bukuria.
Luanin e përzë kah prehet skutave
- 35 n’turinjtë e kap dhe frymën ia zë;
të egrën kafshë e gjuan me shpejtësinë
si dhe fuqinë e harkut që ai mban.
Çkado që flet, çkado që ai vendos
për qytetarët ligj duhet të jetë.
- 40 Më tepër se dëshirën e babait
e çmon djaloshi vullnetin e mbretit.
Porsa i mituri bëhet madhor
bariut t’lartë i bëhet shërbyes –
gjahtar, luftar ose bari kopësh,
- 45 roje ndërtesash, shkruet urdhëresash
o shërbëtor i tempullit të shenjtë.
Për k’naqësitë e vuajtjet e njeriut
mbret Gilgameshi kokën nuk e vret.
Sa madhështor që është e trim i çartur
- 50 dhe mendjemprehtë sa fort ka qëlluar
të rinj e t’vjetër, t’fortë edhe të ligj
për mbretin duhet t’gjithë të punojnë.

Kënga e gjashtë

Ah motër

- Armën e fshin, gjerdanin e shkëlqen,¹
 zverkut lëshuar flokët mirë i kreh,
 teshat e ndyta i hedh, i vesh të rejat;
 mantelin krahëve e vë, n'ije e lidh;
 5 në kokë Gilgameshi e vë tiarën,²
 e mire ai brezin për trupi e shtrëngon
 dhe shumë i bukur Gilgameshi dukej.
 N'hyjneshën e dashnisë epshi i ndizet.
 Ishtarja ia l'shon sytë Gilgameshit:
 10 "Hec, Gilgamesh, bëhu dashnori im!
 Dhuroma farën tënde, falma mua,
 bëhu im burrë e unë gruaja e jote!
 Të mbrehur qerren unë do ta jap
 nga ari është e lapislazili
 15 dhe nga floriri rrotat ajo i ka -
 Anët stolisur me gurë të çmuar;
 një çift kuajsh të bukur e t'fuqishëm
 çdo ditë do na ngasin qerren tënde.
 N'shpi time fisnike kur të vish,
 t'gjithë ata t'frontit këmbët do t'i puthin,
 n'pluhur do të bien mbretërit e t'mëdhenjtë.
 Nga mallet e nga fushat do të sjellin
 Dhunti çka zemra ty të dëshiron.

Kënga e tetë

- Posa e para rreze vesën treti,
 brof Gilgameshi e shkon deri te shtrati -
 në fashë, ratë, rri miku, Enkiduji.
 Krah'rori i ulet edhe i ngritet qetë,
 5 ngadalë i del prej gojës fryma e shpirtit.
 At'herë Gilgameshi zhgrehet n'vaj:
 „Mik, Enkiduj, ku t'mbeten forca e zëri,
 kështu ç'të gjet, o i mjeri Enkiduj?
 Lua i fort', mëzat i egër ishe,
 sikurse një gazelë e shpejtë m'ishe.
 10 Ty të kam dashur, ty si v'la të kisha
 të bëra t'parë mbi të gjith' parinë.
 Ty në Uruk të donin gratë e buk'ra.
 Në mal të Cedrit bashkë me ty vajta,
 15 as ditë as nat', o Enkiduj, s'm'u ndave.
 N'Uruk t'pamposhtur sollëm kryet e Humbabës,
 prej djajsh t'çliruar malsor't na bekuan.
 E vramë demin, nga qielli i dërguar
 gulçimi i tij helmues ndoshta t'goditi?
 20 Ndoshta hyjnitë e lartë emër nuk dhanë
 demin e egër - nga qielli dhunti -
 ta vrasim për urrejtje ndaj Ishtares".
 Ngat shtratit t'mikut rri, në heshtje varri,
 Në largësi t'pafund shikimi i tret.

¹ gjerdanin mbretëror.

² Mbulesë apo kapelë koke, që e përdorin mbretërit
 e vjetër persianë dhe asirë; fjalë greke: tijara.

Kënga e njëmbëdhjetë

- I thotë Gilgameshi Utnapishtimit:
 "Tash pot ë shoh, Utnapishtim; nuk qenke
 as më i madh as më i gjer' se unë
 shumë m'përngjan, sikurse djali babes,
 5 ndryshe as ti nuk qenke i krijuar,
 qenke njeri, ashtu sikurse unë.
 Mirëpo unë qetësi nuk kam
 Dhe jam krijuar që përher' t'luftoj,
 Ndërsa ti je tërhequr nga përleshjet
 10 i qetë rri, i shtrirë n'kokërr t'shpinës
 Si vallë arrite në kuvend t'hyjnive?
 Si e kërrove jetën si e gjete?"
 I tha Utnapishtimi atëbotë:
 "Ty, Gilgamesh, dëshir' kam ta zbuloj

- 15 një ngjarje deri tash krejt të panjohur
 po ta tregoj një fshehtësi t'hyjnive;
 qytetin shumë t'vjetër, Shuripakun,
 buzë Eufratit, t'cilin ti e njeh,
 një kohë t'gjatë hyjt' e mëshiruan.
 20 Ndiç perënditë atëbot' vendosen
 që ta shkaktajnë përmytjen e madhe.
 Në këshillim t'kuvendit merrte pjesë
 dhe vetë Eva, hyu i thellësive,
 këtë vendim që morën perënditë...

POEMA: "ILIADA"

Kënga I

(Vargjet: 1 - 40; 118 - 312)

Këndo hyjneshë,¹ mërinë² e Akil³ Pelidit,
që shumë hidhërimë e kobe akejve⁴ u solli,
dhe para kohe në skëterrë⁵ gremisi⁶
me mijra shpirtra burrërorë fatosash,
kurmet⁷ e tyre gjellë ua bëri qenve
dhe shpezve grabitqarë - kështu u plotësua
dëshira e Zeusit - qysh nga çasti i parë
që u hyri grindja dhe përçarja Atridit,
mbretit të kreshnikëve dhe Akil hyjnorit
gjatë bregut t'atij deti shungullues.
Po cili zot këtë armiqtësi ua ngjalli?
Biri i Letosë e i Zeusit, pse, i zemëruar
me prijsin, çoi ndër radhët e ushtrive.
murtajë shfaruese, dhe polemi⁸ vdiste
për faj t'Atridit, që shumë dhunë i bëri
faltarit Kriz⁹. Te anijet e shpejta akeje,
erdhi të sjellë dhurata të panumërta,
shpërblese për t'bijën, dhe rreth skeptrit¹⁰ t'artë,
mbante kurorat e Feb¹¹ shigjetarit.

Iu suall akejve e mbi të gjithë ai luti
dy Atridët, prijsit kryesorë të popujve:
"O Atridë, dhe ju të tjerë danaj¹²
kollçikëbukur,"¹³
jua prufshin mbarë hyjtë e amshuar t'Olimpit
për të pushtuar qytetin e Priamit,
shëndosh e mirë ndër vatra tuaja u kthefshi,
por time bijë liromani e pranoni
shpërblese për të, pash hatrin e Apolonit,
largshigjetuesit, birit të Kronionit."¹⁴
Të gjithë akejtë njëzëri miratuan;
"Nderim t'i bëhet priftit, t'i pranohen
dhuntitë fisnike". Por mirë nuk i erdhi
Agamemnonit; ky, i zemëruar,
me fjalë të rënda iu kanos dhe nisi:
"Plak, ruaju se të zë te anijet zgavra.
Këty fytyrën most a shoh here tjetër;
në ardhç më vonë, s'do të shpëtojnë kurorra,
as spektri i zotit. Nuk ta liroj vajzën pa
u plakur në shtëpinë time n'Argos,¹⁵
larg vendit të saj. Ndaj shpejt qërohu,
mos m'acaro, po deshe gjallë të kthehesh!"¹⁶

¹ poeti i drejtohet për frymëzim muzës Kaliopi, që ishte muza e poezisë epike.

² mëri - në origjinal është fjala e parë, me të cilën fillon poema dhe gjithë "Iliada" dhe nga ky pasion do të udhëhiqet tërë përmbajtja.

³ Akil, më i madhi dhe më i forti hero i grekëve, sipas mitologjisë ishte i biri i Peleut dhe i nimfës Tetidë.

⁴ emër i vjetër fisi në Greqinë e lashtë.

⁵ në ferr, bota nëntokësore e shpirtrave të vdekur.

⁶ i hodhi poshtë.

⁷ trupat.

⁸ populli.

⁹ baba i Krizeidës dhe prift i Apollonit.

¹⁰ shkop prej ari që mbanin princat dhe priftërinjtë, si simbol pushteti.

¹¹ një epitët i Apollonit, si perëndi i diellit, që përcaktonte shkëlqimin e tij.

¹² një nga emrat e grekëve të vjetër.

¹³ kolca, kolikë të qëndisur.

¹⁴ këtu Apolloni e ka marrë emrin e Kronit, babait të Zeusit.

¹⁵ qytet i Mikenës.

¹⁶ vëreni se si përgjigja e Agamemnonit është nervoze, mizorisht e prerë që plagos prindin

Kënga VI

(Hektori dhe Andromaka)

Hektori pasi kishte luftuar trimërisht në fushën e betejës, kthehet për pak çaste në qytet, ku takon gruan e tij, Andromakën, me të birin e tyre Astianaksin:

Andromaka i thotë:

“O Hektor, trimëria jote do të na vrasë të gjithëve!

Ti nuk ke mëshirë për mua që jam veç një grua, As për këtë fëmijë që është ende në djep. Babi im u vra nga Akili, vëllezërit e mi gjithashtu, Nëna ime vdiq prej dhembjes... tani më ke mbetur vetëm ti.

Të lutem, qëndro në kështjellë, ruaje jetën tënde, Mos më bëj të qaj sërish mbi trupin e një të dashuri tjetër!”

Hektori e përqafon dhe i thotë me zemër të rënduar:

“Gruaja ime e dashur, më dhemb shumë shpirti për ty, Por nuk mund të rri këtu si frikacak, larg betejës. Turpi do të më mbyste, sikur të mos isha në ballë. E di që një ditë Troja do të rrënohet, E ndoshta unë do të vdes... por ajo që më therr në shpirt, Është mendimi se do të të shoh të zvarritur nga armiku, Duke qarë, skllave në një vend të huaj...”

Më pas ai merr djaln në duar, e përkëdhel. E lëshon një buzëqeshje mes trishtimit dhe lavdisë.

Kënga XVIII

(Akili mëson për vdekjen e Patroklit)

Kur lajm për vdekjen e Patroklit i arrin Akilit, ai shembet për dhe, me zemrën e thyer:

“Atëherë Akili, trimi me këmbë të shpejta, Mbuloj me pluhur kokën e tij të ndritur, U shtri përdhe me gjëmë, e zemra iu copëtua.

Rënkonte si luan i plagosur, Qante mikun e tij më të dashur, Ai që i kishte qëndruar gjithmonë pranë.

Shërbëtorët e tij u mblodhën rreth tij, Heshtën, nuk guxonin ta preknin. Por ai s’mund të ngushëllohej, vetëm qante dhe qante.

Nëna e tij, Tetis, e ndjeu dhimbjen nga thellësitë e detit, Doli e mbytur në pikëllim, dhe e pyeti: “O bir, pse qan kështu? Çfarë dhimbje të ka goditur? Thuamë, që të mund të të ndihmoj me gjithë fuqinë time...”

Akili i përgjigjet me dhembje të thellë: “Patrokli vdiq për shkakun tim, Sepse nuk luftova kur duhej, Dhe tani dua vetëm hakmarrje... ose vdekje!”

Kënga XXII

(Vargjet 44 - 218; 369 - 485)

Ulëriu plaku e i ra kokës me grushte,
duart ngritur lart e fort duke rënkuar
thekshëm thërriste duke lutur t'birin.
Përpara dyerve kishqëndruar Hektori
me rreshk të madh t'i dalë n'mejdan Akilit.
Plaku prej pirgut, duke i zgjatur krahët,
Atij i foli me një zë t'përvajshëm:
"mos prit, Hektor, o biri im i dashur,
Vetëm larg shokëve në mejdan t'i dalësh
Atij fatosi, bir, do t'fikësh veten
Mposhtur nga Akili, ai është shumë më i fuqishëm.
Ah e dashtë zeusi sa edua unë mizorin,
dhe toka brenda mos e mbajtë, por orlat
dhe qentë e hëngshin; veç atherë do i hiqej
brenga ksaj zemre që ma thau i prapti;
më la pa djem, të gjithë trima si zana:
të vrarë ja t'shitor rob n'ishuj të largët.
Dhe sot mes trojsve në qytet ngujuar
dy bij të mi të tjerë s'po m'i rrok syri.
as Likaonin dhe as Polidorin,
që ime shoqe i lindi Laotoa,
zonjë mbi gjithë gratë. Në qofshin n'log t'armikut
shëndoshë e mirë, shpërblese për jetë të tyre
jap tunxh e ar; unë plot i kam sarajet,
pse vjehrrin i ndritur, plaku Altë, të bijën
e pat pajisur me një mijë të mira.
Në qofshin vrarë e në skëterrë kanë zbritur,
mua dhe s'ëmës, që në dritë i qitëm,
gjithmonë hidhrimi zemrën do na brejë.
Po aq zi për ta s'ka për të mbajtur populli,
mjaft të mos vdesësh ti nga Akili i mposhtur,
Ç'pret, biri im, hajt futu brenda mureve,
të shpëtosh trojsit dhe gratë trojane,
e as mos ia fal lavdinë e madhe Akilit,
dhe jetën tënde mos ia shkurto vetes.
Për mua të mjerin që mbi dhë bëj hije
pa më lënë mendja ende, ki dhembje n'zemër.
Mëria e Zeusit tash në buzë të varrit
gjithë këto kobe t'rënda mua m'i ruajti.
Shoh bijtë e vrarë e bijat e robëruara,
vatrat e shuara dhe kurorat prishur,
n'atë plojë të gjakshme ferishtet e njoma
për tokë përplasur dhe grabitur nuset
nga duart e kobshme të dhunuesve danaj...

Kënga XXIV

(Vargjet 1-16; 229 - 533)

Kur mbaruan lodrat, çetat u shpërndanë
dhe morën rrugën nga anijet, zgavra,
për t'u përtërirë me darkë e gjumë të ëmbël.
Kurse Akili, duke kujtuar mikun,
shkrehej në vaj, as nuk e zinte gjumi
i gjithpushtetshëm, porse rrotullohej
sa andej-kënde; mjerohej për Patroklin,
për trimëri dhe zemër tij kreshnike:
për gjithë punët që së bashku kryen.
vuajtjet që hoqën n'luftë kundër armiqve
dhe sa rreziqe nëpër tokë e dete.
Kur i kujtohej rrëke i rridhnin lotët,
vendi s'e zinte dhe herë në brinjë sillej,
herë në brinjë tjetër, tash përmbys, tash prapët.
Pastaj flakrim në këmbë prej shtratit ngrihej
e gjatë bregdetit endej si i shkalluar.

Shpejt aherë urdhër plaku u dha të bijve
të mbrehnin mushkat në qerr të rrufeshëm,
mbi të të lidhnin arkë të madhe zunkthi,
Dhe ai vetë zbriti në një dhomë të madhe
që kundërmonte e gdhendur në dru çedri,
ku mbante brenda gjëra shumë të vyera,
e atje i foli gruas së vet Hekubës:
"O e zeza grua, tash nga Zeusi m'erdhi
lajmtarja e qiellit, më urdhëron të nisem
të shpërblej djaln te gale të akejve,
të zbut Akilin me dhunti, fisnike.
Luaj, pra, e thuajm, kjo punë si të duket?
Prej anës sime urrejtja dhe tërbimi.
mua më nxitin me guxim të nisem
te ushtria e madhe pranë galeve akeje.

Fragment nga “Bretkosat”, Aristofani

Hyrja

(Skena hapet me Dionisin dhe Ksantiasin duke hyrë në skenë;

Ksantiasi është i ngarkuar me barrë të rëndë.)

KSANTIASI: O zotëri, a mund të them një nga ato shakatë e zakonshme që gjithmonë e bëjnë publikun të qeshë?

DIONISI: Për Zeus, thuaj çfarë të duash - përveç: “Jam i ngarkuar rëndë”.

“Harroje atë, është vërtet e bezdisshme.

KSANTIASI: As ndonjë tjetër shaka të zgjuar?

DIONISI: Çdo gjë tjetër, përveç “Çfarë ngarkese!”

KSANTIASI: Po atëherë? A mund të them atë më të qeshurën?

DIONISI: Sigurisht, vazhdo - por mos më thuaj këtë.

KSANTIASI: Cilën?

DIONISI: Që duhet të zhvendosësh barrën për të lehtësuar veten.

KSANTIASI: Epo, nuk mund të them që kam një ngarkesë të tillë, që nëse dikush nuk ma heq, do të plas?

DIONISI: Të lutem mos, përveç nëse dëshiron të më bësh të sëmurë.

KSANTIASI: Atëherë pse duhet të mbaj gjithë këtë barrë, pa bërë asnjë nga shakatë që Frinihu dhe Likisi dhe Ameipsiasi gjithmonë bëjnë që mbartësit e barrës të thonë në të gjitha komeditë e tyre?

DIONISI: Thjesht mos. Sepse kur jam në teatër dhe dëgjoj ndonjë nga këto shaka budallaqe, dal prej andej më i vjetër për një vit.

KSANTIASI: Mjerë unë, i mjeri! Qafa ime është vërtet e tendosur, por nuk mund të bëj shaka.

Pjesa I

DIONISI: Eja shpejto, se dua të arrij sa më parë.

Nuk mund të duroj më këtë situatë në teatër: Euripidi ka vdekur, dhe ne kemi mbetur me poetë që nuk thonë gjë tjetër veç budallallëqe.

KSANTIASI: po kush të shtyu të nisesh për në botën e nëndheshme.

DIONISI: Unë vetë, shpirti im, arti! Kam nevojë për një poet të mirë tragjik.

Një shpirt i mençur që mund të flasë me ndjenjë.

KSANTIASI: Po Agathoni?

DIONISI: Oh, ai iku me dëshirën e vet... nuk mund të marr dikë që është ende i gjallë.

Sipas ligjit të Perëndive, s'mund t'i prek dot t'gjallët

KSANTIASI: Dhe si do zbresish poshtë? Me anije?

DIONISI: Jo, jo. Ka shumë mënyra: helm, litar, rrokullisje nga ndonjë shkëmb... por unë kam një mënyrë më fisnike: Do shkoj në derën e Herakliut. Ai ka qenë atje.

KSANTIASI: Pra, do përdorësh petkun e Herakliut për t'u hedhur poshtë?'''

DIONISI: Po, sepse kushdo që e sheh këtë rrobë, dridhet, madje, edhe vetë Hadi, them, do t'm; jap; një vend nderi.

(Ata afrohen te dera e Herakliut dhe trokasin).

HERAKLIU (nga brenda, me zë të fortë): Kush guxon të më shqetësojë kështu?

DIONISI (duke u mbajtur si heroik): Një hero më i madh se ti!

Ai që do të zbresë më thellë se ti vetë.

HERAKLIU (duke hapur derën dhe parë veshjen e tij):

Hah! Ç'është kjo? Veshur si unë, me klub, me lëkurë luani?!

Ti? Një frikacak që dridhet nga vreshti në erë?

DIONISI: Mos më përçmo. Unë vij për të shpëtuar artin!

Jam në mision hyjnor për të kthyer një poet të madh!

Fragment nga tragjedia "Antigona", Sofokliu

PERSONAZHET

ANTIGONA dhe ISMENA - bijat e Edipit

KREONI - mbreti i Tebës

EURIDIKA - gruaja e Kreonit

EMONI - i biri i tyre

TIRESIA - magjistar i verbër

KORI

ROJA

LAJMËTARI I PARË

LAJMËTARI I DYTË

(Ngjarja zhvillohet në Tebë përpara pallatit të Kreonit).

EPISODI I DYTË

SKENA E TRETË

(Hyn Ismena)

KREONI

(I drejtohet Ismenës.)

Ej, ti që u zvarrite me djallëzi në shtëpinë time,
e fshehurazi më thithe gjakun!

Dy armiq të mi paskam mbajtur pranë

tërë këtë kohë e s'e paskam kuptuar!

Shpejt, pra, më thuaj: more pjesë në atë varrim,
apo betohesh se as për të ditur s'e dije?!

ISMENA

Nëse motra më lejon,

edhe unë them se jam bashkëpunëtore në varrim,
pra edhe unë fajtoje jam.

ANTIGONA

Jo, do të ishte e padrejtë,
ti nuk deshe dhe unë të përbuza.

ISMENA

Përderisa ti motër vuan, unë gati jam

që bashkë me ty një det plot rreziqe të kapërcej.

ANTIGONA

Gjithë të vërtetën e dinë perënditë,

por për mua s'është i mirë ai që vetëm fjalë ka.

ISMENA

Ti, e dashur motër, për ndershmëri s'ma kalon,

ndaj me ty dua të vdes e tim vëlla të nderoj.

ANTIGONA

Ti nuk do të vdesësh me mua, s'ke përse.

Vetëm unë do të vdes, dhe kjo mjafton.

ISMENA

Po ç'e dua unë jetën nëse ty të humbas?

ANTIGONA

Pyet mbretin, ai e di më mirë.

ISMENA

Pse shpirtin me tallje ti motër ma sfilit?

ANTIGONA

Nëse këtë tallje e quan,

atëherë me vuajtjet po qesh.

ISMENA

Motër, si mund të të ndihmoj?

ANTIGONA

Shpëto veten, nuk të kam zili.

ISMENA

E gjora unë! Vallë moskokëçarëse jam
për fatin tënd?

ANTIGONA

Po nuk jemi njësoj,

ti zgjodhe jetën, unë vdekjen.

ISMENA

Unë nuk heshta, i thashë të gjitha.

ANTIGONA

Ne nuk u sollëm njëlloj ndaj së arsyeshmes.

ISMENA

Por të dyja njëlloj fajtoje jemi.

ANTIGONA

Oh, bëhu më e guximshme! Ti jeton, ndërsa unë
me kohë kam vdekur e të vdekurve u shërbej.

KREONI

Njëra prej tyre luajti nga mendja,

tjetra e marrë ka lindur.

ISMENA

Mbret, edhe njeriu i mençur

në fatkeqësi e humb gjykimin.

KREONI

Duket që të ka ikur mendja

dhe punë të liga bën bashkë me të ligjtë.

ISMENA

Vallë si mund të jetoj e vetme pa të?

KREONI

Çdo të thotë "pa të"? Ajo tashmë s'është më!

Ti do të dënosh me vdekje nusen e djalit tënd?

KREONI

Ka lëndina të tjera që presin të punohen.

ISMENA

Po a do të puqen në të tillë mënyrë?

KREONI

Djalit unë s'mund t'i jap për grua

një femër të pabindur.

ANTIGONA

O Emon i shtrenjtë, sa poshtë ke rënë!

KREONI

Më turpërove ti dhe kjo martesë.

KORI

Vallë vërtet do t'ia vrasësh të dashurën tët biri?

KREONI

Po, martesës së tyre Hadi do t'i japë fund.

KORI

Me një fjalë, vdekja e saj është vendosur?

KREONI

Kështu them edhe unë, madje sa me shpejt.

(U drejtohet shërbëtorëve).

M'i sillni, shërbëtorë, të dyja në pallat!

Lidhini dhe të rrinë nën mbikëqyrje,

se edhe trimat përpiqen t'ia mbathin

kur Hadi në jetën e tyre troket.

(Antigonën dhe Ismenën i futin në pallat.)

POEMA: "ENEIDA" E VIRGJILIT

Libri i dytë

RRËNIMI I TROJËS

Argumenti: Mbas rrënimit të Trojës, Eneu, i biri i Ankizit dhe i perëndeshës Afërditë, niset bashkë me t'atin e të birin Askanin dhe me një grup njerëzish që kishin shpëtuar nga ploja e grekëve, për të gjetur vend ku të ndërtonte një qytet të ri trojan. Mbas shumë peripetish e mundimesh, Eneu me shokë arrijnë të dalin në brigjet e Afrikës Veriore dhe shkojnë si miq te Didona, mbretëresha e Kartagjenës. Ajo i pret mirë dhe për nder të Eneut shtron një gosti të madhnueshme. Me atë rast kërkon prej Eneut të tregojë se si u rrënua Troja.

Eneu fillon të tregojë duke ringjallur tragjedinë e Ilionit: përshkruan mashtrinë e grekëve, kundërshtimin dhe vdekjen e tmerrshme të Laokoonit, futjen e kalit brenda mureve të Trojës dhe, në fund, ployën e grekëve mbi popullsinë e zënë në gjumë, natën nëpër terr Tregon gjithashtu se si i paraqitet në ëndërr Hektori dhe i lutet të largohet sa më parë nga qyteti. Tregon mandej një varg epizodash plot bukuri e dramaticitet: se si ndeshet me Helenën, shkaktaren e tragjedisë së tmerrshme; tregon se si e ëma Afërdita i paraqet mëninë e perëndive kundër Trojës dhe vendimin e fatit për rrënimin e saj; në fund tregon se si i gjen shokët në mëngjes dhe bashkë me ta merr rrugën e mërgimit.

Heshtën t'gjith' përnjëherë, syt' i mbanin ngulur.
Atëher' Eneu prej shkëmbimi t'lartë kshtu nisi
...Mbretëreshë, do t'përs'ris t'shëmtuarat dhimbje,
Si zhbënë danajt fuqit' e mëdha të Trojës
Dhe mbretërinë e përvuajtshme të sajën,
Ti lyp të tregoj njato mjerime t'mndershme,
Që me sy i i pashë, pjesë në to mora?
Vall' kush prej murmidonëve a prej dolopëve
Ja prej ushtarëve të Uliksit zemërgur,
Këto kobe duke ndjerë, lot' sysh mund t'i ndalë?
E tash ka nisur nata e lagësht të bjerë
E yjet në qiell duke perënduar na joshin
Në gjumë. Por dëshirë të fortë në paç
T'i dish ndeshtrashat tona e t'i dëgjosh
Më të funtmet qëndresa të Trojës, dhe pse zemra
Veç t'i kujtojë tmerrohet e prej zie
Strukur në krahëror hesht, tek po zë filli.
Prisat e grajve, mbasi u thyen ndër lufta
E u gënjyen fatit, si rrshqitën aq mote,
Me frymë t'Pallades ndërtuan një kalë
Sa mali, e brinjët me drrasa breu ia ngjeshën:
Si kusht kthimi bëjnë këtë sikur ia truan,

Vajti kështu zëri. Këtu, përmbrenda kalit,
Me short të zgjedhur burrat më trima i futën
E i mbushën plot me ushtarë t'errtat gopedra,
Të barkut të tij t'pamasë. -Kundruall gjindet
Tenedi ishull, për zë e pasuri larg,
Larg i përmendur, e në këmbë qëndroi
Mbretëri e hapët e Priamit t'shkret', ka mbetur
Tash vetëm gji, e për anije skele
E pasigurtë. Këtu në të shtyrë zateten
N'këtë breg t'vetmuar. Na thanë se kishin ikur
E me erë në pupa Mikenën kishin kapur.
Prandaj kështu Teukra zin' e gjatë e hoqi
U hapën dyert e i pari t'funtmin s'priste
Të shkojë për t'parë ologjet e dorjanëve
Dhe të shkretuarat njato vise e zaje.
"Çetë e dolopve, këtu, këtu i tërbuari
Akil shatoret ngrente, këtu lundria
Vendin e kish, e ushtritë t'i përpiqnin këtu
Ishte zakon". Do të tjerë për dhanti të kobshme
T'virgjeneshës Minervë habitur, me bindje kqyrin
Atë përbindsh kali e Timeti i pari
Përmbrenda mureve këshillon ta çojnë

Dhe përmbi maje të qytezës ta vendojnë,
 A me dredhi apo pse kështu për Trojën
 Fati e kishte shkruar. Veç kapi dhe ata t'cilëve
 Më hollë ua priste mendja, ngulnin këmbë
 Që t'i hedhin n'fund pafund dhanit' me mile
 E me dyshim të Danajve ose le t'i djegin
 Ndër flakë, ja zgavrat cop' e grimë duke i bërë,
 T'ia shqyrtojnë. Mbetur ndër domna dysh
 filloi të ndahej populli mbarë. Më i pari
 Atëherë ndër t'gjithë, ndjekur nga moria
 Ndezur flakë e shkëndija, Laokonti dirgjet
 Nga maja e kështjellës e për s'largu briti:
 „O të mjerë qytetas, mendjen ku ma keni?
 Kujtoni se armiqtë u janë shporrur qafe,
 Apo edhe mendoni se dhanitë argive,
 Kanë mundur të ngelin pa dredhi me vete?
 Kaq mirë ma njifkeni ju dhe vetë Uliksin?
 Ose Akejt mbrenda këtij druri janë fshehur
 A kjo almise është kundra ledheve tona.
 Që t'i zhbirojë kullat kavatuar ka qenë
 Dhe që t'i rrijë pezull mbi krye qytetit,
 A një dinakëri kjo ndryrë në veti e ka:
 Trojanë, ju ruanju se besoni kalit,
 Sido që t'jetë puna unë danajt i druaj
 Edhe kur për fli ua njomë dorën dhurata”.
 Kështu foli e t' rreptën patërshanë e drodhi
 Me sa fuqi kishte n'bark t'zgavërt të kalit,
 U ngul në të dridhur heshtja e prej gjëmës
 Së barkut të kafshës u shtuan rëndë zgavrinat,
 Dhe po mos të kish qenë vullnet i yjve t'epër
 E mos të kish qëlluar e lehtë mendja jonë,
 Me heshta në dorë do t'na shtynte shpellinat
 E grajve t'i dërmonim, e në këmbë sot Troja
 Do t'ishte, dhe ti o e larta kështjell' e Priamit.
 Në ndërkohë erdhi një çetë barish dardanë,
 Lidhur me duar mbas shpine, një djalë po shpinin
 Te mbreti me zhurmë të madhe; ky rrugtarëve
 Pa njohur e pa ditur përpara dalë u kish.
 Që këtë dredhi mir' e mirë ta endte
 Dhe Akejve të mund t'ua çelte Trojën,
 Në vetvete presën ngulur e kish, dhe gati
 Ishte për çdo rrezik, ja në vend mundimin
 E vet ta çonte, ja me krye ta lante.

Gjithanës e mbledhur, shkon e derdhet djelnia
 Teukre për të vrojtur e duke shpotitur robin
 Rreken shoshoqit veç si t'mund t'ia dalin
 Shihi tash dredhitë argive, nisu prej njërit
 E gjyko e dije se ashtu janë t'gjithë të tjerët
 Sapo n'sy të t'gjithve vend pa zënë i shuari
 Pa thikë pa brisk, e përreth e pau shumicën
 E frigasve, fshau: „O unë, tri herë i shkreti,
 Po a ka më tokë a det që mua të më presë?
 A ç'ë ka mbetur mua të mjerit tash më tjetër?
 Që as ndër danaj vend kurrkund më nuk gjej
 E si armik Dardanët vetë do të më gjykojnë
 Për vdekje” Këto fsharje mendjen na e ndërruan
 E hovi i zemrës fashë nisi të bjerë.
 Duam të tregojë për fisi se nga është lindur,
 Ç'lajm sjell me vete e ku e ka vënë shpresën
 Tash që është robëruar. Mbas frike ai foli:
 Për fill e për pe, tha se ç'po ta çeli,
 O mbret, gjithëçkafin, pa i bërë lak kuvendit,
 As nuk mohoj se jam farës së Argut:
 Kjo le t'jetë e para; e sado i mbrapshtë,
 N'e bëri t'mjerë Sinonin fati, rrëc e shtis
 S'ka për ta bërë. Nëse ndonjëherë duke folur
 Gand në vesh do t'ketë rënë zëri e trimëria
 E palamend Belidit, të përmendur larg,
 Të cilin pellazgët për tradhti të shpifur
 E me një padi që kurr s'ka qenë ndëgjuar,
 Pse s'donte që lufta më gjatë të vijonte,
 Të pafaj me vdekje e dënuan e tash të fikur
 Me lot e qajnë: te ky qysh fëmijë at' shkreta
 M' dërgoi ndër lufta trimin unë ta përcillja,
 Si mik që ishte e farefis me ne.

ANALIZË



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Mbi cilat vlera morale dhe ligjore ndërtohen veprat letrare të antikitetit?
- Cilat janë cilësitë e Gilgameshit, si një hero epik?
- Çfarë simbolizon kërkimi i pavdekësisë në këtë vepër?
- Si paraqitet miqësia midis Gilgameshit dhe Enkiduit?
- Si përshkruhen hyjnitë në “Iliadë” dhe çfarë ndikimi kanë te njerëzit?
- Cili është konflikti kryesor në tragjedinë “Antigona”?
- Shkruani një monolog të brendshëm të Antigonës, para se të dënohet me vdekje!
- Krahasoni figurat e Eskilit dhe Euripidit në komedinë “Bretkosat”?
- Shkruani parodi të një debati aktual, duke e ndjekur stilin e “Bretkosave”!
- Portretizoni personazhet, si: Agamemnoni, Akili, Prijami...!
- Çfarë rëndësie ka tragjedia dhe çfarë komedia?



SPROVË LETRARE:

Temat:

- "Flijimi është i patjetërsueshëm për të ngritur diçka të rëndësishme e të dobishme në jetë"!
- "Lavdia dhe vdekja në “Iliadë,”!
- "Simbolika e rrënimit të Trojës, nënkupton një fund apo një fillim"?

HUMANIZMI DHE RENESANCA NË LETËRSINË EVROPIANE

Humanizmi është rrymë kulturore, filozofike dhe letrare, i cili u paraqit në shekullin XIV në Itali dhe synonte të vërë në qendër **njeriun, arsyen, dijen dhe vlerat e jetës tokësore.**

Humanistët mendonin se, rikthimi i dijeve mbi lashtësinë klasike greko-romake, si dhe arsimimi dhe edukimi i njerëzve do ta rikthente lirinë mendore dhe dinjitetin e individit të lirë e të pavarur nga dogmat e mesjetës. Kjo frymë u pasqyrua në art, kulturë e letërsi, ku filluan të trajtohen tema për jetën, natyrën, lirinë, dashurinë... Pra, filloi liria krijuese e njeriut që po çlirohej nga kufizimet e rrepta mesjetare.

Renesanca është një periudhë letrare e kulturore, e cila filloi në shek. XV, në Itali dhe u përhap në tërë Evropën. Rrjedh nga frëngjishtja (renaissance = rilindje), nënkupton rilindjen e idealeve të antikitetit klasik dhe e thekson rëndësinë e njeriut, natyrës dhe përparimit shpirtëror e shkencor, duke sjellë zhvillime në art, filozofi e letërsi.

Me anë të humanizmit dhe renesancës u rikthye besimi te fuqia e arsyes dhe përparimi i shkencës, ku dallohen Koperniku e Galileu, ndërkaq arti dhe letërsia filluan të krijohen në mënyrë më reale, duke e bërë përshkrimin më të saktë të njeriut dhe botës.

Përfaqësues të kësaj rryme janë: Dante Aligieri, Leonardo da Vinçi, Mikelandhelo Buonaroti, Françesko Petrarka, Xhovani Bokaço, Migel de Servantes, Uilliam Shkspir, Desiderius Erasmus (Erasmus i Roterdamit) etj.

DANTE ALIGERI

(1265 - 1321)

Letërsia botërore në majë të piramidës së vlerave të saj letrare ka vendosur autorë të mëdhenj, të cilët pavarësisht epokave kur jetuan i dhanë shumë kulturës dhe njerëzimit. Një ndër ta është edhe Dante Aligieri, jo vetëm emër i çmuar i Rilindjes italiane, por figurë e ndritur e letërsisë botërore.

Fati i Dante Aligerit që i lidhur ngushtë me fatin e atdheut të tij. Ai lindi në Firencë, në vitin 1265, kur në Itali mbretëronte një kohë trazirash politike, shpirtërore dhe kulturore, në një familje të shtresës së mesme aristokrate, ku pati mundësinë që t'i



zhvillojë prirjet dhe dijen e tij. Studioi gjithçka që ishte e mundur në mesjetë: art, gramatikë, letërsi, filozofi, teologji, histori, drejtësi, fizikë, matematikë, astronomi, dije enciklopedike...

Në kohën e Dantes, burim kryesor për formimin letrar ka qenë arti dhe kultura latine e antikitetit romak. Danteja zgjedh Virgjilin si prijës të vetin në botën e pëртејme, për të forcuar *vazhdimësinë* e fenomenit letrar në Evropë.

Ka shkruar disa vepra: “Jeta e re” (1292 - 1293), “Egloga” (1319 - 1321); “Epitrat”, “Mbi gjuhën vulgare 1303 - 1304); “Gostia” (1304 - 1307); “Monarkia”, “Uji dhe toka” (1320).

Vepra letrare: “Komedia hyjnore”

Struktura e veprës: “Komedia hyjnore” është poemë didaktiko-alegorike e ndërtuar sipas modelit të hershëm të *eposeve popullore kombëtare*, me përpikëri letrare, artistike dhe teoriko-stilistike. Sikurse Zoti që e krijoi botën për 7 ditë (duke e filluar në pranverë), ashtu edhe udhëtimi i Dantes në pëртејbotë zgjati 7 ditë.

Vepra përmban 100 këngë, të ndara në tri pjesë: **Ferri (Inferno)**, **Purgatori (Purgatorio)** dhe **Parajsa (Paradiso)**, secila me nga **33 këngë**, të parapirra nga kënga hyrëse. Një konceptim i këtillë strukturor tregon ndjeshmërinë e autorit ndaj harmonisë dhe rendit. Secila pjesë përfaqëson një fazë të udhëtimit shpirtëror të njeriut: mëkati - pastrimi (katarza) - shëlbimi. Çdo këngë është ndarë në tercina (strofa me 3 vargje), me rimë të ndërthurur (aba, bcb, cdc...), e njohur si *terza rima*, një shpikje e vetë Dantes. Poema ofron edhe simetri dhe përpikëri numerike, ku numri 3 (shenjtëria e Trinisë së shenjtë: Zoti, Shën Mëria, Jezu Krishti) është mjaft simbolik dhe përdoret në të gjitha nivelet e ndërtimit.

Përmbajtja: Në poemën “Komedia hyjnore”, Danteja e përshkruan udhëtimin e tij imagjinar nëpër botën e pëртејme, duke takuar shpirtra të ndryshëm dhe duke reflektuar mbi drejtësinë hyjnore, mëkatin, pendimin dhe shpëtimin. Përshkrimi është alegori e thellë për udhëtimin shpirtëror të njeriut, nga errësira e mëkatit drejt ndriçimit dhe bashkimit me Zotin. Gjithçka fillon me hyrjen në Ferr dhe mbishkrimin e famshëm mbi portën e tij: “*Braktisni çdo shpresë, ju që hyni!*”.

Jeta politike e vendlindjes që shkas që e shtyri të përfshihej në të, duke marrë pjesë aktive në debatet e kohës midis Guelfëve dhe Gibelinëve, e më pas mes Guelfëve (të bardhë dhe të zinj). Danteja ishte pjesë e Guelfëve të bardhë, të cilët ishin kundër ndikimit të Papës në punët politike. Në vitin 1302, për shkak të konflikteve dhe akuzave për korrupsion, ai u dëbua nga Firenca.

Ngjarjen e vendos në nëntë rrathët e “Komedisë” që i përshkon i shoqëruar nga Virgjili, pra me poetin që përfaqëson arsyen dhe urtësinë njerëzore e më pas me Beatricën, figura që përfaqëson dashurinë hyjnore. Gjatë rrugëtimit të

tij, takon figura historike, mitologjike dhe bashkëkohës dhe përmes tyre paraqet vlerat, gabimet dhe idealet e shoqërisë.

Figura më e çiltër është ajo e Beatrices, vajzë e re (11 vjeçe), të cilën poeti e dashuroi thellësisht. Edhe pse dashuria e tyre mbeti platonike, ajo u bë frymëzimi i tij shpirtëror dhe poetik. Pas vdekjes së saj të hershme, ajo do të shndërrohet në simbol të virtytit dhe udhëheqëse e shpirtit në poemën “Komedia Hyjnore”.

Stili: Dante Aligieri arriti të krijojë një stil të veçantë, pothuajse solemn (më i arrirë për kohën) që përshtatej me temën hyjnore dhe shpirtërore të veprës. Virtytet dhe mëkatet njerëzore i përshkruan me figura të për zgjedhura e detaje të forta pamore, të cilat i japin gjallëri dhe origjinalitet veprës, shpesh edhe situata dramatike e tejet emocionale.

Gjuha: veprën e shkroi në italishten e asaj kohe (dialektin toskan), duke e ngritur atë në nivelin e një gjuhe shumë më të përsosur, pasi latinishtja ishte ende gjuha e zakonshme e letërsisë e filozofisë. Poetika e Dantes bazohet kryesisht në *simbolikën biblike*.

Vepra është e mbushur me simbole dhe figura alegorike që i përfaqësojnë konceptet morale, fetare dhe filozofike, ku çdo personazh, ngjarje ose vend ka një kuptim të dytë, më të thellë. Përdori gjuhë të pasur me figura si: metafora, krahasime, anafora e eufemizma, që tregon një formim të lartë për njohjen e artit letrar. Gjuha e kësaj vepre, me gjithë pasurinë dhe perfeksionin e saj, e ngriti italishten në një gjuhë kombëtare letrare.

Rëndësia: “Komedia hyjnore” është një enciklopedi poetike e mesjetës, ku Danteja e gërshetoi: letërsinë, filozofinë, teologjinë, historinë dhe ideologjinë politike të kohës. Përballë këtyre dijeve e vendos problematikën shoqërore, të trajtuar në temat universale, që shenjojnë linjën: jeta, vdekja, mëkati, pendimi, shëlbimi, gjë që i jep veprës shumë vlerë.

Ndërthurja e udhëtimit fizik me atë shpirtëror i jep veprës një dimension të thellë filozofik e moral dhe e bën të vlefshme në çdo kohë. Kjo thellësi përmbajtësore e bëri veprën e Dantes frymëzuese edhe për shkrimtarë të tjerë të mëdhenj, si: Bokaço, Petrarka, Milton, Gëte... e shumë të tjerë të brezave të mëvonshëm. “Komedia” u përkthye në shumë gjuhë dhe u komentua nga filozofë, teologë dhe shkrimtarë të shumtë, pasi përfaqëson një sintezë madhështore të dijes së Mesjetës dhe shërben si urë kalimi drejt mendimit humanist të Rilindjes.

Fragment: "Komedia hyjnore"

Dantja e Virgjili

Takim me Virgjilin

(Kënga I, vargjet 21 - 136)

Si ai, që duke marrë frymë me të vështirë,
prej deti del në breg e nga ato valë
aq të rrezikshme sytë e vet i prir,

dhe shpirti im që ikte pa u ndalë,¹
mbrapa u suell me pa atë rrugën trishte,
që s'la njeri të gjallë andej me dalë.

Dërmue, si u çlodha pak mbi atë gurishte,
ia nisa rrugës nëpër breg t'shkretuem,
çdo herë kamba e ndalun ma poshtë ishte .

E, ja, gati përpjetën pa filluem,²
më doli një panterë e lehtë, e shpejtë,
që me lëkurë të larme ish mbuluem;

synin mbi mue e mbante ngulun drejtë,
e udhën time aq keq e kishte pre,
sa qeshë sa herë tu ikë e kthye unë krejt.

Ishte koha kur agonte dita e re
e ngrihej Dielli me atyq në qiell
që me te ishin, kur Zotynë mbi dhe

së pari i lëvizi n'ajër të kthiell;
guxim e shpresë në shpirt më kish përtritun
për bishë-larushen, që s'po i gjeja fill,

ai agu i ditës, e ambla stinë e ndritun,
por jo sa frikë aspak t'mos më shkaktonte
pamja e një luani shfaqë papritun.

Ky dukej se drejt meje po u afronte
me kokën lart, me një uri t'tërbueme,
sa ngjante se edhe ajrin e tmerronte

Veç një ulkojë, që shihej e pushtueme,
ashtu kockë e lëkurë, nga shumë dëshira,
saqë njerëzinë e bani të mjerueme:

*** Poet unë qeshë, këndova t'drejtin bir
të Ankizit³, ardhun Troje, kur u krye
lufta që Ilionin⁴ dogji pa mëshirë.

Po ti drejt s'keqes⁵ pse je tue kthye,
pse s'hyp malit⁶ si çdo gëzimi
edhe hareje asht fillim, arsye?"

¹ të trishtë.

² këmba e majtë, e rënduar nga mëkatet.

³ Enea - prijës trojan.

⁴ Ili, emri i dytë i Trojës.

⁵ drejt jetës tokësore, që është plot mëkatet.

⁶ mali i Purgatorit, nga ngjitesh në parajsë.

Ti qënke ai Virgjili, ai burimi
që fjala i rrjedh si lumë i gjanë? - menjherë
i gjegja unë i skuqun nga turpnimi⁷. -

O ti i gjithë poetëve dritë e nder,
ndihmomë, pash dashurinë e atë mundim
që derdhe unë kam mbi librin tand me vlerë!

Mësuesi im ti je, auktori im,
ti je i vetmi njaj, nga i cili nxora
të bukrin stil, që më ka dhanë nderim.

Shihe shtazën nga e cila rrugën bora⁸!
shpëtomë, o dijetar me nam mbi dhe,
se prej asaj po më dridhet kamba e dora!"⁹

"Po të duesh, një shtek tjetër me dalë ke -
m'u gjegj ai, kur më pa me sy tanë lot, -
në daç shpëtim n'kët vend plot me shkërbe¹⁰:

se kjo bishë, për të cilën thretet ti sot,
nuk len njeri në rrugë të saj me u sjellë,
dhe pa të mbytë ajo s'të lëshon dot:

e ka një shpirt që zi e vajë veç ndjell¹¹,
nga lakmia e pangopshme kurr s'qetësohet,
asht ma e uritun tue fa me gjellë.¹²

Me shumë frymorë* ajo pa da barcohet¹³,
deri sa të vijë Langoni, tjerë* do gjejë,
po mizorisht nga ky do të dërmohet.

Se Ai, që lart e ka mbretnin e tij,
Mbasi ligjës s'iu binda¹⁴, nuk dëshron,
Që përmes meje shpirt atje t'arrijë.

Gjithkund sundon, por veç atje mbretnon,
Atje qytetin ka, selinë e vet, -
Lum ai, të cilin afër e pranoni!"

E un: atij "Të lutem, o Poet,
Deh, pash atë zot, që ti s'e adhurove¹⁵,
Vetëm kështu ti mos më len për shkret:

Më ço ku the, t'ia dal unë kësaj prove,
që portës së Shën Pjetrit¹⁶ t'i hyj brenda,
Të shoh ata, që aq të mjerë përshkrove!"

Ani n'ecje e vu, e unë pëmbra i renda.

⁷ skuqet nga emocioni para Virgjilit.

⁸ e kryer e thjeshtë e foljes - bjerr.

⁹ Dante nuk ka turp të tregojë frikën e vet.

¹⁰ shkërbenj ose përbindës.

¹¹ që ndjell zi e vaj.

¹² ndihet më e uritur kur e ka barkun plot.

¹³ në origjinal: kafshë; *çiftëzohet.

¹⁴ Virgjili ka lindur në v. 70 para Krishtit.

¹⁵ Krishti, që ka lindur para Virgjilit.

¹⁶ portës së Purgatorit, që çon në Parajsë.

Porosia e Beatrice

(Kënga II, vargjet 52 - 81)

Unë isha ndër ata që janë si varë.¹
Një vashë hyjnore e e hijshme² m'thirri pranë,
"M'urdhno, i thashë, e do jem krenar".

Si yj t'shkëlqyem sytë e saj m'u gjanë:
ia nisi të më flasë ambël e qetë,
e engjullor ajo e kishte zanë³.

"O mantovan⁴, ti fisnikija vetë,
që nami ende nëpër botë mbarë s't'u fik
e, sa t'jetë bota, gjallë do t'mbesë përjetë,

një miku im që fati s'e don mik⁵,
diçka s'po e len të lirë n'të shkretin stom,
sa jo përpara, mbrapa shkon ai vrik.

Kam frikë aq t'madhe se asht keq, sa thom
se kot në ndihmë të tij drue kam lëvizun,
për të sa kam dëgjue në t'lartin drom⁶.

Shpejto, pra, dhe me fjalën e stolisun,
me çdo mënyrë si e lyp e mir' e tija,
ndihmoje, ngushëllue ndaç me më nisun.

Beatrice po të çon⁷, vi* nga selia
ku prap un kam dëshirë të fluturoj;⁸
më suell e më shtyn me t'folun dashunija.

Porsa ballë Zotit tim unë të qëndroj,
për ty shpesh para tij kam me u lavdue"
* Kështu fillova, kur ajo heshtoi:

"O vashë n'virtyte e cilësi mbulue,
që njerëzimit dritë ma shumë i dhe
se qielli, që shkon rrathët tue ngushtue,⁹

kaq më pëlqen ky urdhër që më le,
sa do dëshiroja tash ta kishe krye,
ma gjatë, pra, të më flasësh nevojë s'ke.

¹ shpirtërat e ndritshëm të antikitetit.

² Beatrice.

³ zërin.

⁴ Virgjili lindi në Mantova.

⁵ Dantja, i humbur në "pyllin e errët".

⁶ këtu në: Qiell.

⁷ me misin për tek Dantja; *vij;.

⁸ Beatrice zbret nga Parajsa.

⁹ në formë koni, ku në majë rri Perëndia.

Anteu

(Kënga XXXI, vargjet 130 - 141)

Kështu i tha¹; e ai ma nuk u prit,
duerët i shtriu e prisit tim ia ngjiti²,
duerët që trandën Herkul³ petrit.

Si u kap prej tij, Virgjili më thërriti:
"Afrou të marr dhe ty!", e mbas pak kohet
të dy, si t'ishim një, prej dheut nga ngriti.

Si duket Garizenda⁴, po t'shikohet nga poshtë,
kur sipër saj kalon një re,
n'drejtim të kundërt pyrgu thue hepohe⁵,

ashtu m'u duk Anteu, kur vuna re
si po anohej, e n'atë ças i shkreti
do kishja dashë me u gjetë në tjetër dhë.⁶

¹ Virgjili që i pati lypur ndihmë Anteut.

² ia ngjiti duart, e kapi.

³ Anteu desh e mbyti Herkul.

⁴ kullë e lartë, e pjerrët në Bolonjë.

⁵ fiton pjerrtësi.

⁶ në tokë që është më i sigurt.

ANALIZË



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Si e mori emrin lëvizja humanizëm dhe si renesancë?
- Bisedoni rreth përmbajtjes së “Komedisë hyjnore” dhe stilit të shkrimtarit!
- Pse autori e krijoi këtë mendim për shoqërinë e kohës së tij?
- Përshkruani udhëtimin shpirtëror të Dantes!
- Cilët janë bashkudhëtarët e Dantes, jepni karakteristikat e tyre morale!
- Si janë ndërtuar: Ferri, Purgatori dhe Parajsa?
- Përmbledhjeni në pak fjalë rëndësinë e veprës, në kohën e shkrimtarit dhe përtej kësaj kohe!
- Pse vepra “Komedia hyjnore” e Dante Aligerit vazhdon të mbetet një vepër e rëndësishme për letërsinë botërore?

Plotësoni fjalitë:

- Dante Aligieri lindi në qytetin e _____.
- Kryevepra e tij titullohet _____.
- Vepra e Dante Aligerit ndahet në tri pjesë: _____, _____ dhe _____.
- Udhërrëfyesi i Dantes në Ferr dhe Purgator është _____.
- Në fund të udhëtimit, Danteja e takon _____, simbol i dashurisë dhe i shpëtimit hyjnor.

FRANÇESKO PETRARKA

(1304 - 1374)

Françesko Petrarka, një ndër figurat më të shquara të letërsisë italiane dhe shkrimtar i rëndësishëm humanist, që i përket periudhës para Rilindjes ose Rilindjes së hershme.

Lindi në vitin 1304, në qytetin Arezzo, të Italisë. Familja e tij ishte dëbuar nga Firenca për arsye politike, andaj Petrarkës i duhej të studionte në qytete të ndryshme në Itali, madje edhe në Francë. I pëlqente letërsia dhe filozofia, megjithëse babai e kishte drejtuar për në drejtësi. Adhurimi ndaj letërsisë klasike, sidomos për autorët latinë, Ciceronin e Virgjinin, e bëri të ndalonte vetëm në letërsi.

Petrarka, udhëtoi shumë gjatë jetës dhe u lidh me shumë figura të shquara të kohës, punoi për familjet fisnike, duke e përdorur pozicionin e tij për të përhapur idetë humaniste.



Ai vdiq në vitin 1374, në qytetin Arquà (sot Arquà Petrarca).

Petrarka shkroi shumë vepra në latinisht, ndër më të njohurat janë: “Libri i këngëve” (“Il Canzoniere”), “Triumfet”, “Letra familjare”, Letra nga vetmia”, “Afrikani” etj., nëpër të cilat trajtoi tema nga më të ndryshmet.

Vepra letrare: “Libri i këngëve” (“Il Canzoniere”) është përmbledhje prej 366 sonetesh, si një himn dashurie kushtuar gruas së bukur, Laurës, ndonëse mbeti vetëm dashuri platonike. Ajo u shfaq rastësisht në jetën e shkrimtarit (u takuan më 6 prill 1327, në kishën e Shën Klarës, në Avinjon) dhe që në shikimin e parë ai e njohu gruan, e cila do të bëhej muzë e përjetshme e poezisë së tij. Që nga ai çast, emri i Petrarkës është i pandashëm nga ai i Laurës në tërë poetikën e tij, ku përshkruhet udhëtimi i ndjenjave, si pasqyrë e shpirtit të njeriut që dashuron, teksa vuan e shpreson.

Vepra është ndarë në dy pjesë kryesore: “**Në jetë të Laurës**” dhe “**Pas vdekjes së Laurës**” ku përshkruhet rrjedha e ndjenjave të poetit, nga çasti i përjetimit të dashurisë, në mënyrë të zjarrtë dhe të turbullt, deri në pikën kur dashuria shndërrohet në një ndjesi më të pastër, më të qetë dhe shpirtërore pas humbjes së Laurës.

Poezia e Petrarkës karakterizohet me disa elemente, si ndër të parët poetë, që shkroi për ndjenjën e dashurisë si përvojë personale:

Me një stil të përpunuar dhe **të pasur me figura letrare** paraqet ndjenjat intime dhe betejat shpirtërore, në formën e sonetit me muzikalitet të qartë;

Subjektivizmi i theksuar, përmes të cilit i shpreh ndjenjat dhe mendimet personale;

Dashuria platonike: idealja dhe shpirtërorja për Laurën;

Tematika e natyrës bëhet objekt krahasimi dhe pasqyrimi shpirtëror i poetit;

Gjendja e brendshme shpirtërore si konflikt midis dëshirave dhe idealeve shpirtërore.

Soneti (tingëllima), poezi lirike me katër strofa, prej të cilave dy të parat kanë nga 4 vargje (katrena) e dy të dytat nga 3 vargje (tercina), zakonisht njëmbëdhjetërrokëshe (abba, abba, cde, cde), e me sistem rimash të ndryshme.

Rëndësia e veprës:

Françesko Petrarca njihet si poeti më i rëndësishëm evropian që e përdori sonetin për të shprehur ndjenja dashurie, filozofike e shpirtërore, në një vepër që i tejkalon kufijtë e kohës dhe mbetet aktuale, përderisa trajton ndjenja dhe dilema universale, të cilat janë pjesë e përvojës njerëzore në çdo epokë. Ajo reflekton mbi kalimin e kohës dhe fatin njerëzor, duke ruajtur një ton filozofik dhe moral.

Poeti ndikoi thellë në zhvillimin e gjuhës dhe poezisë italiane.

Stili i tij elegant dhe përmbajtja e thellë filozofike bënë që ai të konsiderohet si një nga themeluesit e humanizmit dhe një nga pararendësit më të rëndësishëm të epokës së Rilindjes Evropiane. Kjo mënyrë e të shkruarit ndikoi thellësisht në zhvillimin e poezisë evropiane për shekuj me radhë, duke u marrë si model nga poetët e mëdhenj: Uilliam Shekspiri, Pier de Ronsari dhe Xhakomo Leopardi.

Poezia e Petrarkës u bë një urë midis antikitetit dhe humanizmit të Rilindjes.

Fragment: "Libri i këngëve"

LIBRI I KËNGËVE

I.

Ju që dëgjoni vargjesh zërin tim,
ato psherëtima q'ushqyen zemrën time
kur isha i ri e rashë në gabime.
E tjetër isha në moshë, në lulëzim.

Me tjetër varg po qaj me pikëllim
të shkimet shpresa, dhimbje e kotësi
që i njeh mirë, kush ra në dashuri,
të falur s'dua, po vetëm përdëllim.

Dhe un' e di, të gjithë më kuptuan,
shkoi gjatë kjo përrall' rreth meje, për çudi,
sa prej vetvetes vetë më erdhi rëndë.

Po ky është fryt i shpirtit tënd kur vuan:
pendesë është, delir, nëse s'e di,
se ç'të pëlqen e shkurtër është si ëndërr.

XIII

Kur midis grash kalon e bën kuvend,
unë vij aty e syt' me dritë i mbush;
në bukuri ty s'ta kalon askush
që dashurin' më rrit e që më çmend.

Bekuar qoft' dhe çasti, dhe ai vend
ku atë dritë pane syt' e mi
e them: lavdi për ty, o Perëndi!
që ajo ish e denjë për hirin tënd.

Prej teje lind mendim' i dashurisë
që ti kur ec, pas vetes sate mbledh,
pasione njerëzish, pa gjë të keq i zvjerdh.

Prej teje rrjedh ky shpirt' i bukurisë,
prej qiellit vjen, së mires i hap shteg,
për çdo njeri si unë që shpresa pret.

LXI

Bekuar qofsh, o ditë, muaj, vit,
o kohë, o vend i pastër, i begatë
që ju një çast të ndritur shumë më dhatë,
kur syt' e saj më lidhën timin shpirt.

Bekuar qofsh e para dhimbja ime,
që Dashuria mbi krye na vërtit
dhe me shigjetë në zemër na godit
duke na derdhur helme, pikëllime.

Bekuar ju, o tinguj, fjala ime,
që pëshpërit këtu të sajnë emër,
psherëtim' e lot', që kam në zemër.

Bekuar ju, të mijtë vargje, rima,
Që mall kënduat, mendime. Shpesh nën zë
Për tjetër s'shkrova, po vetëm për atë.

CVII

Ah, ti liri se si më le të shkretë,
trego njëherë se sa i qetë kam qenë
përpara se shigjeta të më kish zënë
dhe hapi plag' që kurrë shërim s'do ketë!

Dy syt' e mi që shtyn sevda në jetë
jo, s'ka ç't'ju bëj' as kjo qrsye gjorë
nga një krijes' e hyjshme t'heqin dorë
kur mbi atë padashur shkuan vetë!

Dëgjuar s'kam gjekund dikush të thotë
kjo vrasëse jo mend s'i ka në kokë,
kur emri i saj mbush botën tingëllima;

Kupidi i madh s'më hedh më vetëtima,
udh' tjetër s'kam e as të tjera duar,
e as një tjetre kurrë s'i pata shkruar.

ANALIZË



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Ku u mbështet vepra poetike e Françesko Petrarkës, si reflektim përmbajtësor i renesancës?
- Si pasqyrohet ndikimi i humanizmit në krijimtarinë e Petrarkës?
- Si e përshkruan veten poeti në strofën e parë të poezisë “Libri i këngëve”?
- Çka simbolizon dashuria e poetit ndaj Laurës, pse ajo mbeti një dashuri platonike?
- Përshkruani ndjenjën e mallit dhe pikëllimit të poetit!
- Gjeni figurën e simbolit dhe metaforën në këtë poezi!
- Analizoni strofat ku kemi monolog si dhe dialog me Laurën!
- Si i kuptoni vargjet e dhëna, kë e hyjnizon Petrarka në strofën e dhënë:

“Prej teje rrjedh ky shpirt’ i bukurisë”,
Prej qiellit vjen, së mirës i hap shteg,
Për çdo njeri si unë që shpresa pret.
- Çfarë mesazhi ju përcjell kjo poezi, shënoni vlerësimet për të!



SPROVË LETRARE:

- Shkruani një sonet sipas modelit të Françesko Petrarkës!
- A njihni ndonjë poet tjetër që i këndoi një dashurie platonike?

NOVELA E RENESANCËS

Novela (tregim i gjatë) ka subjekt realist, përshkruan ngjarje me temë nga jeta e përditshme me personazhe të përzgjedhura nga realiteti shoqëror, pra jo nga figurat mitologjike.

Linja rrëfimore ka **strukturë të përqendruar**, rrëfimi i së cilës është më i gjatë se tregimi, por më i shkurtër se romani. Në qendër e vendos **njeriun**, si qenie e vetëdijshme me **mendime, ndjenja dhe vlera**, duke reflektuar idetë humaniste të kohës.

Novela është një formë e prozës letrare, më e gjatë se tregimi, por më e shkurtër se romani (tregim i gjatë) që zakonisht përshkruan një ngjarje të vetme, me një konflikt të qartë dhe një strukturë të përmbledhur.

Stili i të shkruarit të novelës, në aspektin gjuhësor, përafron me të folurit e zakonshëm, prandaj përdor një gjuhë të gjallë dhe të natyrshme. Si çdo lloj arti, edhe novela shërben për të kritikuar zakonet, padrejtësitë, dogmat dhe të metat e shoqërisë, prandaj e përdor humorin dhe ironinë.

XHOVANI BOKAÇO

(1313 - 1375)

Xhovani Bokaço është themelues i letërsisë moderne, i cili në kohën e trazirave të mëdha, në Evropën e mesjetës, arriti të përçojë frymë të re humaniste, që e vendoste njeriun në qendër të universit. Me kryeveprën “Dekameroni”, ai jo vetëm që do t’i afrohet kulturës klasike dhe letërsisë latine, por do të jetë frymëzim për shumë shkrimtarë të tjerë në Itali dhe më gjerë.

Lindi në vitin 1313, në Firencë, në një familje tregtarësh. Babai e shtyri që të studionte për drejtësi, në Napoli, ndërkohë Bokaçon nuk e tërhiqnin ligjet, por një pasion i madh për kulturën, muzikën, librat... pasi kishte një shpirt të ndjeshëm për letërsi dhe filozofi.

Veprat letrare më të njohura të Bokaços janë: “Dekameroni”, “Filostrati”, “Teseida”, “Fiameta”, “Genealogia Deorum Gentilium” (një përmbledhje enciklopedike mbi mitologjinë greko-romake). Fati nuk ia ofroi më të mirën e jetës (pavarësisht vlerësimit dhe famës), pasi i sëmurë nga murtaja dhe në varfëri të madhe, ai vdiq në Certaldo (qytet i vogël në Toskanë), në vitin 1375.



Vepra letrare “Dekameroni”

Përmbajtja: është një përmbledhje tregimesh për jetën, dashurinë dhe zgjuarsinë e njerëzve gjatë kohës së murtajës. Përbëhet nga 100 novela, të treguara gjatë 10 ditëve nga një grup prej 10 të rinjsh (7 vajza dhe 3 djem) që largohen nga Firenca për t’i shpëtuar murtajës së madhe që e kishte goditur qytetin, në vitin 1348. Shtatë vajzat dhe tre djemtë takohen në kishën dominikane Santa Maria Novella të Firencës dhe pajtohen se rrëfimet do të jenë forcë shpëtimtare për ta mundur vdekjen.

Secili prej tyre rrëfen nga një histori për 10 ditë me radhë, kështu formohen 100 tregime. Për këtë arsye e emëroi Dekameron (greq. deka - dhjetë). Temat, janë të ndryshme, si: dashuria, fati, lakmia, zgjuarsia, mashtrimi, morali, sensualiteti dhe marrëdhëniet shoqërore. Vepra përmban tregime gazmore dhe erotike, ashtu edhe tregime të thella dhe morale. Ngjarjet zhvillohen në vende të njohuara për tregtarët italianë, si: kështjella, manastire, shtëpitë qytetare, kasollet e fshatit, në anije, sheshe dhe në rrugët e qyteteve të vjetra, në Firencë, në Napoli etj.

Stili - Bokaço është shkrimtar i veçantë që përshkruan situata e personazhe me një stil plot gjallëri e ngjyrë. Stili i tij është i kombinuar, herë shkruan me një dozë ironie e satire ku i tall personazhet hipokritë të mashtruar nga lakmia për pushtet, herë përdor stil narrativ dhe lirik ku shkruan me një gjuhë të thjeshtë e të rrjedhshme, por edhe pjesë me ngjyrim poetik. Mbi të gjitha mbizotëron stili humanist, ku e reflekton filozofinë e Rilindjes e në qendër është njeriu, ndjenjat dhe mendja e tij. Në aspektin stilistik “Dekameroni” shënon kalimin nga gjuha latine elitare në gjuhën popullore italiane.

Personazhet - janë të shumtë në secilën novelë, nga tregtarë, fshatarë, gra të mençura, burra të mashtruar, klerikë hipokritë, dashnorë të zjarrit etj. Disa janë figura reale ose të frymëzuar nga jeta e përditshme mesjetare. Vajzat janë shtatë, aq sa janë ditët e javës, aq sa ka planetë në qiell apo shkathtësi teologjike. Përmes personazheve të shumtë dhe ngjarjeve të rrëfyera, “Dekameroni” mbetet pasqyrë e jetës reale, pasioneve dhe mendësisë së njerëzve të kohës, por me vlera që mbeten universale edhe sot.

Fragmente tregimesh nga “Dekameroni”

RRËFENJA E PARË (Dita e dytë)

Martelini bën sikur është zënë ulok dhe sikur shërohet mbi kufomën e Shën Arrigos; kur merret vesh gënjeshtër e tij, kapet, kopaniset dhe rrezikohet të varet në litar; në fund fare shpëton nga çdo e keqe.

-Shumë herë, shoqe të dashura, ka ndodhur që kush ka dashur të tallet me tjetrin dhe sidomos me ndonjë nga ata që duhen adhuruar, ka mbetur i tallur dhe, ngandonjëherë, i dëmtuar për vete. Tani dua t'ju kallëzoj, e cila përputhet pikërisht edhe me temën që na ka caktuar mbretëresha. Do të shihni se qysh një bashkëqytetari ynë në fillim pësoi një fatkeqësi të madhe, pastaj, pa pasur asnjë shpresë, përfundoi në gëzim.

Pak kohë përpara në Trevizo ka qenë një gjerman i quajtur Arrigo, i cili i shtrënguar nga varfëria, robëronte duke mbartur në krahë gjërat e njerit e të tjetrit, që kishin nevojë. Po, me gjithë gjendjen e tij të keqe, të gjithë e njihnin si njeri fort të shenjtë dhe të mirë. Nga ky shkak, është e vërtetë ose jo, sipas thënieve të trevizonasve, kur i erdhi dita e vdekjes, në orën kur jepte e merrte për shpirt, qëlloi të bien vetë, pa i tundur njeri, të gjitha kambanat e kishës së madhe të Trevizos.

Kjo ngjarje u gjykua si një mrekulli. Të gjithë thoshin se Arrigoja ishte shenjt. Gjithë populli i qytetit u lëshua në shtëpinë ku gjendje kufoma e tij, që e morën si një trup të shenjtë dhe e shpunë te kisha e madhe Atje grahën të çalë, të verbër, të kruspulluar e të tjerë me gjithfarëlloj sëmundjesh e të gjymtë nga trupi, duke pandehur se do të shëroheshin me një të prekur të kësaj kufome.

RRËFENJA E GJASHTË (Dita e pestë)

Xhani di Proçidën e gjejnë me një vajzë që ai e donte e që ia kishin dhënë mbret Federigos, dhe e lidhin pas një huri tok me të për t'i djegur të gjallë. Mirëpo e njeh Ruxher del Oria, e kështu shpëton dhe martohet me vajzën.

Me të mbaruar rrëfenja e Neifilës, që u pëlqeu mjaft grave, mbretëresha iu drejtua Pampineas duke i thënë të tregonte diçka. Dhe ajo, si ngriti atë fytyrë të dëlirë, filloi:

E jashtëzakonshme, o gra hirplota, është forca e dashurisë që i shtyn të dashëruarit drejt mundimesh të mëdha e drejt rreziqesh të panumërta e të pa përfytyruara, sikundër mund të kuptohet nga tërë ato që u thanë edhe sot, edhe më parë. Megjithatë më pëlqen ta provoj këtë edhe me historinë e një djaloshi të dashëruar.

Në Iskia, një ujdhesë pranë Napolit, na rronte dikur një vajzë e re dhe mjaft e qeshur me emrin Restituta, që ishte e bija e një fisniku të ujdhesës të quajtur Marin Bullgari. Atë e dashuronte më fort se jetën e vet një djalosh me emrin Xhani, i cili banonte në një ujdhesë të vogël aty pranë Iskias të quajtur Proçida dhe dashurohej gjithashtu prej vajzës. Djaloshi

e kish bërë zakon të vinte për ta parë nga Proçida në Iskia jo vetëm ditën, por shpeshherë edhe natën, bile kur nuk gjente barkë, nisej me not, mjaft që ta shikonte në mos atë, së paku muret e shtëpisë së saj.

Në kohën kur ata dashuroheshin me kaq zjarr, ndodhi që vajza të dilte një ditë vere anës detit dhe tek bridhte fill e vetme shkëmb me shkëmb, duke shkëputur me thikë guaska nga gurët, të arrinte në një vend midis gumoresh, ku ca për hijen e këndshme e ca për ujët e akullit të një burimi, kishin ardhur me një fregatë që nga Napoli disa djelmosha sicilianë.

Këta, me ta parë këtë vajzë të bukur yll e fillikat të vetme, e cila ende s'i kishte vënë re, e ndanë mendjen ta rrëmbenin e ta merrnin me vete. Një të thënë, një të bërë. E rrëmbyen, pra, sado që ajo s'pushonte së thirruri, e hipën në barkë dhe ikën.

ANALIZË



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Si paraqitet shoqëria e kohës në veprën "Dekameroni" të Xhovani Bokaços?
- Cila është korniza rrëfimore e tregimeve?
- Si lidhen tregimet me njëri-tjetrin në anën logjike?
- Sa personazhe janë pjesë e tregimeve?
- Pse personazhet largohen nga Firenca?
- Sa tregime e përbëjnë veprën "Dekameroni"?
- Çfarë porosit përcjell Bokaço nëpërmjet veprës së tij?



SPROVË LETRARE:

- Përpikuni të shkruani një tregim, duke shënuar qartë: vendin, kohën dhe veprimin (ngjarjen)!
- Shkruani përshtypjet tuaja pas leximit të fragmenteve!

ROMANI KALORSIAK

Vepra “Don Kishoti” e Miguel de Servantesit, konsiderohet si romani i parë modern (me elemente të novelës së stilit të renesancës) në historinë e letërsisë botërore, për thellësinë e ideve, originalitetin artistik dhe forcën shpirtërore që mbart. Ka shërbyer si një pikë kthimi nga letërsia mesjetare drejt modernitetit, ku satirizohen idealet kalorësiake dhe përmes personazheve si Don Kishoti dhe Sanço Panço trajton kontrastin midis realitetit dhe iluzioneve.

Servantesi e pasqyron Spanjën e shekullit XVII, si një vend të ndarë mes shtresave, aristokracinë e shthurur dhe popullin e thjeshtë që mbijeton midis varfërisë dhe padrejtësisë. Për të treguar këtë absurditet shoqëror, nuk ndjek një strukturë klasike, por krijon një stil të ri ku përzihen: ironia, satira, realizmi dhe idealizmi, gjithmonë si një pikë bashkëveprimi të ndodhive komike, me tragjizmin dhe filozofinë e absurdit.

Vepra është kritikë ndaj romaneve kalorsiake, meditim mbi rolin e artit dhe të fantazisë në jetën njerëzore, si dhe **reflektim** mbi identitetin, lirinë dhe të vërtetën.

Përmbajtja e romanit e vendos në qendër konfliktin midis realitetit dhe ëndrrës që bartet nga Don Kishoti, individ i që simbolizon idealizmin e pastër, ëndrrën për një botë më të mirë, edhe në qoftë e paarritshme. Ai nuk është thjesht një karikaturë e kalorësit të mesjetës, por një figurë e ndërlikuar, tragjikomike dhe filozofike.

Fragment: “Don Kishoti”

KREU I

Në një fshat të Mançës, në Spanjë, na jetonte një burrë pesëdhjetëvjeçar, që ishte qejfli i madh pas shtijezës e mburojës së vjetër, pas kalit gërdallë dhe pas qenit të gjahut.

Hante mish lope, po edhe deleje, pastërma, pëllumba e më the të thashë, po s'ngopej kurrë, edhe pse për ushqim harxhonte treçerek të të ardhurave që merrte nga çifligu. Vishej me rroba lloj-lloj, nga më të mirat e më të kushtueshmet. Në shtëpi na mbante një kujdestare, një mbesë dhe një shërbyes që i bënte pazarin, i ruante arat dhe i vinte shalën kalit.

I fortë e i thatë si shkop prej thane, mburrej kudo se e kishte shumë qejf gjahun, edhe pse s'kishte vrarë asnjë mizë në jetën e vet. Po më shumë kishte qejf librat me aventura. Nga shkaku i tyre harronte të shkonte edhe për gjah... Aq qejf i kishte, sa herë pas here shiste pasurinë dhe blinte libra. Me një fjalë, e bënte rrush e kumbulla... I pëlqenin sidomos fjalitë e ngatërruara e lodrat e fjalëve, të cilat e linin krejt pa mend e pa gjuhë.

Me pak fjalë u ngatërrua aq keq me kësi farë librash, sa lexonte tërë natën, gjersa gdhihej, dhe tërë ditën, gjersa ngrysej. Nga ky shkak iu bë mendja dhallë, iu tha truri e iu bë dërrasë dhe e humbi gjykimin si Xhaferi simiten. Kështu iu mbush mendja se të gjitha përrallat që tregonin librat ishin të vërteta, aq sa nuk i luante as topi.

I trullosur kësisoj, vendosi të bëhej kalorës, të ngjishte armët, të hipte në kalë, t'i binte botës tejendane dhe të vinte në jetë gjithë ç'kishte lexuar, që të fitonte nam të madh e të ndreqte çdo padrejtësi. I ishte mbushur mendja top se për zotësinë e fuqinë që kishte duhej të ishte bërë të paktën perandor, prandaj gjeti ca armë të stërgjyshërve të tij, që i kishte mbuluar pluhuri e i kishte ngrënë ndryshku për vite e vite të tëra, aq sa s'mbahej mend. I pastroi e i meremetoi sa e si mundi. Edhe pse kishin të meta e mungesa dhe e tregonin qesharak kur i ngjeshte në trup. Pastaj shkoi te kali i tij i vjetër e gërdallë, i cili i dukej më i bukur e më i fortë se Bukefali i Aleksandrit të Madh.

Vrau e vrau mendjen sa e shtrydhi fare gjersa i gjeti një emër, që tingëllonte bukur për veshët e tij. E quajti Rosinant, pasi ai do të ishte më i pari dhe më i dëgjuari i gjithë gërdallave të botës. Pastaj vrau mendjen përsëri që të gjente një emër sa më të bukur e sa më madhështor për veten e vet dhe u vetëquajt Don Kishoti i Mançës, emër që, sipas tij, nderonte prejardhjen dhe vendin ku kishte lindur.

Si i mbaroi këto punë, vendosi të gjente një grua që t'i shkonte për shtat kalorësit, se përndryshe do të ishte si një zog pa krahë e si një pemë pa fletë.

Dhe e gjeti nusen. Ajo quhej Aldonza Lorenzo, por Don Kishoti e pagëzoi Dylqinja e Tobozës, se kështu emri tingëllonte më bukur, ashtu siç tingëllonte edhe emri i kalit të vet, Rosinantit.

KREU VIII

Prifti dhe berberi e vizituan Don Kishotin në shtëpinë e tij. E gjetën të dobësuar, sa lehtë mund ta merrje për mumie. Prifti, për të hequr tërë dyshimet e tij mbi mendjen e Don Kishotit në qe shëruar apo jo, e solli fjalën te punë shtetërore e ndër të tjera edhe tek ajo që sulltani i Turqisë kishte vënë tërë krishtërimin në ankth duke nxjerrë në det një flotë tepër të madhe, e cila s'dihej ç'qëllim kishte.

- Unë do t'i jepja një këshillë mbretit, - tha Don Kishoti, - atë më të duhurën për tani. Veç mbajeni sekret, që të mos bjerë në vesh të atyre që e këshillojnë e të më marrin meritën.

- Unë për vete betohem, - tha berberi.

- Po të besoj, se je njeri i ndershëm. Le të nxjerrë tellallët në tërë vendin e të lajmërojë kalorësit. Edhe një kalorës i vetëm do t'i bënte punë.

Prifti e berberi zgurdulluan sytë, duke kuptuar shume nga kjo "këshillë". Prifti tentoi sërish duke përmendur emra kalorësish e Angjelikën e bukur dhe Don Kishoti me përgjigjet e tij e tregoi përsëri se marrëzia nuk qe shëruar.

U dëgjuan zëra në oborr e të tre rendën jashtë, ku panë mbesën e kujdestaren të ziheshin me Sançon, se nuk donin ta linin brenda. Don Kishoti u bëri shenjë, ato heshtën e Sançoja hyri. U mbyllën të dy vetëm në dhomë e po bisedonin. Sançoja i tregoi çfarë thoshin të tjerët për të e marrëzinë e tij.



SPROVË LETRARE:

- Përshkruani botën ideale për të cilën ëndërronte Don Kishoti?
- Krijoni ese, me temë: "Një jetë më e mirë për mua dhe të tjerët"!

UILLIAM SHEKSPIRI

(1564 - 1616)

Uilliam Shekspir është një nga figurat më të rëndësishme dhe më të njohura të letërsisë botërore, i cili ka lënë gjurmë të pashlyeshme për kulturën dhe artin, respektivisht në dramaturgjinë dhe poezinë angleze.

Shekspiri lindi në vitin 1564, në Stratford, një qytet i vogël në Angli. Në vendlindje e mori shkollimin fillestar, ku i mësoi bazat e latinishtes, gramatikës dhe letërsisë klasike. Njohuritë e tij për letërsinë dhe dramaturgjinë janë të mëdha.

Krijimtaria letrare është e ndarë në tre kategori: tragjedi, komedi dhe drama historike, dhe është mjaft e pasur, me rreth 39 drama, 154 sonete dhe shumë poezi.

Veprat më të njohura: “Hamleti”, “Makbethi”, “Othello”, “Romeo dhe Zhulieta”, janë tragjedi që prezantojnë temën e dashurisë, hakmarrjes, tradhtisë dhe natyrën njerëzore. **Komeditë:** “Mbreti Lir” dhe “Një natë verore”, përmbajnë humor, ironi dhe situata të ndërlikuara reflektimi mbi marrëdhëniet njerëzore. **Dramat historike:** “Henri IV” dhe “Richard III” e shumë të tjera, trajtojnë ngjarje historike angleze dhe janë të pasura me figura të fuqishme dhe dialogë të zjarrtë.

Shekspiri vdiq në vitin 1616, në vendlindje (në moshën 52 vjeçare) dhe la pas një trashëgimi të pasur letrare që vazhdon të studiohet dhe të interpretohet në tërë botën. Kështjella e tij, tani është një muze dhe simbol i përjetësisë së veprës së tij.



Roli i Shekspirit në zhvillimin e teatrit dhe letërsisë angleze

Një shkrimtar i talentuar si Shekspiri, la gjurmë të rëndësishme edhe në teatrin anglez. Ai, nga forma e thjeshtë e argëtimit, e ngriti teatrin në një nivel të lartë, duke i dhënë strukturë të re dramatike, si kombinimin e tragjedisë me komedinë—tragjikomedia, si formë e re teatrore.

Temat që trajtoi janë universale: dashuria, xhelozia, intriga, ambicia, hakmarrja, pushteti... gjë që e bëri veprën e tij të përjetshme, të qëndrueshme në kohë dhe të vlerësuar botërisht.

Pasuria e gjuhës

Shkrimtari, me një pasuri të madhe veprash ndikon fuqishëm në zhvillimin e gjuhës, ashtu siç Shekspiri e begatoi gjuhën angleze me fjalë e shprehje të shumta, veçmas me stilin poetik, me sonetin dhe vargun e bardhë (blank verse), solli një nivel të ri të bukurisë dhe përshtatshmërisë gjuhësore në dramaturgji.

Thellimi i karaktereve - Ndërtimi psikologjik i karaktereve i dha një vend të veçantë veprës së Shekspirit (p.sh.: “Hamleti”, “Makbethi”, “Othello”), pasi solli shumë risi për kohën dhe ndikoi fort në mënyrën se si paraqiten personazhet në letërsi dhe në teatër.

Shekspiri, nuk ishte vetëm një dramaturg, por një themelues i letërsisë moderne angleze. Ai vendosi standarde të reja në artin e të shkruarit, ndikoi në zhvillimin e teatrit, ndikim ky që vazhdoi të ndihet në kulturën, gjuhën dhe mendimin letrar të shekujve që pasuan.

Po të krahasohet tragjedia e Shekspirit “Romeo dhe Zhulieta” (e njohur si tragjedia e dashurisë së ndaluar) me tragjeditë e antikitetit romak dhe grek, dalin një sërë ndryshimesh thelbësore, që ndajnë dy epoka letrare dhe dramatike.

Fragment: “Romeo dhe Zhulieta”

AKTI I Skena V

(Hyn Kapuleti, Zhulieta dhe pjestarë të tjerë të familjes duke u takuar me mysafirët disa prej të cilëve kanë maska; pastaj hyn Romeua i ndjekur prej shokëve të tjerë të maskuar).

KAPULETI: Mirse erdhët, zotërinj! Tani do losni

Me gra që s'kanë kallo nëpër këmbë.

Ah ha! moj zonja! Cila pra nga ju

Nuk ka për të pranuar të kërcejë?

Kush nuk pranon, betohem që ka kallo.

A, sju godita mu atje ku duhet?

Mirse erdhët zotërinj! Dikur edhe unë,

Si ju kam vënë maskë e përshpërisnja

Në vesh' e vashës bukur, fjalë t'ëmblla.

Po iku ajo kohë, iku, iku!

Mirse erdhët zotërinj! Tani pra nisni!

Filloni muzikantë! Hapni! Hapni!

Na hapni vënd, dhe hajde losni çupa!

(Muzika lot dhe vallja fillon)

Hej, djema, sillni shpejt edhe ca dritë!

Largoni bangot shuani dhe zjarrë!

Se dhoma u nxeh tepër. E mor zot,

Kjo lojë e pa pritur po shkon mirë.

I dashur kushëri, ti rri për dhe

Sepse për ne ka ikur koh' e valles.

Sa kohë shkoi që s'kemi vënë maskë?

SHËRBËTOR' i II: Për Shërmërinë, bëhen tridhjet vjet.”)

KAPULETI: Bah! Ç'thua? Jo, nuk bëhen kaqë shumë.

Ne kemi që nga dasma e Lunçetit,

Rushajet kur të vinë mbushen plot

Njëzetepesë vjet që s'vëmë maskë.

SHËRBËTOR' i II: Po bën më shumë; i biri është m'i

math, I biri ka arritur të tridhjetat.

KAPULETI: Ç'po flet, dy vjet më parë, ai ish nxënës.

ROMEUA: (Një shërbëtori)

Kush është ajo zonjë atje tej

Që po m'i ndrit në dorë atij kreshniku?

SHËRBËTORI: S'e di, or zot.

ROMENUA: Oh, shih edhe pishtarit

Ja shkon ajo në dritë e në shkëlqim!

Mbi faqe i ndrit natës si diamant

Siç ndrit mbi vesh t'arapit një brillant.

Kjo bukuri me dorë s'do përlyer

Se qënka shumë e shtrënjtë dhe e vyer.

Ndër shoqe ajo duket si ndër sorra

Kur hyn pëllumb'i bardhë si dëbora.

Do ta bashkoj kur vallja të pushojë

Dhe do' e saja timen të bekojë.

A thua se kjo zëmër nuk ka ndjerë

Një dashuri të saktë tjetër herë?



* * *

KAPULETI: Largohu! Kokë-gdhe! S'tu mbushka mendja?

Nga kjo lëvdatë ndofta humb dhe jetën.
S'të flas më kot, kërkon të kundërshtosh!
- Ju lumtë miqt' e mij! Më gjetë kohën!
Na qenke kakapër! Rri urtë, them,
Sepse për ndryshe... sillni dhe ca dritë
-Për turp të botës të bëj un t'urtë.
Hej, losni miqt' e mij!

TIBALTI: Kur ma frenon inatin detyrimi,
Më ngrihet lesht' e kokës nga tërbimi.
Po shkoj dhe atë çnderim q'e ëmbëlson,
la nxjerr nëpër hundë ca më vonë. (Del)

ROMEUA: (Zhulietës) Sikur ta ndyr me dorë këtë altar,

Si një besnik i urtë, bëj një faj,
Po buzën e kam gati si fetar
Me puthje t'ëmbël prapë të ta laj.

ZHULIETA: Fetar besnik, pse e fyen atë dorë
Që po më çfaq aq' ëmbël adhurim;
Edhe haxhiu tok dorën me shënjtore
Dhe si e tok e puth e merr bekim.

ROMEUA: Po buzë s'ka shënjtori siç ka duar?

ZHULIETA: Ka buzë për tu falur, o haxhi.

ROMENUA: Ahere tok dhe buzët pa nguruar
Dhe falu, shënjt, për gas dhe lumturi.

ZHULIETA: Shenjtori nuk lëviz po rri në vënt.

ROMEUA: Pra mos lëvis të marr bekimin tënt.
(E puth)

Kështu i laj mëkatet që kam bërë.

ZHULIETA: Ahere i mora unë që të tërë.

ROMEUA: Mëkat nga buza ime? Ç'fjal' e çmuar?
M'i jepni prapë (e puth prapë).

ZHULIETA: Puthke si i mësuar.

VAJA: Zonjë, të do jot-ëmë për një fjalë.

ROMEUA: Po cila është e ëma?

VAJA: A mor bir

E ëm' e saj është zonja e shtëpisë.

Dhe ç'zonjë e mirë, e mënçur dhe e sjellë!

Zot unë, ia kam rritur këtë çupë

Me të cilën zotrote kuvendonje.

Ja ku të thëm, ay që do ta marë,

Do këtë dhe kësmet të mbushë xhepin.

ROMEUA: Mos është vallë e bij' e Kapuletit?

Oh, çmim të shtrenjtë u dashka të paguej!

M'u bëka jeta ime borç i hasmit!

BENVOLI: Pra eni t'ikim, darka po mbaron.

ROMEUA: Ashtu më ngjan, prandaj jam turbulluar.

KAPULETI: Mos ikni kaqë herët, zotërinj

Se s'ka mbaruar darka jon' e varfër.

Ashtu? E pse po shkoni? Falemnderit;

Ju falnderoj të ndershëm zotërinj.

Natën e mirë. Sillni dhe ca dritë!

Ahere le të shkojmë për të fjetur.

Mor bir, për besë, qënka tepër von,

Po shkoj të fle.

(Dalin që të gjithë përveç ZHULIETËS dhe VAJES).

ZHULIETA: Pa eja, Vajë; cili është ay?

VAJA: Trashëgimtar' dhe biri i Tiberit.

ZHULIETA: Po ay që po del tani nga dera?

VAJA: Për besë, ay më ngjan' si i biri i Petrit.

ZHULIETA: Po aty prapa tij, që nuk këceu?

VAJA: S' e njoh.

ZHULIETA: Shko pyet. N'është i martuar,

M'u bëftë varri shtrat' i nusërisë.

VAJA: E quajnë Romeo, është Montag,

I vetmi bir i hasmit tënt të madh.

ZHULIETA: Nga kjo urrejtje e vetme për çudi,

Mu ngjallka sot e vetmja dashuri!

Ajo që pres më duket se s'do vijë,

Dhe ajo që s'pres më parë do të mbrijë!

Kjo dashuri me këtë armik të ndyrë,

Më ndjell në zemrën time një mënxyrë.

VAJA: Ç'po flet ashtu?

ZHULIETA: Një vjershë që mësova këtë çast

Nga një valltar kur losnja.

(Dikush thërret përbrënda). "Zhulietë"!

VAJA: Erdhëm, erdhëm!

Pra eja se të gjithë kanë shkuar (Dalin).

Komedia "Kopraci" - Molieri

Përmbajtja e shkurtër: Në komedinë "Kopraci", Molieri demaskon fuqinë shkatërruese të parasë dhe e godet koprracinë, si ves shumë i ulët njerëzor (antihuman) që ishte tipar karakteristik i borgjezisë në zhvillim. Ai e dënon si një ves me pasoja shumë negative për individin, familjen dhe shoqërinë.

Personazhi - Harpagoni, një njeri koprrac e fajdexhi që jetonte nën ethet e parave. Nga lakmia për paranë, ai e kishte humbur dinjitetin dhe ndjenjat prindërore, njëkohësisht edhe dashurinë e fëmijëve. Fëmijët, jo vetëm që nuk ndjenin kurrfarë dashurie për të, por edhe e urrenin. Harpagoni mbetet një nga figurat më negative, antipatik e dorështrenguar e njëkohësisht tepër qesharak, ndër më komikët që ka krijuar mendja dhe pena e komediografit francez Molierit, si dhe një nga dramaturgët më të mëdhenj botëror.

Fragment: "Kopraci", Molieri

Skena II

KLEANTI, ELIZA

KLEANTI. Sa gëzohem që po të gjej vetëm, motër!

Nuk më durohej sa të të shihja, se dua të të besoj një të fshehtë.

ELIZA. Folë, vëlla, po të dëgjoj, ç'ke për të më thënë?

KLEANTI. Shumë gjëra, motër, që përmbliken në këtë fjalë: dashuroj.

ELIZA. Dashuron?

KLEANTI. Po, dashuroj. Por para se të zgjatem më tej, e di që varem nga një baba dhe që - si bir i tij - jam i detyruar t'i nënshtrohem vullnetit të tij. E di që nuk duhet ta japim zemrën tonë pa marrë pëlqimin e atyre që na nxuarën në dritë; që perëndia i ka bërë ata zotër të dëshirave tona dhe që këto s'mund t'i përdorim veçse me urdhër të tyre. E di që ata, pasi nuk nxiten nga ndonjë pasion i çmendur, janë në gjendje të gabohen më pak se ne dhe ta shohim më qartë të mirën tonë; që i duhet besuar më shumë urtësisë së tyre se sa pasionit tonë të verbër; dhe që të nguturit që tregojmë ne të rinjtë mund të na përplasë nëpër gremina të rrezikshme. Po t'i them të gjitha këto, moj motër, që të mos marrësh mundimin e të m'thuash ti; sepse, në fund të fundit, dashuria ime nuk do të dëgjojë asgjë, dhe të lutem të mos më qërtosh aspak

ELIZA. A ja ke dhënë fjalën asaj që dashuron, vëlla?

KLEANTI. Jo, po e kam vendosur. Dhe po të lajmë-roj përsëri të mos përpiqesh të më ndrosh mëndjen me arësytetime.

ELIZA. Pse, vëlla, kaq tuafe më bën mua?

KLEANTI. Jo, motër, po ti nuk dashuron; nuk e njeh atë prangën e ëmbël që u ve zemrave tona dashuria e zjarrtë dhe dyshoj për urtësinë tënde në këtë rast.

ELIZA. Oh! vëlla. Le të mos flasim për urtësinë time. S'gjen njeri që të mos i mungojë, të paktën një herë në jetën e tij, e po të të hapja edhe unë zemrën, ndofta do të isha në sytë e tu shumë më pak e urtë nga ti.

KLEANTI. Ah! dashtë Zoti që edhe zemra jote si e imja...



ELIZA. Le të mbarojmë më parë punën tënde dhe më thuaj kush është ajo që dashuron ti.

KLEANTI. Një vajzë e re që banon prej pakë kohësh në lagjen tonë. Duket sikur ka lindur për t'u falur dashuri të gjithë atyre që e shohin. Natyra, moj motër, s'ka bërë krijesë më të dashur dhe unë u çmënda pas asaj qëkur e pashë. Quhet Marianë. Rron bashkë me nënën e saj plakë, që është pothuajse gjithmonë e sëmurë. Kjo vajzë e dashur përgjërohet aq shumë për të, sa s'mund ta marrësh me mend. I shërben, i qan hallin dhe e ngushëllon me një butësi që të prek thellë në zemër. Çdo punë që të bëjë, i bije një nur i këndëshëm sa s'ka dhe lëvizjet e saja janë tërheqëse e plot hijeshi. Është aq e ëmbël sa s'të bëhet t'ikësh, aq zemërmirë sa të bën borxhli, aq e ndershme sa të vjen ta adhurosh... Ah! moj motër, veç ta shikosh.

ELIZA. - Nga gjithë sa më tregove, vëlla, e marr me mend fare mirë dhe, për të kuptuar se si është, më mjafton që ti e dashuron.

KLEANTI. Kam dëgjuar nga të tjerët se nuk janë në gjendje fort të mirë dhe se me mundim të madh i përballojnë të gjitha nevojat. Merre me mend, motër, sa gëzim të madh ndjen njeriu kur ngre lart gjendjen ekonomike të asaj që dashuron; kur i jep tërthorazi ndonjë ndihmë të vogël për t'i lehtësuar hallat e jetesës një familjeje të ndershme. Mendo se sa i dëshpëruar që jam, pasi nga kopracia e tim eti, zemra ime nuk mund ta ndjejë e ta shijojë këtë gëzim; as, t'ia shprehë dot dashurinë e madhe që ushqen për të.

ELIZA. Po, e kuptoj fare mirë, vëlla, sa i madh është dëshpërimi yt.

KLEANTI. Ah! motër, është më i madh nga ç'mund të pandehet. Sepse, në fund të fundit, a ka gjë më të pashpirt nga ky kursim i ashpër që bëhet mbi kurrizin tonë. Nga kjo thatësi shpirtërore që na bën të lëngojmë? E ç'kuptim ka të kemi pasuri kur kjo nuk mund të na shërbejë në moshën më të bukur, kur jemi të detyruar, për të plotësuar nevojat më të ngutëshme, të mbytemi në borxh, e kur, për t'u veshur si duhet, jam i shtrënguar të kërkoj, bashkë me ty, ndihmën e tregëtarëve? Kam dashur të të flas, pra, që të më ndihmosh për t'i parë mendjen babajt për këto ndjenja që të çfaqja; e në qoftë se e shoh që s'bindet, kam vendosur të shkoj në vise të tjera me atë vajzë të dashur, në mëshirën e fatit tonë. Për këtë qëllim kam dërguar të kërkoj të holla borxh nga të katër anët. Në qoftë se punët e tua, motër, janë të njëjlojta me timet dhe po qe se u dashka që babaj t'i kundërshtojë dëshirat tona, do ta braktisim që të dy dhe do të shpëtojmë nga ajo tirani, ku na mban prej kohësh kopracia e tij e padurueshme.

ELIZA. - Vërtet që ai po na e bën përditë e më të ahme vdekjen e nënës të gjorë, dhe...

KLEANTI. - Po i dëgjoj zënë. Le të largohemi pak, sa t'i japim fund bisedës sonë dhe pastaj do të bashkojmë forcat tona e do të vijmë të sulmojmë karakterin e tij të ashpër.

ANALIZË



PËRFORCIM NJOHURISH:

- Përshkruani figurën e Shekspirit, cila ishte vendlindja e tij dhe gjendja e tij shoqërore?
- Sa e ndihmoi teatri për afirmimin e tij?
- Cilat janë veprat më të njohura të Shekspirit, ndaji ato sipas zhanrit!
- Cilët janë personazhet kryesore në tragjedinë “Romeo dhe Zhulieta”?
- Çfarë porosie (mesazhi) jep autori përmes tragjedisë!
- Si i luftoi Shekspiri dukuritë negative në shoqërinë e kohës?

- Si përshkruhet personazhi i Harpagonit, cili ishte vesi i tij?
- Si është marrëdhënia e Harpagonit me fëmijët, përshkruani arsyen kryesore?
- Pse Molieri e përdor ironinë dhe sarkazmin, çfarë dëshiron të vërë në pah me kritikën e tij?
- Cila është porosia kryesore që përcjell vepra “Koprraci”?
- Tipizoni virtytet dhe të metat e disa personazheve, duke u përqendruar në veprimet e tyre!



SPROVË LETRARE:

- Shkruani disa fjali, duke e përmbledhur në pak rreshta rëndësinë letrare të veprës së Shekspirit!
- Shkruani ese, me temë: “Paraja - burim i komedisë dhe i konfliktit në veprën “Koprraci” të Molierit!

TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA

Të shprehurit është aftësi thelbësore e njeriut, pasi përmes gjuhës ai shpreh mendime, ndjenja dhe qëndrime. Krijimtaria është aftësia për të sjellë forma dhe ide të reja, duke e bërë gjuhën më origjinale dhe shprehjen më tërheqëse. Në shkollë, në shoqëri dhe në jetën akademike, të shprehurit dhe krijimtaria janë të pandara. Të shprehurit është mënyra se si themi mendimet tona, ndërsa krijimtaria është mënyra se si e bëjmë këtë shprehje *më tërheqëse, më të veçantë dhe më me ndikim*. Siç shprehej Aristoteli, *qëllimi i fjalës është ta* bëjë të qartë mendimin, ndërsa Kadare e quante *fjalën armën më të fortë të njeriut*. Pra, përmes tyre, mendimi merr formë të qartë, ideja bëhet e kuptueshme dhe komunikimi fiton forcë ndikimi. Sa më i qartë, i logjikshëm dhe krijues të jetë të shprehurit, aq më i lehtë bëhet kuptimi dhe aq më i suksesshëm rezulton komunikimi në çdo situatë.

Thënie për të shprehurit:

- Aristoteli: *“Qëllimi i fjalës është ta bëjë të qartë mendimin”*.
- Ferdinand de Sosiri (gjuhëtar): *“Gjuha është forma e mendimit dhe të shprehurit është mënyra se si kjo formë bëhet e dukshme”*.
- Ismail Kadare: *“Fjala është arma më e fortë e njeriut, ajo që i jep kuptim ekzistencës së tij”*.

Thënie për krijimtarinë:

- Albert Ajnshtajni: *“Krijimtaria është inteligjenca që argëtohet”*.
- Migjeni: *“Fjalët janë të vdekura, por kur futet shpirti në to, lind arti”*.
- Gjergj Fishta: *“Arti i fjalës është dhuratë e mendjes dhe e zemrës”*.

PREZANTIMI ME GOJË DHE FJALIMI

Të shprehurit me gojë është një nga mënyrat më të zakonshme të komunikimit. Çdo ditë, në familje, në shkollë apo me shokët, ne e përdorim gjuhën për të shprehur mendime, ndjenja apo ide. Mirëpo, jo gjithmonë shprehemi në të njëjtën mënyrë. Ka raste kur gjuha është e lirë dhe e thjeshtë dhe raste të tjera kur kërkohet gjuhë më e kujdesshme, e rregullt dhe e argumentuar.

Kështu, të shprehurit me gojë realizohet në dy forma kryesore:

- **Formë të lirë (joformale)** - përdoret në biseda të përditshme, ku fjalia shpesh është më e shkurtër, fjalori më i thjeshtë dhe komunikimi më i afërt e miqësor. P.sh.: në një bisedë të lirë nxënësi thotë: *“Filmi ishte shumë i bukur (super)”*.

- **Formë të kujdesshme (formale)** - përdoret në situata publike, si fjalime, ligjërata apo debate, ku kërkohet gjuhë e pasur, argumentim i qartë dhe ndërtim logjik i mendimeve. Në një fjalim formal para klasës ai thotë: *“Filmi trajton me mjeshtëri temën e miqësisë dhe sfidat e rinisë, duke dhënë një mesazh me vlerë për të rinjtë e sotëm”.*

Fjalimi nuk është thjesht të flasësh para të tjerëve, por një komunikim i organizuar sipas një strukture të qartë. Ai duhet të ketë:

- **Hyrje** - ku paraqitet tema dhe qëllimi i fjalimit, duke tërhequr vëmendjen e dëgjuesve.
- **Pjesë kryesore** - ku shtjellohen idetë dhe jepen argumentet, të shoqëruara me shembuj bindës.
- **Përfundim** - ku mbyllet fjalimi me një përmbledhje të qartë dhe një mesazh që mbetet te dëgjuesit.

Model **fjalimi**: lexo dhe diskuto!

Tema: Hapat e parë në gjimnaz

Hyrja

Të dashur shokë dhe shoqe, të nderuar profesorë, sot fillojmë një kapitull të ri në jetën tonë shkollore - vitet e gjimnazit. Ky fillim është si një prag i ri në jetën tonë: nga njëra anë mbajmë pas kujtimet e shkollës fillore, ndërsa nga ana tjetër na pret një botë më e gjerë, me më shumë dije, përvoja dhe sfida.

Pjesa kryesore

Gjimnazi nuk është vetëm vazhdim i mësimi, por një hap më lart. Këtu nuk mjafton të dëgjosh e të mbash shënime; duhet të dish të pyesësh, të kërkosh dhe të ndërtosh mendimin tënd. Çdo orë mësimi është një mundësi për të mësuar diçka të re për botën dhe për veten tonë.

Po aq e rëndësishme është edhe shoqëria. Ne vijmë nga shkolla të ndryshme, por këtu bashkohemi në një klasë të vetme. Katër vitet e gjimnazit do të na japin kohë që ta kuptojmë e ta vlerësojmë më mirë njëri-tjetrin, të ndihmojmë e të përkrahemi, të ndajmë gëzime e vështirësi. Miqësitë që lindin në bankat e gjimnazit shpesh zgjasin një jetë të tërë.

Dhe së fundi, gjimnazi është urë drejt së ardhmes. Këtu do të mbledhim dije e përvoja që do të na ndihmojnë të zgjedhim rrugën tonë pas shkollës. Në këtë udhëtim nuk jemi vetëm: kemi pranë profesorët, kujdestaren dhe shokët, që na udhëheqin dhe na mbështesin.

Përfundimi

Të dashur bashkëmoshatarë, fillimi i gjimnazit është një udhëtim që sapo ka nisur. Le ta bëjmë këtë rrugë me kureshtje, me përkushtim dhe me besim te njëri-tjetri. Katër vitet që kemi përpara do të jenë sfida, por edhe dhuratë; le t'i jetojmë duke mësuar, duke ndarë dhe duke ndërtuar kujtime që do të na shoqërojnë përjetë.

Diskutim pas leximit të fjalimit

1. **Çfarë ndjesie ju krijoi ky fjalim?** A ju duket se pasqyron ndjenjat e një nxënësi që sapo ka filluar gjimnazin? Pse?
2. **Cila pjesë ju bëri më shumë përshtypje?** Hyrja, ku flitet për fillimin e ri, pjesa për shoqërinë, apo përfundimi? Jepni arsytet tuaja!
3. **A pajtoheni me mendimin se gjimnazi është një “urë drejt së ardhmes”?** Pse po ose pse jo? Sillni shembuj nga përvoja juaj ose nga pritjet që keni!
4. **Miqësitë e gjimnazit shpesh zgjasin gjithë jetën.** Si mendoni ju: çfarë e bën një miqësi të fortë dhe të qëndrueshme?
5. **Fjalimi flet edhe për mësuesit dhe kujdestaren.** Sipas jush, çfarë roli kanë ata në formimin e nxënësve gjatë katër viteve të gjimnazit?
6. **Po të ishit ju në vend të folësit, çfarë do të shtonit ose do të ndryshonit në këtë fjalim?**

Mos ngatërno!

- Të flasësh nuk është njësoj si të mbash fjalim. Biseda është e lirë; fjalimi kërkon strukturë, përgatitje dhe qëllim të qartë.

ESEJA

Eseja është një formë shkrimi e lirë, por jo e pakufizuar. Ajo kërkon nga autori të shprehë mendimin e vet për një temë të caktuar, duke dhënë qëndrime, arsye dhe shembuj për t'i mbështetur. Ndryshe nga një tregim apo një përshkrim, eseja nuk ka për qëllim vetëm të rrëfejë apo të japë imazhe, por të argumentojë. Për këtë arsye, ajo lidhet ngushtë me aftësinë e të menduarit kritik dhe të shprehjes së qartë.

Një ese e mirë duhet të ketë strukturë të rregullt:

- **Hyrje** - është pika e nisjes së tekstit. Këtu paraqitet tema dhe teza, pra mendimi kryesor që do të mbrohet në tekst. Hyrja duhet të tërheqë vëmendjen e lexuesit dhe të përgatisë terrenin për idetë që do të pasojnë.
- **Pjesë kryesore** - është zemra e esesë. Këtu autori zhvillon idetë e tij, paraqet argumente dhe i mbështet ato me shembuj. Argumentet duhet të lidhen natyrshëm njëri pas tjetrit, në mënyrë që mendimi të ecë qartë dhe pa ndërprerje.
- **Përfundim** - është pika e mbylljes. Këtu autori përmbledh idetë kryesore dhe shpreh qartë qëndrimin përfundimtar. Përfundimi duhet të jetë i shkurtër, i qartë dhe i fortë, në mënyrë që të lërë mbresë te lexuesi.

Eseja nuk është vetëm një detyrë shkrimore; ajo është ushtrim mendimi. Përmes saj, nxënësit mësojnë të rendisin idetë, të zgjedhin fjalët e duhura, të ndërtojnë fjali të qarta dhe të argumentojnë me logjikë. Një ese e mirë tregon jo vetëm sa di nxënësi për një temë, por edhe si mendon dhe si arrin ta bindë lexuesin me idetë e tij.

P.sh.: Nëse tema është **"Rëndësia e leximit për të rinjtë"**, në hyrje nxënësi mund të paraqesë idenë kryesore: *"Leximi është një pasuri që i jep dritë mendjes dhe shpirtit të njeriut."* Në pjesën kryesore ai shtjellon tri arsye: leximi sjell dije, ndihmon të menduarit kritik dhe pasuron gjuhën. Në fund, në përfundim, nxënësi mbyll me një mesazh të qartë: *"Një i ri që lexon është një i rritur i përgatitur për jetën."*

Model eseje: lexo dhe diskuto:

Tema: "Rëndësia e leximit për të rinjtë"

Hyrja

Leximi ka qenë gjithmonë një dritare e hapur drejt dijes dhe botës. Për një të ri, libri nuk është vetëm burim informacioni, por edhe udhëzues për jetën, mik në vetmi dhe frymëzim për të ardhmen. Në kohën kur interneti dhe teknologjia marrin kaq shumë vëmendje, leximi mbetet i pazëvendësueshëm.

Pjesa kryesore

Së pari, leximi e pasuron mendjen. Ai na mëson për historinë, shkencën, kulturën dhe përvoja të ndryshme të njerëzve në kohë dhe vende të largëta. Çdo libër hap horizonte të reja dhe na bën më të ditur.

Së dyti, leximi na mëson të mendojmë me logjikë dhe të shohim gjërat nga më shumë këndvështrime. Një roman, një ese apo një tregim na vendosin përballë situatave ku duhet të gjykojmë, të krahasojmë dhe të nxjerrim mësim. Ky është ushtrim i të menduarit kritik, që na ndihmon edhe në jetën e përditshme.

Së treti, leximi e pasuron gjuhën dhe shprehjen. Përmes librave mësojmë fjalë të reja, mënyra të bukura të të thënit dhe forma të ndryshme stili. Kështu, bëhemi më të aftë të flasim dhe të shkruajmë qartë e bukur.

Përfundimi

Në përfundim, leximi nuk është vetëm një zakon i mirë, por një domosdoshmëri për çdo të ri që dëshiron të ndërtojë një të ardhme të sigurt. Një i ri që lexon jo vetëm që mëson më shumë, por edhe jeton më pasur, sepse leximi e bën mendjen më të lirë dhe shpirtin më të gjerë.

Diskutim pas leximit të esesë:

1. Si ju duket hyrja e kësaj eseje? A jua tërhoqi vëmendjen?
2. Cili prej argumenteve ju duket më bindës: ai për pasurimin e mendjes, për të menduarit kritik apo për gjuhën? Pse?
3. A pajtoheni me mendimin se “leximi është i pazëvendësueshëm edhe në kohën e internetit”? Sillni arsyet tuaja!
4. Si do ta ndryshonit ju përfundimin e esesë? Çfarë mesazhi do të shtonit?
5. Shkruani një paragraf të shkurtër ku tregoni një përvojë tuajën me një libër që ju ka bërë përshtypje!

Mos ngatërro!

- **Opinion** është vetëm një mendim personal, i thënë shkurt.
 - ▶ Një nxënës mund të thotë: “Më pëlqen muzika”.
- **Argument** është arsyeja që e mbështet këtë mendim dhe e bën më bindës.
 - ▶ I njëjti nxënës mund të shtojë: “Sepse muzika më qetëson, më ndihmon të përqendrohem dhe më jep frymëzim”.

Të shkruarit krijues

Të shkruarit krijues përfaqëson përdorimin artistik të gjuhës, ku fjala nuk kufizohet vetëm në dhënien e informacionit, por shndërrohet në mjet të shprehjes së mendimeve, ndjenjave dhe përjetimeve estetike. Kjo formë shkrimi nxit origjinalitetin dhe përdor teknika të veçanta për të ndërtuar tekste që mbartin kuptim të thellë dhe forcë shprehëse. Në letërsinë shqipe dhe botërore, të shkruarit krijues shfaqet në dy rrafshe kryesore: **prozë dhe poezi**.

Në **prozë**, krijimtaria shfaqet përmes tregimeve të shkurtra, novelave, romaneve ose përshkrimeve. Teksti ndërtohet mbi një strukturë të brendshme (hyrje, zhvillim, përfundim) dhe synon të shpalosë ngjarje, personazhe dhe situata që pasqyrojnë jetën reale ose botën e imagjinatës.

Në **poezi**, gjuha përqendrohet dhe fiton intensitet estetik përmes ritmit, rimës dhe figuracionit letrar. Poezia ka zhvilluar gjatë shekujve forma të rregulluara, të cilat kanë shërbyer si modele krijimtarie dhe si mënyra të përsosura të shprehjes poetike. Ndër më të njohurat janë:

Soneti

Soneti është poezi me 14 vargje, e strukturuar zakonisht në dy katrena dhe dy tercina. Ai përfaqëson një ndër format më të disiplinuar të poezisë evropiane, ku ndjenja dhe refleksioni filozofik bashkohen me formën e rreptë. Në traditën shqiptare, **Ndre Mjeda** është ndër poetët që ka shkruar sonete të spikatura, si “Andrra e jetës”, ku struktura e qëndrueshme shërben për të përforcuar thellësinë e mendimit.

Gazeli

Gazeli është poezi lirike me origjinë nga letërsia orientale, e karakterizuar nga refreni dhe rimat e përsëritura. Secili varg është i pavarur në kuptim, por lidhet me të tjerët përmes ritmit dhe figuracionit të përbashkët. Në shqip, forma e gazelit u zhvillua nga poetët e bejtexhinjve, ndër të cilët veçohet **Nezim Frakulla**, që solli në gjuhën shqipe motive të dashurisë, mallit dhe meditimeve shpirtërore.

Balada

Balada është poezi rrëfyese ku ngjarja epike ndërthuret me emocionin lirik. Ajo mbart shpesh tone dramatike dhe trajton tema universale si dashuria, ndarja, sakrifica ose tragjedia njerëzore. Letërsia popullore shqiptare është e pasur me balada, si “Balada e Doruntinës” dhe “Balada e Konstandinit”, të cilat dëshmojnë fuqinë artistike të folklorit për të shndërruar ngjarjet dhe besimet e vjetra në art poetik.

Haiku

Haiku është poezi japoneze e përbërë nga vetëm 17 rrokje, të ndara sipas modelit 5–7–5. Pavarësisht gjatësisë së shkurtër, ajo arrin të përqendrojë një çast të vetëm të natyrës ose të jetës dhe ta shndërrojë atë në imazh poetik me ngarkesë simbolike. Në letërsinë shqipe bashkëkohore, **Moikom Zeqo** ka kultivuar poezi të ngjashme me haikun, ku përmes pak vargjeve pasqyrohen përjetime të fuqishme poetike.

Shembull haiku:

*Çel lulja e parë,
dielli ngroh tokën e ftohtë,
gjallërohet jeta.*

Mos ngatërro!

Dallimi mes prozës dhe poezisë nuk qëndron vetëm në formën e jashtme. Poezia rregullohet nga ritmi, figura dhe simbolika, ndërsa proza është më e lirshme dhe e afërt me gjuhën e përditshme. Çdo formë poetike ka rregullat e veta: soneti mbështetet te numri dhe ndarja e vargjeve, gazeli te refreni dhe rimat e përsëritura, balada te rrëfimi dramatik, ndërsa haiku te përqendrimi i çastit.

Të mos harrojmë

- Të shprehurit me gojë ndahet në joformal (i lirë, në bisedat e përditshme) dhe formal (i kujdesshëm, në fjalime e paraqitje publike).
- Fjalimi formal ka gjithmonë hyrje, zhvillim dhe përfundim.
- Eseja është shkrim i lirë në ide, por i rregulluar në strukturë.
- Paragrafi është bërthama e tekstit: pa të, mendimi humbet qartësinë.
- Poezia ndryshon nga proza jo vetëm nga forma, por nga ritmi, figurat dhe kuptimet e saj të fshehta.
- Soneti, gazeli, balada dhe haiku janë forma të njohura poetike me rregulla të veçanta.
- Të shprehurit dhe krijimtaria e forcojnë gjuhën, mendimin dhe shijen estetike.

Kuptimi i fjalëve të neja

- **Tezë** - mendimi themelor që përcakton drejtimin e një teksti argumentues.
- **Argument** - arsye e ndërtuar logjikisht që mbështet ose vërteton një tezë.
- **Paragraf** - njësi ndërtimore e tekstit, ku përmbledhet një ide përmes fjalisë kryesore, shtjellimit dhe përmbylljes.
- **Fjalim** - formë e të shprehurit publik, e organizuar sipas një strukture të qartë dhe me qëllim bindës ose informues.
- **Sonet** - poezi e rregullt me 14 vargje, që ndërthur mendimin filozofik me ndjeshmërinë lirike.
- **Gazel** - poezi lirike me origjinë orientale, e ritmuar përmes refrenit dhe rimës së përsëritur, që shpreh shpesh dashuri dhe mall.
- **Baladë** - poezi rrëfyese që ndërthur elemente epike dhe lirike, duke dhënë një ngjarje me ngarkesë dramatike dhe ndjesore.
- **Haiku** - poezi japoneze e shkurtër, me vetëm 17 rrokje, që përqendron një çast të natyrës ose të jetës në imazh poetik.

QASU

Informohu
nga burime
të ndryshme



ANALIZO

Kupto mesazhet,
gjuhën, qëllimin
dhe kontekstin




VLERËSO

Vlerëso besueshmërinë
e burimit dhe
dëshmitë



MENI
KRIK





DALLO

Dallo informacionin
e saktë nga
dezinformimi


KUPTO NDIKIMI

Kupto si ndikon
media tek ne dhe
shoqëria

Njohuri mediatike

KRIJO
Përdor mediat
në të komunikuar
në mënyrë të saktë

DO
ISHT





NJOHURI MEDIATIKE

Shoqëria moderne shpesh quhet **shoqëri e informacionit**, sepse çdo ditë përballet me sasi të madhe lajmesh, imazhesh dhe mesazhesh. Nga televizioni dhe radioja, te gazetatat, interneti dhe rrjetet sociale, mediat ndikojnë në mënyrën si mësojmë, si mendojmë dhe si marrim vendime. Në këtë mjedis të mbingarkuar me informacione, njohuritë mediatike janë të domosdoshme. Ato na ndihmojnë:

- të dallojmë faktet nga opinionet,
- të kuptojmë burimet e informacionit,
- të verifikojmë saktësinë e lajmeve,
- të njohim paragjykimet dhe manipulimet,
- të mbrohem nga dezinformata, lajmet e rreme dhe gjuha e urrejtjes.

Fakte dhe opinione

Kur lexojmë lajme, jo çdo fjali duhet marrë si fakt. Disa janë të verifikueshme dhe të qëndrueshme, ndërsa disa të tjera janë thjesht mendime apo komente. Për këtë arsye, është e rëndësishme të dimë dallimin mes faktit dhe opinionit.

- Fakti është informacion i saktë, që mund të kontrollohet dhe të vërtetohet. Ai mbetet i njëjtë, pavarësisht se kush e lexon.
 - ▶ P.sh.: *“Shqipëria shpalli pavarësinë më 28 nëntor 1912”*. Ky është një fakt historik i pranuar nga të gjithë.
- Opinioni është mendim personal mbi një fakt, ngjarje ose dukuri. Opinioni ndryshon nga një person tek tjetri dhe nuk mund të provohet si i vërtetë.
 - ▶ P.sh.: *“Pavarësia e Shqipërisë është ngjarja më e rëndësishme e historisë shqiptare”*. Ky është mendim, sepse dikush tjetër mund ta shohë një ngjarje tjetër si më të rëndësishme.

 Në media shpesh gjejmë lajme që ndërthurin fakte dhe opinione. Lexuesi i vëmendshëm duhet t'i dallojë ato.



Mos ngatërro!

- Faktet janë të vërtetueshme; opinionet janë mendime personale.
- Lajmi përmban fakte; komentet e gazetarit janë opinione.

Burimet e informacionit

Kur lexojmë ose dëgjojmë një lajm, gjithmonë duhet të pyesim: nga e ka marrë gazetari ose autori këtë informacion? Burimet e informacionit dallojnë nga njëri-tjetri dhe nuk e kanë të njëjtin nivel të besueshmërisë. Për të gjykuar drejt, duhet të dimë dallimet mes tyre:

- Media zyrtare (televizioni publik, agjencitë shtetërore të lajmeve) mbajnë përgjegjësi të madhe për saktësinë e lajmeve.
- Media private (gazeta, televizione, portale) shpesh janë më të shpejta dhe dinamike, por ndonjëherë ndikohen nga interesa politike apo ekonomike.
- Blogjet dhe rrjetet sociale japin liri të madhe shprehjeje. Megjithatë, jo gjithmonë kontrollohet vërtetësia e informacionit, prandaj duhet kujdes.
- Burimet shkencore (libra, raporte, studime) janë më të qëndrueshme dhe zakonisht më të besueshme, sepse kalojnë nëpër procese kontrolli dhe recensimi.

👉 Shembull: Pas një tërmeti, media zyrtare jep të dhëna shkencore mbi magnitudën, ndërsa në rrjete sociale mund të qarkullojnë fotografi të pasakta ose thashetheme.

Vërtetimi i fakteve

Në epokën e internetit, lajmet shpërndahen me shpejtësi, por jo gjithmonë janë të sakta. Prandaj duhet të mësojmë t'i verifikojmë faktet:

- Kush e publikoi informacionin?
- A është burim i besueshëm?
- A jepen të dhëna konkrete (data, emra, statistika)?
- A e konfirmojnë lajmin edhe burime të tjera të pavarura?

👉 Shembull: Nëse lexojmë në një portal lajmin “*Shkollat mbyllen për dy javë*”, duhet të shohim në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit. Nëse atje nuk ka njoftim, lajmi është i rremë.

Paragjykimi dhe manipulimi

Mediat nuk e pasqyrojnë gjithmonë realitetin në mënyrë të plotë. Nganjëherë përdorin gjykime të njëanshme, e nganjëherë e shtrembërojnë informacionin qëllimisht. Duhet të dimë dallimin mes paragjykimit dhe manipulimit.

- Paragjykimi është mendim i rrënjosur, i formuar pa fakte të plota.
 - ▶ Shembull: “*Nxënësit gjithmonë janë dembelë.*” Ky është paragjykim, sepse nuk mbështetet në të dhëna.
- Manipulimi është përdorim i qëllimshëm i informacionit për të ndikuar te njerëzit. Shpesh bëhet për interes politik ose ekonomik.

- ▶ Shembull: Një gazetë vendos titullin “*Të rinjtë braktisin shkollën*”, edhe pse në tekst flitet vetëm për disa raste të rralla. Titulli e ekzagjeron për të tërhequr lexuesit.

👉 Lexuesi duhet të mësojë të dallojë se kur një tekst është paragjykes dhe kur synon manipulim të qëllimshëm.

Dezinformatë dhe lajmet e rreme

Jo të gjitha lajmet e pavërteta lindin nga pakujdesia. Ka raste kur ato shpërndahen qëllimisht për të mashtruar ose për të ndikuar te opinioni publik. Në këtë rast kemi të bëjmë me dezinformata dhe lajme të rreme.

- Dezinformata është informacion i rremë, i shpërndarë me qëllim mashtrimi. Ajo përdoret shpesh për të ndikuar te opinioni publik.
- Lajmet e rreme (“fake news”) janë lajme të shpikura, që shpesh kanë si qëllim klikimet, fitimin ose ndikimin politik.

👉 P.sh.: Një portal publikoi lajmin “Aksh (filan) këngëtar i famshëm ka vdekur”, megjithëse në realitet këngëtarit nuk kishte ndodhur një gjë e tillë. Lajmi ishte shpikur vetëm për të tërhequr vizitorë në faqe.

Manipulimi me imazhe dhe video

Me teknologjinë e sotme, është shumë e lehtë të falsifikosh një fotografi ose një video. Pamjet vizuale janë shumë të fuqishme, sepse ndikojnë menjëherë te shikuesi. Por, pikërisht kjo fuqi i bën ato të përdoren për mashtrim.

- Fotografi të montuara – imazhi ndryshohet për të krijuar një përshtypje të rreme.
- Video të falsifikuara (“deepfake”) – teknologjia kompjuterike krijon video ku dikush duket sikur thotë ose bën diçka që nuk e ka thënë kurrë.

👉 P.sh.: Një video e një politikani shpërndahet në rrjet dhe krijon bujë, por më pas del se është e krijuar me programe speciale.

Debatet online (“online”) dhe gjuha e urrejtjes

Rrjetet sociale janë bërë vend ku njerëzit shkëmbejnë ide, komentojnë dhe debatojnë. Ato japin mundësi të shprehësh mendimin lirshëm dhe të marrësh pjesë në diskutime publike. Megjithatë, krahas mundësive, ekzistojnë edhe rreziqe.

- Debatet konstruktive mbështeten në fakte dhe argumente. Ato ndihmojnë në shkëmbimin e ideve.

- Debatet jo konstruktive shpesh degjenerojnë në fyerje.
- Gjuha e urrejtjes është përdorimi i shprehjeve fyese ose diskriminuese ndaj një personi ose një grupi për shkak të gjinisë, fesë, kombësisë, racës etj. Ajo e dëmton shoqërinë dhe shpesh ndalohej edhe me ligj.

👉 Shembull: Komentet fyese ndaj emigrantëve janë formë e gjuhës së urrejtjes dhe nuk ndihmojnë në debatin shoqëror.



A e dini se...?

- Termi **lajme të rreme ("fake news")** është përdorur për herë të parë në fund të shekullit XIX në SHBA, për lajme të shpikura që risnin shitjet e gazetave.
- Në vitin 1835, një gazetë e Nju Jorkut botoi artikuj për "jetën në Hënë", duke përshkruar qenie imagjinare që nuk ekzistonin. Ky mashtrim u quajt **Gënjeshtër e Madhe për Hënë (The Great Moon Hoax)**.
- Edhe sot, lajmet e rreme përhapen shpejt, sepse ngjallin emocione dhe tërheqin lexues.



Të mos harrojmë!

- Faktet janë të kontrollueshme; opinionet janë mendime personale.
- Burimet e informacionit nuk janë të gjitha të besueshme.
- Verifikimi i lajmit është thelbësor.
- Paragjykimi është mendim i njëanshëm; manipulimi është mashtrim i qëllimshëm.
- Dezinformata dhe lajmet e rreme përhapen për manipulim.
- Imazhet dhe videot mund të falsifikohen.
- Debatet online duhen bërë me kulturë; gjuha e urrejtjes është e rrezikshme.



Sa kuptove?

1. Jep një shembull fakti dhe një shembull opinion.
2. Përmend tri burime informacioni dhe shpjego cili është më i besueshëm.
3. Si mund të verifikojmë një lajm të lexuar në internet?
4. Çfarë është paragjykimi dhe si ndryshon nga manipulimi?
5. Jep një shembull të një lajmi të rremë.
6. Çfarë është një video e falsifikuar "deepfake"?
7. Si dallohen debatet konstruktive nga gjuha e urrejtjes?

**Kuptimi i fjalëve të reja**

- **Blog** – faqe interneti personale ose grupe me mendime dhe lajme, shpesh pa verifikim.
- **Burim informacioni** – vendi ose mjeti nga merret një lajm (media, portale, blogje, rrjete sociale, libra).
- **Dezinformatë** – informacion i rremë për mashtrim.
- **Lajme të rreme (fake news)** – lajme të shpikura për klikime ose për ndikim politik.
- **Paragjykim** – mendim i njëanshëm, pa fakte të plota.
- **Manipulim** – përdorim i qëllimshëm i informacionit për mashtrim.
- **Video e falsifikuar “deepfake”** – video e falsifikuar me teknologji kompjuterike.
- **Gjuha e urrejtjes** – shprehje fyese ose diskriminuese ndaj një grupi.

**Ushtrime****1. Lexo një lajm nga gazeta dhe dallo faktet nga opinionet. P.sh.:**

- Fakt: “Qeveria ka miratuar një ligj të ri për arsimin.”
- Opinion: “Ky ligj është i vonuar dhe nuk do të sjellë ndryshime të mëdha.”

👉 Ky ushtrim ju ndihmon të dalloni midis informacionit të vërtetuar dhe mendimit personal.

2. Krahasoni të njëjtën ngjarje në një media zyrtare dhe një blog. Çfarë ndryshon?

- Media zyrtare: “Në kryeqytet sot u hap një shkollë e re, e cila do të presë 500 nxënës.”
- Blog: “Shkolla e re është hapur, por mendoj se nuk do të ketë kushte të mira.”

👉 Ky ushtrim ju ndihmon të shihni ndryshimin mes burimeve të besueshme dhe opinionëve personale.

3. Gjej në internet një fotografi ose video të manipuluar dhe shpjego pse është mashtruese. (Për orientim, shihni shembujt e dhënë.)

- Shembull: Një fotografi e montuar sikur një person ka marrë pjesë në një protestë.
- Shpjegim: Fotografia krijon një përshtypje të rreme, sepse personi në të vërtetë nuk ka qenë aty.

👉 Ky ushtrim ju ndihmon të kuptoni si funksionon manipulimi vizual.

4. Diskutoni: “Si të mbrohemi nga lajmet e rreme?”

- Kontrolloni burimin.
- Krahasoni lajmin me disa media.
- Mos e shpërndani lajmin pa u siguruar.

👉 Ky ushtrim ju ndihmon të përforconi aftësinë për të verifikuar fakte.



Ushtrime

5. Në fletore shkruaj një lajm të shkurtër vetëm me fakte, pa opinione. (Për orientim, shihni shembujt e dhënë.)

- Shembulli 1: *“Më 21 qershor 2025, në Tetovë u zhvillua Panairi i Librit, ku morën pjesë 40 shtëpi botuese dhe 200 autorë.”*
- Shembulli 2: *“Më 21 tetor 2025, në Tiranë u hap Panairi i Librit, ku morën pjesë mbi 100 shtëpi botuese shqiptare dhe të huaja. Gjatë panairit u organizuan 50 aktivitete kulturore.”*

 Ky ushtrim ju mëson të shkruani duke ndarë informacionin faktik nga komentet.

6. Jep një shembull të gjuhës së urrejtjes dhe shpjego pse është e dëmshme. (Për orientim, shihni shembujt e dhënë.)

- Shembulli 1: *“Emigrantët janë fajtorë për problemet tona.”*
- Shembulli 2: *“Të gjithë të rinjtë që i përdorin rrjetet sociale janë dembelë dhe nuk lexojnë libra.”*
- Shpjegim: Të dy shembujt janë gjuhë urrejtjeje, sepse etiketojnë grupe të tëra njerëzish pa dallim dhe krijojnë ndasi shoqërore.

 Ky ushtrim ju ndihmon ta kuptoni rrezikun e përdorimit të gjuhës së urrejtjes si në hapësirën publike, ashtu edhe në komunikimin nëpërmjet internetit, pra komunikimin onlajn.

DO KETE CIP TE RI!

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

37.016:821.18(075.3)

SULEJMANI, Berton
GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, PËR VITIN I, ARSIMI I GJIMNAZIT /
Berton Sulejmani, Zejnepe Rexhepi. - Tetovë :
Arbëria Design, 2025. - 288 faqe. : илустр. ; 24 см

ISBN 978-608-236-490-2

1. Rexhepi, Zejnepe [автор]

COBISS.MK-ID 66741253

ISBN 978-608-236-500-8



9 786082 365008

www.arberiabooks.info